- καὶ ἄνθρωπος ὃς ἂν πατάξῃ ψυχὴν ἀνθρώπου καὶ ἀποθάνῃ θανάτῳ θανατούσθω
- 18 Kush rreh për vdekje një kafshë, do ta paguajë: jetë për jetë.
- And anyone wounding a beast and causing its death, will have to make payment for it: a life for a life.
- καὶ ὃς ἂν πατάξῃ κτήνος καὶ ἀποθάνῃ ἀποτεισάτω ψυχὴν ἀντι ψυχῆς
- 19 Kur dikush i shkakton një dëmtim fqinjit të tij, ai do të pësojë po atë që i ka bërë tjetrit;
- And if a man does damage to his neighbour, as he has done, so let it be done to him;
- καὶ ἐὰν τις δῶ μῶμον τῷ πλησίον ὡς ἐποίησεν αὐτῷ ὡσαύτως ἀντιποιηθήσεται αὐτῷ
- 20 thyerje për thyerje, sy për sy, dhëmb për dhëmb; ai do të pësojë po atë gjymtim që u ka shkakuar të tjerëve.
- Wound for wound, eye for eye, tooth for tooth; whatever damage he has done, so let it be done to him.
- σύντριμμα ἀντι συντρίμματος ὀφθαλμὸν ἀντι ὀφθαλμοῦ δόντα ἀντι δόντος καθότι ἂν δῶ μῶμον τῷ ἀνθρώπῳ οὕτως δοθήσεται αὐτῷ
- 21 Kush rreh për vdekje një kafshë, do ta paguajë; por ai që ia heq jetën një njeriu do të vritet.
- He who puts a beast to death will have to make payment for it; he who puts a man to death will himself be put to death.
- ὃς ἂν πατάξῃ ἄνθρωπον καὶ ἀποθάνῃ θανάτῳ θανατούσθω

- 22 Do të keni të njëjtin ligj për të huajin dhe për atë që ka lindur në vend; sepse unë jam Zoti, Perëndia juaj&quot;;  
 You are to have the same law for a man of another nation living among you as for an Israelite; for I am the Lord your God.  
 δικαιοσύνη μία ἔσται τῷ προσηλῶτῳ καὶ τῷ ἐγγωρίῳ ὅτι ἐγὼ εἰμι κύριος ὁ θεὸς ὑμῶν
- 23 Pastaj Moisiu u foli bijve të Izraelit, të cilët e çuan jashtë kampit atë blasfemues dhe e vranë me gurë. Kështu bijtë e Izraelit vepruan ashtu si e kishte urdhëruar Zoti Moisiun.  
 And Moses said these words to the children of Israel, and they took the man who had been cursing outside the tent-circle and had him stoned. The children of Israel did as the Lord gave orders to Moses.  
 καὶ ἐλάλησεν μοῦσῆς τοῖς υἱοῖς ἰσραὴλ καὶ ἐξήγαγον τὸν καταρασάμενον ἔξω τῆς παρεμβολῆς καὶ ἐλιθοβόλησαν αὐτὸν ἐν λίθοις καὶ οἱ υἱοὶ ἰσραὴλ ἐποίησαν καθὰ συνέταξεν κύριος τῷ μοῦσῃ
- 1 Zoti i foli akoma Moisiut në malin Sinai, duke i thënë:  
 And the Lord said to Moses on Mount Sinai,  
 καὶ ἐλάλησεν κύριος πρὸς μοῦσῃν ἐν τῷ ὄρει σιναι λέγων
- 2 &quot;Folu bijve të Izraelit dhe u thuaj atyre: Kur do të hyni në vendin që unë po ju jap, toka do të respektojë një të shtunë pushimi për Zotin.  
 Say to the children of Israel, When you come into the land which I will give you, let the land keep a Sabbath to the Lord.  
 λάλησον τοῖς υἱοῖς ἰσραὴλ καὶ εἰπὲς πρὸς αὐτούς ἐὰν εἰσέλθῃτε εἰς τὴν γῆν ἣν ἐγὼ δίδωμι ὑμῖν καὶ ἀναπαύσεται ἡ γῆ ἣν ἐγὼ δίδωμι ὑμῖν σάββατα τῷ κυρίῳ
- 3 Gjashtë vjet me radhë do të mbjellësh arën tënde, gjashtë vjet me radhë do të krasitësh vreshtin tënd dhe do të mbledhësh prodhimet;  
 For six years put seed into your land, and for six years give care to your vines and get in the produce of them;  
 ἕξ ἔτη σπερεῖς τὸν ἀγρὸν σου καὶ ἕξ ἔτη τεμεῖς τὴν ἀμπελὸν σου καὶ συνάξεις τὸν καρπὸν αὐτῆς
- 4 por viti i shtatë do të jetë një e shtunë pushimi për tokën, një e shtunë për nder të Zotit; nuk do të mbjellësh as arën tënde, as do të krasitësh vreshtin tënd.  
 But let the seventh year be a Sabbath of rest for the land, a Sabbath to the Lord; do not put seed into your land or have your vines cut.  
 τῷ δὲ ἔτει τῷ ἑβδόμῳ σάββατα ἀναπαύσεις ἔσται τῇ γῇ σάββατα τῷ κυρίῳ τὸν ἀγρὸν σου οὐ σπερεῖς καὶ τὴν ἀμπελὸν σου οὐ τεμεῖς
- 5 Nuk do të korrësh atë që rritet vetvetiu në prodhimin tënd dhe nuk do të vjelësh rrushin e vreshtit të pakrasitur; do të jetë një vit pushimi për tokën.  
 That which comes to growth of itself may not be cut, and the grapes of your uncared-for vines may not be taken off; let it be a year of rest for the land.  
 καὶ τὰ αὐτόματα ἀναβαίνοντα τοῦ ἀγροῦ σου οὐκ ἐκθερῖσεις καὶ τὴν σταφυλὴν τοῦ ἀγιάσματος σου οὐκ ἐκτρύγῃσεις ἐνιαυτὸς ἀναπαύσεως ἔσται τῇ γῇ
- 6 Atë që toka do të prodhojë gjatë pushimit të saj do të shërbejë si ushqim për ty, për shërbëtorin ose shërbëtoren, për punëtorin tënd dhe për të huajin, me një fjalë për ata që banojnë me ty,  
 And the Sabbath of the land will give food for you and your man-servant and your woman-servant and those working for payment, and for those of another country who are living among you;  
 καὶ ἔσται τὰ σάββατα τῆς γῆς βρώματά σοι καὶ τῷ παιδί σου καὶ τῇ παιδίσκῃ σου καὶ τῷ μισθωτῷ σου καὶ τῷ παροίκῳ τῷ προσκεκλιμένῳ πρὸς σέ
- 7 për bagëtinë dhe kafshët që ndodhen në vendin tënd; tërë prodhimi i saj do të shërbejë si ushqim i tyre.  
 And for your cattle and the beasts on the land; all the natural increase of the land will be for food.  
 καὶ τοῖς κτήνεσιν σου καὶ τοῖς θηρίοις τοῖς ἐν τῇ γῇ σου ἔσται πᾶν τὸ γένημα αὐτοῦ εἰς βρώσιν
- 8 Gjithashtu do të llogaritësh për vete shtatë të shtuna vitesh: shtatë herë shtatë vjet; këto shtatë javë vitesh do të bëjnë për ty një periudhë prej dyzet e nëntë vjetësh.  
 And let seven Sabbaths of years be numbered to you, seven times seven years; even the days of seven Sabbaths of years, that is forty-nine years;  
 καὶ ἑξαριθμήσεις σεαυτῷ ἑπτὰ ἀναπαύσεις ἐτῶν ἑπτὰ ἔτη ἑπτάκις καὶ ἔσονται σοι ἑπτὰ ἑβδομάδες ἐτῶν ἐννέα καὶ τεσσαράκοντα ἔτη
- 9 Ditën e dhjetë të muajit të shtatë do t'i biesh burisë; ditën e shlyerjes do të bëni që të hjerë buria në të gjithë vendin.  
 Then let the loud horn be sounded far and wide on the tenth day of the seventh month; on the day of taking away sin let the horn be sounded through all your land.  
 καὶ διαγγελεῖτε σάλπιγγος φωνῇ ἐν πάσῃ τῇ γῇ ὑμῶν τῷ μηνὶ τῷ ἑβδόμῳ τῇ δεκάτῃ τοῦ μηνός τῇ ἡμέρᾳ τοῦ Ἰλασμοῦ διαγγελεῖτε σάλπιγγι ἐν πάσῃ τῇ γῇ ὑμῶν
- 10 Dhe do të shenjtëroni vitin e pesëdhjetë dhe do shpallni në vend lirinë për të gjithë banorët e tij. Do të jetë për ju një jubile; secili prej jush do të kthehet në pronën e vet dhe secili prej jush do të kthehet në familjen e vet.  
 And let this fiftieth year be kept holy, and say publicly that everyone in the land is free from debt: it is the Jubilee, and every man may go back to his heritage and to his family.  
 καὶ ἀγιάσετε τὸ ἔτος τὸ πεντηκοστὸν ἐνιαυτὸν καὶ διαβोधέσετε ἄφεισιν ἐπὶ τῆς γῆς πᾶσιν τοῖς κατοικοῦσιν αὐτὴν ἐνιαυτὸς ἀφέσεως σημασία αὕτη ἔσται ὑμῖν καὶ ἀπελεύσεται εἰς ἕκαστος εἰς τὴν κτήσιν αὐτοῦ καὶ ἕκαστος εἰς τὴν πατρίδα αὐτοῦ ἀπελεύσεσθε
- 11 Viti i pesëdhjetë do të jetë për ju një jubile; nuk do të mbillni dhe nuk do të korrni atë që rritet vetiu dhe nuk do të vilni vreshtat e pakrasitur.  
 Let this fiftieth year be the Jubilee: no seed may be planted, and that which comes to growth of itself may not be cut, and the grapes may not be taken from the uncared-for vines.  
 ἀφέσεως σημασία αὕτη τὸ ἔτος τὸ πεντηκοστὸν ἐνιαυτὸς ἔσται ὑμῖν οὐ σπερεῖτε οὐδὲ ἀμήσετε τὰ αὐτόματα ἀναβαίνοντα αὐτῆς καὶ οὐ τρυγήσετε τὰ ἡγιασμένα αὐτῆς

- 12 Sepse është jubileu; ai do të jetë i shenjtë për ju; do të hani prodhimet që ju japin arat.  
For it is the Jubilee, and it is holy to you; your food will be the natural increase of the field.  
ὅτι ἀφέσεως σημασία ἐστὶν ἅγιον ἔσται ὑμῖν ἀπὸ τῶν πεδίων φάγεσθε τὰ γενήματα αὐτῆς
- 13 Në këtë vit të jubileut secili do të kthehet në pronën e vet.  
In this year of Jubilee, let every man go back to his heritage.  
ἐν τῷ ἔτει τῆς ἀφέσεως σημασία αὐτῆς ἐπανελεύσεται ἕκαστος εἰς τὴν κτῆσιν αὐτοῦ
- 14 Në rast se i shisni diçka fqinjit tuaj, ose blini diçka nga fqinji juaj, nuk do t'i bëni asnjë të padrejtë njëri tjetrit.  
And in the business of trading goods for money, do no wrong to one another.  
ἐὰν δὲ ἀποδῶ πρᾶσιν τῷ πλησίον σου ἐὰν καὶ κτήση παρὰ τοῦ πλησίον σου μὴ θλιβέτω ἄνθρωπος τὸν πλησίον
- 15 Do të blesh nga fqinji yt në bazë të numrit të viteve që kanë kaluar mbas jubileut, dhe ai do të shesë në bazë të numrit të viteve të korrjes.  
Let your exchange of goods with your neighbours have relation to the number of years after the year of Jubilee, and the number of times the earth has given her produce.  
κατὰ ἀριθμὸν ἐτῶν μετὰ τὴν σημασίαν κτήση παρὰ τοῦ πλησίον κατὰ ἀριθμὸν ἐνιαυτῶν γενημάτων ἀποδώσεται σοι
- 16 Sa më tepër vite mbeten, aq më tepër do ta ngrësh çmimin; sa më pak vite mbeten, aq më shumë do ta ulësh çmimin; sepse ai të shet në bazë të numrit të korrjeve.  
If the number of years is great, the price will be increased, and if the number of years is small, the price will be less, for it is the produce of a certain number of years which the man is giving you.  
καθότι ἂν πλεῖον τῶν ἐτῶν πληθύνη τὴν ἔγκτησιν αὐτοῦ καὶ καθότι ἂν ἕλαττον τῶν ἐτῶν ἕλαττωνώση τὴν κτῆσιν αὐτοῦ ὅτι ἀριθμὸν γενημάτων αὐτοῦ οὕτως ἀποδώσεται σοι
- 17 Asnjë nga ju të mos dëmtojë fqinjin e tij, por të keni frikë nga Perëndia juaj; sepse unë jam Zoti, Perëndia juaj.  
And do no wrong, one to another, but let the fear of your God be before you; for I am the Lord your God.  
μὴ θλιβέτω ἄνθρωπος τὸν πλησίον καὶ φοβηθήσῃ κύριον τὸν θεόν σου ἐγὼ εἰμι κύριος ὁ θεὸς ὑμῶν
- 18 Ju do të vini në zbatim statutet e mia, do të respektoni dekretet e mia dhe do t'i zbatoni; kështu do të banoni të sigurt në vendin tuaj.  
So keep my rules and my decisions and do them, and you will be safe in your land.  
καὶ ποιήσετε πάντα τὰ δικαιώματά μου καὶ πάσας τὰς κρίσεις μου καὶ φυλάξασθε καὶ ποιήσετε αὐτὰ καὶ κατοικήσετε ἐπὶ τῆς γῆς πεποιθότες
- 19 Toka do të prodhojë frytet e saj dhe ju do t'i hani sa të ngopeni, dhe do të banoni të sigurt në të.  
And the land will give her fruit, and you will have food in full measure and be safe in the land.  
καὶ δώσει ἡ γῆ τὰ ἐκφόρια αὐτῆς καὶ φάγεσθε εἰς πλησμονὴν καὶ κατοικήσετε πεποιθότες ἐπ' αὐτῆς
- 20 Por në rast se thoni: "Çfarë do të hamë vitin e shtatë, po nuk mbollëm dhe nuk korrëm prodhimet tona?"  
And if you say, Where will our food come from in the seventh year, when we may not put in seed, or get in the increase  
ἐὰν δὲ λέγητε τί φαγόμεθα ἐν τῷ ἔτει τῷ ἑβδόμῳ τούτῳ ἐὰν μὴ σπεύρωμεν μηδὲ συναγάγωμεν τὰ γενήματα ἡμῶν
- 21 Unë kam urdhëruar që bekimi im të vijë mbi ju vitin e gjashtë, dhe ai do t'ju japë një korrje që do të mjaftojë për tre vjet.  
Then I will send my blessing on you in the sixth year, and the land will give fruit enough for three years.  
καὶ ἀποστελῶ τὴν εὐλογίαν μου ὑμῖν ἐν τῷ ἔτει τῷ ἕκτῳ καὶ ποιήσει τὰ γενήματα αὐτῆς εἰς τὰ τρία ἔτη
- 22 Kështu vitin e tetë do të mbillni dhe do të hani nga korrja e vjetër deri në vitin e nëntë; do të hani nga korrja e vjetër deri sa të vijë e reja.  
And in the eighth year you will put in your seed, and get your food from the old stores, till the fruit of the ninth year is ready.  
καὶ σπερεῖτε τὸ ἔτος τὸ ὄγδοον καὶ φάγεσθε ἀπὸ τῶν γενημάτων παλαιά ἕως τοῦ ἔτους τοῦ ἐνάτου ἕως ἂν ἔλθῃ τὸ γένημα αὐτῆς φάγεσθε παλαιὰ παλαιῶν
- 23 Tokat nuk do të shiten për gjithnjë, sepse toka është imja; sepse ju jeni të huaj dhe qiramarrës tek unë.  
No exchange of land may be for ever, for the land is mine, and you are as my guests, living with me for a time.  
καὶ ἡ γῆ οὐ πρῶθῆσεται εἰς βεβαίωσιν ἐμὴ γὰρ ἐστὶν ἡ γῆ διότι προσήλυτοι καὶ πάροικοι ὑμεῖς ἐστε ἐναντίον μου
- 24 Prandaj në të gjithë vendin që keni pronë do të jepni të drejtën e shpengimit të tokës.  
Wherever there is property in land, the owner is to have the right of getting it back.  
καὶ κατὰ πᾶσαν γῆν κατασχέσεως ὑμῶν λύτρα δώσετε τῆς γῆς
- 25 Në qoftë se yt vëlla bëhet i varfër dhe shet një pjesë të pronës së tij, ai që ka të drejtën e shpengimit, i afërti i tij më i ngushtë, do të vijë dhe do të shpengojë atë që vëllai i tij ka shitur.  
If your brother becomes poor, and has to give up some of his land for money, his nearest relation may come and get back that which his brother has given up.  
ἐὰν δὲ πένηται ὁ ἀδελφός σου ὁ μετὰ σοῦ καὶ ἀποδῶται ἀπὸ τῆς κατασχέσεως αὐτοῦ καὶ ἔλθῃ ὁ ἀγγιστεῶν ἐγγίζων ἔγγιστα αὐτοῦ καὶ λυτρώσεται τὴν πρᾶσιν τοῦ ἀδελφοῦ αὐτοῦ

- 26 Dhe në qoftë se dikush nuk ka njeri që të mund ta shpenjojë pronën e tij, por arrin të gjejë vetë shumën e nevojshme për shpengimin,  
*And if he has no one to get it back for him, and later he himself gets wealth and has enough money to get it back;*  
 ἐὰν δὲ μὴ ἦ τινι ὁ ἀγχιστεύων καὶ εὐπορηθῆ τῆ χειρὶ καὶ εὐρεθῆ αὐτῷ τὸ ἱκανὸν λύτρα αὐτοῦ
- 27 do të numërojë vitet që kaluan dhe do t'i japë blerësit shumën e viteve që mbeten akoma, dhe do të rifitojë kështu pronën e tij.  
*Then let him take into account the years from the time when he gave it up, and make up the loss for the rest of the years to him who took it, and so get back his property.*  
 καὶ συλλογίζεται τὰ ἔτη τῆς πράσεως αὐτοῦ καὶ ἀποδώσει ὁ ὑπερέχει τῷ ἀνθρώπῳ ᾧ ἀπέδοτο ἑαυτὸν αὐτῷ καὶ ἀπελεύσεται εἰς τὴν κατάσχεσιν αὐτοῦ
- 28 Por në qoftë se nuk është në gjëndje ta shpenjojë pronën e tij, ajo që ka shitur do të mbetet në dorë të blerësit deri në vitin e jubileut; atë vit do të shpengohet dhe do të kthehet në zotërim të tij.  
*But if he is not able to get it back for himself, then it will be kept by him who gave a price for it, till the year of Jubilee; and in that year it will go back to its first owner and he will have his property again.*  
 ἐὰν δὲ μὴ εὐπορηθῆ ἡ χεὶρ αὐτοῦ τὸ ἱκανὸν ὥστε ἀποδοῦναι αὐτῷ καὶ ἔσται ἡ πράσις τῷ κτησαμένῳ αὐτὰ ἕως τοῦ ἕκτου ἔτους τῆς ἀφέσεως καὶ ἐξελεύσεται τῆ ἀφέσει καὶ ἀπελεύσεται εἰς τὴν κατάσχεσιν αὐτοῦ
- 29 Në rast se dikush shet një shtëpi në një qytet të rrethuar me mure, ai ka të drejtë ta shpenjojë gjatë një viti të tërë mbas shitjes se saj; e drejta e riblerjes zgjat një vit të tërë.  
*And if a man gives his house in a walled town for money, he has the right to get it back for the space of a full year after he has given it up.*  
 ἐὰν δὲ τις ἀποδῶται οἰκίαν οἰκητὴν ἐν πόλει τεταχισμένη καὶ ἔσται ἡ λύτρωσις αὐτῆς ἕως πληρωθῆ ἑνιαυτὸς ἡμερῶν ἔσται ἡ λύτρωσις αὐτῆς
- 30 Por në qoftë se shtëpia që ndodhet në qytetin e rrethuar me mure nuk është riblerë para se të ketë kaluar një vit i tërë, ajo do të mbetet për gjithnjë pronë e blerësit dhe e trashëgimtarëve të tij; nuk do të shpengohet me rastin e jubileut.  
*And if he does not get it back by the end of the year, then the house in the town will become the property of him who gave the money for it, and of his children for ever; it will not go from him in the year of Jubilee.*  
 ἐὰν δὲ μὴ λυτρωθῆ ἕως ἂν πληρωθῆ αὐτῆς ἑνιαυτὸς ὅλος κυρωθήσεται ἡ οἰκία ἡ οὕσα ἐν πόλει τῆ ἐχούση τεῖχος βεβαίως τῷ κτησαμένῳ αὐτὴν εἰς τὰς γενεὰς αὐτοῦ καὶ οὐκ ἐξελεύσεται ἐν τῆ ἀφέσει
- 31 Shtëpitë e fshatrave të parrethura me mure do të konsiderohen përkundrazi si tokë bujqësore; mund të shpengohen dhe me rastin e jubileut do të jenë të shpenguara.  
*But houses in small unwallled towns will be the same as property in the country; they may be got back, and they will go back to their owners in the year of Jubilee.*  
 αἱ δὲ οἰκίαι αἱ ἐν ἐπαύλεσιν αἷς οὐκ ἔστιν ἐν αὐταῖς τεῖχος κύκλῳ πρὸς τὸν ἀγρὸν τῆς γῆς λογισθήτωσαν λυτρωταὶ διὰ παντὸς ἔσονται καὶ ἐν τῆ ἀφέσει ἐξελεύσονται
- 32 Përsa u përket qyteteve të Levitëve, Levitët do të mund të riblen gjithnjë shtëpitë e qyteteve që ishin pronë e tyre.  
*But the houses in the towns of the Levites may be got back by the Levites at any time.*  
 καὶ αἱ πόλεις τῶν λευιτῶν οἰκίαι τῶν πόλεων αὐτῶν κατασχέσεως λυτρωταὶ διὰ παντὸς ἔσονται τοῖς λευίταις
- 33 Në rast se pastaj dikush ble një shtëpi nga Levitët, shtëpia e shitur në qytet që është pronë e tyre do të shpengohet vitin e jubileut, sepse shtëpitë e qyteteve të Levitëve janë pronë e tyre, në mes të bijve të Izraelit.  
*And if a Levite does not give money to get back his property, his house in the town which was exchanged for money will come back to him in the year of Jubilee. For the houses of the towns of the Levites are their property among the children of Israel.*  
 καὶ ὅς ἂν λυτρωσάμενος παρὰ τῶν λευιτῶν καὶ ἐξελεύσεται ἡ διάπρασις αὐτῶν οἰκῶν πόλεως κατασχέσεως αὐτῶν ἐν τῆ ἀφέσει ὅτι οἰκίαι τῶν πόλεων τῶν λευιτῶν κατάσχεσις αὐτῶν ἐν μέσῳ υἱῶν Ἰσραὴλ
- 34 Por tokat e kullotës të qyteteve të tyre nuk mund të shiten, sepse janë pronë e përjetshme e tyre.  
*But the land on the outskirts of their towns may not be exchanged for money, for it is their property for ever.*  
 καὶ οἱ ἀγροὶ οἱ ἀφορισμένοι ταῖς πόλεσιν αὐτῶν οὐ πραθήσονται ὅτι κατάσχεσις αἰωνία τοῦτο αὐτῶν ἔστιν
- 35 Në rast se vëllai yt varfërohet dhe ndodhet ngushtë në mes tua, ti do ta përkrahësh si të huaj dhe si mik që të mund të jetojë pranë teje.  
*And if your brother becomes poor and is not able to make a living, then you are to keep him with you, helping him as you would a man from another country who is living among you.*  
 ἐὰν δὲ πένηται ὁ ἀδελφός σου καὶ ἀδυνατήσῃ ταῖς χερσὶν παρὰ σοὶ ἀντιλήμνη αὐτοῦ ὡς προσηλύτου καὶ παροίκου καὶ ζήσεται ὁ ἀδελφός σου μετὰ σοῦ
- 36 Mos nxirr nga ai asnjë përfitim ose dobi; por ki frikë nga Perëndia yt, dhe vëllai yt do të jetojë pranë teje.  
*Take no interest from him, in money or in goods, but have the fear of your God before you, and let your brother make a living among you.*  
 οὐ λήμνη παρ' αὐτοῦ τόκον οὐδὲ ἐπὶ πλήθει καὶ φοβηθήσῃ τὸν θεόν σου ἐγὼ κύριος καὶ ζήσεται ὁ ἀδελφός σου μετὰ σοῦ
- 37 Nuk do t'i japësh hua paratë e tua me kamatë, as do t'i japësh ushqimet e tua për të nxjerrë ndonjë përfitim.  
*Do not take interest on the money which you let him have or on the food which you give him.*  
 τὸ ἀργύριόν σου οὐ δώσεις αὐτῷ ἐπὶ τόκῳ καὶ ἐπὶ πλεονασμὸν οὐ δώσεις αὐτῷ τὰ βρώματά σου

- 38 Unë jam Zoti, Perëndia juaj, që ju nxori nga vendi i Egjiptit që t'ju jap vendin e Kanaanit dhe që të jem Perëndia juaj.  
I am the Lord your God, who took you out of the land of Egypt to give you the land of Canaan, that I might be your God.  
ἐγὼ κύριος ὁ θεὸς ὑμῶν ὁ ἐξαγαγὼν ὑμᾶς ἐκ γῆς αἰγύπτου δοῦναι ὑμῖν τὴν γῆν χανααν ὥστε εἶναι ὑμῶν θεός
- 39 Në rast se vëllai yt që jeton pranë teje bëhet i varfër dhe shitet te ti, nuk do ta detyrosh të të shërbejë si skllav,  
And if your brother becomes poor and gives himself to you for money, do not make use of him like a servant who is your property;  
ἐὰν δὲ ταπεινωθῆ ὁ ἀδελφός σου παρὰ σοὶ καὶ πραθῆ σοὶ οὐ δουλεύσει σοὶ δουλείαν οἰκέτου
- 40 por do të rrijë pranë teje si argat dhe si mik; do të të shërbejë deri në vitin e jubileut.  
But let him be with you as a servant working for payment, till the year of Jubilee;  
ὡς μισθωτὸς ἢ πάροικος ἔσται σοὶ ἕως τοῦ ἔτους τῆς ἀφέσεως ἐργᾶται παρὰ σοὶ
- 41 Atëherë do të largohet prej teje, ai dhe bijtë e tij, dhe do të kthehet në familjen e tij; kështu do të rifitojë pronën e etërve të tij.  
Then he will go out from you, he and his children with him, and go back to his family and to the property of his fathers.  
καὶ ἐξελεύσεται τῇ ἀφέσει καὶ τὰ τέκνα αὐτοῦ μετ' αὐτοῦ καὶ ἀπελεύσεται εἰς τὴν γενεὰν αὐτοῦ εἰς τὴν κατάσχεσιν τὴν πατρικὴν ἀποδραμεῖται
- 42 Sepse ata janë shërbëtorët e mi, që unë i kam nxjerrë nga vendi i Egjiptit; nuk duhet, pra, të shiten si shiten skllavërit.  
For they are my servants whom I took out from the land of Egypt; they may not become the property of another.  
διότι οἰκέται μοῦ εἰσιν οὗτοι οὐδὲ ἐξήγαγον ἐκ γῆς αἰγύπτου οὐ πραθήσεται ἐν πράσει οἰκέτου
- 43 Nuk do ta sundosh me ashpërsi, por të kesh frikë Perëndinë tënd.  
Do not be a hard master to him, but have the fear of God before you.  
οὐ κατατενεῖς αὐτὸν ἐν τῷ μόχθῳ καὶ φοβηθήσῃ κύριον τὸν θεόν σου
- 44 Sa për skllavin dhe skllaven që mund të kesh, do t'i marrësh nga kombet që ju rrethojnë; prej tyre do të blini skllavin dhe skllaven.  
But you may get servants as property from among the nations round about; from them you may take men-servants and women-servants.  
καὶ παῖς καὶ παιδίσκη ὅσοι ἂν γένωνται σοὶ ἀπὸ τῶν ἐθνῶν ὅσοι κύκλῳ σου εἰσιν ἀπ' αὐτῶν κτήσεσθε δοῦλον καὶ δούλην
- 45 Mund të blini gjithashtu skllavë ndër bijtë e të huajve që jetojnë midis jush dhe midis familjeve të tyre që gjenden midis jush dhe që kanë lindur në vendin tuaj; ata do të jenë pronë e juaj.  
And in addition, you may get, for money, servants from among the children of other nations who are living with you, and from their families which have come to birth in your land; and these will be your property.  
καὶ ἀπὸ τῶν υἱῶν τῶν παροίκων τῶν ὄντων ἐν ὑμῖν ἀπὸ τούτων κτήσεσθε καὶ ἀπὸ τῶν συγγενῶν αὐτῶν ὅσοι ἂν γένωνται ἐν τῇ γῇ ὑμῶν ἔστωσαν ὑμῖν εἰς κατάσχεσιν
- 46 Dhe mund t'ua lini si trashëgim bijve tuaj pas jush, si pronë e tyre; mund t'i shfrytëzoni si skllavë për gjithnjë; por, sa për vëllezërit tuaj, bijtë e Izraelit, askush nuk do të sundojë mbi tjetrin me ashpërsi.  
And they will be your children's heritage after you, to keep as their property; they will be your servants for ever; but you may not be hard masters to your countrymen, the children of Israel.  
καὶ καταμεριεῖτε αὐτοὺς τοῖς τέκνοις ὑμῶν μεθ' ὑμᾶς καὶ ἔσονται ὑμῖν κατόχμοι εἰς τὸν αἰῶνα τῶν ἀδελφῶν ὑμῶν τῶν υἱῶν ἰσραηλ ἕκαστος τὸν ἀδελφὸν αὐτοῦ οὐ κατατενεῖ αὐτὸν ἐν τοῖς μόχθοις
- 47 Në rast se një i huaj që jeton pranë teje pasurohet dhe vëllai yt që jeton pranë tij varfërohet, dhe i shitet të huajt ose mikut që ndodhet pranë teje, ose dikujt nga familja e të huajt,  
And if one from another nation living among you gets wealth, and your countryman, at his side, becomes poor and gives himself for money to the man from another nation or to one of his family;  
ἐὰν δὲ εὖρη ἢ χεὶρ τοῦ πρῶσιτου ἢ τοῦ παροίκου τοῦ παρὰ σοὶ καὶ ἀπορηθῆς ὁ ἀδελφός σου πραθῆ τῷ πρῶσιτῳ ἢ τῷ παροίκῳ τῷ παρὰ σοὶ ἐκ γενετῆς πρῶσιτῳ
- 48 pas shitjes së tij, mund të blihet përsëri; mund ta riblejë një nga vëllezërit e tij.  
After he has given himself he has the right to be made free, for a price, by one of his brothers,  
μετὰ τὸ πραθῆναι αὐτῷ λύτρωσις ἔσται αὐτῷ εἰς τῶν ἀδελφῶν αὐτοῦ λυτρώσεται αὐτόν
- 49 Mund ta riblejë ungji i tij ose biri i ungjit të tij; mund të riblihet nga një i afërt i po atij gjaku; ose po të ketë mjetet, mund të shpengohet vet.  
Or his father's brother, or the son of his father's brother, or any near relation; or if he gets money, he may make himself free.  
ἀδελφός πατρός αὐτοῦ ἢ υἱός ἀδελφοῦ πατρός λυτρώσεται αὐτόν ἢ ἀπὸ τῶν οικείων τῶν σαρκῶν αὐτοῦ ἐκ τῆς φυλῆς αὐτοῦ λυτρώσεται αὐτόν ἐὰν δὲ εὐπορηθῆς ταῖς χερσὶν λυτρώσεται ἑαυτόν
- 50 Do të bëjë llogarinë me blerësin e tij, qysh prej vitit që iu shit atij deri në vitin e jubileut; dhe çmimi që do të paguhet do të llogaritet në bazë të numrit të viteve, duke i vlerësuar ditët e tij si ato të një argati.  
And let the years be numbered from the time when he gave himself to his owner till the year of Jubilee, and the price given for him will be in relation to the number of years, on the scale of the payment of a servant.  
καὶ ἀλλογοῖται πρὸς τὸν κεκτημένον αὐτόν ἀπὸ τοῦ ἔτους οὗ ἀπέδοτο ἑαυτόν αὐτῷ ἕως τοῦ ἐνιαυτοῦ τῆς ἀφέσεως καὶ ἔσται τὸ ἀργύριον τῆς πράσεως αὐτοῦ ὡς μισθίου ἔτος ἐξ ἔτους ἔσται μετ' αὐτὸν οὐ

- 51 Në qoftë se mbeten akoma shumë vjet, do ta paguajë shpengimin e tij në bazë të numrit të tyre dhe çmimit me të cilin qe blerë;  
**If there is still a long time, he will give back, on account of it, a part of the price which was given for him.**  
 ἐὰν δὲ τιμὴ πλεῖον τῶν ἐτῶν ἢ πρὸς ταῦτα ἀποδώσει τὰ λύτρα αὐτοῦ ἀπὸ τοῦ ἀργυρίου τῆς πράξεως αὐτοῦ
- 52 po të jetë se mbeten vetëm pak vite për të arritur në jubile, do ta bëjë llogarinë me blerësin e tij dhe do ta paguajë çmimin e shpengimit të tij në bazë të pak viteve që kanë mbetur.  
**And if there is only a short time, he will take account of it with his master, and in relation to the number of years he will give back the price of making him free.**  
 ἐὰν δὲ ὀλίγον καταλειφθῆ ἀπὸ τῶν ἐτῶν εἰς τὸν ἐνιαυτὸν τῆς ἀφέσεως καὶ συλλογίζεται αὐτῷ κατὰ τὰ ἔτη αὐτοῦ καὶ ἀποδώσει τὰ λύτρα αὐτοῦ
- 53 Si argat le të mbetet bashkë me të zotin një vit pas tjetrit, por ky nuk do ta trajtojë me ashpërsi përpara syve të tua.  
**And he will be with him as a servant working for payment year by year; his master is not to be cruel to him before your eyes.**  
 ὡς μισθωτὸς ἐνιαυτὸν ἐξ ἐνιαυτοῦ ἔσται μετ' αὐτοῦ οὐ κατατενεῖς αὐτὸν ἐν τῷ μόχθῳ ἐνώπιόν σου
- 54 Dhe po nuk u shpengua me asnjë nga këto mënyra, do të lihet i lirë në vitin e jubileut, ai dhe bijtë e tij.  
**And if he is not made free in this way, he will go out in the year of Jubilee, he and his children with him.**  
 ἐὰν δὲ μὴ λυτρωθῆ κατὰ ταῦτα ἐξελεύσεται ἐν τῷ ἔτει τῆς ἀφέσεως αὐτὸς καὶ τὰ παιδιά αὐτοῦ μετ' αὐτοῦ
- 55 Sepse bijtë e Izraelit janë shërbëtorët e mi; janë shërbëtorët e mi, që i nxora nga vendi i Egjiptit. Unë jam Zoti, Perëndia juaj "  
**For the children of Israel are servants to me; they are my servants whom I took out of the land of Egypt: I am the Lord your God.**  
 ὅτι ἐμοὶ οἱ υἱοὶ ἰσραὴλ οἰκέται παῖδες μου οὗτοί εἰσιν οὗς ἐξήγαγον ἐκ γῆς αἰγύπτου ἐγὼ κύριος ὁ θεὸς ὑμῶν
- 1 "Nuk do të bëni idhuj, nuk do të ngrini figura të gdhendura ose ndonjë kolonë dhe nuk do të vendosni në vendin tuaj asnjë gur të stolisur me figura, me qëllim që të përuleni para tij; sepse unë jam Zoti, Perëndia juaj.  
**Do not make images of false gods, or put up an image cut in stone or a pillar or any pictured stone in your land, to give worship to it; for I am the Lord your God.**  
 οὐ ποιήσετε ὑμῖν αὐτοῖς χειροποίητα οὐδὲ γλυπτὰ οὐδὲ στήλην ἀναστήσετε ὑμῖν οὐδὲ λίθον σκοπὸν θήσετε ἐν τῇ γῇ ὑμῶν προσκυνῆσαι αὐτῷ ἐγὼ εἰμι κύριος ὁ θεὸς ὑμῶν
- 2 Do të respektoni të shtunat e mia dhe do të respektoni shenjtëroren time. Unë jam Zoti.  
**Keep my Sabbaths and give honour to my holy place: I am the Lord.**  
 τὰ σάββατά μου φυλάξεσθε καὶ ἀπὸ τῶν ἁγίων μου φοβηθήσεσθε ἐγὼ εἰμι κύριος
- 3 Në rast se silleni simbas statuteve të mia, në se respektoni urdhrat e mia dhe i zbatoni në praktikë,  
**If you are guided by my rules, and keep my laws and do them,**  
 ἐὰν τοῖς προστάγμασίν μου πορεύησθε καὶ τὰς ἐντολάς μου φυλάσσησθε καὶ ποιήσητε αὐτάς
- 4 unë do t'ju jap shirat simbas stinëve, toka do të japë prodhimin e saj dhe drurët e fshatit do të japin frytet e tyre.  
**Then I will give you rain at the right time, and the land will give her increase and the trees of the field will give their fruit;**  
 καὶ δώσω τὸν ὑετὸν ὑμῖν ἐν καιρῷ αὐτοῦ καὶ ἡ γῆ δώσει τὰ γενήματα αὐτῆς καὶ τὰ ξύλα τῶν πεδίων ἀποδώσει τὸν καρπὸν αὐτῶν
- 5 Të shirat do të vazhdojnë deri në kohën e vjeljes së rrushit dhe vjelja e rrushit do të vazhdojë deri në kohën e mbjelljeve; do të hani bukën tuaj sa të ngopeni dhe do të banoni të sigurt në vendin tuaj.  
**And the crushing of the grain will overtake the cutting of the grapes, and the cutting of the grapes will overtake the planting of the seed, and there will be bread in full measure, and you will be living in your land safely.**  
 καὶ καταλήμψεται ὑμῖν ὁ ὀλοητὸς τὸν τρύγητον καὶ ὁ τρύγητος καταλήμψεται τὸν σπῆρον καὶ φάγεσθε τὸν ἄρτον ὑμῶν εἰς πλησμονὴν καὶ κατοικήσετε μετὰ ἀσφαλείας ἐπὶ τῆς γῆς ὑμῶν
- 6 Unë do të bëj që të mbretërojë paqja në vend; do të bini në shtrat dhe askush nuk ka për t'ju trembur; do të zhdruk nga vendi juaj kafshët e këqia dhe shpata nuk ka për të kaluar nëpër vendin tuaj.  
**And I will give you peace in the land, and you will take your rest and no one will give you cause for fear; and I will put an end to all evil beasts in the land, and no sword of war will go through your land.**  
 καὶ πόλεμος οὐ διελεύσεται διὰ τῆς γῆς ὑμῶν καὶ δώσω εἰρήνην ἐν τῇ γῇ ὑμῶν καὶ κοιμηθήσεσθε καὶ οὐκ ἔσται ὑμᾶς ὁ ἐκφοβῶν καὶ ἀπολώ θηρία πονηρὰ ἐκ τῆς γῆς ὑμῶν
- 7 Ju do t'i ndiqni armiqtë tuaj dhe ata do të bien para jush të shpuar tej për tej nga shpata.  
**And you will put to flight those who are against you, and they will be put to death by your swords.**  
 καὶ διώξεσθε τοὺς ἐχθροὺς ὑμῶν καὶ πεσοῦνται ἐναντίον ὑμῶν φόνῳ
- 8 Pesë prej jush do të ndjekin njëqind prej tyre, dhe njëqind prej jush do të ndjekin dhjetë mijë prej tyre, dhe armiqtë tuaj do të bien para jush të shpuar tej për tej nga shpata.  
**Then five of you will put to flight a hundred, and a hundred of you will put to flight ten thousand, and all who are against you will be put to death by your swords.**  
 καὶ διώξονται ἐξ ὑμῶν πέντε ἑκατὸν καὶ ἑκατὸν ὑμῶν διώξονται μυριάδας καὶ πεσοῦνται οἱ ἐχθροὶ ὑμῶν ἐναντίον ὑμῶν μαχαίρα

- 9 Unë do të kthehem nga ju, do t'ju bëj pjellorë dhe do t'ju shumzoj, dhe kështu do të vërtetohet besëlidhjen time me ju.  
And I will have pleasure in you and make you fertile and greater in number; and I will keep my agreement with you.  
καὶ ἐπιβλέψω ἐφ' ὑμᾶς καὶ αὐξάνω ὑμᾶς καὶ πληθύνω ὑμᾶς καὶ στήσω τὴν διαθήκην μου μεθ' ὑμῶν
- 10 Ju do të hani nga prodhimi i vjetër, i ruajtur për një kohë të gjatë dhe do ta hiqni atë për t'i bërë vend prodhimit të ri.  
And old stores long kept will be your food, and you will take out the old because of the new;  
καὶ φάγεσθε παλαιὰ καὶ παλαιὰ παλαιῶν καὶ παλαιὰ ἐκ προσώπου νέων ἐξοίσετε
- 11 Unë do ta vendos banesën time midis jush dhe nuk do t'ju përzë.  
And I will put my holy House among you, and my soul will not be turned away from you in disgust.  
καὶ θήσω τὴν διαθήκην μου ἐν ὑμῖν καὶ οὐ βδελύξεται ἡ ψυχὴ μου ὑμᾶς
- 12 Do të eci midis jush dhe do të jem Perëndia juaj, dhe ju do të jeni populli im.  
And I will be present among you and will be your God and you will be my people.  
καὶ ἐμπεριπατήσω ἐν ὑμῖν καὶ ἔσομαι ὑμῶν θεὸς καὶ ὑμεῖς ἔσεσθέ μου λαός
- 13 Unë jam Zoti, Perëndia juaj, që ju nxori nga vendi i Egjiptit, që të mos ishit më skllëverit e tij; e kam thyer zgjedhën tuaj dhe kam bërë që të ecni me kokën lart.  
I am the Lord your God, who took you out of the land of Egypt so that you might not be servants to them; by me the cords of your yoke were broken and I made you go upright.  
ἐγώ εἰμι κύριος ὁ θεὸς ὑμῶν ὁ ἐξαγαγὼν ὑμᾶς ἐκ γῆς αἰγύπτου ὄντων ὑμῶν δούλων καὶ συνέτριψα τὸν δεσμόν τοῦ ζυγοῦ ὑμῶν καὶ ἤγαγον ὑμᾶς μετὰ παρρησίας
- 14 Por në rast se nuk më dëgjoni dhe nuk zbatoni në praktikë të gjitha urdhërimet e mia,  
But if you do not give ear to me, and do not keep all these my laws;  
ἐὰν δὲ μὴ ὑπακούσητέ μου μηδὲ ποιήσητε τὰ προστάγματά μου ταῦτα
- 15 në rast se përçmoni statutet e mia dhe shpirti juaj hedh poshtë dekretet e mia, duke mos zbatuar në praktikë të gjithë urdhërimet e mia, duke shkelur besëlidhjen time,  
And if you go against my rules and if you have hate in your souls for my decisions and you do not do all my orders, but go against my agreement;  
ἀλλὰ ἀπειθήσητε αὐτοῖς καὶ τοῖς κρίμασιν μου προσοχθίση ἡ ψυχὴ ὑμῶν ὥστε ὑμᾶς μὴ ποιεῖν πάσας τὰς ἐντολάς μου ὥστε διασκεδάσαι τὴν διαθήκην μου
- 16 edhe unë do ta bëj këtë për ju: do të çoj kundër jush tmerrin, ligështimin dhe ethet, të cilët do të konsumojnë sytë tuaj dhe do ta bëj jetën tuaj të meket; dhe do ta mbillni kot farën tuaj, sepse do ta hanë armiqtë tuaj.  
This will I do to you: I will put fear in your hearts, even wasting disease and burning pain, drying up the eyes and making the soul feeble, and you will get no profit from your seed, for your haters will take it for food.  
καὶ ἐγὼ ποιήσω οὕτως ὑμῖν καὶ ἐπισυστήσω ἐφ' ὑμᾶς τὴν ἀπορίαν τὴν τε ψόραν καὶ τὸν ἵκτερον καὶ σφακελίζοντας τοὺς ὀφθαλμοὺς ὑμῶν καὶ τὴν ψυχὴν ὑμῶν ἐκτήκουσαν καὶ σπερεῖτε διὰ κενῆς τὰ σπέρματα ὑμῶν καὶ ἔδονται οἱ ὑπεναντίοι ὑμῶν
- 17 Do ta kthej fytyrën time kundër jush dhe armiqtë tuaj do t'ju mundin; do të sundoheni prej atyre që ju urrejnë dhe do t'ua mbathni këmbëve pa qenë të ndjekur nga askush.  
And my face will be turned from you, and you will be broken before those who are against you, and your haters will become your rulers, and you will go in flight when no man comes after you.  
καὶ ἐπιστήσω τὸ πρόσωπόν μου ἐφ' ὑμᾶς καὶ πεσεῖσθε ἐναντίον τῶν ἐχθρῶν ὑμῶν καὶ διώξονται ὑμᾶς οἱ μισοῦντες ὑμᾶς καὶ φεύξεσθε οὐθενὸς διώκοντος ὑμᾶς
- 18 Dhe në qoftë se edhe mbas kësaj nuk më dëgjoni, unë do t'ju dënoj shtatë herë më tepër për mëkatet tuaja.  
And if, even after these things, you will not give ear to me, then I will send you punishment seven times more for your sins.  
καὶ ἐὰν ἕως τούτου μὴ ὑπακούσητέ μου καὶ προσθήσω τοῦ παιδεῦσαι ὑμᾶς ἑπτάκις ἐπὶ ταῖς ἁμαρτίαις ὑμῶν
- 19 Do ta thyej kryelartësinë e forcës suaj, do ta bëj qiellin tuaj si hekur dhe tokën tuaj si bakër.  
And the pride of your strength will be broken, and I will make your heaven as iron and your earth as brass;  
καὶ συντρίψω τὴν ὕβριν τῆς ὑπερηφανίας ὑμῶν καὶ θήσω τὸν οὐρανὸν ὑμῖν σιδηρὸν καὶ τὴν γῆν ὑμῶν ὥσει χαλκῆν
- 20 Forca juaj do të konsumohet më kot, sepse toka juaj nuk do të japë më prodhimet e saj, dhe drurët e fushës nuk do të japin më frutat e tyre.  
And your strength will be used up without profit; for your land will not give her increase and the trees of the field will not give their fruit.  
καὶ ἔσται εἰς κενὸν ἡ ἰσχύς ὑμῶν καὶ οὐ δώσει ἡ γῆ ὑμῶν τὸν σπόρον αὐτῆς καὶ τὸ ξύλον τοῦ ἀγροῦ ὑμῶν οὐ δώσει τὸν καρπὸν αὐτοῦ
- 21 Dhe në rast se silleni si armiq të mi dhe nuk doni të më dëgjoni, unë do t'ju godas shtatë herë më tepër me plagë, simbas mëkateve tuaja.  
And if you still go against me and will not give ear to me, I will put seven times more punishments on you because of your sins.  
καὶ ἐὰν μετὰ ταῦτα πορεύησθε πλάγιος καὶ μὴ βούλησθε ὑπακοῦειν μου προσθήσω ὑμῖν πλῆγὺς ἑπτὰ κατὰ τὰς ἁμαρτίας ὑμῶν

- 22 Do të dërgoj kundër jush bishat e fushës, që do të rrëmbejnë fëmijët tuaj, do të shfarosin bagëtinë tuaj, do t'ju pakësojnë shumë dhe do t'i bëjnë të shkreta rrugët tuaja.  
I will let loose the beasts of the field among you, and they will take away your children and send destruction on your cattle, so that your numbers will become small and your roads become waste.  
καὶ ἀποστελῶ ἐφ' ὑμᾶς τὰ θηρία τὰ ἄγρια τῆς γῆς καὶ κατέδεται ὑμᾶς καὶ ἐξαναλώσει τὰ κτήνη ὑμῶν καὶ ὀλιγοστοὺς ποιήσει ὑμᾶς καὶ ἐρημωθήσονται αἱ ὁδοὶ ὑμῶν
- 23 Dhe në se, me gjithë këto gjëra, nuk do të ndreqeni për t'u kthyer tek unë, por me sjelljen tuaj  
And if by these things you will not be turned to me, but still go against me;  
καὶ ἐπὶ τούτοις ἐὰν μὴ παιδευθῆτε ἀλλὰ πορεύησθε πρὸς με πλάγιοι
- 24 silleni si armiq të mi, edhe unë do të bëhem armiku juaj, dhe do t'ju godas shtatë herë më tepër për mëkatet tuaja.  
Then I will go against you, and I will give you punishment, I myself, seven times for all your sins.  
πορεύσομαι καγὼ μεθ' ὑμῶν θυμῷ πлагίῳ καὶ πατάξω ὑμᾶς καγὼ ἐπτάκις ἀντὶ τῶν ἁμαρτιῶν ὑμῶν
- 25 Dhe do të sjell kundër jush shpatën që do të kryejë hakmarrjen e besëlidhjes sime; ju do të mblidheni në qytetet tuaja, por unë do të dërgoj në mes jush murtagjen dhe do të bini në duart e armikut.  
And I will send a sword on you to give effect to the punishment of my agreement; and when you come together into your towns I will send disease among you and you will be given up into the hands of your haters.  
καὶ ἐπάξω ἐφ' ὑμᾶς μάχαιραν ἐκδικουσαν δίκην διαθήκης καὶ καταφεύξεσθε εἰς τὰς πόλεις ὑμῶν καὶ ἐξαποστελῶ θάνατον εἰς ὑμᾶς καὶ παραδοθήσεσθε εἰς χεῖρας ἐχθρῶν
- 26 Kur do t'ju heq bukën e gojës, dhjetë gra do të pjekin bukën tuaj në të njëjtën furrë dhe do të racionojnë bukën tuaj, duke e shpërndarë me peshë; ju do të hani, por nuk do të ngopeni.  
When I take away your bread of life, ten women will be cooking bread in one oven, and your bread will be measured out by weight; you will have food but never enough.  
ἐν τῷ θλίψει ὑμᾶς σιτοδείξ ἄρτων καὶ πέψουσιν δέκα γυναῖκες τοὺς ἄρτους ὑμῶν ἐν κλιβάνῳ ἐνὶ καὶ ἀποδώσουσιν τοὺς ἄρτους ὑμῶν ἐν σταθμῷ καὶ φάγεσθε καὶ οὐ μὴ ἐμπλησθῆτε
- 27 Dhe në se, me gjithë këtë nuk do të më dëgjoni, por do të silleni si armiq të mi,  
And if, after all this, you do not give ear to me, but go against me still,  
ἐὰν δὲ ἐπὶ τούτοις μὴ ὑπακούσητέ μου καὶ πορεύησθε πρὸς με πλάγιοι
- 28 edhe unë do të bëhem armiku i juaj plot mëri dhe do t'ju dënoj shtatë herë më shumë për mëkatet tuaja.  
Then my wrath will be burning against you, and I will give you punishment, I myself, seven times for your sins.  
καὶ αὐτὸς πορεύσομαι μεθ' ὑμῶν ἐν θυμῷ πлагίῳ καὶ παιδεύσω ὑμᾶς ἐγὼ ἐπτάκις κατὰ τὰς ἁμαρτίας ὑμῶν
- 29 Do të hani mishin e bijve tuaj dhe do të hani mishin e bijave tuaja.  
Then you will take the flesh of your sons and the flesh of your daughters for food;  
καὶ φάγεσθε τὰς σάρκας τῶν υἱῶν ὑμῶν καὶ τὰς σάρκας τῶν θυγατέρων ὑμῶν φάγεσθε
- 30 Unë do të shkatërroj vendet tuaja të larta, do të rrëzoj idhujtë tuaj dhe do t'i hedh kufomat tuaja mbi gërmadhat pa jetë të idhujve tuaj; dhe do t'ju urrej.  
And I will send destruction on your high places, overturning your perfume altars, and will put your dead bodies on your broken images, and my soul will be turned from you in disgust.  
καὶ ἐρημώσω τὰς στήλας ὑμῶν καὶ ἐξολεθρεύσω τὰ ξύλινα χειροποίητα ὑμῶν καὶ θήσω τὰ κῶλα ὑμῶν ἐπὶ τὰ κῶλα τῶν εἰδώλων ὑμῶν καὶ προσοχθιεῖ ἡ ψυχὴ μου ὑμῖν
- 31 Do t'i katandis qytetet tuaja në shkretëtira, do të shkretoj vendet tuaja të shenjta dhe nuk do të thith më erën e këndshme të parfumeve tuaja.  
And I will make your towns waste and send destruction on your holy places; I will take no pleasure in the smell of your sweet perfumes;  
καὶ θήσω τὰς πόλεις ὑμῶν ἐρήμους καὶ ἐξερημώσω τὰ ἅγια ὑμῶν καὶ οὐ μὴ ὀσφρανθῶ τῆς ὀσμῆς τῶν θυσιῶν ὑμῶν
- 32 Do të shkretoj vendin; dhe armiqtë tuaj që banojnë në të do të mbeten të habitur.  
And I will make your land a waste, a wonder to your haters living in it.  
καὶ ἐξερημώσω ἐγὼ τὴν γῆν ὑμῶν καὶ θαυμάσονται ἐπ' αὐτῇ οἱ ἐχθροὶ ὑμῶν οἱ ἐνοικοῦντες ἐν αὐτῇ
- 33 Do t'ju shpërndaj midis kombeve dhe do të nxjerr shpatën kundër jush; vendi juaj do të shkretohet dhe qytetet tuaja do të jenë të shkretuara.  
And I will send you out in all directions among the nations, and my sword will be uncovered against you, and your land will be without any living thing, and your towns will be made waste.  
καὶ διασπερῶ ὑμᾶς εἰς τὰ ἔθνη καὶ ἐξαναλώσει ὑμᾶς ἐπιπορευομένη ἡ μάχαιρα καὶ ἔσται ἡ γῆ ὑμῶν ἔρημος καὶ αἱ πόλεις ὑμῶν ἔσονται ἔρημοι
- 34 Atëherë toka do të gëzojë të shtunat e saj për gjithë kohën që do të jetë e shkretuar dhe ju do të jeni në vendin e armiqve tuaj; kështu toka do të pushojë dhe do të gëzojë të shtunat e saj.  
Then will the land take pleasure in its Sabbaths while it is waste and you are living in the land of your haters; then will the land have rest.  
τότε εὐδοκῆσει ἡ γῆ τὰ σάββατα αὐτῆς καὶ πάσας τὰς ἡμέρας τῆς ἐρημώσεως αὐτῆς καὶ ὑμεῖς ἔσεσθε ἐν τῇ γῆ τῶν ἐχθρῶν ὑμῶν τότε σαββατιεῖ ἡ γῆ καὶ εὐδοκῆσει τὰ σάββατα αὐτῆς
- 35 Për gjithë kohën që do të mbetet e shkretuar do të gëzojë pushimin që nuk pati në të shtunat tuaja, kur banonit në të.  
All the days while it is waste will the land have rest, such rest as it never had in your Sabbaths, when you were living in it.  
πάσας τὰς ἡμέρας τῆς ἐρημώσεως αὐτῆς σαββατιεῖ ἃ οὐκ ἐσαββάτισεν ἐν τοῖς σαββάτοις ὑμῶν ἡνίκα κατοκεῖτε αὐτήν



- 36 Atyre prej jush që do të shpëtojnë do t'u kall në zemër tmerrin në vendin e armiqve të tyre; fërfërima e një gjethi që lëviz do t'i bëjë që t'ua mbathin këmbëve; do të turren ashtu siç iket përpara shpatës dhe do të bien pa i ndjekur askush.  
And as for the rest of you, I will make their hearts feeble in the land of their haters, and the sound of a leaf moved by the wind will send them in flight, and they will go in flight as from the sword, falling down when no one comes after them;  
καὶ τοῖς καταλειφθεῖσιν ἐξ ὑμῶν ἐπάξω δειλίαν εἰς τὴν καρδίαν αὐτῶν ἐν τῇ γῆ τῶν ἐχθρῶν αὐτῶν καὶ διώξεται αὐτοὺς φωνὴ φύλλου φερομένου καὶ φεύγονται ὡς φεύγοντες ἀπὸ πολέμου καὶ πεσοῦνται οὐθενὸς διώκοντος
- 37 Do të përplasen njëri me tjetrin, ashtu si përpara shpatës, pa i ndjekur askush; dhe nuk do të mund të qëndroni përpara armiqve tuaj.  
Falling on one another, as before the sword, when no one comes after them; you will give way before your haters.  
καὶ ὑπερόψεται ὁ ἀδελφὸς τὸν ἀδελφὸν ὡσεὶ ἐν πολέμῳ οὐθενὸς κατατρέχοντος καὶ οὐ δυνήσεσθε ἀντιστῆναι τοῖς ἐχθροῖς ὑμῶν
- 38 Do të shuheni midis kombeve dhe vendi i armiqve tuaj do t'ju gëlltisë.  
And death will overtake you among strange nations, and the land of your haters will be your destruction.  
καὶ ἀπολείσθαι ἐν τοῖς ἔθνεσιν καὶ κατέδετα ὑμᾶς ἡ γῆ τῶν ἐχθρῶν ὑμῶν
- 39 Ata prej jush që do të mbijetojnë do të përgjërohen për shkak të paudhësisë së tyre në vendin e armiqve; edhe do të përgjërohen gjithashtu për shkak të paudhësisë së etërve të tyre.  
And those of you who are still living will be wasting away in their sins in the land of your haters; in the sins of their fathers they will be wasting away.  
καὶ οἱ καταλειφθέντες ἀφ' ὑμῶν καταφθαρήσονται διὰ τὰς ἁμαρτίας ὑμῶν ἐν τῇ γῆ τῶν ἐχθρῶν αὐτῶν τακῆσονται
- 40 Por në se do të pranojnë paudhësinë e tyre dhe paudhësinë e etërve të tyre në shkeljet që kanë kryer kundër meje dhe gjithashtu sepse janë sjellë si armiq të mi, And they will have grief for their sins and for the sins of their fathers, when their hearts were untrue to me, and they went against me;  
καὶ ἐξαγορεύσουσιν τὰς ἁμαρτίας αὐτῶν καὶ τὰς ἁμαρτίας τῶν πατέρων αὐτῶν ὅτι παρέβησαν καὶ ὑπερεῖδόν με καὶ ὅτι ἐπορεύθησαν ἐναντίον μου πλάγιοι
- 41 sa që më kanë shtyrë të bëhem armik i tyre dhe t'i çoj në vendin e armiqve të tyre; në rast se zemra e tyre e parrethprerë do të përulet dhe do të pranojë ndëshkimin e paudhësisë së tyre, So that I went against them and sent them away into the land of their haters: if then the pride of their hearts is broken and they take the punishment of their sins,  
καὶ ἐγὼ ἐπορεύθην μετ' αὐτῶν ἐν θυμῷ πλάγιῳ καὶ ἀπολῶ αὐτοὺς ἐν τῇ γῆ τῶν ἐχθρῶν αὐτῶν τότε ἐντραπήσεται ἡ καρδία αὐτῶν ἢ ἀπερίτμητος καὶ τότε εὐδοκήσουσιν τὰς ἁμαρτίας αὐτῶν
- 42 atëherë unë do të kujtohem për besëlidhjen time të lidhur me Jakobin, do të kujtohem për besëlidhjen time të lidhur me Isakun dhe për besëlidhjen time me Abrahamin dhe do të kujtohem për vendin;  
Then I will keep in mind the agreement which I made with Jacob and with Isaac and with Abraham, and I will keep in mind the land.  
καὶ μνησθήσομαι τῆς διαθήκης ἰακωβ καὶ τῆς διαθήκης ἰσαακ καὶ τῆς διαθήκης ἀβρααμ μνησθήσομαι καὶ τῆς γῆς μνησθήσομαι
- 43 sepse vendi do të braktiset prej tyre dhe do të gëzojë të shtunat e tij, ndërsa do të jetë i shkretuar pa ta; kështu ata do të pranojnë ndëshkimin e paudhësisë së tyre për faktin se kanë përcmuar dekretet e mia dhe kanë kundërshtuar statutet e mia.  
And the land, while she is without them, will keep her Sabbaths; and they will undergo the punishment of their sins, because they were turned away from my decisions and in their souls was hate for my laws.  
καὶ ἡ γῆ ἐγκαταλειφθήσεται ὑπ' αὐτῶν τότε προσδέξεται ἡ γῆ τὰ σάββατα αὐτῆς ἐν τῷ ἐρημοθῆναι αὐτὴν δι' αὐτούς καὶ αὐτοὶ προσδέξονται τὰς αὐτῶν ἀνομίας ἀνθ' ὧν τὰ κρίματά μου ὑπερεῖδον καὶ αὐτοὶς προστάγμασιν μου προσώχθισαν τῇ ψυχῇ αὐτῶν
- 44 Megjithatë kur do të ndodhen në vendin e armiqve të tyre, unë nuk do t'i përcmoj dhe nuk do t'i urrej aq sa t'i asgjësoj krejt dhe të prish besëlidhjen time që kam lidhur me ta; unë jam Zoti, Perëndia i tyre;  
But for all that, when they are in the land of their haters I will not let them go, or be turned away from them, or give them up completely; my agreement with them will not be broken, for I am the Lord their God.  
καὶ οὐδ' ὧς ὄντων αὐτῶν ἐν τῇ γῆ τῶν ἐχθρῶν αὐτῶν οὐχ ὑπερεῖδον αὐτοὺς οὐδὲ προσώχθισα αὐτοῖς ὥστε ἐξαναλῶσαι αὐτοὺς τοῦ διασκεδάσαι τὴν διαθήκην μου τὴν πρὸς αὐτούς ὅτι ἐγὼ εἰμι κύριος ὁ θεὸς αὐτῶν
- 45 por për dashuri ndaj tyre do të kujtohem për besëlidhjen e lidhur me stërgjyshërit e tyre, që i nxora nga vendi i Egjiptit para syve të kombeve për të qënë Perëndia i tyre. Unë jam Zoti &quot;;  
And because of them I will keep in mind the agreement which I made with their fathers, whom I took out of the land of Egypt before the eyes of the nations, to be their God: I am the Lord.  
καὶ μνησθήσομαι αὐτῶν τῆς διαθήκης τῆς προτέρας ὅτε ἐξήγαγον αὐτοὺς ἐκ γῆς αἰγύπτου ἐξ οἴκου δουλείας ἐναντι τῶν ἐθνῶν τοῦ εἶναι αὐτῶν θεός ἐγὼ εἰμι κύριος
- 46 Këto janë statutet, dekretet dhe ligjet që Zoti vendosi midis tij dhe bijve të Izraelit, mbi malin Sinai me anë të Moisiut.  
These are the rules, decisions, and laws, which the Lord made between himself and the children of Israel in Mount Sinai, by the hand of Moses.  
ταῦτα τὰ κρίματα καὶ τὰ προστάγματα καὶ ὁ νόμος ὃν ἔδωκεν κύριος ἀνὰ μέσον αὐτοῦ καὶ ἀνὰ μέσον τῶν υἱῶν ἰσραηλ ἐν τῷ ὄρει σινα ἐν χειρὶ μουσῆ

- 1** Zoti i foli akoma Moisiut, duke i thënë:  
**And the Lord said to Moses,**  
*καὶ ἐλάλησεν κύριος πρὸς μοϋσῆν λέγων*
- 2** "Folu bijve të Izraelit dhe u thuaj atyre: Kur një njeri lidh një kusht të rëndësishëm për t'i shenjtëruar Zotit një person dhe mendon t'i japë një barasvlerë,  
**Say to the children of Israel, If a man makes a special oath, you will give your decision as to the value of the persons for the Lord.**  
*λάλησον τοῖς υἱοῖς ἰσραὴλ καὶ ἐρεῖς αὐτοῖς ὅς ἂν εὐζηταὶ εὐχὴν ὥστε τιμὴν τῆς ψυχῆς αὐτοῦ τῷ κυρίῳ*
- 3** në rast se vlerësimi yt ka të bëjë me një mashkull njëzet vjeç e lart, deri në gjashtëdhjetë vjeç, atëherë vlerësimi yt do të jetë pesëdhjetë sikla argjendi, simbas siklit të shenjtërores.  
**And you will put the value of a male from twenty years to sixty years old at fifty shekels of silver, by the scale of the holy place.**  
*ἔσται ἡ τιμὴ τοῦ ἄρσενος ἀπὸ εἰκοσαετοῦς ἕως ἑξηκονταετοῦς ἔσται αὐτοῦ ἡ τιμὴ πενήκοντα δίδραγμα ἀργυρίου τῷ σταθμῷ τῷ ἁγίῳ*
- 4** Po të jetë se ka të bëjë me një grua, vlerësimi yt do të jetë tridhjetë sikla.  
**And if it is a female, the value will be thirty shekels.**  
*τῆς δὲ θηλείας ἔσται ἡ συντίμησις τριάκοντα δίδραγμα*
- 5** Për ata që janë pesë vjeç e lart, deri njëzet vjeç, vlerësimi yt do të jetë njëzet sikla për një mashkull dhe dhjetë sikla për një femër.  
**And if the person is from five to twenty years old, the value will be twenty shekels for a male, and ten for a female.**  
*ἐὰν δὲ ἀπὸ πενταετοῦς ἕως εἴκοσι ἐτῶν ἔσται ἡ τιμὴ τοῦ ἄρσενος εἴκοσι δίδραγμα τῆς δὲ θηλείας δέκα δίδραγμα*
- 6** Nga një muajsh e lart deri në pesë vjeç, vlerësimi yt do të jetë pesë sikla argjendi për një mashkull dhe tri sikla argjendi për një femër.  
**And if the person is from one month to five years old, then the value for a male will be five shekels of silver, and for a female three shekels.**  
*ἀπὸ δὲ μηνιαίου ἕως πενταετοῦς ἔσται ἡ τιμὴ τοῦ ἄρσενος πέντε δίδραγμα ἀργυρίου τῆς δὲ θηλείας τρία δίδραγμα*
- 7** Nga gjashtëdhjetë vjeç e lart vlerësimi yt do të jetë pesëmbëdhjetë sikla për një mashkull dhe dhjetë sikla për një femër.  
**And for sixty years old and over, for a male the value will be fifteen shekels, and for a female, ten.**  
*ἐὰν δὲ ἀπὸ ἑξηκονταετῶν καὶ ἐπάνω ἐὰν μὲν ἄρσεν ᾗ ἔσται ἡ τιμὴ πεντεκαίδεκα δίδραγμα ἀργυρίου ἐὰν δὲ θήλεια δέκα δίδραγμα*
- 8** Por në se ai është tepër i varfër për të paguar shumën e kërkuar nga vlerësimi yt, atëherë do të paraqitet para priftit dhe ky do të bëjë vlerësimin. Prifti do ta bëjë vlerësimin duke pasur parasysh mjetet që ka ai që ka lidhur kushtin.  
**But if he is poorer than the value which you have put on him, then let him be taken to the priest, and the priest will put a value on him, such as it is possible for him to give.**  
*ἐὰν δὲ ταπεινὸς ᾗ τῇ τιμῇ στήσεται ἐναντίον τοῦ ἱερέως καὶ τιμήσεται αὐτὸν ὁ ἱερεὺς καθάπερ ἰσχύει ἡ χεὶρ τοῦ εὐξαμένου τιμήσεται αὐτὸν ὁ ἱερεὺς*
- 9** Në rast se është puna për kafshë që mund t'i paraqiten si ofertë Zotit, çdo kafshë e ofruar Zotit do të jetë gjë e shenjtë.  
**And if it is a beast of which men make offerings to the Lord, whatever any man gives of such to the Lord will be holy.**  
*ἐὰν δὲ ἀπὸ τῶν κτηνῶν τῶν προσφερομένων ἀπ' αὐτῶν δῶρον τῷ κυρίῳ ὅς ἂν δῶ ἀπὸ τούτων τῷ κυρίῳ ἔσται ἅγιον*
- 10** Ai nuk do të mund as ta zëvendësojë, as ta këmbëjë, as një të mirë me një të keqe, as një të keqe me një të mirë; por, edhe sikur të këmbente një kafshë me një tjetër, që të dyja do të jenë gjë e shenjtë.  
**It may not be changed in any way, a good given for a bad, or a bad for a good; if one beast is changed for another, the two will be holy.**  
*οὐκ ἀλλάξει αὐτὸ καλὸν πονηρῷ οὐδὲ πονηρὸν καλῷ ἐὰν δὲ ἀλλάσσω ἀλλάξῃ αὐτὸ κτήνος κτήνει ἔσται αὐτὸ καὶ τὸ ἄλλαγμα ἅγια*
- 11** Por në qoftë se është puna për një kafshë të papastër, që mund t'i ofrohet Zotit, atëherë ai do ta paraqesë kafshën para priftit;  
**And if it is any unclean beast, of which offerings are not made to the Lord, then let him take the beast before the priest;**  
*ἐὰν δὲ πᾶν κτήνος ἀκάθαρτον ἀφ' ὧν οὐ προσφέρεται ἀπ' αὐτῶν δῶρον τῷ κυρίῳ στήσει τὸ κτήνος ἐναντι τοῦ ἱερέως*
- 12** dhe prifti do të bëjë vlerësimin, qoftë kafsha e mirë apo e keqe; çfarëdo vlerësimi të bëjë prifti, ai do të vlejë.  
**And let the priest put a value on it, if it is good or bad; whatever value the priest puts on it, so will it be.**  
*καὶ τιμήσεται αὐτὸ ὁ ἱερεὺς ἀνά μέσον καλοῦ καὶ ἀνά μέσον πονηροῦ καὶ καθότι ἂν τιμήσεται ὁ ἱερεὺς οὕτως στήσεται*
- 13** Por në qoftë se dikush dëshiron ta shpengojë, duhet të shtojë një të pestën e vlerësimin.  
**But if he has a desire to get it back for himself, let him give a fifth more than your value.**  
*ἐὰν δὲ λυτρούμενος λυτρώσῃται αὐτὸ προσθήσει τὸ ἐπίπεμπτον πρὸς τὴν τιμὴν αὐτοῦ*
- 14** Në rast se dikush shenjtëron shtëpinë e tij për ta bërë gjë të shenjtë për Zotin, prifti do të bëjë vlerësimin, qoftë ajo e mirë apo e keqe; çfarëdo vlerësimi të bëjë prifti ai do të vlejë.  
**And if a man has given his house as holy to the Lord, then the priest will put a value on it, if it is good or bad; as the priest gives decision so will the value be fixed.**  
*καὶ ἄνθρωπος ὅς ἂν ἀγάσῃ τὴν οἰκίαν αὐτοῦ ἁγίαν τῷ κυρίῳ καὶ τιμήσεται αὐτὴν ὁ ἱερεὺς ἀνά μέσον καλῆς καὶ ἀνά μέσον πονηρᾶς ὡς ἂν τιμήσεται αὐτὴν ὁ ἱερεὺς οὕτως σταθήσεται*

- 15 Dhe në se ai që ka shenjtëruar shtëpinë e tij dëshiron ta shpengojë, duhet t'i shtojë një të pestën e vlerësimit dhe ajo do të bëhet e tij.  
 And if the owner has a desire to get back his house, let him give a fifth more than your value, and it will be his.  
 ἐὰν δὲ ὁ ἀγίασας αὐτὴν λυτῶται τὴν οἰκίαν αὐτοῦ προσθήσει ἐπ' αὐτὸ τὸ ἐπίπεμπτον τοῦ ἀργυρίου τῆς τιμῆς καὶ ἔσται αὐτῷ
- 16 Në qoftë se dikush i shenjtëron Zotit një arë, pronë e tij, vlerësimi i saj do të bëhet në bazë të farës së nevojshme për të: pesëdhjetë sikla argjendi për një omer farë elbi.  
 And if a man gives to the Lord part of the field which is his property, then let your value be in relation to the seed which is planted in it; a measure of barley grain will be valued at fifty shekels of silver.  
 ἐὰν δὲ ἀπὸ τοῦ ἀγροῦ τῆς κατασχέσεως αὐτοῦ ἀγίαση ἄνθρωπος τῷ κυρίῳ καὶ ἔσται ἡ τιμὴ κατὰ τὸν σπóρον αὐτοῦ κόρου κριθῶν πεντήκοντα δίδραγμα ἀργυρίου
- 17 Në rast se e shenjtëron arën e tij nga viti i jubileut, çmimi do të mbetet ai i caktuar nga vlerësimi yt;  
 If he gives his field from the year of Jubilee, the value will be fixed by your decision.  
 ἐὰν δὲ ἀπὸ τοῦ ἐνιαυτοῦ τῆς ἀφέσεως ἀγίαση τὸν ἀγρὸν αὐτοῦ κατὰ τὴν τιμὴν αὐτοῦ στήσεται
- 18 Por në rast se e shenjtëron arën e tij pas jubileut, prifti do të vlerësojë çmimin e saj duke llogaritur vitet që mbeten deri në jubile, duke pasur parasysh vlerësimin tënd.  
 But if he gives his field after the year of Jubilee, the amount of the money will be worked out by the priest in relation to the number of years till the coming year of Jubilee, and the necessary amount will be taken off your value.  
 ἐὰν δὲ ἔσχατον μετὰ τὴν ἀφῆσιν ἀγίαση τὸν ἀγρὸν αὐτοῦ προσλογιεῖται αὐτῷ ὁ ἱερεὺς τὸ ἀργύριον ἐπὶ τὰ ἔτη τὰ ἐπίλοιπα ἕως εἰς τὸν ἐνιαυτὸν τῆς ἀφέσεως καὶ ἀνθοφαιρεθῆσεται ἀπὸ τῆς συντιμῆσεως αὐτοῦ
- 19 Dhe në qoftë se ai që ka shenjtëruar arën do ta shpengojë, duhet t'i shtojë një të pestën vlerësimit tënd dhe ajo do të mbetet e tij.  
 And if the man who has given the field has a desire to get it back, let him give a fifth more than the price at which it was valued and it will be his.  
 ἐὰν δὲ λυτῶται τὸν ἀγρὸν ὁ ἀγίασας αὐτόν προσθήσει τὸ ἐπίπεμπτον τοῦ ἀργυρίου πρὸς τὴν τιμὴν αὐτοῦ καὶ ἔσται αὐτῷ
- 20 Por në rast se nuk dëshiron ta shpengojë arën e tij ose ia ka shitur një tjetri, nuk do të mund ta shpengojë më;  
 But if he has no desire to get it back, or if he has given it for a price to another man, it may not be got back again.  
 ἐὰν δὲ μὴ λυτῶται τὸν ἀγρὸν καὶ ἀποδῶται τὸν ἀγρὸν ἀνθρώπῳ ἑτέρῳ οὐκέτι μὴ λυτῶσεται αὐτόν
- 21 dhe ara, kur shpengohet në jubile, do të jetë e shenjtë për Zotin si një arë që i është caktuar Perëndisë, dhe do të bëhet pronë e priftit.  
 But the field, when it becomes free at the year of Jubilee, will be holy to the Lord, as a field given under oath: it will be the property of the priest.  
 ἀλλ' ἔσται ὁ ἀγρὸς ἐξεληλυθυίας τῆς ἀφέσεως ἅγιος τῷ κυρίῳ ὡσπερ ἡ γῆ ἢ ἀφορισμένη τῷ ἱερεῖ ἔσται κατὰσχῆσις
- 22 Në rast se dikush i shenjtëron Zotit një arë të blerë prej tij dhe që nuk bën pjesë në pronën e tij,  
 And if a man gives to the Lord a field which he has got for money from another, which is not part of his heritage;  
 ἐὰν δὲ ἀπὸ τοῦ ἀγροῦ οὗ κέκτηται ὃς οὐκ ἔστιν ἀπὸ τοῦ ἀγροῦ τῆς κατασχέσεως αὐτοῦ ἀγίαση τῷ κυρίῳ
- 23 prifti do të caktojë vlerësimin e tij për të deri në vitin e jubileut, dhe ai person do të paguajë po atë ditë çmimin e caktuar, si një gjë të shenjtë për Zotin.  
 Then the value fixed by you up to the year of Jubilee will be worked out for him by the priest, and in that day he will give the amount of your value as holy to the Lord.  
 λογιεῖται πρὸς αὐτόν ὁ ἱερεὺς τὸ τέλος τῆς τιμῆς ἐκ τοῦ ἐνιαυτοῦ τῆς ἀφέσεως καὶ ἀποδώσει τὴν τιμὴν ἐν τῇ ἡμέρᾳ ἐκείνῃ ἅγιον τῷ κυρίῳ
- 24 Vitin e jubileut ara do t'i kthehet atij që i qe blerë dhe pasurisë së cilës ajo bënte pjesë.  
 In the year of Jubilee the field will go back to him from whom he got it, that is, to him whose heritage it was.  
 καὶ ἐν τῷ ἐνιαυτῷ τῆς ἀφέσεως ἀποδοθήσεται ὁ ἀγρὸς τῷ ἀνθρώπῳ παρ' οὗ κέκτηται αὐτόν οὗ ἢν ἢ κατὰσχῆσις τῆς γῆς
- 25 Të gjitha vlerësimet e tua do të bëhen në sikla të shenjtërores; një sikël vlen njëzet gere.  
 And let all your values be based on the shekel of the holy place, that is, twenty gerahs to the shekel.  
 καὶ πᾶσα τιμὴ ἔσται σταθμίσις ἁγίοις εἴκοσι ὀβολοὶ ἔσται τὸ δίδραχμον
- 26 Por asnjëri nuk mund t'i shenjtërojë pjelljet e para të bagëtisë, sepse si të parëlindur i përkasin Zotit; qoftë ka apo qengj, ai i takon Zotit.  
 But a man may not give by oath to the Lord the first-fruits of cattle which are offered to the Lord: if it is an ox or a sheep it is the Lord's.  
 καὶ πᾶν πρωτότοκον ὃ ἂν γένηται ἐν τοῖς κτήνεσίν σου ἔσται τῷ κυρίῳ καὶ οὐ καθαγιάσει οὐθεὶς αὐτό ἐὰν τε μῶσχον ἐὰν τε πρόβατον τῷ κυρίῳ ἔστιν
- 27 Në rast se është puna për një kafshë të papastër, do ta shpengojë simbas çmimit të caktuar nga vlerësimi yt, duke i shtuar një të pestën; në rast se nuk shpengohet, do të shitet me çmimin e caktuar simbas vlerësimit tënd.  
 And if it is an unclean beast, then the owner of it may give money to get it back, in agreement with the value fixed by you, by giving a fifth more; or if it is not taken back, let it be given for money in agreement with your valuing.  
 ἐὰν δὲ τῶν τετραπόδων τῶν ἀκαθάρτων ἀλλάξει κατὰ τὴν τιμὴν αὐτοῦ καὶ προσθήσει τὸ ἐπίπεμπτον πρὸς αὐτό καὶ ἔσται αὐτῷ ἐὰν δὲ μὴ λυτῶται πραθήσεται κατὰ τὸ τίμημα αὐτοῦ

- 28 Megjithatë nuk do të mund të shitet a të shpengohet asgjë nga ato që i janë caktuar Zotit dhe që dikush ka caktuar për Zotin, midis tërë gjërave që i përkasin, qoftë një person, një kafshë o një copë toke nga pasuria e tij; çdo gjë e caktuar Perëndisë është një gjë shumë e shenjtë për Zotin.  
**But nothing which a man has given completely to the Lord, out of all his property, of man or beast, or of the land which is his heritage, may be given away or got back in exchange for money; anything completely given is most holy to the Lord.**  
*πᾶν δὲ ἀνάθεμα ὃ ἐὰν ἀναθῆ ἄνθρωπος τῷ κυρίῳ ἀπὸ πάντων ὅσα αὐτῷ ἐστὶν ἀπὸ ἀνθρώπου ἕως κτήνους καὶ ἀπὸ ἀγροῦ κατασχέσεως αὐτοῦ οὐκ ἀποδώσεται οὐδὲ λυτρώσεται πᾶν ἀνάθεμα ἅγιον ἄγιον ἔσται τῷ κυρίῳ*
- 29 Asnjë person i caktuar të shfaroset nuk mund të shpengohet; ai duhet të vritet.  
**Any man given completely to the Lord may not be got back: he is certainly to be put to death.**  
*καὶ πᾶν ὃ ἐὰν ἀνατεθῆ ἀπὸ τῶν ἀνθρώπων οὐ λυτρωθήσεται ἀλλὰ θανάτῳ θανατωθήσεται*
- 30 Çdo e dhjetë e tokës, qoftë nga prodhimet e tokës, qoftë nga pemët e drurëve, i takon Zotit; është një gjë e shenjtëruar Zotit.  
**And every tenth part of the land, of the seed planted, or of the fruit of trees, is holy to the Lord.**  
*πᾶσα δεκάτη τῆς γῆς ἀπὸ τοῦ σπέρματος τῆς γῆς καὶ τοῦ καρποῦ τοῦ ξυλίνου τῷ κυρίῳ ἐστὶν ἅγιον τῷ κυρίῳ*
- 31 Në se dikush do të shpengojë një pjesë të së dhjetës së vet, do t'i shtojë një të pestën.  
**And if a man has a desire to get back any of the tenth part which he has given, let him give a fifth more.**  
*ἐὰν δὲ λυτρωταὶ λύτρῳ ἄνθρωπος τὴν δεκάτην αὐτοῦ τὸ ἐπίπεμπτον προσθήσει πρὸς αὐτὸ καὶ ἔσται αὐτῷ*
- 32 Dhe për të dhjetën e bagëtive të trasha dhe të imta, koka e dhjetë e të gjitha kafshëve që kalojnë nën shufrën do t'i shenjtërohet Zotit.  
**And a tenth part of the herd and of the flock, whatever goes under the rod of the valuer, will be holy to the Lord.**  
*καὶ πᾶσα δεκάτη βοῶν καὶ προβάτων καὶ πᾶν ὃ ἐὰν ἔλθῃ ἐν τῷ ἀριθμῷ ὑπὸ τὴν ῥάβδον τὸ δέκατον ἔσται ἅγιον τῷ κυρίῳ*
- 33 Nuk do të bëjë dallim midis së mirës dhe të keqes, as do të bëjë këmbime; dhe po të këmbejë njërën me tjetrën, të dyja do të jenë gjë e shenjtë; nuk do të mund të shpengohen.  
**He may not make search to see if it is good or bad, or make any changes in it; and if he makes exchange of it for another, the two will be holy; he will not get them back again.**  
*οὐκ ἀλλάξεις καλὸν πονηρῷ ἐὰν δὲ ἀλλάσῃς ἀλλάξῃς αὐτὸ καὶ τὸ ἀλλαγμᾶ αὐτοῦ ἔσται ἅγιον οὐ λυτρωθήσεται*
- 34 Këto janë urdhërimet që Zoti i dha Moisiut për bijtë e Izraelit në malin Sinai.  
**These are the orders which the Lord gave to Moses for the children of Israel in Mount Sinai.**  
*αὗται εἰσὶν αἱ ἐντολαὶ ἃς ἐνετείλατο κύριος τῷ μουσῇ πρὸς τοὺς υἱοὺς ἰσραὴλ ἐν τῷ ὄρει σινα .*
- 1 Zoti i foli akoma Moisiut në shkretëtirën e Sinaït, në çadrën e mbledhjes, ditën e parë të muajit të dytë, gjatë vitit të dytë nga dalja e tyre nga vendi i Egjiptit, dhe i tha:  
**And the Lord said to Moses in the waste land of Sinai, in the Tent of meeting, on the first day of the second month, in the second year after they came out of the land of Egypt,**  
*καὶ ἐλάλησεν κύριος πρὸς μουσῆν ἐν τῇ ἐρήμῳ τῇ σινα ἐν τῇ σκηνῇ τοῦ μαρτυρίου ἐν μῇ τοῦ μηνὸς τοῦ δευτέρου ἔτους δευτέρου ἐξεληθόντων αὐτῶν ἐκ γῆς αἰγύπτου λέγων*
- 2 &quot;Bëni regjistrimin e gjithë asamblesë së bijve të Izraelit në bazë të familjeve të tyre dhe të shtëpive të etërve të tyre, duke numëruar një për një emrat e çdo mashkulli.  
**Take the full number of the children of Israel, by their families, and by their fathers' houses, every male by name;**  
*λάβετε ἀρχὴν πάσης συναγωγῆς υἱῶν ἰσραὴλ κατὰ συγγενείας αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ἐξ ὀνόματος αὐτῶν κατὰ κεφαλὴν αὐτῶν πᾶς ἄρσῃν*
- 3 Nga moshë njëzet vjeç e lart, të gjithë ata që në Izrael mund të shkojnë në luftë; ti dhe Aaroni do t'i regjistroni, grup pas grupi.  
**All those of twenty years old and over, who are able to go to war in Israel, are to be numbered by you and Aaron.**  
*ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκπορευόμενος ἐν δυνάμει ἰσραὴλ ἐπισκέψασθε αὐτοὺς σὺν δυνάμει αὐτῶν σὺ καὶ ααρὼν ἐπισκέψασθε αὐτούς*
- 4 Dhe me ju do të jetë një burrë për çdo fis, një që të jetë i pari i shtëpisë së atit të tij.  
**And to give you help, take one man from every tribe, the head of his father's house.**  
*καὶ μεθ' ὑμῶν ἔσονται ἕκαστος κατὰ φυλὴν ἐκάστου ἀρχόντων κατ' οἴκους πατριῶν ἔσονται*
- 5 Këta janë emrat e burrave që do të jenë me ju. nga Ruben, Elitsur, bir i Shedeutit;  
**These are the names of those who are to be your helpers: from Reuben, Elizur, the son of Shedeut;**  
*καὶ ταῦτα τὰ ὀνόματα τῶν ἀνδρῶν οἵτινες παραστήσονται μεθ' ὑμῶν τῶν ρουβην ελισουρ υἱὸς σεδιουρ*
- 6 nga Simeoni, Shelumieli, bir i Tsurishadait;  
**From Simeon, Shelumiel, the son of Zurishaddai;**  
*τῶν συμειων σαλαμιελ υἱὸς σουρισαδα*

- 7 nga Juda, Nahshoni, bir i Aminadabit;  
From Judah, Nahshon, the son of Amminadab;  
τῶν ιουδα ναασσον υἱὸς αμιναδαβ
- 8 nga Isakari, Nethaneeli, bir i Tsuarit;  
From Issachar, Nethanel, the son of Zuar;  
τῶν ισσαχαρ ναθαναηλ υἱὸς σωγαρ
- 9 nga Zabuloni, Eliabi, bir i Helonit;  
From Zebulun, Eliab, the son of Helon;  
τῶν ζαβουλων ελιαβ υἱὸς χαιλων
- 10 nga bijtë e Jozefit, për Efraimin, Elishama, bir i Amihudit; për Manasën, Gamalieli, bir i Pedahtsurit;  
Of the children of Joseph: from Ephraim, Elishama, the son of Ammihud; from Manasseh, Gamaliel, the son of Pedahzur,  
τῶν υἱῶν ιωσηφ τῶν εφραϊμ ελισαμα υἱὸς εμιουδ τῶν μανασση γαμαλιηλ υἱὸς φαδασσουρ
- 11 nga Beniamini, Abidani, bir i Gideonit;  
From Benjamin, Abidan, the son of Gideon;  
τῶν βενιαμιν αβιδαν υἱὸς γαδεωνι
- 12 nga Dani, Ahiezeri, bir i Amishadaidit;  
From Dan, Ahiezer, the son of Ammi-shaddai;  
τῶν δαν αχιεζερ υἱὸς αμισαδαι
- 13 nga Asheri, Pagieli, bir i Okranit;  
From Asher, Pagiel, the son of Ochran;  
τῶν ασηρ φαγιαηλ υἱὸς εχραν
- 14 nga Gadi, Eliasafi, bir i Deuelit;  
From Gad, Eliasaph, the son of Reuel;  
τῶν γαδ ελισαφ υἱὸς ραγουηλ
- 15 nga Neftali, Ahira, bir i Enanit&quot;;  
From Naphtali, Ahira, the son of Enan.  
τῶν νεφθαλι αχιρε υἱὸς αιναν
- 16 Këta janë ata që u zgjodhën nga asambleja, prijësit e fiseve të etërve të tyre, krerët e divizioneve të Izraelit.  
These are the men named out of all the people, chiefs of their fathers' houses, heads of the tribes of Israel.  
οὗτοι ἐπίκλητοι τῆς συναγωγῆς ἄρχοντες τῶν φυλῶν κατὰ πατριὰς χιλιάρχοι ἰσραηλ εἰσὶν
- 17 Moisiu dhe Aaroni morën, pra, këta burra që ishin caktuar me emër,  
And Moses and Aaron took these men, marked out by name;  
καὶ ἔλαβεν μουσῆς καὶ ααρων τοὺς ἄνδρας τούτους τοὺς ἀνακληθέντας ἐξ ὀνόματος
- 18 dhe thirrën tërë asamblenë, ditën e parë të muajit të dytë; ata u treguan fisin e tyre, në bazë të familjeve të tyre dhe të shtëpive të etërve të tyre, duke numëruar personat me moshë njëzet vjeç e lart, një për një.  
And they got together all the people on the first day of the second month; and everyone made clear his family and his father's house, by the number of the names, from twenty years old and over.  
καὶ πᾶσαν τὴν συναγωγὴν συνήγαγον ἐν μιᾷ τοῦ μηνὸς τοῦ δευτέρου ἔτους καὶ ἐπηξονοῦσαν κατὰ γενέσεις αὐτῶν κατὰ πατριὰς αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ὀνομάτων αὐτῶν ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶν ἄρσενικὸν κατὰ κεφαλὴν αὐτῶν
- 19 Ashtu si Zoti pat urdhëruar Moisiun, ai bëri regjistrimin e tyre në shkretëtirën e Sinait.  
As the Lord had given orders to Moses, so they were numbered by him in the waste place of Sinai.  
ὄν τρόπον συνέταξεν κύριος τῷ μουσῆ καὶ ἐπεσκέπησαν ἐν τῇ ἐρήμῳ τῆ σινα

- 20 Nga bijtë e Rubenit, i parë linduri i Izraelit, trashëgimtarët e tyre në bazë të familjeve të tyre dhe të shtëpive të etërve të tyre, duke numëruar emrat e të gjithë meshkujve, një për një, nga mosha njëzet vjeç e lart, tërë ata që ishin të aftë të shkonin në luftë:  
The generations of the sons of Reuben, the oldest son of Israel, were numbered by their families and their fathers' houses, every male of twenty years old and over, who was able to go to war;  
καὶ ἐγένοντο οἱ υἱοὶ ρουβην πρωτοτόκου ἰσραὴλ κατὰ συγγενείας αὐτῶν κατὰ δήμους αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ὀνομάτων αὐτῶν πάντα ἀρσενικὰ ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκπορευόμενος ἐν τῇ δυνάμει
- 21 ata që u regjistruan nga fisi i Rubenit ishin dyzet e gjashtë mijë e pesëqind.  
Forty-six thousand, five hundred of the tribe of Reuben were numbered.  
ἡ ἐπίσκεψις αὐτῶν ἐκ τῆς φυλῆς ρουβην ἕξ καὶ τεσσαράκοντα χιλιάδες καὶ πεντακόσιοι
- 22 Nga bijtë e Simeonit, trashëgimtarët e tyre në bazë të familjeve të tyre dhe të shtëpive të etërve të tyre, ata që u regjistruan duke numëruar emrat e të gjithë meshkujve, një për një, nga mosha njëzet vjeç e lart, të gjithë ata që ishin të aftë të shkonin në luftë:  
The generations of the sons of Simeon were numbered by their families and their fathers' houses, every male of twenty years old and over, who was able to go to war;  
τοὺς υἱοὺς σιμων κατὰ συγγενείας αὐτῶν κατὰ δήμους αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ὀνομάτων αὐτῶν κατὰ κεφαλὴν αὐτῶν πάντα ἀρσενικὰ ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκπορευόμενος ἐν τῇ δυνάμει
- 23 ata që u regjistruan nga fisi i Simeonit ishin pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind.  
Fifty-nine thousand, three hundred of the tribe of Simeon were numbered.  
ἡ ἐπίσκεψις αὐτῶν ἐκ τῆς φυλῆς σιμων ἑννέα καὶ πενήκοντα χιλιάδες καὶ τριακόσιοι
- 24 Nga bijtë e Gadit, trashëgimtarët e tyre në bazë të familjeve të tyre dhe të shtëpive të etërve të tyre, duke numëruar emrat e atyre që ishin njëzet vjeç e lart, të gjithë ata që ishin të aftë të shkonin në luftë:  
The generations of the sons of Gad were numbered by their families and their fathers' houses, every male of twenty years old and over who was able to go to war;  
τοὺς υἱοὺς ἰουδα κατὰ συγγενείας αὐτῶν κατὰ δήμους αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ὀνομάτων αὐτῶν κατὰ κεφαλὴν αὐτῶν πάντα ἀρσενικὰ ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκπορευόμενος ἐν τῇ δυνάμει
- 25 ata që u regjistruan nga fisi i Gadit ishin dyzet e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë.  
Forty-five thousand, six hundred and fifty of the tribe of Gad were numbered.  
ἡ ἐπίσκεψις αὐτῶν ἐκ τῆς φυλῆς ἰουδα τέσσαρες καὶ ἑβδομήκοντα χιλιάδες καὶ ἑξακόσιοι
- 26 Nga bijtë e Judës, trashëgimtarët e tyre në bazë të familjeve të tyre dhe të shtëpive të etërve të tyre, duke i numëruar emrat e tyre nga njëzet vjeç e lart, të gjithë ata që ishin të aftë të shkonin në luftë:  
The generations of the sons of Judah were numbered by their families and their fathers' houses, every male of twenty years old and over who was able to go to war;  
τοὺς υἱοὺς ἰσσαχαρ κατὰ συγγενείας αὐτῶν κατὰ δήμους αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ὀνομάτων αὐτῶν κατὰ κεφαλὴν αὐτῶν πάντα ἀρσενικὰ ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκπορευόμενος ἐν τῇ δυνάμει
- 27 ata që u regjistruan nga fisi i Judës ishin shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind.  
Seventy-four thousand, six hundred of the tribe of Judah were numbered.  
ἡ ἐπίσκεψις αὐτῶν ἐκ τῆς φυλῆς ἰσσαχαρ τέσσαρες καὶ πενήκοντα χιλιάδες καὶ τετρακόσιοι
- 28 Nga bijtë e Isakarit, trashëgimtarët e tyre në bazë të familjeve të tyre dhe të shtëpive të etërve të tyre, duke i numëruar emrat nga njëzet vjeç e lart, të gjithë ata që ishin të aftë të shkonin në luftë:  
The generations of the sons of Issachar were numbered by their families and their fathers' houses, every male of twenty years old and over who was able to go to war;  
τοὺς υἱοὺς ζαβουλων κατὰ συγγενείας αὐτῶν κατὰ δήμους αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ὀνομάτων αὐτῶν κατὰ κεφαλὴν αὐτῶν πάντα ἀρσενικὰ ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκπορευόμενος ἐν τῇ δυνάμει
- 29 ata që u regjistruan nga fisi i Isakarit ishin pesëdhjetë e katër mijë e katërqind.  
Fifty-four thousand, four hundred of the tribe of Issachar were numbered.  
ἡ ἐπίσκεψις αὐτῶν ἐκ τῆς φυλῆς ζαβουλων ἑπτὰ καὶ πενήκοντα χιλιάδες καὶ τετρακόσιοι
- 30 Nga bijtë e Zabulonit, trashëgimtarët e tyre në bazë të familjeve dhe të shtëpive të etërve të tyre duke i numëruar nga mosha njëzet vjeç e lart, të gjithë ata që ishin të aftë të shkonin në luftë:  
The generations of the sons of Zebulun were numbered by their families and their fathers' houses, every male of twenty years old and over who was able to go to war;  
τοὺς υἱοὺς ἰωσηφ υἱοὺς εφραϊμ κατὰ συγγενείας αὐτῶν κατὰ δήμους αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ὀνομάτων αὐτῶν κατὰ κεφαλὴν αὐτῶν πάντα ἀρσενικὰ ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκπορευόμενος ἐν τῇ δυνάμει

- 31 ata që u regjistruan nga fisi i Zabulonit ishin pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind.  
**Fifty-seven thousand, four hundred of the tribe of Zebulun were numbered.**  
 ή επίσκεψις αὐτῶν ἐκ τῆς φυλῆς εφραϊμ τεσσαράκοντα χιλιάδες καὶ πεντακόσιοι
- 32 Ndër bijtë e Jozefit: nga bijtë e Efraimit, trashëgimtarët e tyre në bazë të familjeve dhe të shtëpive të etërve të tyre, duke i numëruar emrat nga mosha njëzet vjeç e lart, të gjithë ata që ishin të aftë për të shkuar në luftë:  
**The generations of the sons of Joseph were numbered by their families and their fathers' houses, every male of twenty years old and over who was able to go to war;**  
 τοῖς υἱοῖς μανασση κατὰ συγγενείας αὐτῶν κατὰ δήμους αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ὀνομάτων αὐτῶν κατὰ κεφαλὴν αὐτῶν πάντα ἀρσενικὰ ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκ πορευόμενος ἐν τῇ δυνάμει
- 33 ata që u regjistruan nga fisi i Efraimit ishin dyzet mijë e pesëqind.  
**Forty thousand, five hundred of the tribe of Ephraim were numbered.**  
 ή επίσκεψις αὐτῶν ἐκ τῆς φυλῆς μανασση δύο καὶ τριάκοντα χιλιάδες καὶ διακόσιοι
- 34 Nga bijtë e Manasit, trashëgimtarët e tyre në bazë të familjeve dhe të shtëpive të etërve të tyre, duke i numëruar emrat nga mosha njëzet vjeç e lart, të gjithë ata që ishin të aftë të shkonin në luftë:  
**The generations of the sons of Manasseh were numbered by their families and their fathers' houses, every male of twenty years old and over who was able to go to war;**  
 τοῖς υἱοῖς βενιαμιν κατὰ συγγενείας αὐτῶν κατὰ δήμους αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ὀνομάτων αὐτῶν κατὰ κεφαλὴν αὐτῶν πάντα ἀρσενικὰ ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκ πορευόμενος ἐν τῇ δυνάμει
- 35 ata që u regjistruan nga fisi i Manasit ishin tridhjetë e dy mijë e dyqind.  
**Thirty-two thousand, two hundred of the tribe of Manasseh were numbered.**  
 ή επίσκεψις αὐτῶν ἐκ τῆς φυλῆς βενιαμιν πέντε καὶ τριάκοντα χιλιάδες καὶ τετρακόσιοι
- 36 Nga bijtë e Beniaminit, trashëgimtarët e tyre në bazë të familjeve të tyre dhe të etërve të tyre, duke i numëruar emrat nga mosha njëzet vjeç e lart, të gjithë ata që ishin të aftë të shkonin në luftë:  
**The generations of the sons of Benjamin were numbered by their families and their fathers' houses, every male of twenty years old and over who was able to go to war;**  
 τοῖς υἱοῖς γαδ κατὰ συγγενείας αὐτῶν κατὰ δήμους αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ὀνομάτων αὐτῶν κατὰ κεφαλὴν αὐτῶν πάντα ἀρσενικὰ ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκπορευόμενος ἐν τῇ δυνάμει
- 37 ata që u regjistruan nga fisi i Beniaminit ishin tridhjetë e pesë mijë e katërqind.  
**Thirty-five thousand, four hundred of the tribe of Benjamin were numbered.**  
 ή επίσκεψις αὐτῶν ἐκ τῆς φυλῆς γαδ πέντε καὶ τεσσαράκοντα χιλιάδες καὶ ἑξακόσιοι καὶ πενήκοντα
- 38 Nga bijtë e Danit, trashëgimtarët e tyre në bazë të familjeve dhe të shtëpive të etërve të tyre, duke i numëruar emrat nga mosha njëzet vjeç e lart, të gjithë ata që ishin të aftë të shkonin në luftë:  
**The generations of the sons of Dan were numbered by their families and their fathers' houses, every male of twenty years and over who was able to go to war;**  
 τοῖς υἱοῖς δαν κατὰ συγγενείας αὐτῶν κατὰ δήμους αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ὀνομάτων αὐτῶν κατὰ κεφαλὴν αὐτῶν πάντα ἀρσενικὰ ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκπορευόμενος ἐν τῇ δυνάμει
- 39 ata që u regjistruan nga fisi i Danit ishin gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind.  
**Sixty-two thousand, seven hundred of the tribe of Dan were numbered.**  
 ή επίσκεψις αὐτῶν ἐκ τῆς φυλῆς δαν δύο καὶ ἐξήκοντα χιλιάδες καὶ ἑπτακόσιοι
- 40 Nga bijtë e Asherit, trashëgimtarët e tyre në bazë të familjeve të tyre dhe të shtëpive të etërve të tyre, duke i numëruar emrat nga mosha njëzet vjeç e lart, të gjithë ata që ishin të aftë të shkonin në luftë:  
**The generations of the sons of Asher were numbered by their families and their fathers' houses, every male of twenty years old and over who was able to go to war;**  
 τοῖς υἱοῖς ασηρ κατὰ συγγενείας αὐτῶν κατὰ δήμους αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ὀνομάτων αὐτῶν κατὰ κεφαλὴν αὐτῶν πάντα ἀρσενικὰ ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκπορευόμενος ἐν τῇ δυνάμει
- 41 ata që u regjistruan nga fisi i Asherit ishin dyzet e një mijë e pesëqind.  
**Forty-one thousand, five hundred of the tribe of Asher were numbered.**  
 ή επίσκεψις αὐτῶν ἐκ τῆς φυλῆς ασηρ μία καὶ τεσσαράκοντα χιλιάδες καὶ πεντακόσιοι
- 42 Nga bijtë e Neftalit, trashëgimtarët e tyre në bazë të familjeve të tyre dhe të shtëpive të etërve të tyre, duke i numëruar emrat nga mosha njëzet vjeç e lart, të gjithë ata që ishin të aftë të shkonin në luftë:  
**The generations of the sons of Naphtali were numbered by their families and their fathers' houses, every male of twenty years old and over who was able to go to war;**  
 τοῖς υἱοῖς νεφθαλι κατὰ συγγενείας αὐτῶν κατὰ δήμους αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν ὀνομάτων αὐτῶν κατὰ κεφαλὴν αὐτῶν πάντα ἀρσενικὰ ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκπορευόμενος ἐν τῇ δυνάμει

- 43 ata që u regjistruan nga fisi i Neftalit ishin pesëdhjetë e tre mijë e katërqind.  
Fifty-three thousand, four hundred of the tribe of Naphtali were numbered.  
ή επίσκεψις αὐτῶν ἐκ τῆς φυλῆς νεφθαλί τρεῖς καὶ πενήκοντα χιλιάδες καὶ τετρακόσιοι
- 44 Këta ishin të regjistruarit nga Moisiu dhe Aaroni, së bashku me dymbëdhjetë burrat, prijës të Izraelit, secili përfaqësues i shtëpisë së atit të tij.  
These are they who were numbered by Moses and Aaron and by the twelve chiefs of Israel, one from every tribe.  
αὕτη ἡ επίσκεψις ἦν ἐπεσκέψαντο μουσῆς καὶ ααρὼν καὶ οἱ ἄρχοντες ἰσραηλ δώδεκα ἄνδρες ἀνὴρ εἷς κατὰ φυλὴν μίαν κατὰ φυλὴν οἴκων πατριᾶς ἦσαν
- 45 Kështu tërë bijtë e Izraelit që u regjistruan në bazë të shtëpive të etërve të tyre, nga mosha njëzet vjeç e lart, domethënë tërë njerëzit që në Izrael ishin të aftë të shkonin në luftë,  
So all those who were numbered of the children of Israel, by their families, all those of twenty years old and over who were able to go to war,  
καὶ ἐγένετο πᾶσα ἡ επίσκεψις υἰῶν ἰσραηλ σὺν δυνάμει αὐτῶν ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω πᾶς ὁ ἐκπορευόμενος παρατάξασθαι ἐν ἰσραηλ.
- 46 të gjithë ata që u regjistruan ishin gjashtëqind e tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë.  
Were six hundred and three thousand, five hundred and fifty.  
ἑξακόσιοι χιλιάδες καὶ τρισχίλιοι καὶ πεντακόσιοι καὶ πενήκοντα
- 47 Por Levitët nuk u regjistruan bashkë me të tjerët, simbas fisit të etërve të tyre,  
But the Levites, of the tribe of their fathers, were not numbered among them.  
οἱ δὲ λευῖται ἐκ τῆς φυλῆς πατριᾶς αὐτῶν οὐκ ἐπεσκέπησαν ἐν τοῖς υἰοῖς ἰσραηλ
- 48 sepse Zoti i kishte folur Moisiut, duke i thënë:  
For the Lord said to Moses,  
καὶ ἐλάλησεν κύριος πρὸς μουσῆν λέγων
- 49 "Vetëm në fisin e Levit nuk do të bësh regjistrimin dhe nuk do të llogaritësh numrin e tyre me bijtë e Izraelit;  
Only the tribe of Levi is not to be numbered among the children of Israel,  
ὄρα τὴν φυλὴν τὴν λευὶ οὐ συνεπισκέψη καὶ τὸν ἀριθμὸν αὐτῶν οὐ λήμψη ἐν μέσῳ τῶν υἰῶν ἰσραηλ
- 50 por besojo Levitëve kujdesin për tabernakullin e dëshmisë, për të gjitha orënditë e tij dhe për çdo gjë që i përket. Ata do të mbartin tabernakullin dhe tërë orënditë e tij, do të bëjnë shërbimin dhe do të fushojnë rreth tabernakullit.  
But to them you are to give the care of the Tent of meeting with its vessels and everything in it: they are to take up the Tent, and be responsible for everything to do with it, and put up their tents round it.  
καὶ σὺ ἐπίστησον τοὺς λευῖτας ἐπὶ τὴν σκηνὴν τοῦ μαρτυρίου καὶ ἐπὶ πάντα τὰ σκεύη αὐτῆς καὶ ἐπὶ πάντα ὅσα ἐστὶν ἐν αὐτῇ αὐτοὶ ἀροῦσιν τὴν σκηνὴν καὶ πάντα τὰ σκεύη αὐτῆς καὶ αὐτοὶ λειτουργήσουσιν ἐν αὐτῇ καὶ κύκλῳ τῆς σκηνῆς παρεμβалоῦσιν
- 51 Kur tabernakulli duhet të zhvendoset, Levitët do ta bëjnë pjesë-pjesë; kur tabernakulli duhet të ndalet, ata do ta ngrenë; dhe i huaji që do të afrohet do të dënohet me vdekje.  
And when the Tent of meeting goes forward, the Levites are to take it down; and when it is to be put up, they are to do it: any strange person who comes near it is to be put to death.  
καὶ ἐν τῷ ἐξάιρειν τὴν σκηνὴν καθελοῦσιν αὐτὴν οἱ λευῖται καὶ ἐν τῷ παρεμβάλλειν τὴν σκηνὴν ἀναστήσουσιν καὶ ὁ ἀλλογενὴς ὁ προσπορευόμενος ἀποθανέτω
- 52 Bijtë e Izraelit do t'i ngrenë çadrat e tyre secili në kampin e vet, secili pranë flamurit të vet, simbas renditjes së tyre.  
The children of Israel are to put up their tents, every man in his tent-circle round his flag.  
καὶ παρεμβалоῦσιν οἱ υἰοὶ ἰσραηλ ἀνὴρ ἐν τῇ ἑαυτοῦ τάξει καὶ ἀνὴρ κατὰ τὴν ἑαυτοῦ ἡγεμονίαν σὺν δυνάμει αὐτῶν
- 53 Por Levitët do t'i ngrenë çadrat e tyre rreth tabernakullit të dëshmisë me qëllim që mëria ime të mos bjerë mbi asamblenë e bijve të Izraelit; kështu Levitët do të kujdesen për tabernakullin e dëshmisë";  
But the tents of the Levites are to be round the Tent of meeting, so that wrath may not come on the children of Israel: the Tent of meeting is to be in the care of the Levites.  
οἱ δὲ λευῖται παρεμβαλέτωσαν ἐναντίον κυρίου κύκλῳ τῆς σκηνῆς τοῦ μαρτυρίου καὶ οὐκ ἔσται ἁμάρτημα ἐν υἰοῖς ἰσραηλ καὶ φυλάξουσιν οἱ λευῖται αὐτοὶ τὴν φυλακὴν τῆς σκηνῆς τοῦ μαρτυρίου
- 54 Bijtë e Izraelit iu binden gjithçkaje që Zoti kishte urdhëruar Moisiun, dhe kështu bënë.  
So the children of Israel did as the Lord had given orders to Moses.  
καὶ ἐποίησαν οἱ υἰοὶ ἰσραηλ κατὰ πάντα ἃ ἐνετείλατο κύριος τῷ μουσῆ καὶ ααρὼν οὕτως ἐποίησαν
- 1 Zoti i foli akoma Moisiut dhe Aaronit, duke u thënë:  
And the Lord said to Moses and Aaron,  
καὶ ἐλάλησεν κύριος πρὸς μουσῆν καὶ ααρὼν λέγων



- 2 &quot;Bijtë e Izraelit do të vendosen secili pranë flamurit të vet nën shenjat e shtëpisë së etërve të tyre; do të vendosen rreth e rrotull çadrës së mbledhjes, por në një farë largësie prej saj.  
The children of Israel are to put up their tents in the order of their families, by the flags of their fathers' houses, facing the Tent of meeting on every side.  
ἀνθρωπος ἐχόμενος αὐτοῦ κατὰ τάγμα κατὰ σημέας κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν παρεμβάλετοσαν οἱ υἱοὶ ἰσραηλ ἐναντίο κύκλω τῆς σκηνῆς τοῦ μαρτυρίου παρεμβάλοσιν οἱ υἱοὶ ἰσραηλ.
- 3 Në krahun lindor, ndaj diellit që po ngrihet, do të vendoset flamuri i kampit të Judës simbas renditjes së tij; prijësi i bijve të Efraimit është Nashoni, bir i Aminadabit;  
Those whose tents are on the east side, looking to the dawn, will be round the flag of the children of Judah, with Nahshon, the son of Amminadab, as their chief.  
καὶ οἱ παρεμβάλλοντες πρῶτοι κατ' ἀνατολὰς τάγμα παρεμβολῆς ἰουδα σὺν δυνάμει αὐτῶν καὶ ὁ ἄρχων τῶν υἱῶν ἰουδα ναασσων υἱὸς ἀμιναδαβ
- 4 ata që u regjistruan në divizionin e tij ishin shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind.  
The number of his army was seventy-four thousand, six hundred.  
δύναμις αὐτοῦ οἱ ἐπεσκεμμένοι τέσσαρες καὶ ἑβδομήκοντα χιλιάδες καὶ ἑξακόσιοι
- 5 Pranë tij do të vendoset fisi i Isakarit; prijësi i bijve të Isakarit është Nethaneeli, bir i Tsuarit;  
And nearest to him will be the tribe of Issachar, with Nethanel, the son of Zuar, as their chief.  
καὶ οἱ παρεμβάλλοντες ἐχόμενοι φυλῆς ἰσσαχαρ καὶ ὁ ἄρχων τῶν υἱῶν ἰσσαχαρ ναθαναιλ υἱὸς σωγαρ
- 6 ata që u regjistruan në divizionin e tij ishin pesëqind e katër mijë e katërqind.  
The number of his army was fifty-four thousand, four hundred.  
δύναμις αὐτοῦ οἱ ἐπεσκεμμένοι τέσσαρες καὶ πενήκοντα χιλιάδες καὶ τετρακόσιοι
- 7 Pastaj do të vijë fisi i Zabulonit; prijësi i bijve të Zabulonit është Eliabi, bir i Helonit;  
After him, the tribe of Zebulun, with Eliab, the son of Helon, as their chief.  
καὶ οἱ παρεμβάλλοντες ἐχόμενοι φυλῆς ζαβουλων καὶ ὁ ἄρχων τῶν υἱῶν ζαβουλων ελιαβ υἱὸς χαλων
- 8 ata që u regjistruan në divizionin e tij ishin pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind.  
The number of his army was fifty-seven thousand, four hundred.  
δύναμις αὐτοῦ οἱ ἐπεσκεμμένοι ἑπτὰ καὶ πενήκοντα χιλιάδες καὶ τετρακόσιοι
- 9 Të gjithë ata që u regjistruan në kampin e Judës, simbas ndarjeve të tij, ishin njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind. Ata do ta fillojnë marshimin të parët.  
The number of all the armies of Judah was a hundred and eighty-six thousand, four hundred. They go forward first.  
πάντες οἱ ἐπεσκεμμένοι ἐκ τῆς παρεμβολῆς ἰουδα ἑκατὸν ὀγδοήκοντα χιλιάδες καὶ ἑξακισχίλιοι καὶ τετρακόσιοι σὺν δυνάμει αὐτῶν πρῶτοι ἐξαροῦσιν
- 10 Në krahun jugor do të vihet flamuri i kampit të Rubenit simbas renditjes së ushtarëve të tij; dhe prijësi i bijve të Rubenit është Elitsuri, bir i Shedeutit;  
On the south side is the flag of the children of Reuben, in the order of their armies, with Elizur, the son of Shedeur, as their chief.  
τάγμα παρεμβολῆς ρουβην πρὸς λίβα σὺν δυνάμει αὐτῶν καὶ ὁ ἄρχων τῶν υἱῶν ρουβην ελισουρ υἱὸς σεδιουρ
- 11 dhe ata që u regjistruan në divizionin e tij ishin dyzet e gjashtë mijë e pesëqind.  
The number of his army was forty-six thousand, five hundred.  
δύναμις αὐτοῦ οἱ ἐπεσκεμμένοι ἑξ καὶ τεσσαράκοντα χιλιάδες καὶ πεντακόσιοι
- 12 Pranë tij do të vendoset fisi i Simeonit; dhe prijësi i bijve të Simeonit është Shelumjeli, bir i Tsurishadait;  
And nearest to him, the tribe of Simeon, with Shelumiel, the son of Zurishaddai, as their chief.  
καὶ οἱ παρεμβάλλοντες ἐχόμενοι αὐτοῦ φυλῆς σιμεων καὶ ὁ ἄρχων τῶν υἱῶν σιμεων σαλαμιηλ υἱὸς σουρισαδαι
- 13 ata që u regjistruan në divizionin e tij ishin pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind.  
The number of his army was fifty-nine thousand, three hundred.  
δύναμις αὐτοῦ οἱ ἐπεσκεμμένοι ἑννέα καὶ πενήκοντα χιλιάδες καὶ τριακόσιοι
- 14 Pastaj do të vijë fisi i Gadit; prijësi i bijve të Gadit është Eliasafi, bir i Reuelit,  
Then the tribe of Gad, with Eliasaph, son of Reuel, as their chief.  
καὶ οἱ παρεμβάλλοντες ἐχόμενοι αὐτοῦ φυλῆς γαδ καὶ ὁ ἄρχων τῶν υἱῶν γαδ ελισταφ υἱὸς ραγουηλ
- 15 ata që u regjistruan në divizionin e tij ishin dyzet e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë.  
The number of his army was forty-five thousand, six hundred and fifty.  
δύναμις αὐτοῦ οἱ ἐπεσκεμμένοι πέντε καὶ τεσσαράκοντα χιλιάδες καὶ ἑξακόσιοι καὶ πενήκοντα

- 16 Tërë ata që janë regjistruar në kampin e Rubenit, simbas divizioneve të tyre, ishin njëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë. Këta do ta fillojnë marshimin të dytë.  
**The number of all the armies of Reuben together came to a hundred and fifty-one thousand, four hundred and fifty. They go forward second.**  
*πάντες οἱ ἐπισκεμμένοι τῆς παρεμβολῆς ρουβην ἑκατὸν πενήκοντα μία χιλιάδες καὶ τετρακόσιοι καὶ πενήκοντα σὺν δυνάμει αὐτῶν δεῦτεροι ἐξαροῦσιν*
- 17 Pastaj do të niset për marshim çadra e mbledhjes bashkë me kampin e Levitëve në mes të kampeve të tjera. Do ta fillojnë marshimin në po atë rend të sistemit të tyre, duke qëndruar secili në vendin e tij, pranë flamurit të vet.  
**Then the Tent of meeting is to go forward, with the tents of the Levites, in the middle of the armies; in the same order as their tents are placed, they are to go forward, every man under his flag.**  
*καὶ ἀρθήσεται ἡ σκηνὴ τοῦ μαρτυρίου καὶ ἡ παρεμβολὴ τῶν λευιτῶν μέσον τῶν παρεμβολῶν ὡς καὶ παρεμβάλλουσιν οὕτως καὶ ἐξαροῦσιν ἕκαστος ἐχόμενος καθ' ἡγεμονίαν*
- 18 Në krahun perëndimor do të jetë flamuri i kampit të Efraimit simbas renditjes së tij, prijësi i bijve të Efraimit është Elishama, bir i Amihudit;  
**On the west side will be the flag of the children of Ephraim, with Elishama, the son of Ammihud, as their chief.**  
*τάγμα παρεμβολῆς εφραϊμ παρὰ θάλασσαν σὺν δυνάμει αὐτῶν καὶ ὁ ἄρχων τῶν υἱῶν εφραϊμ ελίσσαμα υἱὸς εμιουδ*
- 19 ata që u regjistruan në divizionin e tij ishin dyzet mijë e pesëqind.  
**The number of his army was forty thousand, five hundred.**  
*δύναμις αὐτοῦ οἱ ἐπισκεμμένοι τεσσαράκοντα χιλιάδες καὶ πεντακόσιοι*
- 20 Pranë tij do të zërë vend fisi i Manasit; prijësi i bijve të Manasit është Gamalieli, bir i Pedahtsurit;  
**And by him the tribe of Manasseh with Gamaliel, the son of Pedahzur, as their chief.**  
*καὶ οἱ παρεμβάλλοντες ἐχόμενοι φυλῆς μανασση καὶ ὁ ἄρχων τῶν υἱῶν μανασση γαμαλιηλ υἱὸς φαδασσουρ*
- 21 ata që u regjistruan në divizionin e tij ishin tridhjetë e dy mijë e dyqind.  
**The number of his army was thirty-two thousand, two hundred.**  
*δύναμις αὐτοῦ οἱ ἐπισκεμμένοι δύο καὶ τριάκοντα χιλιάδες καὶ διακόσιοι*
- 22 Pastaj do të vijë fisi i Beniaminit; prijësi i bijve të Beniaminit është Abidan, bir i Gideonit;  
**Then the tribe of Benjamin, with Abidan, the son of Gideoni, as their chief.**  
*καὶ οἱ παρεμβάλλοντες ἐχόμενοι φυλῆς βενιαμιν καὶ ὁ ἄρχων τῶν υἱῶν βενιαμιν αβιδαν υἱὸς γαδεωνι*
- 23 ata që u regjistruan në divizionin e tij ishin tridhjetë e pesë mijë e katërqind.  
**The number of his army was thirty-five thousand, four hundred.**  
*δύναμις αὐτοῦ οἱ ἐπισκεμμένοι πέντε καὶ τριάκοντα χιλιάδες καὶ τετρακόσιοι*
- 24 Të gjithë ata që janë regjistruar në kampin e Efraimit, simbas divizioneve të tyre, ishin njëqind e tetë mijë e njëqind. Këta do ta fillojnë marshimin të tretë.  
**The number of all the armies of Ephraim was a hundred and eight thousand, one hundred. They go forward third.**  
*πάντες οἱ ἐπισκεμμένοι τῆς παρεμβολῆς εφραϊμ ἑκατὸν χιλιάδες καὶ ὀκτακισχίλιοι καὶ ἑκατὸν σὺν δυνάμει αὐτῶν τρίτοι ἐξαροῦσιν*
- 25 Në krahun perëndimor do të jetë flamuri i kampit të Danit simbas renditjes së tij; prijësi i bijve të Danit është Ahiezeri, bir i Amishadait;  
**On the north side will be the flag of the children of Dan, with Ahiezer, the son of Ammishaddai, as their chief.**  
*τάγμα παρεμβολῆς δαν πρὸς βορρᾶν σὺν δυνάμει αὐτῶν καὶ ὁ ἄρχων τῶν υἱῶν δαν αχιεζερ υἱὸς αμισαδαι*
- 26 ata që u regjistruan në divizionin e tij ishin gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind.  
**The number of his army was sixty-two thousand, seven hundred.**  
*δύναμις αὐτοῦ οἱ ἐπισκεμμένοι δύο καὶ ἐξήκοντα χιλιάδες καὶ ἑπτακόσιοι*
- 27 Pranë tij do të zërë vend fisi i Asherit; prijësi i bijve të Asherit është Pagieli, bir i Okranit;  
**Nearest to him will be the tribe of Asher, with Pagieli, the son of Ochran, as their chief.**  
*καὶ οἱ παρεμβάλλοντες ἐχόμενοι αὐτοῦ φυλῆς ασηρ καὶ ὁ ἄρχων τῶν υἱῶν ασηρ φαγιαηλ υἱὸς εχραν*
- 28 ata që u regjistruan në divizionin e tij ishin dyzet e një mijë e pesëqind.  
**The number of his army was forty-one thousand, five hundred;**  
*δύναμις αὐτοῦ οἱ ἐπισκεμμένοι μία καὶ τεσσαράκοντα χιλιάδες καὶ πεντακόσιοι*
- 29 Pastaj do të vijë fisi i Neftalit; prijësi i bijve të Neftalit është Ahira, bir i Enanit;  
**Then the tribe of Naphtali, with Ahira, the son of Enan, as their chief.**  
*καὶ οἱ παρεμβάλλοντες ἐχόμενοι φυλῆς νεφθαλι καὶ ὁ ἄρχων τῶν υἱῶν νεφθαλι αχιρε υἱὸς αναν*

- 30 ata që u regjistruan në divizionin e tij ishin pesëdhjetë e tre mijë e katërqind.  
The number of his army was fifty-three thousand, four hundred.  
δύναμις αὐτοῦ οἱ ἐπισκευημένοι τρεῖς καὶ πενήκοντα χιλιάδες καὶ τετρακόσιοι
- 31 Të gjithë ata që u regjistruan në divizionin e Danit, ishin njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind. Ata do të nisen për marshim të fundit, pranë flamujve të tyre.  
The number of all the armies in the tents of Dan was a hundred and fifty-seven thousand, six hundred. They will go forward last, by their flags.  
πάντες οἱ ἐπισκευημένοι τῆς παρεμβολῆς δαν ἑκατὸν καὶ πενήκοντα ἐπτὰ χιλιάδες καὶ ἑξακόσιοι ἔσχατοι ἑξαροῦσιν κατὰ τάγμα αὐτῶν
- 32 Këta janë bijtë e Izraelit që u regjistruan në bazë të shtëpive të etërve të tyre. Të gjithë ata që u regjistruan në kampet e ndryshme simbas divizioneve të tyre ishin gjashtëqind e tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë.  
These are all who were numbered of the children of Israel, in the order of their fathers' families: all the armies in their tents together came to six hundred and three thousand, five hundred and fifty.  
αὕτη ἡ ἐπίσκεψις τῶν υἱῶν ἰσραὴλ κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν πᾶσα ἢ ἐπίσκεψις τῶν παρεμβολῶν σὺν ταῖς δυνάμεσιν αὐτῶν ἑξακόσιοι χιλιάδες καὶ τρισχίλιοι πεντακόσιοι πενήκοντα
- 33 Por Levitet nuk u regjistruan me bijtë e Izraelit, sepse kështu e kishte urdhëruar Zoti Moisiun.  
But the Levites were not numbered among the children of Israel, as the Lord said to Moses.  
οἱ δὲ λευῖται οὐ συνεπεσκέπησαν ἐν αὐτοῖς καθὰ ἐνετείλατο κύριος τῷ μοϋσῆ
- 34 Bijtë e Izraelit iu bindën të gjitha urdhrave që Zoti i kishte dhënë Moisiut: kështu ata fushuan pranë flamurëve të tyre dhe kështu e nisnin marshimin, secili simbas familjes së tij dhe simbas shtëpisë së etërve të tij.  
So the children of Israel did as the Lord said to Moses, so they put up their tents by their flags, and they went forward in the same order, by their families, and by their fathers' houses.  
καὶ ἐποίησαν οἱ υἱοὶ ἰσραὴλ πάντα ὅσα συνέταξεν κύριος τῷ μοϋσῆ οὕτως παρενέβαλον κατὰ τάγμα αὐτῶν καὶ οὕτως ἐξῆρον ἕκαστος ἐχόμενοι κατὰ δήμους αὐτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν
- 1 Këta janë pasardhësit e Aaronit dhe të Moisiut në kohën kur Zoti i foli Moisiut në malin Sinai.  
Now these are the generations of Aaron and Moses, in the day when the word of the Lord came to Moses on Mount Sinai.  
καὶ αὗται αἱ γενέσεις ααρων καὶ μοϋσῆ ἐν ἡμέρᾳ ἐλάλησεν κύριος τῷ μοϋσῆ ἐν ὄρει σινα
- 2 Këta janë emrat e bijve të Aaronit: Nadabi, i parëlinduri, Abihu, Eleazari dhe Ithamari.  
These are the names of the sons of Aaron: Nadab the oldest, and Abihu, Eleazar, and Ithamar.  
καὶ ταῦτα τὰ ὀνόματα τῶν υἱῶν ααρων πρωτότοκος ναδαβ καὶ αβιουδ ελεαζαρ καὶ ιθαμαρ
- 3 Këta janë emrat e bijve të Aaronit, të vajosur si priftërinj, që ai i shenjtëroi për të shërbyer si priftërinj.  
These are the names of the sons of Aaron, the priests, on whom the holy oil was put, who were marked out as priests.  
ταῦτα τὰ ὀνόματα τῶν υἱῶν ααρων οἱ ἱερεῖς οἱ ἠλειμμένοι οὓς ἐτελείωσαν τὰς χεῖρας αὐτῶν ἱερατεύειν
- 4 Nadabi dhe Abihu vdiqën para Zotit, kur ofruan një zjarr të palejueshëm para Zotit në shkretëtirën e Sinai; ata nuk patën bij. Kështu Eleazari dhe Ithamari shërbyen si priftërinj në prani të Aaronit, atit të tyre.  
And Nadab and Abihu were put to death before the Lord when they made an offering of strange fire before the Lord, in the waste land of Sinai, and they had no children: and Eleazar and Ithamar did the work of priests before Aaron their father.  
καὶ ἐτελεύτησεν ναδαβ καὶ αβιουδ ἔναντι κυρίου προσφερόντων αὐτῶν πῦρ ἀλλότριον ἔναντι κυρίου ἐν τῇ ἐρήμῳ σινα καὶ παιδία οὐκ ἦν αὐτοῖς καὶ ἱεράτευσεν ελεαζαρ καὶ ιθαμαρ μετ' ααρων τοῦ πατρὸς αὐτῶν
- 5 Pastaj Zoti i foli Moisiut, duke i thënë:  
And the Lord said to Moses,  
καὶ ἐλάλησεν κύριος πρὸς μοϋσῆν λέγων
- 6 "Afro fisin e Levitëve dhe paraqite para priftit Aaron, që të vihet në shërbim të tij.  
Make the tribe of Levi come near, and put them before Aaron the priest, to be his helpers,  
λαβὲ τὴν φυλὴν λευι καὶ στήσεις αὐτοὺς ἔναντιον ααρων τοῦ ἱερέως καὶ λειτουργήσουσιν αὐτῷ
- 7 Ata do të zbatojnë të gjitha udhëzimet e tij dhe do të kryejnë të gjitha detyrat që lidhen me tërë asambleenë para çadrës së mbledhjes, duke kryer shërbimin e tabernakullit.  
In order that they may be responsible to him and to all Israel for the care of the Tent of meeting, and to do the work of the House;  
καὶ φυλάξουσιν τὰς φυλακὰς αὐτοῦ καὶ τὰς φυλακὰς τῶν υἱῶν ἰσραὴλ ἔναντι τῆς σκηνῆς τοῦ μαρτυρίου ἐργάζεσθαι τὰ ἔργα τῆς σκηνῆς
- 8 Do të kujdesen për të gjitha orenditë e çadrës së mbledhjes dhe do të përmbushin të gjitha detyrimet e bijve të Izraelit, duke kryer shërbimin e tabernakullit.  
And they will have the care of all the vessels of the Tent of meeting, and will do for the children of Israel all the necessary work of the House.  
καὶ φυλάξουσιν πάντα τὰ σκεῦη τῆς σκηνῆς τοῦ μαρτυρίου καὶ τὰς φυλακὰς τῶν υἱῶν ἰσραὴλ κατὰ πάντα τὰ ἔργα τῆς σκηνῆς

- 9 Levitët do t'ua japësh Aaronit dhe bijve të tij; ata duhet t'u jepen plotësisht nga gjiri i bijve të Izraelit.  
Give the Levites to Aaron and his sons; so that they may be his without question from among the children of Israel.  
καὶ δώσεις τοὺς λευίτας ααρων καὶ τοῖς υἱοῖς αὐτοῦ τοῖς ἱερεῦσιν δόμα δεδομένοι οὗτοί μοι εἰσιν ἀπὸ τῶν υἱῶν ἰσραηλ.
- 10 Ti do të vendosësh Aaronin dhe bijtë e tij në mënyrë që ata të kryejnë funksionet e priftërisë së tyre; por çdo i huaj tjetër që afrohet do të dënohet me vdekje."  
And give orders that Aaron and his sons are to keep their place as priests; any strange person who comes near is to be put to death.  
καὶ ααρων καὶ τοὺς υἱοὺς αὐτοῦ καταστήσεις ἐπὶ τῆς σκηνῆς τοῦ μαρτυρίου καὶ φυλάξουσιν τὴν ἱερατείαν αὐτῶν καὶ πάντα τὰ κατὰ τὸν βωμὸν καὶ ἔσω τοῦ καταπετάσματος καὶ ὁ ἀλλογενὴς ὁ ἀπτόμηνος ἀποθάνειται
- 11 Zoti i foli akoma Moisiut, duke i thënë:  
And the Lord said to Moses,  
καὶ ἐλάλησεν κύριος πρὸς μουσῆν λέγων
- 12 "Ja, unë i mora Levitët nga gjiri i bijve të Izraelit në vend të çdo të parëlinduri që çel barkun e nënës midis bijve të Izraelit; prandaj Levitët do të jenë të mitë,  
See, I have taken the Levites out of the children of Israel to be mine in place of the first sons of the children of Israel;  
καὶ ἐγὼ ἰδοὺ εἴληφα τοὺς λευίτας ἐκ μέσου τῶν υἱῶν ἰσραηλ ἀντὶ παντός πρωτοτόκου διανοίγοντος μήτραν παρὰ τῶν υἱῶν ἰσραηλ λύτρα αὐτῶν ἔσονται καὶ ἔσονται ἐμοὶ οἱ λευῖται
- 13 sepse çdo i parëlindur është imi; ditën që godita të gjithë të parëlindurit në vendin e Egjiptit, unë ia shenjëtërova vetvetes të gjithë të parëlindurit në Izrael, qoftë të njerëzve, qoftë të kafshëve; ata do të jenë të mitë. Unë jam Zoti.  
For all the first sons are mine; on the day when I put to death all the first sons in the land of Egypt, I took for myself every first male birth of man and beast. They are mine; I am the Lord.  
ἐμοὶ γὰρ πᾶν πρωτότοκον ἐν ἧ ἡμέρᾳ ἐπάταξα πᾶν πρωτότοκον ἐν γῆ αἰγύπτου ἡγάσασα ἐμοὶ πᾶν πρωτότοκον ἐν ἰσραηλ ἀπὸ ἀνθρώπου ἕως κτήνους ἐμοὶ ἔσονται ἐγὼ κύριος
- 14 Pastaj Zoti i foli Moisiut në shkretëtirën e Sinaï, duke i thënë:  
And the Lord said to Moses in the waste land of Sinai,  
καὶ ἐλάλησεν κύριος πρὸς μουσῆν ἐν τῇ ἐρήμῳ σινα λέγων
- 15 "Bëj regjistrimin e bijve të Levit në bazë të shtëpive të etërve të tyre dhe të familjeve të tyre; do të bësh regjistrimin e të gjithë meshkujve një muajsh e lart".  
Let all the children of Levi be numbered by their families and their fathers' houses; let every male of a month old and over be numbered.  
ἐπίσκειψαι τοὺς υἱοὺς λευι κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν κατὰ δήμους αὐτῶν κατὰ συγγενείας αὐτῶν πᾶν ἄρσενικὸν ἀπὸ μηνιαίου καὶ ἐπάνω ἐπισκέψασθε αὐτούς
- 16 Kështu Moisiu bëri regjistrimin simbas urdhërit të Zotit ashtu siç ishte urdhëruar.  
So Moses did as the Lord said, numbering them as he had been ordered.  
καὶ ἐπεσκέψαντο αὐτούς μουσῆς καὶ ααρων διὰ φωνῆς κυρίου ὃν τρόπον συνέταξεν αὐτοῖς κύριος
- 17 Këta janë bijtë e Levit, simbas emrave të tyre: Gershon, Kehat dhe Merari.  
These were the sons of Levi by name: Gershon and Kohath and Merari.  
καὶ ἦσαν οὗτοί οἱ υἱοὶ λευι ἐξ ὀνομάτων αὐτῶν γεδσον καθ καὶ μεραρι
- 18 Këta janë emrat e bijve të Gershonit, simbas familjeve të tyre: Libni dhe Shimei;  
And these are the names of the sons of Gershon, by their families: Libni and Shimei.  
καὶ ταῦτα τὰ ὀνόματα τῶν υἱῶν γεδσον κατὰ δήμους αὐτῶν λοβεני καὶ σεμεῖ
- 19 bijtë e Kehathit, simbas familjeve të tyre, ishin Amrami, Itsehari, Hebroni dhe Uzieli;  
And the sons of Kohath, by their families: Amram and Izhar and Hebron and Uzziel.  
καὶ υἱοὶ καθ κατὰ δήμους αὐτῶν αμραμ καὶ ἰσσαρ χεβρων καὶ οζιηλ.
- 20 bijtë e Merarit, simbas familjeve të tyre, ishin Mahli dhe Mushi. Këto janë familjet e Levitëve, në bazë të shtëpive të etërve të tyre.  
And the sons of Merari by their families: Mahli and Mushi. These are the families of the Levites in the order of their fathers' houses.  
καὶ υἱοὶ μεραρι κατὰ δήμους αὐτῶν μοολι καὶ μουσι οὗτοί εἰσιν ἄνθρωποι τῶν λευιτῶν κατ' οἴκους πατριῶν αὐτῶν
- 21 Nga Gershoni rrjedhin familja e Libnitëve dhe familja e Shimetëve; këto janë familjet e Gershonitëve.  
From Gershon come the Libnites and the Shimeites; these are the families of the Gershonites.  
τῷ γεδσον δῆμος τοῦ λοβενοὶ καὶ δῆμος τοῦ σεμεῖ οὗτοι δῆμοι τοῦ γεδσον

- 22 Ata që u regjistruan, duke numëruar tërë meshkujt e moshës një muajsh e lart, ishin shtatë mijë e pesëqind.  
Those who were numbered of them, the males from one month old and over, were seven thousand, five hundred.  
ἢ ἐπίσκεψις αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν παντὸς ἀρσενικοῦ ἀπὸ μηνιαίου καὶ ἐπάνω ἢ ἐπίσκεψις αὐτῶν ἑπτακισχίλιοι καὶ πεντακόσιοι
- 23 Familjet e Gershonitëve duhet të zinin vend prapa tabernakullit, në drejtim të perëndimit.  
The tents of the Gershonites are to be placed at the back of the House, to the west.  
καὶ υἱοὶ γεδσων ὀπίσω τῆς σκηνῆς παρὰ θάλασσαν παρεμβалоῦσιν
- 24 I pari i shtëpisë së etërve të Gershonitëve ishte Eliasafi, bir i Laelit.  
The chief of the Gershonites is Eliasaph, the son of Lael.  
καὶ ὁ ἄρχων οἴκου πατριᾶς τοῦ δήμου τοῦ γεδσων ελισαφ υἱὸς λαηλ
- 25 Detyrat e bijve të Gershonit në çadrën e mbledhjes kishin të bënin me tabernakullin, me çadrën dhe mbulesën e saj, me perden e hyrjes në çadrën e mbledhjes,  
In the Tent of meeting, the Gershonites are to have the care of the House, and the Tent with its cover, and the veil for the door of the Tent of meeting,  
καὶ ἡ φυλακὴ υἱῶν γεδσων ἐν τῇ σκηνῇ τοῦ μαρτυρίου ἢ σκηνῇ καὶ τὸ κάλυμμα καὶ τὸ κατακάλυμμα τῆς θύρας τῆς σκηνῆς τοῦ μαρτυρίου
- 26 me perdet e oborrit, me perden në hyrjen e oborrit rreth tabernakullit dhe rreth altarit dhe litarët e tij për tërë shërbimin që u takonte.  
And the hangings for the open space round the House and the altar, and the curtain for its doorway, and all the cords needed for its use.  
καὶ τὰ ἰστία τῆς αὐλῆς καὶ τὸ καταπέτασμα τῆς πύλης τῆς αὐλῆς τῆς οὔσης ἐπὶ τῆς σκηνῆς καὶ τὰ κατάλοιπα πάντων τῶν ἔργων αὐτοῦ
- 27 Nga Kehathi rrjedhin familja e Amramitëve, familja e Itsharhit, familja e Hebronitëve dhe familja e Uzielitëve; këto janë familjet e Kehathitëve.  
From Kohath come the Amramites and the Izharites and the Hebronites and the Uzzielites; these are the families of the Kohathites.  
τῷ καθὸς δήμος ὁ αμραμις καὶ δήμος ὁ σααρις καὶ δήμος ὁ χεβρωνις καὶ δήμος ὁ οζιηλις οὗτοί εἰσιν ἄνθρωποι τοῦ καθὸς
- 28 Duke numëruar tërë meshkujt që ishin në moshë një muajsh e lart, kishte tetë mijë e gjashtëqind vetë, që kujdeseshin për shenjtëroren.  
Those who were numbered of them, the males from one month old and over, were eight thousand, six hundred, who were responsible for the care of the holy place.  
κατὰ ἀριθμὸν πᾶν ἀρσενικὸν ἀπὸ μηνιαίου καὶ ἐπάνω ὀκτακισχίλιοι καὶ ἑξακόσιοι φυλάσσοντες τὰς φυλακὰς τῶν ἁγίων
- 29 Familjet e bijve të Kehathit duhet të zinin vend në krahun jugor të tabernakullit.  
The tents of the Kohathites are to be placed on the south side of the House.  
οἱ ἄνθρωποι τῶν υἱῶν καθὸς παρεμβалоῦσιν ἐκ πλαγίων τῆς σκηνῆς κατὰ λίβα
- 30 I pari i shtëpisë së etërve të Kehathit ishte Elitsafani, bir i Uzielit.  
Their chief is Elizaphan, the son of Uzziel.  
καὶ ὁ ἄρχων οἴκου πατριῶν τῶν δήμων τοῦ καθὸς ελισαφαν υἱὸς οζιηλ
- 31 Detyrat e tyre kishin të bënin me arkën, me tryezën, me shandanin, me altarët dhe me orenditë e shenjtërores me të cilat ata kryenin shërbimin, me velin dhe gjithë punën që lidhet me këto gjëra.  
In their care are the ark, and the table, and the lights, and the altars, and all the vessels used in the holy place, and the veil, and all they are used for.  
καὶ ἡ φυλακὴ αὐτῶν ἢ κιβωτὸς καὶ ἡ τράπεζα καὶ ἡ λυχνία καὶ τὰ θυσιαστήρια καὶ τὰ σκεύη τοῦ ἁγίου ὅσα λειτουργοῦσιν ἐν αὐτοῖς καὶ τὸ κατακάλυμμα καὶ πάντα τὰ ἔργα αὐτῶν
- 32 Princi i princave të Levitëve ishte Eleazari, bir i priftit Aaron; ai mbikqyrte ata që kujdeseshin për shenjtëroren.  
Eleazar, the son of Aaron the priest, will be head over all the Levites and overseer of those responsible for the care of the holy place.  
καὶ ὁ ἄρχων ἐπὶ τῶν ἀρχόντων τῶν λευιτῶν ελεαζαρ ὁ υἱὸς ααρων τοῦ ἱερέως καθεσταμένος φυλάσσειν τὰς φυλακὰς τῶν ἁγίων
- 33 Nga Merari rrjedhin familja e Mahlitëve dhe familja e Mushitëve; këto janë familjet e Merarit.  
From Merari come the Mahlites and the Mushites; these are the families of Merari.  
τῷ μεραρι δήμος ὁ μοολι καὶ δήμος ὁ μουσι οὗτοί εἰσιν ἄνθρωποι μεραρι
- 34 Ata që u regjistruan, duke numëruar tërë meshkujt nga mosha një muajsh e lart, ishin gjashtë mijë e dyqind.  
Those who were numbered of them, the males of a month old and over, were six thousand, two hundred.  
ἢ ἐπίσκεψις αὐτῶν κατὰ ἀριθμὸν πᾶν ἀρσενικὸν ἀπὸ μηνιαίου καὶ ἐπάνω ἑξακισχίλιοι καὶ πεντήκοντα
- 35 Prijësi i shtëpisë së etërve të familjeve të Merarit ishte Tsurieli, bir i Abihailit. Ata duhet të zinin vend në krahun verior të tabernakullit.  
The chief of the families of Merari was Zuriel, the son of Abihail: their tents are to be placed on the north side of the House.  
- 17 paraqitjen e një kafshe që është mbi tokë, paraqitjen e një zogu që fluturon në qiell,  
Or any beast of the earth, or winged bird of the air,  
ὁμοίωμα παντὸς κτήνου τῶν ὀντων ἐπὶ τῆς γῆς ὁμοίωμα παντὸς ὀρνέου πτερωτοῦ ὃ πέταται ὑπὸ τὸν οὐρανόν
- 18 paraqitjen e çdo gjëje që zvarritet mbi dhe, paraqitjen e një peshku që noton në ujërat poshtë tokës;  
Or of anything which goes flat on the earth, or any fish in the water under the earth.  
ὁμοίωμα παντὸς ἔρπετοῦ ὃ ἔρπει ἐπὶ τῆς γῆς ὁμοίωμα παντὸς ἰχθύος ὅσα ἐστὶν ἐν τοῖς ὕδασι ὑποκάτω τῆς γῆς
- 19 sepse duke ngritur sytë në qiell dhe duke parë diellin, hënë, yjet, të tëra, domethënë tërë ushtrinë qiellore, ti të mos nxitesh të biesh përmbys përpara këtyre gjërave dhe t'u shërbesh, gjërave që Zoti, Perëndia yt, u ka dhënë tërë popujve që ndodhen nën të gjithë qiejtë;  
And when your eyes are lifted up to heaven, and you see the sun and the moon and the stars, all the army of heaven, do not let yourselves be moved to give them worship, or become the servants of what the Lord has given equally to all peoples under heaven.  
καὶ μὴ ἀναβλέψῃς εἰς τὸν οὐρανὸν καὶ ἰδὼν τὸν ἥλιον καὶ τὴν σελήνην καὶ τοὺς ἀστέρας καὶ πάντα τὸν κόσμον τοῦ οὐρανοῦ πλανηθεὶς προσκυνήσῃς αὐτοῖς καὶ λατρεύσῃς αὐτοῖς ἃ ἀπένευμεν κύριος ὁ θεὸς σου αὐτὰ πάντα τοῖς ἔθνεσιν τοῖς ὑποκάτω τοῦ οὐρανοῦ
- 20 por Zoti ju mori dhe ju nxori nga furra e hekurt, nga Egjipti, për të qenë populli i tij, trashëgimia e tij, ashtu siç jeni sot.  
But the Lord has taken you out of the flaming fire, out of Egypt, to be to him the people of his heritage, as you are today.  
ὕμᾱς δὲ ἔλαβεν ὁ θεὸς καὶ ἐξήγαγεν ὑμᾶς ἐκ τῆς καμίνου τῆς σιδηρᾶς ἐξ αἰγύπτου εἶναι αὐτῷ λαὸν ἐγκληρον ὡς ἐν τῇ ἡμέρᾳ ταύτῃ
- 21 Zoti u zemërua me mua për shkakun tuaj, dhe u betua që nuk do ta kaloja Jordanin dhe nuk do të hyja në vendin e mirë që Zoti, Perëndia yt, të jep si trashëgimi.  
And the Lord was angry with me because of you, and made an oath that I was not to go over Jordan into the good land which the Lord is giving you for your heritage:  
καὶ κύριος ἐθυμώθη μοι περὶ τῶν λεγομένων ὅφ' ὑμῶν καὶ ὤμοσεν ἵνα μὴ διαβῶ τὸν ἰορδάνην τοῦτον καὶ ἵνα μὴ εἰσέλθω εἰς τὴν γῆν ἣν κύριος ὁ θεὸς δίδωσίν σοι ἐν κλήρῳ
- 22 Kështu unë do të vdes në këtë vend pa kaluar Jordanin; ju do ta kaloni dhe do të shtini në dorë atë vend të mirë.  
But death is to come to me in this land, I may not go over Jordan: but you will go over and take that good land for your heritage.  
ἐγὼ γὰρ ἀποθνήσκω ἐν τῇ γῇ ταύτῃ καὶ οὐ διαβαίνω τὸν ἰορδάνην τοῦτον ὑμεῖς δὲ διαβαίνετε καὶ κληρονομήσετε τὴν γῆν τὴν ἀγαθὴν ταύτην
- 23 Ruhuni se harroni besëlidhjen që Zoti, Perëndia juaj, ka lidhur me ju, dhe bëni ndonjë shëmbëlltyrë të gdhendur në trajtën e çfarëdo gjëje që Zoti, Perëndia yt, e ka ndaluar.  
Take care that you do not let the agreement of the Lord your God, which he has made with you, go out of your mind, or make for yourselves images of any sort, against the orders which the Lord your God has given you.  
προσέχετε ὑμεῖς μὴ ἐπιλάθησθε τὴν διαθήκην κυρίου τοῦ θεοῦ ὑμῶν ἣν διέθετο πρὸς ὑμᾶς καὶ ποιήσητε ὑμῖν ἑαυτοῖς γλυπτὸν ὁμοίωμα πάντων ὧν συνέταξεν κύριος ὁ θεὸς σου
- 24 Sepse Zoti, Perëndia yt, është një zjarr që të konsumon, një Zot ziliqar.  
For the Lord your God is an all-burning fire, and he will not let the honour which is his be given to any other.  
ὅτι κύριος ὁ θεὸς σου πῦρ καταναλίσκων ἐστὶν θεὸς ζηλωτῆς
- 25 Kur të kesh pjellë bij dhe bij të bijve të tu, dhe të keni banuar për një kohë të gjatë në atë vend, në rast se shthureni dhe sajoni shëmbëlltyra të gdhendura në trajtën e çfarëdo gjëje, dhe bëni të keqen në sytë e Zotit, Perëndisë tuaj, për ta ngacmuar,  
If, when you have had children and children's children, and have been living a long time in the land, you are turned to evil ways, and make an image of any sort, and do evil in the eyes of the Lord your God, moving him to wrath:  
ἐὰν δὲ γεννήσῃς υἱοὺς καὶ υἱοὺς τῶν υἱῶν σου καὶ χρονίσῃτε ἐπὶ τῆς γῆς καὶ ἀνομήσητε καὶ ποιήσητε γλυπτὸν ὁμοίωμα παντὸς καὶ ποιήσητε τὰ πονηρὰ ἐναντίον κυρίου τοῦ θεοῦ ὑμῶν παροργίσει αὐτόν
- 26 unë thërres sot për të dëshmuar kundër jush qiellin dhe tokën, se ju do të zhdukeni shpejt plotësisht nga vendi ku shkoni për t'u bërë zotër të tij, duke kaluar Jordanin. Ju atje nuk do t'i zgjatni ditët tuaja, por do të shkatërroheni plotësisht.  
May heaven and earth be my witnesses against you today, that destruction will quickly overtake you, cutting you off from that land which you are going over Jordan to take; your days will not be long in that land, but you will come to a complete end.  
διαμαρτύρομαι ὑμῖν σήμερον τὸν τε οὐρανὸν καὶ τὴν γῆν ὅτι ἀπολεία ἀπολείσθε ἀπὸ τῆς γῆς εἰς ἣν ὑμεῖς διαβαίνετε τὸν ἰορδάνην ἐκεῖ κληρονομήσει αὐτὴν οὐχὶ πολυχρονεῖτε ἡμέρας ἐπ' αὐτῆς ἀλλ' ἢ ἐκτριβῆ ἑκτριβήσεσθε

- 27 Dhe Zoti do t'ju shpërndajë midis popujve, dhe nuk do të mbetet nga ju veçse një numër i vogël njerëzish midis kombeve ku do t'ju çojë Zoti.  
And the Lord will send you wandering among the peoples; only a small band of you will be kept from death among the nations where the Lord will send you.  
καὶ διασπερῆει κύριος ὑμᾶς ἐν πᾶσιν τοῖς ἔθνεσιν καὶ καταλειφθήσεσθε ὀλίγοι ἀριθμῶ ἐν τοῖς ἔθνεσιν εἰς οὓς εἰσάξει κύριος ὑμᾶς ἐκεῖ
- 28 Dhe atje do t'u shërbeni perëndive prej druri e prej guri, të bëra nga dora e njeriut, që nuk shohin, nuk dëgjojnë, nuk hanë dhe nuk nuhasin.  
There you will be the servants of gods, made by men's hands, of wood and stone, having no power of seeing or hearing or taking food or smelling.  
καὶ λατρεύετε ἐκεῖ θεοῖς ἐτέροις ἔργοις χειρῶν ἀνθρώπων ξύλοις καὶ λίθοις οἱ οὐκ ὄνουνται οὐδὲ μὴ ἀκούσωσιν οὔτε μὴ φάγωσιν οὔτε μὴ ὀσφρανθῶσιν
- 29 Por aty do të kërkoksh Zotin, Perëndinë tënd; dhe do ta gjesh, në rast se do ta kërkoksh me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt.  
But if in those lands you are turned again to the Lord your God, searching for him with all your heart and soul, he will not keep himself from you.  
καὶ ζητήσετε ἐκεῖ κύριον τὸν θεὸν ὑμῶν καὶ εὐρήσετε ὅταν ἐκζητήσητε αὐτὸν ἐξ ὅλης τῆς καρδίας σου καὶ ἐξ ὅλης τῆς ψυχῆς σου ἐν τῇ θλίψει σου
- 30 Kur do të jesh në ankth dhe do të kenë ndodhur tërë këto gjëra, në kohën e fundit, do të kthehesh tek Zoti, Perëndia yt, dhe do ta dëgjosh zërin e tij;  
When you are in trouble and all these things have come on you, if, in the future, you are turned again to the Lord your God, and give ear to his voice:  
καὶ εὐρήσουσιν σε πάντες οἱ λόγοι οὗτοι ἐπ' ἐσχάτῳ τῶν ἡμερῶν καὶ ἐπιστραφήσῃ πρὸς κύριον τὸν θεόν σου καὶ εἰσακούσῃ τῆς φωνῆς αὐτοῦ
- 31 (sepse Zoti, Perëndia yt, është një Zot mëshirëplotë); ai nuk të ka braktisur dhe nuk do të të shkatërrojë, nuk do të harrojë besëlidhjen për të cilën iu betua etërve të tu.  
Because the Lord your God is a God of mercy, he will not take away his help from you or let destruction overtake you, or be false to the agreement which he made by an oath with your fathers.  
ὅτι θεὸς οἰκτίρμων κύριος ὁ θεὸς σου οὐκ ἐγκαταλείψει σε οὐδὲ μὴ ἐκτρίψει σε οὐκ ἐπιλήσεται τὴν διαθήκην τῶν πατέρων σου ἣν ὤμοσεν αὐτοῖς
- 32 Pyet gjithashtu kohërat e lashta, që kanë qenë para teje, nga dita që Perëndia krijoi njeriun në tokë, dhe pyet nga një anë e qiellit në tjetrën në se ka pasur ndonjë herë një gjë aq të madhe si kjo ose në se është dëgjuar një gjë e tillë si kjo.  
Give thought now to the days which are past, before your time, from the day when God first gave life to man on the earth, and searching from one end of heaven to the other, see if such a great thing as this has ever been, or if anything like it has been talked of in story.  
ἐπερωτήσατε ἡμέρας προτέρας τὰς γενομένας προτέρας σου ἀπὸ τῆς ἡμέρας ἧς ἔκτισεν ὁ θεὸς ἄνθρωπον ἐπὶ τῆς γῆς καὶ ἐπὶ τὸ ἄκρον τοῦ οὐρανοῦ ἕως ἄκρου τοῦ οὐρανοῦ εἰ γέγονεν κατὰ τὸ ῥῆμα τὸ μέγα τοῦτο εἰ ἤκουσται τοιοῦτο
- 33 A ka pasur vallë ndonjë popull që të ketë dëgjuar zërin e Perëndisë të flasë nga mesi i zjarrit, siç e dëgjove ti, dhe të ketë mbetur gjallë?  
Has any people ever gone on living after hearing the voice of God out of the heart of the fire as you did?  
εἰ ἀκήκοεν ἔθνος φωνὴν θεοῦ ζῶντος λαλοῦντος ἐκ μέσου τοῦ πυρός ὃν τρόπον ἀκήκοας σὺ καὶ ἔζησας
- 34 A ka pasur vallë ndonjë Perëndi që ka provuar të shkojë e të marrë për vete një komb në mes të një kombi tjetër me anë provash, shenjash, mrekullish dhe betejash, me dorë të fuqishme, me krahe të shtrirë dhe me ankthe të mëdha terrori, siç bëri për ju Zoti, Perëndia juaj, në Egjipt para syve tuaj?  
Has God ever before taken a nation for himself from out of another nation, by punishments and signs and wonders, by war and by a strong hand and a stretched-out arm and great acts of wonder and fear, as the Lord your God did for you in Egypt, before your very eyes?  
εἰ ἐπειράσεν ὁ θεὸς εἰσελθὼν λαβεῖν ἑαυτῷ ἔθνος ἐκ μέσου ἔθνους ἐν πειρασμῷ καὶ ἐν σημείοις καὶ ἐν τέρασιν καὶ ἐν πολέμῳ καὶ ἐν χειρὶ κραταιᾷ καὶ ἐν βραχίονι ὑψηλῷ καὶ ἐν ὀράμασιν μεγάλοις καὶ τὰ πάντα ὅσα ἐποίησεν κύριος ὁ θεὸς ἡμῶν ἐν αἰγύπτῳ ἐνώπιόν σου βλέποντος
- 35 Të tëra këto të janë treguar, në mënyrë që të pranosh se Zoti është Perëndi dhe që nuk ka asnjë tjetër veç tij.  
All this he let you see, so that you might be certain that the Lord is God and there is no other.  
ὥστε εἰδήσῃς σε ὅτι κύριος ὁ θεὸς σου οὗτος θεὸς ἐστὶν καὶ οὐκ ἐστὶν ἕτι πλὴν αὐτοῦ
- 36 Nga qielli bëri që të dëgjosh zërin e tij që të të mësojë; dhe mbi tokë të bëri të shikosh zjarrin e tij të madh dhe dëgjove fjalët e tij në mes të zjarrit.  
Out of heaven itself his voice came to you, teaching you; and on earth he let you see his great fire; and his words came to your ears out of the heart of the fire.  
ἐκ τοῦ οὐρανοῦ ἀκουστὴ ἐγένετο ἡ φωνὴ αὐτοῦ παιδεύσαι σε καὶ ἐπὶ τῆς γῆς ἔδειξεν σοὶ τὸ πῦρ αὐτοῦ τὸ μέγα καὶ τὰ ῥήματα αὐτοῦ ἤκουσας ἐκ μέσου τοῦ πυρός
- 37 Dhe nga që i deshë etërit e tu, ai zgjodhi pasardhësit e tyre dhe i nxori nga Egjipti në prani të tij, me anë të fuqisë së tij të madhe.  
And because of his love for your fathers, he took their seed and made it his, and he himself, present among you, took you out of Egypt by his great power;  
διὰ τὸ ἀγαπήσαι αὐτὸν τοὺς πατέρας σου καὶ ἐξελέξατο τὸ σπέρμα αὐτῶν μετ' αὐτοὺς ὑμᾶς καὶ ἐξήγαγέ σε αὐτὸς ἐν τῇ ἰσχύϊ αὐτοῦ τῇ μεγάλῃ ἐξ αἰγύπτου
- 38 duke dëbuar para teje kombe më të mëdha dhe më të fuqishme se ti, me qëllim që ti të hyje dhe ta merrje si trashëgimi vendin e tyre.  
Driving out before you nations greater and stronger than you, to take you into their land and give it to you for your heritage, as at this day.  
ἐξολεθρεύσαι ἔθνη μέγала καὶ ἰσχυρότερα σου πρὸ προσώπου σου εἰσαγαγείν σε δοῦναι σοὶ τὴν γῆν αὐτῶν κληρονομεῖν καθὼς ἔχεις σήμερον

- 39 Mëso, pra, sonte dhe mbaje në zemrën tënde që Zoti është Perëndi atje lart në qiejt dhe këtu poshtë në tokë, dhe se nuk ka asnjë tjetër.  
**So today be certain, and keep the knowledge deep in your hearts, that the Lord is God, in heaven on high and here on earth; there is no other God.**  
*καὶ γνώση σήμερον καὶ ἐπιστραφήσῃ τῇ διανοίᾳ ὅτι κύριος ὁ θεὸς σου οὗτος θεὸς ἐν τῷ οὐρανῷ ἄνω καὶ ἐπὶ τῆς γῆς κάτω καὶ οὐκ ἔστιν ἔτι πλὴν αὐτοῦ*
- 40 Respekto pra statutet dhe urdhërimet e tij që unë po të jap sot, që të jetosh në begati ti dhe bijtë e tu mbas teje dhe të zgjatësh ditët e tua në vendin që Zoti, Perëndia yt, po të jep për gjithnjë.  
**Then keep his laws and his orders which I give you today, so that it may be well for you and for your children after you, and that your lives may be long in the land which the Lord your God is giving you for ever.**  
*καὶ φυλάξῃ τὰ δικαιώματα αὐτοῦ καὶ τὰς ἐντολὰς αὐτοῦ ὅσας ἐγὼ ἐντέλλομαι σοὶ σήμερον ἵνα εὖ σοὶ γένηται καὶ τοῖς υἱοῖς σου μετὰ σέ ὅπως μακροήμεροι γένησθε ἐπὶ τῆς γῆς ἧς κύριος ὁ θεὸς σου δίδωσίν σοι πάσας τὰς ἡμέρας*
- 41 Atëherë Moisiu veçoi tri qytete matanë Jordanit, në drejtim të lindjes,  
**Then Moses had three towns marked out on the far side of Jordan looking to the east;**  
*τότε ἀφώρισεν μουσῆς τρεῖς πόλεις πέραν τοῦ ἰορδάνου ἀπὸ ἀνατολῶν ἡλίου*
- 42 në të cilët mund të strehohej vrasësi që kishte vrarë të afërmin e tij padashur, pa e urryer më parë, dhe me qëllim që të ruante jetën e tij duke u strehuar në njerin prej këtyre qyteteve:  
**To which anyone causing the death of his neighbour in error and not through hate, might go in flight; so that in one of these towns he might be kept from death:**  
*φυγεῖν ἐκεῖ τὸν φονεῦτῃ ὃς ἂν φονεύσῃ τὸν πλησίον οὐκ εἰδὼς καὶ οὗτος οὐ μισῶν αὐτὸν πρὸ τῆς ἔχθρᾶς καὶ τρίτης καὶ καταφεύζεται εἰς μίαν τῶν πόλεων τούτων καὶ ζήσεται*
- 43 Betseri në shkretëtirën e krahinës fushore për Rubenitët, Ramothi në Galaad për Gaditët dhe Golani në Bashan për Manasitët.  
**The names of the towns were Bezer in the waste land, in the table-land, for the Reubenites; and Ramoth in Gilead for the Gadites; and Golan in Bashan for Manasseh.**  
*τὴν βοσορ ἐν τῇ ἐρήμῳ ἐν τῇ γῆ τῇ πεδινῇ τῷ ρουβην καὶ τὴν ραμωθ ἐν γαλααδ τῷ γαδδι καὶ τὴν γαυλων ἐν βασαν τῷ μανασση*
- 44 Ky është ligji që Moisiu u paraqiti bijve të Izraelit.  
**This is the law which Moses put before the children of Israel:**  
*οὗτος ὁ νόμος ὃν παρέθετο μουσῆς ἐνώπιον υἱῶν ἰσραηλ*
- 45 Këto janë regullat, statutet dhe dekretet që Moisiu u dha bijve të Izraelit kur dolën nga Egjipti,  
**These are the rules and the laws and the decisions which Moses gave to the children of Israel after they came out of Egypt;**  
*ταῦτα τὰ μαρτύρια καὶ τὰ δικαιώματα καὶ τὰ κρίματα ὅσα ἐλάλησεν μουσῆς τοῖς υἱοῖς ἰσραηλ ἐν τῇ ἐρήμῳ ἐξεληθόντων αὐτῶν ἐκ γῆς αἰγύπτου*
- 46 matanë Jordanit, në luginën përballë Beth-Peorit, në vendin e Sihonit, mbretit të Amorejve, që banonte në Heshbon, dhe që Moisiu dhe bijtë e Izraelit i mundën kur dolën nga Egjipti.  
**On the far side of Jordan, in the valley facing Beth-peor, in the land of Sihon, king of the Amorites, who was ruling in Heshbon, whom Moses and the children of Israel overcame after they had come out of Egypt:**  
*ἐν τῷ πέραν τοῦ ἰορδάνου ἐν φάραγγι ἐγγὺς οἴκου φογορ ἐν γῆ σηων βασιλέως τῶν αμορραίων ὃς κατόκει ἐν εσεβων οὗς ἐπάταξεν μουσῆς καὶ οἱ υἱοὶ ἰσραηλ ἐξεληθόντων αὐτῶν ἐκ γῆς αἰγύπτου*
- 47 Ata shtinë në dorë vendin e tij dhe vendin e Ogut, mbretit të Balshanit, dy mbretër të Amorejve, që banonin matanë Jordanit, në drejtim të lindjes,  
**And they took his land for a heritage, and the land of Og, king of Bashan, the two kings of the Amorites, whose lands were on the other side of Jordan to the east;**  
*καὶ ἐκκληρονόμησαν τὴν γῆν αὐτοῦ καὶ τὴν γῆν ὡγ βασιλέως τῆς βασαν δύο βασιλέων τῶν αμορραίων οἳ ἦσαν πέραν τοῦ ἰορδάνου κατ' ἀνατολὰς ἡλίου*
- 48 nga Aroreri, që ndodhet në brigjet e përroit Arnon, deri në malin Sion, (domethënë mali i Hermonit),  
**From Aroer on the edge of the valley of the Arnon as far as Mount Sion, which is Hermon,**  
*ἀπὸ αρορη ἣ ἔστιν ἐπὶ τοῦ χειλὸς χειμάρρου αρνων καὶ ἐπὶ τοῦ ὄρους τοῦ σηων ὃ ἔστιν αερμων*
- 49 bashkë me gjithë fushën matanë Jordanit, në drejtim të lindjes, deri në detin e Arabahut, poshtë shpateve të Pisgahut.  
**And all the Arabah on the far side of Jordan to the east, as far as the sea of the Arabah under the slopes of Pisgah.**  
*πᾶσαν τὴν αραβα πέραν τοῦ ἰορδάνου κατ' ἀνατολὰς ἡλίου ὑπὸ ἀσηδωθ τὴν λαξευτὴν*
- 1 Moisiu mblodhi tërë Izraelin dhe i tha: &quot;Dëgjo, Izrael, statutet dhe dekretet që unë shpall sot në veshët e tu me qëllim që ti t'i mësosh dhe të zotohesh t'i zbatosh.  
**And Moses sent for all Israel, and said to them, Give ear, O Israel, to the laws and the decisions which I give you today, and give attention to them so that you may keep and do them.**  
*καὶ ἐκάλεσεν μουσῆς πάντα ἰσραηλ καὶ εἶπεν πρὸς αὐτούς ἄκουε ἰσραηλ τὰ δικαιώματα καὶ τὰ κρίματα ὅσα ἐγὼ λαλῶ ἐν τοῖς ὦσιν ὑμῶν ἐν τῇ ἡμέρᾳ ταύτῃ καὶ μαθήσεσθε αὐτὰ καὶ φυλάξεσθε ποιεῖν αὐτά*
- 2 Zoti, Perëndia ynë, lidhi një besëlidhje me ne në Horeb.  
**The Lord our God made an agreement with us in Horeb.**  
*κύριος ὁ θεὸς ὑμῶν διέθετο πρὸς ὑμᾶς διαθήκην ἐν χωρηβ*

- 3 Zoti e lidhi këtë besëlidhje jo me etërit tanë, por me ne që jemi këtu të gjithë të gjallë.  
The Lord did not make this agreement with our fathers but with us, who are all living and present here today.  
οὐχὶ τοῖς πατράσιν ὑμῶν διέθετο κύριος τὴν διαθήκην ταύτην ἀλλ' ἢ πρὸς ὑμᾶς ὑμεῖς ὠδε πάντες ζῶντες σήμερον
- 4 Zoti ju foli në sy në mal, nga mesi i zjarrit.  
The word of the Lord came to you face to face on the mountain, out of the heart of the fire,  
πρόσωπον κατὰ πρόσωπον ἐλάλησεν κύριος πρὸς ὑμᾶς ἐν τῷ ὄρει ἐκ μέσου τοῦ πυρός
- 5 Unë ndodhesha atëherë midis Zotit dhe jush për t'ju referuar fjalën e tij, sepse ju patët frikë nga zjarri dhe nuk u ngjitetë në mal. Ai tha:  
(I was between the Lord and you at that time, to make clear to you the word of the Lord: because, through fear of the fire, you did not go up the mountain;) saying,  
κάγω εἰστήκειν ἀνὰ μέσον κυρίου καὶ ὑμῶν ἐν τῷ καιρῷ ἐκεῖνῳ ἀναγγεῖλαι ὑμῖν τὰ ῥήματα κυρίου ὅτι ἐφοβήθητε ἀπὸ προσώπου τοῦ πυρός καὶ οὐκ ἀνέβητε εἰς τὸ ὄρος λέγων
- 6 "Unë jam Zoti, Perëndia yt, që të ka nxjerrë nga vendi i Egjiptit, nga shtëpia e skllavërisë.  
I am the Lord your God, who took you out of the land of Egypt, out of the prison-house.  
ἐγὼ κύριος ὁ θεὸς σου ὁ ἐξαγαγὼν σε ἐκ γῆς αἰγύπτου ἐξ οἴκου δουλείας
- 7 Nuk do të kesh perëndi të tjera përpara meje.  
You are to have no other gods but me.  
οὐκ ἔσονται σοι θεοὶ ἕτεροι πρὸ προσώπου μου
- 8 Nuk do të bësh asnjë skulpturë apo shëmbëlltyrë të gjërave që janë atje lart në qiell, këtu poshtë në tokë apo në ujërat poshtë tokës.  
You may not make for yourselves an image in the form of anything in heaven or on earth or in the waters under the earth:  
οὐ ποιήσεις σεαυτῷ εἰδωλον οὐδὲ παντὸς ὁμοίωμα ὅσα ἐν τῷ οὐρανῷ ἄνω καὶ ὅσα ἐν τῇ γῇ κάτω καὶ ὅσα ἐν τοῖς ὕδασιν ὑποκάτω τῆς γῆς
- 9 Nuk do të biesh përmbys para tyre dhe nuk do t'u shërbesh, sepse unë, Zoti, Perëndia yt, jam një Perëndi xhelos që dënon paudhësinë e etërve ndaj bijve deri në brezin e tretë dhe të katërt të atyre që më urrejnë,  
You may not go down on your faces before them or give them worship: for I, the Lord your God, am a God who will not give his honour to another; and I will send punishment on the children for the wrongdoing of their fathers, to the third and fourth generation of my haters;  
οὐ προσκυνήσεις αὐτοῖς οὐδὲ μὴ λατρεύσεις αὐτοῖς ὅτι ἐγὼ εἰμι κύριος ὁ θεὸς σου θεὸς ζηλωτῆς ἀποδιδοὺς ἀμαρτίας πατέρων ἐπὶ τέκνα ἐπὶ τρίτην καὶ τετάρτην γενεὰν τοῖς μισοῦσίν με
- 10 por tregohem i dashur ndaj mijëra njerëzish që më duan dhe respektojnë urdhërimet e mia.  
And I will have mercy through a thousand generations on those who have love for me and keep my laws.  
καὶ ποιῶν ἔλεος εἰς χιλιάδας τοῖς ἀγαπῶσίν με καὶ τοῖς φυλάσσουσιν τὰ προστάγματά μου
- 11 Nuk do ta përdorësh më kot emrin e Zotit, Perëndisë tënd, sepse Zoti nuk ka për ta lënë të padënuar atë që përdor emrin e tij kot.  
You are not to make use of the name of the Lord your God for an evil purpose; whoever takes the Lord's name on his lips for an evil purpose will be judged as a sinner by the Lord.  
οὐ λήμψῃ τὸ ὄνομα κυρίου τοῦ θεοῦ σου ἐπὶ ματαίῳ οὐ γὰρ μὴ καθάριση κύριος τὸν λαμβάνοντα τὸ ὄνομα αὐτοῦ ἐπὶ ματαίῳ
- 12 Respekto ditën e shtunë për të shenjtëruar, ashtu siç të ka porositur Zoti, Perëndia yt.  
Keep the Sabbath day as a holy day, as you have been ordered by the Lord your God.  
φύλαξαι τὴν ἡμέραν τῶν σαββάτων ἀγιάζειν αὐτὴν ὡν τρόπον ἐνετείλατό σοι κύριος ὁ θεὸς σου
- 13 Do të punosh gjashtë ditë dhe gjatë këtyre ditëve do të bësh çdo punë tënde,  
On six days do all your work:  
ἕξ ἡμέρας ἐργᾶ καὶ ποιήσεις πάντα τὰ ἔργα σου
- 14 por dita e shtatë është e shtuna, e shenjtë për Zotin, Perëndinë tënd; nuk do të bësh gjatë kësaj dite asnjë punë, as ti, as biri yt, as bija jote, as shërbëtori, as shërbëtorja, as kau, as gomari, asnjë nga kafshët e tua, dhe të huajt që ndodhen brenda portave të shtëpisë sate, me qëllim që shërbëtori dhe shërbëtorja jote të çlodhen si ti.  
But the seventh day is a Sabbath to the Lord your God; on that day do no work, you or your son or your daughter, or your man-servant or your woman-servant, or your ox or your ass or any of your cattle, or the man from a strange country who is living among you; so that your man-servant and your woman-servant may have rest as well as you.  
τῇ δὲ ἡμέρᾳ τῇ ἑβδόμῃ σάββατα κυρίῳ τῷ θεῷ σου οὐ ποιήσεις ἐν αὐτῇ πᾶν ἔργον σὺ καὶ οἱ υἱοὶ σου καὶ ἡ θυγάτηρ σου ὁ παῖς σου καὶ ἡ παιδίσκη σου ὁ βοῦς σου καὶ τὸ ὑποζύγιόν σου καὶ πᾶν κτήνός σου καὶ ὁ προσήλυτος ὁ παροικῶν ἐν σοὶ ἵνα ἀναπαύσῃται ὁ παῖς σου καὶ ἡ παιδίσκη σου ὡσπερ καὶ σὺ

- 15** Dhe mos harro që ke qenë skllav në vendin e Egjiptit dhe që Zoti, Perëndia yt, të nxori që andej me një dorë të fuqishme dhe vepruese; prandaj Zoti, Perëndia yt, të urdhëron të respektosh ditën e shtunë.  
**And keep in mind that you were a servant in the land of Egypt, and that the Lord your God took you out of that land by his strong hand and his stretched-out arm: for this reason the Lord has given you orders to keep the Sabbath day.**  
 και μνησθήση ότι οικέτης ήσθα εν γη αιγύπτω και εξήγαγέν σε κύριος ο θεός σου εκείθεν εν χειρι κραταιῃ και εν βραχίονι ύψηλῷ διὰ τοῦτο συνέταξεν σοι κύριος ο θεός σου ὥστε φυλάσσεσθαι τήν ή μέραν τῶν σαββάτων και αγιάζειν αὐτήν
- 16** Do të nderosh atin dhe nënën tënde ashtu si të ka urdhëruar Zoti, Perëndia yt, që të jetosh gjatë dhe të gëzosh begatinë në tokën që Zoti, Perëndia yt, po të jep.  
**Give honour to your father and your mother, as you have been ordered by the Lord your God; so that your life may be long and all may be well for you in the land which the Lord your God is giving you.**  
 τίμα τὸν πατέρα σου και τήν μητέρα σου ὄν τρόπον ἐνετείλατό σοι κύριος ο θεός σου ἵνα εὖ σοι γένηται και ἵνα μακροχρόνιος γένη ἐπὶ τῆς γῆς ἧς κύριος ο θεός σου δίδωσίν σοι
- 17** Nuk do të vrasësh.  
**Do not put anyone to death without cause.**  
 οὐ μοιχεύσεις
- 18** Nuk do të shkelësh besnikërinë bashkëshortore.  
**Do not be false to the married relation.**  
 οὐ φονεύσεις
- 19** Nuk do të vjedhësh.  
**Do not take the property of another.**  
 οὐ κλέψεις
- 20** Nuk do të bësh dëshmi të rreme kundër të afërmit tënd.  
**Do not give false witness against your neighbour;**  
 οὐ ψευδομαρτυρήσεις κατά τοῦ πλησίον σου μαρτυρίαν ψευδῆ
- 21** Nuk do të dëshirosh gruan e të afërmit tënd, nuk do të dëshirosh shtëpinë e të afërmit tënd, as arën, as shërbëtorin, as shërbëtoren, as kaun, as gomarin dhe asnjë send që janë pronë e tij<sup>2</sup>.  
**Or let your desire be turned to your neighbour's wife, or his house or his field or his man-servant or his woman-servant or his ox or his ass or anything which is your neighbour's.**  
 οὐκ ἐπιθυμήσεις τήν γυναίκα τοῦ πλησίον σου οὐκ ἐπιθυμήσεις τήν οικίαν τοῦ πλησίον σου οὔτε τὸν ἄγρον αὐτοῦ οὔτε τὸν παῖδα αὐτοῦ οὔτε τήν παιδίσκην αὐτοῦ οὔτε τοῦ βοῦς αὐτοῦ οὔτε τοῦ ὑποζυγίου αὐτοῦ οὔτε παντός κτήνους αὐτοῦ οὔτε ὅσα τῷ πλησίον σου ἐστιν
- 22** Këto fjalë tha Zoti përpara tërë asamblesë tuaj, nga mesi i zjarrit, të resë dhe të errësirës së dendur, me zë të fortë; dhe nuk shtoi tjetër. I shkroi mbi dy pllaka prej guri dhe mi dha mua.  
**These words the Lord said to all of you together on the mountain, out of the heart of the fire, out of the cloud and the dark, with a great voice: and he said no more; he put them in writing on the two stones of the law and gave them to me.**  
 τὰ ῥήματα ταῦτα ἐλάλησεν κύριος πρὸς πᾶσαν συναγωγὴν ὁμῶν εν τῷ ὄρει ἐκ μέσου τοῦ πυρός σκοτός γνώφος θύελλα φωνή μεγάλη και οὐ προσέθηκεν και ἔγραψεν αὐτὰ ἐπὶ δύο πλάκας λιθίνας και ἔδωκέν μοι
- 23** Kur ju dëgjuat zërin në mes të errësirës, ndërsa mali ishte tërë flakë, ju m'u afruat, gjithë prijësit e fiseve dhe pleqtë tuaj,  
**And after hearing the voice which came out of the dark while the mountain was burning with fire, all the heads of your tribes and your chiefs came to me,**  
 και ἐγένετο ὡς ἠκούσατε τήν φωνήν ἐκ μέσου τοῦ πυρός και τὸ ὄρος ἐκαίετο πυρί και προσήλθετε πρὸς με πάντες οἱ ἡγούμενοι τῶν φυλῶν ὁμῶν και ἡ γερουσία ὁμῶν
- 24** dhe thatë: &quot;Ja, Zoti, Perëndia ynë, na tregoi lavdinë dhe madhërinë e tij, dhe ne dëgjua zërin e tij nga mesi i zjarrit; sot kemi parë që Perëndia mund të flasë me njeriun dhe ky të mbetet i gjallë.  
**And said, The Lord has let us see his glory and his power, and his voice has come to us out of the fire: today we have seen that a man may go on living even after hearing the voice of God.**  
 και ἐλέγετε ἰδοὺ ἔδειξεν ἡμῖν κύριος ο θεός ἡμῶν τήν δόξαν αὐτοῦ και τήν φωνήν αὐτοῦ ἠκούσαμεν ἐκ μέσου τοῦ πυρός εν τῇ ἡμέρᾳ ταύτῃ εἶδομεν ότι λαλήσει ο θεός πρὸς ἄνθρωπον και ζήσεται
- 25** Po pse duhet të vdesim? Ky zjarr i madh në të vërtetë do të na gllabërojë; në rast se vazhdojmë të dëgjojmë akoma zërin e Zotit, të Perëndisë tonë, ne kemi për të vdekur.  
**Why then is death to be our fate? For if the voice of the Lord our God comes to us any more, death will overtake us, and we will be burned up in this great fire.**  
 και νῦν μὴ ἀποθάνομεν ότι ἐξαναλώσει ἡμᾶς τὸ πῦρ τὸ μέγα τοῦτο ἐὰν προσθώμεθα ἡμεῖς ἀκοῦσαι τήν φωνήν κυρίου τοῦ θεοῦ ἡμῶν ἐτι και ἀποθανοῦμεθα
- 26** Sepse, midis gjithë njerëzve, kush është ai që, si ne, ka dëgjuar zërin e Perëndisë të gjallë të flasë në mes të zjarrit dhe ka mbetur i gjallë?  
**For what man is there in all the earth, who, hearing the voice of the living God as we have, out of the heart of the fire, has been kept from death?**  
 τίς γὰρ σὰρξ ἦτις ἠκουσεν φωνήν θεοῦ ζῶντος λαλοῦντος ἐκ μέσου τοῦ πυρός ὡς ἡμεῖς και ζήσεται

- 27 Afrohu ti dhe dëgjo të gjitha ato që Zoti, Perëndia ynë, do të të thotë, dhe ne do ta dëgjojmë dhe do të bëjmë ato që kërkon ai&quot;;  
**Do you go near: and after hearing everything which the Lord our God has to say, give us an account of all he has said to you, and we will give ear, and do it.**  
*πρόσελθε σὺ καὶ ἄκουσον ὅσα ἐὰν εἴπῃ κύριος ὁ θεὸς ἡμῶν καὶ σὺ λαλήσεις πρὸς ἡμᾶς πάντα ὅσα ἂν λαλήσῃ κύριος ὁ θεὸς ἡμῶν πρὸς σέ καὶ ἀκουσόμεθα καὶ ποιήσομεν*
- 28 Zoti dëgjoi tingullin e fjalëve tuaja ndërsa më flisnit; kështu Zoti më tha: &quot;Unë dëgjova tingullin e fjalëve që ky popull të drejtoi; çdo gjë që ata thanë është mirë.  
**Then the Lord, hearing your words to me, said to me, The words which this people have said to you have come to my ears: what they have said is well said.**  
*καὶ ἤκουσεν κύριος τὴν φωνὴν τῶν λόγων ὑμῶν λαλοῦντων πρὸς με καὶ εἶπεν κύριος πρὸς με ἤκουσα τὴν φωνὴν τῶν λόγων τοῦ λαοῦ τούτου ὅσα ἐλάλησαν πρὸς σέ ὀρθῶς πάντα ὅσα ἐλάλησαν*
- 29 Ah, sikur të kishin gjithnjë një zemër të tillë, të më kishin frikë dhe të respektonin tërë urdhërimet e mia, që të rronin gjithnjë në begati ata dhe bijtë e tyre!  
**If only they had such a heart in them at all times, so that they might go in fear of me and keep my orders and that it might be well for them and for their children for ever!**  
*τίς δώσει οὕτως εἶναι τὴν καρδίαν αὐτῶν ἐν αὐτοῖς ὥστε φοβεῖσθαι με καὶ φυλάσσεσθαι τὰς ἐντολάς μου πάσας τὰς ἡμέρας ἵνα εὖ ᾦ αὐτοῖς καὶ τοῖς υἱοῖς αὐτῶν δι' αἰῶνος*
- 30 Shko dhe u thuaj: Kthehuni në çadrat tuaja.  
**Now say to them, Go back to your tents.**  
*βάδισον εἰπὼν αὐτοῖς ἀποστράφητε ὑμεῖς εἰς τοὺς οἴκους ὑμῶν*
- 31 Por ti qëndro këtu me mua dhe unë do të të tregoj tërë urdhërimet, tërë statutet dhe dekretet që do t'u mësosh atyre, me qëllim që t'i zbatojnë në vendin që unë po u jap si trashëgimi&quot;;  
**But as for you, keep your place here by me, and I will give you all the orders and the laws and the decisions which you are to make clear to them, so that they may do them in the land which I am giving them for their heritage.**  
*σὺ δὲ αὐτοῦ στήθι μετ' ἐμοῦ καὶ λαλήσω πρὸς σέ τὰς ἐντολάς καὶ τὰ δικαιώματα καὶ τὰ κρίματα ὅσα διδάξεις αὐτούς καὶ ποιείτωσαν ἐν τῇ γῇ ἣν ἐγὼ δίδωμι αὐτοῖς ἐν κλήρῳ*
- 32 Kini pra kujdes të bëni atë që Zoti, Perëndia juaj, ju ka urdhëruar; mos u shmangni as djathtas, as majtas;  
**Take care, then, to do whatever the Lord your God has given you orders to do; let there be no turning away to the right hand or to the left.**  
*καὶ φυλάξεσθε ποιεῖν ὃν τρόπον ἐνετείλατό σοι κύριος ὁ θεός σου οὐκ ἐκκλινεῖτε εἰς δεξιὰ οὐδὲ εἰς ἀριστερά*
- 33 ecni të tërë në rrugën që Zoti, Perëndia juaj, ju ka caktuar, që të jetoni, të keni mbarësi dhe të zgjatni ditët tuaja në vendin që do të pushtoni&quot;;  
**Go on walking in the way ordered for you by the Lord your God, so that life may be yours and it may be well for you, and your days may be long in the land of your heritage.**  
*κατὰ πᾶσαν τὴν ὁδὸν ἣν ἐνετείλατό σοι κύριος ὁ θεός σου πορεύεσθαι ἐν αὐτῇ ὅπως καταπαύσῃ σε καὶ εὖ σοι ᾦ καὶ μακροημερεύσῃτε ἐπὶ τῆς γῆς ἣς κληρονομήσετε*
- 1 Ky është urdhërimi, statutet dhe dekretet që Zoti, Perëndia juaj, ka urdhëruar t'ju mësojë, për t'i zbatuar në vendin në të cilin po hyni për ta marrë në zotërim;  
**Now these are the orders and the laws and the decisions which the Lord your God gave me for your teaching, so that you might do them in the land of your heritage to which you are going:**  
*καὶ αὗται αἱ ἐντολαὶ καὶ τὰ δικαιώματα καὶ τὰ κρίματα ὅσα ἐνετείλατο κύριος ὁ θεὸς ἡμῶν διδάξαι ὑμᾶς ποιεῖν οὕτως ἐν τῇ γῇ εἰς ἣν ὑμεῖς εἰσπορεύεσθε ἐκεῖ κληρονομήσαι αὐτήν*
- 2 me qëllim që ti të kesh frikë nga Zoti, Perëndia yt, të respektosh gjatë gjithë ditëve të jetës sate, ti, yt bir dhe djali i birit tënd, të tëra statutet dhe të gjitha urdhërimet e tij që unë po të jap, dhe me qëllim që ditët e jetës sate të zgjaten.  
**So that living in the fear of the Lord your God, you may keep all his laws and his orders, which I give you: you and your son and your son's son, all the days of your life; and so that your life may be long.**  
*ἵνα φοβῆσθε κύριον τὸν θεὸν ὑμῶν φυλάσσεσθαι πάντα τὰ δικαιώματα αὐτοῦ καὶ τὰς ἐντολάς αὐτοῦ ὅσας ἐγὼ ἐντέλλομαι σοι σήμερον σὺ καὶ οἱ υἱοὶ σου καὶ οἱ υἱοὶ τῶν υἱῶν σου πάσας τὰς ἡμέρας τῆς ζωῆς σου ἵνα μακροημερεύσῃτε*
- 3 Dëgjo, pra, Izrael, dhe ki kujdes t'i zbatosh në praktikë, me qëllim që të njohësh begatinë dhe të shumëzohesh me të madhe në vendin ku rrjedh qumësht dhe mjalt, ashtu si të ka thënë Zoti, Perëndia i etërve të tu.  
**So give ear, O Israel, and take care to do this; so that it may be well for you, and you may be greatly increased, as the Lord the God of your fathers has given you his word, in a land flowing with milk and honey.**  
*καὶ ἄκουσον ἰσραὴλ καὶ φύλαξαι ποιεῖν ὅπως εὖ σοι ᾦ καὶ ἵνα πληθυνθῆτε σφόδρα καθάπερ ἐλάλησεν κύριος ὁ θεὸς τῶν πατέρων σου δοῦναί σοι γῆν ῥέουσαν γάλα καὶ μέλι*
- 4 Dëgjo, Izrael, Zoti, Perëndia ynë, është një i vetëm.  
**Give ear, O Israel: the Lord our God is one Lord:**  
*καὶ ταῦτα τὰ δικαιώματα καὶ τὰ κρίματα ὅσα ἐνετείλατο κύριος τοῖς υἱοῖς ἰσραὴλ ἐν τῇ ἐρήμῳ ἐξελεθόντων αὐτῶν ἐκ γῆς αἰγύπτου ἄκουε ἰσραὴλ κύριος ὁ θεὸς ἡμῶν κύριος εἷς ἐστίν*
- 5 Ti do ta duash, pra, Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, me gjithë shpirt dhe me tërë forcën tënde.  
**And the Lord your God is to be loved with all your heart and with all your soul and with all your strength.**  
*καὶ ἀγαπήσεις κύριον τὸν θεόν σου ἐξ ὅλης τῆς καρδίας σου καὶ ἐξ ὅλης τῆς ψυχῆς σου καὶ ἐξ ὅλης τῆς δυνάμεώς σου*



- 6** Dhe këto fjalë që sot po të urdhëroj do të mbeten në zemrën tënde;  
**Keep these words, which I say to you this day, deep in your hearts;**  
 και ἔσται τὰ ῥήματα ταῦτα ὅσα ἐγὼ ἐντέλλομαι σοι σήμερον ἐν τῇ καρδίᾳ σου καὶ ἐν τῇ ψυχῇ σου
- 7** do t'ua ngulitësh bijve të tu, do të flasësh për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat dhe kur çohesh.  
**Teaching them to your children with all care, talking of them when you are at rest in your house or walking by the way, when you go to sleep and when you get up.**  
 και προβιβάσεις αὐτὰ τοὺς υἱοὺς σου καὶ λαλήσεις ἐν αὐτοῖς καθήμενος ἐν οἴκῳ καὶ πορευόμενος ἐν ὁδῷ καὶ κοιταζόμενος καὶ διανιστάμενος
- 8** Do t'i lidhësh si një shenjë në dorë, do të jenë si shirita midis syve,  
**Let them be fixed as a sign on your hand, and marked on your brow;**  
 και ἀφάψεις αὐτὰ εἰς σημεῖον ἐπὶ τῆς χειρὸς σου καὶ ἔσται ἀσάλευτον πρὸ ὀφθαλμῶν σου
- 9** dhe do t'i shkruash mbi pllakat e shtëpisë sate dhe mbi portat e tua.  
**Have them lettered on the pillars of your houses and over the doors of your towns.**  
 και γράψετε αὐτὰ ἐπὶ τὰς φλιάς τῶν οἰκιῶν ὑμῶν καὶ τῶν πυλῶν ὑμῶν
- 10** Kur pastaj Zoti, Perëndia yt, do të të fusë në vendin për të cilin iu betua etërve të tu, Abrahamit, Isakut dhe Jakobit, të të japë qytete të mëdha dhe të bukura që ti nuk i ke ndërtuar,  
**And when the Lord your God has taken you into the land which he gave his oath to your fathers, to Abraham, to Isaac, and to Jacob, that he would give you; with great and fair towns which were not of your building;**  
 και ἔσται ὅταν εἰσαγάγῃ σε κύριος ὁ θεός σου εἰς τὴν γῆν ἣν ὤμοσεν τοῖς πατράσιν σου τῷ αβραάμ καὶ ἰσαακ καὶ ἰακωβ δοῦναί σοι πόλεις μεγάλας καὶ καλὰς ἃς οὐκ ἠκοδόμησας
- 11** dhe shtëpi plot me të mira që ti nuk i ke mbushur, puse të çelur që ti nuk i ke gërmuar, vreshta dhe ullishte që ti nuk i ke mbjellë; kur të kesh ngrënë dhe të jesh ngopur,  
**And houses full of good things not stored up by you, and places for storing water which you did not make, and vine-gardens and olive-trees not of your planting; and you have taken food and are full;**  
 οἰκίας πλήρεις πάντων ἀγαθῶν ἃς οὐκ ἐπέλησας λάκκους λελατομημένους οὓς οὐκ ἐξελατόμησας ἀμπελώνας καὶ ἐλαιώνας οὓς οὐ κατεφύτευσας καὶ φαγῶν καὶ ἐμπλησθεῖς
- 12** ki kujdes të mos harrosh Zotin që të nxori nga vendi i Egjiptit, nga shtëpia e skllavërisë.  
**Then take care that you keep your hearts true to the Lord, who took you out of the land of Egypt, out of the prison-house.**  
 πρόσχε σεαυτῷ μὴ ἐπιλάβῃ κυρίου τοῦ θεοῦ σου τοῦ ἐξαγαγόντος σε ἐκ γῆς αἰγύπτου ἐξ οἴκου δουλείας
- 13** Do të kesh frikë nga Zoti, Perëndia yt, do t'i shërbesh dhe do të betohesh për emrin e tij.  
**Let the fear of the Lord your God be in your hearts, and be his servants, taking your oaths by his name.**  
 κύριον τὸν θεόν σου φοβηθήσῃ καὶ αὐτῷ λατρεύσεις καὶ πρὸς αὐτὸν κολληθήσῃ καὶ τῷ ὀνόματι αὐτοῦ ὀμῇ
- 14** Nuk do të shkoni pas perëndive të tjera midis perëndive të popujve që ju rrethojnë,  
**Do not go after other gods, the gods of the peoples round about you;**  
 οὐ πορεύσεσθε ὀπίσω θεῶν ἑτέρων ἀπὸ τῶν θεῶν τῶν ἐθνῶν τῶν περικύκλω ὑμῶν
- 15** (sepse Zoti, Perëndia yt, që ndodhet në mes teje, është një Perëndi ziliqar); përndryshe zemërimi i Zotit, Perëndisë tënd, do të ndizej kundër teje dhe do të bënte që ti të zhdukesh nga faqja e dheut.  
**For the Lord your God who is with you is a God who will not let his honour be given to another; or the wrath of the Lord will be burning against you, causing your destruction from the face of the earth.**  
 ὅτι θεὸς ζηλωτῆς κύριος ὁ θεός σου ἐν σοὶ μὴ ὀργισθεῖς θυμῶθῃ κύριος ὁ θεός σου ἐν σοὶ καὶ ἐξολεθρεύσῃ σε ἀπὸ προσώπου τῆς γῆς
- 16** Nuk do të tundoni Zotin, ashtu si u përpoqët në Masa.  
**Do not put the Lord your God to the test as you did in Massah.**  
 οὐκ ἐκπειράσεις κύριον τὸν θεόν σου ὡν τρόπον ἐξεπειράσασθε ἐν τῷ πειρασμῷ
- 17** Do të respektoni me kujdes urdhërimet e Zotit, Perëndisë tuaj, rregullat dhe statutet e tij që ai ju ka urdhëruar.  
**Keep with care the orders of the Lord your God, and his rules and his laws which he has given you;**  
 φυλάσσω φυλάξῃ τὰς ἐντολάς κυρίου τοῦ θεοῦ σου τὰ μαρτύρια καὶ τὰ δικαιώματα ὅσα ἐνετείλατό σοι
- 18** Prandaj do të bësh atë që është e drejtë dhe e mirë në sytë e Zotit, që ti të përparosh dhe të hysh e të pushtosh vendin e mirë që Zoti iu betua t'u japë etërve të tu,  
**And do what is upright and good in the eyes of the Lord your God, so that it may be well for you and you may go in and take for your heritage that good land from which the Lord undertook by an oath to your fathers,**  
 και ποιήσεις τὸ ἀρεστὸν καὶ τὸ καλὸν ἐναντίον κυρίου τοῦ θεοῦ ὑμῶν ἵνα εὖ σοι γένηται καὶ εἰσέλθῃς καὶ κληρονομήσῃς τὴν γῆν τὴν ἀγαθὴν ἣν ὤμοσεν κύριος τοῖς πατράσιν ὑμῶν

- 19 duke dëbuar tërë armiqtë e tu, ashtu siç kishte premtuar Zoti.  
To send out from before you all those who are against you.  
ἐκδιώξει πάντας τοὺς ἐχθρούς σου πρὸ προσώπου σου καθὼς ἐλάλησεν
- 20 Kur në të ardhmen biri yt do të të pyesë: "Çfarë kuptimi kanë këto rregulla, statute dhe dekrete, që Zoti, Perëndia ynë, ju ka urdhëruar?",  
And when your son says to you in time to come, What is the reason for these rules and laws and decisions which the Lord our God has given you?  
καὶ ἔσται ὅταν ἐρωτήσῃ σε ὁ υἱός σου αὐρίων λέγων τί ἐστὶν τὰ μαρτύρια καὶ τὰ δικαιώματα καὶ τὰ κρίματα ὅσα ἐνετείλατο κύριος ὁ θεὸς ἡμῶν ἡμῖν
- 21 ti do t'i përgjigjesh birit tënd: "Ishim skllevër të Faraonit në Egjipt dhe Zoti na nxori nga Egjipti me një dorë të fuqishme  
Then you will say to your son, We were servants under Pharaoh's yoke in Egypt; and the Lord took us out of Egypt with a strong hand:  
καὶ ἐρεῖς τῷ υἱῷ σου οἰκέται ἦμεν τῷ φαραῶ ἐν γῆ αἰγύπτῳ καὶ ἐξήγαγεν ἡμᾶς κύριος ἐκείθεν ἐν χειρὶ κραταιᾷ καὶ ἐν βραχίονι ὑψηλῷ
- 22 Përveç kësaj Zoti veproi para syve tona, kreu mrekulli të mëdha dhe të tmerrshme kundër Egjiptit, Faraonit dhe gjithë shtëpisë së tij.  
And the Lord did great signs and wonders against Egypt, and against Pharaoh and all his house, before our eyes:  
καὶ ἔδωκεν κύριος σημεῖα καὶ τέρατα μεγάλα καὶ πονηρὰ ἐν αἰγύπτῳ ἐν φαραῶ καὶ ἐν τῷ οἴκῳ αὐτοῦ ἐνώπιον ἡμῶν
- 23 Dhe na nxori që andej për të na çuar në vendin që u ishte betuar t'u jepte etërve tanë.  
And he took us out from that place, guiding us here to give us this land, as he said in his oath to our fathers.  
καὶ ἡμᾶς ἐξήγαγεν ἐκείθεν ἵνα εἰσαγάγῃ ἡμᾶς δοῦναι ἡμῖν τὴν γῆν ταύτην ἣν ὤμοσεν δοῦναι τοῖς πατράσιν ἡμῶν
- 24 Kështu Zoti na urdhëroi të zbatonim në praktikë të gjitha këto statute duke pasur frikë nga Zoti, Perëndia ynë, që të kemi gjithnjë mirëqenie dhe që ai të na mbante të gjallë, siç po ndodh tani.  
And the Lord gave us orders to keep all these laws, in the fear of the Lord our God, so that it might be well for us for ever, and that he might keep us from death, as he has done to this day.  
καὶ ἐνετείλατο ἡμῖν κύριος ποιεῖν πάντα τὰ δικαιώματα ταῦτα φοβεῖσθαι κύριον τὸν θεὸν ἡμῶν ἵνα εὖ ᾦ ἡμῖν πάσας τὰς ἡμέρας ἵνα ζῶμεν ὥσπερ καὶ σήμερον
- 25 Dhe kjo do të jetë drejtësia jonë në rast se kujdesemi të zbatojmë në praktikë tërë urdhërimet e Zotit, Perëndisë tonë, ashtu siç na ka urdhëruar"&quot;,  
And it will be our righteousness if we take care to keep all this order before the Lord our God as he has given it to us.  
καὶ ἐλεημοσύνη ἔσται ἡμῖν ἐὰν φυλασσώμεθα ποιεῖν πάσας τὰς ἐντολὰς ταύτας ἐναντίον κυρίου τοῦ θεοῦ ἡμῶν καθὼς ἐνετείλατο ἡμῖν κύριος
- 1 "Kur Zoti, Perëndia yt, do të të fusë në vendin ku ti po hyn për ta zotëruar atë, dhe kur të ketë dëbuar para teje shumë kombe: Hitejtë, Girgashejtë, Amorejte, Kananejte, Perezejte, Hivejtë dhe Gebusejtë,  
When the Lord your God takes you into the land where you are going, which is to be your heritage, and has sent out the nations before you, the Hittites and the Girgashites and the Amorites and the Canaanites and the Perizzites and the Hivites and the Jebusites, seven nations greater and stronger than you;  
ἐὰν δὲ εἰσαγάγῃ σε κύριος ὁ θεός σου εἰς τὴν γῆν εἰς ἣν εἰσπορεύῃ ἐκεῖ κληρονομησῆσαι καὶ ἐξαρεῖ ἔθνη μεγάλα ἀπὸ προσώπου σου τὸν χετταῖον καὶ γεργασαῖον καὶ αμορραῖον καὶ χαναναῖον καὶ φερεζαῖον καὶ ευαῖον καὶ ιεβουσαῖον ἑπτὰ ἔθνη πολλὰ καὶ ἰσχυρότερα ὑμῶν
- 2 dhe kur Zoti, Perëndia yt, t'i ketë lënë në pushtetin tënd, ti do t'i mundësh dhe do të vendosësh shfarosjen e tyre, nuk do të bësh asnjë aleancë me ta dhe nuk do të tregosh asnjë mëshirë ndaj tyre.  
And when the Lord has given them up into your hands and you have overcome them, give them up to complete destruction: make no agreement with them, and have no mercy on them:  
καὶ παραδώσει αὐτοὺς κύριος ὁ θεός σου εἰς τὰς χεῖράς σου καὶ πατάξεις αὐτούς ἀφανισμῷ ἀφανιεῖς αὐτούς οὐ διαθήσῃ πρὸς αὐτούς διαθήκην οὐδὲ μὴ ἐλεήσῃτε αὐτούς
- 3 Nuk do të lidhësh martesë me ta. Nuk do t'u japësh bijat e tua bijve të tyre dhe nuk do të marrësh bijat e tyre për bijtë e tu,  
Do not take wives or husbands from among them; do not give your daughters to their sons, or take their daughters for your sons.  
οὐδὲ μὴ γαμβρεύσῃτε πρὸς αὐτούς τὴν θυγατέρα σου οὐ δώσεις τῷ υἱῷ αὐτοῦ καὶ τὴν θυγατέρα αὐτοῦ οὐ λήμψῃ τῷ υἱῷ σου
- 4 sepse do t'i largonin bijtë e tu nga unë për t'u shërbyer perëndive të tjera, dhe zemërimi i Zotit do të ndizej kundër jush dhe do t'ju shkatërronte menjëherë.  
For through them your sons will be turned from me to the worship of other gods: and the Lord will be moved to wrath against you and send destruction on you quickly.  
ἀποστήσει γὰρ τὸν υἱόν σου ἀπ' ἐμοῦ καὶ λατρεύσει θεοῖς ἑτέροις καὶ ὀργισθῆσεται θυμῷ κύριος εἰς ὑμᾶς καὶ ἐξολοθρεύσει σε τὸ τάχος
- 5 Por me ta do të silleni kështu: do të shkatërroni altarët e tyre, do të copëtoni kolonat e tyre të shenjta, do të rrëzoni Asherimet e tyre dhe do t'u vini flakën shëmbëlltyrave të tyre të gdhendura.  
But this is what you are to do to them: their altars are to be pulled down and their pillars broken, and their holy trees cut down and their images burned with fire.  
ἀλλ' οὕτως ποιήσετε αὐτοῖς τοὺς βωμοὺς αὐτῶν καθελεῖτε καὶ τὰς στηλάς αὐτῶν συντρίψετε καὶ τὰ ἄλση αὐτῶν ἐκκόψετε καὶ τὰ γλυπτὰ τῶν θεῶν αὐτῶν κατακαύσετε πυρὶ
- 6 Me qenë se ti je një popull që je shenjtëruar tek Zoti, Perëndia yt; Zoti, Perëndia yt, të ka zgjedhur për të qenë thesari i tij i veçantë midis tërë popujve që ndodhen mbi faqen e dheut.  
For you are a holy people to the Lord your God: marked out by the Lord your God to be his special people out of all the nations on the face of the earth.  
ὅτι λαὸς ἅγιος εἶ κύριῳ τῷ θεῷ σου καὶ σε προεἶλατο κύριος ὁ θεός σου εἶναι σε αὐτῷ λαὸν περιούσιον παρὰ πάντα τὰ ἔθνη ὅσα ἐπὶ προσώπου τῆς γῆς

- 7 Zoti nuk e ka vënë dashurinë e tij mbi ju, as nuk ju ka zgjedhur, sepse nuk ishit më të shumtë nga asnjë popull tjetër; ju ishit në fakt më i vogli i të gjithë popujve;  
**The Lord did not give you his love or take you for himself because you were more in number than any other people; for you were the smallest of the nations:**  
*οὐχ ὅτι πολυπληθεῖτε παρὰ πάντα τὰ ἔθνη προεἰλατο κύριος ὑμᾶς καὶ ἐξελέξατο ὑμᾶς ὅτι ἐστε ὀλιγοστοὶ παρὰ πάντα τὰ ἔθνη*
- 8 por sepse Zoti ju do dhe ka dashuri të mbajë betimin që u ka bërë etërve tuaj, ai ju nxori me një dorë të fuqishme dhe ju shpëtoi nga shtëpia e skllavërisë, nga dora e Faraonit, mbretit të Egjiptit.  
**But because of his love for you, and in order to keep his oath to your fathers, the Lord took you out with the strength of his hand, making you free from the prison-house and from the hand of Pharaoh, king of Egypt.**  
*ἀλλὰ παρὰ τὸ ἀγαπᾶν κύριον ὑμᾶς καὶ διατηρῶν τὸν ὄρκον ὃν ὤμοσεν τοῖς πατράσιν ὑμῶν ἐξήγαγεν κύριος ὑμᾶς ἐν χειρὶ κραταιᾷ καὶ ἐν βραχίονι ὑψηλῷ καὶ ἐλυτρώσατο ἐξ οἴκου δουλείας ἐκ χειρὸς φαραω βασιλέως αἰγύπτου*
- 9 Prano, pra, që Zoti, Perëndia yt, është Perëndia, Perëndia besnik që respekton besëlidhjen e tij dhe tregohet i mbarë deri në brezin e njëmijhtë ndaj atyre që e duan dhe që zbatojnë urdhërimet e tij,  
**Be certain, then, that the Lord your God is God; whose faith and mercy are unchanging, who keeps his word through a thousand generations to those who have love for him and keep his laws;**  
*καὶ γνώση ὅτι κύριος ὁ θεὸς σου οὗτος θεὸς θεὸς πιστὸς ὁ φυλάσσειν διαθήκην καὶ ἔλεος τοῖς ἀγαπῶσιν αὐτὸν καὶ τοῖς φυλάσσουσιν τὰς ἐντολὰς αὐτοῦ εἰς χιλιάς γενεῶν*
- 10 por u përgjigjet menjëherë atyre që e urrejnë, duke i zhdukur; ai nuk vonon, por do t'u përgjigjet menjëherë atyre që e urrejnë.  
**Rewarding his haters to their face with destruction; he will have no mercy on his hater, but will give him open punishment.**  
*καὶ ἀποδίδους τοῖς μισοῦσιν κατὰ πρόσωπον ἐξολοθρεῦσαι αὐτούς καὶ οὐχὶ βραδυνεῖ τοῖς μισοῦσιν κατὰ πρόσωπον ἀποδώσει αὐτοῖς*
- 11 Prandaj respekto urdhërimet, statutet dhe dekretet që po të jap sot, duke i zbatuar në praktikë.  
**So keep the orders and the laws and the decisions which I give you today and do them.**  
*καὶ φυλάξῃ τὰς ἐντολὰς καὶ τὰ δικαιώματα καὶ τὰ κρίματα ταῦτα ὅσα ἐγὼ ἐντέλλομαι σοὶ σήμερον ποιεῖν*
- 12 Kështu, në rast se ju keni parasysh këto ligje, i respektoni dhe i zbatoni në praktikë, Zoti, Perëndia juaj, do ta mbajë besëlidhjen me ju dhe dashamirësinë për të cilën u është betuar etërve tuaj.  
**And it will be, that if you give attention to these decisions and keep and do them, then the Lord will keep his agreement with you and his mercy, as he said in his oath to your fathers.**  
*καὶ ἔσται ἡνίκα ἂν ἀκούσῃτε πάντα τὰ δικαιώματα ταῦτα καὶ φυλάξῃτε καὶ ποιήσῃτε αὐτὰ καὶ διαφυλάξῃ κύριος ὁ θεὸς σου τὴν διαθήκην καὶ τὸ ἔλεος ὃ ὤμοσεν τοῖς πατράσιν ὑμῶν*
- 13 Ai do të të dojë, do të të bekojë dhe do të të shumëzojë, do të bekojë frytin e gjit tënd dhe frytin e tokës sate, grurin tënd, mushtin dhe vajin tënd, pjelljet e lopëve dhe të deleve të tua në vendin që u betua t'u japë etërve të tu.  
**And he will give you his love, blessing you and increasing you: he will send his blessing on the offspring of your body and the fruit of your land, your grain and your wine and your oil, the increase of your cattle and the young of your flock, in the land which by his oath to your fathers he undertook to give you.**  
*καὶ ἀγαπήσει σε καὶ εὐλογήσει σε καὶ πληθυνεῖ σε καὶ εὐλογήσει τὰ ἔκγονα τῆς κοιλίας σου καὶ τὸν καρπὸν τῆς γῆς σου τὸν σῖτόν σου καὶ τὸν οἶνον σου καὶ τὸ ἔλαιόν σου τὰ βουκόλια τῶν βοῶν σου καὶ αἱ τὰ ποίμνια τῶν προβάτων σου ἐπὶ τῆς γῆς ἧς ὤμοσεν κύριος τοῖς πατράσιν σου δοῦναι σοὶ*
- 14 Ti do të jesh më i bekuari i të gjithë popujve dhe nuk do të ketë midis teje asnjë burrë apo grua shterpë, as edhe midis bagëtisë sate.  
**You will have greater blessings than any other people: no male or female among you or among your cattle will be without offspring.**  
*εὐλογητὸς ἔσῃ παρὰ πάντα τὰ ἔθνη οὐκ ἔσται ἐν ὑμῖν ἄγονος οὐδὲ στείρα καὶ ἐν τοῖς κτήνεσίν σου*
- 15 Zoti do të largojë nga ti çfarëdo lloj sëmundje, nuk do të dërgojë mbi ty asnjë të keqe vdekjeprurëse të Egjiptit që ke njohur, por do t'i dërgojë mbi të gjithë ata që të urrejnë.  
**And the Lord will take away from you all disease, and will not put on you any of the evil diseases of Egypt which you have seen, but will put them on your haters.**  
*καὶ περιελεῖ κύριος ἀπὸ σοῦ πᾶσαν μαλακίαν καὶ πάσας νόσους αἰγύπτου τὰς πονηράς ἃς ἐώρακας καὶ ὅσα ἔγνωσ οὐκ ἐπιθήσει ἐπὶ σέ καὶ ἐπιθήσει αὐτὰ ἐπὶ πάντας τοὺς μισοῦντάς σε*
- 16 Do të shfarosësh, pra, të gjithë popujt që Zoti, Perëndia yt, po të jep në pushtetin tënd; syri yt nuk duhet të ketë mëshirë për ta dhe mos u shërbe perëndive të tyre, sepse ky do të ishte një kurth për ty.  
**And you are to send destruction on all the peoples which the Lord your God gives into your hands; have no pity on them, and do not give worship to their gods; for that will be a cause of sin to you.**  
*καὶ φάγῃ πάντα τὰ σκῶλα τῶν ἐθνῶν ἃ κύριος ὁ θεὸς σου δίδωσίν σοι οὐ φείσεται ὁ ὀφθαλμὸς σου ἐπ' αὐτοῖς καὶ οὐ λατρεύσεις τοῖς θεοῖς αὐτῶν ὅτι σκῶλον τοῦτο ἔστιν σοὶ*
- 17 Në zemrën tënde mund të thuash: "Këta kombe janë më të mëdhenj se unë, si do të arrij unë t'i dëboj?"  
**If you say in your hearts, These nations are greater in number than we are: how are we to take their land from them?**  
*ἐὰν δὲ λέγῃς ἐν τῇ διανοίᾳ σου ὅτι πολὺ τὸ ἔθνος τοῦτο ἢ ἐγὼ πῶς δυνήσομαι ἐξολοθρεῦσαι αὐτούς*
- 18 Mos ki frikë prej tyre, por kujto atë që Zoti, Perëndia yt, i bëri Faraonit dhe të gjithë Egjiptasve;  
**Have no fear of them, but keep well in mind what the Lord your God did to Pharaoh and to all Egypt;**  
*οὐ φοβηθήσῃ αὐτούς μνεία μνησθήσῃ ὅσα ἐποίησεν κύριος ὁ θεὸς σου τῷ φαραω καὶ πᾶσι τοῖς αἰγυπτίοις*

- 19 kujto provat e mëdha që pe me sytë e tu, shenjat dhe mrekullitë e dorës së fuqishme dhe të krahut të shtrirë me të cilët Zoti, Perëndia yt, të nxori nga Egjipti; kështu do të veprojë Zoti, Perëndia yt, me të gjithë popujt nga të cilët ke frikë.  
The great punishments which your eyes saw, and the signs and the wonders and the strong hand and the stretched-out arm, by which the Lord your God took you out: so will the Lord your God do to all the peoples who are the cause of your fears.  
τοὺς πειρασμοὺς τοῦς μεγάλους οὓς εἶδοσαν οἱ ὀφθαλμοὶ σου τὰ σημεῖα καὶ τὰ τέρατα τὰ μέγала ἐκεῖνα τὴν χεῖρα τὴν κραταιὰν καὶ τὸν βραχίονα τὸν ὑψηλόν ὡς ἐξήγαγέν σε κύριος ὁ θεός σου οὕτως ποιήσει κύριος ὁ θεός ἡμῶν πᾶσι τοῖς ἔθνεσιν οὓς σὺ φοβῆ ἀπὸ προσώπου αὐτῶν
- 20 Përveç kësaj, Zoti, Perëndia yt, do të çojë kundër tyre grerat, deri sa ata që kanë mbetur dhe ata që janë fshehur nga frika jote të kenë vdekur.  
And the Lord will send a hornet among them, till all the rest who have kept themselves safe from you in secret places have been cut off.  
καὶ τὰς σφηκίας ἀποστελεῖ κύριος ὁ θεός σου εἰς αὐτοὺς ἕως ἂν ἐκτριβῶσιν οἱ καταλελειμμένοι καὶ οἱ κεκρυμμένοι ἀπὸ σοῦ
- 21 Mos ki frikë prej tyre, sepse Zoti, Perëndia yt, është në mes jush, një Perëndi i madh dhe i tmerrshëm.  
Have no fear of them: for the Lord your God is with you, a great God greatly to be feared.  
οὐ τρωθήσῃ ἀπὸ προσώπου αὐτῶν ὅτι κύριος ὁ θεός σου ἐν σοὶ θεὸς μέγας καὶ κραταῖός
- 22 Zoti, Perëndia yt, do t'i dëbojë pak e nga pak këto kombe para teje; ti nuk do të arrish t'i zhdukësh menjëherë, sepse përndryshe bishat e fushës do të shtoheshin shumë kundër teje;  
The Lord your God will send out the nations before you little by little; they are not to be rooted out quickly, for fear that the beasts of the field may be increased overmuch against you.  
καὶ καταναλώσει κύριος ὁ θεός σου τὰ ἔθνη ταῦτα ἀπὸ προσώπου σου κατὰ μικρὸν μικρὸν οὐ δυνήσῃ ἐξαναλῶσαι αὐτοὺς τὸ τάχος ἵνα μὴ γένηται ἡ γῆ ἔρημος καὶ πληθυνθῇ ἐπὶ σὲ τὰ θηρία τὰ ἄγρια
- 23 por Zoti, Perëndia yt, do t'i vërë nën pushtetin tënd, dhe do t'i hutojë shumë deri sa të shfarosen.  
But the Lord your God will give them up into your hands, overpowering them till their destruction is complete.  
- 11** dhe do të gëzoheni, ti, Leviti dhe i huaji që ndodhet në radhët e tua për të mirat që Zoti, Perëndia yt, të ka dhënë ty dhe shtëpisë sate.  
 And you will have joy in every good thing which the Lord your God has given to you and to your family; and the Levite, and the man from a strange land who is with you, will take part in your joy.  
 και εὐφρανθήσῃ ἐν πᾶσιν τοῖς ἀγαθοῖς οἷς ἔδωκέν σοι κύριος ὁ θεός σου καὶ τῇ οἰκίᾳ σου σὺ καὶ ὁ λευίτης καὶ ὁ προσήλυτος ὁ ἐν σοί
- 12** Kur të kesh mbaruar së dhëni tërë të dhjetat e të ardhurave të tua në vitin e tretë, viti i të dhjetave, dhe ua ke dhënë Levitit, të huajit, jetimit dhe gruas së ve, me qëllim që t'i hanë brenda portave të tua dhe të ngopen,  
 When you have taken out a tenth from the tenth of all your produce in the third year, which is the year when this has to be done, give it to the Levite, and the man from a strange land, and the child without a father, and the widow, so that they may have food in your towns and be full;  
 ἐὰν δὲ συντελέσῃς ἀποδεκατῶσαι πᾶν τὸ ἐπιδέκατον τῶν γεννημάτων τῆς γῆς σου ἐν τῷ ἔτει τῷ τρίτῳ τὸ δεῦτερον ἐπιδέκατον δώσεις τῷ λευίτῃ καὶ τῷ προσηλύτῳ καὶ τῷ ὀρφανῷ καὶ τῇ χήρᾳ καὶ φάγονται ἐν ταῖς πόλεσίν σου καὶ ἐμπλησθήσονται



- 13** do të thuash përpara Zotit, Perëndisë tënd: &quot;Unë kam hequr nga shtëpia ime atë që është shenjtëruar dhe ua kam dhënë Levitit, të huajit, jetimit dhe gruas së ve, në bazë të të gjitha gjërave që më ke urdhëruar; nuk kam shkelur as kam harruar asnjë nga urdhrat e tua.  
**And say before the Lord your God, I have taken all the holy things out of my house and have given them to the Levite, and the man from a strange land, and him who has no father, and the widow, as you have given me orders: I have kept in mind all your orders, in nothing have I gone against them:**  
*καὶ ἐρεῖς ἐναντίον κυρίου τοῦ θεοῦ σου ἐξεκάθαρα τὰ ἅγια ἐκ τῆς οἰκίας μου καὶ ἔδωκα αὐτὰ τῷ λευίτῃ καὶ τῷ προσηλύτῳ καὶ τῷ ὀρφανῷ καὶ τῇ χήρᾳ κατὰ πάσας τὰς ἐντολάς ἃς ἐνετείλω μοι οὐ παρῆλθον τὴν ἐντολήν σου καὶ οὐκ ἐπελαθόμην*
- 14** Nuk i hëngra gjatë zisë sime, nuk mora prej tyre kur isha i papastër dhe nuk ua ofrova të vdekurve; iu binda zërit të Zotit, Perëndisë tim, dhe veprova në bazë të të gjitha gjërave që më ke urdhëruar.  
**No part of these things has been used for food in a time of weeping, or put away when I was unclean, or given for the dead: I have given ear to the voice of the Lord my God, and have done all you have given me orders to do.**  
*καὶ οὐκ ἔφαγον ἐν ὀδύνη μου ἀπ' αὐτῶν οὐκ ἐκάρπωσα ἀπ' αὐτῶν εἰς ἀκάθαρτον οὐκ ἔδωκα ἀπ' αὐτῶν τῷ τεθηκῶτι ὑπήκουσα τῆς φωνῆς κυρίου τοῦ θεοῦ μου ἐποίησα καθὰ ἐνετείλω μοι*
- 15** Kthe ndaj nesh vështrimin tënd nga banesa jote e shenjtë, nga qielli, dhe beko popullin tënd të Izraelit dhe vendin që na ke dhënë, siç iu betove etërve tanë, një vend ku rrjedh qumësht e mjaltë.  
**So, looking down from your holy place in heaven, send your blessing on your people Israel and on the land which you have given us, as you said in your oath to our fathers, a land flowing with milk and honey.**  
*κάτιδε ἐκ τοῦ οἴκου τοῦ ἁγίου σου ἐκ τοῦ οὐρανοῦ καὶ εὐλόγησον τὸν λαόν σου τὸν Ἰσραὴλ καὶ τὴν γῆν ἣν ἔδωκας αὐτοῖς καθὰ ὠμοσας τοῖς πατράσιν ἡμῶν δοῦναι ἡμῖν γῆν ῥέουσαν γάλα καὶ μέλι*
- 16** Sot Zoti, Perëndia yt, të urdhëron të zbatosh në praktikë këto statute dhe dekrete; ki kujdes që t'i zbatosh me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt.  
**Today the Lord your God gives you orders to keep all these laws and decisions: so then keep and do them with all your heart and all your soul.**  
*ἐν τῇ ἡμέρᾳ ταύτῃ κύριος ὁ θεὸς σου ἐνετείλατό σοι ποιῆσαι πάντα τὰ δικαιώματα ταῦτα καὶ τὰ κρίματα καὶ φυλάξεσθε καὶ ποιήσετε αὐτὰ ἐξ ὅλης τῆς καρδίας ὑμῶν καὶ ἐξ ὅλης τῆς ψυχῆς ὑμῶν*
- 17** Ti sot deklaroje që Zoti është Perëndia yt, që do të ecësh në rrugët e tij dhe do të respektosh statutet, urdhërimet dhe dekretet e tij, dhe do t'i bindesh zërit të tij.  
**Today you have given witness that the Lord is your God, and that you will go in his ways and keep his laws and his orders and his decisions and give ear to his voice:**  
*τὸν θεὸν εἴλου σήμερον εἶναι σου θεὸν καὶ πορεύεσθαι ἐν ταῖς ὁδοῖς αὐτοῦ καὶ φυλάσσεσθαι τὰ δικαιώματα καὶ τὰ κρίματα αὐτοῦ καὶ ὑπακοεῖν τῆς φωνῆς αὐτοῦ*
- 18** Sot Zoti ka deklaruar gjithashtu që ti je popull i tij, një thesar i veçantë, siç të ka thënë, me qëllim që ti të respektosh të gjitha urdhërimet e tij,  
**And the Lord has made it clear this day that you are a special people to him, as he gave you his word; and that you are to keep all his orders;**  
*καὶ κύριος ἐλάτῳ σε σήμερον γενέσθαι σε αὐτῷ λαὸν περιούσιον καθάπερ εἶπέν σοι φυλάσσειν πάσας τὰς ἐντολάς αὐτοῦ*
- 19** dhe ti të mund të lartësohesh mbi të gjitha kombet që ai ka bërë për lavdi, famë dhe zulmë dhe që ti të jesh një popull i shenjtëruar për Zotin, Perëndinë tënd, ashtu siç e ka thënë ai &quot;;  
**And that he will make you high over all the nations he has made, in praise, in name, and in honour, and that you are to be a holy people to the Lord your God as he has said.**  
*καὶ εἶναι σε ὑπεράνω πάντων τῶν ἐθνῶν ὡς ἐποίησέν σε ὀνομαστὸν καὶ καύχημα καὶ δόξαστόν εἶναι σε λαὸν ἅγιον κυρίῳ τῷ θεῷ σου καθὼς ἐλάλησεν*
- 1** Atëherë Moisiu dhe pleqtë e Izraelit i dhanë popullit këtë urdhër: &quot;Respektoni të gjitha urdhërimet që po ju caktoj sot.  
**Then Moses and the responsible men of Israel gave the people these orders: Keep all the orders which I have given you this day;**  
*καὶ προσέταξεν μουσῆς καὶ ἡ γερούσια Ἰσραὴλ λέγων φυλάσσεσθε πάσας τὰς ἐντολάς ταύτας ὅσας ἐγὼ ἐντέλλομαι ὑμῖν σήμερον*
- 2** Ditën që do të kapërceni Jordanin për të hyrë në vendin që Zoti, Perëndia juaj, ju jep, do të ngrësh për vete gurë të mëdhenj dhe do t'i lyesh me gëlqere.  
**And on the day when you go over Jordan into the land which the Lord your God is giving you, put up great stones, coating them with building-paste,**  
*καὶ ἔσται ἡ ἡμέρα διαβῆτε τὸν ἰορδάνην εἰς τὴν γῆν ἣν κύριος ὁ θεὸς σου δίδωσιν σοι καὶ στήσεις σεαυτῷ λίθους μεγάλους καὶ κονιάσεις αὐτοὺς κονία*
- 3** Pastaj do të shkruash mbi ta tërë fjalët e këtij ligji, kur të kapërcësh Jordanin për të hyrë në vendin që Zoti, Perëndia yt, të jep, një vend ku rrjedh qumësht dhe mjaltë, ashtu si të ka thënë Zoti, Perëndia i etërve të tu.  
**And writing on them all the words of this law, after you have gone over; so that you may take the heritage which the Lord your God is giving you, a land flowing with milk and honey, as the Lord, the God of your fathers, has said.**  
*καὶ γράψεις ἐπὶ τῶν λίθων πάντας τοὺς λόγους τοῦ νόμου τούτου ὡς ἂν διαβῆτε τὸν ἰορδάνην ἡνίκα ἐὰν εἰσέλθητε εἰς τὴν γῆν ἣν κύριος ὁ θεὸς τῶν πατέρων σου δίδωσιν σοι γῆν ῥέουσαν γάλα καὶ μέλι ὃν τρόπον εἶπεν κύριος ὁ θεὸς τῶν πατέρων σου σοι*
- 4** Kështu, pra, kur të kaloni Jordanin, do të ngrini në malin Ebal këta gurë, që sot ju urdhëroj, dhe do t'i lyesh me gëlqere.  
**And when you have gone over Jordan, you are to put up these stones, as I have said to you today, in Mount Ebal, and have them coated with building-paste.**  
*καὶ ἔσται ὡς ἂν διαβῆτε τὸν ἰορδάνην στήσετε τοὺς λίθους τούτους οὗς ἐγὼ ἐντέλλομαι σοι σήμερον ἐν ὄρει γαιβαλ καὶ κονιάσεις αὐτοὺς κονία*
- 5** Aty do t'i ngrësh edhe një altar Zotit, Perëndisë tënd, një altar gurësh, mbi të cilët nuk do të përdorësh vegël hekuri.  
**There you are to make an altar to the Lord your God, of stones on which no iron instrument has been used.**  
*καὶ οἰκοδομήσεις ἐκεῖ θυσιαστήριον κυρίῳ τῷ θεῷ σου θυσιαστήριον ἐκ λίθων οὐκ ἐπιβαλεῖς ἐπ' αὐτοὺς σίδηρον*

- 6 Do të ndërtohet altarin e Zotit, Perëndisë tënd, me gurë të pacënuar, dhe mbi të do t'i ofrosh olokauste Zotit, Perëndisë tënd.  
You are to make the altar of the Lord your God of uncut stones; offering on it burned offerings to the Lord your God:  
λίθους ὀλοκλήρους οἰκοδομήσεις θυσιαστήριον κυρίῳ τῷ θεῷ σου καὶ ἀνοίσεις ἐπ' αὐτὸ ὀλοκαντώματα κυρίῳ τῷ θεῷ σου
- 7 Do të ofrosh flijime falenderimi, dhe aty do të hash dhe do të gëzohesh përpara Zotit, Perëndisë tënd.  
And you are to make your peace-offerings, feasting there with joy before the Lord your God.  
καὶ θύσεις ἐκεῖ θυσίαν σωτηρίου κυρίῳ τῷ θεῷ σου καὶ φάγη καὶ ἐμπλησθήσῃ καὶ εὐφρανθήσῃ ἐναντίον κυρίου τοῦ θεοῦ σου
- 8 Dhe do të shkruash mbi këta gurë tërë fjalët e këtij ligji me gërma shumë të qarta<sup>“</sup>.  
And put on the stones all the words of this law, writing them very clearly.  
καὶ γράψεις ἐπὶ τῶν λίθων πάντα τὸν νόμον τοῦτον σαφῶς σφόδρα
- 9 Pastaj Moisiu dhe priftërinjtë levitë i folën tërë Izraelit, duke thënë: <sup>“</sup>Mbaj qetësi dhe dëgjo, o Izrael! Sot je bërë populli i Zotit, Perëndisë tënd.  
Then Moses and the priests, the Levites, said to all Israel, Be quiet and give ear, O Israel; today you have become the people of the Lord your God.  
καὶ ἐλάλησεν μουσῆς καὶ οἱ ἱερεῖς οἱ λευῖται παντὶ Ἰσραηλ λέγοντες σιώπα καὶ ἄκουε Ἰσραηλ ἐν τῇ ἡμέρᾳ ταύτῃ γέγονας εἰς λαὸν κυρίῳ τῷ θεῷ σου
- 10 Do t'i bindesh, pra, zërit të Zotit, Perëndisë tënd, dhe do t'i zbatosh në praktikë urdhërimet dhe ligjet që sot të urdhëroj<sup>“</sup>.  
For this cause you are to give ear to the voice of the Lord your God, and do his orders and his laws which I give you this day.  
καὶ εἰσακούσῃ τῆς φωνῆς κυρίου τοῦ θεοῦ σου καὶ ποιήσεις πάσας τὰς ἐντολὰς αὐτοῦ καὶ τὰ δικαιώματα αὐτοῦ ὅσα ἐγὼ ἐντέλλομαι σοὶ σήμερον
- 11 Po atë ditë Moisiu i dha këtë urdhër popullit, duke i thënë:  
That same day Moses said to the people,  
καὶ ἐνετείλατο μουσῆς τῷ λαῷ ἐν τῇ ἡμέρᾳ ἐκείνῃ λέγων
- 12 <sup>“</sup>Ja ata do të rrijnë në malin Gerizim për të bekuar popullin kur të keni kapërcyer Jordanin: Simeoni, Levi, Juda, Isakari, Jozefi dhe Beniamini;  
These are to take their places on Mount Gerizim for blessing the people when you have gone over Jordan: Simeon and Levi and Judah and Issachar and Joseph and Benjamin;  
οὗτοι στήσονται εὐλογεῖν τὸν λαὸν ἐν ὄρει γαριζὶν διαβάντες τὸν ἰορδάνην συμφωνοῦντες λευὶ ἰουδας ἰσσαχαρ ἰωσηφ καὶ βενιαμιν
- 13 dhe ja ata që do të rrijnë në malin Ebal për të shqiptuar mallkimin: Rubeni, Gadi, Asheri, Zabuloni, Dani dhe Neftali.  
And these are to be on Mount Ebal for the curse: Reuben, Gad, and Asher, and Zebulun, Dan, and Naphtali.  
καὶ οὗτοι στήσονται ἐπὶ τῆς κατάρας ἐν ὄρει γαιβαλ ρουβην γαδ καὶ ασηρ ζαβουλων δαν καὶ νεφθαλι
- 14 Levitët do të flasin dhe do t'u thonë me zë të lartë gjithë burrave të Izraelit:  
Then the Levites are to say in a loud voice to all the men of Israel,  
καὶ ἀποκριθέντες οἱ λευῖται ἐροῦσιν παντὶ Ἰσραηλ φωνῇ μεγάλῃ
- 15 <sup>“</sup>Mallkuar qoftë ai njeri që bën një shëmbëllturë të gdhendur o prej metali të shkrirë, gjë e neveritshme për Zotin, vepër e duarve të një artizani, dhe e vendos në një vend sekret!<sup>“</sup>. Dhe tërë populli do të përgjigjet dhe do të thotë: <sup>“</sup>Amen<sup>“</sup>.  
Cursed is the man who makes any image of wood or stone or metal, disgusting to the Lord, the work of man's hands, and puts it up in secret. And let all the people say, So be it.  
ἐπικατάρατος ἄνθρωπος ὅστις ποιήσει γλυπτὸν καὶ χωνευτὸν βδέλυγμα κυρίῳ ἔργον χειρῶν τεχνίτου καὶ θήσῃ αὐτὸ ἐν ἀποκρύφῳ καὶ ἀποκριθεὶς πᾶς ὁ λαὸς ἐροῦσιν γένοιτο
- 16 <sup>“</sup>Mallkuar qoftë ai që përçmon atin ose nënën e tij!<sup>“</sup>. Dhe tërë populli do të thotë: <sup>“</sup>Amen<sup>“</sup>.  
Cursed is he who does not give honour to his father or mother. And let all the people say, So be it.  
ἐπικατάρατος ὁ ἀτιμάζων πατέρα αὐτοῦ ἢ μητέρα αὐτοῦ καὶ ἐροῦσιν πᾶς ὁ λαὸς γένοιτο
- 17 <sup>“</sup>Mallkuar qoftë ai që zhvendos kufijtë e të afërmit të tij!<sup>“</sup>. Dhe tërë populli do të thotë: <sup>“</sup>Amen<sup>“</sup>.  
Cursed is he who takes his neighbour's landmark from its place. And let all the people say, So be it.  
ἐπικατάρατος ὁ μετατιθεὶς ὄρια τοῦ πλησίον καὶ ἐροῦσιν πᾶς ὁ λαὸς γένοιτο
- 18 <sup>“</sup>Mallkuar qoftë ai që i humb rrugën të verbërit!<sup>“</sup>. Dhe tërë populli do të thotë: <sup>“</sup>Amen<sup>“</sup>.  
Cursed is he by whom the blind are turned out of the way. And let all the people say, So be it.  
ἐπικατάρατος ὁ πλανῶν τυφλὸν ἐν ὁδῷ καὶ ἐροῦσιν πᾶς ὁ λαὸς γένοιτο
- 19 <sup>“</sup>Mallkuar qoftë ai që çënon të drejtën e të huajit, të jetimit dhe të gruas së ve!<sup>“</sup>. Dhe tërë populli do të thotë: <sup>“</sup>Amen<sup>“</sup>.  
Cursed is he who gives a wrong decision in the cause of a man from a strange land, or of one without a father, or of a widow. And let all the people say, So be it.  
ἐπικατάρατος ὃς ἂν ἐκκλίνῃ κρίσιν προσηλύτου καὶ ὄρφανοῦ καὶ χήρας καὶ ἐροῦσιν πᾶς ὁ λαὸς γένοιτο

- 20 "Mallkuar qoftë ai që bie në shtrat me gruan e atit të tij,; sepse ka ngritur cepin e mbulesës së atit të tij!". Dhe tërë populli do të thotë: "Amen".  
Cursed is he who has sex relations with his father's wife, for he has put shame on his father. And let all the people say, So be it.  
ἐπικατάρατος ὁ κοιμώμενος μετὰ γυναικὸς τοῦ πατρὸς αὐτοῦ ὅτι ἀπεκάλυψεν συγκάλυμμα τοῦ πατρὸς αὐτοῦ καὶ ἐροῦσιν πᾶς ὁ λαὸς γένοιτο
- 21 "Mallkuar qoftë ai që bie në shtrat me çfarëdo kafshë!". Dhe tërë populli do të thotë: "Amen".  
Cursed is he who has sex relations with any sort of beast. And let all the people say, So be it.  
ἐπικατάρατος ὁ κοιμώμενος μετὰ παντὸς κτήνους καὶ ἐροῦσιν πᾶς ὁ λαὸς γένοιτο
- 22 "Mallkuar qoftë ai që bie në shtrat me motrën e tij, me bijën e atit të tij ose me bijën e nënes së tij!". Dhe tërë populli do të thotë: "Amen".  
Cursed is he who has sex relations with his sister, the daughter of his father or of his mother. And let all the people say, So be it.  
ἐπικατάρατος ὁ κοιμώμενος μετὰ ἀδελφῆς ἢ ἐκ πατρὸς ἢ ἐκ μητρὸς αὐτοῦ καὶ ἐροῦσιν πᾶς ὁ λαὸς γένοιτο
- 23 "Mallkuar qoftë ai që bie në shtrat me vjehrrën e tij!". Dhe tërë populli do të thotë: "Amen".  
Cursed is he who has sex relations with his mother-in-law. And let all the people say, So be it.  
ἐπικατάρατος ὁ κοιμώμενος μετὰ πενθερᾶς αὐτοῦ καὶ ἐροῦσιν πᾶς ὁ λαὸς γένοιτο ἐπικατάρατος ὁ κοιμώμενος μετὰ ἀδελφῆς γυναικὸς αὐτοῦ καὶ ἐροῦσιν πᾶς ὁ λαὸς γένοιτο
- 24 "Mallkuar qoftë ai që vret të afërmin e tij në mënyrë të fshehtë!". Dhe tërë populli do të thotë: "Amen".  
Cursed is he who takes his neighbour's life secretly. And let all the people say, So be it.  
ἐπικατάρατος ὁ τύπτων τὸν πλησίον αὐτοῦ δόλῳ καὶ ἐροῦσιν πᾶς ὁ λαὸς γένοιτο
- 25 "Mallkuar qoftë ai që pranon një dhuratë për të goditur për vdekje një të pafajshëm!". Dhe tërë populli do të thotë: "Amen".  
Cursed is he who for a reward puts to death one who has done no wrong. And let all the people say, So be it.  
ἐπικατάρατος ὃς ἂν λάβῃ δῶρα πατάξαι ψυχὴν αἵματος ἀθώου καὶ ἐροῦσιν πᾶς ὁ λαὸς γένοιτο
- 26 "Mallkuar qoftë ai që nuk u përmbahet fjalëve të këtij ligji për t'i zbatuar në praktikë!". Tërë populli do të thotë: "Amen".  
Cursed is he who does not take this law to heart to do it. And let all the people say, So be it.  
ἐπικατάρατος πᾶς ἄνθρωπος ὃς οὐκ ἐμμενεῖ ἐν πᾶσιν τοῖς λόγοις τοῦ νόμου τούτου τοῦ ποιῆσαι αὐτούς καὶ ἐροῦσιν πᾶς ὁ λαὸς γένοιτο
- 1 "Tani, në rast se ti i bindesh me zell zërit të Zotit, Perëndisë tënd, duke pasur kujdes të zbatosh tërë urdhërimet e tij që sot unë po të urdhëroj, do të ndodhë që Zoti, Perëndia yt, do të të lartësojë mbi të gjitha kombet e dheut;  
Now if you give ear to the voice of the Lord your God, and keep with care all these orders which I have given you today, then the Lord your God will put you high over all the nations of the earth:  
καὶ ἔσται ὡς ἂν διαβῆτε τὸν ιορδάνην εἰς τὴν γῆν ἣν κύριος ὁ θεὸς ὑμῶν δίδωσιν ὑμῖν ἐὰν ἀκοῆ εἰσακούσητε τῆς φωνῆς κυρίου τοῦ θεοῦ ὑμῶν φυλάσσειν καὶ ποιεῖν πάσας τὰς ἐντολὰς αὐτοῦ ὡς ἐγὼ ἐντέλλομαι σοι σήμερον καὶ δώσει σε κύριος ὁ θεός σου ὑπεράνω πάντων τῶν ἐθνῶν τῆς γῆς
- 2 të gjitha këto bekime do të bien mbi ty dhe do të të zënë, në rast se dëgjon zërin e Zotit, Perëndisë tënd:  
And all these blessings will come on you and overtake you, if your ears are open to the voice of the Lord your God.  
καὶ ἤξουσιν ἐπὶ σὲ πᾶσαι αἱ εὐλογίαι αὐταὶ καὶ εὐρήσουσιν σε ἐὰν ἀκοῆ ἀκούσης τῆς φωνῆς κυρίου τοῦ θεοῦ σου
- 3 Do të jesh i bekuar në qytete dhe në fshatra.  
A blessing will be on you in the town, and a blessing in the field.  
εὐλογημένος σὺ ἐν πόλει καὶ εὐλογημένος σὺ ἐν ἀγρῷ
- 4 I bekuar do të jetë edhe fryti i barkut tënd, fryti i tokës dhe i bagëtisë sate, pjelljet e lopëve të tua dhe fryti i deleve të tua.  
A blessing will be on the fruit of your body, and on the fruit of your land, on the fruit of your cattle, the increase of your herd, and the young of your flock.  
εὐλογημένα τὰ ἔκγονα τῆς κοιλίας σου καὶ τὰ γενήματα τῆς γῆς σου τὰ βουκόλια τῶν βοῶν σου καὶ τὰ ποιμνία τῶν προβάτων σου
- 5 Të bekuara do të jenë shporta dhe magjja jote.  
A blessing will be on your basket and on your bread-basin.  
εὐλογημένα αἱ ἀποθήκῃ σου καὶ τὰ ἐγκαταλείμματά σου
- 6 Do të jesh i bekuar kur hyn dhe i bekuar kur del.  
A blessing will be on your coming in and on your going out.  
εὐλογημένος σὺ ἐν τῷ εἰσπορεύεσθαί σε καὶ εὐλογημένος σὺ ἐν τῷ ἐκπορεύεσθαί σε

- 7** Zoti do të veprojë në mënyrë që armiqtë e tu, që ngrihen kundër teje, të munden para teje; do të dalin kundër teje nëpër një rrugë, por do të ikin para teje nëpër shtatë rrugë.  
**By the power of the Lord, those who take arms against you will be overcome before you: they will come out against you one way, and will go in flight from you seven ways.**  
*παραδῶ κύριος ὁ θεός σου τοὺς ἐχθρούς σου τοὺς ἀνθεστηκότας σοι συντετριμμένους πρὸ προσώπου σου ὁδῶ μιᾷ ἐξελεύσονται πρὸς σὲ καὶ ἐν ἑπτὰ ὁδοῖς φεύξονται ἀπὸ προσώπου σου*
- 8** Dhe Zoti do ta urdhërojë bekimin të ndodhet mbi ty në hambaret e tua dhe mbi të gjitha ato gjëra ku ti do të vësh dorë; dhe do të bekojë në vendin që Zoti, Perëndia yt, të jep.  
**The Lord will send his blessing on your store-houses and on everything to which you put your hand: his blessing will be on you in the land which the Lord your God is giving you.**  
*ἀποστέλλει κύριος ἐπὶ σὲ τὴν εὐλογίαν ἐν τοῖς ταμειείοις σου καὶ ἐν πᾶσιν οὗ ἂν ἐπιβάλης τὴν χεῖρά σου ἐπὶ τῆς γῆς ἧς κύριος ὁ θεός σου δίδωσιν σοι*
- 9** Zoti do të të vendosë në mënyrë që të jesh për të një popull i shenjtë, ashtu si të është betuar, në qoftë se do të respektosh urdhërimet e Zotit, Perëndisë tënd, dhe do të ecësh në rrugët e tij;  
**The Lord will keep you as a people holy to himself, as he has said to you in his oath, if you keep the orders of the Lord your God and go on walking in his ways.**  
*ἀναστήσει σε κύριος ὁ θεός σου ἑαυτῷ λαὸν ἅγιον ὃν τρόπον ὤμοσεν τοῖς πατράσιν σου ἐὰν εἰσακούσῃς τῆς φωνῆς κυρίου τοῦ θεοῦ σου καὶ πορευθῆς ἐν ταῖς ὁδοῖς αὐτοῦ*
- 10** Kështu tërë popujt e dheut do të shohin që ti je i thirrur me emrin e Zotit, dhe do të kenë frikë prej teje.  
**And all the peoples of the earth will see that the name of the Lord is on you, and they will go in fear of you.**  
*καὶ ὄψονται σε πάντα τὰ ἔθνη τῆς γῆς ὅτι τὸ ὄνομα κυρίου ἐπικέκληται σοι καὶ φοβηθήσονται σε*
- 11** Zoti, Perëndia yt, do të të mbushë me të mira, me frytin e barkut tënd, me frytin e bagëtisë sate dhe me frytin e tokës sate në vendin që Zoti u betua t'u japë etërve të tu.  
**And the Lord will make you fertile in every good thing, in the fruit of your body, and the fruit of your cattle, and the fruit of your fields, in the land which the Lord, by his oath to your fathers, said he would give you.**  
*καὶ πληθυνεῖ σε κύριος ὁ θεός σου εἰς ἀγαθὰ ἐπὶ τοῖς ἐκγόνοις τῆς κοιλίας σου καὶ ἐπὶ τοῖς γενήμασιν τῆς γῆς σου καὶ ἐπὶ τοῖς ἐκγόνοις τῶν κτηνῶν σου ἐπὶ τῆς γῆς ἧς ὤμοσεν κύριος τοῖς πατράσιν σου δοῦναί σοι*
- 12** Zoti do të hapë për ty qiellin, thesarin e tij të mirë, për t'i dhënë tokës sate shiun në kohën e duhur dhe për të bekuar veprën e duarve të tua; ti do t'u japësh hua shumë kombeve, por nuk do të marrësh asgjë hua.  
**Opening his store-house in heaven, the Lord will send rain on your land at the right time, blessing all the work of your hands: other nations will make use of your wealth, and you will have no need of theirs.**  
*ἀνοίξει σοι κύριος τὸν θησαυρὸν αὐτοῦ τὸν ἀγαθὸν τὸν οὐρανῶν δοῦναι τὸν υἱὸν τῆ γῆ σου ἐπὶ καιροῦ αὐτοῦ εὐλογῆσαι πάντα τὰ ἔργα τῶν χειρῶν σου καὶ δανιεῖς ἔθνεσιν πολλοῖς σὺ δὲ οὐ δανιῆ καὶ ἄρξεις σὺ ἔθνῶν πολλῶν σοῦ δὲ οὐκ ἄρξουσιν*
- 13** Zoti do të bëjë që të jesh koka dhe jo bishti, dhe do të jesh gjithnjë lart dhe kurrë poshtë, në rast se u bindesh urdhërimeve të Zotit, Perëndisë tënd, që sot të urdhëron t'i respektosh dhe t'i zbatosh në praktikë.  
**The Lord will make you the head and not the tail; and you will ever have the highest place, if you give ear to the orders of the Lord your God which I give you today, to keep and to do them;**  
*καταστήσει σε κύριος ὁ θεός σου εἰς κεφαλὴν καὶ μὴ εἰς οὐρὰν καὶ ἔση τότε ἐπάνω καὶ οὐκ ἔση ὑποκάτω ἐὰν ἀκούσῃς τῶν ἐντολῶν κυρίου τοῦ θεοῦ σου ὅσα ἐγὼ ἐντέλλομαι σοι σήμερον φυλάσσειν καὶ ποιεῖν*
- 14** Kështu nuk do të shmangesh as djathtas, as majtas nga asnjë prej fjalëve që sot ju urdhëroj, për të shkuar pas perëndive të tjera dhe për t'u shërbyer atyre.  
**Not turning away from any of the orders which I give you today, to the right hand or to the left, or going after any other gods to give them worship.**  
*οὐ παραβῆση ἀπὸ πάντων τῶν λόγων ὧν ἐγὼ ἐντέλλομαι σοι σήμερον δεξιὰ οὐδὲ ἀριστερὰ πορεύεσθαι ὀπίσω θεῶν ἐτέρων λατρεύειν αὐτοῖς*
- 15** Por në rast se nuk i bindesh zërit të Zotit, Perëndisë tënd, për të respektuar me kujdes të gjitha urdhërimet dhe të gjitha statutet e tij që sot të urdhëroj, do të ndodhë që të gjitha këto mallkime do të bien mbi ty dhe do të të gjejnë.  
**But if you do not give ear to the voice of the Lord your God, and take care to do all his orders and his laws which I give you today, then all these curses will come on you and overtake you:**  
*καὶ ἔσται ἐὰν μὴ εἰσακούσῃς τῆς φωνῆς κυρίου τοῦ θεοῦ σου φυλάσσειν καὶ ποιεῖν πάσας τὰς ἐντολὰς αὐτοῦ ὅσας ἐγὼ ἐντέλλομαι σοι σήμερον καὶ ἐλεύσονται ἐπὶ σὲ πᾶσαι αἱ κατάραι αὐταὶ καὶ καταλήμψονται σε*
- 16** Do të jesh i mallkuar në qytet dhe do të jesh i mallkuar në fshat.  
**You will be cursed in the town and cursed in the field.**  
*ἐπικατάρατος σὺ ἐν πόλει καὶ ἐπικατάρατος σὺ ἐν ἀγρῷ*
- 17** Të mallkuara do të jenë shporta jote dhe magjia jote.  
**A curse will be on your basket and on your bread-basin.**  
*ἐπικατάρατοι αἱ ἀποθήκαι σου καὶ τὰ ἐγκαταλείμματά σου*
- 18** I mallkuar do të jetë fryti i barkut tënd, fryti i tokës sate, pjelljet e lopëve të tua dhe fryti i deleve të tua.  
**A curse will be on the fruit of your body, and on the fruit of your land, on the increase of your cattle, and the young of your flock.**  
*ἐπικατάρατα τὰ ἔκγονα τῆς κοιλίας σου καὶ τὰ γενήματα τῆς γῆς σου τὰ βουκόλια τῶν βοῶν σου καὶ τὰ ποίμνια τῶν προβάτων σου*

- 19 Do të jesh i mallkuar kur hyn dhe i mallkuar kur del.  
 You will be cursed when you come in and cursed when you go out.  
 επικατάρατος σὺ ἐν τῷ ἐκπορεύεσθαί σε καὶ επικατάρατος σὺ ἐν τῷ εἰσπορεύεσθαί σε
- 20 Zoti do të dërgojë kundër teje mallkimin, rrëmujën dhe mosmiratimin për çdo gjë mbi të cilën do të vësh dorë dhe që do të bësh, deri sa ti të shkatërrohesh dhe të vdesësh shpejt, për shkak të ligësisë së veprimeve të tua në të cilat më ke braktisur.  
 The Lord will send on you cursing and trouble and punishment in everything to which you put your hand, till sudden destruction overtakes you; because of your evil ways in which you have been false to me.  
 ἔξαποστεῖλαι κύριος σοὶ τὴν ἔνδειαν καὶ τὴν ἐκλιμίαν καὶ τὴν ἀνάλωσιν ἐπὶ πάντα οὗ ἂν ἐπιβάλῃς τὴν χεῖρά σου ὅσα ἐὰν ποιήσῃς ἕως ἂν ἐξολεθρεύῃ σε καὶ ἕως ἂν ἀπολέσῃ σε ἐν τάχει διὰ τὰ πονηρὰ ἐπιτηδεύματά σου διότι ἐγκατέλιπές με
- 21 Zoti do të bëjë që të të zërë murtaja, deri sa të konsumohesh prej saj në vendin ku je duke hyrë për ta pushtuar.  
 The Lord will send disease after disease on you, till you have been cut off by death from the land to which you are going.  
 προσκολλησά σου κύριος εἰς σέ τὸν θάνατον ἕως ἂν ἐξανλώσῃ σε ἀπὸ τῆς γῆς εἰς ἣν σὺ εἰσπορεύῃ ἐκεῖ κληρονομήσαι αὐτήν
- 22 Zoti do të godasë me ligështim, me ethe, me mahisje, me vapë djegëse, me shpatë, me plasje dhe vrug, që do të ndjekin deri në shkatërrimin tënd.  
 The Lord will send wasting disease, and burning pain, and flaming heat against you, keeping back the rain till your land is waste and dead; so will it be till your destruction is complete.  
 πατάξει σε κύριος ἀπορία καὶ πυρετῶ καὶ ῥίγει καὶ ἐρεθισμῶ καὶ φόνῳ καὶ ἀνεμοφοθρία καὶ τῆ ὄχρα καὶ καταδιώξονται σε ἕως ἂν ἀπολέσωσιν σε
- 23 Qielli mbi kokën tënde do të jetë prej bakri dhe toka poshtë teje do të jetë prej hekuri.  
 And the heaven over your heads will be brass, and the earth under you hard as iron.  
 καὶ ἔσται σοὶ ὁ οὐρανὸς ὁ ὑπὲρ κεφαλῆς σου χαλκοῦς καὶ ἡ γῆ ἡ ὑποκάτω σου σιδηρᾶ
- 24 Zoti do ta kthejë shiun e vendit tënd në rërë dhe pluhur, që do të bien mbi ty deri sa të shkatërrohesh.  
 The Lord will make the rain of your land powder and dust, sending it down on you from heaven till your destruction is complete.  
 δόψῃ κύριος τὸν ὑετὸν τῆ γῆ σου κονιορτόν καὶ χοῦς ἐκ τοῦ οὐρανοῦ καταβήσεται ἐπὶ σέ ἕως ἂν ἐκτρίψῃ σε καὶ ἕως ἂν ἀπολέσῃ σε
- 25 Zoti do të të braktisë në disfatë dhe në masakër para armiqve të tu; do të dalësh kundër tyre nga një rrugë dhe do të largohesh prej tyre duke ua mbathur nëpër shtatë rrugë; dhe kështu do të bëhesh një objekt urrejtjeje nga ana e të gjitha mbretërive të dheut.  
 The Lord will let you be overcome by your haters: you will go out against them one way, and you will go in flight before them seven ways: you will be the cause of fear among all the kingdoms of the earth.  
 δόψῃ σε κύριος ἐπικοπήν ἐναντίον τῶν ἐχθρῶν σου ἐν ὁδῷ μὴ ἐξελεύσῃ πρὸς αὐτοὺς καὶ ἐν ἐπτὰ ὁδοῖς φεύξῃ ἀπὸ προσώπου αὐτῶν καὶ ἔσῃ ἐν διασπορᾷ ἐν πάσαις ταῖς βασιλείαις τῆς γῆς
- 26 Kufomat e tua do t'u shërbejnë si ushqim tërë zogjve të qiellit dhe kafshëve të tokës, dhe askush nuk ka për t'i përzënë.  
 Your bodies will be meat for all the birds of the air and the beasts of the earth; there will be no one to send them away.  
 καὶ ἔσονται οἱ νεκροὶ ὑμῶν κατὰβρωμα τοῖς πετεινοῖς τοῦ οὐρανοῦ καὶ τοῖς θηρίοις τῆς γῆς καὶ οὐκ ἔσται ὁ ἀποσοβῶν
- 27 Zoti do të të godasë me ulcerën e Egjiptit, me hemorroidet, me zgjeben dhe me qerren, sëmundje nga të cilat nuk do të mund të shërohesh.  
 The Lord will send on you the disease of Egypt, and other sorts of skin diseases which nothing will make well.  
 πατάξει σε κύριος ἐν ἔλκει αἰγυπτίῳ ἐν ταῖς ἔδραις καὶ ψόρα ἀγρία καὶ κνήφῃ ὥστε μὴ δύνασθαι σε ἰαθῆναι
- 28 Zoti do të të godasë me marrëzinë, me verbërinë dhe me shushatjen e zemrës;  
 He will make your minds diseased, and your eyes blind, and your hearts wasted with fear:  
 πατάξει σε κύριος παραπληξία καὶ ἀρασία καὶ ἐκστάσει διανοίας
- 29 dhe do të ecësh me tahmin në mes të ditës, ashtu si ecën i verbëri në errësirë; nuk do të kesh mbarësi në rrugët e tua, por do të jesh vetëm i shtypur dhe i zhveshur vazhdimisht pa pasur ndihmën e askujt.  
 You will go feeling your way when the sun is high, like a blind man for whom all is dark, and nothing will go well for you: you will be crushed and made poor for ever, and you will have no saviour.  
 καὶ ἔσῃ ψηλαφῶν μεσημβρίας ὥσει ψηλαφήσαι ὁ τυφλὸς ἐν τῷ σκότει καὶ οὐκ εὐδοώσει τὰς ὁδοὺς σου καὶ ἔσῃ τότε ἀδικούμενος καὶ διαρπαζόμενος πάσας τὰς ἡμέρας καὶ οὐκ ἔσται σοὶ ὁ βοηθῶν
- 30 Do të fejojesh me një femër, por një burrë tjetër do të bjerë në shtrat me të; do të ndërtohet një shtëpi, por nuk do të banosh në të; do të mbjellësh një vresht, por nuk do të mbledhësh rrushin e tij.  
 You will take a wife, but another man will have the use of her: the house which your hands have made will never be your resting-place: you will make a vine-garden, and never take the fruit of it.  
 γυναῖκα λήμψῃ καὶ ἄνῃρ ἕτερος ἔξει αὐτήν οἰκίαν οἰκοδομήσεις καὶ οὐκ οἰκήσεις ἐν αὐτῇ ἀμπελῶνα φυτεύσεις καὶ οὐ τρυγήσεις αὐτόν

- 31 **Kau yt do të vritet para syve të tu, por ti nuk do të hash mishin e tij; gomarin tënd do të ta marrin në praninë tënde dhe nuk do të ta kthejnë; delet e tua do t'ua japin armiqve të tu dhe askush nuk do të të ndihmojë.**  
**Your ox will be put to death before your eyes, but its flesh will not be your food: your ass will be violently taken away before your face, and will not be given back to you: your sheep will be given to your haters, and there will be no saviour for you.**  
*ὁ μόσχος σου ἐσφαγμένος ἐναντίον σου καὶ οὐ φάγη ἐξ αὐτοῦ ὁ ὄνος σου ἠρπασμένος ἀπὸ σοῦ καὶ οὐκ ἀποδοθήσεται σοὶ τὰ πρόβατά σου δεδομένα τοῖς ἐχθροῖς σου καὶ οὐκ ἔσται σοὶ ὁ βοηθὸν*
- 32 **Bijtë e tu dhe bijat e tua do t'i jepen një populli tjetër; sytë e tu do të shikojnë dhe do të përgjeronen tërë ditën nga dëshira për t'i parë, dhe dora jote do të jetë pa fuqi.**  
**Your sons and your daughters will be given to another people, and your eyes will be wasted away with looking and weeping for them all the day: and you will have no power to do anything.**  
*οἱ υἱοὶ σου καὶ αἱ θυγατέρες σου δεδομένα ἔθνη ἐτέρω καὶ οἱ ὀφθαλμοὶ σου βλέψονται σφακελίζοντες εἰς αὐτά καὶ οὐκ ἰσχύσει ἡ χεὶρ σου*
- 33 **Një popull që ti nuk e ke njohur, do të hajë frytin e tokës sate dhe të gjithë mundit tënd, dhe pa tjetër do të jesh i shtypur dhe i dërmuar vazhdimisht.**  
**The fruit of your land and all the work of your hands will be food for a nation which is strange to you and to your fathers; you will only be crushed down and kept under for ever:**  
*τὰ ἐκφόρια τῆς γῆς σου καὶ πάντας τοὺς πόνοους σου φάγεται ἔθνος ὃ οὐκ ἐπίστασαι καὶ ἔση ἀδικούμενος καὶ τεθραυσμένος πάσας τὰς ἡμέρας*
- 34 **Do të çmëndesh para pamjes që do të shohin sytë e tu.**  
**So that the things which your eyes have to see will send you out of your minds.**  
*καὶ ἔση παράπληκτος διὰ τὰ ὀράματα τῶν ὀφθαλμῶν σου ἃ βλέψη*
- 35 **Zoti do të të godasë në gjunjët dhe në kofshët me një ulcer të keqe, nga e cila nuk do të mund të shërohesh, nga tabani i këmbëve deri në majë të kokës.**  
**The Lord will send a skin disease, attacking your knees and your legs, bursting out from your feet to the top of your head, so that nothing will make you well.**  
*πατάξει σε κύριος ἐν ἔλκει πονηρῷ ἐπὶ τὰ γόνατα καὶ ἐπὶ τὰς κνήμας ὥστε μὴ δύνασθαι σε ἰαθῆναι ἀπὸ ἴχνους τῶν ποδῶν σου ἕως τῆς κορυφῆς σου*
- 36 **Zoti do të të çojë ty dhe mbretin tënd, që e ke vënë mbi ty, në një komb që as ti, as etërit e tu, nuk e keni njohur; dhe atje do t'u shërbeni perëndive të tjera prej druri dhe prej guri;**  
**And you, and the king whom you have put over you, will the Lord take away to a nation strange to you and to your fathers; there you will be servants to other gods of wood and stone.**  
*ἀπαγάγοι κύριος σε καὶ τοὺς ἄρχοντας σου οὓς ἐὰν καταστήσῃς ἐπὶ σεαυτὸν εἰς ἔθνος ὃ οὐκ ἐπίστασαι σὺ καὶ οἱ πατέρες σου καὶ λατρεύσεις ἐκεῖ θεοὺς ἐτέροις ξύλοις καὶ λίθοις*
- 37 **dhe do të bëhesh objekt habie, proverbi dhe talljeje në mes tërë popujve pranë të cilëve do të të çojë Zoti.**  
**And you will become a wonder and a name of shame among all the nations where the Lord will take you.**  
*καὶ ἔση ἐκεῖ ἐν αἰνίγματι καὶ παραβολῇ καὶ διηγήματι ἐν πᾶσιν τοῖς ἔθνεσιν εἰς οὓς ἂν ἀπαγάγῃ σε κύριος ἐκεῖ*
- 38 **Do të çosh shumë farë në arë por do të korrësh pak, sepse karkaleci do ta gllabërojë.**  
**You will take much seed out into the field, and get little in; for the locust will get it.**  
*σπέρμα πολλὸ ἐξοίσεις εἰς τὸ πεδῖον καὶ ὀλίγα εἰσοίσεις ὅτι κατέδεται αὐτὰ ἡ ἀκρίς*
- 39 **Do të mbjellësh vreshta, do t'i punosh, por nuk do të pish verë as do të mbledhësh rrush, sepse krimbi do t'i hajë.**  
**You will put in vines and take care of them, but you will get no wine or grapes from them; for they will be food for worms.**  
*ἀμπελῶνα φυτεύσεις καὶ κατεργᾷ καὶ οἶνον οὐ πίσεις οὐδὲ εὐφρανθήσῃ ἐξ αὐτοῦ ὅτι καταφάγεται αὐτὰ ὁ σκόληξ*
- 40 **Do të kesh ullinj në të gjithë territorin tënd, por nuk do të lyesh me vaj, sepse ullinjtë e tu do të bien.**  
**Your land will be full of olive-trees, but there will be no oil for the comfort of your body; for your olive-tree will give no fruit.**  
*ἐλαῖαι ἔσονται σοὶ ἐν πᾶσι τοῖς ὀρίοις σου καὶ ἔλαιον οὐ χρίση ὅτι ἐκρυσταίνεται ἡ ἐλαία σου*
- 41 **Do të të lindin bij dhe bija, por nuk do të jenë të tutë, sepse do të shkojnë në skllavëri.**  
**You will have sons and daughters, but they will not be yours; for they will go away prisoners into a strange land.**  
*υἱοὺς καὶ θυγατέρας γεννήσεις καὶ οὐκ ἔσονται σοὶ ἀπελεύσονται γὰρ ἐν αἰχμαλωσίᾳ*
- 42 **Tërë pemët e tua dhe frytet e tokës sate do të jenë pre nga karkalecit.**  
**All your trees and the fruit of your land will be the locust's.**  
*πάντα τὰ ξύλινά σου καὶ τὰ γενήματα τῆς γῆς σου ἐξαναλώσει ἡ ἐρυσίβη*
- 43 **I huaji që ndodhet në mes teje do të ngrihet gjithnjë e më lart mbi ty dhe ti do të biesh gjithnjë e më poshtë.**  
**The man from a strange land who is living among you will be lifted up higher and higher over you, while you go down lower and lower.**  
*ὁ προσήλυτος ὃς ἔστιν ἐν σοὶ ἀναβήσεται ἐπὶ σὲ ἄνω ἄνω σὺ δὲ καταβήσῃ κάτω κάτω*

- 44 Ai do të të japë hua, por ti nuk do t'i japësh hua atij; ai do të jetë koka dhe ti bishti.  
He will let you have his wealth at interest, and will have no need of yours: he will be the head and you the tail.  
οὗτος δανιεῖ σοι σὺ δὲ τούτῳ οὐ δανιεῖς οὗτος ἔσται κεφαλὴ σὺ δὲ ἔση οὐρά
- 45 Të gjitha këto mallkime do të bien mbi ty, do të të ndjekin dhe do të të zënë deri sa të shkatërrohesh, sepse nuk iu binde zërit të Zotit, Perëndisë tënd, duke respektuar urdhërimet dhe statutet që ai të ka urdhëruar.  
And all these curses will come after you and overtake you, till your destruction is complete; because you did not give ear to the voice of the Lord your God, or keep his laws and his orders which he gave you:  
καὶ ἐλεύσονται ἐπὶ σὲ πᾶσαι αἱ κατάραι αὐταὶ καὶ καταδιώξονται σε καὶ καταλήμψονται σε ἕως ἂν ἐξολεθρεύῃ σε καὶ ἕως ἂν ἀπολέσῃ σε ὅτι οὐκ εἰσήκουσας τῆς φωνῆς κυρίου τοῦ θεοῦ σου φυλάξα ἰ τὰς ἐντολὰς αὐτοῦ καὶ τὰ δικαιώματα αὐτοῦ ὅσα ἐνετειλάτο σοι
- 46 Ato do të jenë si një shenjë dhe si një mrekulli për ty dhe pasardhësit e tu, për gjithnjë.  
These things will come on you and on your seed, to be a sign and a wonder for ever;  
καὶ ἔσται ἐν σοὶ σημεῖα καὶ τέρατα καὶ ἐν τῷ σπέρματί σου ἕως τοῦ αἵωνος
- 47 Sepse nuk i ke shërbyer Zotit, Perëndisë tënd, me gëzim dhe hare në zemër për bollëkun në çdo gjë,  
Because you did not give honour to the Lord your God, worshipping him gladly, with joy in your hearts on account of all your wealth of good things;  
ἀνθ' ὃν οὐκ ἐλάτρευσας κυρίῳ τῷ θεῷ σου ἐν εὐφροσύνῃ καὶ ἀγαθῇ καρδίᾳ διὰ τὸ πλῆθος πάντων
- 48 do t'u shërbesh armiqve të tu që Zoti do të dërgojë kundr teje, në një gjendje uri, etjeje, lakuriqësie dhe mungese të çdo gjëje; dhe ai do të vërë një zgjedhë të hekurt rreth qafës sate deri sa të të shkatërrojë.  
For this cause you will become servants to those whom the Lord your God will send against you, without food and drink and clothing, and in need of all things: and he will put a yoke of iron on your neck till he has put an end to you.  
καὶ λατρεύσεις τοῖς ἐχθροῖς σου οὐδὲ ἐπαποστελεῖ κύριος ἐπὶ σὲ ἐν λιμῷ καὶ ἐν δίψει καὶ ἐν γυμνότητι καὶ ἐν ἐκλείψει πάντων καὶ ἐπιθήσει κλοιὸν σιδηροῦν ἐπὶ τὸν τράχηλόν σου ἕως ἂν ἐξολεθρεύῃ σε
- 49 Zoti do të sjellë kundër teje nga larg, nga skajet e dheut, një komb të shpejtë, si shqiponja që fluturon, një komb gjuhën e të cilit ti nuk do ta kuptosh,  
The Lord will send a nation against you from the farthest ends of the earth, coming with the flight of an eagle; a nation whose language is strange to you;  
ἐπάξει κύριος ἐπὶ σὲ ἔθνος μακρόθεν ἀπ' ἐσχάτου τῆς γῆς ὅσμι ὄρμημα ἀετοῦ ἔθνος ὃ οὐκ ἀκούσῃ τῆς φωνῆς αὐτοῦ
- 50 një komb me një pamje të egër që nuk do të respektojë plakun dhe nuk do të ketë mëshirë për të voglin,  
A hard-faced nation, who will have no respect for the old or mercy for the young:  
ἔθνος ἀναιδὲς προσώπῳ ὅστις οὐ θαυμάσει πρόσωπον πρεσβύτου καὶ νέον οὐκ ἐλεήσει
- 51 dhe do të hajë frytin e bagëtisë sate dhe prodhimin e tokës sate, deri sa të shkatërrohesh; dhe nuk do të lërë as grurë, as musht, as vaj as pjelljet e lopëve të tua ose pjelljet e deleve të tua, deri sa të të ketë shkatërruar.  
He will take the fruit of your cattle and of your land till death puts an end to you: he will let you have nothing of your grain or wine or oil or any of the increase of your cattle or the young of your flock, till he has made your destruction complete.  
καὶ κατέδεται τὰ ἔκγονα τῶν κτηνῶν σου καὶ τὰ γενήματα τῆς γῆς σου ὥστε μὴ καταλιπεῖν σοι σίτον οἶνον ἔλαιον τὰ βουκόλια τῶν βοῶν σου καὶ τὰ ποιμνια τῶν προβάτων σου ἕως ἂν ἀπολέσῃ σε
- 52 Dhe do të rrethojë në të gjitha qytetet e tua, deri sa të rrezohen në të gjithë vendin muret e larta dhe të fortifikuara te të cilat kishte besim. Do të të rrethojë në të gjitha qytetet e tua, në të gjithë vendin që Zoti, Perëndia yt, të ka dhënë.  
Your towns will be shut in by his armies, till your high walls, in which you put your faith, have come down: his armies will be round your towns, through all your land which the Lord your God has given you.  
καὶ ἐκτρίψῃ σε ἐν πάσαις ταῖς πόλεσίν σου ἕως ἂν καθαιρεθῶσιν τὰ τείχη σου τὰ ὑψηλὰ καὶ τὰ ὀχυρά ἐφ' οἷς σὺ πέποιθας ἐπ' αὐτοῖς ἐν πάσῃ τῇ γῇ σου καὶ θλίψει σε ἐν πάσαις ταῖς πόλεσίν σου αἷς ἔδ ωκέν σοι κύριος ὁ θεός σου
- 53 Përveç kësaj gjatë rrethimit dhe në fatkeqësinë në të cilën do të të katandisë armiku yt, do të hash frytin e barkut tënd, mishin e bijve dhe të bijave të tua, që Zoti, Perëndia yt, të ka dhënë.  
And your food will be the fruit of your body, the flesh of the sons and daughters which the Lord your God has given you; because of your bitter need and the cruel grip of your haters.  
καὶ φάγη τὰ ἔκγονα τῆς κοιλίας σου κρέα υἱῶν σου καὶ θυγατέρων σου ὅσα ἔδωκέν σοι κύριος ὁ θεός σου ἐν τῇ στενοχωρίᾳ σου καὶ ἐν τῇ θλίψει σου ἢ θλίψει σε ὁ ἐχθρός σου
- 54 Njeriu më zemërbutë dhe më delikat do të ketë një zemër kaq keqdashëse ndaj vëllait të tij, ndaj gruas që pushon mbi kraharorin e tij e ndaj fëmijëve që ka akoma,  
That man among you who is soft and used to comfort will be hard and cruel to his brother, and to his dear wife, and to of those his children who are still living;  
ὁ ἀπαλὸς ἐν σοὶ καὶ ὁ τρυφερὸς σφόδρα βασκανεῖ τῷ ὀφθαλμῷ τὸν ἀδελφὸν καὶ τὴν γυναῖκα τὴν ἐν τῷ κόλπῳ αὐτοῦ καὶ τὰ καταλειμμένα τέκνα ἂν καταλειφθῇ

- 55 sa të mos i japë asnjë prej tyre mishin e bijve të tij, që ai do të hajë për vete, sepse nuk do t'i mbetet asgjë gjatë rrethimit dhe në mjerimin në të cilin do ta katandisin armiqtë e tu në të gjitha qytetet e tua.  
**And will not give to any of them the flesh of his children which will be his food because he has no other; in the cruel grip of your haters on all your towns.**  
 ὥστε δοῦναι ἐνὶ αὐτῶν ἀπὸ τῶν σαρκῶν τῶν τέκνων αὐτοῦ ὃν ἂν κατέσθῃ διὰ τὸ μὴ καταλειφθῆναι αὐτῶ μὴ ἐν τῇ στενοχωρίᾳ σου καὶ ἐν τῇ θλίψει σου ἧ ἂν θλίψωσιν σε οἱ ἐχθροί σου ἐν πάσαις ταῖς πόλεσίν σου
- 56 Gruaja më zemërbutë dhe delikate midis jush, që për delikatesën dhe elegancën e saj do të kishte guxuar të vendoste tabanin e këmbës në tokë, do të ketë një zemër keqbërëse ndaj burrit që pushon mbi gjirin e saj, ndaj djalit dhe vajzës së saj,  
**The most soft and delicate of your women, who would not so much as put her foot on the earth, so delicate is she, will be hard-hearted to her husband and to her son and to her daughter;**  
 καὶ ἡ ἀπαλὴ ἐν ὑμῖν καὶ ἡ τρυφερὰ σφόδρα ἧς οὐχὶ πείραν ἔλαβεν ὁ ποὺς αὐτῆς βαίνειν ἐπὶ τῆς γῆς διὰ τὴν τρυφερότητα καὶ διὰ τὴν ἀπαλότητα βασκανεῖ τῷ ὀφθαλμῷ αὐτῆς τὸν ἄνδρα αὐτῆς τὸν ἐν τῷ κόλπῳ αὐτῆς καὶ τὸν υἱὸν καὶ τὴν θυγατέρα αὐτῆς
- 57 ndaj placentës që del nga barku i saj dhe ndaj fëmijëve që lind, sepse ajo do t'i hajë fshehurazi, për shkak se çdo gjë mungon gjatë rrethimit dhe për shkak të mjerimit të madh që do të pësosh nga armiqtë e tu në të gjitha qytetet e tua.  
**And to her baby newly come to birth, and to the children of her body; for having no other food, she will make a meal of them secretly, because of her bitter need and the cruel grip of your haters on all your towns.**  
 καὶ τὸ χόριον αὐτῆς τὸ ἐξελθὸν διὰ τῶν μηρῶν αὐτῆς καὶ τὸ τέκνον ὃ ἂν τέκη καταφάγεται γὰρ αὐτὰ διὰ τὴν ἔνδειαν πάντων κρυφῇ ἐν τῇ στενοχωρίᾳ σου καὶ ἐν τῇ θλίψει σου ἧ θλίψει σε ὁ ἐχθρός σου ἐν πάσαις ταῖς πόλεσίν σου
- 58 Po të mos kesh kujdes të zbatosh në praktikë të gjitha fjalët e këtij ligji, që janë shkruar në këtë libër, duke pasur frikë nga ky emër i lavdishëm dhe i tmerrshëm, Zoti, Perëndia yt,  
**If you will not take care to do all the words of this law, recorded in this book, honouring that name of glory and of fear, THE LORD YOUR GOD;**  
 ἐὰν μὴ εἰσακούσητε ποιεῖν πάντα τὰ ῥήματα τοῦ νόμου τούτου τὰ γεγραμμένα ἐν τῷ βιβλίῳ τούτῳ φοβεῖσθαι τὸ ὄνομα τὸ ἔντιμον καὶ τὸ θαυμαστὸν τοῦτο κύριον τὸν θεόν σου
- 59 atëherë Zoti do të lëshojë mbi ty dhe mbi pasardhësit e tu mjerime të papërshkrueshme, të mëdha dhe të zgjatura, si dhe sëmundje të këqija dhe të qëndrueshme;  
**Then the Lord your God will make your punishment, and the punishment of your seed, a thing to be wondered at; great punishments and cruel diseases stretching on through long years.**  
 καὶ παραδοξάσει κύριος τὰς πληγὰς σου καὶ τὰς πληγὰς τοῦ σπέρματός σου πληγὰς μεγάλας καὶ θαυμαστάς καὶ νόσους πονηρὰς καὶ πιστὰς
- 60 përveç kësaj do të kthejë mbi ty të gjitha sëmundjet e Egjiptit, nga të cilat kishe frikë, dhe ato do të të ngjiten.  
**He will send on you again all the diseases of Egypt, which were a cause of fear to you, and they will take you in their grip.**  
 καὶ ἐπιστρέψει ἐπὶ σέ πᾶσαν τὴν ὀδύνην αἰγύπτου τὴν πονηρὰν ἣν διευλαβοῦ ἀπὸ προσώπου αὐτῶν καὶ κολληθήσονται ἐν σοί
- 61 Edhe të gjitha sëmundjet dhe tërë fatkeqësitë e pashkruara në librin e këtij ligji, Zoti do t'i sjellë mbi ty, deri sa të shkatërrosh.  
**And all the diseases and the pains not recorded in the book of this law will the Lord send on you till your destruction is complete.**  
 καὶ πᾶσαν μαλακίαν καὶ πᾶσαν πληγὴν τὴν μὴ γεγραμμένην ἐν τῷ βιβλίῳ τοῦ νόμου τούτου ἐπάξει κύριος ἐπὶ σέ ἕως ἂν ἐξολεθρεύῃ σε
- 62 Kështu do të mbeten pak, mbasi keni qenë shumë si yjet e qiellit, sepse nuk i je bindur zërit të Zotit, Perëndisë tënd.  
**And you will become a very small band, though your numbers were like the stars of heaven; because you did not give ear to the voice of the Lord your God.**  
 καὶ καταλειφθήσεσθε ἐν ἀριθμῷ βραχέϊ ἀνθ' ὧν ὅτι ἤτε ὡσεὶ τὰ ἄστρα τοῦ οὐρανοῦ τῷ πληθει ὅτι οὐκ εἰσηκούσατε τῆς φωνῆς κυρίου τοῦ θεοῦ ὑμῶν
- 63 Dhe do të ndodhë që, ashtu si Zoti ndjente kënaqësi t'ju bënte të mirë dhe t'ju shumëzonte, po kështu Zoti do të ndjejë kënaqësi duke ju zhdukur dhe shkatërruar; dhe do t'ju rrëmbejnë nga vendi ku po hyni për ta pushtuar.  
**And as the Lord took delight in doing you good and increasing you, so the Lord will take pleasure in cutting you off and causing your destruction, and you will be uprooted from the land which you are about to take as your heritage.**  
 καὶ ἔσται ὃν τρόπον εὐφράνθη κύριος ἐφ' ὑμῖν εὖ ποιῆσαι ὑμᾶς καὶ πληθῦναι ὑμᾶς οὕτως εὐφρανθήσεται κύριος ἐφ' ὑμῖν ἐξολεθρεῦσαι ὑμᾶς καὶ ἐξαρθήσεσθε ἀπὸ τῆς γῆς εἰς ἣν ὑμεῖς εἰσπορεύεσθε ἐκεῖ κληρονομήσαι αὐτήν
- 64 Zoti do të shpërndajë midis tërë popujve, nga njeri skaj i tokës në tjetrin; dhe atje ti do t'u shërbesh perëndive të tjera, që as ti as etërit e tu nuk i keni njohur kurrë, perëndi prej druri dhe prej guri.  
**And the Lord will send you wandering among all peoples, from one end of the earth to the other: there you will be servants to other gods, of wood and stone, gods of which you and your fathers had no knowledge.**  
 καὶ διασπερεῖ σε κύριος ὁ θεός σου εἰς πάντα τὰ ἔθνη ἀπ' ἄκρου τῆς γῆς ἕως ἄκρου τῆς γῆς καὶ δουλεύσεις ἐκεῖ θεοῖς ἑτέροις ξύλοις καὶ λίθοις οὓς οὐκ ἠπίστω σὺ καὶ οἱ πατέρες σου
- 65 Dhe midis atyre kombeve nuk do të gesh prehje dhe vend ku të pushojnë tabanët e këmbëve të tua; aty Zoti do të të japë një zemër të drithëruar, sy përgjërues dhe ankth në shpirt.  
**And even among these nations there will be no peace for you, and no rest for your feet: but the Lord will give you there a shaking heart and wasting eyes and weariness of soul:**  
 ἀλλὰ καὶ ἐν τοῖς ἔθνεσιν ἐκείνοις οὐκ ἀναπαύσει σε οὐδ' οὐ μὴ γένηται στάσις τῷ ἴγνει τοῦ ποδός σου καὶ δώσει σοι κύριος ἐκεῖ καρδίαν ἀθυμοῦσαν καὶ ἐκλείποντας ὀφθαλμοὺς καὶ τηκομένην ψυχὴν



- 66 Jeta jote do të qëndrojë përpara pezull në pasiguri; do të dridhesh natën dhe ditën dhe nuk do të kesh asnjë siguri për qenien tënde.  
Your very life will be hanging in doubt before you, and day and night will be dark with fears, and nothing in life will be certain:  
καὶ ἔσται ἡ ζωὴ σου κρεμασμένη ἀπέναντι τῶν ὀφθαλμῶν σου καὶ φοβηθήσῃ ἡμέρας καὶ νυκτὸς καὶ οὐ πιστεύσεις τῇ ζωῇ σου
- 67 Në mëngjes do të thuash: &quot;Ah, të ishte mbrëmje!&quot;, dhe në mbrëmje do të thuash: &quot;Ah, të ishte mëngjes!&quot;, për shkak të llahtarës që do të mbushë zemrën tënde dhe të pamjes që do të shohin sytë e tu.  
In the morning you will say, If only it was evening! And at evening you will say, If only morning would come! Because of the fear in your hearts and the things which your eyes will see.  
τὸ πρωὶ ἔρεις πῶς ἂν γένοιτο ἑσπέρα καὶ τὸ ἑσπέρας ἔρεις πῶς ἂν γένοιτο πρωὶ ἀπὸ τοῦ φόβου τῆς καρδίας σου ἃ φοβηθήσῃ καὶ ἀπὸ τῶν ὀραμάτων τῶν ὀφθαλμῶν σου ὧν ὄψῃ
- 68 Dhe Zoti do të të kthejë në Egjipt me anije, nëpër rrugën që të pata thënë: &quot;Nuk do ta shohësh më kurrë!&quot;. Dhe aty do t'ju ofrojnë armiqve tuaj për t'ju shitur si skllavër dhe si skllave, por askush nuk do t'ju blejë&quot;.  
And the Lord will take you back to Egypt again in ships, by the way of which I said to you, You will never see it again: there you will be offering yourselves as men-servants and women-servants to your haters for a price, and no man will take you.  
καὶ ἀποστρέψει σε κύριος εἰς αἴγυπτον ἐν πλοίοις καὶ ἐν τῇ ὁδῷ ἣ εἶπα οὐ προσθήσῃσθε ἔτι ἰδεῖν αὐτήν καὶ πρῆθήσῃσθε ἐκεῖ τοῖς ἐχθροῖς ὑμῶν εἰς παῖδας καὶ παιδίσκας καὶ οὐκ ἔσται ὁ κτόμενος
- 1 Këto janë fjalët e besëlidhjes që Zoti i urdhëroi Moisiut të përfundonte me bijtë e Izraelit në vendin e Moabit, përveç besëlidhjes që kishte bërë me ta në malin Horeb.  
These are the words of the agreement which Moses was ordered by the Lord to make with the children of Israel in the land of Moab, in addition to the agreement which he made with them in Horeb.  
καὶ ἐκάλεσεν μουσῆς πάντας τοὺς υἱοὺς ἰσραηλ καὶ εἶπεν πρὸς αὐτοὺς ὑμεῖς ἐωράκατε πάντα ὅσα ἐποίησεν κύριος ἐν γῆ αἰγύπτῳ ἐνώπιον ὑμῶν φαραῶ καὶ τοῖς θεράπουσιν αὐτοῦ καὶ πάσῃ τῇ γῆ αὐτῶν
- 2 Moisiu thirri tërë Izraelin dhe u tha atyre: &quot;Ju keni parë të gjitha ato që i ka bërë Zoti në Egjipt para syve tuaj Faraonit, të gjithë shërbëtorëve të tij dhe tërë vendit;  
And Moses said in the hearing of all Israel, You have seen all the Lord did before your eyes in the land of Egypt to Pharaoh and to all his servants and all his land;  
τοὺς πειρασμοὺς τοὺς μεγάλους οὓς ἐωράκασιν οἱ ὀφθαλμοὶ σου τὰ σημεῖα καὶ τὰ τέρατα τὰ μεγάλα ἐκεῖνα
- 3 sytë tuaj kanë parë mjerimet e mëdha, shenjat dhe mrekullitë e mëdha;  
The great tests which your eyes saw, and the signs and wonders:  
καὶ οὐκ ἔδωκεν κύριος ὁ θεὸς ὑμῖν καρδίαν εἰδέναι καὶ ὀφθαλμοὺς βλέπειν καὶ ὄτα ἀκοῦειν ἕως τῆς ἡμέρας ταύτης
- 4 por deri sot Zoti nuk ju ka dhënë zemër për të kuptuar, sy për të parë dhe veshë për të dëgjuar.  
But even to this day the Lord has not given you a mind open to knowledge, or seeing eyes or hearing ears.  
καὶ ἤγαγεν ὑμᾶς τεσσαράκοντα ἔτη ἐν τῇ ἐρήμῳ οὐκ ἐπαλαιώθη τὰ ἰμάτια ὑμῶν καὶ τὰ ὑποδήματα ὑμῶν οὐ κατετριβήν ἀπὸ τῶν ποδῶν ὑμῶν
- 5 Unë ju kam udhëhequr dyzet vjet në shkretëtirë; rrobat tuaja nuk ju janë prishur në trup, sandalet tuaja nuk iu janë konsumuar në këmbët tuaja.  
For forty years I have been your guide through the waste land: your clothing has not become old on your backs, or your shoes on your feet.  
ἄρτον οὐκ ἐφάγετε οἶνον καὶ σικερα οὐκ ἐπίετε ἵνα γινώτε ὅτι οὗτος κύριος ὁ θεὸς ὑμῶν
- 6 Nuk keni ngrënë bukë dhe nuk keni pirë verë as pije dehëse, me qëllim që të njihnit që unë jam Zoti, Perëndia juaj.  
You have had no bread, or wine, or strong drink: so that you might see that I am the Lord your God.  
καὶ ἤλθετε ἕως τοῦ τόπου τούτου καὶ ἐξῆλθεν σηὼν βασιλεὺς εσεβον καὶ ὠγ βασιλεὺς τῆς βασαν εἰς συνάντησιν ἡμῖν ἐν πολέμῳ καὶ ἐπατάξαμεν αὐτοὺς
- 7 Kur arritët në këtë vend, Sihoni, mbret i Heshbonit, dhe Ogu, mbret i Bashanit, dolën kundër nesh për të luftuar, por ne i mundëm,  
When you came to this place, Sihon, king of Heshbon, and Og, king of Bashan, came out to make war against us and we overcame them:  
καὶ ἐλάβομεν τὴν γῆν αὐτῶν καὶ ἔδωκα αὐτήν ἐν κλήρῳ τῷ ρουβην καὶ τῷ γαδδί καὶ τῷ ἡμίσει φυλῆς μανασση
- 8 pushtuam vendin e tyre dhe ia dhamë në trashëgimi Rubenitëve, Gaditëve dhe gjysmës së fisit të Manasit.  
And we took their land and gave it to the Reubenites and the Gadites and the half-tribe of Manasseh, for their heritage.  
καὶ φυλάξεσθε ποιεῖν πάντας τοὺς λόγους τῆς διαθήκης ταύτης ἵνα συνῆτε πάντα ὅσα ποιήσετε
- 9 Respektoni, pra, fjalët e kësaj besëlidhje dhe zbatoheni në praktikë, me qëllim që të keni mbarësi në çdo gjë që bëni.  
So keep the words of this agreement and do them, so that it may be well for you in everything you do.  
ὑμεῖς ἐστήκατε πάντες σήμερον ἐναντίον κυρίου τοῦ θεοῦ ὑμῶν οἱ ἀρχιφυλοὶ ὑμῶν καὶ ἡ γερουσία ὑμῶν καὶ οἱ κριταὶ ὑμῶν καὶ οἱ γραμματοεισαγωγεῖς ὑμῶν πᾶς ἀνὴρ ἰσραηλ
- 10 Sot të gjithë ju ndodheni para Zotit, Perëndisë tuaj; krerët tuaj, fiset tuaja, pleqtë tuaj, zyrtarët tuaj, tërë njerëzit e Izraelit,  
You have come here today, all of you, before the Lord your God; the heads of your tribes, the overseers, and those who are in authority over you, with all the men of Israel,  
αἱ γυναῖκες ὑμῶν καὶ τὰ ἔκγονα ὑμῶν καὶ ὁ προσήλυτος ὁ ἐν μέσῳ τῆς παρεμβολῆς ὑμῶν ἀπὸ ξυλοκόπου ὑμῶν καὶ ἕως ὁδροφόρου ὑμῶν

- 5** Atyre të Sukothit u tha: &quot;Ju lutem, u jepni bukë njerëzve që më vijnë pas, sepse janë të lodhur, dhe unë jam duke ndjekur Zebahun dhe Tsalmunain, mbretër të Madianit&quot;.  
**And he said to the men of Succoth, Give bread cakes to my people, for they are overcome with weariness, and I am going on after Zebah and Zalmunna, the kings of Midian.**  
 και εἶπεν τοῖς ἀνδράσιν σοκχωθ δότε δὴ ἄρτους τῷ λαῷ τῷ μετ' ἐμοῦ ὅτι πεινῶσιν ἐγὼ δὲ διώκω ὀπίσω ζεβее καὶ σαλμανα βασιλέων μαδιαμ
- 6** Por krerët e Sukothit u përgjegjën: &quot;Mos vallë Zebahu dhe Tsalmunai janë në dorën tënde, që ne të duhet t'i japim bukë ushtrisë tënde?&quot;.  
**But the chiefs of Succoth said, Are the hands of Zebah and Zalmunna even now in your hand that we are to give bread to your army?**  
 και εἶπαν οἱ ἄρχοντες σοκχωθ μὴ χεῖρ ζεβее καὶ σαλμανα νῦν ἐν τῇ χειρὶ σου ὅτι δώσομεν τῇ στρατιᾷ σου ἄρτους
- 7** Atëherë Gedeoni tha: &quot;Për këtë, kur Zoti të më japë në dorë Zebahun dhe Tsalmunain, do të copëtoj trupin tuaj me gjembat dhe me ferrat e shkretëtirës.  
**Then Gideon said, Because of this, when the Lord has given Zebah and Zalmunna into my hands, I will have you stretched on a bed of thorns of the waste land and on sharp stems, and have you crushed as grain is crushed on a grain-floor.**  
 και εἶπεν γεδεων οὐχ οὕτως ἐν τῷ δοῦναι κύριον τὸν ζεβее καὶ σαλμανα ἐν τῇ χειρὶ μου καὶ καταξανθ τὰς σάρκας ὑμῶν ἐν ταῖς ἀκάνθαις τῆς ἐρήμου καὶ ἐν ταῖς βαρκωνμ
- 8** Që andej shkoi në Penuel dhe u foli në të njëjtën mënyrë banorëve të tij; burrat e Penuelit iu përgjigjën në të njëjtën mënyrë si ata të Sukothit.  
**So he went up from there to Penuel and made the same request to the men of Penuel; but they gave him the same answer as the men of Succoth had given.**  
 και ἀνέβη ἐκεῖθεν εἰς φανουηλ καὶ ἐλάλησεν πρὸς αὐτούς κατὰ ταῦτα καὶ ἀπεκρίθησαν αὐτῷ οἱ ἄνδρες φανουηλ ὃν τρόπον ἀπεκρίθησαν αὐτῷ οἱ ἄνδρες σοκχωθ
- 9** Kështu ai u foli edhe burrave të Penuelit, duke u thënë: &quot;Kur të kthehem në paqe, do të rrëzoj këtë kala&quot;.  
**So he said to the men of Penuel, When I come back in peace, I will have this tower broken down.**  
 και εἶπεν τοῖς ἀνδράσιν φανουηλ λέγων ἐν τῷ ἐπιστρέφειν με μετ' εἰρήνης κατασκάψω τὸν πύργον τοῦτον
- 10** Zebahu dhe Tsalmunai ndodheshin në Karkor me gjithë ushtrinë e tyre prej rreth pesëmbëdhjetë mijë burrash, ajo që mbetej nga tërë ushtria e bijve të lindjes, sepse njëqind e njëzet mijë njerëz që mbanin shpatë i kishin vranë.  
**Now Zebah and Zalmunna were in Karkor and their armies with them, about fifteen thousand men, those of all the army of the children of the east who were still living; for a hundred and twenty thousand of their swordsmen had been put to death.**  
 και ζεβее καὶ σαλμανα ἐν καρκαρ καὶ ἡ παρεμβολὴ αὐτῶν μετ' αὐτῶν ὥσει πεντεκαίδεκα χιλιάδες οἱ καταλειφθέντες ἐν πάσῃ παρεμβολῇ υἰῶν ἀνατολῶν καὶ οἱ πεπτωκότες ἦσαν ἑκατὸν καὶ εἴκοσι χιλιάδες ἀνδρῶν ἐσπασμένων ῥομφαίαν
- 11** Gedeoni shkoi nëpër rrugët e atyre që banonin në çadra, në lindje të Nobahut dhe të Jogbehahut, dhe mundi ushtrinë që e pandehte veten në siguri.  
**And Gideon went up by the way used by the people living in tents on the east of Nobah and Jogbehah, and made an attack on the army when they had no thought of danger.**  
 και ἀνέβη γεδεων ὁδὸν κατοικούντων ἐν σκηναῖς ἀνατολῶν τῆς ναβεθ ἐξ ἐναντίας ζεβее καὶ ἐπάταξεν τὴν παρεμβολὴν ἣ δὲ παρεμβολὴ ἦν πεποιθυῖα

- 12** Dhe Zebahu dhe Tsalmunai ikën me vrap; por ai i ndoqi dhe i zuri të dy mbretërit e Madianit, Zebahun dhe Tsalmunain, dhe e shpartalloi tërë ushtrinë.  
**And Zebah and Zalmunna went in flight; and he went after them, and took the two kings of Midian, Zebah and Zalmunna, and put all the army to the curse.**  
 και ἔφυγεν ζεβее και σαλμανα και ἐδίωξεν ὀπίσω αὐτῶν και ἐκράτησεν τοὺς δύο βασιλεῖς μαδιαμ τὸν ζεβее και τὸν σαλμανα και πᾶσαν τὴν παρεμβολὴν αὐτῶν ἐξέτριψεν
- 13** Pastaj Gedeoni, bir i Joashit, u kthye në fushën e betejës nëpër të përpjetën e Heresit.  
**Then Gideon, the son of Joash, went back from the fight:**  
 και ἀνέστρεψεν γεδεων υἱὸς ιωασ ἐκ τοῦ πολέμου ἀπὸ ἀναβάσεως ἀρες
- 14** Kapi një të ri nga njerëzit e Sukothit dhe e mori në pyetje, dhe ky i dha me shkrim emrat e krerëve dhe të pleqve të Sukothit, gjithsej shtatëdhjetë e shtatë burra.  
**And taking prisoner a young man of the people of Succoth, he got from him, in answer to his questions, a list of the chiefs of Succoth and the responsible men, seventy-seven men.**  
 και συνέλαβον παιδάριον ἐκ τῶν ἀνδρῶν σοκχωθ και ἐπηρώτησεν αὐτόν και ἀπεγράματο πρὸς αὐτοὺς τοὺς ἄρχοντας σοκχωθ και τοὺς πρεσβυτέρους αὐτῆς ἐβδομήκοντα ἐπτὰ ἄνδρας
- 15** Pastaj shkoi te njerëzit e Sukothit dhe tha: "Ja, Zebahu dhe Tsalmunai, në lidhje me të cilët jeni tallur me mua, duke thënë: "Mos vallë Zebahu dhe Tsalmunai janë në dorën tënde, që ne të duhet t'u japim bukë njerëzve të tu të lodhur?"  
**So he came to the men of Succoth and said, Here are Zebah and Zalmunna, on account of whom you made sport of me, saying, Are the hands of Zebah and Zalmunna even now in your hand, that we are to give bread to your army who are overcome with weariness?**  
 και παρεγένετο γεδεων πρὸς τοὺς ἄρχοντας σοκχωθ και εἶπεν αὐτοῖς ἰδοὺ ζεβее και σαλμανα δι' οὓς ὠνειδίσατέ με λέγοντες μὴ χεῖρ ζεβее και σαλμανα νῦν ἐν τῇ χειρὶ σου ὅτι δόσομεν τοῖς ἀνδράσιν σου τοῖς ἐκλελυμένοις ἄρτους
- 16** Mori pastaj pleqtë e qytetit dhe me gjembat dhe ferrat e shkretëtirës u dha një mësim burrave të Sukothit.  
**Then he took the responsible men of the town and had them crushed on a bed of thorns and sharp stems.**  
 και ἔλαβεν τοὺς ἄρχοντας και τοὺς πρεσβυτέρους τῆς πόλεως και κατέξανεν αὐτοὺς ἐν ταῖς ἀκάνθαις τῆς ἐρήμου και ταῖς βαρακινημ και κατέξανεν ἐν αὐτοῖς ἄνδρας σοκχωθ
- 17** Rrëzoi gjithashtu kalanë e Penuelit dhe vrau njerëzit e qytetit.  
**And he had the tower of Penuel broken down and the men of the town put to death.**  
 και τὸν πύργον φανουηλ κατέσκαψεν και ἀπέκτεινεν τοὺς ἄνδρας τῆς πόλεως
- 18** Pastaj u tha Zebahut dhe Tsalmunait: "Si ishin njerëzit që keni vrrarë në Tabor?" Ata u përgjigjën: "Ishin si ti; secili prej tyre kishte pamjen e birit të një mbreti."  
**Then he said to Zebah and Zalmunna, Where are the men whom you put to death at Tabor? And they gave answer, As you are, so were they; every one of them was like a king's son.**  
 και εἶπεν πρὸς ζεβее και σαλμανα ποῦ οἱ ἄνδρες οὓς ἀπέκτεινάτε ἐν θαβωρ και εἶπαν ὡσεὶ σύ ὁμοιος σοὶ ὁμοιος αὐτῶν ὡς εἶδος μορφῆς υἱῶν βασιλέων
- 19** Ai vazhdoi: "Ishin vëllezërit e mi, bij të nënes sime; ashtu siç është e vërtetë që Zoti rron, po të mos i kishit vrrarë, unë nuk do t'ju vrisja!"  
**And he said, They were my brothers, my mother's sons: by the life of the Lord, if you had kept them safe, I would not put you to death.**  
 και εἶπεν γεδεων ἀδελφοί μου και υἱοὶ τῆς μητρὸς μου εἰσιν και ὤμοσεν αὐτοῖς ζῆ κύριος εἰ ἐζωογονήσατε αὐτοὺς οὐκ ἂν ἀπέκτεινα ὑμᾶς
- 20** Pastaj i tha Jetherit, birit të tij të parë: "Çohu dhe vriti!" Por i riu nuk e nxori shpatën, sepse kishte frikë, ishte ende i ri.  
**Then he said to Jether, his oldest son, Up! Put them to death. But the boy did not take out his sword, fearing because he was still a boy.**  
 και εἶπεν τῷ ἱεθερ τῷ πρωτοτόκῳ αὐτοῦ ἀναστάς ἀπόκτεινον αὐτούς και οὐκ ἔσπασεν τὸ παιδάριον αὐτοῦ τὴν μάχαιραν αὐτοῦ ὅτι ἐφοβήθη ὅτι ἦν νεώτερος
- 21** Atëherë Zebahu dhe Tsalmunai thanë: "Çohu ti vetë dhe na godit, sepse si të jetë burri ashtu është edhe forca e tij." Kështu Gedeoni u ngrit dhe vrau Zebahun dhe Tsalmunain, dhe shtiu në dorë gjysmëhënat që devetë e tyre mbanin në qafë.  
**Then Zebah and Zalmunna said, Up! Put an end to us yourself: for you have a man's strength. Then Gideon got up and put Zebah and Zalmunna to death and took the ornaments which were on their camels' necks.**  
 και εἶπεν ζεβее και σαλμανα ἀνάστα δὴ σύ και ἀπάντησον ἡμῖν ὅτι ὡς ἀνὴρ ἡ δύναμις αὐτοῦ και ἀνέστη γεδεων και ἀνείλεν τὸν ζεβее και τὸν σαλμανα και ἔλαβεν τοὺς μινίσκους τοὺς ἐν τοῖς τραχήλοισι τῶν καμήλων αὐτῶν
- 22** Atëherë burrat e Izraelit i thanë Gedeonit: "Mbretëro mbi ne ti, biri yt dhe i biri i birit tënd, sepse na ke çliruar nga sundimi i Madianit."  
**Then the men of Israel said to Gideon, Be our ruler, you and your son and your son's son after him; for you have been our saviour from the hands of Midian.**  
 και εἶπεν ἀνὴρ ἰσραηλ πρὸς γεδεων ἄρχε ἐν ἡμῖν σύ και οἱ υἱοί σου ὅτι σέσωκας ἡμᾶς ἐκ χειρὸς μαδιαμ
- 23** Por Gedeoni u përgjegj: "Unë nuk do të mbretëroj mbi ju, as edhe biri im!"  
**But Gideon said to them, I will not be a ruler over you, and my son will not be a ruler over you: it is the Lord who will be ruler over you.**  
 και εἶπεν πρὸς αὐτοὺς γεδεων οὐκ ἄρξω ἐγὼ ὑμῶν και οὐκ ἄρξει ὁ υἱός μου ὑμῶν κύριος ἄρξει ὑμῶν



- 24 Pastaj Gedeoni u tha: "Por dua t'ju kërkoj diçka: secili prej jush të më japë vathët e plaçkës së tij". Ata kishin vathët prej ari sepse ishin Ishmaelitë.  
Then Gideon said to them, I have a request to make to you; let every man give me the ear-rings he has taken. (For they had gold ear-rings, because they were Ishmaelites.)  
καὶ εἶπεν πρὸς αὐτοὺς γεδεων αἰτήσομαι παρ' ὑμῶν αἰτήσιν καὶ δότε μοι ἀνὴρ ἐνώτιον τῶν σκύλων αὐτοῦ ὅτι ἐνώτια χρυσᾶ πολλὰ ἦν αὐτοῖς ὅτι ἰσμαηλῖται ἦσαν
- 25 Ata u përgjigjën: "Ne i japim me gjithë qejf". Kështu ata shtrinë një mantel dhe secili hodhi vathët e plaçkës së tij.  
And they gave answer, We will gladly give them. So they put down a robe, every man dropping into it the ear-rings he had taken.  
καὶ εἶπαν διδόντες δόσομεν καὶ ἀνέπτυξεν τὸ ἱμάτιον αὐτοῦ καὶ ἔρριψεν ἐκεῖ ἀνὴρ ἐνώτιον χρυσοῦν τῶν σκύλων αὐτοῦ
- 26 Pasha e vathëve prej ari që ai kishte kërkuar ishte një mijë e shtatëqind sikla ari, përveç gjysmëhënzave, varëseve dhe rrobave të purpurta që vishnin mbretërit e Madianit, përveç qaforeve që devetë e tyre mbanin në qafë.  
The weight of the gold ear-rings which he got from them was one thousand, seven hundred shekels of gold; in addition to the moon-ornaments and jewels and the purple robes which were on the kings of Midian, and the chains on their camels' necks.  
καὶ ἐγενήθη ὁ σταθμὸς τῶν ἐνωτίων τῶν χρυσοῦν ὧν ἠτήσατο σίκλοι χίλιοι καὶ ἑπτακόσιοι χρυσοῦ πλην τῶν σιρώνων καὶ τῶν ὀρμίσκων ἐνφωθ καὶ τῶν περιβολαίων τῶν πορφυρῶν τῶν ἐπὶ τοῖς βασιλεῦσιν μαδιαμ καὶ πλην τῶν κλειῶν τῶν χρυσοῦν τῶν ἐν τοῖς τραχήλοις τῶν καμήλων αὐτῶν
- 27 Pastaj Gedeoni me të bëri një eford, dhe e vendosi në Ofrah, në qytetin e tij; tërë Izraelit shkoi atje dhe u kurvërua me të dhe kështu u shndërrua në një lak për Gedeonin dhe shtëpinë e tij.  
And Gideon made an ephod from them and put it up in his town Ophrah; and all Israel went after it there and were false to the Lord; and it became a cause of sin to Gideon and his house.  
καὶ ἐποίησεν αὐτὸ γεδεων εἰς εφοῦδ καὶ ἔστησεν αὐτὸ ἐν πόλει αὐτοῦ ἐν εφραθα καὶ ἐξεπόρνευσεν πᾶς ἰσραηλ ὀπίσω αὐτοῦ ἐκεῖ καὶ ἐγένετο τῷ γεδεων καὶ τῷ οἴκῳ αὐτοῦ εἰς σκάνδαλον
- 28 Kështu Madiani u poshtërua përpara bijve të Izraelit dhe nuk ngriti më kokë; dhe vendi pati paqe dyzet vjet me radhë, gjatë gjithë jetës së Gedeonit.  
So Midian was broken before the children of Israel and the Midianites never got back their strength. And the land had peace for forty years, in the days of Gideon.  
καὶ ἐνετράπη μαδιαμ ἐνώπιον υἱῶν ἰσραηλ καὶ οὐ προσέθεντο ἄρα κεφαλὴν αὐτῶν καὶ ἡσύχασεν ἡ γῆ ἔτη τεσσαράκοντα ἐν ἡμέραις γεδεων
- 29 Pastaj Jerubaali, bir i Joashit, u kthye të banojë në shtëpinë e tij.  
And Jerubbaal, the son of Joash, went back to his house and was living there.  
καὶ ἐπορεύθη ἱεροβααλ υἱὸς ἰωας καὶ κατέκησεν ἐν τῷ οἴκῳ αὐτοῦ
- 30 Gedeoni pati shtatëdhjetë fëmijë që dolën nga ijet e tij, sepse pati shumë gra.  
Gideon had seventy sons, the offspring of his body; for he had a number of wives.  
καὶ τῷ γεδεων ἦσαν ἑβδομήκοντα υἱοὶ ἐκπορευόμενοι ἐκ μηρῶν αὐτοῦ ὅτι γυναῖκες πολλαὶ ἦσαν αὐτῷ
- 31 Por konkubina e tij që banonte në Sikem, i lindi edhe ajo një djalë, të cilit i vuri emrin Abimelek.  
And the servant-wife he had in Shechem had a son by him, to whom he gave the name Abimelech.  
καὶ ἡ παλλακὴ αὐτοῦ ἢ ἐν σικμοῖς ἔτεκεν αὐτῷ καὶ γε αὐτῇ υἱόν καὶ ἐπέθηκεν τὸ ὄνομα αὐτοῦ ἀβιμελεχ
- 32 Pastaj Gedeoni, bir i Joashit, vdiq në pleqëri të mbarë dhe u varros në varrin e Joashit, të atit të tij, në Ofrah të Abiezeritëve.  
And Gideon, the son of Joash, came to his end when he was very old, and his body was put in the resting-place of Joash his father, in Ophrah of the Abiezrites.  
καὶ ἀπέθανεν γεδεων υἱὸς ἰωας ἐν πολὺ ἀγαθῇ καὶ ἐτάφη ἐν τῷ τάφῳ ἰωας τοῦ πατρὸς αὐτοῦ ἐν εφραθα πατρὸς ἀβιεζρι
- 33 Pas vdekjes së Gedeonit, bijtë e Izraelit filluan përsëri të kurvëroheshin përpara Baalit dhe zgjedhën Baal-Berithin si zot të tyre.  
And after the death of Gideon, the children of Israel again went after the gods of Canaan and were false to the Lord, and made Baal-berith their god.  
καὶ ἐγενήθη ὡς ἀπέθανεν γεδεων καὶ ἀπεστράφησαν οἱ υἱοὶ ἰσραηλ καὶ ἐξέπορνευσαν ὀπίσω τῶν βααλιμ καὶ ἔθεντο αὐτοῖς τὸν βααλβεριθ εἰς διαθήκην τοῦ εἶναι αὐτοῖς αὐτὸν εἰς θεόν
- 34 Bijtë e Izraelit nuk u kujtuan fare për Zotin, Perëndinë e tyre, që i kishte çliruar nga të gjithë armiqtë që i rrethonin,  
And the children of Israel did not keep in their minds the Lord their God, who had been their saviour from all their haters on every side;  
καὶ οὐκ ἐμνήσθησαν οἱ υἱοὶ ἰσραηλ κυρίου τοῦ θεοῦ αὐτῶν τοῦ ῥυσαμένου αὐτοὺς ἐκ χειρὸς πάντων τῶν ἐχθρῶν αὐτῶν κυκλόθεν
- 35 dhe nuk u treguan fare mirënjohës ndaj shtëpisë së Jerubaalit (domethënë të Gedeonit) për gjithë ato të mira që i kishte bërë Izraelit.  
And they were not kind to the house of Jerubbaal, that is, Gideon, in reward for all the good he had done to Israel.  
καὶ οὐκ ἐποίησαν ἔλεος μετὰ τοῦ οἴκου ἱεροβααλ γεδεων κατὰ πᾶσαν τὴν ἀγαθωσύνην ἣν ἐποίησεν μετὰ ἰσραηλ
- 1 Abimeleku, bir i Jerubaalit, shkoi në Sikem te vëllezërit e nënes së tij dhe foli me ta dhe me gjithë familjen e atit të nënes së tij, duke thënë:  
Now Abimelech, the son of Jerubbaal, went to Shechem to his mother's family, and said to them and to all the family of his mother's father,  
καὶ ἐπορεύθη ἀβιμελεχ υἱὸς ἱεροβααλ εἰς σικμα πρὸς τοὺς ἀδελφοὺς τῆς μητρὸς αὐτοῦ καὶ ἐλάλησεν πρὸς αὐτοὺς καὶ πρὸς πᾶσαν τὴν συγγένειαν τοῦ οἴκου τῆς μητρὸς αὐτοῦ λέγων

- 2 &quot;U thoni gjithë banorëve të Sikemit: &quot;Ç'është më e mirë për ju, që të gjithë shtatëdhjetë bijtë e Jerubaalit të mbretërojnë mbi ju, apo të mbretërojë mbi ju vetëm një?&quot;. Dhe mos harroni që unë rrjedh nga kocka dhe mishi juaj&quot;.  
Say now in the ears of all the townsmen of Shechem, Is it better for you to be ruled by all the seventy sons of Jerubbaal or by one man only? And keep in mind that I am your bone and your flesh.  
λαλήσατε δὴ ἐν ὧσιν τῶν ἀνδρῶν σικμιων ποῖον βέλτιόν ἐστιν τὸ ἄρχειν ὑμῶν ἢ ἑβδομήκοντα ἄνδρας πάντας υἱοὺς ἱεροβααλ ἢ κυριεῦειν ὑμῶν ἄνδρα ἓνα καὶ μνήσθητε ὅτι σὰρξ ὑμῶν καὶ ὀστοῦν ὑμῶν ἐγώ εἰμι
- 3 Vëllezërit e nënes së tij i përhapën këto fjalë të tij tërë banorëve të Sikemit; dhe zemra e tyre anoi në dobi të Abimelekut, sepse thanë: &quot;Është vëllai ynë&quot;.  
So his mother's family said all this about him in the ears of all the townsmen of Shechem: and their hearts were turned to Abimelech, for they said, He is our brother.  
καὶ ἐλάλησαν περὶ αὐτοῦ οἱ ἀδελφοὶ τῆς μητρὸς αὐτοῦ ἐν τοῖς ὧσιν πάντων τῶν ἀνδρῶν σικμιων πάντας τοὺς λόγους τούτους καὶ ἐκλινεν καρδία αὐτῶν ὀπίσω ἀβιμελεχ ὅτι εἶπαν ἀδελφὸς ἡμῶν ἐστιν
- 4 Kështu i dhanë shtatëdhjetë sikla argjendi, që i tërhoqën nga tempulli i Baal-Berithit, me të cilat Abimeleku rekrutoi njerëz pa kurrfarë vlere, por trima; dhe ata i shkuan pas.  
And they gave him seventy shekels of silver from the house of Baal-berith, with which Abimelech got the support of a number of uncontrolled and good-for-nothing persons.  
καὶ ἔδωκαν αὐτῷ ἑβδομήκοντα ἀργυρίου ἐκ τοῦ οἴκου βααλ διαθήκης καὶ ἐμισθώσατο ἐν αὐτοῖς ἀβιμελεχ ἄνδρας κενοὺς καὶ θαμβουμένους καὶ ἐπορεύθησαν ὀπίσω αὐτοῦ
- 5 Pastaj ai shkoi në shtëpinë e atit të tij në Ofrah dhe vrau mbi po atë gur vëllezërit e tij, të shtatëdhjetë bijtë e Jerubaalit. Por Jothami biri më i vogël i Jerubaalit, shpëtoi sepse ishte fshehur.  
Then he went to his father's house at Ophrah, and put his brothers, the seventy sons of Jerubbaal, to death on the same stone; however, Jotham, the youngest, kept himself safe by going away to a secret place.  
καὶ εἰσῆλθεν εἰς τὸν οἶκον τοῦ πατρὸς αὐτοῦ εἰς εφραθα καὶ ἀπέκτεινεν τοὺς ἀδελφοὺς αὐτοῦ υἱοὺς ἱεροβααλ ἑβδομήκοντα ἄνδρας ἐπὶ λίθον ἓνα καὶ ἀπελείφθη ἰωθαμ υἱὸς ἱεροβααλ ὁ νεώτερος ὅτι ἐκρύβη
- 6 Atëherë tërë banorët e Sikemit dhe tërë shtëpia e Milos u mbledhën dhe shkuan ta shpallin mbret Abimeleku, pranë lisit të monumentit që gjendet në Sikem.  
And all the townsmen of Shechem and all Beth-millo came together and went and made Abimelech their king, by the oak of the pillar in Shechem.  
καὶ συνήχθησαν πάντες οἱ ἄνδρες σικμιων καὶ πᾶς ὁ οἶκος μαλλων καὶ ἐπορεύθησαν καὶ ἐβασίλευσαν τὸν ἀβιμελεχ εἰς βασιλέα πρὸς τῇ βαλάνῳ τῆς στάσεως ἐν σικμιοις
- 7 Kur Jothami u informua për këtë gjë, shkoi dhe zuri në majën e malit Gerezim dhe, duke ngritur zërin, thirri: &quot;Dëgjomëni, banorë të Sikemit, dhe Perëndia të mund t'ju dëgjojë!  
Now Jotham, on hearing of it, went to the top of Mount Gerizim, and crying out with a loud voice said to them, Give ear to me, you townsmen of Shechem, so that God may give ear to you.  
καὶ ἀνήγγειλαν τῷ ἰωθαμ καὶ ἐπορεύθη καὶ ἔστη ἐπὶ τῆς κορυφῆς τοῦ ὄρους γαριζιν καὶ ἐπήρην τὴν φωνὴν αὐτοῦ καὶ ἐκάλεσεν καὶ εἶπεν αὐτοῖς ἀκούσατέ μου ἄνδρες σικμιων καὶ ἀκούσαί ὑμῶν ὁ θεὸς
- 8 Një ditë drurët u nisën për të vajasur një mbret që të mbretëronte mbi ta; dhe i thanë ullirit: &quot;Mbretëro mbi ne&quot;.  
One day the trees went out to make a king for themselves; and they said to the olive-tree, Be king over us.  
πορευόμενα ἐπορεύθησαν τὰ ξύλα τοῦ χρίσαι ἑαυτοῖς βασιλέα καὶ εἶπον τῇ ἐλαίᾳ βασιλευσον ἐφ' ἡμῶν
- 9 Por ulliri u përgjegj me këto fjalë: &quot;A duhet të heq dorë nga vaji im metë cilin Perëndia dhe njerëzit nderohen, dhe të shkoj të shqetësohem për drurët?&quot;.  
But the olive-tree said to them, Am I to give up my wealth of oil, by which men give honour to God, and go waving over the trees?  
καὶ εἶπεν αὐτοῖς ἡ ἐλαία ἀφείσα τὴν πλῆθειά μου ἣν ἐν ἐμοὶ ἐδόξασεν ὁ θεὸς καὶ ἄνθρωποι πορευθῶ ἄρχειν τῶν ξύλων
- 10 Atëherë drurët i thanë fikut: &quot;Eja ti të mbretërosh mbi ne&quot;.  
Then the trees said to the fig-tree, You come and be king over us.  
καὶ εἶπαν τὰ ξύλα τῇ συκῇ δεῦρο βασιλευσον ἐφ' ἡμῶν
- 11 Por fiku iu përgjegj atyre: &quot;A duhet të heq dorë nga ëmbëlsia ime dhe nga fruti im shumë i shijshëm dhe të shkoj të shqetësohem për drurët?&quot;.  
But the fig-tree said to them, Am I to give up my sweet taste and my good fruit and go waving over the trees?  
καὶ εἶπεν αὐτοῖς ἡ συκὴ ἀφείσα τὴν γλυκύτητά μου καὶ τὸ γένημά μου τὸ ἀγαθὸν πορευθῶ ἄρχειν ἐπὶ ξύλων
- 12 Atëherë drurët iu drejtuan hardhisë: &quot;Eja ti të mbretërosh mbi ne&quot;.  
Then the trees said to the vine, You come and be king over us.  
καὶ εἶπαν τὰ ξύλα τῇ ἀμπέλῳ δεῦρο βασιλευσον ἐφ' ἡμῶν
- 13 Por hardhia u përgjegj kështu: &quot;A duhet të heq dorë nga vera ime e ëmbël që gëzon Perëndinë dhe njerëzit, dhe të shkoj të shqetësohem për drurët?&quot;.  
But the vine said to them, Am I to give up my wine, which makes glad God and men, to go waving over the trees?  
καὶ εἶπεν αὐτοῖς ἡ ἀμπελος ἀφείσα τὸν οἶνόν μου τὴν εὐφροσύνην τὴν παρὰ τοῦ θεοῦ τῶν ἀνθρώπων πορευθῶ ἄρχειν ξύλων
- 14 Atëherë tërë drurët i thanë ferrës: &quot;Eja ti të mbretërosh mbi ne&quot;.  
Then all the trees said to the thorn, You come and be king over us.  
καὶ εἶπαν τὰ ξύλα πρὸς τὴν ῥάμνον δεῦρο σὺ βασιλευσον ἐφ' ἡμῶν

- 15 Ferra iu përgjegj me këto fjalë drurëve: "Në rast se doni me të vërtetë të më vajosni si mbret për të sunduar mbi ju, ejani të strehoheni nën hijen time; përndryshe daltë një zjarr nga ferra dhe përpiftë kedrat e Libanit!".
- And the thorn said to the trees, If it is truly your desire to make me your king, then come and put your faith in my shade; and if not, may fire come out of the thorn, burning up the cedars of Lebanon.
- καὶ εἶπεν ἡ ῥάμνος πρὸς τὰ ξύλα εἰ ἐν ἀληθείᾳ ὑμεῖς χριετέ με εἰς βασιλέα ἐφ' ὑμῶν δεῦτε πεποιθατε ἐν τῇ σκέπῃ μου καὶ εἰ μὴ ἐξέλθοι πῦρ ἐκ τῆς ῥάμνου καὶ καταφάγοι τὰς κέδρους τοῦ λιβάνου
- 16 Por ju nuk u suallët me besnikëri dhe me ndershmëri duke e shpallur mbret Abimelekun, nuk mbajtët një qëndrim të mirë ndaj Jerubaalit dhe shtëpisë së tij dhe nuk e keni trajtuar siç e meritonte, So now, if you have done truly and uprightly in making Abimelech king, and if you have done well to Jerubbaal and his house in reward for the work of his hands;
- καὶ νῦν εἰ ἐν ἀληθείᾳ καὶ ἐν τελειότητι ἐποιήσατε καὶ ἐβασιλεύσατε τὸν ἀβιμελεχ καὶ εἰ καλῶς ἐποιήσατε μετὰ ιεροβααλ καὶ μετὰ τοῦ οἴκου αὐτοῦ καὶ εἰ κατὰ τὸ ἀνταπόδομα τῆς χειρὸς αὐτοῦ ἐποιήσατε αὐτῷ
- 17 sepse im atë ka luftuar për ju, ka rrezikuar jetën e vet dhe ju ka çliruar nga sundimi i Madianit. (For my father made war for you, and put his life in danger, and made you free from the hands of Midian;
- ὡς ἐπολέμησεν ὁ πατήρ μου ὑπὲρ ὑμῶν καὶ ἔρριψεν τὴν ψυχὴν αὐτοῦ ἐξ ἐναντίας καὶ ἐξείλατο ὑμᾶς ἐκ χειρὸς μαδιαμ
- 18 Kurse sot ju keni ngritur krye kundër shtëpisë së atit tim, keni vrrarë të shtatëdhjetë bijtë e tij mbi po atë gur dhe keni shpallur mbret të Sikemitëve Abimelekun, birin e shërbëtores, sepse është vëllai juaj. And you have gone against my father's family this day, and have put to death his sons, even seventy men on one stone, and have made Abimelech, the son of his servant-wife, king over the townsmen of Shechem because he is your brother;)
- καὶ ὑμεῖς ἐπανέστητε ἐπὶ τὸν οἶκον τοῦ πατρὸς μου σήμερον καὶ ἀπεκτείνετε τοὺς υἱοὺς αὐτοῦ ἑβδομήκοντα ἄνδρας ἐπὶ λίθον ἓνα καὶ ἐβασιλεύσατε τὸν ἀβιμελεχ υἱὸν τῆς παιδίσκης αὐτοῦ ἐπὶ τοὺς ἄνδρας σικιμων ὅτι ἀδελφὸς ὑμῶν ἐστίν
- 19 Në rast se sot keni vepruar me besnikëri dhe ndershmëri ndaj Jerubaalit dhe shtëpisë së tij, atëherë e gëzofshi Abimelekun dhe ai u gëzoftë me ju! If then you have done what is true and upright to Jerubbaal and his family this day, may you have joy in Abimelech, and may he have joy in you;
- καὶ εἰ ἐν ἀληθείᾳ καὶ τελειότητι ἐποιήσατε μετὰ ιεροβααλ καὶ τοῦ οἴκου αὐτοῦ τῇ ἡμέρᾳ ταύτῃ εὐλογηθεῖτε ὑμεῖς καὶ εὐφρανθεῖτε ἐν ἀβιμελεχ καὶ εὐφρανθεῖτε καὶ αὐτὸς ἐν ὑμῖν
- 20 Por në rast se punët nuk janë kështu, le të dalë nga Abimeleku një zjarr që të gllabërojë banorët e Sikemit dhe shtëpinë e Milos, dhe le të dalë nga banorët e Sikemit dhe nga shtëpitë e Milos një zjarr që të gllabërojë Abimelekun".
- But if not, may fire come out from Abimelech, burning up the townsmen of Shechem and Beth-millo; and may fire come out from the townsmen of Shechem and Beth-millo, for the destruction of Abimelech.
- καὶ εἰ μὴ ἐξέλθοι πῦρ ἐξ ἀβιμελεχ καὶ καταφάγοι τοὺς ἄνδρας σικιμων καὶ τὸν οἶκον μααλλον καὶ εἰ μὴ ἐξέλθοι πῦρ ἀπὸ ἀνδρῶν σικιμων καὶ ἐκ τοῦ οἴκου μααλλον καὶ καταφάγοι τὸν ἀβιμελεχ
- 21 Pastaj Jothemi iku, ia mbathi dhe shkoi të banojë në Beer nga frika e vëllait të tij Abimelek. Then Jotham straight away went in flight to Beer, and was living there for fear of his brother Abimelech.
- καὶ ἀπέδρα ιωθαμ καὶ ἐπορεύθη ἐν ὁδοῖ καὶ ἔφυγεν εἰς βαρα καὶ κατοίκησεν ἐκεῖ ἀπὸ προσώπου ἀβιμελεχ τοῦ ἀδελφοῦ αὐτοῦ
- 22 Abimeleku sundoi tre vjet mbi Izraelin. So Abimelech was chief over Israel for three years.
- καὶ ἦρξεν ἀβιμελεχ ἐπὶ ἰσραηλ τρία ἔτη
- 23 Pastaj Perëndia dërgoi një frymë të keq midis Abimelekut dhe banorëve të Sikemit, dhe banorët e Sikemit e tradhtuan Abimelekun, And God sent an evil spirit between Abimelech and the townsmen of Shechem; and the townsmen of Shechem were false to Abimelech;
- καὶ ἐξαπέστειλεν ὁ θεὸς πνεῦμα πονηρὸν ἀνὰ μέσον ἀβιμελεχ καὶ ἀνὰ μέσον τῶν ἀνδρῶν σικιμων καὶ ἠθέτησαν οἱ ἄνδρες σικιμων ἐν τῷ οἴκῳ ἀβιμελεχ
- 24 me qëllim që dhuna e ushtruar kundër të shtatëdhjetë bijve të Jerubaalit të zgjidhej dhe gjaku i tyre të binte mbi vëllanë e tyre Abimelek, që i kishte vrrarë dhe mbi banorët e Sikemit, që e kishin ndihmuar të vriste vëllezërit e tij. So that punishment for the violent attack made on the seventy sons of Jerubbaal, and for their blood, might come on Abimelech, their brother, who put them to death, and on the townsmen of Shechem who gave him their help in putting his brothers to death.
- τοῦ ἐπαγαγεῖν τὴν ἀδικίαν τῶν ἑβδομήκοντα υἱῶν ιεροβααλ καὶ τὸ αἷμα αὐτῶν ἐπιθεῖναι ἐπὶ ἀβιμελεχ τὸν ἀδελφὸν αὐτῶν τὸν ἀποκτείναντα αὐτοὺς καὶ ἐπὶ τοὺς ἄνδρας σικιμων τοὺς κατισχύσαντας τὸν ἀβιμελεχ ὥστε ἀποκτεῖναι τοὺς ἀδελφοὺς αὐτοῦ
- 25 Banorët e Sikemit vunë njerëz në pritë kundër tij në majën e maleve, dhe këta plaçkitën tërë ata që kalonin në rrugë afër tyre. Abimeleku u informua për këtë. And the townsmen of Shechem put secret watchers on the tops of the mountains, and they made attacks on all who went by on the road and took their goods; and word of this came to Abimelech.
- καὶ ἔθεντο αὐτῷ οἱ ἄνδρες σικιμων ἕνεδρα ἐπὶ τὰς κεφαλὰς τῶν ὀρέων καὶ ἀνήρπασον πάντας τοὺς διαπορευομένους ἐπ' αὐτοὺς ἐν τῇ ὁδοῖ καὶ ἀπηγγέλη τῷ ἀβιμελεχ

- 26 Pastaj Gaali, bir i Ebedit, dhe vëllezërit e tij erdhën dhe u transferuan në Sikem, dhe banorët e Sikemit krijuan besim tek ai.  
Then Gaal, the son of Ebed, came with his brothers, and went over to Shechem; and the men of Shechem put their faith in him.  
kai ἦλθεν γααλ υἱὸς αβεδ και οἱ ἀδελφοὶ αὐτοῦ εἰς σικιμα και ἐπεποιθήσαν ἐν αὐτῷ οἱ ἄνδρες σικιμων
- 27 Ata dolën në ara, mblohdhën rrushin në vreshtat e tyre, e shtypën dhe bënë festë. Pastaj hynë në shtëpinë e zotit të tyre, hëngrën, pinë dhe mallkuan Abimelekun.  
And they went out into their fields and got in the fruit of their vines, and when the grapes had been crushed, they made a holy feast and went into the house of their god, and over their food and drink they were cursing Abimelech.  
kai ἦλθον εἰς ἀγρὸν και ἐτρώγυσαν τοὺς ἀμπελῶνας αὐτῶν και κατεπάτουν και ἐποίησαν χοροὺς και εἰσήλθον εἰς οἶκον θεοῦ αὐτῶν και ἔφαγον και ἔπιον και κατηρώντο τὸν αβιμελεχ
- 28 Gaali, bir i Ebedit, tha: "Kush është Abimeleku dhe çfarë përfaqëson Sikemi, pse duhet t'i shërbejmë? A nuk është vallë bir i Jerubaalit, dhe a nuk është Zebuli mëkëmbësi i tij? Më mirë u shërbeni njerëzve të Hamorit atit të Sikemit! Po pse u dashka që ne t'i shërbejmë këtij njeriu?  
And Gaal, the son of Ebed, said, Who is Abimelech and who is Shechem, that we are to be his servants? Is it not right for the son of Jerubbaal and Zebul his captain to be servants to the men of Hamor, the father of Shechem? But why are we to be his servants?  
kai εἶπεν γααλ υἱὸς αβεδ τι ἐστιν αβιμελεχ και τις ἐστιν ὁ υἱὸς συχημ ὅτι δουλεύσομεν αὐτῷ οὐχ οὗτος υἱὸς ιεροβααλ και ζεβουλ ἐπίσκοπος αὐτοῦ δοῦλος αὐτοῦ σὺν τοῖς ἀνδράσιν εμμωρ πατρὸς συχημ και τι ὅτι δουλεύσομεν αὐτῷ ἡμεῖς
- 29 Po ta kisha këtë popull nën urdhrat e mia, unë do ta kisha dëbuar Abimelekun!". Pastaj i tha Abimeleku: "Forcoje ushtrinë tënde dhe më dil përpara!".  
If only I had authority over this people! I would put Abimelech out of the way, and I would say to Abimelech, Make your army strong, and come out.  
kai τις δῶν τὸν λαὸν τοῦτον ἐν χειρὶ μου και μεταστήσω τὸν αβιμελεχ και ἐρῶ τῷ αβιμελεχ πλήθυνον τὴν δύναμίν σου και ἔξελθε
- 30 Kur Zebuli, qeveritar i qytetit, dëgjoji këto fjalë të Gaalit, birit të Ebedit, u zemërua shumë,  
Now Zebul, the ruler of the town, hearing what Gaal, the son of Ebed, had said, was moved to wrath.  
kai ἤκουσεν ζεβουλ ὁ ἄρχων τῆς πόλεως τοὺς λόγους γααλ υἱοῦ αβεδ και ἐθυμώθη ὀργῇ
- 31 dhe i dërgoi fshehurazi lajmëtarë Abimeleku për t'i thënë: "Ja, Gaali, bir i Ebedit, dhe vëllezërit e tij kanë ardhur në Sikem; ata po e ngrenë qytetin kundër teje.  
And he sent to Abimelech at Arumah, saying, See, Gaal, the son of Ebed, and his brothers have come to Shechem, and they are working up the town against you.  
kai ἀπέστειλεν ἀγγέλους πρὸς αβιμελεχ μετὰ δώρων λέγων ἰδοὺ γααλ υἱὸς αβεδ και οἱ ἀδελφοὶ αὐτοῦ παραγεγόνασιν εἰς σικιμα και οἶδε πολιορκοῦσιν τὴν πόλιν ἐπὶ σέ
- 32 Prandaj çohu natën, ti dhe njerëzit e tu, dhe zëru pritë në fushë;  
So now, get up by night, you and your people, and keep watch in the field secretly;  
kai νῦν ἀνάστηθι νυκτὸς σὺ και ὁ λαὸς ὁ μετὰ σοῦ και ἐνέδρευσον ἐν τῷ ἀγρῷ
- 33 dhe nesër në mëngjes, sa të lindë dielli do të ngrihesh dhe do t'i sullesh qytetit. Kur pastaj Gaali me gjithë njerëzit që janë me të do të dalë kundër teje, ti do t'i bësh atë që beson se është më e përshtatshme".  
And in the morning, when the sun is up, get up early and make a rush on the town; and when he and his people come out against you, do to them whatever you have a chance to do.  
kai ἐσται τὸ πρωὶ ἅμα τῷ ἀνατεῖλαι τὸν ἥλιον και ὀρθοίσεις και ἐκτενεῖς ἐπὶ τὴν πόλιν και ἰδοὺ αὐτὸς και ὁ λαὸς ὁ μετ' αὐτοῦ ἐκπορεύονται πρὸς σέ και ποιήσεις αὐτῷ καθάπερ ἐὰν εὕρῃ ἡ χεὶρ σου
- 34 Abimeleku dhe tërë njerëzit që ishin me të u ngritën natën dhe zunë një pritë kundër Sikemit, të ndarë në katër grupe.  
So Abimelech and the people with him got up by night, in four bands, to make a surprise attack on Shechem.  
kai ἀνέστη αβιμελεχ και πᾶς ὁ λαὸς ὁ μετ' αὐτοῦ νυκτὸς και ἐνήδρευσαν ἐπὶ σικιμα τέσσαρας ἀρχάς
- 35 Kur Gaali, bir i Ebedit, doli dhe u ndal në hyrjen e portës së qytetit, Abimeleku doli nga prita me gjithë njerëzit që ishin me të.  
And Gaal, the son of Ebed, went out, and took his place at the doorway into the town; then Abimelech and his people got up from the place where they had been waiting.  
kai ἐγένετο πρωὶ και ἐξῆλθεν γααλ υἱὸς αβεδ και ἔστη πρὸς τῇ θύρᾳ τῆς πόλεως και ἀνέστη αβιμελεχ και ὁ λαὸς ὁ μετ' αὐτοῦ ἐκ τῶν ἐνέδρων
- 36 Duke i parë ata njerëz, Gaali i tha Zebulit: "Ja, disa njerëz që zbresin nga maja e maleve". Por Zebuli iu përgjegj: "Hijet e maleve të duken ty si njerëz".  
And when Gaal saw the people, he said to Zebul, See! people are coming down from the tops of the mountains. And Zebul said to him, You see the shade of the mountains like men.  
kai εἶδεν γααλ υἱὸς αβεδ τὸν λαὸν και εἶπεν πρὸς ζεβουλ ἰδοὺ λαὸς καταβαίνων ἀπὸ τῶν κορυφῶν τῶν ὀρέων και εἶπεν πρὸς αὐτὸν ζεβουλ τὴν σκιάν τῶν ὀρέων σὺ ὀρᾷς ὡς ἄνδρας
- 37 Gaali nisi përsëri të flasë, duke thënë: "Shiko, ka njerëz që zbresin nga majat e lartësive të vendit, dhe një grup tjetër po vjen nga rruga e lisit të shortarëve".  
And Gaal said again, See! people are coming down from the middle of the land, and one band is coming by way of the oak-tree of the Seers.  
kai προσέθετο ἔτι γααλ τοῦ λαλῆσαι και εἶπεν ἰδοὺ λαὸς καταβαίνων κατὰ θάλασσαν ἀπὸ τοῦ ἐχόμενα τοῦ ὀμφαλοῦ τῆς γῆς και ἀρχὴ μία παραγίνεται ἀπὸ ὁδοῦ δρυὸς ἀποβλεπόντων

- 38 Atëherë Zebuli i tha: "Ku e ke kapadaillëkun, kur thojë: "Kush është Abimeleku, pse duhet t'i shërbejmë?". A nuk është ky popull që ti përçmoje? Dil, pra, përpara dhe lufto kundër tij!".  
Then Zebul said to him, Now where is your loud talk when you said, Who is Abimelech that we are to be his servants? Is this not the people whom you were rating so low? Go out now, and make war on them.  
καὶ εἶπεν πρὸς αὐτὸν ζεβουλ ποῦ ἐστὶν νῦν τὸ στόμα σου τὸ λέγον τίς ἐστὶν ἀβιμελεχ ὅτι δουλεύσομεν αὐτῷ οὐκ ἰδοῦ οὗτός ἐστιν ὁ λαὸς ὃν ἐξουδένωσας ἔξελθε νῦν καὶ πολέμει πρὸς αὐτόν
- 39 Atëherë Gaali doli në krye të banorëve të Sikemit dhe i nisi betejën kundër Abimelekut.  
So Gaal went out at the head of the townsmen of Shechem and made war on Abimelech.  
καὶ ἐξῆλθεν γααλ ἀπὸ προσώπου τῶν ἀνδρῶν σικιμων καὶ ἐπολέμησεν ἐν ἀβιμελεχ
- 40 Por Abimeleku e ndoqi dhe ai iku me vrap para tij; shumë njerëz ranë për tokë të plagosur për vdekje deri në hyrje të portës.  
And Abimelech went after him and he went in flight before him; and a great number were falling by the sword all the way up to the town.  
καὶ κατεδίωξεν αὐτὸν ἀβιμελεχ καὶ ἔφυγεν ἀπὸ προσώπου αὐτοῦ καὶ ἔπεσον τραυματῖαι πολλοὶ ἕως θυρῶν τῆς πόλεως
- 41 Abimeleku u ndal pastaj në Arumah, dhe Zebuli dëboi Gaalin dhe vëllezërit e tij, që nuk qëndruan dot më në Sikem.  
Then Abimelech went back to Arumah; and Zebul sent Gaal and his brothers away and would not let them go on living in Shechem.  
καὶ ἐκάθισεν ἀβιμελεχ ἐν ἀρριμα καὶ ἐξέβαλεν ζεβουλ τὸν γααλ καὶ τοὺς ἀδελφοὺς αὐτοῦ τοῦ μὴ οἰκεῖν ἐν σικιμοῖς
- 42 Të nesërmen populli i Sikemit doli nëpër fusha; Abimeleku u informua për këtë.  
Now the day after, the people went out into the fields; and news of it came to Abimelech.  
καὶ ἐγενήθη τῇ ἐπαύριον καὶ ἐξῆλθεν ὁ λαὸς εἰς τὸ πεδῖον καὶ ἀπηγγέλη τῷ ἀβιμελεχ
- 43 Atëherë ai mori njerëzit e tij, i ndau në tre grupe dhe zuri pritë në fusha; kur pa që populli po dilte nga qyteti, ai u hodh kundër tij dhe bëri kërdinë.  
And he took his people, separating them into three bands, and was waiting secretly in the field; and when he saw the people coming out of the town, he went up and made an attack on them.  
καὶ παρέλαβεν τὸν λαὸν καὶ διεῖλεν αὐτὸν τρεῖς ἀρχὰς καὶ ἐνήδρευσεν ἐν αὐτῷ καὶ εἶδεν καὶ ἰδοῦ λαὸς ἐξῆλθεν ἐκ τῆς πόλεως καὶ ἐπανεῖστη αὐτοῖς καὶ ἐπάταξεν αὐτούς
- 44 Pastaj Abimeleku dhe njerëzit që ishin me të u sulën përpara dhe zunë hyrjen e portës së qytetit, kurse dy grupet e tjera u sulën mbi tërë ata që ishin nëpër fusha dhe bënë kërdinë.  
And Abimelech with his band made a rush, and took up their position at the doorway into the town; and the other two bands made a rush on all those who were in the fields, and overcame them.  
καὶ ἀβιμελεχ καὶ αἱ ἀρχαὶ αἱ μετ' αὐτοῦ ἐξετάθησαν καὶ ἔστησαν παρὰ τὴν πύλην τῆς πόλεως καὶ αἱ δύο ἀρχαὶ ἐξεχύθησαν ἐπὶ πάντας τοὺς ἐν τῷ ἀγρῷ καὶ ἐπάταξεν αὐτούς
- 45 Abimeleku e pushtoi me sulm po atë ditë qytetin dhe vrau popullin që gjendej në të; pastaj e sheshoi qytetin dhe aty hodhi kripë.  
And all that day Abimelech was fighting against the town; and he took it, and put to death the people who were in it, and had the town pulled down and covered with salt.  
καὶ ἀβιμελεχ ἐπολέμει ἐν τῇ πόλει ὅλην τὴν ἡμέραν ἐκείνην καὶ κατελάβοντο τὴν πόλιν καὶ τὸν λαὸν τὸν ἐν αὐτῇ ἀνείλεν καὶ τὴν πόλιν καθείλεν καὶ ἔσπειρεν αὐτὴν ἅλας
- 46 Kur të gjithë banorët e kalasë së Sikemit dëgjuan këtë ngjarje, u tërhoqën në kullën kryesore të tempullit të perëndisë Berith.  
Then all the townsmen of the tower of Shechem, hearing of it, went into the inner room of the house of El-berith.  
καὶ ἤκουσαν πάντες οἱ ἄνδρες πύργου σικιμων καὶ εἰσῆλθον εἰς τὸ ὄχυρῶμα οἴκου τοῦ βααλ διαθήκης
- 47 Kështu i thanë Abimelekut që tërë banorët e kalasë së Sikemit ishin mbledhur bashkë.  
And word was given to Abimelech that all the men of the tower of Shechem were there together.  
καὶ ἀπηγγέλη τῷ ἀβιμελεχ ὅτι συνήχθησαν πάντες οἱ ἄνδρες τοῦ πύργου σικιμων
- 48 Atëherë Abimeleku u ngjiti në malin Tsalmon, ai vetë bashkë me njerëzit e tij; pastaj Abimeleku kapi një sëpatë, preu degën e një druri, e ngriti dhe e vuri mbi shpatullat e tij; padstaj u tha njerëzve që ishin me të: "Atë që patë që unë bëra, bëjeni shpejt edhe ju!".  
Then Abimelech went up to Mount Zalmon, with all his people; and Abimelech took an axe in his hand and, cutting down branches of trees, took them and put them on his back. And he said to the people who were with him, Be quick and do as you have seen me do.  
καὶ ἀνέβη ἀβιμελεχ εἰς ὄρος σελμων αὐτὸς καὶ πᾶς ὁ λαὸς ὁ μετ' αὐτοῦ καὶ ἔλαβεν ἀβιμελεχ ἄξινην ἐν τῇ χειρὶ αὐτοῦ καὶ ἔκοψεν φορτίον ξύλων καὶ ἔλαβεν αὐτὸ καὶ ἐπέθηκεν ἐπὶ τοὺς ὄμους αὐτοῦ καὶ αἱ εἶπεν πρὸς τὸν λαὸν ὅρος μετ' αὐτοῦ τί εἶδετέ με ποιῶντα ταχέως ποιήσατε ὡς καὶ ἐγώ
- 49 Kështu secili prej tyre preu një degë dhe shkoi pas Abimeleku; i vendosën degët përballë kullës kryesore dhe e dogjën atë. Kështu gjetën vdekjen gjithë njerëzit e kalasë së Sikemit, pothuajse një mijë veta, gra e burra.  
So all the people got branches, every man cutting down a branch, and they went with Abimelech at their head and, massing the branches against the inner room, put fire to the room over them; so all those who were in the tower of Shechem, about a thousand men and women, were burned to death with it.  
καὶ ἔκοψαν καὶ αὐτοὶ ἕκαστος φορτίον καὶ ἦραν καὶ ἐπορεύθησαν ὀπίσω ἀβιμελεχ καὶ ἐπέθηκαν ἐπὶ τὸ ὄχυρῶμα καὶ ἐνέπρησαν ἐπ' αὐτούς τὸ ὄχυρῶμα ἐν πυρὶ καὶ ἀπέθανον πάντες οἱ ἄνδρες πύργου σικιμων ὥσει χίλιοι ἄνδρες καὶ γυναῖκες

- 50 Pastaj Abimeleku shkoi në Thebets, e rrethoi dhe e pushtoi.  
Then Abimelech went to Thebez, and put his army in position against Thebez and took it.  
καὶ ἐπορεύθη ἀβιμελεχ εἰς θεβες καὶ περιεκάθισεν ἐπ' αὐτήν καὶ προκατέλαβετο αὐτήν
- 51 Në mes të qytetit kishte një kullë të fortifikuar, ku ishin strehuar tërë njerëzit e qytetit, gra e burra; u mbyllën brenda dhe hipën mbi çatinë e kullës.  
But in the middle of the town there was a strong tower, to which all the men and women of the town went in flight and, shutting themselves in, went up to the roof of the tower.  
καὶ πύργος ἦν ὄχυρός ἐν μέσῳ τῆς πόλεως καὶ ἔφυγον ἐκεῖ πάντες οἱ ἄνδρες καὶ αἱ γυναῖκες καὶ πάντες οἱ ἠγοούμενοι τῆς πόλεως καὶ ἀπέκλεισαν ἐφ' ἑαυτοὺς καὶ ἀνέβησαν ἐπὶ τὸ δῶμα τοῦ πύργου
- 52 Kështu Abimeleku arriti në këmbët e kalasë dhe e sulmoi; iu afrua pastaj portës së kalasë për t'i vënë flakën.  
And Abimelech came to the tower and made an attack on it, and got near to the door of the tower for the purpose of firing it.  
καὶ ἦλθεν ἀβιμελεχ ἕως τοῦ πύργου καὶ ἐξεπολέμησαν αὐτόν καὶ ἤγγισεν ἀβιμελεχ ἕως τῆς θύρας τοῦ πύργου ἐμπρήσαι αὐτόν ἐν πυρὶ
- 53 Por një grua hodhi poshtë pjesën e sipërme të një mokre mbi kokën e Abimelekut dhe i theu kafkën.  
But a certain woman sent a great stone, such as is used for crushing grain, on to the head of Abimelech, cracking the bone.  
καὶ ἔρριψεν γυνὴ μία κλάσμα μύλου ἐπὶ τὴν κεφαλὴν ἀβιμελεχ καὶ συνέθλασεν τὸ κρανίον αὐτοῦ
- 54 Ai thirri menjëherë të riun që i mbante armët dhe i tha: &quot;Nxirre shpatën dhe më vrit, që të mos thonë: &quot;E vrau një grua!&quot;&quot;. Kështu i riu e shpoi tejmbanë dhe ai vdiq.  
Then quickly crying out to his body-servant, he said to him, Take out your sword and put an end to me straight away, so that men may not say of me, His death was the work of a woman. So the young man put his sword through him, causing his death.  
καὶ ἐβόησεν τὸ τάχος πρὸς τὸ παιδάριον τὸν αἰρόντα τὰ σκευὴ αὐτοῦ καὶ εἶπεν αὐτῷ σπάσαι τὴν μάχαιράν σου καὶ θανάτωσόν με μήποτε εἴπωσιν γυνὴ ἀπέκτεινεν αὐτόν καὶ ἐξεκέντησεν αὐτόν τὸ παιδάριον αὐτοῦ καὶ ἀπέθανεν ἀβιμελεχ
- 55 Kur Izraelitët panë që Abimeleku kishte vdekur, secili u kthye në shtëpinë e tij.  
And when the men of Israel saw that Abimelech was dead, they went away, every man to his place.  
καὶ εἶδεν ἄνθρωποι ἰσραηλ ὅτι ἀπέθανεν ἀβιμελεχ καὶ ἀπῆλθον ἄνθρωποι εἰς τὸν τόπον αὐτοῦ
- 56 Kështu Perëndia ia shkarkoi Abimelekut të keqen që kishte bërë kundër atit të tij, duke vrarë shtatëdhjetë vëllezërit e tij.  
In this way Abimelech was rewarded by God for the evil he had done to his father in putting his seventy brothers to death;  
καὶ ἀπέστρεψεν ὁ θεὸς τὴν κακίαν ἀβιμελεχ ἣν ἐποίησεν τῷ πατρὶ αὐτοῦ ἀποκτεῖναι τοὺς ἑβδομήκοντα ἀδελφοὺς αὐτοῦ
- 57 Perëndia bëri që të binte mbi kokën e njerëzve të Sikemit tërë e keqja e bërë; kështu kundër tyre u realizua mallkimi i Jothamit, birit të Jerubaalit.  
And God sent back on to the heads of the men of Shechem all the evil they had done, and the curse of Jotham, the son of Jerubbaal, came on them.  
καὶ πᾶσαν κακίαν ἀνδρῶν σικμων ἐπέστρεψεν ὁ θεὸς εἰς τὴν κεφαλὴν αὐτῶν καὶ ἐπῆλθεν ἐπ' αὐτοὺς ἡ κατάρα ἰωαθαμ τοῦ υἱοῦ ἱεροβααλ
- 1 Pas Abimelekut doli për të shpëtuar Izraelin, Tola, bir i Puahut, biri i Dodit, njeri i Isakarit. Ai banonte në Shamir, në krahinën malore të Efraimit;  
Now after Abimelech, Tola, the son of Puah, the son of Dodo, a man of Issachar, became the saviour of Israel; he was living in Shamir in the hill-country of Ephraim.  
καὶ ἀνέστη μετὰ ἀβιμελεχ τοῦ σῶσαι τὸν ἰσραηλ. θωλα υἱὸς φουα υἱὸς πατραδέλφου αὐτοῦ ἄνθρωπος ἰσσαχαρ καὶ αὐτὸς κατοῖκεν ἐν σαμαρείᾳ ἐν ὄρει εφραϊμ
- 2 qe gjyqtar i Izraelit për njëzet e tre vjet me radhë; pastaj vdiq dhe e varrosën në Shamir.  
He was judge over Israel for twenty-three years; and at his death his body was put to rest in the earth in Shamir.  
καὶ ἔκρινεν τὸν ἰσραηλ εἴκοσι καὶ τρία ἔτη καὶ ἀπέθανεν καὶ ἐτάφη ἐν σαμαρείᾳ
- 3 Mbas tij doli Jairi, Galaaditi, që qe gjyqtar i Izraelit njëzet e dy vjet me radhë.  
And after him came Jair the Gileadite, who was judge over Israel for twenty-two years.  
καὶ ἀνέστη μετ' αὐτὸν ἰαῖρ ὁ γαλααδίτης καὶ ἔκρινεν τὸν ἰσραηλ εἴκοσι καὶ δύο ἔτη
- 4 Ai kishte tridhjetë bij që u hipnin tridhjetë gomaricave dhe kishin tridhjetë qytete, që quhen edhe sot fshatrat e Jairit dhe ndodhen në vendin e Galaadit.  
And he had thirty sons, who went on thirty young asses; and they had thirty towns in the land of Gilead, which are named Havvoth-Jair to this day.  
καὶ ἐγένοντο αὐτῷ τριάκοντα καὶ δύο υἱοὶ ἐπιβεβηκότες ἐπὶ τριάκοντα καὶ δύο πόλους καὶ τριάκοντα καὶ δύο πόλεις αὐτοῖς καὶ ἐκάλεσεν αὐτὰς ἐπαύλεις ἰαῖρ ἕως τῆς ἡμέρας ταύτης αἱ εἰσιν ἐν τῇ γῆ γαλααδ
- 5 Pastaj Jairi vdiq dhe u varros në Kamon.  
And at the death of Jair his body was put to rest in the earth in Kamon.  
καὶ ἀπέθανεν ἰαῖρ καὶ ἐτάφη ἐν ραμμω

- 6 Pastaj bijtë e Izraelit filluan përsëri të bëjnë atë që është e keqe për sytë e Zotit dhe u shërbyen Baalit dhe Ashtarothit, perëndive të Sirisë, perëndive të Sidonit, perëndive të Moabit, perëndive  
And again the children of Israel did evil in the eyes of the Lord, worshipping the Baals and Astartes, and the gods of Aram and the gods of Zidon and the gods of Moab and the gods of the children of Ammon and the gods of the Philistines; they gave up the Lord and were servants to him no longer.  
kai προσέθευτο οί υιοί ισραηλ ποιήσαι τὸ πονηρὸν ἐναντι κυρίου και ἐλάτρευσαν ταίς βααλιμ και ταίς ασταρωθ και τοίς θεοίς σιδῶνος και τοίς θεοίς μοαβ και τοίς θεοίς υιών αμμων και τοίς θεοίς τῶν ἀλλοφύλων και ἐγκατέλιπον τὸν κύριον και οὐκ ἐδούλευσαν αὐτῷ
- 7 Kështu zemërimi i Zotit kundër Izraelit u ndez dhe ai i dorëzoi në duart e Filistejve dhe në duart e bijve të Amonit.  
And the wrath of the Lord was burning against Israel, and he gave them up into the hands of the Philistines and into the hands of the children of Ammon.  
kai ἐθυμώθη ὄργῃ κύριος ἐν τῷ ισραηλ και ἀπέδοτο αὐτούς ἐν χειρὶ ἀλλοφύλων και ἐν χειρὶ υιών αμμων
- 8 Atë vit ata u ranë më qafë dhe shtypën bijtë e Izraelit; gjatë tetëmbëdhjetë vjetve me radhë ata shtypën tërë bijtë e Izraelit që ndodheshin matanë Jordanit, në vendin e Amorejve, në Galaad.  
And that year the children of Israel were crushed under their yoke; for eighteen years all the children of Israel on the other side of Jordan, in the land of the Amorites which is in Gilead, were cruelly crushed down.  
kai ἐσάθρωσαν και ἐθλασαν τοὺς υιούς ισραηλ ἐν τῷ ἐνιαυτῷ ἐκεῖνῳ ὀκτωκαίδεκα ἔτη πάντας τοὺς υιούς ισραηλ ἐν τῷ πέραν τοῦ ιορδάνου ἐν τῇ γῆ τοῦ αμορραίου ἐν τῇ γαλααδίτιδι
- 9 Pastaj bijtë e Amonit kaluan Jordanin për të luftuar edhe kundër Judës, kundër Beniaminit dhe kundër shtëpisë së Efraimit; dhe Izraeli u ndodh në një situatë shumë fatkeqe.  
And the children of Ammon went over Jordan, to make war against Judah and Benjamin and the house of Ephraim; and Israel was in great trouble.  
kai διεβησαν οί υιοί αμμων τὸν ιορδάνην ἐκπολεμήσαι και ἐν τῷ ιουδα και βενιαμιν και ἐν τῷ οἴκῳ εφραιμ και ἐθλίβησαν οί υιοί ισραηλ σφόδρα
- 10 Atëherë bijtë e Izraelit i klithën Zotit, duke i thënë: "Kemi mëkatuar ndaj teje, sepse kemi braktisur Perëndinë tonë dhe i kemi shërbyer Baalit".  
Then the children of Israel, crying out to the Lord, said, Great is our sin against you, for we have given up our God and have been servants to the Baals.  
kai ἐκέκραζαν οί υιοί ισραηλ πρὸς κύριον λέγοντες ἡμάρτομέν σοι ὅτι ἐγκατελίπομεν τὸν θεὸν ἡμῶν και ἐλάτρευσαμεν ταίς βααλιμ
- 11 Zoti u tha bijve të Izraelit: "A nuk ju çlirova unë nga Egjiptasit, nga Amorejtë, nga bijtë e Amonit dhe nga Filistejtë?  
And the Lord said to the children of Israel, Were not the Egyptians and the Amorites and the children of Ammon and the Philistines  
kai εἶπεν κύριος πρὸς τοὺς υιούς ισραηλ οὐχὶ οί αἰγύπτιοι και οί αμορραῖοι και οί υιοί αμμων και μοαβ και οί ἀλλόφυλοι
- 12 Kur ata të Sidonit, Amalekitët dhe Maonitët ju shtypnin dhe ju bëtë thirrje, a nuk ju çlirova nga duart e tyre?  
And the Zidonians and Amalek and Midian crushing you down, and in answer to your cry did I not give you salvation from their hands?  
kai σιδῶνιοι και μαδιαμ και αμαληκ ἐξέθλιψαν ὑμᾶς και ἐκεκράζατε πρὸς με και ἔσωσα ὑμᾶς ἐκ χειρὸς αὐτῶν
- 13 Megjithatë ju më braktisët dhe u vutë në shërbim të perëndive të tjera; prandaj unë nuk do t'ju çliroj më.  
But, for all this, you have given me up and have been servants to other gods: so I will be your saviour no longer.  
kai ὑμεῖς ἐγκατελίπετέ με και ἐλατρεύσατε θεοὶς ἐτέροις διὰ τοῦτο οὐ προσθήσω τοῦ σώσαι ὑμᾶς
- 14 Shkoni, pra, t'u thërrisni perëndive që keni zgjedhur; le t'ju shpëtojnë ato në kohën e fatkeqësive tuaja!"  
Go, send up your cry for help to the gods of your selection; let them be your saviours in the time of your trouble.  
βαδίζετε και βοᾶτε πρὸς τοὺς θεοὺς οὓς ἐξελέξασθε ἑαυτοὺς και αὐτοὶ σωσάτωσαν ὑμᾶς ἐν καιρῷ θλίψεως ὑμῶν
- 15 Bijtë e Izraelit i thanë Zotit: "Kemi mëkatuar; bëna çfarë të duash, por na çliro sot, të lutemi shumë".  
And the children of Israel said to the Lord, We are sinners; do to us whatever seems good to you: only give us salvation this day.  
kai εἶπαν οί υιοί ισραηλ πρὸς κύριον ἡμάρτομεν ποιήσον σὺ ἡμῖν κατὰ πάντα ὅσα ἂν ἀρέσκη ἐνώπιόν σου πλην κύριε ἐξελοῦ ἡμᾶς ἐν τῇ ἡμέρᾳ ταύτῃ
- 16 Atëherë hoqën nga mjedisi i tyre perënditë e huaja dhe i shërbyen Zotit që u trishtua për vuajtjet e Izraelit.  
So they put away the strange gods from among them, and became the Lord's servants; and his soul was angry because of the sorrows of Israel.  
kai μετέστησαν τοὺς θεοὺς τοὺς ἀλλοτρίους ἐκ μέσου αὐτῶν και ἐλάτρευσαν τῷ κυρίῳ και οὐκ εὐηρέστησεν ἐν τῷ λαῷ και ὠλιγοψύχησεν ἐν τῷ κόπῳ ισραηλ
- 17 Pastaj bijtë e Amonit u mblodhën dhe ngritën kampin e tyre në Galaad dhe bijtë e Izraelit u mblodhën dhe ngritën kampin e tyre në Mitspah.  
Then the children of Ammon came together and put their army in position in Gilead. And the children of Israel came together and put their army in position in Mizpah.  
kai ἀνήβησαν οί υιοί αμμων και παρενέβαλον ἐν γαλααδ και ἐξῆλθον οί υιοί ισραηλ και παρενέβαλον ἐν τῇ μασσηφα
- 18 Populli, domethënë princat e Galaadit i thanë njeri tjetrit: "Kush do të jetë njeriu që do të fillojë të luftojë kundër bijve të Amonit? Ai do të jetë kreu i të gjithë banorëve të Galaadit".  
And the people of Israel said to one another, Who will be the first to make an attack on the children of Ammon? We will make him head over all Gilead.  
kai εἶπον οί ἄρχοντες τοῦ λαοῦ γαλααδ ἀνὴρ πρὸς τὸν πλησίον αὐτοῦ τίς ἀνήρ ὃς ἄρξεται πολεμήσαι ἐν τοῖς υιοῖς αμμων και ἔσται εἰς κεφαλὴν πᾶσιν τοῖς κατοικοῦσιν γαλααδ

- 1** Jefteu, Galaaditi, ishte një njeri i fortë dhe trim, bir i një prostitute dhe i Galaadit.  
*Now Jephthah the Gileadite was a great man of war; he was the son of a loose woman, and Gilead was his father.*  
*καὶ ἰεφθαε ὁ γαλααδίτης δυνατὸς ἐν ἰσχύι καὶ αὐτὸς ἦν υἱὸς γυναικὸς πόρνης καὶ ἔτεκεν τῷ γαλααδ τὸν ἰεφθαε*
- 2** Bashkëshortja e Galaadit i lindi bij të tjerë; kur bijtë e gruas së tij arritën në moshën madhore, ata e dëbuan Jefteun dhe i thanë: "Ti nuk do të kesh trashëgimi në shtëpinë e atit tonë, sepse je biri i një gruaje tjetër".  
*And Gilead's wife gave birth to sons, and when her sons became men, they sent Jephthah away, saying, You have no part in the heritage of our father's house, for you are the son of another woman.*  
*καὶ ἔτεκεν ἡ γυνὴ γαλααδ αὐτῷ υἱούς καὶ ἠδρύνθησαν οἱ υἱοὶ τῆς γυναικὸς καὶ ἐξέβαλον τὸν ἰεφθαε καὶ εἶπον αὐτῷ οὐ κληρονομήσεις ἐν τῷ οἴκῳ τοῦ πατρὸς ἡμῶν ὅτι γυναικὸς υἱὸς ἐταίρας εἶ σύ*
- 3** Atëherë Jefteu iku larg vëllezërve të tij dhe u vendos në vendin e Tobit. Rreth Jefteu u mblodhën njerëz pa asnjë vlerë, që kryenin sulme bashkë me të.  
*So Jephthah went in flight from his brothers and was living in the land of Tob, where a number of good-for-nothing men, joining Jephthah, went out with him on his undertakings.*  
*καὶ ἀπέδρα ἰεφθαε ἐκ προσώπου τῶν ἀδελφῶν αὐτοῦ καὶ κατέκησεν ἐν γῆ τοῦβ καὶ συνελέγοντο πρὸς τὸν ἰεφθαε ἄνδρες λιτοὶ καὶ συνεξεπορεύοντο μετ' αὐτοῦ*
- 4** Pas një farë kohe bijtë e Amonit i shpallën luftë Izraelit.  
*Now after a time the children of Ammon made war against Israel.*  
*καὶ ἐγένετο μεθ' ἡμέρας καὶ ἐπολέμησαν οἱ υἱοὶ αμμων μετὰ ἰσραηλ*
- 5** Kur bijtë e Amonit filluan luftën kundër Izraelit, pleqtë e Galaadit shkuan ta kërkojnë Jefteun në vendin e Tobit;  
*And when the children of Ammon made war against Israel, the responsible men of Gilead went to get Jephthah back from the land of Tob;*  
*καὶ ἐγενήθη ἠνίκα ἐπολέμουν οἱ υἱοὶ αμμων μετὰ ἰσραηλ καὶ ἐπορεύθησαν οἱ πρεσβύτεροι γαλααδ παραλαβεῖν τὸν ἰεφθαε ἐν γῆ τοῦβ*
- 6** dhe i thanë Jefteut: "Eja me ne dhe bëhu kapidani ynë, për të luftuar kundër bijve të Amonit".  
*And they said to Jephthah, Come and be our chief so that we may make war against the children of Ammon.*  
*καὶ εἶπαν πρὸς ἰεφθαε δεῦρο καὶ ἔση ἡμῖν εἰς ἡγούμενον καὶ πολεμήσομεν ἐν τοῖς υἱοῖς αμμων*
- 7** Por Jefteu iu përgjegj pleqve të Galaadit duke thënë: "A nuk më keni urryer dhe dëbuar nga shtëpia e atit tim? Pse vini tani tek unë kur jini keq?"  
*But Jephthah said to the responsible men of Gilead, Did you not, in your hate for me, send me away from my father's house? Why do you come to me now when you are in trouble?*  
*καὶ εἶπεν ἰεφθαε τοῖς πρεσβυτέροις γαλααδ οὐχ ὑμεῖς ἐμισήσατέ με καὶ ἐξεβάλατέ με ἐκ τοῦ οἴκου τοῦ πατρὸς μου καὶ ἐξαπεστείλατέ με ἀφ' ὑμῶν καὶ τί ὅτι ἤλθατε πρὸς με ἠνίκα ἐθλίβητε*
- 8** Pleqtë e Galaadit i thanë Jefteut: "Pikërisht për këtë jemi kthyer tani te ti, me qëllim që ti të vish me ne për të luftuar kundër bijve të Amonit, dhe të vihesh në krye të gjithë banorëve të Galaadit".  
- 15 Në Jeruzalem specialistët i ndërtuan gjithashtu disa makina të cilat ai i vendosi mbi kullat dhe në qoshet, për të hedhur shigjeta dhe gurë të mëdhenj. Fama e tij u përhap larg, sepse u ndihmua në mënyrë të mrekullueshme deri sa u bë i fuqishëm.  
And in Jerusalem he made machines, the invention of expert men, to be placed on the towers and angles of the walls for sending arrows and great stones. And his name was honoured far and wide; for he was greatly helped till he was strong.  
καὶ ἐποίησεν ἐν ἱερουσαλὴμ μηχανὰς μεμηχανευμένας λογιστοῦ τοῦ εἶναι ἐπὶ τῶν πύργων καὶ ἐπὶ τῶν γωνιῶν βάλλειν βέλεισιν καὶ λίθοις μεγάλοις καὶ ἠκούσθη ἡ κατασκευὴ αὐτῶν ἕως πόρρω ὅτι ἔθαυμαστώθη τοῦ βοηθηθῆναι ἕως οὗ κατίσχυσεν
- 16 Por, mbasi u bë i fuqishëm, zemra e tij u bë krenare aq sa u korruptua dhe ai mëkatoi kundër Zotit, duke hyrë në tempullin e Zotit për të djegur temjan në altarin e temjanit.  
But when he had become strong, his heart was lifted up in pride, causing his destruction; and he did evil against the Lord his God; for he went into the Temple of the Lord for the purpose of burning perfumes on the altar of perfumes.  
καὶ ὡς κατίσχυσεν ὑψώθη ἡ καρδία αὐτοῦ τοῦ καταφθεῖραι καὶ ἠδίκησεν ἐν κυρίῳ θεῷ αὐτοῦ καὶ εἰσήλθεν εἰς τὸν ναὸν κυρίου θυμιάσαι ἐπὶ τὸ θυσιαστήριον τῶν θυμιαμάτων
- 17 Pas tij hyri prifti Azariah me tetëdhjetë priftërinj të Zotit, njerëz trima.  
And Azariah the priest went in after him, with eighty of the Lord's priests, who were strong men;  
καὶ εἰσήλθεν ὀπίσω αὐτοῦ αζαριας ὁ ἱερεὺς καὶ μετ' αὐτοῦ ἱερεῖς τοῦ κυρίου ὀγδοήκοντα υἱοὶ δυνατοὶ
- 18 Ata iu kundërvunë mbretit Uziah dhe i thanë: "Nuk të takon ty, o Uziah, t'i ofrosh temjan Zotit, por priftërinjve, bijve të Aaronit, që janë shenjtëruar për të ofruar temjan. Dil nga vendi i shenjtë, sepse ke kryer mëkat! Kjo nuk do të sjellë asnjë nder nga ana e Zotit Perëndi".  
And they made protests to Uzziah the king, and said to him, The burning of perfumes, Uzziah, is not your business but that of the priests, the sons of Aaron, who have been made holy for this work: go out of the holy place, for you have done wrong, and it will not be to your honour before God.  
καὶ ἔστησαν ἐπὶ οὐρανὸν τὸν βασιλεῖα καὶ εἶπαν αὐτῷ οὐ σοὶ οὐκ ἔστιν ἔργον ἡγιασμένων θυμιάσαι τῷ κυρίῳ ἀλλ' ἡ τοῖς ἱερεῦσιν υἱοῖς ααρὼν τοῖς ἡγιασμένοις θυμιάσαι ἐξελθε ἐκ τοῦ ἁγιάσματος ὅτι ἀπέστης ἀπὸ κυρίου καὶ οὐκ ἔσται σοι τοῦτο εἰς δόξαν παρὰ κυρίου θεοῦ
- 19 Atëherë Uziahu, që kishte në dorë një temjanisë për të ofruar temjanin, u zemërua; por ndërsa po u hakërruhej priftërinjve, mbi ballin e tij shpërtheu lebra, përpara priftërinjve, në shtëpinë e Zotit, pranë altarit të temjanit.  
Then Uzziah was angry; and he had in his hand a vessel for burning perfume; and while his wrath was bitter against the priests, the mark of the leper's disease came out on his brow, before the eyes of the priests in the house of the Lord by the altar of perfumes.  
καὶ ἐθυμώθη οὐκ ἔστιν ἐν τῇ χειρὶ αὐτοῦ τὸ θυμιατήριον τοῦ θυμιάσαι ἐν τῷ ναῷ καὶ ἐν τῷ θυμωθῆναι αὐτὸν πρὸς τοὺς ἱερεῖς καὶ ἡ λέπρα ἀνέτειλεν ἐν τῷ μετώπῳ αὐτοῦ ἐναντίον τῶν ἱερέων ἐν οἴκῳ κυρίου ἐπάνω τοῦ θυσιαστηρίου τῶν θυμιαμάτων
- 20 Kryeprifti Azariah dhe tërë priftërinjtë e tjerë u kthyen ndaj tij, dhe ja, mbi ballin e tij dukeshin shenjat e lebrës. Kështu e nxorën me të shpejtë dhe ai vetë nxitoi të dalë sepse Zoti e kishte goditur.  
And Azariah, the chief priest, and all the priests, looking at him, saw the mark of the leper on his brow, and they sent him out quickly and he himself went out straight away, for the Lord's punishment had come on him.  
καὶ ἐπέστρεψεν ἐπ' αὐτὸν ὁ ἱερεὺς ὁ πρῶτος καὶ οἱ ἱερεῖς καὶ ἰδοὺ αὐτὸς λεπρὸς ἐν τῷ μετώπῳ καὶ κατέσπευσαν αὐτὸν ἐκεῖθεν καὶ γὰρ αὐτὸς ἔσπευσεν ἐξελεῖν ὅτι ἠλεγξεν αὐτὸν κύριος
- 21 Mbreti Uziah mbeti lebroz deri ditën e vdekjes së tij dhe banoi në një shtëpi të izoluar, sepse ishte lebroz dhe ishte përjashtuar nga shtëpia e Zotit; dhe i biri Jotham ishte kryeintendenti i pallatit mbretëror dhe administronte drejtësinë e popullit të vendit.  
So King Uzziah was a leper till the day of his death, living separately in his private house; for he was cut off from the house of God; and Jotham his son was ruling over his house, judging the people of the land.  
καὶ ἦν οὐκ ἔστιν ὁ βασιλεὺς λεπρὸς ἕως ἡμέρας τῆς τελευτῆς αὐτοῦ καὶ ἐν οἴκῳ ἀφουσῶθ ἐκάθητο λεπρὸς ὅτι ἀπεσχίσθη ἀπὸ οἴκου κυρίου καὶ ἰωθαμ ὁ υἱὸς αὐτοῦ ἐπὶ τῆς βασιλείας αὐτοῦ κρίνων τὸν λαὸν τῆς γῆς
- 22 Pjesa tjetër e bëmave të Uziahut, nga të parat deri në të fundit, janë shkruar nga profeti Isaia, bir i Amosit.  
Now the rest of the acts of Uzziah, first and last, were recorded by Isaiah the prophet, the son of Amoz.  
καὶ οἱ λοιποὶ λόγοι οὐκ ἔστιν οἱ πρῶτοι καὶ οἱ ἔσχατοι γεγραμμένοι ὑπὸ ἱεσοῦ τοῦ προφήτου

- 23 Kështu Uziahu pushoi bashkë me etërit e tij dhe e varrosën bashkë me etërit e tij në fushën e varrimit që u takonte mbretërve, sepse thuhej: "E ka zënë lebra". Në vend të tij mbretëroi i biri, Jothami.  
So Uzziah went to rest with his fathers; and they put his body into the earth in the field used for the resting-place of the kings, for they said, He is a leper: and Jotham his son became king in his place.  
καὶ ἐκοιμήθη οὐκίας μετὰ τῶν πατέρων αὐτοῦ καὶ ἔθαψαν αὐτὸν μετὰ τῶν πατέρων αὐτοῦ ἐν τῷ πεδίῳ τῆς ταφῆς τῶν βασιλέων ὅτι εἶπαν ὅτι λεπρός ἐστὶν καὶ ἐβασίλευσεν ἰωθαμὶ υἱὸς αὐτοῦ ἀντ' αὐτὸν
- 1 Jothami ishte njëzet e pesë vjeç kur filloi të mbretërojë dhe mbretëroi gjashtëmbëdhjetë vjet në Jeruzalem. E ëma quhej Jerushah; ishte bija e Tsadokut.  
Jotham was twenty-five years old when he became king; and he was ruling in Jerusalem for sixteen years; and his mother's name was Jerushah, the daughter of Zadok.  
υἱὸς εἴκοσι πέντε ἐτῶν ἰωθαμὶ ἐν τῷ βασιλευσάσῃ αὐτὸν καὶ δέκα ἕξ ἔτη ἐβασίλευσεν ἐν ἱερουσαλὴμ καὶ ὄνομα τῆς μητρὸς αὐτοῦ ἱερουσα θυγάτηρ σαδοκ
- 2 Ai bëri atë që është e drejtë në sytë e Zotit, pikërisht ashtu si kishte vepruar i ati, Uziahu; (megjithëse nuk hyri në tempullin e Zotit), por populli i tij vazhdonte të korruptohej.  
He did what was right in the eyes of the Lord, as his father Uzziah had done; but he did not go into the Temple of the Lord. And the people still went on in their evil ways.  
καὶ ἐποίησεν τὸ εὐθὲς ἐνώπιον κυρίου κατὰ πάντα ὅσα ἐποίησεν οὐκίας ὁ πατὴρ αὐτοῦ ἀλλ' οὐκ εἰσῆλθεν εἰς τὸν ναὸν κυρίου καὶ ἔτι ὁ λαὸς κατεφθείρετο
- 3 Ai ndërtoi portën e sipërme të shtëpisë së Zotit dhe bëri shumë punime në muret e Ofelit.  
He put up the higher doorway of the house of the Lord, and did much building on the wall of the Ophel.  
αὐτὸς ἠκοδόμησεν τὴν πύλην οἴκου κυρίου τὴν ὑψηλὴν καὶ ἐν τείχει τοῦ οφλα ἠκοδόμησεν πολλὰ
- 4 Përveç kësaj ndërtoi qytete në krahinën malore të Judës dhe kala dhe kulla ndër pyje.  
In addition, he made towns in the hill-country of Judah, and strong buildings and towers in the woodlands.  
καὶ πόλεις ἠκοδόμησεν ἐν ὄρει ἰουδα καὶ ἐν τοῖς ὄρεσιν καὶ οἰκίσεις καὶ πύργους
- 5 I shpalli gjithashtu luftë mbretit të bijve të Amonit dhe i mundi ata. Bijtë e Amonit i dhanë atë vit njëqind talenta argjendi, dhjetë mijë kore gruri dhe dhjetë mijë elbi. Po kjo sasi iu dorëzua nga bijtë e Amonit vitin e dytë dhe të tretë.  
He went to war with the king of the children of Ammon and overcame them. That year, the children of Ammon gave him a hundred talents of silver, and ten thousand measures of grain and ten thousand measures of barley. And the children of Ammon gave him the same amount the second year and the third.  
αὐτὸς ἐμαχέσατο πρὸς βασιλέα υἱῶν αμμων καὶ κατίσχυσεν ἐπ' αὐτὸν καὶ ἐδίδον αὐτῷ οἱ υἱοὶ αμμων κατ' ἐνιαυτὸν ἑκατὸν τάλαντα ἀργυρίου καὶ δέκα χιλιάδας κόρων πυροῦ καὶ κριθῶν δέκα χιλιάδας ταῦτα ἔφερον αὐτῷ βασιλεὺς αμμων κατ' ἐνιαυτὸν ἐν τῷ πρώτῳ ἔτει καὶ τῷ δευτέρῳ καὶ τῷ τρίτῳ
- 6 Kështu Jothami u bë i fuqishëm, sepse rregulloi ecjen e tij përpara Zotit, Perëndisë të tij.  
So Jotham became strong, because in all his ways he made the Lord his guide.  
καὶ κατίσχυσεν ἰωθαμὶ ὅτι ἠτοίμασεν τὰς ὁδοὺς αὐτοῦ ἐναντι κυρίου θεοῦ αὐτοῦ
- 7 Pjesa tjetër e bëmave të Jothamit, tërë luftërat dhe ndërmarrjet e tij janë shkruar në librin e mbretërve të Izraelit dhe të Judës.  
Now the rest of the acts of Jotham, and all his wars and his ways, are recorded in the book of the kings of Israel and Judah.  
καὶ οἱ λοιποὶ λόγοι ἰωθαμὶ καὶ ὁ πόλεμος καὶ αἱ πράξεις αὐτοῦ ἰδοὺ γεγραμμένοι ἐπὶ βιβλίῳ βασιλέων ἰουδα καὶ ἰσραηλ
- 9 Pastaj Jothamin pushoi bashkë me etërit e tij dhe e varrosën në qytetin e Davidit. Në vend të tij mbretëroi i biri, Ashazi.  
And Jotham went to rest with his fathers, and they put his body into the earth in the town of David; and Ahaz his son became king in his place.  
καὶ ἐκοιμήθη ἰωθαμὶ μετὰ τῶν πατέρων αὐτοῦ καὶ ἐτάφη ἐν πόλει δαυὶδ καὶ ἐβασίλευσεν ἀχαζ υἱὸς αὐτοῦ ἀντ' αὐτοῦ
- 1 Ashazi ishte njëzet vjeç kur filloi të mbretërojë, dhe mbretëroi gjashtëmbëdhjetë vjet në Jeruzalem. Ai nuk bëri atë që është e drejtë në sytë e Zotit, siç kishte bërë Davidi, i ati;  
Ahaz was twenty years old when he became king, and he was ruling in Jerusalem for sixteen years; he did not do what was right in the eyes of the Lord, like David his father:  
υἱὸς εἴκοσι ἐτῶν ἀχαζ ἐν τῷ βασιλευσάσῃ αὐτὸν καὶ δέκα ἕξ ἔτη ἐβασίλευσεν ἐν ἱερουσαλὴμ καὶ οὐκ ἐποίησεν τὸ εὐθὲς ἐνώπιον κυρίου ὡς δαυὶδ ὁ πατὴρ αὐτοῦ
- 2 por ndoqi rrugët e mbretërve të Izraelit, madje bëri shëmbëlltyra prej metali të shkrirë për Baalët.  
But he went in the ways of the kings of Israel and made images of metal for the Baals.  
καὶ ἐπορεύθη κατὰ τὰς ὁδοὺς βασιλέων ἰσραηλ καὶ γὰρ γλυπτὰ ἐποίησεν τοῖς εἰδώλοις αὐτῶν
- 3 Ai dogji temjan në luginën e Birit të Hinomit dhe dogji në zjarr bijtë e tij, duke ndjekur veprimet e neveritshme të kombeve që Zoti kishte dëbuar përpara bijve të Izraelit;  
More than this, he had offerings burned in the valley of the son of Hinnom, and made his children go through fire, copying the disgusting ways of the nations whom the Lord had sent out of the land before the children of Israel.  
καὶ ἔθυσεν ἐν γαιβενονομ καὶ διήγειν τὰ τέκνα αὐτοῦ διὰ πυρὸς κατὰ τὰ βδελύγματα τῶν ἐθνῶν ὧν ἐξωλέθρευσεν κύριος ἀπὸ προσώπου υἱῶν ἰσραηλ

- 4 përveç kësaj bënte fljime dhe dogji temjan mbi vendet e larta, mbi kodrat dhe nën çdo pemë të gjelbëruar.  
And he made offerings and had perfumes burned in the high places and on the hills and under every green tree.  
καὶ ἐθυμία ἐπὶ τῶν ὑψηλῶν καὶ ἐπὶ τῶν ὀρυμμάτων καὶ ὑποκάτω παντὸς ξύλου ἀλωόδου
- 5 Prandaj Zoti, Perëndia i tij, ia dha në dorë mbretit të Sirisë; ky i mundi dhe zuri një numër të madh robërish që i çuan në Damask. U dha gjithashtu në dorë të mbretit të Izraelit, që i shkaktoi një humbje të madhe.  
So the Lord his God gave him up into the hands of the king of Aram; and they overcame him, and took away a great number of his people as prisoners to Damascus. Then he was given into the hands of the king of Israel, who sent great destruction on him.  
καὶ παρέδωκεν αὐτὸν κύριος ὁ θεὸς αὐτοῦ διὰ χειρὸς βασιλέως συρίας καὶ ἐπάταξεν ἐν αὐτῷ καὶ ἠχμαλώτευσεν ἐξ αὐτῶν αἰχμαλωσίαν πολλήν καὶ ἤγαγεν εἰς δαμασκὸν καὶ γὰρ εἰς τὰς χεῖρας βασιλέως ἰσραὴλ παρέδωκεν αὐτὸν καὶ ἐπάταξεν ἐν αὐτῷ πληγὴν μεγάλην
- 6 Në të vërtetë Pekahu, bir i Remaliahut, brenda një dite vrau njëqind e njëzet mijë burra në Judë, tërë trima, sepse kishin braktisur Zotin, Perëndinë e etërve të tyre.  
For Pekah, the son of Remaliah, in one day put to death a hundred and twenty thousand men of Judah, all of them good fighting-men; because they had given up the Lord, the God of their fathers.  
καὶ ἀπέκτεινεν φακας ὁ τοῦ ρομελια βασιλεὺς ἰσραὴλ ἐν ἰουδα ἐν μιᾷ ἡμέρᾳ ἑκατὸν εἰκοσι χιλιάδας ἀνδρῶν δυνατῶν ἰσχύϊ ἐν τῷ αὐτοῦ καταλαίπειν τὸν κύριον θεὸν τῶν πατέρων αὐτῶν
- 7 Zikri, një trim nga Efraimi, vrau Maasejahun, birin e mbretit, Azrikam, prefektin e pallatit, dhe Elkanahun, që zinte vendin e dytë pas mbretit.  
And Zichri, a great fighting-man of Ephraim, put to death Maaseiah, the king's son, and Azrikam, the controller of his house, and Elkanah, who was second in authority to the king.  
καὶ ἀπέκτεινεν εζεκρι ὁ δυνατὸς τοῦ εφραιμ τὸν μαασαιαν τὸν υἱὸν τοῦ βασιλέως καὶ τὸν εσδρικαμ ἡγούμενον τοῦ οἴκου αὐτοῦ καὶ τὸν ελκανα τὸν διάδοχον τοῦ βασιλέως
- 8 Bijtë e Izraelit çuan robër, midis vëllezërve të tyre, dyqind mijë gra, bij dhe bija; u morën atyre edhe një plaçkë të madhe, që e çuan në Samari.  
And the children of Israel took away as prisoners from their brothers, two hundred thousand, women and sons and daughters, and a great store of their goods, and took them to Samaria.  
καὶ ἠχμαλώτισαν οἱ υἱοὶ ἰσραὴλ ἀπὸ τῶν ἀδελφῶν αὐτῶν τριακοσίας χιλιάδας γυναῖκας υἱοὺς καὶ θυγατέρας καὶ σκῦλα πολλὰ ἐσκύλευσαν ἐξ αὐτῶν καὶ ἤνεγκαν τὰ σκῦλα εἰς σαμάρειαν
- 9 Por aty ishte një profet i Zotit, që quhej Obed. Ai doli para ushtrisë që po kthehej në Samari dhe tha: &quot;Ja, me qenë se Zoti, Perëndia i etërve tuaj, ishte i zemëruar me Judën, ju dha ata në duart tuaja, por ju i vratë me tërbim, që arriti deri në qiell.  
But a prophet of the Lord was there, named Obed; and he went out in front of the army which was coming into Samaria and said to them, Truly, because the Lord, the God of your fathers, was angry with Judah, he gave them up into your hands, and you have put them to death in an outburst of wrath stretching up to heaven.  
καὶ ἐκεῖ ἦν ὁ προφήτης τοῦ κυρίου ὠδηδ ὄνομα αὐτῷ καὶ ἐξῆλθεν εἰς ἀπάντησιν τῆς δυνάμεως τῶν ἐρχομένων εἰς σαμάρειαν καὶ εἶπεν αὐτοῖς ἰδοὺ ὀργὴ κυρίου θεοῦ τῶν πατέρων ὑμῶν ἐπὶ τὸν ἰουδα ἡ καὶ παρέδωκεν αὐτοὺς εἰς τὰς χεῖρας ὑμῶν καὶ ἀπεκτείνετε ἐν αὐτοῖς ἐν ὀργῇ ἕως τῶν οὐρανῶν ἔφθακεν
- 10 Dhe tani doni t'i nënshtroni, si skllëvërit tuaj dhe skllavet tuaja, bijtë dhe bijat e Judës dhe të Jeruzalemit. Por në realitet a nuk jeni fajtorë ju vetë përpara Zotit, Perëndisë tuaj?  
And now your purpose is to keep the children of Judah and Jerusalem as men-servants and women-servants under your yoke: but are there no sins against the Lord your God to be seen among yourselves?  
καὶ νῦν υἱοὺς ἰουδα καὶ ἱερουσαλημ ὑμεῖς λέγετε κατακτήσεσθαι εἰς δούλους καὶ δούλας οὐκ ἰδοὺ εἰμι μεθ' ὑμῶν μαρτυρῆσαι κυρίῳ θεῷ ὑμῶν
- 11 Dëgjomëni, pra, dhe kthejini robërit që keni zënë midis vëllezërve tuaj, sepse përndryshe zemërimi i zjarrtë i Zotit do të bjerë mbi ju&quot;.  
And now give ear to me, and send back the prisoners whom you have taken from your brothers: for the wrath of the Lord is burning against you.  
καὶ νῦν ἀκούσατέ μου καὶ ἀποστρέψατε τὴν αἰχμαλωσίαν ἣν ἠχμαλωτεύσατε τῶν ἀδελφῶν ὑμῶν ὅτι ὀργὴ θυμοῦ κυρίου ἐφ' ὑμῖν
- 12 Atëherë disa nga krerët e bijve të Efraimit, Azariah, bir i Johananit, Berekiahu, bir i Meshilemothit, Ezekia, bir i Shalunit, dhe Amasa, bir i Hadlait, u ngritën kundër atyre që ktheheshin nga lufta,  
Then certain of the heads of the children of Ephraim, Azariah, the son of Johanan, Berechiah, the son of Meshillemoth Jehizkiah, the son of Shallum, and Amasa the son of Hadlai, put themselves against those who had come from the war,  
καὶ ἀνέστησαν ἄρχοντες ἀπὸ τῶν υἱῶν εφραιμ οὐδία ὁ τοῦ ἰωανου καὶ βαραχιας ὁ τοῦ μοσολαμωθ καὶ εζεκιας ὁ τοῦ σελλημ καὶ αμασας ὁ τοῦ χοδλι ἐπὶ τοὺς ἐρχομένους ἀπὸ τοῦ πολέμου
- 13 dhe u thanë: &quot;Ju nuk do t'i sillni këtu robërit, sepse mbi ne rëndon tanimë një faj kundër Zotit; ajo që keni ndër mend të bëni do t'i shtojë edhe më tepër mëkatet dhe fajin tonë, sepse faji ynë është mjaft i madh dhe një zemërim i zjarrtë i kërcënohet Izraelit&quot;.  
And said to them, You are not to let these prisoners come here; for what you are designing to do will be a cause of sin against the Lord to us, making even greater our sin and our wrongdoing, which now are great enough, and his wrath is burning against Israel.  
καὶ εἶπαν αὐτοῖς οὐ μὴ εἰσαγάγητε τὴν αἰχμαλωσίαν ὧδε πρὸς ἡμᾶς ὅτι εἰς τὸ ἁμαρτάνειν τῷ κυρίῳ ἐφ' ἡμᾶς ὑμεῖς λέγετε προσθεῖναι ἐπὶ ταῖς ἁμαρτίαις ἡμῶν καὶ ἐπὶ τὴν ἄγνοιαν ὅτι πολλὴ ἡ ἁμαρτία ἡμῶν καὶ ὀργὴ θυμοῦ κυρίου ἐπὶ τὸν ἰσραὴλ
- 14 Atëherë ushtarët i lanë robërit dhe plaçkën përpara komandantëve dhe tërë asamblesë.  
So the armed men gave up the prisoners and the goods they had taken to the heads and the meeting of the people.  
καὶ ἀφήκαν οἱ πολεμιστὰι τὴν αἰχμαλωσίαν καὶ τὰ σκῦλα ἐναντίον τῶν ἀρχόντων καὶ πάσης τῆς ἐκκλησίας

- 15 Pastaj disa njerëz të thirrur me emër u ngritën dhe morën robërit dhe me rrobat e plaçkës veshën tërë ata që ishin lakuriq; u dhanë rroba dhe sandale, për të ngrënë dhe për të pirë dhe i vajosën; pastaj i mbartën tërë të dobët mbi gomarë dhe i çuan në Jeriko, qyteti i palmave, pranë vëllezërve të tyre, pastaj u kthyen në Samari.  
 And those men who have been named went up and took the prisoners, clothing those among them who were uncovered, with things from the goods which had been taken in the war, and putting robes on them and shoes on their feet; and they gave them food and drink and oil for their bodies, and seating all the feeble among them on asses, they took them to Jericho, the town of palm-trees, to their people, and then went back to Samaria.  
 και ανέστησαν ἄνδρες οἱ ἐπεκλήθησαν ἐν ὀνόματι καὶ ἀντελάβοντο τῆς αἰχμαλωσίας καὶ πάντα τοὺς γυμνοὺς περιέβαλον ἀπὸ τῶν σκύλων καὶ ἐνέδυσαν αὐτοὺς καὶ ὑπέδησαν αὐτοὺς καὶ ἔδωκαν φαγ εἶν καὶ ἀλείψασθαι καὶ ἀντελάβοντο ἐν ὑποζυγίοις παντὸς ἀσθενοῦντος καὶ κατέστησαν αὐτοὺς εἰς ιερὶχὸν πόλιν φοινίκων πρὸς τοὺς ἀδελφοὺς αὐτῶν καὶ ἐπέστρεψαν εἰς σαμάρειαν
- 16 Në atë kohë mbreti Ashaz shkoi t'i kërkojë ndihmë mbretit të Asirisë.  
 At that time King Ahaz sent for help to the king of Assyria.  
 ἐν τῷ καιρῷ ἐκεῖνῳ ἀπέστειλεν ἀχάζ πρὸς βασιλέα ασσοῦρ βοηθῆσαι αὐτῷ
- 17 Edomitët kishin ardhur përsëri, kishin mundur Judën dhe kishin marrë me vete robërit.  
 For the Edomites had come again, attacking Judah and taking away prisoners.  
 καὶ ἐν τούτῳ ὅτι ἰδουμαῖοι ἐπέθεντο καὶ ἐπάταξαν ἐν ἰουδα καὶ ἤγαλῶτισαν αἰχμαλωσίαν
- 18 Filistejtë kishin pushtuar edhe qytetet e fushës dhe të Negev-it të Judës dhe kishin marrë Beth-Shemeshin, Ajalonin, Gederothin, Sokon me fshatrat e tij, Timnahun me fshatrat e tij, Gimzon me fshatrat e tij, dhe ishin vendosur aty.  
 And the Philistines, forcing their way into the towns of the lowlands and the south of Judah, had taken Beth-shemesh and Aijalon and Gederoth and Soco, with their daughter-towns, as well as Timnah and Gimzo and their daughter-towns, and were living there.  
 καὶ οἱ ἀλλόφυλοι ἐπέθεντο ἐπὶ τὰς πόλεις τῆς πεδινῆς καὶ ἀπὸ λιβὸς τοῦ ἰουδα καὶ ἔλαβον τὴν βαιθσαμὺς καὶ τὴν αἰλων καὶ τὴν γαδῆρωθ καὶ τὴν σοχω καὶ τὰς κόμας αὐτῆς καὶ τὴν θαμνα καὶ τὰς κόμας αὐτῆς καὶ τὴν γαμζω καὶ τὰς κόμας αὐτῆς καὶ κατόκησαν ἐκεῖ
- 19 Zoti në fakt kishte poshtëruar Judën për shkak të Ashazit, mbretit të Izraelit, që kishte nxitur rënien morale në Judë dhe kishte kryer mëkate të rënda kundër Zotit.  
 For the Lord made Judah low, because of Ahaz, king of Israel; for he had given up all self-control in Judah, sinning greatly against the Lord.  
 ὅτι ἐταπεινώσεν κύριος τὸν ἰουδαν δι' ἀχάζ βασιλέα ἰουδα ὅτι ἀπέστη ἀποστάσει ἀπὸ κυρίου
- 20 Kështu Tiglath-Pilneseri, mbret i Asirisë, doli kundër tij dhe e shtypi në vend që ta ndihmonte,  
 Then Tiglath-pileser, king of Assyria, came to him, but was a cause of trouble and not of strength to him.  
 καὶ ἦλθεν ἐπ' αὐτὸν θαγλαθφελλασαρ βασιλεὺς ασσοῦρ καὶ ἐπάταξεν αὐτόν
- 21 megjithatë Ashazi kishte marrë një pjesë të thesareve të shtëpisë të Zotit, të pallatit të mbretit dhe të krerëve, dhe ia kishte dhënë të gjitha mbretit të Asirisë; megjithatë kjo nuk i vlejti fare.  
 For Ahaz took a part of the wealth from the house of the Lord, and from the house of the king and of the great men, and gave it to the king of Assyria; but it was no help to him.  
 καὶ ἔλαβεν ἀχάζ τὰ ἐν οἴκῳ κυρίου καὶ τὰ ἐν οἴκῳ τοῦ βασιλέως καὶ τῶν ἀργόντων καὶ ἔδωκεν τῷ βασιλεῖ ασσοῦρ καὶ οὐκ εἰς βοήθειαν αὐτῷ
- 22 Edhe kur ishte i shtypur, mbreti Ashaz mëkatoi edhe më shumë kundër Zotit.  
 And in the time of his trouble, this same King Ahaz did even more evil against the Lord.  
 ἀλλ' ἢ τῷ θλιβῆναι αὐτὸν καὶ προσέθηκεν τοῦ ἀποστῆναι ἀπὸ κυρίου καὶ εἶπεν ὁ βασιλεὺς
- 23 U ofroj flijime perëndive të Damaskut që e kishin mundur, duke thënë: "Me qenë se perënditë e mbretit të Sirisë i ndihmojnë ata, unë do t'i ofroj atyre flijime që të më ndimojnë edhe mua". Por qenë pikërisht ata që shkaktuan shkatërrimin e tij dhe atë të të gjithë Izraelit.  
 For he made offerings to the gods of Damascus, who were attacking him, and said, Because the gods of the kings of Aram are giving them help, I will make offerings to them so that they may give me help. But they were the cause of his downfall, and of that of all Israel.  
 ἐκζητήσω τοὺς θεοὺς δαμασκοῦ τοὺς τύπτοντάς με καὶ εἶπεν ὅτι θεοὶ βασιλέως συρίας αὐτοὶ κατισχύουσιν αὐτούς αὐτοῖς τοῖνυν θύσω καὶ ἀντιλήμνονταί μου καὶ αὐτοὶ ἐγένοντο αὐτῷ εἰς σκόλον καὶ αἰ παντὶ ἰσραηλ
- 24 Ashazi mbledhi gjithë veglat e shtëpisë së Perëndisë, i bëri ato copë-copë, mbylli portat e shtëpisë të Zotit, ndërtoi altare në çdo kënd të Jeruzalemit,  
 And Ahaz got together the vessels of the house of God, cutting up all the vessels of the house of God, and shutting the doors of the Lord's house; and he made altars in every part of Jerusalem.  
 καὶ ἀπέστησεν ἀχάζ τὰ σκεύη οἴκου κυρίου καὶ κατέκοψεν αὐτὰ καὶ ἐκλείσεν τὰς θύρας οἴκου κυρίου καὶ ἐποίησεν ἑαυτῷ θυσιαστήρια ἐν πάσῃ γωνίᾳ ἐν ἱερουσαλημ
- 25 dhe në çdo qytet të Judës vendosi vende të larta për t'u djegur temjan perëndive të tjera, duke shkaktuar kështu zemërimin e Zotit, Perëndisë të etërve të tij.  
 And in every town of Judah he made high places where perfumes were burned to other gods, awaking the wrath of the Lord, the God of his fathers.  
 καὶ ἐν πάσῃ πόλει καὶ πόλει ἐν ἰουδα ἐποίησεν ὑψηλὰ θυμῶν θεοῖς ἄλλοτρίοις καὶ παρώργισαν κύριον τὸν θεὸν τῶν πατέρων αὐτῶν

- 26 Pjesa tjetër e bëmave të tij dhe tërë sjelljet e tij, nga e para në të fundit, janë shkruar në librin e mbretërve të Judës dhe të Izraelit.  
Now the rest of his acts and all his ways, first and last, are recorded in the book of the kings of Judah and Israel.  
καὶ οἱ λοιποὶ λόγοι αὐτοῦ καὶ αἱ πράξεις αὐτοῦ αἱ πρῶται καὶ αἱ ἔσχαται ἰδοὺ γεγραμμένα ἐπὶ βιβλίῳ βασιλέων ἰουδα καὶ ἰσραηλ.
- 27 Pastaj Ashazin pushoi bashkë me etërit e tij dhe e varrosën në qytet, në Jeruzalem, por nuk deshën ta vënë në varrezat e mbretërve të Izraelit. Në vend të tij mbretëroi i biri, Ezekia.  
And Ahaz went to rest with his fathers, and they put his body into the earth in Jerusalem; but they did not put him in the resting-place of the kings of Israel: and Hezekiah his son became king in his place.  
καὶ ἐκοιμήθη ἀχάζ μετὰ τῶν πατέρων αὐτοῦ καὶ ἐτάφη ἐν πόλει δαυὶδ ὅτι οὐκ εἰσήνεγκαν αὐτὸν εἰς τοὺς τάφους τῶν βασιλέων ἰσραηλ καὶ ἐβασίλευσεν ἐζεκιας υἱὸς αὐτοῦ ἀντ' αὐτοῦ
- 1 Ezekia ishte njëzet e pesë vjeç kur filloi të mbretërojë dhe mbretëroi njëzet e nëntë vjet në Jeruzalem. E ëma quhej Abijah; ishte bija e Zakarias.  
Hezekiah became king when he was twenty-five years old; and he was king in Jerusalem for twenty-nine years; and his mother's name was Abijah, the daughter of Zechariah.  
καὶ ἐζεκιας ἐβασίλευσεν ὡν εἴκοσι καὶ πέντε ἔτων καὶ εἴκοσι καὶ ἑννέα ἔτη ἐβασίλευσεν ἐν ἱερουσαλημ καὶ ὄνομα τῆ μητρὶ αὐτοῦ ἀββα θυγάτηρ ζαχαρια
- 2 Ai bëri atë që ishte e drejtë në sytë e Zotit, pikërisht ashtu si kishte vepruar Davidi, i ati.  
He did what was right in the eyes of the Lord, as his father David had done.  
καὶ ἐποίησεν τὸ εὐθὲς ἐνώπιον κυρίου κατὰ πάντα ὅσα ἐποίησεν δαυὶδ ὁ πατὴρ αὐτοῦ
- 3 Në vitin e parë të mbretërimit të tij, në muajin e parë, ai hapi portat e shtëpisë të Zotit dhe i restauroi.  
In the first year of his rule, in the first month, opening the doors of the Lord's house, he made them strong.  
καὶ ἐγένετο ὡς ἔστη ἐπὶ τῆς βασιλείας αὐτοῦ ἐν τῷ πρώτῳ μηνὶ ἀνέφωξεν τὰς θύρας οἴκου κυρίου καὶ ἐπεσκεύασεν αὐτάς
- 4 Pastaj solli priftërinjtë dhe Levitët, dhe i mblodhi në sheshin lindor,  
And he sent for the priests and the Levites, and got them together in the wide place on the east side,  
καὶ εἰσήγαγεν τοὺς ἱερεῖς καὶ τοὺς λευίτας καὶ κατέστησεν αὐτοὺς εἰς τὸ κλίτος τὸ πρὸς ἀνατολάς
- 5 dhe u tha: "Më dëgjoni, o Levitë! Tani shenjtërohuni dhe shenjtëroni shtëpinë e Zotit, Perëndisë të etërve tuaj, dhe nxirrni nga vendi i shenjtë çdo gjë të papastër.  
And said to them, Give ear to me, O Levites: now make yourselves holy, and make holy the house of the Lord, the God of your fathers, and take away everything unclean from the holy place.  
καὶ εἶπεν αὐτοῖς ἀκούσατε οἱ λευῖται νῦν ἀγνίσθητε καὶ ἀγνίσατε τὸν οἶκον κυρίου θεοῦ τῶν πατέρων ὑμῶν καὶ ἐκβάλετε τὴν ἀκαθαρσίαν ἐκ τῶν ἁγίων
- 6 Sepse etërit tanë kanë kryer mëkate dhe kanë bërë atë që është e keqe në sytë e Zotit, Perëndisë tonë dhe e kanë braktisur, duke i hequr fytyrat e tyre nga banesa e Zotit dhe duke i kthyer krahët.  
For our fathers have done evil, sinning in the eyes of the Lord our God, and have given him up, turning away their faces from the house of the Lord, and turning their backs on him.  
ὅτι ἀπέστησαν οἱ πατέρες ὑμῶν καὶ ἐποίησαν τὸ πονηρὸν ἐναντίον κυρίου καὶ ἐγκατέλιπον αὐτὸν καὶ ἀπέστρεψαν τὸ πρόσωπον ἀπὸ τῆς σκηνῆς κυρίου καὶ ἔδωκαν ἀχένα
- 7 Ata madje kanë mbyllur portat e portikut, kanë shuar llambat dhe nuk kanë djegur më temjan as nuk kanë ofruar olokauste në vendin e shenjtë të Perëndisë të Izraelit.  
The doors of his house have been shut and the lights put out; no perfumes have been burned or offerings made to the God of Israel in his holy place.  
καὶ ἀπέκλεισαν τὰς θύρας τοῦ ναοῦ καὶ ἔσβεσαν τοὺς λύχνους καὶ θυμίαμα οὐκ ἐθυμίασαν καὶ ὀλοκαντώματα οὐ προσήνεγκαν ἐν τῷ ἁγίῳ θεῷ ἰσραηλ
- 8 Prandaj zemërimi i Zotit ra mbi Judën dhe Jeruzalemin, dhe ai i ka braktisur në telashe, në shkretim dhe në përbuzje, siç mund ta shihni me sytë tuaj.  
And so the wrath of the Lord has come on Judah and Jerusalem, and he has given them up to be a cause of fear and wonder and shame, as your eyes have seen.  
καὶ ὠργίσθη ὀργῇ κύριος ἐπὶ τὸν ἰουδα καὶ ἐπὶ τὴν ἱερουσαλημ καὶ ἔδωκεν αὐτοὺς εἰς ἔκστασιν καὶ εἰς ἀφανισμόν καὶ εἰς συρισμόν ὡς ὑμεῖς ὁρᾶτε τοῖς ὀφθαλμοῖς ὑμῶν
- 9 Dhe ja, për shkak të kësaj, etërit tanë ranë nga goditjet e shpatës, dhe bijtë tanë, bijat tona dhe gratë tona janë në robëri.  
For see, our fathers have been put to death with the sword, and our sons and daughters and wives have been taken away prisoners because of this.  
καὶ ἰδοὺ πεπλήγασιν οἱ πατέρες ὑμῶν μαχαίρᾳ καὶ οἱ υἱοὶ ὑμῶν καὶ αἱ θυγατέρες ὑμῶν καὶ αἱ γυναῖκες ὑμῶν ἐν αἰχμαλωσίᾳ ἐν γῆ οὐκ αὐτῶν ὁ καὶ νῦν ἐστιν
- 10 Tani kam në zemër të bëj një besëlidhje me Zotin, Perëndinë e Izraelit, me qëllim që zjarri i zemërimit të tij të largohet prej nesh.  
Now it is my purpose to make an agreement with the Lord, the God of Israel, so that the heat of his wrath may be turned away from us.  
ἐπὶ τοῦτοις νῦν ἐστιν ἐπὶ καρδίας διαθέσθαι διαθήκην κυρίου θεοῦ ἰσραηλ καὶ ἀποστρέψει τὴν ὀργὴν θυμοῦ αὐτοῦ ἀφ' ἡμῶν
- 11 Bij të mij, mos u tregoni të shkujdesur tani, sepse Zoti ju ka zgjedhur që t'i shërbeni atij, që të jemi shërbëtorët e tij dhe që t'i ofroni temjan"  
My sons, take care now: for you have been marked out by the Lord to come before him and to be his servants, burning offerings to him.  
καὶ νῦν μὴ διαλίπητε ὅτι ἐν ὑμῖν ἠρέτικεν κύριος στήναι ἐναντίον αὐτοῦ λειτουργεῖν καὶ εἶναι αὐτῷ λειτουργοῦντας καὶ θυμιῶντας

- 12 Atëherë Levitët u ngritën: Mahathi, bir i Amasait, Joeli, bir i Azariahut, nga bijtë e Kehathit. Nga bijtë e Merarit, Kishi, bir i Abdiut dhe Azariahut, bir i Jehalelelit. Nga Ghershonitët, Joahu, bir i Zimahut dhe Edeni, bir i Joahut.  
Then the Levites took their places; Mahath, the son of Amasai, and Joel, the son of Azariah, among the Kohathites; and of the sons of Merari, Kish, the son of Abdi, and Azariah, the son of Jehallelel; and of the Gershonites, Joah, the son of Zimmah, and Eden, the son of Joah;  
καὶ ἀνέστησαν οἱ λευῖται μααθ ὁ τοῦ αμασι καὶ ιωηλ ὁ τοῦ αζαριου ἐκ τῶν υἱῶν καθθ καὶ ἐκ τῶν υἱῶν μεραρι κισ ὁ τοῦ αβδι καὶ αζαριας ὁ τοῦ ιαλλεληλ καὶ ἀπὸ τῶν υἱῶν γεδσωνι ιωα ὁ τοῦ ζεμμαθ κ αὶ ιωδαν ὁ τοῦ ιωαχα
- 13 Nga bijtë e Elitsafanit, Shimri dhe Jeieli. Nga bijtë e Asafit, Zakaria dhe Mataniahu.  
And of the sons of Elizaphan, Shimri and Jeuel; and of the sons of Asaph, Zechariah and Mattaniah;  
καὶ τῶν υἱῶν ελισταφαν σαμβρι καὶ ιηλ καὶ τῶν υἱῶν ασαφ ζαχαριας καὶ μαθθανιας
- 14 Nga bijtë e Hemanit, Jehieli dhe Shimei. Nga bijtë e Jeduthunit, Shemajahu dhe Uzieli.  
And of the sons of Heman, Jehuel and Shimei; and of the sons of Jeduthun, Shemaiah and Uzziel.  
καὶ τῶν υἱῶν αιμαν ιηλ καὶ σεμεὶ καὶ τῶν υἱῶν ιδιθων σαμιας καὶ οζιηλ
- 15 Ata mblodhën vëllezërit e tyre dhe u shenjtëruan; pastaj hynë në shtëpinë e Zotit për ta pastruar, sipas urdhrut të mbretit, në përputhje me fjalët e Zotit.  
And they got their brothers together and made themselves holy, and went in, as the king had said by the word of the Lord, to make the house of the Lord clean.  
καὶ συνήγαγον τοὺς ἀδελφοὺς αὐτῶν καὶ ἡγνίσθησαν κατὰ τὴν ἐντολὴν τοῦ βασιλέως διὰ προστάγματος κυρίου καθαρῆσαι τὸν οἶκον κυρίου
- 16 Kështu priftërinjtë hynë brënda shtëpisë të Zotit për ta pastruar dhe nxorën jashtë, në oborrin e shtëpisë të Zotit, të gjitha sendet e papastra që gjetën në tempullin e Zotit; Levitët i morën për t'i çuar jashtë në përroin e Kidronit.  
And the priests went into the inner part of the house of the Lord to make it clean, and everything unclean which was to be seen in the Temple of the Lord they took out into the outer square of the Lord's house, and the Levites got it together and took it away to the stream Kidron.  
καὶ εἰσῆλθον οἱ ἱερεῖς ἔσω εἰς τὸν οἶκον κυρίου ἀγνίσαι καὶ ἐξέβαλον πᾶσαν τὴν ἀκαθαρσίαν τὴν εὐρεθεῖσαν ἐν τῷ οἴκῳ κυρίου καὶ εἰς τὴν αὐλὴν οἴκου κυρίου καὶ ἐδέξαντο οἱ λευῖται ἐκβαλεῖν εἰς τὸ ν χειμάρρον κεδρον ἔξω
- 17 Filluan të shenjtërohen ditën e parë të muajit; ditën e tetë të muajit hynë në portikun e Zotit; brenda tetë ditëve pastruan shtëpinë e Zotit dhe e përfunduan ditën e gjashtëmbëdhjetë të muajit të parë.  
On the first day of the first month the work of making the house holy was started, and on the eighth day they came to the covered way of the Lord; in eight days they made the Lord's house holy, and on the sixteenth day of the first month the work was done.  
καὶ ἤρξαντο τῇ ἡμέρᾳ τῇ πρώτῃ νομηνία τοῦ μηνὸς τοῦ πρώτου ἀγνίσαι καὶ τῇ ἡμέρᾳ τῇ ὀγδόῃ τοῦ μηνὸς εἰσῆλθαν εἰς τὸν ναὸν κυρίου καὶ ἡγνισαν τὸν οἶκον κυρίου ἐν ἡμέραις ὀκτὼ καὶ τῇ ἡμέρᾳ τῇ ἑκκαιδεκάτῃ τοῦ μηνὸς τοῦ πρώτου συνετέλεσαν
- 18 Pastaj hynë në pallatin e mbretit Ezekia dhe i thanë: "Kemi pastruar tërë shtëpinë e Zotit, altarin e olokausteve me të gjitha veglat e tij dhe tryezën e bukëve të paraqitjes me gjithë veglat e saj.  
Then they went in to King Hezekiah and said, We have made all the house of the Lord clean, as well as the altar of burned offerings with all its vessels, and the table for the holy bread, with all its vessels.  
καὶ εἰσῆλθαν ἔσω πρὸς ἐζεκιαν τὸν βασιλέα καὶ εἶπαν ἡγνίσαμεν πάντα τὰ ἐν οἴκῳ κυρίου τὸ θυσιαστήριον τῆς ὀλοκαυτώσεως καὶ τὰ σκεύη αὐτοῦ καὶ τὴν τράπεζαν τῆς προθέσεως καὶ τὰ σκεύη αὐτῆς
- 19 Përveç kësaj kemi vënë përsëri në vend dhe kemi pastruar të gjitha përdorëset që mbreti Ashaz në mëkatën e tij kishte flakur tej gjatë mbretërimit të tij; dhe ja, tani janë përpara altarit të Zotit";  
And all the vessels which were turned out by King Ahaz in his sin while he was king, we have put in order and made holy, and now they are in their places before the altar of the Lord.  
καὶ πάντα τὰ σκεύη ἃ ἐμίανεν αχαζ ὁ βασιλεὺς ἐν τῇ βασιλείᾳ αὐτοῦ ἐν τῇ ἀποστασίᾳ αὐτοῦ ἠτοιμάκαμεν καὶ ἡγνίκαμεν ἰδοὺ ἐστὶν ἐναντίον τοῦ θυσιαστηρίου κυρίου
- 20 Atëherë mbreti Ezekia u ngrit shpejt, mblodhi parinë e qytetit dhe u ngjiti në shtëpinë e Zotit.  
Then Hezekiah the king got up early, and got together the great men of the town, and went up to the house of the Lord.  
καὶ ὄρθρισεν ἐζεκιας ὁ βασιλεὺς καὶ συνήγαγεν τοὺς ἄρχοντας τῆς πόλεως καὶ ἀνέβη εἰς οἶκον κυρίου
- 21 Ata sollën shtatë dema, shtatë desh, shtatë qengja dhe shtatë cjep, si flijim për mëkatën për mbretërinë, për shenjtëroren dhe për Judën. Pastaj mbreti urdhëroi priftërinjtë, bijtë e Aaronit, t'i ofronin në altarin e Zotit.  
And they took with them seven oxen and seven male sheep and seven lambs and seven he-goats as a sin-offering for the kingdom and for the holy house and for Judah. And he gave orders to the sons of Aaron, the priests, that these were to be offered on the altar of the Lord.  
καὶ ἀνήνεγκεν μόσχους ἑπτὰ κριοὺς ἑπτὰ ἀμνοὺς ἑπτὰ χιμάρους αἰγῶν ἑπτὰ περὶ ἁμαρτίας περὶ τῆς βασιλείας καὶ περὶ τῶν ἁγίων καὶ περὶ ἰσραηλ καὶ εἶπεν τοῖς υἱοῖς ααρων τοῖς ἱερεῦσιν ἀναβαίνειν ἐ πὶ τὸ θυσιαστήριον κυρίου

- 22** Kështu therën demat, dhe priftërinjtë mblodhën gjakun e tyre dhe spërkatën altarin me të; në të njëjtën mënyrë therën deshtë dhe spërkatën gjakun e tyre mbi altar; pastaj therën qengjat dhe spërkatën me gjakun e tyre altarin.  
 So they put the oxen to death and their blood was given to the priests to be drained out against the altar; then they put the male sheep to death, draining out their blood against the altar, and they put the lambs to death, draining out their blood against the altar.  
 και ἔθυσαν τοὺς μόσχους καὶ ἐδέξαντο οἱ ἱερεῖς τὸ αἷμα καὶ προσέχεον ἐπὶ τὸ θυσιαστήριον καὶ ἔθυσαν τοὺς κριοὺς καὶ προσέχεον τὸ αἷμα ἐπὶ τὸ θυσιαστήριον καὶ ἔθυσαν τοὺς ἀμνοὺς καὶ περιέχεον τὸ αἷμα τῷ θυσιαστηρίῳ
- 23** Pastaj i paraqitën mbretit dhe asamblejë cjeptë e flijimit për mëkatën, dhe ata vunë mbi to duart e tyre.  
 Then they took the he-goats for the sin-offering, placing them before the king and the meeting of the people, and they put their hands on them:  
 καὶ προσήγαγον τοὺς χιμάρους τοὺς περὶ ἁμαρτίας ἐναντίον τοῦ βασιλέως καὶ τῆς ἐκκλησίας καὶ ἐπέθηκαν τὰς χεῖρας αὐτῶν ἐπ' αὐτούς
- 24** Priftërinjtë i therën dhe ofruan gjakun e tyre mbi altar si flijim për mëkatën, si shlyerje e fajit për tërë Izraelin, sepse mbreti kishte urdhëruar të ofronin olokaustin dhe flijimin për mëkatën, për tërë Izraelin.  
 And the priests put them to death, and made a sin-offering with their blood on the altar, to take away the sin of all Israel: for the king gave orders that the burned offering and the sin-offering were for all Israel.  
 και ἔθυσαν αὐτούς οἱ ἱερεῖς καὶ ἐξέλασαν τὸ αἷμα αὐτῶν πρὸς τὸ θυσιαστήριον καὶ ἐξέλασαν περὶ παντὸς ἰσραηλ ὅτι περὶ παντὸς ἰσραηλ εἶπεν ὁ βασιλεὺς ἡ ὀλοκαύτωσις καὶ τὰ περὶ ἁμαρτίας
- 25** Mbreti vendosi gjithashtu Levitët në shtëpinë e Zotit me cembale, me harpa dhe me qeste, sipas urdhrit të Davidit, të Gadit, shikuesi i mbretit, dhe të profetit Nathan, sepse urdhri ishte dhënë nga Zoti me anë të profetëve të tij.  
 Then he put the Levites in their places in the house of the Lord, with brass and corded instruments of music as ordered by David and Gad, the king's seer, and Nathan the prophet: for the order was the Lord's, given by his prophets.  
 και ἔστησεν τοὺς λευίτας ἐν οἴκῳ κυρίου ἐν κυμβάλοις καὶ ἐν νάβλαις καὶ ἐν κινύραις κατὰ τὴν ἐντολὴν δαυὶδ τοῦ βασιλέως καὶ γαδ τοῦ ὀρώντος τῷ βασιλεῖ καὶ ναθαν τοῦ προφήτου ὅτι δι' ἐντολῆς κυρίου τὸ πρόσταγμα ἐν χειρὶ τῶν προφητῶν
- 26** Kështu Levitët zunë vend me veglat e Davidit, dhe priftërinjtë me boritë.  
 So the Levites took their places with David's instruments, and the priests with their horns.  
 και ἔστησαν οἱ λευῖται ἐν ὄργανοῖς δαυὶδ καὶ οἱ ἱερεῖς ταῖς σάλπιγγιν
- 27** Atëherë Ezekia urdhëroi që olokausti të ofrohej mbi altar; dhe në çastin që filloi olokausti, filloi gjithashtu kënga e Zotit me boritë dhe me shoqërimin e veglave të Davidit, mbretit të Izraelit.  
 And Hezekiah gave the word for the burned offering to be offered on the altar. And when the burned offering was started, then the song of the Lord was started, with the blowing of horns and with all the instruments of David, king of Israel.  
 και εἶπεν ἐζεκιας ἀνεγέγκαι τὴν ὀλοκαύτωσιν ἐπὶ τὸ θυσιαστήριον καὶ ἐν τῷ ἄρξασθαι ἀναφέρειν τὴν ὀλοκαύτωσιν ἤρξαντο ἄδειν κυρίῳ καὶ αἱ σάλπιγγες πρὸς τὰ ὄργανα δαυὶδ βασιλέως ἰσραηλ
- 28** Atëherë tërë asambleja u përl, ndërsa këngëtarët këndonin dhe trumbetierët u binin veglave të tyre; e tërë kjo vazhdoi deri në fund të olokaustit.  
 And all the people gave worship, to the sound of songs and the blowing of horns; and this went on till the burned offering was ended.  
 και πᾶσα ἡ ἐκκλησία προσεκύνει καὶ οἱ ψαλτῳδοὶ ἄδοντες καὶ αἱ σάλπιγγες σαλπίζουσαι ἕως οὗ συνετελέσθη ἡ ὀλοκαύτωσις
- 29** Me të mbaruar olokausti, mbreti dhe tërë ata që ishin me të u përkulën dhe adhuruan.  
 And at the end of the offering, the king and all who were present with him gave worship with bent heads.  
 και ὡς συνετέλεσαν ἀναφέροντες ἕκαμψεν ὁ βασιλεὺς καὶ πάντες οἱ εὐρεθέντες καὶ προσεκύνησαν
- 30** Pastaj mbreti Ezekia dhe paria urdhëruan Levitët të lëvdnin Zotin me fjalët e Davidit dhe të shikuesit Asaf; ata e lëvduan me gëzim, pastaj u përkulën dhe e adhuruan.  
 Then King Hezekiah and the captains gave orders to the Levites to give praise to God in the words of David and Asaph the seer. And they made songs of praise with joy, and with bent heads gave worship.  
 και εἶπεν ἐζεκιας ὁ βασιλεὺς καὶ οἱ ἄρχοντες τοῖς λευίταις ὑμνεῖν τὸν κύριον ἐν λόγοις δαυὶδ καὶ ασαφ τοῦ προφήτου καὶ ὕμνουν ἐν εὐφροσύνῃ καὶ ἔπεσον καὶ προσεκύνησαν
- 31** Atëherë Ezekia mori fjalën dhe tha: "Tani që i jeni shenjtëruar Zotit, afrohuni dhe sillni flijime dhe oferta falënderimi në shtëpinë e Zotit"; Kështu asambleja solli flijime dhe oferta falënderimi; dhe të gjithë ata që ua donte zemra sollën olokauste.  
 Then Hezekiah made answer and said, Now that you have given yourselves to the Lord, come near and take offerings and praise-offerings into the house of the Lord. So all the people took in offerings and praise-offerings: and those whose hearts were moved, took in burned offerings.  
 και ἀπεκρίθη ἐζεκιας καὶ εἶπεν νῦν ἐπληρώσατε τὰς χεῖρας ὑμῶν κυρίῳ προσάγαγετε καὶ φέρετε θυσίας καὶ αἰνέσεως εἰς οἶκον κυρίου καὶ ἀνήνεγκεν ἡ ἐκκλησία θυσίας καὶ αἰνέσεως εἰς οἶκον κυρίου καὶ πᾶς πρόθυμος τῆ καρδία ὀλοκαυτώσει
- 32** Numri i olokausteve që solli asambleja ishte shtatëdhjetë dema, njëqind desh dhe dyqind qengja; të tëra këto ishin olokauste për Zotin.  
 The number of burned offerings which the people took in was seventy oxen, a hundred male sheep, and two hundred lambs: all these were for burned offerings to the Lord.  
 και ἐγένετο ὁ ἀριθμὸς τῆς ὀλοκαυτώσεως ἧς ἀνήνεγκεν ἡ ἐκκλησία μόσχοι ἑβδομήκοντα κριοὶ ἑκατὸν ἀμνοὶ διακόσιοι εἰς ὀλοκαύτωσιν κυρίῳ πάντα ταῦτα



- 33 Kafshët e shenjtëruara ishin gjashtëqind lopë dhe tre mijë dele.  
*And the holy things were six hundred oxen and three thousand sheep.*  
*καὶ οἱ ἡγιασμένοι μόσχοι ἑξακόσιοι πρόβατα τρισχίλια*
- 34 Por priftërinjtë ishin shumë të pakët dhe nuk mund të rripnin tërë olokaustet; prandaj vëllezërit e tyre, Levitët, i ndihmuan deri sa mbaroi tërë puna dhe deri sa të shenjtëroheshin priftërinjtë e tjerë, sepse Levitët e kishin zemrën më të pastër në shenjtërimin e priftërinjve.  
*There were not enough priests for the work of cutting up all the burned offerings; so their brothers the Levites gave them help till the work was done and the priests had made themselves holy: for the Levites were more upright in heart to make themselves holy than the priests.*  
*ἀλλ' ἢ οἱ ἱερεῖς ὀλίγοι ἦσαν καὶ οὐκ ἐδύναντο δεῖραι τὴν ὀλοκαύτωσιν καὶ ἀντελάβοντο αὐτῶν οἱ ἀδελφοὶ αὐτῶν οἱ λευῖται ἕως οὗ συνετελέσθη τὸ ἔργον καὶ ἕως οὗ ἡγνίσθησαν οἱ ἱερεῖς ὅτι οἱ λευῖται προθύμως ἡγνίσθησαν παρὰ τοὺς ἱερεῖς*
- 35 Patë një numër të madh olokaustesh së bashku me dhjamin e fljimeve të falënderimit dhe me blatimet e olokausteve. Kështu u rivendos shërbimi i shtëpisë të Zotit.  
*And there was a great amount of burned offerings, with the fat of the peace-offerings and the drink offerings for every burned offering. So the work of the Lord's house was put in order.*  
*καὶ ἡ ὀλοκαύτωσις πολλὴ ἐν τοῖς στέασι τῆς τελειώσεως τοῦ σωτηρίου καὶ τῶν σπονδῶν τῆς ὀλοκαυτώσεως καὶ κατορθώθη τὸ ἔργον ἐν οἴκῳ κυρίου*
- 36 Ezekia dhe tërë populli u gëzua që Perëndia e kishte përgatitur popullin; në të vërtetë kjo gjë u bë shpejt.  
*And Hezekiah and all the people were full of joy, because God had made the people ready: for the thing was done suddenly.*  
*καὶ ἠὐφράνθη ἐξεκίας καὶ πᾶς ὁ λαὸς διὰ τὸ ἠτουμακέναι τὸν θεὸν τῷ λαῷ ὅτι ἐξάπινα ἐγένετο ὁ λόγος*
- 1 Pastaj Ezekia i dërgoi lajmëtarë tërë Izraelit dhe Judës dhe i shkroi gjithashtu letra Efraimit dhe Manasit që të vinin në shtëpinë e Zotit në Jeruzalem për të festuar Pashkën për nder të Zotit, Perëndisë të Izraelit.  
*Then Hezekiah sent word to all Israel and Judah, and sent letters to Ephraim and Manasseh, requesting them to come to the house of the Lord at Jerusalem, to keep the Passover to the Lord, the God of Israel.*  
*καὶ ἀπέστειλεν ἐξεκίας ἐπὶ πάντα Ἰσραὴλ καὶ Ἰουδαν καὶ ἐπιστολὰς ἔγραψεν ἐπὶ τὸν εφραϊμ καὶ μανασση ἐλθεῖν εἰς οἶκον κυρίου εἰς ἱερουσαλὴμ ποιῆσαι τὸ φασεκ τῷ κυρίῳ θεῷ Ἰσραὴλ*
- 2 Mbreti, paria dhe tërë asambleja në Jeruzalem vendosën ta kremtojnë Pashkën në muajin e dytë;  
*For the king, after discussion with his chiefs and all the body of the people in Jerusalem, had made a decision to keep the Passover in the second month.*  
*καὶ ἐβουλευσατο ὁ βασιλεὺς καὶ οἱ ἄρχοντες καὶ πᾶσα ἡ ἐκκλησία ἣ ἐν ἱερουσαλὴμ ποιῆσαι τὸ φασεκ τῷ μηνὶ τῷ δευτέρῳ*
- 3 në të vërtetë nuk kishin mundur ta kremtonin në kohën e caktuar, sepse priftërinjtë nuk ishin shenjtëruar në numër të mjaftueshëm dhe populli nuk ishte mbledhur në Jeruzalem.  
*It was not possible to keep it at that time, because not enough priests had made themselves holy, and the people had not come together in Jerusalem.*  
*οὐ γὰρ ἠδυνάσθησαν αὐτὸ ποιῆσαι ἐν τῷ καιρῷ ἐκεῖνο ὅτι οἱ ἱερεῖς οὐχ ἡγνίσθησαν ἱκανοὶ καὶ ὁ λαὸς οὐ συνήχθη εἰς ἱερουσαλὴμ*
- 4 Kjo gjë i pëlqeu mbretit dhe tërë asamblesë.  
*And the thing was right in the eyes of the king and all the people.*  
*καὶ ἤρεσεν ὁ λόγος ἐναντίον τοῦ βασιλέως καὶ ἐναντίον τῆς ἐκκλησίας*
- 5 Vendosën kështu të shpallin në tërë Izraelin, një njoftim nga Beer-Sheba deri në Dan, që të vijnë në Jeruzalem për të kremtuar Pashkën për nder të Zotit, Perëndisë të Izraelit, sepse prej shumë vitesh nuk e kishin kremtuar në mënyrën e paracaktuar.  
*So it was ordered that word was to be sent out through all Israel, from Beer-sheba to Dan, that they were to come to keep the Passover to the Lord, the God of Israel, at Jerusalem: because they had not kept it in great numbers in agreement with the law.*  
*καὶ ἔστησαν λόγον διελεῖν κήρυγμα ἐν παντὶ Ἰσραὴλ ἀπὸ βηρσαβεε ἕως δαν ἐλθόντας ποιῆσαι τὸ φασεκ κυρίῳ θεῷ Ἰσραὴλ ἐν ἱερουσαλὴμ ὅτι πλῆθος οὐκ ἐποίησεν κατὰ τὴν γραφὴν*
- 6 Korrierët, pra, shkuan në gjithë Izraelin dhe në Judën me letrat e mbretit dhe të parisë së tij, duke shpallur sipas urdhrit të mbretit: "Bij të Izraelit, kthehuni tek Zoti, Perëndia i Abrahamit, i Isakut dhe i Izraelit, me qëllim që ai të rikthehet pranë asaj që iu ka mbetur dhe që ka shpëtuar nga duart e mbretërve të Asirisë.  
*So runners went with letters from the king and his chiefs through all Israel and Judah, by the order of the king, saying, O children of Israel, come back again to the Lord, the God of Abraham, Isaac, and Israel, so that he may come again to that small band of you which has been kept safe out of the hands of the kings of Assyria.*  
*καὶ ἐπορεύθησαν οἱ τρέχοντες σὺν ταῖς ἐπιστολαῖς παρὰ τοῦ βασιλέως καὶ τῶν ἀρχόντων εἰς πάντα Ἰσραὴλ καὶ Ἰουδαν κατὰ τὸ πρόσταγμα τοῦ βασιλέως λέγοντες υἱοὶ Ἰσραὴλ ἐπιστρέψατε πρὸς θεὸν Ἀβραὰμ καὶ Ἰσαὰκ καὶ Ἰσραὴλ καὶ ἐπιστρέψετε τοὺς ἀνασεσωσμένους τοὺς καταλειφθέντας ἀπὸ χειρὸς βασιλέως Ἀσσυριῶν*
- 7 Mos jini si etërit tuaj dhe vëllezërit tuaj, që kanë mëkatur kundër Zotit, Perëndisë të etërve të tyre, i cili për këtë shkak i ka braktisur dhe i ka lënë në pikëllim, siç e shihni.  
*Do not be like your fathers and your brothers, who were sinners against the Lord, the God of their fathers, so that he made them a cause of fear, as you see.*  
*καὶ μὴ γίνεσθε καθὼς οἱ πατέρες ὑμῶν καὶ οἱ ἀδελφοὶ ὑμῶν οἱ ἀπέστησαν ἀπὸ κυρίου θεοῦ πατέρων αὐτῶν καὶ παρέδωκεν αὐτοὺς εἰς ἐρήμωσιν καθὼς ὑμεῖς ὁρᾶτε*

- 8 Tani mos e fortësoni zverkun si etërit tuaj, por jepini dorën Zotit, ejani në shenjtëroren e tij që ai ka shenjtëruar përjetë dhe i shërbeni Zotit, Perëndisë tuaj, me qëllim që zjarri i zemërimit të tij të largohet nga ju.  
Now do not be hard-hearted, as your fathers were; but give yourselves to the Lord, and come into his holy place, which he has made his for ever, and be the servants of the Lord your God, so that the heat of his wrath may be turned away from you.  
καὶ νῦν μὴ σκληρόνητε τοὺς τραχήλους ὑμῶν δότε δόξαν κυρίῳ τῷ θεῷ καὶ εἰσέλθατε εἰς τὸ ἅγιασμα αὐτοῦ ὃ ἡγάσεν εἰς τὸν αἰῶνα καὶ δουλεύσατε τῷ κυρίῳ θεῷ ὑμῶν καὶ ἀποστρέψει ἀφ' ὑμῶν θυμὸν ὀργῆς
- 9 Sepse, në rast se ktheheni tek Zoti, vëllezërit tuaj dhe bijtë tuaj do të trajtohen me dhembshuri nga ata që i kanë internuar dhe do të kthehen në këtë vend, sepse Zoti, Perëndia juaj, është i mëshirshëm dhe zemërmadh dhe nuk do ta heqë fytyrën prej jush, në rast se ktheheni tek ai;&quot;;  
For if you come back to the Lord, those who took away your brothers and your children will have pity on them, and let them come back to this land: for the Lord your God is full of grace and mercy, and his face will not be turned away from you if you come back to him.  
ὅτι ἐν τῷ ἐπιστρέφειν ὑμᾶς πρὸς κύριον οἱ ἀδελφοὶ ὑμῶν καὶ τὰ τέκνα ὑμῶν ἔσονται ἐν οἰκτιρμοῖς ἔναντι πάντων τῶν αἰχμαλωτισάντων αὐτούς καὶ ἀποστρέψει εἰς τὴν γῆν ταύτην ὅτι ἐλεήμων καὶ οἰκτιρῶν κύριος ὁ θεὸς ὑμῶν καὶ οὐκ ἀποστρέψει τὸ πρόσωπον αὐτοῦ ἀφ' ἡμῶν ἐὰν ἐπιστρέψωμεν πρὸς αὐτόν
- 10 Dhe korrierët kaluan nga një qytet në tjetrin në vendin e Efraimit dhe të Manasit deri në Zabulon; por njerëzit i përqeshnin dhe talleshin me ta.  
So the runners went from town to town through all the country of Ephraim and Manasseh as far as Zebulun: but they were laughed at and made sport of.  
καὶ ἦσαν οἱ τρέχοντες διαπορευόμενοι πόλιν ἐκ πόλεως ἐν τῷ ὄρει εφραιμ καὶ μανασση καὶ ἕως ζαβουλὸν καὶ ἐγένοντο ὡς καταγελῶντες αὐτῶν καὶ καταμωκόμενοι
- 11 Megjithatë disa burra nga Asheri, nga Zabuloni dhe nga Manasi u përulën dhe erdhën në Jeruzalem.  
However, some of Asher and Manasseh and Zebulun put away their pride and came to Jerusalem.  
ἀλλὰ ἄνθρωποι ἀσρη καὶ ἀπὸ μανασση καὶ ἀπὸ ζαβουλὸν ἐνετρέψθησαν καὶ ἦλθον εἰς ἱερουσαλημ
- 12 Por në Judë dora e Perëndisë veproi duke u dhënë atyre një zemër të njëlojtë për të kryer urdhrin e mbretit dhe të parisë, sipas fjalës të Zotit.  
And in Judah the power of God gave them one heart to do the orders of the king and the captains, which were taken as the word of the Lord.  
καὶ ἐν ἰουδα ἐγένετο χεῖρ κυρίου δοῦναι αὐτοῖς καρδίαν μίαν ἐλθεῖν τοῦ ποιῆσαι κατὰ τὸ πρόσταγμα τοῦ βασιλέως καὶ τῶν ἀρχόντων ἐν λόγῳ κυρίου
- 13 Një turmë e madhe u mbledh në Jeuzalem për të kremtuar festën e të Ndormëve gjatë muajit të dytë; ishte një kuvend shumë i madh.  
So a very great number of people came together at Jerusalem to keep the feast of unleavened bread in the second month.  
καὶ συνήχθησαν εἰς ἱερουσαλημ λαὸς πολὺς τοῦ ποιῆσαι τὴν ἑορτὴν τῶν ἀζύμων ἐν τῷ μηνὶ τῷ δευτέρῳ ἐκκλησία πολλὴ σφόδρα
- 14 U ngritën dhe zhdukën altarët që ishin në Jeruzalem; zhdukën gjithashtu tërë altarët e temjanit dhe i hodhën në përroin e Kidronit.  
And they got to work and took away all the altars in Jerusalem, and they put all the vessels for burning perfumes into the stream Kidron.  
καὶ ἀνέστησαν καὶ καθεῖλαν τὰ θυσιαστήρια τὰ ἐν ἱερουσαλημ καὶ πάντα ἐν οἷς ἐθυμῶσαν τοῖς ψευδέσιν κατέσπασαν καὶ ἔρριψαν εἰς τὸν χειμάρρον κεδρὸν
- 15 Pastaj flijuan Pashkën, ditën e katërbëdhjetë të muajit të dytë. Priftërinjtë dhe Levitët, plot turp, u shenjtëruan dhe ofruan olokauste në shtëpinë e Zotit.  
Then on the fourteenth day of the second month they put the Passover lambs to death: and the priests and the Levites were shamed, and made themselves holy and took burned offerings into the house of the Lord.  
καὶ ἔθυσαν τὸ φασεκ τῇ τεσσαρεσκαίδεκάτῃ τοῦ μηνὸς τοῦ δευτέρου καὶ οἱ ἱερεῖς καὶ οἱ λευῖται ἐνετρέψθησαν καὶ ἡγνίσθησαν καὶ εἰσήνεκαν ὀλοκαυτώματα εἰς οἶκον κυρίου
- 16 Ata zunë vendet që u përkisnin sipas normave të përshkruara nga ligji i Moisiut, njeriut të Perëndisë. Priftërinjtë spërkatnin gjakun, që merrnin nga duart e Levitëve.  
And they took their places in their right order, as it was ordered in the law of Moses, the man of God: the priests draining out on the altar the blood given them by the Levites.  
καὶ ἔστησαν ἐπὶ τὴν στάσιν αὐτῶν κατὰ τὸ κρίμα αὐτῶν κατὰ τὴν ἐντολὴν μουσῆ ἀνθρώπου τοῦ θεοῦ καὶ οἱ ἱερεῖς ἐδέχοντο τὰ αἵματα ἐκ χειρὸς τῶν λευιτῶν
- 17 Duke qenë se shumë njerëz të asamblesë nuk ishin shenjtëruar, Levitët kishin për detyrë t'i flijonin qengjat e Pashkës për tërë ata që nuk ishin të pastër, për t'ia shenjtëruar Zotit.  
For there were still a number of the people there who had not made themselves holy: so the Levites had to put Passover lambs to death for those who were not clean, to make them holy to the Lord.  
ὅτι πλῆθος τῆς ἐκκλησίας οὐχ ἡγνίσθη καὶ οἱ λευῖται ἦσαν τοῦ θύειν τὸ φασεκ παντὶ τῷ μὴ δυναμένῳ ἡγνισθῆναι τῷ κυρίῳ
- 18 Në të vërtetë një pjesë e madhe e popullit, shumë nga Efraimi, nga Manasi, nga Isakari dhe nga Zabuloni nuk ishin pastruar, dhe e hëngrenë njëlojtë Pashkën, duke vepruar ndryshe nga sa ishte shkruar. Por Ezekia u lut për ata, duke thënë: &quot;Zoti, që është i mirë, të falë cilindo  
For a great number of the people from Ephraim and Manasseh, Issachar and Zebulun, had not made themselves clean, but they took the Passover meal, though not in the right way. For Hezekiah had made prayer for them, saying, May the good Lord have mercy on everyone  
- 14 Në të vërtetë ti je dërguar nga ana e mbretit dhe nga shtatë këshilltarët e tij për të bërë hulumtime në Judë dhe në Jeruzalem mbi ligjin e Perëndisë tënd, që është në duart e tua,  
Because you are sent by the king and his seven wise men, to get knowledge about Judah and Jerusalem, as you are ordered by the law of your God which is in your hand;  
καὶ ἠγάγosan τὴν ἑορτὴν τῶν ἄζύμων ἐπτὰ ἡμέρας εὐφραινόμενοι ἔναντι τοῦ κυρίου
- 15 dhe për t'i cuar argjendin dhe arin që mbreti dhe këshilltarët e tij ia kanë ofruar spontanisht Perëndisë të Izraelit, banesa e të cilit është në Jeruzalem,  
And to take with you the silver and gold freely offered by the king and his wise men to the God of Israel, whose Temple is in Jerusalem,  
ὅτι μετέστρεψεν τὴν βουλὴν τοῦ βασιλέως ἄσσυρίων ἐπ' αὐτοὺς κατισχύσαι τὰς χεῖρας αὐτῶν ἐπὶ τὰ ἔργα κυρίου θεοῦ ἰσραὴλ
- 1 Këta janë krerët e shtëpive atërore dhe lista gjenealogjike e atyre që u kthyen me mua nga Babilonia, nën mbretërimin e Artasersit.  
Now these are the heads of families who were listed of those who went up with me from Babylon, when Artaxerxes was king.  
καὶ μεταγενέστερος τούτων βασιλεύοντος ἀρταξέρξου τοῦ περσῶν βασιλέως προσέβη εσδρας σαραιου τοῦ ἐζερίου τοῦ χελκίου τοῦ σαλημου
- 2 Nga bijtë e Finehasit, Gershomit; nga bijtë e Ithamarit, Danieli; nga bijtë e Davidit, Hatushi.  
Of the sons of Phinehas, Gershom; of the sons of Ithamar, Daniel; of the sons of David, Hattush;  
τοῦ σαδδουκου τοῦ αχιτωβ τοῦ αμαριου τοῦ οζιου τοῦ βοκκα τοῦ αβισουε τοῦ φινεεε τοῦ ελεαζαρ τοῦ ααρων τοῦ πρώτου ἱερέως
- 3 Nga bijtë e Shekaniahut; nga bijtë e Paroshit, Zakaria, dhe bashkë me të u regjistruan njëqind e pesëdhjetë meshkuj.  
Of the sons of Shecaniah; of the sons of Parosh, Zechariah; and with him were listed a hundred and fifty males.  
οὗτος εσδρας ἀνέβη ἐκ βαβυλώνας ὡς γραμματεὺς εὐφροῆς ὢν ἐν τῷ μουσέως νόμῳ τῷ ἐκδεδομένῳ ὑπὸ τοῦ θεοῦ τοῦ ἰσραὴλ

- 4 Nga bijtë e Pahath-Moabit, Elihoenai, bir i Zeremiahut, dhe me të dyqind meshkuj.  
Of the sons of Pahath-moab, Elihoenai, the son of Zeremiah; and with him two hundred males.  
καὶ ἔδωκεν αὐτῷ ὁ βασιλεὺς δόξαν εὐρόντος χάριν ἐναντίον αὐτοῦ ἐπὶ πάντα τὰ ἀξιώματα αὐτοῦ
- 5 Nga bijtë e Shekaniahut, i biri i Jahazielit dhe bashkë me të treqind meshkuj.  
Of the sons of Shecaniah, the son of Jahaziel; and with him three hundred males.  
καὶ συνανέβησαν ἐκ τῶν υἱῶν ἰσραὴλ καὶ τῶν ἱερέων καὶ λευιτῶν καὶ ἱεροψαλτῶν καὶ θυρωρῶν καὶ ἱεροδοῦλων εἰς ἱεροσόλυμα ἔτους ἑβδόμου βασιλεύοντος ἀρταξέρξου ἐν τῷ πέμπτῳ μηνί οὗτος ἐνὶ αὐτῷ ἔβδομος τῷ βασιλεῖ
- 6 Nga bijtë e Adinit, Ebedi, bir i Jonathanit, dhe bashkë me të pesëdhjetë meshkuj.  
And of the sons of Adin, Ebed, the son of Jonathan; and with him fifty males.  
ἐξεληθόντες γὰρ ἐκ βαβυλωνῶν τῇ νομηνίᾳ τοῦ πρώτου μηνὸς ἐν τῇ νομηνίᾳ τοῦ πέμπτου μηνὸς παρεγένοντο εἰς ἱεροσόλυμα κατὰ τὴν δοθεῖσαν αὐτοῖς εὐοδίαν παρὰ τοῦ κυρίου ἐπ' αὐτῷ
- 7 Nga bijtë e Elamit, Isai, bir i Athaliahut, dhe bashkë me të shtatëdhjetë meshkuj.  
And of the sons of Elam, Jeshaiah; the son of Athaliah; and with him seventy males.  
ὁ γὰρ ἐσδρας πολλὴν ἐπιστήμην περιεῖχεν εἰς τὸ μηδὲν παραλείπει τῶν ἐκ τοῦ νόμου κυρίου καὶ ἐκ τῶν ἐντολῶν διδάξαι τὸν πάντα ἰσραὴλ πάντα τὰ δικαιώματα καὶ τὰ κρίματα
- 8 Nga bijtë e Shefatiahut, Zebadiah, bir i Mikaelit, dhe bashkë me të tetëdhjetë meshkuj.  
And of the sons of Shephatiah, Zebadiah, the son of Michael; and with him eighty males.  
προσπεσόντος δὲ τοῦ γραφέντος προστάγματος παρὰ ἀρταξέρξου τοῦ βασιλέως πρὸς ἐσδραν τὸν ἱερέα καὶ ἀναγνώστην τοῦ νόμου κυρίου οὗ ἔστιν ἀντίγραφον τὸ ὑποκείμενον
- 9 Nga bijtë e Joabit, Obadiah, bir i Jehielit, dhe bashkë me të dyqind e tetëmbëdhjetë meshkuj.  
Of the sons of Joab, Obadiah, the son of Jehiel; and with him two hundred and eighteen males.  
βασιλεὺς ἀρταξέρξου ἐσδρα τῷ ἱερεῖ καὶ ἀναγνώστη τῷ νόμου κυρίου χαίρειν
- 10 Nga bijtë e Shelomithit, bir i Josifiahut dhe bashkë me të njëqind e gjashtëdhjetë meshkuj.  
And of the sons of Shelomith, the son of Josiphiah; and with him a hundred and sixty males.  
καὶ τὰ φιλόνηρα ἐγὼ κρίνας προσέταξα τοῖς βουλομένοις ἐκ τοῦ ἔθνους τῶν ἰουδαίων αἰρετίζοντας καὶ τῶν ἱερέων καὶ τῶν λευιτῶν καὶ τῶν δὲ ἐν τῇ ἡμετέρᾳ βασιλείᾳ συμπορεύεσθαι σοι εἰς ἱεροσόλυμα
- 11 Nga bijtë e Bebeit, Zakaria, bir i Bebeit, dhe bashkë me të njëzet e tetë meshkuj.  
And of the sons of Bebai, Zechariah, the son of Bebai; and with him twenty-eight males.  
ὅσοι οὖν ἐνθυμοῦνται συνεξορμάτωσαν καθάπερ δέδοκται ἐμοί τε καὶ τοῖς ἐπτά φίλοις συμβουλευταῖς
- 12 Nga bijtë e Azgadit, Johanani, bir i Hakatas, dhe bashkë me të njëqind e dhjetë meshkuj.  
And of the sons of Azgad, Johanan, the son of Hakatan; and with him a hundred and ten males.  
ὅπως ἐπισκέψονται τὰ κατὰ τὴν ἰουδαίαν καὶ ἱερουσαλὴμ ἀκολούθως ᾧ ἔχει ἐν τῷ νόμῳ τοῦ κυρίου
- 13 Nga bijtë e Adonikamit, të fundit, emrat e të cilëve ishin: Elifelet, Jehiel dhe Shemajah, dhe bashkë me ta gjashtëdhjetë meshkuj.  
And of the sons of Adonikam, the last, whose names were Eliphelet, Jeuel, and Shemaiah; and with them sixty males.  
καὶ ἀπενεγκεῖν δῶρα τῷ κυρίῳ τοῦ ἰσραὴλ ἃ ἠξάμην ἐγὼ τε καὶ οἱ φίλοι εἰς ἱερουσαλὴμ καὶ πᾶν χρυσίον καὶ ἀργύριον ὃ ἐὰν εὔρεθῇ ἐν τῇ χώρᾳ τῆς βαβυλωνίας τῷ κυρίῳ εἰς ἱερουσαλὴμ σὺν τῷ δεδωρημένῳ ὑπὸ τοῦ ἔθνους εἰς τὸ ἱερὸν τοῦ κυρίου αὐτῶν τὸ ἐν ἱερουσαλὴμ
- 14 Nga bijtë e Bigvait, Uthai dhe Zabudi, dhe bashkë me ta shtatëdhjetë meshkuj.  
And of the sons of Bigvai, Uthai and Zabbud; and with them seventy males.  
συναχθῆναι τὸ τε χρυσίον καὶ ἀργύριον εἰς ταύρους καὶ κριοὺς καὶ ἄρνας καὶ τὰ τούτοις ἀκόλουθα
- 15 Unë i mbledha pranë lumit që rrjedh në drejtim të Ahavës, dhe fusham aty tri ditë. Kur kalova në revistë popullin dhe priftërinjtë, nuk gjeta asnjë bir Leviti.  
And I made them come together by the river flowing to Ahava; and we were there in tents for three days: and after viewing the people and the priests I saw that no sons of Levi were there.  
ὥστε προσενεγκεῖν θυσίας ἐπὶ τὸ θυσιαστήριον τοῦ κυρίου αὐτῶν τὸ ἐν ἱερουσαλὴμ
- 16 Atëherë dërgova të thërrasë Eliezerin, Arielin, Shemajahun, Elnathanin, Jaribin, Elnathanin, Nathanin, Zakarian dhe Meshulam, që ishin të parë, si edhe Jojaribin dhe Elnathanin që ishin njerëz të urtë,  
Then I sent for Eliezer and Ariel and Shemaiah and Elnathan Jarib and Elnathan and Nathan and Zechariah and Meshullam, all responsible men; and for Jojarib and Elnathan, who were wise men.  
καὶ πάντα ὅσα ἂν βούλῃ μετὰ τῶν ἀδελφῶν σου ποιῆσαι χρυσίῳ καὶ ἀργυρίῳ ἐπιτέλει κατὰ τὸ θέλημα τοῦ θεοῦ σου

- 17 dhe i urdhërova të shkolin tek Ido, kreu i lokalitetit të Kasifias, dhe u vura në gojë fjalët që duhet t'i thonin Idos dhe vëllezërve të tij, Nethinejve në lokalitetin e Kasifias, që të na dërgonin njerëz që të kryenin shërbimin në shtëpinë e Perëndisë tonë.  
 And I sent them to Iddo the chief at the place Casiphia, and gave them orders what to say to Iddo and his brothers the Nethinim at the place Casiphia, so that they might come back to us with men to do the work of the house of our God.  
 και τὰ ἱερά σκεύη τοῦ κυρίου τὰ διδόμενά σοι εἰς τὴν χρεῖαν τοῦ ἱεροῦ τοῦ θεοῦ σου τοῦ ἐν ἱερουσαλημ
- 18 Me qenë se dora mirëbërëse e Perëndisë tonë ishte mbi ne, ata na dërguan Sherebiahun, një njeri me mend, nga bijtë e Mahlit, birit të Levit, bir i Izraelit, bashkë me bijtë e vëllezërit e tij, gjithsej tetëmbëdhjetë;  
 And by the help of our God they got for us Ish-sechel, one of the sons of Mahli, the son of Levi, the son of Israel; and Sherebiah with his sons and brothers, eighteen;  
 και τὰ λοιπά ὅσα ἂν ὑποπίπτη σοι εἰς τὴν χρεῖαν τοῦ ἱεροῦ τοῦ θεοῦ σου δώσεις ἐκ τοῦ βασιλικοῦ γαζοφυλακίου
- 19 dhe Hashabiahun, dhe me të Isai nga bijtë e Merarit, vëllezërit dhe bijtë e tyre, gjithsej njëzet;  
 And Hashabiah, and with him Jeshai of the sons of Merari, his brothers and their sons, twenty;  
 κἀγὼ δὲ ἄρταξέρξης ὁ βασιλεὺς προσέταξα τοῖς γαζοφύλαξι σαρίας καὶ φοινίκης ἵνα ὅσα ἂν ἀποστεύῃ εσδρας ὁ ἱερεὺς καὶ ἀναγνώστης τοῦ νόμου τοῦ θεοῦ τοῦ ὑψίστου ἐπιμελῶς διδώσιν αὐτῷ ἕως ἀργυρίου ταλάντων ἑκατὸν
- 20 dhe nga Nethinej, që Davidi dhe krerët kishin caktuar në shërbim të Levitëve, dyqind e njëzet Nethinej, të gjithë të caktuar me emër.  
 And of the Nethinim, to whom David and the captains had given the work of helping the Levites, two hundred and twenty Nethinim, all of them specially named.  
 ὁμοίως δὲ καὶ ἕως πυροῦ κόρων ἑκατὸν καὶ οἴνου μετρητῶν ἑκατὸν καὶ ἄλλα ἐκ πλήθους
- 21 Aty, pranë lumit Ahava, unë shpalla një agjërime për t'u përlur përpara Perëndisë tonë, për t'i kërkuar një udhëtim të sigurt për ne, për fëmijët tanë dhe për të gjitha pasuritë tona.  
 Then I gave orders for a time of going without food, there by the river Ahava, so that we might make ourselves low before our God in prayer, requesting from him a straight way for us and for our little ones and for all our substance.  
 πάντα τὰ κατὰ τὸν τοῦ θεοῦ νόμον ἐπιτελεσθήτω ἐπιμελῶς τῷ θεῷ τῷ ὑψίστῳ ἕνεκα τοῦ μὴ γενέσθαι ὀργὴν εἰς τὴν βασιλείαν τοῦ βασιλέως καὶ τῶν υἱῶν
- 22 Në fakt unë kisha turp t'i kërkoja mbretit një roje ushtarësh dhe kalorësish që të na mbronte nga armiku gjatë udhëtimit, sepse i kishim thënë mbretit: "Dora e Perëndisë tonë është mbi të gjithë ata që kërkojnë për të mirën e tyre, por fuqia e tij dhe zemërimi i tij janë kundër të gjithë atyre që e braktisin";  
 For I would not, for shame, make request to the king for a band of armed men and horsemen to give us help against those who might make attacks on us on the way: for we had said to the king, The hand of our God is on his servants for good, but his power and his wrath are against all those who are turned away from him.  
 και ὑμῖν δὲ λέγεται ὅπως πᾶσι τοῖς ἱερεῦσιν καὶ τοῖς λευίταις καὶ ἱεροψάλταις καὶ θυρωροῖς καὶ ἱεροδοῦλοις καὶ πραγματικοῖς τοῦ ἱεροῦ τούτου μηδεμίαν φορολογία μηδὲ ἄλλη ἐπιβολὴ γίγνηται καὶ ἐξουσίαν μηδένα ἔχειν ἐπιβαλεῖν τι τούτοις
- 23 Kështu ne agjeruam dhe iu lutëm Perëndisë tonë për këtë arësye, dhe ai e dëgjoi lutjen tonë.  
 So we went without food, requesting our God for this: and his ear was open to our prayer.  
 και σὺ εσδρα κατὰ τὴν σοφίαν τοῦ θεοῦ ἀνάδειξον κριτὰς καὶ δικαστὰς ὅπως δικάζωσιν ἐν ὅλῃ σαρῖα καὶ φοινίκη πάντας τοὺς ἐπισταμένους τὸν νόμον τοῦ θεοῦ σου καὶ τοὺς μὴ ἐπισταμένους δὲ διδάξεις
- 24 Atëherë unë zgjodha dymbëdhjetë nga krerët e priftërinjve: Sherebiahun, Hashabiahun dhe bashkë me ta dhjetë nga vëllezërit e tyre,  
 So I put on one side twelve of the chiefs of the priests, Sherebiah, Hashabiah, and ten of their brothers with them,  
 και πάντες ὅσοι ἐὰν παραβαίνωσι τὸν νόμον τοῦ θεοῦ σου καὶ τὸν βασιλικὸν ἐπιμελῶς κολασθήσονται ἐάν τε καὶ θανάτῳ ἐάν τε καὶ τιμωρίᾳ ἢ ἀργυρικῇ ζημίᾳ ἢ ἀπαγωγῇ
- 25 dhe u peshova atyre argjendin, arin, veglat, që ishin oferta e bërë për shtëpinë e Perëndisë tonë nga mbreti, nga këshilltarët dhe nga paria e tij, dhe nga të gjithë Izraelitët që ndodheshin atje.  
 And gave to them by weight the silver and the gold and the vessels, all the offering for the house of our God which the king and his wise men and his captains and all Israel there present had given:  
 εὐλογητὸς μόνος ὁ κύριος ὁ δὸς ταῦτα εἰς τὴν καρδίαν τοῦ βασιλέως δοῦναι τὸν οἶκον αὐτοῦ τὸν ἐν ἱερουσαλημ
- 26 Në duart e tyre peshova gjithashtu gjashtëqind e pesëdhjetë talenta argjendi, vegla prej argjendi me një vlerë prej njëqind talentash, njëqind talenta ari,  
 Measuring into their hands six hundred and fifty talents of silver, and silver vessels, a hundred talents' weight, and a hundred talents of gold,  
 και ἐμὲ ἐτίμησεν ἔναντι τοῦ βασιλέως καὶ τῶν συμβουλευόντων καὶ πάντων τῶν φίλων καὶ μεγιστάνων αὐτοῦ
- 27 njëzet kupa ari me një vlerë prej një mijë darikë, dy enë prej bronzi të hollë dhe të shndritshëm, i çmueshëm si ari.  
 And twenty gold basins, of a thousand darics, and two vessels of the best bright brass, equal in value to gold.  
 και ἐγὼ εὐθαρσῆς ἐγενόμην κατὰ τὴν ἀντίληψιν κυρίου τοῦ θεοῦ μου καὶ συνήγαγον ἐκ τοῦ ἱσραηλ ἄνδρας ὥστε συναβῆναι μοι
- 28 Pastaj u thashë atyre: "Ju i jeni shenjtëruar Zotit; edhe përdorëset janë të shenjta, dhe argjendi dhe ari janë një ofertë vullnetare për Zotin, Perëndinë e etërve tuaj.  
 And I said to them, You are holy to the Lord and the vessels are holy: and the silver and the gold are an offering freely given to the Lord, the God of your fathers.  
 και οὗτοι οἱ προηγούμενοι κατὰ τὰς πατριὰς αὐτῶν καὶ τὰς μεριδαρχίας οἱ ἀναβάντες μετ' ἐμοῦ ἐκ βαβυλῶνος ἐν τῇ βασιλείᾳ ἀρταξέρξου τοῦ βασιλέως

- 29** Kini kujdes dhe ruajini deri sa t'i peshoni përpara krerëve të priftërinjve, Levitëve dhe të parëve të shtëpive atërore të Izraelit në Jeruzalem, në dhomat e shtëpisë të Zotit;
- Take care of them and keep them, till you put them on the scales before the chiefs of the priests and the Levites and the chiefs of the families of Israel, in Jerusalem, in the rooms of the house of the Lord.*
- ἐκ τῶν υἰῶν φινεες γαρσομος ἐκ τῶν υἰῶν ιεταμαρου γαμηλος ἐκ τῶν υἰῶν δαυιδ αττους ὁ σεχενιου*
- 30** Kështu priftërinjtë dhe Levitët morën argjendin, arin dhe veglat që u peshuan atëherë, për t'i çuar në Jeruzalem në shtëpinë e Perëndisë tonë.
- So the priests and the Levites took the weight of silver and gold and the vessels, to take them to Jerusalem into the house of our God.*
- ἐκ τῶν υἰῶν φορος ζαχαριας καὶ μετ' αὐτοῦ ἀπὸ γραφῆς ἄνδρες ἑκατὸν πενήκοντα*
- 31** Ditën e dymbëdhjetë të muajit të parë u nisëm nga lumi Ahava për të shkuar në Jeruzalem; dora e Perëndisë tonë ishte mbi ne dhe gjatë udhëtimit na liroi nga armiku dhe nga pritat e tij.
- Then we went away from the river of Ahava on the twelfth day of the first month, to go to Jerusalem; and the hand of our God was on us, and he gave us salvation from our haters and those who were waiting to make an attack on us by the way.*
- ἐκ τῶν υἰῶν φασθμοαβ ελιαωνιας ζαριαου καὶ μετ' αὐτοῦ ἄνδρες διακόσιοι*
- 32** Arritëm kështu në Jeruzalem dhe qëndruam tri ditë atje.
- And we came to Jerusalem and were there for three days.*
- ἐκ τῶν υἰῶν ζαθοης σεχενιας ιεζηλου καὶ μετ' αὐτοῦ ἄνδρες τριακόσιοι ἐκ τῶν υἰῶν αδιου βην-ιωναθου καὶ μετ' αὐτοῦ ἄνδρες διακόσιοι πενήκοντα*
- 33** Ditën e katërt në shtëpinë e Perëndisë tonë, u peshuan argjendi, ari dhe veglat në duart e Meremthit, birit të priftit Uriah, me të cilin ishte Eleazari, bir i Finehasit, dhe me ta Levitët Jozabad, bir i Jeshuas, dhe Noadiah, bir i Binuit.
- And on the fourth day, the silver and the gold and the vessels were measured out by weight in the house of our God into the hands of Meremoth, the son of Uriah, the priest; and with him was Eleazar, the son of Phinehas; and with them were Jozabad, the son of Jeshua, and Noadiah, the son of Binnui, the Levites;*
- ἐκ τῶν υἰῶν ηλαμ ιεσιας γοθολιου καὶ μετ' αὐτοῦ ἄνδρες ἑβδομήκοντα*
- 34** U njëhsua dhe u peshua çdo gjë; dhe pesha e të gjitha gjërave u vu me shkrim.
- All was handed over by number and by weight: and the weight was put on record at that time.*
- ἐκ τῶν υἰῶν σαφατιου ζαριας μιχαηλου καὶ μετ' αὐτοῦ ἄνδρες ἑβδομήκοντα*
- 35** Të mërguarit që u kthyen nga robëria, i ofruan si olokauste Perëndisë të Izraelit dymbëdhjetë dema për tërë Izraelin, nëntëdhjetë e gjashtë desh, shtatëdhjetë e shtatë qengja dhe dymbëdhjetë cjep si flijim për mëkatin, e tërë kjo si olokaust për Zotin.
- And those who had been prisoners, who had come back from a strange land, made burned offerings to the God of Israel, twelve oxen for all Israel, ninety-six male sheep, seventy-seven lambs, twelve he-goats for a sin-offering; all this was a burned offering to the Lord.*
- ἐκ τῶν υἰῶν ιωαβ αβαδιας ιεζηλου καὶ μετ' αὐτοῦ ἄνδρες διακόσιοι δέκα δύο*
- 36** Pastaj ua dorëzuan dekretet e mbretit satrapëve të mbretit dhe qeveritarëve të krahinës matanë Lumit, dhe këta ndihmuan popullin dhe shtëpinë e Perëndisë.
- And they gave the king's orders to the king's captains and the rulers across the river, and they gave the people and the house of God the help which was needed.*
- ἐκ τῶν υἰῶν βανι ασσαλιμωθ ιωσαφιου καὶ μετ' αὐτοῦ ἄνδρες ἑκατὸν ἐξήκοντα*
- 1** Mbasi përfunduan këto gjëra, krerët erdhën tek unë, duke thënë: "Populli i Izraelit, priftërinjtë dhe Levitët nuk janë ndarë nga popujt e këtyre vendeve, për gjërat e neveritshme të Kananejve, të
- Now after these things were done, the captains came to me and said, The people of Israel and the priests and Levites have not kept themselves separate from the people of the lands, but have taken part in the disgusting ways of the Canaanites, the Hittites, the Perizzites, the Jebusites, the Ammonites, the Moabites, the Egyptians, and the Amorites.*
- καὶ ἀναστὰς εσδρας ἀπὸ τῆς ἀλλῆς τοῦ ἱεροῦ ἐπορεύθη εἰς τὸ παστοφόριον ιωαναν τοῦ ελιασιβου*
- 2** Në fakt ata kanë marrë si bashkëshorte disa nga bijat e tyre për vete dhe për bijtë e tyre, duke përzier kështu fisin e shenjtë me popujt e këtyre vendeve. Mjerisht gjyqtarët kanë qenë të parët që e kryen këtë mëkat;
- For they have taken their daughters for themselves and for their sons, so that the holy seed has been mixed with the peoples of the lands; and in fact the captains and rulers have been the first to do this evil.*
- καὶ ἀλλισθεῖς ἐκεῖ ἄρτου οὐκ ἐγεύσατο οὐδὲ ὕδωρ ἔπιεν πενθῶν ὑπὲρ τῶν ἀνομιῶν τῶν μεγάλων τοῦ πλήθους*
- 3** Kur dëgjova këtë gjë, grisa rrobat dhe mantelin, shkula flokët e kokës dhe mjekrën, dhe u ula i shtangur.
- And hearing this, with signs of grief and pulling out the hair of my head and my chin, I took my seat on the earth deeply troubled.*
- καὶ ἐγένετο κήρυγμα ἐν ὅλῃ τῇ ιουδαίᾳ καὶ ιερουσαλημ πᾶσι τοῖς ἐκ τῆς αἰχμαλωσίας συναχθῆναι εἰς ιερουσαλημ*



- 4 Atëherë tërë ata që dridheshin nga fjalët e Perëndisë të Izraelit u mblodhën rreth meje për shkak të mëkatit të atyre që ishin kthyer nga robëria; dhe unë mbeta i ulur dhe i shtangur deri në blatimin e mbrëmjes.  
Then everyone who went in fear of the words of the God of Israel, because of the sin of those who had come back, came together to me; and I kept where I was, overcome with grief, till the evening offering.  
καὶ ὅσοι ἂν μὴ ἀπαντήσωσιν ἐν δυσὶν ἢ τρισὶν ἡμέραις κατὰ τὸ κρίμα τῶν προκαθημένων πρεσβυτέρων ἀνιερωθήσονται τὰ κτήνη αὐτῶν καὶ αὐτοὺς ἀλλοτριωθήσεται ἀπὸ τοῦ πλήθους τῆς αἰχμαλωσί-  
ας
- 5 Në blatimin e mbrëmjes u ngrita nga agjerimi, me rrobat dhe mantelin të grisur; pastaj rashë në gjunjë dhe shtriva duart nga Zoti, Perëndia im,  
And at the evening offering, having made myself low before God, I got up, and with signs of grief, falling down on my knees, with my hands stretched out to the Lord my God,  
καὶ ἐπισυνήχθησαν οἱ ἐκ τῆς φυλῆς ἰουδα καὶ βενιαμιν ἐν τρισὶν ἡμέραις εἰς ἱερουσαλημ οὗτος ὁ μὴν ἔνατος τῆ εἰκάδι τοῦ μηνός
- 6 dhe thashë: "O Perëndia im, unë jam i pështjelluar dhe më vjen turp të ngre fytyrën time ndaj teje, o Perëndia im, sepse paudhësitë tona janë shumëzuar deri mbi kokën tonë, dhe faji ynë ka arritur deri në qiell.  
I said, O my God, shame keeps me from lifting up my face to you, my God: for our sins are increased higher than our heads and our evil-doing has come up to heaven.  
καὶ συνεκάθισαν πᾶν τὸ πλήθος ἐν τῇ εὐρυχώρῳ τοῦ ἱεροῦ τρέμοντες διὰ τὸν ἐνεστώτα χειμῶνα
- 7 Nga ditët e etërve tanë deri në ditën e sotme kemi qenë shumë fajtorë, dhe për shkak të paudhësive tona ne, mbretërit tanë dhe priftërinjtë tanë u lamë në duart e mbretërve të kombeve të huaja, nën kanosjen e shpatës, të internimit, të plaçkitjes dhe të turp-it, ashtu si po ndodh tani.  
From the days of our fathers till this day we have been great sinners; and for our sins, we and our kings and our priests have been given up into the hands of the kings of the lands, to the sword and to prison and to loss of goods and to shame of face, as it is this day.  
καὶ ἀναστάς εὐδρας εἶπεν αὐτοῖς ὑμεῖς ἠνομήσατε καὶ συνφύκατε γυναῖκας ἀλλογενεῖς τοῦ προσθεῖναι ἁμαρτίαν τῷ ἰσραηλ
- 8 Por tani Zoti, Perëndia ynë, na ka dhënë hir për një çast të shkurtër, duke na lënë një mbetje dhe duke na dhënë një strehë në vendin e tij të shenjtë, dhe kështu Perëndia ynë i ka ndriçuar sytë tanë dhe na ka dhënë një rizgjim të vogël në skllavërinë tonë.  
And now for a little time grace has come to us from the Lord our God, to let a small band of us get free and to give us a nail in his holy place, so that our God may give light to our eyes and a measure of new life in our prison chains.  
καὶ νῦν δότε ὁμολογίαν δόξαν τῷ κυρίῳ θεῷ τῶν πατέρων ἡμῶν
- 9 Në të vërtetë ne ishim skllavër, megjithatë Perëndia ynë nuk na braktisi në skllavërinë tonë, por na siguroi mirëdashjen e mbretërve të Persisë, duke na rizgjuar për të ngritur përsëri shtëpinë e Perëndisë tonë, duke restauruar rrënojat e saj dhe për të na dhënë një mur mbrojtjeje në Judë dhe Jeruzalem.  
For we are servants; but our God has not been turned away from us in our prison, but has had mercy on us before the eyes of the kings of Persia, to give us new strength to put up again the house of our God and to make fair its waste places, and to give us a wall in Judah and Jerusalem.  
καὶ ποιῆσατε τὸ θέλημα αὐτοῦ καὶ χωρίσητε ἀπὸ τῶν ἐθνῶν τῆς γῆς καὶ ἀπὸ τῶν γυναικῶν τῶν ἀλλογενῶν
- 10 Por tani, o Perëndia ynë, çfarë do të themi pas kësaj? Sepse i kemi braktisur urdhërimet e tua,  
And now, O our God, what are we to say after this? for we have not kept your laws,  
καὶ ἐφώνησαν ἅπαν τὸ πλήθος καὶ εἶπον μεγάλη τῇ φωνῇ οὕτως ὡς εἱρηκας ποιήσομεν
- 11 që na kishe urdhëruar me anë të shërbëtorëve të tu, profetëve, duke thënë: "Vendi në të cilin po hyni për ta shtë në dorë është një vend i papastër për shkak të papastërtisë së popujve të këtyre vendeve, për shkak të gjërave të neveritshme me të cilat e kanë mbushur fund e krye me ndotjet e tyre.  
Which you gave to your servants the prophets, saying, The land into which you are going, to take it for a heritage, is an unclean land, because of the evil lives of the peoples of the land and their disgusting ways, which have made the land unclean from end to end.  
ἀλλὰ τὸ πλήθος πολὺ καὶ ἡ ὥρα χειμερινή καὶ οὐκ ἰσχύομεν στήναι αἰθριοὶ καὶ οὐχ εὐρομεν καὶ τὸ ἔργον ἡμῖν οὐκ ἔστιν ἡμέρας μιᾶς οὐδὲ δύο ἐπὶ πλεῖον γὰρ ἡμάρτομεν ἐν τούτοις
- 12 Prandaj tani mos u jepni bijat tuaja bijve të tyre dhe mos merrni bijat e tyre për bijtë tuaj; mos kërkoni kurrë begatinë e tyre, as mirëqënien e tyre, sepse kështu do të bëheni të fortë, do të hani prodhimet më të mira të vendit dhe do t'ua lini atë në trashëgimi bijve tuaj përjetë."  
So now do not give your daughters to their sons or take their daughters for your sons or do anything for their peace or well-being for ever; so that you may be strong, living on the good of the land, and handing it on to your children for a heritage for ever.  
στήτωσαν δὲ οἱ προηγούμενοι τοῦ πλήθους καὶ πάντες οἱ ἐκ τῶν κατοικιῶν ἡμῶν ὅσοι ἔχουσιν γυναῖκας ἀλλογενεῖς παραγενηθήτωσαν λαβόντες χρόνον
- 13 Por mbas gjithë asaj që na ra mbi krye për shkak të veprimeve tona të këqija dhe të fajeve tona të mëdha, duke qenë se ti, o Perëndia ynë, na dënove më pak nga sa e meritoni fajet tona dhe na le një pikë si kjo,  
And after everything which has come on us because of our evil-doing and our great sin, and seeing that the punishment which you, O God, have given us, is less than the measure of our sins, and that you have kept from death those of us who are here;  
καὶ ἐκάστου δὲ τόπου τοὺς πρεσβυτέρους καὶ τοὺς κριτὰς ἕως τοῦ λῦσαι τὴν ὀργὴν τοῦ κυρίου ἀφ' ἡμῶν τοῦ πράγματος τούτου

- 14 a do të kthehemi përsëri të shkelim urdhërimet e tua dhe të bashkohemi me martesë me popujt që kryejnë këto gjëra të neveritshme? A nuk do të zemëroheshe kundër nesh deri sa të shkatërroje pa lënë asnjë të mbetur ose të shpëtuar?  
 Are we again to go against your orders, taking wives from among the people who do these disgusting things? would you not be angry with us till our destruction was complete, till there was not one who got away safe?  
 ιωναθας αζαηλου και ιεζιας θοοκανου επεδέξαντο κατὰ ταῦτα και μοσολλαμος και λευις και σαββαταιος συνεβράβευσαν αὐτοῖς
- 15 O Zot, Perëndia i Izraelit, ti je i drejtë, prandaj ne kemi mbetur sot, një mbetje njerëzish që kanë shpëtuar. Ja ku jemi para teje me fajin tonë, megjithëse për shkak të tij asnjë nuk mund të qëndrojë para teje!&quot;  
 O Lord God of Israel, righteousness is yours; we are only a small band which has been kept from death, as at this day: see, we are before you in our sin; for no one may keep his place before you because of this.  
 και ἐποίησαν κατὰ πάντα ταῦτα οἱ ἐκ τῆς αἰχμαλωσίας
- 1 Ejalët e Nehemias, birit të Hakaliahut. Ndodhi që në muajin e Kisleut, në vitin e njëzetë, ndërsa unë ndodhesha në kalanë e Suzës,  
 The history of Nehemiah, the son of Hacaliah. Now it came about, in the month Chislev, in the twentieth year, when I was in Shushan, the king's town,  
 και ἐν τῷ πρώτῳ ἔτει κύρου τοῦ βασιλέως περσῶν τοῦ τελεσθῆναι λόγον κυρίου ἀπὸ στόματος ιερεμιου ἐξήγειρεν κύριος τὸ πνεῦμα κύρου βασιλέως περσῶν και παρήγγειλεν φωνὴν ἐν πάσῃ βασιλείᾳ αὐτοῦ και γε ἐν γραπτῷ λέγων
- 2 arriti në Judë Hanani, një nga vëllezërit e mi, bashkë me disa burra të tjerë. Unë i pyeta lidhur me Judejtë që kishin shpëtuar, që ishin kthyer gjallë nga robëria, dhe lidhur me Jeruzalemin.  
 That Hanani, one of my brothers, came with certain men from Judah; and in answer to my request for news of the Jews who had been prisoners and had got away, and of Jerusalem,  
 οὕτως εἶπεν κύρος βασιλεὺς περσῶν πάσας τὰς βασιλείας τῆς γῆς ἔδωκεν μοι κύριος ὁ θεὸς τοῦ οὐρανοῦ και αὐτὸς ἐπεσκέψατο ἐπ' ἐμὲ τοῦ οικοδομῆσαι αὐτῷ οἶκον ἐν ιερουσαλημ τῇ ἐν τῇ ιουδαίᾳ
- 3 Ata më thanë: &quot;Ata që kanë shpëtuar nga robëria janë atje poshtë në krahinë, në një varfëri të madhe dhe me faqe të zezë; përveç kësaj muret e Jeruzalemit janë plot me të çara dhe portat e tij janë konsumuar nga zjarri&quot;,  
 They said to me, The small band of Jews now living there in the land are in great trouble and shame: the wall of Jerusalem has been broken down, and its doorways burned with fire.  
 τὶς ἐν ἡμῖν ἀπὸ παντὸς τοῦ λαοῦ αὐτοῦ και ἔσται ὁ θεὸς αὐτοῦ μετ' αὐτοῦ και ἀναβήσεται εἰς ιερουσαλημ τὴν ἐν τῇ ιουδαίᾳ και οικοδομησάτω τὸν οἶκον θεοῦ ισραηλ αὐτὸς ὁ θεὸς ὁ ἐν ιερουσαλημ
- 4 Sa i dëgjova këto fjalë, u ula dhe qava; pastaj mbajta zi disa ditë me radhë, agjerova dhe u luta përpara Perëndisë të qiellit.  
 Then, after hearing these words, for some days I gave myself up to weeping and sorrow, seated on the earth; and taking no food I made prayer to the God of heaven,  
 και πᾶς ὁ καταλειπόμενος ἀπὸ πάντων τῶν τόπων οὐ αὐτὸς παροικεῖ ἐκεῖ και λήμψονται αὐτὸν ἄνδρες τοῦ τόπου αὐτοῦ ἐν ἀργυρίῳ και χρυσῷ και ἀποσκευῇ και κτήνεσιν μετὰ τοῦ ἔκουσίου εἰς οἶκον τοῦ θεοῦ τοῦ ἐν ιερουσαλημ
- 5 Dhe thashë: &quot;Të lutem shumë, o Zot, Perëndia i qiellit, Perëndi i madh dhe i tmerrshëm, që i qëndron besnik besëlidhjes dhe ke mëshirë për ata që të duan dhe respektojnë urdhërimet e tua,  
 And said, O Lord, the God of heaven, the great God, greatly to be feared, keeping faith and mercy with those who have love for him and are true to his laws:  
 και ἀνέστησαν ἄρχοντες τῶν πατριῶν τῷ ιουδα και βενιαμιν και οἱ ἱερεῖς και οἱ λευῖται πάντων ὧν ἐξήγειρεν ὁ θεὸς τὸ πνεῦμα αὐτῶν τοῦ ἀναβῆναι οικοδομῆσαι τὸν οἶκον κυρίου τὸν ἐν ιερουσαλημ
- 6 qofshin veshët e tua të vëmëndshëm dhe sytë e tu të hapur për të dëgjuar lutjen e shërbëtorit tënd që tani ta drejton ty ditën dhe natën për bijtë e Izraelit, shërbëtorë të tu, duke rrëfyer mëkatet e bijve të Izraelit, që ne kemi kryer kundër teje. Po, unë dhe shtëpia e atit tim kemi mëkatuar.  
 Let your ear now take note and let your eyes be open, so that you may give ear to the prayer of your servant, which I make before you at this time, day and night, for the children of Israel, your servants, while I put before you the sins of the children of Israel, which we have done against you: truly, I and my father's people are sinners.  
 και πάντες οἱ κυκλόθεν ἐνίσχυσαν ἐν χερσὶν αὐτῶν ἐν σκεύεσιν ἀργυρίου ἐν χρυσῷ ἐν ἀποσκευῇ και ἐν κτήνεσιν και ἐν ξενίοις πάρεξ τῶν ἐν ἔκουσίαις
- 7 Jemi sjellë shumë keq me ty dhe nuk kemi respektuar urdhërimet, statutet dhe dekretet që ti i ke urdhëruar Moisiut, shërbëtorit tënd.  
 We have done great wrong against you, and have not kept the orders, the rules, and the decisions, which you gave to your servant Moses.  
 και ὁ βασιλεὺς κύρος ἐξήνεγκεν τὰ σκεῦη οἴκου κυρίου ἃ ἔλαβεν ναυσοδομοσορ ἀπὸ ιερουσαλημ και ἔδωκεν αὐτὰ ἐν οἴκῳ θεοῦ αὐτοῦ
- 8 Mbaje mend fjalën që i urdhërove Moisiut, shërbëtorit tënd, duke i thënë: &quot;Në qoftë se do të mëkatoni, unë do t'ju shpërndaj midis popujve;  
 Keep in mind, O Lord, the order you gave your servant Moses, saying, If you do wrong I will send you wandering among the peoples:  
 και ἐξήνεγκεν αὐτὰ κύρος βασιλεὺς περσῶν ἐπὶ χεῖρα μιθραδάτου γασβαρηνου και ἠρίθμησεν αὐτὰ τῷ σασαβασαρ ἄρχοντι τοῦ ιουδα
- 9 por në rast se do të ktheheni tek unë dhe do të respektoni urdhërimet e mia, dhe do t'i zbatoni në praktikë, edhe sikur njerëzit tuaj të shpërndarë të jenë në kufijtë e qiellit, unë do t'i mbledh që andej dhe do t'i sjell përsëri në vendin që kam zgjedhur ku të banojë emri im&quot;.  
 But if you come back to me and keep my orders and do them, even if those of you who have been forced out are living in the farthest parts of heaven, I will get them from there, and take them back to the place marked out by me for the resting-place of my name.  
 και οὗτος ὁ ἀριθμὸς αὐτῶν ψυκτῆρες χρυσοὶ τριακόνα και ψυκτῆρες ἀργυροὶ χίλιοι παρηλλαγμένα ἑννέα και εἴκοσι

- 10 Tani këta janë shërbëtorët e tu dhe populli yt, që ti i ke çliruar me fuqinë tënde të madhe dhe me dorën tënde të fortë.  
Now these are your servants and your people, whom you have made yours by your great power and by your strong hand.  
κεφουρη χρυσοί τριακόντα και ἀργυροί διακόσιοι και σκευή ἑτερα χίλια
- 11 O Zot, të lutem, qofshin veshët e tu të vëmëndshëm ndaj lutjes së shërbëtorit tënd dhe lutjes së shërbëtorëve të tu që ndjejnë kënaqësi kur kanë frikë prej emrit tënd; jepi, madje sot të lutem, një sukses të mirë shërbëtorit tënd, duke bërë që ai të gjejë zemërbutësi në sytë e këtij njeriu. Unë atëherë isha kupëmbajtësi i mbretit.  
O Lord, let your ear take note of the prayer of your servant, and of the prayers of your servants, who take delight in worshipping your name: give help, O Lord, to your servant this day, and let him have mercy in the eyes of this man. (Now I was the king's wine-servant.)  
πάντα τὰ σκευή τῷ χρυσῷ και τῷ ἀργύρῳ πεντακισχίλια και τετρακόσια τὰ πάντα ἀναβαίνοντα μετὰ σασαβασαρ ἀπὸ τῆς ἀποικίας ἐκ βαβυλῶνος εἰς ἱερουσαλημ
- 1 Në muajin e Nisanit, vitin e njëzetë të mbretit Artakserks, sapo e sollën verën para tij, unë e mora verën dhe ia zgjata atij. Unë nuk kisha qenë i trishtuar kurrë në prani të tij.  
And it came about in the month Nisan, in the twentieth year of Artaxerxes the king, when wine was before him, that I took up the wine and gave it to the king. Now I had never before been sad when the king was present.  
καὶ οὗτοι οἱ υἱοὶ τῆς χώρας οἱ ἀναβαίνοντες ἀπὸ τῆς αἰχμαλωσίας τῆς ἀποικίας ἧς ἀπέκτισεν ναβουχοδονοσορ βασιλεὺς βαβυλῶνος εἰς βαβυλῶνα και ἐπέστρεψαν εἰς ἱερουσαλημ και ἰουδα ἀνὴρ εἰς πόλιν αὐτοῦ
- 2 Prandaj mbreti më tha: "Pse ke pamje të trishtuar, ndonjëse nuk je i sëmurë? Kjo nuk mund të jetë veçse një trishtim i zemrës. Atëherë më zuri një frikë shumë e madhe,  
And the king said to me, Why is your face sad, seeing that you are not ill? this is nothing but sorrow of heart. Then I was full of fear;  
οἱ ἦλθον μετὰ ζοροβαβελ ἰησοῦς νεεμιας σαραιας ρεελιας μαρδοχαιος βαλασαν μασφαρ βαγουι ρεουμ βαανα ἀνδρῶν ἀριθμὸς λαοῦ ἰσραηλ
- 3 dhe i thashë mbretit: "Rroftë mbreti përjetë! Si mund të mos jetë fytyra ime e trishtuar kur qyteti ku janë varrosur etërit e mi është shkatërruar dhe portat e tij janë konsumuar nga zjarri?"  
And said to the king, May the king be living for ever: is it not natural for my face to be sad, when the town, the place where the bodies of my fathers are at rest, has been made waste and its doorways burned with fire?  
υἱοὶ φορορ δισχίλιοι ἑκατὸν ἑβδομήκοντα δύο
- 4 Mbreti më tha: "Çfarë kërkon? Atëherë unë iu luta Perëndisë të qiellit  
Then the king said to me, What is your desire? So I made prayer to the God of heaven.  
υἱοὶ σαφατια τριακόσιοι ἑβδομήκοντα δύο
- 5 dhe pastaj iu përgjigja mbretit: "Në qoftë se kjo i pëlqen mbretit dhe shërbëtori yt ka gjetur mirëdashje në sytë e tu, më lejo të shkoj në Judë, në qytetin e varreve të etërve të mi, që ta rindërtoj atë."  
And I said to the king, If it is the king's pleasure, and if your servant has your approval, send me to Judah, to the town where the bodies of my fathers are at rest, so that I may take in hand the building of it.  
υἱοὶ ηρα ἑπτακόσιοι ἑβδομήκοντα πέντε
- 6 Mbreti më tha (mbretëresha i rrinte ulur në krah): "Sa do të zgjasë udhëtimi dhe kur do të kthehesh? Kështu i pëlqeu mbretit të më lërë të shkoj dhe unë i tregova një afat kohe.  
And the king said to me (the queen being seated by his side), How long will your journey take, and when will you come back? So the king was pleased to send me, and I gave him a fixed time.  
υἱοὶ φααθμοαβ τοῖς υἱοῖς ἰησοῦε ἰωαβ δισχίλιοι ὀκτακόσιοι δέκα δύο
- 7 Pastaj i thashë mbretit: "Në rast se kështu i pëlqen mbretit, të më jepen letra për qeveritarët e krahinës matanë Lumit që të më japin lejen e kalimit deri sa të arrijë në Judë,  
Further, I said to the king, If it is the king's pleasure, let letters be given to me for the rulers across the river, so that they may let me go through till I come to Judah;  
υἱοὶ αἰλαμ χίλιοι διακόσιοι πεντήκοντα τέσσαρες
- 8 dhe një letër për Asafin, mbikëqyrësin e pyllit të mbretit, që të më japë lëndën e drurit për të ndërtuar portat e qytetës së bashkuar me tempullin, për muret e qytetit dhe për shtëpinë në të cilën do të shkoj të banoj. Mbreti më dha letrat, sepse dora mirëdashëse e Perëndisë tim ishte mbi mua.  
And a letter to Asaph, the keeper of the king's park, so that he may give me wood to make boards for the doors of the tower of the house, and for the wall of the town, and for the house which is to be mine. And the king gave me this, for the hand of my God was on me.  
υἱοὶ ζαθουα ἑννακόσιοι τεσσαράκοντα πέντε
- 9 Arrita kështu te qeveritarët e krahinës matanë Lumit dhe u dhashë atyre letrat e mbretit. Me mua mbreti kishte dërguar një trup përcjellës të përbërë nga komandantë të ushtrisë dhe nga kalorës.  
Then I came to the rulers of the lands across the river and gave them the king's letters. Now the king had sent with me captains of the army and horsemen.  
υἱοὶ ζακχου ἑπτακόσιοι ἐξήκοντα

- 10 Por kur Sanballati, Horoniti dhe Tobiahu, shërbëtori i Amonit, e mësuan këtë gjë, u shqetësuan shumë, sepse kishte ardhur një burrë që kërkonte të mirën e bijve të Izraelit.  
And Sanballat the Horonite and Tobiah the servant, the Ammonite, hearing of it, were greatly troubled because a man had come to the help of the children of Israel.  
vίoi βανουι ἐξακόσιοι τεσσαράκοντα δύο
- 11 Kështu arrita në Jeruzalem dhe qëndrova atje tri ditë.  
So I came to Jerusalem and was there three days.  
vίoi βαβι ἐξακόσιοι εἴκοσι τρεῖς
- 12 Pastaj u ngrita natën me pak burra të tjerë, por nuk i thashë gjë asnjëriut nga ato që Perëndia im më kishte vënë në zemër të bëja për Jeruzalemin. Nuk kisha me vete asnjë kafshë tjetër, barre, veç asaj së cilës i kisha hipur.  
And in the night I got up, taking with me a small band of men; I said nothing to any man of what God had put into my heart to do for Jerusalem: and I had no beast with me but the one on which I was seated.  
vίoi ασγαδ τρισχίλιοι διακόσιοι εἴκοσι δύο
- 13 Dola natën nga porta e Luginës, në drejtim të burimit të Dragoit dhe të portës së Plehut, duke kontrolluar kështu muret e Jeruzalemit që ishin plot me të çara dhe portat e tij të konsumuara nga zjarri.  
And I went out by night, through the doorway of the valley, and past the dragon's water-spring as far as the place where waste material was put, viewing the walls of Jerusalem which were broken down, and the doorways which had been burned with fire.  
vίoi αδωνικαμ ἐξακόσιοι ἐξήκοντα ἕξ
- 14 Vazhdova pastaj me portën e Burimit dhe pishinën e Mbretit, por nuk kishte vend nga të kalonte kafsha mbi të cilën kisha hipur.  
Then I went on to the door of the fountain and to the king's pool: but there was no room for my beast to get through.  
vίoi βαγοι δισχίλιοι πεντήκοντα ἕξ
- 15 Atëherë iu ngjita natën luginës, duke inspektuar gjithnjë muret; më në fund u ktheva prapa, duke hyrë nga porta e Luginës, dhe kështu u ktheva.  
Then in the night, I went up by the stream, viewing the wall; then turning back, I went in by the door in the valley, and so came back.  
vίoi αδιν τετρακόσιοι πεντήκοντα τέσσαρες
- 16 Zyrtarët nuk dinin se ku kisha shkuar dhe as me se isha marrë. Deri në atë çast nuk u kisha thënë asgjë Judejve, priftërinjve, parisë, zyrtarëve dhe as atyre që merreshin me punimet.  
And the chiefs had no knowledge of where I had been or what I was doing; and I had not then said anything to the Jews or to the priests or the great ones or the chiefs or the rest of those who were doing the work.  
vίoi ατηρ τῷ εζεκια ἐνεήκοντα ὀκτώ
- 17 Atëherë u thashë atyre: "Ju e shikoni gjendjen e mjeruar në të cilat ndodhemi: Jeruzalemi është shkatërruar dhe portat e tij janë konsumuar nga zjarri! E jani, t'i rindërtojme muret e Jeruzalemit, dhe kështu nuk do të jemi më të turpëruar!"  
Then I said to them, You see what a bad condition we are in; how Jerusalem is a waste, and its doorways burned with fire: come, let us get to work, building up the wall of Jerusalem, so that we may no longer be put to shame.  
vίoi βασου τριακόσιοι εἴκοσι τρεῖς
- 18 U tregova pastaj atyre si dora bamirëse e Perëndisë tim kishte qenë mbi mua si dhe fjalët që mbreti më kishte thënë. Atëherë ata thanë: "Të ngrihemi dhe t'i vihemi ndërtimit!", Kështu morën kurajo për t'i forcuar duart e tyre për këtë punë të rëndësishme.  
Then I gave them an account of how the hand of my God was on me, helping me; and of the king's words which he had said to me. And they said, Let us get to work on the building. So they made their hands strong for the good work.  
vίoi ιωρα ἑκατὸν δέκα δύο
- 19 Por kur Sanballati, Horoniti dhe Tobiahu, shërbëtori i Amonit, dhe Geshemi, Arabi, e mësuan këtë gjë, filluan të tallen dhe të na përbuzin, duke thënë: "Çfarë po bëni? Mos doni, vallë, të ngrini krye kundër mbretit?"  
But Sanballat the Horonite and Tobiah the servant, the Ammonite, and Geshem the Arabian, hearing of it, made sport of us, laughing at us and saying, What are you doing? will you go against the king?  
vίoi ασεμ διακόσιοι εἴκοσι τρεῖς
- 20 Atëherë unë u përgjigja dhe u thashë atyre: "Do të jetë vetë Perëndia i qiellit që do të na sigurojë suksesin. Ne, shërbëtorët e tij, do të fillojmë ndërtimin, por për ju nuk do të ketë as pjesë, as të drejtë, as kujtim në Jeruzalem".  
Then answering them I said, The God of heaven, he will be our help; so we his servants will go on with our building: but you have no part or right or any name in Jerusalem.  
vίoi γαβερ ἐνεήκοντα πέντε

- 1** Eliashibi, kryeprifti, u ngrit atëherë bashkë me vëllezërit e tij priftërinj dhe ndërtuan portën e Deleve; e shenjtëruan dhe ia vunë kanatet. Vazhduan të ndërtojnë deri në kullën e Meahut, që pastaj Then Eliashib, the chief priest, got up with his brothers the priests, and took in hand the building of the sheep doorway; they made it holy and put its doors in position; as far as the tower of Hammeah they made it holy, even to the tower of Hananel.  
 και ἔφθασεν ὁ μὴν ὁ ἕβδομος καὶ οἱ υἱοὶ ἰσραὴλ ἐν πόλεσιν αὐτῶν καὶ συνήχθη ὁ λαὸς ὡς ἀνὴρ εἷς εἰς ἱερουσαλὴμ
- 2** Pranë Eliashibit ndërtuan njerëzit e Jerikos dhe pranë tyre ndërtoi Zakuri, bir i Imrit. And by his side the men of Jericho were building. And after them, Zaccur, the son of Imri.  
 και ἀνέστη ἰησοῦς ὁ τοῦ ἰωσεδεκ καὶ οἱ ἀδελφοὶ αὐτοῦ ἱερεῖς καὶ ζοροβαβελ ὁ τοῦ σαλαθιηλ καὶ οἱ ἀδελφοὶ αὐτοῦ καὶ ὠκοδόμησαν τὸ θυσιαστήριον θεοῦ ἰσραὴλ τοῦ ἀνερέγκαι ἐπ' αὐτὸ ὀλοκαυτώσει ς κατὰ τὰ γεγραμμένα ἐν νόμῳ μουσῆ ἀνθρώπου τοῦ θεοῦ
- 3** Bijtë e Senaahut ndërtuan portën e Peshqve, bënë kasën dhe vunë kanatet e saj, bravat dhe shufrat. The sons of Hassenaaah were the builders of the fish doorway; they put its boards in place and put up its doors, with their locks and rods.  
 και ἠτοίμασαν τὸ θυσιαστήριον ἐπὶ τὴν ἑτοιμασίαν αὐτοῦ ὅτι ἐν καταπλήξει ἐπ' αὐτοὺς ἀπὸ τῶν λαῶν τῶν γαιῶν καὶ ἀνέβη ἐπ' αὐτὸ ὀλοκαυτώσει τῷ κυρίῳ τὸ πρῶν καὶ εἰς ἐσπέραν
- 4** Pranë tyre punonte për riparimet Meremothi, bir i Urias, që ishte bir i Kotsit; pranë tyre për riparimet punonte Meshullami, bir i Berekiatit, që ishte bir i Meshezabeelit; pranë tyre punonte për riparimet Tsadoku, bir i Baanas; By their side Meremoth, the son of Uriah, the son of Hakkoz, was making good the walls. Then Meshullam, the son of Berechiah, the son of Meshezabel; and by him, Zadok, the son of Baana.  
 και ἐποίησαν τὴν ἑορτὴν τῶν σκηνῶν κατὰ τὸ γεγραμμένον καὶ ὀλοκαυτώσει ἡμέραν ἐν ἡμέρᾳ ἐν ἀριθμῷ ὡς ἡ κρίσις λόγον ἡμέρας ἐν ἡμέρᾳ αὐτοῦ
- 5** pranë tyre për riparimet punonin Tekoitet; por fisnikët midis tyre nuk e ulën qafën për të bërë punën e Zotit të tyre. Near them, the Tekoites were at work; but their chiefs did not put their necks to the work of their Lord.  
 και μετὰ τοῦτο ὀλοκαυτώσει ἐνδελειχισμοῦ καὶ εἰς τὰς νομηνίας καὶ εἰς πάσας ἑορτὰς τὰς ἡγιασμένας καὶ παντὶ ἑκουσιαζομένῳ ἑκούσιον τῷ κυρίῳ
- 6** Jehojada, bir i Paseahut, dhe Meshullami, bir i Besodejahut, restauruan portën e Vjetër; bënë kasën dhe vunë kanatet e saj, bravat dhe shufrat. Joiada, the son of Paseah, and Meshullam, the son of Besodeiah, made good the old doorway; they put its boards in place and put up its doors, with their locks and rods.  
 ἐν ἡμέρᾳ μιᾷ τοῦ μηνὸς τοῦ ἕβδομου ἤρξαντο ἀναφέρειν ὀλοκαυτώσει τῷ κυρίῳ καὶ ὁ οἶκος κυρίου οὐκ ἔθεμελιώθη
- 7** Pranë tyre punonin për riparimin e selisë së qeveritarit të krahinës matanë Lumit Melatiah, Gabaoniti, Jadoni Meronithiti dhe njerëzit e Gabaonit dhe të Mitspahut. By their side were working Melatiah the Gibeonite and Jadon the Meronothite, the men of Gibeon and of Mizpah from the seat of the ruler across the river.  
 και ἔδωκαν ἀργύριον τοῖς λατόμοις καὶ τοῖς τέκτοσιν καὶ βρώματα καὶ ποτὰ καὶ ἔλαιον τοῖς σηδανιν καὶ τοῖς σωριν ἐνέγκαι ξύλα κέδρινα ἀπὸ τοῦ λιβάνου πρὸς θάλασσαν ἰόππης κατ' ἐπιχώρησιν κύρου βασιλέως περσῶν ἐπ' αὐτοῦς
- 8** Pranë tyre punonte për riparimet Uzieli, bir i Harhajahut, një ndër argjendarët; pranë tij punonte për riparimet Hananiahu, një nga parfumierët. Ata e përforcuan Jeruzalemin deri në Murin e Gjerë. Near them was working Uzziel, the son of Harhaiah, the gold-worker. And by him was Hananiah, one of the perfume-makers, building up Jerusalem as far as the wide wall.  
 και ἐν τῷ ἔτει τῷ δευτέρῳ τοῦ ἐλθεῖν αὐτοὺς εἰς οἶκον τοῦ θεοῦ εἰς ἱερουσαλὴμ ἐν μηνὶ τῷ δευτέρῳ ἤρξατο ζοροβαβελ ὁ τοῦ σαλαθιηλ καὶ ἰησοῦς ὁ τοῦ ἰωσεδεκ καὶ οἱ κατάλοιποι τῶν ἀδελφῶν αὐτῶν οἱ ἱερεῖς καὶ οἱ λεῦται καὶ πάντες οἱ ἐρχόμενοι ἀπὸ τῆς αἰχμάλωσις εἰς ἱερουσαλὴμ καὶ ἔστησαν τοὺς λεῦταις ἀπὸ εἰκοσαετοῦς καὶ ἐπάνω ἐπὶ τοὺς ποιοῦντας τὰ ἔργα ἐν οἴκῳ κυρίου
- 9** Pranë tyre punoi për riparimet Refajahu, bir i Hurit, kryetar i gjysmës së rrethit të Jeruzalemit. Near them was working Rephaiah, the son of Hur, the ruler of half Jerusalem.  
 και ἔστη ἰησοῦς καὶ οἱ υἱοὶ αὐτοῦ καὶ οἱ ἀδελφοὶ αὐτοῦ καδμηλ καὶ οἱ υἱοὶ αὐτοῦ υἱοὶ ἰουδα ἐπὶ τοὺς ποιοῦντας τὰ ἔργα ἐν οἴκῳ τοῦ θεοῦ υἱοὶ ἡναδαὶ υἱοὶ αὐτῶν καὶ ἀδελφοὶ αὐτῶν οἱ λεῦται
- 10** Pranë tyre punonte për riparimet, përballë shtëpisë së tij, Jedajahu, bir i Harumafit; pranë tij punonin për riparimet Hatushi, bir i Hashabnejahut. By his side was Jedaiah, the son of Harumaph, opposite his house. And by him was Hattush, the son of Hashabneiah.  
 και ἔθεμελιώσαν τοῦ οἰκοδομῆσαι τὸν οἶκον κυρίου καὶ ἔστησαν οἱ ἱερεῖς ἑστολισμένοι ἐν σάλπιγγιν καὶ οἱ λεῦται υἱοὶ ασαφ ἐν κυμβάλοις τοῦ αἰνεῖν τὸν κύριον ἐπὶ χεῖρας δαυὶδ βασιλέως ἰσραὴλ
- 11** Malkijahu, bir i Harimit, dhe Hashshubi, bir i Pahath-Moabit, ndreqën një pjesë tjetër të mureve dhe kullën e Furrave. Malchijah, the son of Harim, and Hashshub, the son of Pahath-moab, were working on another part, and the tower of the ovens.  
 και ἀπεκρίθησαν ἐν αἴνῳ καὶ ἀνθομολογήσει τῷ κυρίῳ ὅτι ἀγαθόν ὅτι εἰς τὸν αἰῶνα τὸ ἔλεος αὐτοῦ ἐπὶ ἰσραὴλ καὶ πᾶς ὁ λαὸς ἐσήμιανον φωνὴν μεγάλην αἰνεῖν τῷ κυρίῳ ἐπὶ θεμελιώσει οἴκου κυρίου
- 12** Pranë tij punonte për riparimet, bashkë me bijat e tij, Shalumi, bir i Haloeshit, kryetar i gjysmës së rrethit të Jeruzalemit. Near them was Shallum, the son of Halloesh, the ruler of half Jerusalem, with his daughters.  
 και πολλοὶ ἀπὸ τῶν ἱερέων καὶ τῶν λευιτῶν καὶ ἄρχοντες τῶν πατριῶν οἱ πρεσβύτεροι οἱ εἶδον τὸν οἶκον τὸν πρῶτον ἐν θεμελιώσει αὐτοῦ καὶ τοῦτον τὸν οἶκον ἐν ὀφθαλμοῖς αὐτῶν ἔκλειον φωνὴν μεγάλην καὶ ὄχλος ἐν σημασίᾳ μετ' ἐφοροσύνης τοῦ ὑψῶσαι φθῆν

- 13** Hanuni dhe banorët e Zanoahit ndreqën portën e Luginës; e ndërtuan dhe i vunë kanatet, bravat dhe shufrat. Përveç kësaj ndreqën një mijë kubitë muri deri në portën e Plehut.  
Hanun and the people of Zanoah were working on the doorway of the valley; they put it up and put up its doors, with their locks and rods, and a thousand cubits of wall as far as the doorway where the waste material was placed.  
καὶ οὐκ ἦν ὁ λαὸς ἐπιγινώσκων φωνὴν σημασίας τῆς εὐφροσύνης ἀπὸ τῆς φωνῆς τοῦ κλαυθμοῦ τοῦ λαοῦ ὅτι ὁ λαὸς ἐκραύγασεν φωνῇ μεγάλη καὶ ἡ φωνὴ ἠκούετο ἕως ἀπὸ μακρόθεν
- 1** Kur Sanballati dëgjoi që ne po rindërtonim muret, u zemërua, u revoltua thellë dhe filloi të tallet me Judejtë,  
Now, Sanballat, hearing that we were building the wall, was very angry, and in his wrath made sport of the Jews.  
καὶ ἤκουσαν οἱ θλιβόντες ἰουδα καὶ βενιαμιν ὅτι οἱ υἱοὶ τῆς ἀποικίας οἰκοδομοῦσιν οἶκον τῷ κυρίῳ θεῷ ἰσραηλ
- 2** dhe u tha përpara vëllezërve të tij dhe ushtarëve të Samarisë: &quot;Çfarë po bëjnë këta Judej matufë? Do të fortifikohen? Do të ofrojnë flijime? A do të mbarojnë brenda një dite? Mos vallë do të ringjallin gurët e konsumuar nga zjarri i togjeve të rrënojave?&quot;.  
And in the hearing of his countrymen and the army of Samaria he said, What are these feeble Jews doing? will they make themselves strong? will they make offerings? will they get the work done in a day? will they make the stones which have been burned come again out of the dust?  
καὶ ἤγγισαν πρὸς ζοροβαβελ καὶ πρὸς τοὺς ἄρχοντας τῶν πατριῶν καὶ εἶπαν αὐτοῖς οἰκοδομήσομεν μεθ' ὑμῶν ὅτι ὡς ὑμεῖς ἐκζητοῦμεν τῷ θεῷ ὑμῶν καὶ αὐτῷ ἡμεῖς θυσιάζομεν ἀπὸ ἡμερῶν ασαραδὼν ὡν βασιλέως ασσουρ τοῦ ἐνέγκαντος ἡμᾶς ὧδε
- 3** Tobiahu, Amoniti, që i rrinte pranë, tha: &quot;Le të ndërtojnë! Por në rast se një dhëlpër hipën sipër, do ta rrëzojë murin e tyre prej guri!&quot;.  
Now Tobiah the Ammonite was by him, and he said, Such is their building that if a fox goes up it, their stone wall will be broken down.  
καὶ εἶπεν πρὸς αὐτοὺς ζοροβαβελ καὶ ἰησοῦς καὶ οἱ κατάλοιποι τῶν ἀρχόντων τῶν πατριῶν τοῦ ἰσραηλ οὐχ ἡμῖν καὶ ὑμῖν τοῦ οἰκοδομῆσαι οἶκον τῷ θεῷ ἡμῶν ὅτι ἡμεῖς αὐτοὶ ἐπὶ τὸ αὐτὸ οἰκοδομήσομεν τῷ κυρίῳ θεῷ ἡμῶν ὡς ἐνετείλατο ἡμῖν κύριος ὁ βασιλεὺς περσῶν
- 4** Dëgjo, o Perëndia ynë, sepse na përçmojnë! Bëj që të bjerë mbi kokën e tyre fyerja e tyre dhe braktisi në përbuzje në një vend robërie!  
Give ear, O our God, for we are looked down on: let their words of shame be turned back on themselves, and let them be given up to wasting in a land where they are prisoners:  
καὶ ἦν ὁ λαὸς τῆς γῆς ἐκλύων τὰς χεῖρας τοῦ λαοῦ ἰουδα καὶ ἐνεπόδιζον αὐτοὺς τοῦ οἰκοδομεῖν
- 5** Mos e mbulo paudhësinë e tyre dhe mos lejo që mëkati i tyre të fshihet para teje, sepse kanë provokuar zemërimin tënd para ndërtuesve&quot;.  
Let not their wrongdoing be covered or their sin washed away from before you: for they have made you angry before the builders.  
καὶ μισθοῦμενοι ἐπ' αὐτοὺς βουλευόμενοι τοῦ διασκεδάσαι βουλῆν αὐτῶν πάσας τὰς ἡμέρας κύριος βασιλέως περσῶν καὶ ἕως βασιλείας δαρείου βασιλέως περσῶν
- 6** Ne, pra, i rindërtuam muret që u bashkuan deri në gjysmën e lartësisë së tyre; populli e kishte marrë me zemër punën.  
So we went on building the wall; and all the wall was joined together half-way up: for the people were working hard.  
καὶ ἐν βασιλείᾳ ασουηρον ἐν ἀρχῇ βασιλείας αὐτοῦ ἔγραψαν ἐπιστολὴν ἐπὶ οἰκοῦντας ἰουδα καὶ ἱερουσαλημ
- 7** Por kur Sanballati, Tobiahu, Arabët, Amonitët dhe Asdodejtë mësuam që riparimi i mureve të Jeruzalemit po përparonte dhe të çarat kishin filluar të mbylleshin, ata u zemëruan shumë,  
But when it came to the ears of Sanballat and Tobiah and the Arabians and the Ammonites and the Ashdodites, that the building of the walls of Jerusalem was going forward and the broken places were being made good, they were full of wrath;  
καὶ ἐν ἡμέραις αρθασασθα ἔγραψεν ἐν εἰρήνῃ μισραδάτη ταβηλ συν καὶ τοῖς λοιποῖς συνδούλοις αὐτοῦ πρὸς αρθασασθα βασιλέα περσῶν ἔγραψεν ὁ φορολόγος γραφὴν συριστι καὶ ἡρμηνευμένην
- 8** dhe të gjithë së bashku komplotuan për të ardhur në Jeruzalem dhe për të krijuar trazira në të.  
And they made designs, all of them together, to come and make an attack on Jerusalem, causing trouble there.  
ραουμ βααλαταμ καὶ σαμσαι ὁ γραμματεὺς ἔγραψαν ἐπιστολὴν μίαν κατὰ ἱερουσαλημ τῷ αρθασασθα βασιλεῖ
- 9** Por ne iu lutëm Perëndisë tonë dhe për shkak të tyre vumë roje natë e ditë kundër tyre.  
But we made our prayer to God, and had men on watch against them day and night because of them.  
τάδε ἔκρινεν ραουμ βααλαταμ καὶ σαμσαι ὁ γραμματεὺς καὶ οἱ κατάλοιποι σύνδουλοι ἡμῶν διναῖοι αφαρσαθαχαῖοι ταφαλλαῖοι αφαρσαῖοι αρχαῖοι βαβυλώνιοι σουσαναχαῖοι οἱ εἰσιν ἡλαμαῖοι
- 10** Por ata të Judës thonin: &quot;Forcat e mbartësve të peshave vijnë duke u pakësuar dhe gërmadhat janë aq të shumta sa nuk do të arrijmë të ndërtojmë muret!  
And Judah said, The strength of the workmen is giving way, and there is much waste material; it is impossible for us to put up the wall.  
- 19 &lt;aaa see&gt; Për shkak të zemërimit të Zotit të ushtrive vendi digjet dhe populli është si eshkë për zjarrin; askujt nuk i vjen keq për vëllanë e vet.  
The land was dark with the wrath of the Lord of armies: the people were like those who take men's flesh for food.  
ἀλλὰ ἐκκλίνει εἰς τὰ δεξιὰ ὅτι πεινάσει καὶ φάγεται ἐκ τῶν ἀριστερῶν καὶ οὐ μὴ ἐμπλησθῆ ἄνθρωπος τὰς σάρκας τοῦ βραχίονος αὐτοῦ
- 20 &lt;aaa see&gt; Këputet nga e djathta, por uria vazhdon; gëlltitet nga e majta, por pa u ngopur; secili përpin mishin e krahut të vet.  
On the right a man was cutting off bits and was still in need; on the left a man took a meal but had not enough; no man had pity on his brother; every man was making a meal of the flesh of his neighbour.  
φάγεται γὰρ μανασση τοῦ εφραιμ καὶ εφραιμ τοῦ μανασση ὅτι ἅμα πολιορκήσουσιν τὸν ἰουδα ἐπὶ τούτοις πᾶσιν οὐκ ἀπεστράφη ὁ θυμὸς ἀλλ' ἔτι ἡ χεὶρ ὑψηλὴ
- 1 Mjerë ata që nxjerrin dekrete të padrejta dhe ata që vazhdojnë të hartojnë vendime të padrejta,  
Cursed are those who make evil decisions, and the writers who make the records of their cruel acts:  
οὐαὶ τοῖς γράφουσιν πονηρίαν γράφοντες γὰρ πονηρίαν γράφουσιν
- 2 për t'u mohuar drejtësinë të mjerëve, për t'u mohuar të drejtën të varfërve të popullit tim, dhe për t'i bërë gratë e veja pre të tyre dhe jetimët plaçkë të tyre.  
Who do wrong to the poor in their cause, and take away the right of the crushed among my people, so that they may have the property of widows, and get under their power those who have no father.  
ἐκκλίνοντες κρίσιν πτωχῶν ἀρπάζοντες κρίμα πενήτων τοῦ λαοῦ μου ὥστε εἶναι αὐτοῖς χήραν εἰς ἀρπαγὴν καὶ ὄρφανὸν εἰς προνομήν
- 3 Çfarë do të bëni ditën e ndëshkimit dhe të shkatërrimit që do të vijë nga larg? Te kush do të ikni për të kërkuar ndihmë dhe kujt do t'ia lini pasurinë tuaj?  
And what will you do in the day of punishment, and in the destruction which is coming from far? to whom will you go for help, and what will become of your glory?  
καὶ τί ποιήσουσιν ἐν τῇ ἡμέρᾳ τῆς ἐπισκοπῆς ἡ γὰρ θλίψις ὑμῖν πόρρωθεν ἦξει καὶ πρὸς τίνα καταφεύξεσθε τοῦ βοηθηθῆναι καὶ ποῦ καταλείπετε τὴν δόξαν ὑμῶν
- 4 Atyre nuk do t'u mbetet tjetër veç se të përkulen midis robërve ose të bien midis të vvarëve. Megjithëkëtë zemërimi i tij nuk qetësohet dhe dora e tij mbetet e shtrirë.  
... For all this his wrath is not turned away, but his hand is stretched out still.  
τοῦ μὴ ἐμπσεῖν εἰς ἐπαγωγὴν ἐπὶ πᾶσι τούτοις οὐκ ἀπεστράφη ὁ θυμὸς ἀλλ' ἔτι ἡ χεὶρ ὑψηλὴ
- 5 Mjerë Asiria, shufra e zemërimit tim, në duart e së cilës ndodhet shkopi i indinjatës sime!  
Ho! Assyrian, the rod of my wrath, the instrument of my punishment!  
οὐαὶ ἀσσυρίοις ἡ ῥάβδος τοῦ θυμοῦ μου καὶ ὀργῆς ἐστὶν ἐν ταῖς χερσὶν αὐτῶν
- 6 Unë do ta dërgoj kundër një kombi të pabesë dhe kundër popullit të zemërimit tim. Do ta urdhëroj që ta plaçkitë, ta zhveshë dhe ta shkelë si baltën e rrugëve.  
I will send him against a nation of wrongdoers, and against the people of my wrath I will give him orders, to take their wealth in war, crushing them down like the dust in the streets.  
τὴν ὀργὴν μου εἰς ἔθνος ἀνομον ἀποστελῶ καὶ τῷ ἐμῷ λαῷ συντάξω ποιῆσαι σκῦλα καὶ προνομήν καὶ καταπατεῖν τὰς πόλεις καὶ θεῖναι αὐτὰς εἰς κονιορτόν
- 7 Por ajo mendon ndryshe dhe në zemër të vet ka plane të tjera, por dëshiron të shkatërrojë dhe të shfarosë një numër të madh kombesh.  
But this is not what is in his mind, and this is not his design; but his purpose is destruction, and the cutting off of more and more nations.  
αὐτὸς δὲ οὐχ οὕτως ἐνεθυμήθη καὶ τῇ ψυχῇ οὐχ οὕτως λελόγησται ἀλλὰ ἀπαλλάξει ὁ νοῦς αὐτοῦ καὶ τοῦ ἔθνη ἐξολοθρεῦσαι οὐκ ὀλίγα
- 8 Në fakt thotë: &quot;Princat e mi nuk janë të gjithë mbretër?  
For he says, Are not all my captains kings?  
καὶ ἐὰν εἴπωσιν αὐτῷ σὺ μόνος εἶ ἄρχων
- 9 A nuk është Kalno si Karkemishi? A nuk është Hamathi si Arpadi? A nuk është Samaria si Damasku?  
Will not the fate of Calno be like that of Carchemish? is not Hamath as Arpad? is not Samaria as Damascus?  
καὶ ἐρεῖ οὐκ ἔλαβον τὴν χώραν τὴν ἐπάνω βαβυλωνῶνος καὶ χαλαννῆ οὐδ' ὁ πύργος ψκοδομήθη καὶ ἔλαβον ἀραβίαν καὶ δαμασκὸν καὶ σαμάρειαν

- 10 Ashtu siç ka arritur dora ime mbretëritë e idhujve, shëmbëlltyrat e gdhendura të të cilëve ishin më të shumta se ato të Jeruzalemit dhe të Samarias,  
As my hand has come on the kingdoms of the images, whose pictured images were more in number than those of Jerusalem and Samaria;  
ὄν τρόπον ταύτας ἔλαβον ἐν τῇ χειρὶ μου καὶ πάσας τὰς ἀρχὰς λήψομαι ὁλολύξατε τὰ γλυπτὰ ἐν ἱερουσαλημ καὶ ἐν σαμαρεία
- 11 ashtu si bëra me Samarian dhe me idhujt e saj, a nuk do të veproj edhe në Jeruzalem dhe me idhujt e tij?&quot;;  
So, as I have done to Samaria and her images, I will do to Jerusalem and her images.  
ὄν τρόπον γὰρ ἐποίησα σαμαρεία καὶ τοῖς χειροποιήτοις αὐτῆς οὕτως ποιήσω καὶ ἱερουσαλημ καὶ τοῖς εἰδώλοις αὐτῆς
- 12 Por do të ndodhë që, kur Zoti të ketë mbaruar tërë veprën e tij në malin Sion dhe në Jeruzalem, ai do të thotë: &quot;;Unë do të dënoj frytin e mëndjemadhësisë së zemrës së mbretit të Asirisë dhe lavdinë e syve të tij krenarë&quot;;  
For this cause it will be that, when the purpose of the Lord against Mount Zion and Jerusalem is complete, I will send punishment on the pride of the heart of the king of Assyria, and on the glory of his uplifted eyes.  
καὶ ἔσται ὅταν συντελέσῃ κύριος πάντα ποιῶν ἐν τῷ ὄρει σιων καὶ ἐν ἱερουσαλημ ἐπάξει ἐπὶ τὸν νοῦν τὸν μέγαν τὸν ἄρχοντα τῶν ἀσσυρίων καὶ ἐπὶ τὸ ὕψος τῆς δόξης τῶν ὀφθαλμῶν αὐτοῦ
- 13 Në fakt ai thotë: &quot;;E bëra me forcën e dorës sime dhe me diturinë time, sepse jam i zgjuar; lëviza kufijtë e popujve, plaçkita thesaret e tyre dhe si një njeri i fuqishëm shfuqizova ata që rrinin mbi fron.  
For he has said, By the strength of my hand I have done it, and by my knowledge, for I am wise: and I have taken away the limits of the peoples' lands, and the stores of their wealth have become mine; and I have made towns low in the dust, sending destruction on those living in them;  
εἶπεν γὰρ τῇ ἰσχύϊ ποιήσω καὶ τῇ σοφίᾳ τῆς συνέσεως ἀφελῶ ὄρια ἐθνῶν καὶ τὴν ἰσχὸν αὐτῶν προνομεύσω καὶ σείσω πόλεις κατοικουμένας
- 14 Dora ime ka gjetur si një fole pasuritë e popujve; ashtu si dikush mbledh vezët e braktisura, kështu unë grumbullova tërë dheun dhe nuk pati asnjeri që të lëvizë krahët, apo të hapë sqepin dhe të pingërojë&quot;;  
And I have put my hands on the wealth of the peoples, as on the place where a bird has put her eggs; and as a man may take the eggs from which a bird has gone, so I have taken all the earth for myself: and not a wing was moved, and not a mouth gave out a sound.  
καὶ τὴν οἰκουμένην ὅλην καταλήψομαι τῇ χειρὶ ὡς νοσσιῶν καὶ ὡς καταλελειμμένα φᾶ ἄρῳ καὶ οὐκ ἔστιν ὅς διαφεύξεται με ἢ ἀντείτῃ μοι
- 15 Mos vallë sëpata lëvdohet me atë që pret me të ose mburret sharra me atë që e përdor? Ashtu si shufra të duhej të drejtonte atë që e ngre, apo shkopi të mund të ngrihej a thua se nuk është prej druri!  
Will the axe say high-sounding words against him who is using it, or the blade be full of pride against him who is cutting with it? As if a rod had the power of shaking him who is using it, or as if a stick might take up him who is not wood.  
μη δοξασθήσεται ἄξινῃ ἄνευ τοῦ κόπτοντος ἐν αὐτῇ ἢ ὑψοθήσεται πρὶὸν ἄνευ τοῦ ἔλκοντος αὐτόν ὡσαύτως ἐάν τις ἄρη ῥάβδον ἢ ξύλον
- 16 Prandaj Perëndia, Zoti i ushtrive, do të dërgojë ligështimin midis radhëve të tyre më të fuqishme, dhe në vend të lavdisë së tij ai do të ndezë një zjarr, si flakët e një zjarri.  
For this cause the Lord, the Lord of armies, will make his fat become wasted; and in his inner parts a fire will be lighted like a burning flame.  
καὶ οὐχ οὕτως ἀλλὰ ἀποστελεῖ κύριος σαβαωθ εἰς τὴν σὴν τιμὴν ἀτιμίαν καὶ εἰς τὴν σὴν δόξαν πῦρ καιόμενον καυθήσεται
- 17 Kështu drita e Izraelit do të bëhet një zjarr dhe i Shenjti i tij një flakë, që do të flakërojë dhe do të përpijë ferrat dhe gjembat brenda një dite të vetme.  
And the light of Israel will be for a fire, and his Holy One for a flame: wasting and burning up his thorns in one day.  
καὶ ἔσται τὸ φῶς τοῦ ἰσραηλ εἰς πῦρ καὶ ἁγιάσει αὐτόν ἐν πυρὶ καιομένῳ καὶ φάγεται ὡσεὶ χόρτον τὴν ὕλην τῇ ἡμέρᾳ ἐκείνῃ
- 18 Ai do të konsumojë lavdinë e pyllit të tij dhe të fushës pjellore të tij nga shpirti deri te trupi; do të jetë si një i sëmurë që ligështohet.  
And he will put an end to the glory of his woods and of his planted fields, soul and body together; and it will be as when a man is wasted by disease.  
ἀποσβεσθήσεται τὰ ὄρη καὶ οἱ βουνοὶ καὶ οἱ ὄρυμοὶ καὶ καταφάγεται ἀπὸ ψυχῆς ἕως σαρκῶν καὶ ἔσται ὁ φεύγων ὡς ὁ φεύγων ἀπὸ φλογὸς καιομένης
- 19 Pjesa tjetër e drurëve të pyllit të tij do të katandiset në një numër aq të vogël që edhe një fëmijë mund t'i numërojë.  
And the rest of the trees of his wood will be small in number, so that a child may put them down in writing.  
καὶ οἱ καταλειφθέντες ἀπ' αὐτῶν ἔσονται ἀριθμὸς καὶ παιδίον γράψει αὐτούς
- 20 Atë ditë do të ndodhë që pjesa që mbetet e Izraelit dhe ata që kanë shpëtuar nga shtëpia e Jakobit nuk do të mbështeten më mbi atë që i godiste, por do të mbështeten në të vërtetë mbi Zotin, të Shenjtin e Izraelit.  
And it will be in that day that the rest of Israel, and those of Jacob who have come safely through these troubles, will no longer go for help to him whose rod was on their back, but their faith will be in the Lord, the Holy One of Israel.  
καὶ ἔσται ἐν τῇ ἡμέρᾳ ἐκείνῃ οὐκέτι προστεθήσεται τὸ καταλειφθὲν ἰσραηλ καὶ οἱ σωθέντες τοῦ ἰακωβ οὐκέτι μὴ πεποιθότες ὧσιν ἐπὶ τοῦς ἀδικήσαντας αὐτούς ἀλλὰ ἔσονται πεποιθότες ἐπὶ τὸν θεὸν τὸν ἅγιον τοῦ ἰσραηλ τῇ ἀληθείᾳ

- 21 Një mbetje, mbetja e Jakobit, do t'i kthehet Zotit të fuqishëm.  
The rest, even the rest of Jacob, will come back to the Strong God.  
καὶ ἔσται τὸ καταλειφθὲν τοῦ ἰακωβ ἐπὶ θεὸν ἰσχύοντα
- 22 Sepse, edhe sikur populli yt, o Izrael, të ishte si rëra e detit, vetëm një mbetje e tij do të kthehet; shfarosja e dekretuar do ta bëjë drejtësinë të vërshojë.  
For though your people, O Israel, are as the sand of the sea, only a small number will come back: for the destruction is fixed, overflowing in righteousness.  
καὶ ἐὰν γέννηται ὁ λαὸς ἰσραηλ ὡς ἡ ἄμμος τῆς θαλάσσης τὸ κατάλειμμα αὐτῶν σωθήσεται λόγον γὰρ συντελῶν καὶ συντέμνων ἐν δικαιοσύνῃ
- 23 Në fakt Zoti, Zoti i ushtrive, do të kryejë shfarosjen e dekretuar në mes të të gjithë dheut.  
For the Lord, the Lord of armies, is about to make destruction complete in all the land.  
ὅτι λόγον συντετημένον ποιήσει ὁ θεὸς ἐν τῇ οἰκουμένῃ ὅλη
- 24 Prandaj kështu thotë Zoti, Zoti i ushtrive: &quot;O populli im, që banon në Sion, mos ki frikë nga Asiri, që të rreh me shufër dhe ngre kundër teje shkopin e tij, ashtu si bëri Egjipti.  
For this cause the Lord, the Lord of armies, says, O my people living in Zion, have no fear of the Assyrian, even if his rod comes on your back, and his stick is lifted up as in Egypt.  
διὰ τοῦτο τάδε λέγει κύριος σαβαωθ μὴ φοβοῦ ὁ λαός μου οἱ κατοικοῦντες ἐν σιων ἀπὸ ἀσσυρίων ὅτι ἐν ῥάβδῳ πατάξει σε πληγὴν γὰρ ἐγὼ ἐπάγω ἐπὶ σὲ τοῦ ἰδεῖν ὁδὸν αἰγύπτου
- 25 Sepse edhe pak kohë dhe indinjata do të marrë fund, ndërsa zemërimi im do të drejtohet për shkatërrimin e tyre.  
For in a very short time my passion will be over, and my wrath will be turned to their destruction.  
ἔτι γὰρ μικρὸν καὶ παύσεται ἡ ὀργή ὁ δὲ θυμὸς μου ἐπὶ τὴν βουλὴν αὐτῶν
- 26 Zoti i ushtrive do të ngrejë kundër tij kamxhikun, ashtu siç e goditi Madianin te shkëmbi i Horebit; dhe ashtu si shtriu shkopin e tij mbi det, kështu do ta ngrerë akoma ashtu si bëri në Egjipt.  
And the Lord of armies will be shaking a whip against him, as when he overcame Midian at the rock of Oreb: and his rod will be lifted up against them as it was against the Egyptians.  
καὶ ἐπεγερεῖ ὁ θεὸς ἐπ' αὐτοὺς κατὰ τὴν πληγὴν τὴν μαδιαμ ἐν τόπῳ θλίψεως καὶ ὁ θυμὸς αὐτοῦ τῇ ὁδῷ τῇ κατὰ θάλασσαν εἰς τὴν ὁδὸν τὴν κατ' αἴγυπτον
- 27 Atë ditë do të ndodhë që barra e tij do të hiqet nga kurrizi dhe zgjedha e tij nga qafa jote; zgjedha do të shkatërrohet nga vajosj e vajit&quot;;  
And in that day the weight which he put on your back will be taken away, and his yoke broken from off your neck.  
καὶ ἔσται ἐν τῇ ἡμέρᾳ ἐκείνῃ ἀφαιρεθήσεται ὁ φόβος αὐτοῦ ἀπὸ σοῦ καὶ ὁ ζυγὸς αὐτοῦ ἀπὸ τοῦ ὤμου σου καὶ καταφθαρήσεται ὁ ζυγὸς ἀπὸ τῶν ὤμων ὑμῶν
- 28 Ai arrin në Ajath, e kapërcen Migronin dhe i lë ngarkesën e tij në Mikmash.  
He has gone up from Pene-Rimmon, he has come to Aiath; he has gone past Migron, at Michmash he puts his forces in order.  
ἦξει γὰρ εἰς τὴν πόλιν αγγαὶ καὶ παρελεύσεται εἰς μαγεδω καὶ ἐν μαχμας θήσει τὰ σκεῦη αὐτοῦ
- 29 Kapërcejnë vendkalimin, fushojnë në Geba; Ramahu dridhet, Gibeahu i Saulit ka ikur.  
They have gone across the mountain; Geba will be our resting-place tonight, they say: Ramah is shaking with fear; Gibeah of Saul has gone in flight.  
καὶ παρελεύσεται φάραγγα καὶ ἦξει εἰς αγγαὶ φόβος λήμνεται ραμα πόλιν σαουλ φεύζεται
- 30 Ço zërin tënd, o bija e Galimit! Kij kujdes, o Laish! E mjera Anathoth!  
Give a loud cry, daughter of Gallim; let Laishah give ear; let Anathoth give answer to her.  
ἡ θυγάτηρ γαλλίμ ἐπακούσεται λαισα ἐπακούσεται αναθωθ
- 31 Madmenahu ka ikur, banorët e Gebimit kërkajnë një strehë.  
Madmenah has gone; the men of Gebim are putting their goods in a safe place.  
ἐξέστη μαδεβηνα καὶ οἱ κατοικοῦντες γιββίμ παρακαλεῖτε
- 32 Megjithatë do të qëndrojë sot në Nob, duke tundur grushtin kundër malit të bijës së Sionit, kodrës së Jeruzalemit.  
This very day he is stopping at Nob; he is shaking his hand against the mountain of the daughter of Zion, the hill of Jerusalem.  
σήμερον ἐν ὁδῷ τοῦ μείναι τῇ χειρὶ παρακαλεῖτε τὸ ὄρος τὴν θυγατέρα σιων καὶ οἱ βουνοὶ οἱ ἐν ἱερουσαλημ
- 33 Ja, Zoti, Zoti i ushtrive, do t'i këpusë degët me dhunë të tmerrshme; më të lartat do të priten; më krenarët do të ulen.  
See, the Lord, the Lord of armies, is cutting off his branches with a great noise, and his strong ones are falling and his high ones are coming down.  
ἰδοὺ γὰρ ὁ δεσπότης κύριος σαβαωθ συνταράσσει τοὺς ἐνδόξους μετὰ ἰσχύος καὶ οἱ ὑψηλοὶ τῇ ὄβρει συντριβήσονται καὶ οἱ ὑψηλοὶ ταπεινωθήσονται
- 34 Ai do të rrëzojë me sëpatë pjesën më të dendur të pyllit dhe Libani do të bjerë nën goditjet e të Fuqishmit.  
And he is cutting down the thick places of the wood with an axe, and Lebanon with its tall trees is coming down.  
καὶ πεσοῦνται οἱ ὑψηλοὶ μαχαίρᾳ ὁ δὲ λίβανος σὺν τοῖς ὑψηλοῖς πεσεῖται

- 1** Pastaj një degëz do të dalë nga trungu i Isaias dhe një filiz do të mbijë nga rrënjët e tij.  
*And there will come a rod out of the broken tree of Jesse, and a branch out of his roots will give fruit.*  
*καὶ ἐξελεύσεται ῥάβδος ἐκ τῆς ῥίζης ιεσσαὶ καὶ ἄνθος ἐκ τῆς ῥίζης ἀναβήσεται*
- 2** Fryma e Zotit do të pushojë mbi të; fryma e diturisë dhe e zgjuarësisë, fryma e këshillës dhe e fuqisë, fryma e njohurisë dhe e frikës të Zotit.  
*And the spirit of the Lord will be resting on him, the spirit of wisdom and good sense, the spirit of wise guiding and strength, the spirit of knowledge and of the fear of the Lord;*  
*καὶ ἀναπαύσεται ἐπ' αὐτὸν πνεῦμα τοῦ θεοῦ πνεῦμα σοφίας καὶ συνέσεως πνεῦμα βουλῆς καὶ ἰσχύος πνεῦμα γνώσεως καὶ εὐσεβείας*
- 3** I dashuri i tij do të qëndrojë në frikën nga Zoti, nuk do të gjykojë nga pamja, nuk do të japë vendime sipas fjalëve që thuhet,  
*And he will not be guided in his judging by what he sees, or give decisions by the hearing of his ears:*  
*ἐμπλήσει αὐτὸν πνεῦμα φόβου θεοῦ οὐ κατὰ τὴν δόξαν κρινεῖ οὐδὲ κατὰ τὴν λαλιὰν ἐλέγξει*
- 4** por do t'i gjykojë të varfërit me drejtësi dhe do të marrë vendime të drejta për njerëzit e përlulur të vendit. Do ta godasë vendin me shufrën e gojës së tij dhe me frymën e buzëve të tij do ta bëjë të vdesë të pabesin.  
*But he will do right in the cause of the poor, and give wise decisions for those in the land who are in need; and the rod of his mouth will come down on the cruel, and with the breath of his lips he will put an end to the evil-doer.*  
*ἀλλὰ κρινεῖ ταπεινῶ κρίσιν καὶ ἐλέγξει τοὺς ταπεινοὺς τῆς γῆς καὶ πατάξει γῆν τῶ λόγῳ τοῦ στόματος αὐτοῦ καὶ ἐν πνεύματι διὰ χειλέων ἀνελεῖ ἀσεβῆ*
- 5** Drejtësia do të jetë brezi i ijëve të tij dhe besnikëria brezi i anëve të tij.  
*And righteousness will be the cord of his robe, and good faith the band round his breast.*  
*καὶ ἔσται δικαιοσύνη ἐξωσμένος τὴν ὄσφυν αὐτοῦ καὶ ἀληθεία εἰλημένος τὰς πλευράς*
- 6** Ujku do të banojë bashkë me qengjin dhe leopardi do të rrijë me kecin; viçi, luani i vogël dhe bagëtia e majmur do të rrinë bashkë dhe do të udhëhiqen nga një fëmijë.  
*And the wolf will be living with the lamb, and the leopard will take his rest with the young goat; and the lion will take grass for food like the ox; and the young lion will go with the young ones of the herd; and a little child will be their guide.*  
*καὶ συμβοσκηθήσεται λύκος μετὰ ἀρνός καὶ πάρδαλις συναπαύσεται ἐρίφῳ καὶ μοσχάριον καὶ ταῦρος καὶ λέων ἅμα βοσκηθήσονται καὶ παιδίον μικρὸν ἄξει αὐτούς*
- 7** Lopa do të kullojë bashkë me arushen, të vegjëlit e tyre do të rrinë bashkë, dhe luani do të ushqehet me kashtë si kau.  
*And the cow and the bear will be friends while their young ones are sleeping together.*  
*καὶ βοῦς καὶ ἄρκος ἅμα βοσκηθήσονται καὶ ἅμα τὰ παιδιά αὐτῶν ἔσονται καὶ λέων καὶ βοῦς ἅμα φάγονται ἄχυρα*
- 8** Foshnja e gjirit do të lozë mbi vrimën e gjarpërit dhe fëmija e zvjerdhur do të vërë dorën e tij në çerdhen e nëpërkës.  
*And the child at the breast will be playing by the hole of the snake, and the older child will put his hand on the bright eye of the poison-snake.*  
*καὶ παιδίον νήπιον ἐπὶ τρώγλῃν ἀσπίδων καὶ ἐπὶ κοίτην ἐκγόνων ἀσπίδων τὴν χεῖρα ἐπιβαλεῖ*
- 9** Nuk do të bëhet asnjë e keqe, asnjë shkatërrim mbi tërë malin tim të shenjtë, sepse vendi do të mbushet me njohurinë e Zotit, ashtu si ujërat mbulojnë detin.  
*There will be no cause of pain or destruction in all my holy mountain: for the earth will be full of the knowledge of the Lord as the sea is covered by the waters.*  
*καὶ οὐ μὴ κακοποιήσωσιν οὐδὲ μὴ δύνωνται ἀπολέσαι οὐδένα ἐπὶ τὸ ὄρος τὸ ἅγιόν μου ὅτι ἐνεπλήσθη ἡ σύμπασα τοῦ γνῶναι τὸν κύριον ὡς ὕδωρ πολὺ κατακαλύψει θαλάσσας*
- 10** Atë ditë do të ndodhë që rrënja e Isaias do të ngrihet si një flamur për popujt; kombet do ta kërkojnë dhe vendi i prehjes së tij do të jetë i lavdishëm.  
*And in that day, the eyes of the nations will be turned to the root of Jesse which will be lifted up as the flag of the peoples; and his resting-place will be glory.*  
*καὶ ἔσται ἐν τῇ ἡμέρᾳ ἐκείνῃ ἡ ῥίζα τοῦ ιεσσαὶ καὶ ὁ ἀνιστάμενος ἄρχειν ἐθνῶν ἐπ' αὐτῷ ἔθνη ἐλπιούσιν καὶ ἔσται ἡ ἀνάπαυσις αὐτοῦ τιμὴ*
- 11** Po atë ditë do të ndodhë që Zoti do të shtrijë dorën e tij për herë të dytë për të shpënguar mbetjen e popullit të tij që shpëtoi nga Asiria dhe nga Egjipti, nga Pathrosi dhe Etiopia, nga Elami, nga Shinari, nga Hamathi dhe nga ishujt e detit.  
*And in that day the hand of the Lord will be stretched out the second time to get back the rest of his people, from Assyria, and from Egypt, and from Pathros, and from Cush, and from Elam, and from Shinar, and from Hamath, and from the sea-lands.*  
*καὶ ἔσται τῇ ἡμέρᾳ ἐκείνῃ προσθήσει κύριος τοῦ δεῖξαι τὴν χεῖρα αὐτοῦ τοῦ ζηλωσῆαι τὸ καταλειφθῆν ὑπόλοιπον τοῦ λαοῦ ὃ ἂν καταλειφθῆ ἀπὸ τῶν ἀσσυρίων καὶ ἀπὸ αἰγύπτου καὶ βαβυλωνίας καὶ αἰθιοπίας καὶ ἀπὸ αἰλαμιτῶν καὶ ἀπὸ ἡλίου ἀνατολῶν καὶ ἐξ ἀραβίας*
- 12** Ai do të ngrerë flamurin për kombet, do të mbledhë të dëbuarit e Izraelit dhe do të grumbullojë ata që u shpërndanë nga Juda në të katër anët e dheut.  
*And he will put up a flag as a sign to the nations, and he will get together those of Israel who had been sent away, and the wandering ones of Judah, from the four ends of the earth.*  
*καὶ ἀρεῖ σημεῖον εἰς τὰ ἔθνη καὶ συνάξει τοὺς ἀπολομένους ἰσραηλ καὶ τοὺς διεσπαρμένους τοῦ ἰουδα συνάξει ἐκ τῶν τεσσάρων πτερόγων τῆς γῆς*



- 13** Smira e Efraimit do të zhduket dhe kundërshtarët e Judës do të asgjesohen; Efraimi nuk do ta ketë më zili Judën dhe Juda nuk do të ketë më armiqësi me Efraimin.  
*And the envy of Ephraim will be gone, and those who make trouble for Judah will come to an end: Ephraim will have no more envy of Judah, and there will be an end of Judah's hate for Ephraim.*  
*καὶ ἀφαιρεθήσεται ὁ ζήλος εφραιμ καὶ οἱ ἐχθροὶ ἰουδα ἀπολοῦνται εφραιμ οὐ ζηλώσει ἰουδαν καὶ ἰουδας οὐ θλίψει εφραιμ*
- 14** Ata do t'u sulen me turr Filistejve nga pas, në drejtim të perëndimit, bashkë do të plaçkitin bijtë e lindjes; do të vënë dorën e tyre mbi Edomin dhe mbi Moabin, dhe bijtë e Amonit do të jenë nënshetetas të tyre.  
*And they will be united in attacking the Philistines on the west, and together they will take the goods of the children of the east: their hand will be on Edom and Moab; and the children of Ammon will be under their rule.*  
*καὶ πετασθήσονται ἐν πλοίοις ἀλλοφύλων θάλασσαν ἅμα προνομεύουσιν καὶ τοὺς ἀφ' ἡλίου ἀνατολῶν καὶ ἰδουμαίαν καὶ ἐπὶ μοαβ πρῶτον τὰς χεῖρας ἐπιβαλοῦσιν οἱ δὲ υἱοὶ αμμων πρῶτοι ὑπακούσονται*
- 15** Zoti do të shkatërrtojë plotësisht gjuhën e detit të Egjiptit dhe me fuqinë e frymës së tij do të lëvizë dorën e tij mbi lumin dhe do të godasë duke e ndarë në shtatë kanale, kështu që të ketë mundësi të kapërcehet me sandale.  
*And the Lord will make the tongue of the Egyptian sea completely dry; and with his burning wind his hand will be stretched out over the River, and it will be parted into seven streams, so that men may go over it with dry feet.*  
*καὶ ἐρημόσει κύριος τὴν θάλασσαν αἰγύπτου καὶ ἐπιβαλεῖ τὴν χεῖρα αὐτοῦ ἐπὶ τὸν ποταμὸν πνεύματι βιαίῳ καὶ πατάξει ἐπτά φάραγγας ὥστε διαπορεύεσθαι αὐτὸν ἐν ὑποδήμασιν*
- 16** Do të ketë një rrugë për mbetjen e popullit të tij që ka mbetur në Asiri, ashtu si pati një rrugë për Izraelin ditën që doli nga vendi i Egjiptit.  
*And there will be a highway for the rest of his people from Assyria; as there was for Israel in the day when he came up out of the land of Egypt.*  
*καὶ ἔσται δίοδος τῷ καταλειφθέντι μου λαῷ ἐν αἰγύπτῳ καὶ ἔσται τῷ ἰσραηλ ὡς ἡ ἡμέρα ὅτε ἐξῆλθεν ἐκ γῆς αἰγύπτου*
- 1** Atë ditë do të thuash: "Unë të kremtoj, o Zot. Edhe pse ishe i zemëruar me mua, zemërimi yt me mua u qetësua dhe më ka ngushëlluar.  
*And in that day you will say I will give praise to you, O Lord; for though you were angry with me, your wrath is turned away, and I am comforted.*  
*καὶ ἐρεῖς ἐν τῇ ἡμέρᾳ ἐκείνῃ εὐλογήσω σε κύριε διότι ὀργίσθης μοι καὶ ἀπέστρεψας τὸν θυμὸν σου καὶ ἠλέησάς με*
- 2** Ja, Perëndia është shpëtimi im; unë do të kem besim dhe nuk do të kem frikë, sepse Zoti, po, Zoti është forca ime dhe kantiku im, dhe ka qenë shpëtimi im"  
*See, God is my salvation; I will have faith in the Lord, without fear: for the Lord Jah is my strength and song; and he has become my salvation.*  
*ἰδοὺ ὁ θεὸς μου σωτήρ μου κύριος πεποιθὸς ἔσομαι ἐπ' αὐτῷ καὶ σωθήσομαι ἐν αὐτῷ καὶ οὐ φοβηθήσομαι διότι ἡ δόξα μου καὶ ἡ αἰνεσίς μου κύριος καὶ ἐγένετό μοι εἰς σωτηρίαν*
- 3** Ju do të merrni me gëzim ujën nga burimet e shpëtimit.  
*So with joy will you get water out of the springs of salvation.*  
*καὶ ἀντλήσετε ὕδωρ μετ' εὐφροσύνης ἐκ τῶν πηγῶν τοῦ σωτηρίου*
- 4** Atë ditë do të thoni: "Kremtoni Zotin, thërrisni emrin e tij, i bëni të njohura veprat e tij midis popujve, shpallni që emri i tij është i lartësuar.  
*And in that day you will say, Give praise to the Lord, let his name be honoured, give word of his doings among the peoples, say that his name is lifted up.*  
*καὶ ἐρεῖς ἐν τῇ ἡμέρᾳ ἐκείνῃ ὑμνεῖτε κύριον βοᾶτε τὸ ὄνομα αὐτοῦ ἀναγγεῖλατε ἐν τοῖς ἔθνεσιν τὰ ἔνδοξα αὐτοῦ μνησθεσθε ὅτι ὑψώθη τὸ ὄνομα αὐτοῦ*
- 5** Këndojini lavde Zotit, sepse ka bërë gjëra të madhërishme; kjo të dihet mbi gjithë tokën.  
*Make a song to the Lord; for he has done noble things: give news of them through all the earth.*  
*ὕμνησατε τὸ ὄνομα κυρίου ὅτι ὑψηλὰ ἐποίησεν ἀναγγεῖλατε ταῦτα ἐν πάσῃ τῇ γῇ*
- 6** Bërtit dhe ngazëllohu nga gëzimi, o banore e Sionit, sepse i madh është i Shenjti i Izraelit në mes tuaj"  
*Let your voice be sounding in a cry of joy, O daughter of Zion, for great is the Holy One of Israel among you.*  
*ἀγαλλιᾶσθε καὶ εὐφραίνεσθε οἱ κατοικοῦντες σιων ὅτι ὑψώθη ὁ ἅγιος τοῦ ἰσραηλ ἐν μέσῳ αὐτῆς*
- 1** Profecia mbi Babiloninë, që ju paraqit në vegim Isaias, birit të Amotsit.  
*The word of the Lord about Babylon which Isaiah, the son of Amoz, saw.*  
*ὄρασις ἦν εἶδεν ἡσαίας υἱὸς αμωσ κατὰ βαβυλῶνος*
- 2** "Ngrini një flamur mbi një mal të lartë, ngrini zërin ndaj tyre, lëvizni dorën që të hyjnë në portat e princave.  
*Put up a flag on a clear mountain-top, make a loud outcry to them, give directions with the hand, so that they may go into the doors of the great ones.*  
*ἐπ' ὄρους πεδινῶ ἄρατε σημεῖον ὑψώσατε τὴν φωνὴν αὐτοῖς μὴ φοβεῖσθε παρακαλεῖτε τῇ χειρὶ ἀνοίξατε οἱ ἄρχοντες*
- 3** Unë u dhashë urdhër atyre që më janë shenjtëruar mua, thirra trimat e mi për të zbatuar zemërimin tim, ata që ngazëllohen në madhërinë time.  
*I have given orders to my holy ones, I have sent out my men of war, those of mine who take pride in their power, to give effect to my wrath.*  
*ἐγὼ συντάσσω καὶ ἐγὼ ἄγω αὐτούς ἡγιασμένοι εἰσὶν καὶ ἐγὼ ἄγω αὐτούς γίγαντες ἔρχονται πληρῶσαι τὸν θυμὸν μου χαίροντες ἅμα καὶ ὕβρίζοντες*

- 4 Dëgjohet zhurma e një turme të madhe ndër malet, e ngjashme me atë të një populli të pamasë; zhurma plot rrëmet e mbretërive, e kombeve të mbledhura. Zoti i ushtrive kalon në revistë ushtrinë gati për betejë.  
The noise of great numbers in the mountains, like the noise of a strong people! The noise of the kingdoms of the nations meeting together! The Lord of armies is numbering his forces for war.  
φωνή ἐθνῶν πολλῶν ἐπὶ τῶν ὄρεων ὁμοία ἐθνῶν πολλῶν φωνὴ βασιλείων καὶ ἐθνῶν συνηγμένων κύριος σαβαωθ ἐντέταλται ἔθνει ὀπλομάχῳ
- 5 Vijnë nga një vend i largët, nga skaji i qiejve, Zoti dhe mjetet e zemërimit të tij, për të shkatërruar mbarë dheun.  
They come from a far country, from the farthest part of heaven, even the Lord and the instruments of his wrath, with destruction for all the land.  
ἔρχεσθαι ἐκ γῆς πόρρωθεν ἀπ' ἄκρου θεμελίου τοῦ οὐρανοῦ κύριος καὶ οἱ ὀπλομάχοι αὐτοῦ τοῦ καταφθεῖραι τὴν οἰκουμένην ὅλην
- 6 Bërtisni, sepse dita e Zotit është e afërt; ajo po vjen si një shkatërrim nga ana e të Plotfuqishmit.  
Send out a cry of grief; for the day of the Lord is near; it comes as destruction from the Most High.  
ὀλολόζετε ἐγγὺς γάρ ἡ ἡμέρα κυρίου καὶ συντριβὴ παρὰ τοῦ θεοῦ ἦξει
- 7 Prandaj të gjitha duart e njerëzve do të jenë të dobëta dhe çdo zemër e tyre do të ligështohet.  
For this cause all hands will be feeble, and every heart of man be turned to water;  
διὰ τοῦτο πᾶσα χεὶρ ἐκλυθήσεται καὶ πᾶσα ψυχὴ ἀνθρώπου δειλιάσει
- 8 Do t'i zërë tmerri, do të kenë spazma dhe dhembje, do të përpëlitën si një grua që po lind, do të shikojnë njëri tjetrin në fytyrë si të hutuar, fytyrat e tyre do të jenë fytyra të zjarrra.  
Their hearts will be full of fear; pains and sorrows will overcome them; they will be in pain like a woman in childbirth; they will be shocked at one another; their faces will be like flames.  
καὶ παραχθήσονται οἱ πρέσβεις καὶ ὠδίνες αὐτοῦς ἔξουσιν ὡς γυναῖκός τικτοῦσας καὶ συμφοράσουσιν ἕτερος πρὸς τὸν ἕτερον καὶ ἐκστήσονται καὶ τὸ πρόσωπον αὐτῶν ὡς φλόξ μεταβαλοῦσιν
- 9 Ja, dita e Zotit po vjen: një ditë mizore, indinjate dhe zemërimi të fortë, për ta bërë tokën shkretëtirë dhe për të shfarosur mëkatarët prej saj.  
See, the day of the Lord is coming, cruel, with wrath and burning passion: to make the land a waste, driving the sinners in it to destruction.  
ἰδοὺ γὰρ ἡμέρα κυρίου ἀνιάτος ἔρχεται θυμοῦ καὶ ὀργῆς θεῖναι τὴν οἰκουμένην ὅλην ἔρημον καὶ τοὺς ἁμαρτωλοὺς ἀπολέσαι ἐξ αὐτῆς
- 10 Sepse yjet e qiellit dhe yllësitë nuk do të shkëlqejnë më me dritën e tyre; dielli do të errësohet në lindjen e tij dhe hëna nuk do të përhapë më dritën e saj.  
For the stars of heaven and its bright armies will not give their light: the sun will be made dark in his journey through the heaven, and the moon will keep back her light.  
οἱ γὰρ ἀστέρες τοῦ οὐρανοῦ καὶ ὁ ὥριον καὶ πᾶς ὁ κόσμος τοῦ οὐρανοῦ τὸ φῶς οὐ δώσουσιν καὶ σκοτισθήσεται τοῦ ἡλίου ἀνατέλλοντος καὶ ἡ σελήνη οὐ δώσει τὸ φῶς αὐτῆς
- 11 Unë do të dënoj botën për ligësinë e saj dhe të pabesët për paudhësinë e tyre; do t'i jap fund krenarisë së kryelartëve dhe do të hedh poshtë arrogancën e tiranëve.  
And I will send punishment on the world for its evil, and on the sinners for their wrongdoing; and I will put an end to all pride, and will make low the power of the cruel.  
καὶ ἐντελοῦμαι τῇ οἰκουμένῃ ὅλη κακὰ καὶ τοῖς ἀσεβέσιν τὰς ἁμαρτίας αὐτῶν καὶ ἀπολῶ ὕβριν ἀνόμων καὶ ὕβριν ὑπερηφάνων ταπεινώσω
- 12 Do ta bëjë njeriun e vdekshëm më të rrallë se ari i kulluar, njerëzinë më të rrallë se arin e Ofirit.  
I will make men so small in number, that a man will be harder to get than gold, even the best gold of Ophir.  
καὶ ἔσονται οἱ καταλειμμένοι ἐντιμοὶ μᾶλλον ἢ τὸ χρυσίον τὸ ἄπυρον καὶ ὁ ἄνθρωπος μᾶλλον ἐντιμὸς ἔσται ἢ ὁ λίθος ὁ ἐκ σουφίρ
- 13 Prandaj do të bëjë që të dridhen qiejtë, dhe toka do të tundet nga vendi i saj për shkak të indinjatës së Zotit të ushtrive ditën e zemërimit të zjarrtë të tij.  
For this cause the heavens will be shaking, and the earth will be moved out of its place, in the wrath of the Lord of armies, and in the day of his burning passion.  
ὁ γὰρ οὐρανὸς θυμωθήσεται καὶ ἡ γῆ σεισθήσεται ἐκ τῶν θεμελίων αὐτῆς διὰ θυμὸν ὀργῆς κυρίου σαβαωθ τῇ ἡμέρᾳ ἣ ἂν ἐπέλθῃ ὁ θυμὸς αὐτοῦ
- 14 Atëherë si një gazelë e ndjekur apo si një kope që askush nuk e mbledh, gjithkush do të kthehet drejt popullit të tij, gjithkush do të ikë në vend të vet.  
And it will be that, like a roe in flight, and like wandering sheep, they will go every man to his people and to his land.  
καὶ ἔσονται οἱ καταλειμμένοι ὡς δορκάδιον φεῦγον καὶ ὡς πρόβατον πλανώμενον καὶ οὐκ ἔσται ὁ συνάγων ὥστε ἄνθρωπον εἰς τὸν λαὸν αὐτοῦ ἀποστραφεῖν καὶ ἄνθρωπον εἰς τὴν χώραν αὐτοῦ διῶξαι
- 15 Kushdo që do të gjendet do të shpohet dhe kushdo që do të kapet do të vritet me shpatë.  
Everyone who is overtaken will have a spear put through him, and everyone who goes in flight will be put to the sword.  
ὅς γὰρ ἂν ἀλφῆ ἡττηθήσεται καὶ οἵτινες συνηγμένοι εἰσὶν μαχαίρᾳ πεσοῦνται
- 16 Fëmijët e tyre do të bëhen copë-copë para syve të tyre, shtëpitë e tyre do të plaçkiten dhe gratë e tyre do të dhunohen.  
Their young children will be broken up before their eyes; their goods will be taken away, and their wives made the property of others.  
καὶ τὰ τέκνα αὐτῶν ἐνώπιον αὐτῶν ῥάξουσιν καὶ τὰς οἰκίας αὐτῶν προνομεύσουσιν καὶ τὰς γυναῖκας αὐτῶν ἔξουσιν

- 17 Ja, unë po nxis kundër tyre Medët që nuk do ta kenë mendjen te argjendi dhe nuk gjejnë kënaqësi te ari.  
See, I am driving the Medes against them, who put no value on silver and have no pleasure in gold.  
ἰδοὺ ἐπεγείρω ὑμῖν τοὺς μῆδους οἱ οὐ λογίζονται ἀργύριον οὐδὲ χρυσοῦ χρεῖαν ἔχουσιν
- 18 Harqet e tyre do t'i rrëzojnë për tokë të rinjtë; nuk do të kenë mëshirë për foshnjat në bark të nënës; syri i tyre nuk do t'i kursejë fëmijët.  
In their hands are bows and spears; they are cruel, violently putting the young men to death, and crushing the young women; they have no pity for children, and no mercy for the fruit of the body.  
τοξεύματα νεανίσκων συντρίψουσιν καὶ τὰ τέκνα ὑμῶν οὐ μὴ ἐλεήσωσιν οὐδὲ ἐπὶ τοῖς τέκνοις οὐ φείσονται οἱ ὀφθαλμοὶ αὐτῶν
- 19 Kështu Babilonia, shkëlqimi i mbretërive, lavdia e krenarisë së Kaldeasve, do të jetë si Sodoma dhe Gomora kur Perëndia i përmbysi.  
And Babylon, the glory of kingdoms, the beautiful town which is the pride of the Chaldaeans, will be like God's destruction of Sodom and Gomorrah.  
καὶ ἔσται βαβυλῶν ἢ καλεῖται ἔνδοξος ὑπὸ βασιλείως χαλδαίων ὃν τρόπον κατέστρεψεν ὁ θεὸς σοδομα καὶ γομορρα
- 20 Ajo nuk do të banohet më as nuk do të popullohet brez pas brezi; Arabi nuk do të ngrerë më aty çadrën e tij, as barinjët nuk do t'i ndalin aty kopetë e tyre.  
People will never be living in it again, and it will have no more men from generation to generation: the Arab will not put up his tent there; and those who keep sheep will not make it a resting-place for their flocks.  
οὐ κατοικηθήσεται εἰς τὸν αἰῶνα χρόνον οὐδὲ μὴ εἰσελθῶσιν εἰς αὐτὴν διὰ πολλῶν γενεῶν οὐδὲ μὴ διέλθωσιν αὐτὴν ἄραβες οὐδὲ ποιμένες οὐ μὴ ἀναπαύσονται ἐν αὐτῇ
- 21 Por aty do të pushojnë bishat e shkretëtirës, shtëpitë e tyre do të mbushen me huta, do të banojnë aty strucat, do të hedhin valle satirët.  
But the beasts of the waste land will have their holes there; and the houses will be full of crying jackals, and ostriches will have their place there, and evil spirits will be dancing there.  
καὶ ἀναπαύσονται ἐκεῖ θηρία καὶ ἐμπλησθήσονται αἱ οἰκίαι ἤχου καὶ ἀναπαύσονται ἐκεῖ σειρήνες καὶ δαιμόνια ἐκεῖ ὀρχήσονται
- 22 Hienat do të ulërijnë në shtëpitë e tij të shkretuara, çakajtë në pallatet e tij luksoze. Koha e tij po afrohet, ditët e tij nuk do të zgjaten më &quot;  
And wolves will be answering one another in their towers, and jackals in their houses of pleasure: her time is near, and her days of power will quickly be ended.  
καὶ ὀνοκένταυροι ἐκεῖ κατοικήσουσιν καὶ νοσσοποιήσουσιν ἔχῃνοι ἐν τοῖς οἴκοις αὐτῶν ταχὺ ἔρχεται καὶ οὐ χρονεῖ
- 1 Me qenë se Zotit do t'i vijë keq për Jakobin, ai do të zgjedhë përsëri Izraelin dhe do t'i rivendosë në tokën e tyre; të huajtë do të bashkohen me ta dhe do të lidhen me shtëpinë e Jakobit.  
For the Lord will have mercy on Jacob, and will again make Israel his special people, and will put them in their land; and the man from a strange country will take his place among them and be joined to the family of Jacob.  
καὶ ἐλεήσει κύριος τὸν ἰακωβ καὶ ἐκλέξεται ἔτι τὸν ἰσραηλ καὶ ἀναπαύσονται ἐπὶ τῆς γῆς αὐτῶν καὶ ὁ γιώρας προστεθήσεται πρὸς αὐτοὺς καὶ προστεθήσεται πρὸς τὸν οἶκον ἰακωβ
- 2 Popujt do t'i marrin dhe do t'i çojnë përsëri në vendin e tyre dhe shtëpia e Izraelit do t'i zotërojë në vendin e Zotit si robër dhe robinja; do të zënë robër ata që i kishin zënë robër dhe do të mbretërojnë mbi shtypësit e tyre.  
And the people will take them with them to their place: and the children of Israel will give them a heritage in the Lord's land as men-servants and women-servants, making them prisoners whose prisoners they were; and they will be rulers over their masters.  
καὶ λήψονται αὐτοὺς ἔθνη καὶ εἰσάξουσιν εἰς τὸν τόπον αὐτῶν καὶ κατακληρονομήσουσιν καὶ πληθυνθήσονται ἐπὶ τῆς γῆς τοῦ θεοῦ εἰς δούλους καὶ δούλας καὶ ἔσονται αἰχμάλωτοι οἱ αἰχμαλωτεύσα ντες αὐτοὺς καὶ κυριευθήσονται οἱ κυριεύσαντες αὐτῶν
- 3 Kështu që ditën në të cilën Zoti do t'i japë prehje lodhjes sate, shqetësimit tënd nga skllavëria e rëndë së cilës i ishe nënshtruar,  
And it will be, in the day when the Lord gives you rest from your sorrow, and from your trouble, and from the hard yoke which they had put on you,  
καὶ ἔσται ἐν τῇ ἡμέρᾳ ἐκείνῃ ἀναπαύσει σε ὁ θεὸς ἐκ τῆς ὀδύνης καὶ τοῦ θυμοῦ σου καὶ τῆς δουλείας σου τῆς σκληρᾶς ἧς ἐδούλευσας αὐτοῖς
- 4 ti do të shqiptosh këtë sentencë mbi mbretin e Babilonisë dhe do të thuash: &quot;Ashtu si mbaroi shtypësi, tagrambledhja e arit ka mbaruar.  
That you will take up this bitter song against the king of Babylon, and say, How has the cruel overseer come to an end! He who was lifted up in pride is cut off;  
καὶ λήμψη τὸν θρῆνον τοῦτον ἐπὶ τὸν βασιλέα βαβυλῶνος καὶ ἐρεῖς ἐν τῇ ἡμέρᾳ ἐκείνῃ πῶς ἀναπέπταται ὁ ἀπαιτῶν καὶ ἀναπέπταται ὁ ἐπισπουδαστής
- 5 Zoti e ka thyer shkopin e të pabesëve, skeptrin e tiranëve.  
The stick of the evil-doers, the rod of the rulers, is broken by the Lord;  
συνέτριψεν ὁ θεὸς τὸν ζυγὸν τῶν ἀμαρτωλῶν τὸν ζυγὸν τῶν ἀρχόντων
- 6 Ai që në tërbim e sipër godiste popujt me goditje të pandërprera, ai që sundonte me zemërim mbi kombet tani përndiqet pa mëshirë.  
He whose rod was on the peoples with an unending wrath, ruling the nations in passion, with an uncontrolled rule.  
πατάξας ἔθνος θυμῷ πληγῇ ἀνιάτῳ παῖον ἔθνος πληγῇ θυμοῦ ἢ οὐκ ἐφείσατο
- 7 Mbarë dheu pushon i qetë, njerëzit shpërthejnë në britma gëzimi.  
All the earth is at rest and is quiet: they are bursting into song.  
ἀνεπαύσατο πεποιθῶς πᾶσα ἡ γῆ βοᾷ μετ' εὐφροσύνης

- 8 Madje edhe selvitë e kedrat e Libanit gëzohen për ty dhe thonë: "Që kur ke rënë, asnjë druvar s'ka dalë kundër nesh";  
Even the trees of the wood are glad over you, the trees of Lebanon, saying, From the time of your fall no wood-cutter has come up against us with an axe.  
καὶ τὰ ξύλα τοῦ λιβάνου εὐφράνθησαν ἐπὶ σοὶ καὶ ἡ κέδρος τοῦ λιβάνου ἀφ' οὗ σὺ κεκοίμησαι οὐκ ἀνέβη ὁ κόπτων ἡμᾶς
- 9 Sheoli poshtë është në lëvizje për ty, me qëllim që të të dalë përpara kur të vish; ai zgjon frymët e të vdekurve, tërë princat e dheut; ka ngritur nga fronet e tyre gjithë mbretërit e kombeve.  
The underworld is moved at your coming: the shades of the dead are awake before you, even the strong ones of the earth; all the kings of the world have got up from their seats.  
ὁ ἕδης κάτωθεν ἐπικράνθη συναντήσας σοὶ συνηγέρθησάν σοι πάντες οἱ γίγαντες οἱ ἄρξαντες τῆς γῆς οἱ ἐγειραντες ἐκ τῶν θρόνων αὐτῶν πάντας βασιλεῖς ἐθνῶν
- 10 Të gjithë e marrin fjalën për të të thënë: "Edhe ti je bërë i dobët si ne dhe je bërë i ngjashëm me ne.  
They all make answer and say to you, Have you become feeble like us? have you been made even as we are?  
πάντες ἀποκριθήσονται καὶ ἐροῦσίν σοι καὶ σὺ ἐάλως ὥσπερ καὶ ἡμεῖς ἐν ἡμῖν δὲ κατελογίσθης
- 11 Salltaneti yt ka rënë në Sheol tok me tingujt e harpave të tua; poshtë teje shtrihet një shtrat me krimba dhe krimbat janë mbulesa jote";  
Your pride has gone down into the underworld, and the noise of your instruments of music; the worms are under you, and your body is covered with them.  
κατέβη δὲ εἰς ἕδου ἡ δόξα σου ἢ πολλή σου εὐφροσύνη ὑποκάτω σου στρώσουσιν σῆψιν καὶ τὸ κατακάλυμμά σου σκώληξ
- 12 Vallë, si ke rënë nga qielli, o Lucifer, bir i agimit? Vallë si të hodhën për tokë ty që i hidhje poshtë kombet?  
How great is your fall from heaven, O shining one, son of the morning! How are you cut down to the earth, low among the dead bodies!  
πῶς ἐξέπεσεν ἐκ τοῦ οὐρανοῦ ὁ ἑωσφόρος ὁ πρῶτὸ ἀνατέλλον συνετρίβη εἰς τὴν γῆν ὁ ἀποστέλλον πρὸς πάντα τὰ ἔθνη
- 13 Ti thoshnje në zemrën tënde: "Unë do të ngjitem në qiell, do të ngre fronin tim përmbi yjet e Perëndisë; do të ulem mbi malin e asamblesë në pjesën skajore të veriut;  
For you said in your heart, I will go up to heaven, I will make my seat higher than the stars of God; I will take my place on the mountain of the meeting-place of the gods, in the inmost parts of the north.  
σὺ δὲ εἶπας ἐν τῇ διανοίᾳ σου εἰς τὸν οὐρανὸν ἀναβήσομαι ἐπάνω τῶν ἀστρῶν τοῦ οὐρανοῦ θήσω τὸν θρόνον μου καθιῶ ἐν ὄρει ὑψηλῷ ἐπὶ τὰ ὄρη τὰ ὑψηλὰ τὰ πρὸς βορρᾶν
- 14 do të ngjitem mbi pjesët më të larta të reve, do të jem i ngjashëm me Shumë të Lartin";  
I will go higher than the clouds; I will be like the Most High.  
ἀναβήσομαι ἐπάνω τῶν νεφελῶν ἔσομαι ὅμοιος τῷ ὑψίστῳ
- 15 Po përkundrazi do të hidhesh në Sheol, në thellësitë e gropës.  
But you will come down to the underworld, even to its inmost parts.  
νῦν δὲ εἰς ἕδου καταβήσῃ καὶ εἰς τὰ θεμέλια τῆς γῆς
- 16 Ata që të shikojnë të ngulin sytë, të vërejnë me kujdes dhe thonë: "Ky është njeriu që e bënte tokën të dridhej, që i trondiste mbretëritë,  
Those who see you will be looking on you with care, they will be in deep thought, saying, Is this the troubler of the earth, the shaker of kingdoms?  
οἱ ἰδόντες σε θαυμάσουσιν ἐπὶ σοὶ καὶ ἐροῦσιν οὗτος ὁ ἄνθρωπος ὁ παροξύνων τὴν γῆν σείων βασιλεῖς
- 17 që e katandisi botën në shkretëtirë, që shkatërron qytetet e saj dhe nuk i la kurrë të shkojnë të lirë robërit e tij?";  
Who made the world a waste, overturning its towns; who did not let his prisoners loose from the prison-house.  
ὁ θεὸς τὴν οἰκουμένην ὄλην ἔρημον καὶ τὰς πόλεις καθεῖλεν τοὺς ἐν ἐπαγωγῇ οὐκ ἔλυσεν
- 18 Të gjithë mbretërit e kombeve, tërë ata prehen në lavdi, secili në varrin e tij;  
All the kings of the earth are at rest in glory, every man in his house,  
πάντες οἱ βασιλεῖς τῶν ἐθνῶν ἐκοιμήθησαν ἐν τιμῇ ἄνθρωπος ἐν τῷ οἴκῳ αὐτοῦ
- 19 ty përkundrazi të hodhën larg varrit tënd si një farë e neveritshme, si një rrobe të të vrarëve nga shpata, që i zbresin mbi gurët e gropës, si një kufomë e shkelur.  
But you, like a birth before its time, are stretched out with no resting-place in the earth; clothed with the bodies of the dead who have been put to the sword, who go down to the lowest parts of the underworld; a dead body, crushed under foot.  
σὺ δὲ ῥύφήσῃ ἐν τοῖς ὄρεσιν ὡς νεκρὸς ἐβδελυγμένος μετὰ πολλῶν τεθνηκότων ἐκκεκεντημένων μαχαίραις καταβαινόντων εἰς ἕδου ὃν τρόπον ἱμάτιον ἐν αἵματι πεφυρμένον οὐκ ἔσται καθαρὸν
- 20 Ti nuk do të bashkohesh me ta në varr, sepse ke shkatërruar vendin tënd dhe ke vrarë popullin tënd; pasardhësit e keqbërësve nuk do të përmenden më.  
As for your fathers, you will not be united with them in their resting-place, because you have been the cause of destruction to your land, and of death to your people; the seed of the evil-doer will have no place in the memory of man.  
οὕτως οὐδὲ σὺ ἔση καθαρὸς διότι τὴν γῆν μου ἀπόλεσας καὶ τὸν λαόν μου ἀπέκτεινας οὐ μὴ μείνης εἰς τὸν αἰῶνα χρόνον σπέρμα πονηρὸν

- 21 Përgatitni masakrën e bijve të tij për shkak të paudhësisë së etërve të tyre, që të mos ngrihen më për të zotëruar tokën dhe për të mbushur faqen e dheut me qytete.  
 Make ready a place of death for his children, because of the evil-doing of their father; so that they may not come up and take the earth for their heritage, covering the face of the world with waste places.  
 ετοιμασον τὰ τέκνα σου σφαγήναι ταῖς ἀμαρτίαις τοῦ πατρός σου ἵνα μὴ ἀναστῶσιν καὶ τὴν γῆν κληρονομήσωσιν καὶ ἐμπλήσωσι τὴν γῆν πόλεων
- 22 "Unë do të ngrihem kundër tyre", thotë Zoti i ushtrive, "dhe do të shfaros nga Babilonia emrin dhe ata që kishin shpëtuar, fëmijët dhe pasardhësit";, thotë Zoti.  
 For I will come up against them, says the Lord of armies, cutting off from Babylon name and offspring, son and son's son, says the Lord.  
 καὶ ἐπαναστήσομαι αὐτοῖς λέγει κύριος σαβαωθ καὶ ἀπολωῶ αὐτῶν ὄνομα καὶ κατάλειμμα καὶ σπέρμα τάδε λέγει κύριος
- 23 "Do të bëj që atje të sundojë iriqi dhe moçali; do ta fshij me fshesën e shkatërrimit";, thotë Zoti i ushtrive";.  
 And I will make you a heritage for the hedgehog, and pools of water: and I will go through it with the brush of destruction, says the Lord of armies.  
 καὶ θήσω τὴν βαβυλωνίαν ἔρημον ὥστε κατοικεῖν ἐχίνους καὶ ἔσται εἰς οὐδέν καὶ θήσω αὐτὴν πηλοῦ βάραθρον εἰς ἀπώλειαν
- 24 Zoti i ushtrive është betuar duke thënë: "Në të vërtetë ashtu siç e kam menduar ashtu do të jetë, dhe ashtu si kam vendosur, kështu ka për të ndodhur.  
 The Lord has taken an oath, saying, My design will certainly come about, and my purpose will be effected:  
 τάδε λέγει κύριος σαβαωθ ὃν τρόπον εἶρηκα οὕτως ἔσται καὶ ὃν τρόπον βεβούλευμαι οὕτως μενεῖ
- 25 Do ta dërrmoj Asirin në vendin tim, do ta shkel në malet e mia; atëherë zgjedha e tij do t'u hiqet atyre dhe barra tij do të hiqet nga kurrizi i tyre.  
 To let the Assyrian be broken in my land, and crushed under foot on my mountains: there will his yoke be taken away from them, and his rule over them come to an end.  
 τοῦ ἀπολέσαι τοὺς ἀσσυρίους ἀπὸ τῆς γῆς τῆς ἐμῆς καὶ ἀπὸ τῶν ὀρέων μου καὶ ἔσονται εἰς καταπάτημα καὶ ἀφαιρεθήσεται ἀπ' αὐτὸν ὁ ζυγὸς αὐτῶν καὶ τὸ κῶδος αὐτῶν ἀπὸ τῶν ὁμῶν ἀφαιρεθήσεται
- 26 Ky është plani i vendosur kundër të gjithë dheut dhe kjo është dora e shtrirë kundër të gjithë kombeve.  
 This is the purpose for all the earth: and this is the hand stretched out over all nations.  
 αὕτη ἡ βουλή ἦν βεβούλευται κύριος ἐπὶ τὴν οἰκουμένην ὅλην καὶ αὕτη ἡ χεὶρ ἡ ὑψηλὴ ἐπὶ πάντα τὰ ἔθνη τῆς οἰκουμένης
- 27 Me qenë se Zoti i ushtrive e ka vendosur këtë, kush mund t'ia anullojë? Dora e tij është shtrirë dhe kush mund ta detyrojë ta tërheqë?".  
 For it is the purpose of the Lord of armies, and who will make it of no effect? when his hand is stretched out, by whom may it be turned back?  
 ἂ γὰρ ὁ θεὸς ὁ ἅγιος βεβούλευται τίς διασκεδάσει καὶ τὴν χεῖρα τὴν ὑψηλὴν τίς ἀποστρέψει
- 28 Në vitin e vdekjes së mbretit Ashaz u shqiptua kjo profeci:  
 In the year of the death of King Ahaz this word came to the prophet:  
 τοῦ ἔτους οὗ ἀπέθανεν αχαζ ὁ βασιλεὺς ἐγενήθη τὸ ῥῆμα τοῦτο
- 29 "Mos u gëzo, o Filisti e tërë, sepse shufra që të godiste është thyer! Sepse nga rrënja e gjarpërit ka për të dalë një nëpërkë, dhe fryti i saj do të jetë një gjarpër i zjarrtë dhe fluturues.  
 Be not glad, O Philistia, all of you, because the rod which was on you is broken: for out of the snake's root will come a poison-snake, and its fruit will be a winged poison-snake.  
 μὴ εὐφρανθεῖτε πάντες οἱ ἀλλόφυλοι συνετριβὴ γὰρ ὁ ζυγὸς τοῦ παίνοντος ὑμᾶς ἐκ γὰρ σπέρματος ὄφρων ἐξελεύσεται ἔκγονα ἀσπίδων καὶ τὰ ἔκγονα αὐτῶν ἐξελεύσονται ὄφεις πετόμενοι
- 30 Të parëlindurit e të varfërve do të kenë ç'të hanë dhe nevojtarët do të pushojnë të sigurt; por do të bëj që të vdesin urie rrënjët e tua dhe kjo do të shkatërrojë mbetjen tënde.  
 And the poorest of the land will have food, and those in need will be given a safe resting-place: but your seed will come to an end for need of food, and the rest of you will be put to the sword.  
 καὶ βοσκηθήσονται πτωχοὶ δι' αὐτοῦ πτωχοὶ δὲ ἄνδρες ἐπ' εἰρήνης ἀναπαύσονται ἀνελεῖ δὲ λιμῶ τὸ σπέρμα σου καὶ τὸ κατάλειμμά σου ἀνελεῖ
- 31 Bëriti, o portë, thirr, o qytet! Shkrihu, o Filisti e tërë, sepse nga veriu vjen një tym, dhe askush nuk lë vendin e tij në radhët e veta".  
 Send out a cry, O door! Make sounds of sorrow, O town! All your land has come to nothing, O Philistia; for there comes a smoke out of the north, and everyone keeps his place in the line.  
 ὀλολύετε πύλαι πόλεων κεκραγέτωσαν πόλεις τεταραγμέναι οἱ ἀλλόφυλοι πάντες ὅτι καπνὸς ἀπὸ βορρᾶ ἔρχεται καὶ οὐκ ἔστιν τοῦ εἶναι
- 32 Çfarë përgjigje do t'u jepet lajmëtarëve të këtij kombi? "Që Zoti ka themeluar Sionin dhe që në të gjejnë strehë të mjerët e popullit të tij".  
 What answer, then, will my people give to the representatives of the nation? That the Lord is the builder of Zion, and she will be a safe place for the poor of his people.  
 καὶ τί ἀποκριθήσονται βασιλεῖς ἐθνῶν ὅτι κύριος ἐθεμελίωσεν σιων καὶ δι' αὐτοῦ σωθήσονται οἱ ταπεινοὶ τοῦ λαοῦ
- 1 Profecia mbi Moabin. Ar-Moabi është shkretuar natën dhe është shkatërruar. Po, Kir-Moabi është shkretuar natën dhe është shkatërruar.  
 The word about Moab. For in a night Ar of Moab has become waste, and is seen no longer; for in a night Kir of Moab has become waste, and is seen no longer.  
 τὸ ῥῆμα τὸ κατὰ τῆς μοαβίτιδος νυκτὸς ἀπολεῖται ἢ μοαβίτις νυκτὸς γὰρ ἀπολεῖται τὸ τεῖχος τῆς μοαβίτιδος

- 2 Është ngjitur në tempull dhe në Didon, në vendet e larta, për të qarë; Moabi ngre një vajtim për Nebin dhe Medebën; të gjitha kokat janë rruar, të gjitha mjekrat janë prerë.  
The daughter of Dibon has gone up to the high places, weeping; Moab is sounding her cry of sorrow over Nebo, and over Medeba: everywhere the hair of the head and of the face is cut off.  
λυπεῖσθε ἐφ' ἑαυτοῖς ἀπολείται γὰρ καὶ δηβὼν οὐ ὁ βωμὸς ὑμῶν ἐκεῖ ἀναβήσεσθε κλαίειν ἐπὶ ναβὰν τῆς μοαβίτιδος ὀλολύετε ἐπὶ πάσης κεφαλῆς φαλάκρωμα πάντες βραχίονες κατατετημημένοι
- 3 Në rrugët e tij ata vishen me thasë, mbi çatitë dhe në sheshet gjithkush ankohet dhe qan me të madhe.  
In their streets they are covering themselves with haircloth: on the tops of their houses, and in their public places, there is crying and bitter weeping.  
ἐν ταῖς πλατεῖαις αὐτῆς περιζώσασθε σάκκους καὶ κόπτεσθε ἐπὶ τῶν δομάτων αὐτῆς καὶ ἐν ταῖς ρύμαις αὐτῆς πάντες ὀλολύετε μετὰ κλαυθμοῦ
- 4 Heshboni dhe Elealehu këlthasin, klithma e tyre dëgjohej deri në Jahats; prandaj luftëtarët e Moabit nxjerrin klithma dhembjeje; shpirti i tij drithërohet.  
Heshbon is crying out, and Elealeh; their voice is sounding even to Jahaz: for this cause the heart of Moab is shaking; his soul is shaking with fear.  
ὅτι κέκραγεν εσεβων καὶ ελεαλη ἕως ιασσα ἠκούσθη ἡ φωνὴ αὐτῶν διὰ τοῦτο ἡ ὄσφὸς τῆς μοαβίτιδος βοᾷ ἡ ψυχὴ αὐτῆς γνώσεται
- 5 Zemra ime vajton për Moabin, të ikurit e të cilit arrijnë deri në Tsoar, si një mëshqerrë trevjeçare. Po, ata e marrin duke qarë të përpjetën e Luhithit dhe nxjerrin britma shkatërrimi në rrugën e Horonaimit;  
My heart is crying out for Moab; her people go in flight to Zoar, and to Eglath-shelishiyah: for they go up with weeping by the slope of Luhith; on the way to Horonaim they send up a cry of destruction.  
ἡ καρδιά τῆς μοαβίτιδος βοᾷ ἐν αὐτῇ ἕως σηγὼρ δάμαλις γὰρ ἐστὶν τριετής ἐπὶ δὲ τῆς ἀναβάσεως τῆς λουιθὸς πρὸς σὲ κλαίοντες ἀναβήσονται τῇ ὁδῷ αρωνιμ βοᾷ σύντριμμα καὶ σεισμός
- 6 Sepse ujërat e Nimrimit janë një shkretim, bari është tharë, bari i njomë është zhdukur; nuk gjelbëron më asgjë.  
The waters of Nimrim will become dry: for the grass is burned up, the young grass is coming to an end, every green thing is dead.  
τὸ ὕδωρ τῆς νεμμὶ ἐρημὸν ἔσται καὶ ὁ χόρτος αὐτῆς ἐκλείψει χόρτος γὰρ χλωρὸς οὐκ ἔσται
- 7 Prandaj pasuritë që i kanë grumbulluar dhe gjërat që kanë mbledhur i çojnë matanë përroit të shëlgjeve.  
For this cause they will take away their wealth, and the stores they have got together, over the stream of the water-plants.  
μὴ καὶ οὕτως μέλλει σωθῆναι ἐπάξω γὰρ ἐπὶ τὴν φάραγγα ἄραβας καὶ λήψονται αὐτήν
- 8 Britmat jehojnë nëpër gjithë territorin e Moabit, klithma e tij arrin deri në Eglaim, klithma e tij arrin deri në Beer-Elim.  
For the cry has gone round the limits of Moab; as far as to Eglaim and Beer-elim.  
συνήψεν γὰρ ἡ βοή ἡ βοή τὸ ὄριον τῆς μοαβίτιδος τῆς ἀγαλλμὶ καὶ ὀλολυγμὸς αὐτῆς ἕως τοῦ φρέατος τοῦ αλιμ
- 9 Ujërat e Dimonit janë plot me gjak, sepse do t'i shkaktoj Dimonit të këqija të tjera: një luan për ata që shpëtuan nga Moabi dhe për ata që kanë mbetur në vend.  
For the waters of Dimon are full of blood: and I'm sending even more on Moab, a lion on those of Moab who go in flight, and on the rest of the land.  
- 6 Në muajin e katërt, më nëntë të muajit, uria ishte aq e rëndë në qytet, sa që nuk kishte më bukë për popullin e vendit. **In the fourth month, on the ninth day of the month, the store of food in the town was almost gone, so that there was no food for the people of the land.**  
ἐν τῇ ἐνάτῃ τοῦ μηνὸς καὶ ἑσπερέωθη ὁ λιμὸς ἐν τῇ πόλει καὶ οὐκ ἦσαν ἄρτοι τῷ λαῷ τῆς γῆς
- 7 Atëherë u hap një e çarë në muret dhe të gjithë luftëtarët ikën, duke dalë natën nga qyteti nëpër portën midis dy mureve, e cila ndodhej pranë kopshtit të mbretit, megjithëse Kaldeasit ishin rreth qytetit. Kështu ata morën rrugën e Arabahut. **Then an opening was made in the wall of the town, and all the men of war went in flight out of the town by night through the doorway between the two walls which was by the king's garden; (now the Chaldaeans were stationed round the town:) and they went by the way of the Arabah.**  
καὶ διεκόπη ἡ πόλις καὶ πάντες οἱ ἄνδρες οἱ πολεμισταὶ ἐξῆλθον νυκτὸς κατὰ τὴν ὁδὸν τῆς πύλης ἀνά μέσον τοῦ τείχους καὶ τοῦ προτειχίσματος ὃ ἦν κατὰ τὸν κήπον τοῦ βασιλέως καὶ οἱ χαλδαῖοι ἐπὶ τῆς πόλεως κύκλῳ καὶ ἐπορεύθησαν ὁδὸν τὴν εἰς ἀραβὰ

- 8 Por ushtria e Kaldeasve ndoqi mbretin, e arriti Sedekian në fushën e Jerikos, ndërsa tërë ushtria e tij po shpërndahej larg tij.  
And the Chaldean army went after King Zedekiah and overtook him on the other side of Jericho, and all his army went in flight from him in every direction.  
καὶ κατεδίωξεν ἡ δύναμις τῶν χαλδαίων ὀπίσω τοῦ βασιλέως καὶ κατέλαβον αὐτὸν ἐν τῷ πέραν ἱερικῶ καὶ πάντες οἱ παῖδες αὐτοῦ διεσπάρησαν ἀπ' αὐτοῦ
- 9 Kështu ata zunë mbretin dhe e çuan në Riblah, në vendin e Hamathit te mbreti i Babilonisë, që shqiptoi vendimin kundër tij.  
Then they made the king a prisoner and took him up to the king of Babylon to Riblah in the land of Hamath to be judged.  
καὶ συνέλαβον τὸν βασιλέα καὶ ἤγαγον αὐτὸν πρὸς τὸν βασιλέα βαβυλωνῶνος εἰς δεβλαθα καὶ ἐλάλησεν αὐτῷ μετὰ κρίσεως
- 10 Mbreti i Babilonisë vrau pastaj bijtë e Sedekias para syve të tij dhe vrau gjithashtu tërë princat e Judës në Riblah;  
And the king of Babylon put the sons of Zedekiah to death before his eyes: and he put to death all the rulers of Judah in Riblah.  
καὶ ἐσφαξεν βασιλεὺς βαβυλωνῶνος τοὺς υἱοὺς σεδεκιου κατ' ὀφθαλμοὺς αὐτοῦ καὶ πάντας τοὺς ἄρχοντας ἰουδα ἐσφαξεν ἐν δεβλαθα
- 11 pastaj i nxori sytë Sedekias. Mbreti i Babilonisë e lidhi me pranga prej bronzi, e çoi në Babiloni dhe e futi në burg deri ditën e vdekjes së tij.  
And he put out Zedekiah's eyes; and the king of Babylon, chaining him in iron bands, took him to Babylon, and put him in prison till the day of his death.  
καὶ τοὺς ὀφθαλμοὺς σεδεκιου ἐξετόφλωσεν καὶ ἔδησεν αὐτὸν ἐν πέδαις καὶ ἤγαγεν αὐτὸν βασιλεὺς βαβυλωνῶνος εἰς βαβυλώνα καὶ ἔδοκεν αὐτὸν εἰς οἰκίαν μύλωνος ἕως ἡμέρας ἧς ἀπέθανεν
- 12 Muajin e pestë, më dhjetë të muajit (që ishte viti i nëntëmbëdhjetë i Nebukadnetsarit, mbretit të Babilonisë), Nebuzaradani, komandanti i rojeve personale në shërbim të mbretit të Babilonisë, arriti në Jeruzalem.  
Now in the fifth month, on the tenth day of the month, in the nineteenth year of King Nebuchadrezzar, king of Babylon, Nebuzaradan, the captain of the armed men, a servant of the king of Babylon, came into Jerusalem.  
καὶ ἐν μηνὶ πέμπτῳ δεκάτῃ τοῦ μηνὸς ἦλθεν ναβουζαρδαν ὁ ἀρχιμάγειρος ὁ ἐσθητικὸς κατὰ πρόσωπον τοῦ βασιλέως βαβυλωνῶνος εἰς ἱερουσαλημ
- 13 Ai dogji shtëpinë e Zotit dhe shtëpinë e mbretit dhe u vuri flakën tërë shtëpive të Jeruzalemit dhe tërë shtëpive të fisnikëve.  
And he had the house of the Lord and the king's house and all the houses of Jerusalem, even every great house, burned with fire:  
καὶ ἐνέπρησεν τὸν οἶκον κυρίου καὶ τὸν οἶκον τοῦ βασιλέως καὶ πάσας τὰς οἰκίας τῆς πόλεως καὶ πᾶσαν οἰκίαν μεγάλην ἐνέπρησεν ἐν πυρὶ
- 14 Tërë ushtria e Kaldeasve që ishte me komandantin e rojeve rrëzoi të gjitha muret rreth e qark Jeruzalemit.  
And the walls round Jerusalem were broken down by the Chaldean army which was with the captain.  
καὶ πᾶν τεῖχος ἱερουσαλημ κύκλῳ καθεῖλεν ἡ δύναμις τῶν χαλδαίων ἢ μετὰ τοῦ ἀρχιμαγείρου
- 16 Por Nebuzaradani, komandanti i rojeve, la disa nga më të varfrit e vendit të punojnë vreshtat dhe arat.  
But Nebuzaradan, the captain of the armed men, let the poorest of the land go on living there, to take care of the vines and the fields.  
καὶ τοὺς καταλοίπους τοῦ λαοῦ κατέλιπεν ὁ ἀρχιμάγειρος εἰς ἀμπελοουργοὺς καὶ εἰς γεωργοὺς
- 17 Kaldeasit i copëtuan shtyllat prej bronzi që ishin në shtëpinë e Zotit, qerret dhe detin prej bronzi që ishin në shtëpinë e Zotit dhe e çuan bronzin në Babiloni.  
And the brass pillars which were in the house of the Lord, and the wheeled bases and the great brass water-vessel in the house of the Lord, were broken up by the Chaldeans, who took all the brass away to Babylon.  
καὶ τοὺς στύλους τοὺς χαλκοῦς τοὺς ἐν οἴκῳ κυρίου καὶ τὰς βάσεις καὶ τὴν θάλασσαν τὴν χαλκὴν τὴν ἐν οἴκῳ κυρίου συνέτριψαν οἱ χaldaῖοι καὶ ἔλαβον τὸν χαλκὸν αὐτῶν καὶ ἀπήνεγκαν εἰς βαβυλώνα
- 18 Ata morën edhe tiganët, kunjat, thikat, legenët, kupat dhe të gjitha veglat prej bronzi, që përdorehin në shërbimin e tempullit.  
And the pots and the spades and the scissiors for the lights and the spoons, and all the brass vessels used in the Lord's house, they took away.  
καὶ τὴν στεφάνην καὶ τὰς φιάλας καὶ τὰς κρεάγρας καὶ πάντα τὰ σκευὴ τὰ χαλκᾶ ἐν οἷς ἐλειτούργουν ἐν αὐτοῖς
- 19 Komandanti i rojes mori gjithashtu kupat, mangallët, legenët, shandanet, tasat dhe kupat, arin e sendet që ishin prej ari të kulluar dhe argjendin e kulluar.  
And the cups and the fire-trays and the basins and the pots and the supports for the lights and the spoons and the wide basins; the gold of the gold vessels, and the silver of the silver vessels, the captain of the armed men took away.  
καὶ τὰ σαφφῶθ καὶ τὰ μασμαρῶθ καὶ τοὺς ὑποχυτήρας καὶ τὰς λυχνίας καὶ τὰς θυίσκας καὶ τοὺς κυάθους ἃ ἦν χρυσᾶ χρυσᾶ καὶ ἃ ἦν ἀργυρᾶ ἀργυρᾶ ἔλαβεν ὁ ἀρχιμάγειρος
- 20 Sa për dy kolonat, për detin dhe për të dymbëdhjetë qetë prej bronzi që ishin poshtë tij dhe për qerret që Salomoni kishte bërë për shtëpinë e Zotit, bronzi i tërë këtyre sendeve kishte një peshë që nuk mund të llogaritej.  
The two pillars, the great water-vessel, and the twelve brass oxen which were under it, and the ten wheeled bases, which King Solomon had made for the house of the Lord: the brass of all these vessels was without weight.  
καὶ οἱ στῦλοι δύο καὶ ἡ θάλασσα μία καὶ οἱ μόσχοι δώδεκα χαλκοῖ ὑποκάτω τῆς θαλάσσης ἃ ἐποίησεν ὁ βασιλεὺς σαλωμων εἰς οἶκον κυρίου οὐκ ἦν σταθμὸς τοῦ χαλκοῦ αὐτῶν

- 21** Për sa u përket shtyllave, lartësia e një shtylle ishte tetëmbëdhjetë kubitë; dhe duhej një fill prej dymbëdhjetë kubitësh për të matur rrethin e tyre; trashësia e saj ishte katër gishtërinj; nga brenda ishte bosh.  
**And as for the pillars, one pillar was eighteen cubits high, and twelve cubits measured all round, and it was as thick as a man's hand: it was hollow.**  
**καὶ οἱ στύλοι τριάκοντα πέντε πηχῶν ὕψους τοῦ στύλου τοῦ ἑνός καὶ σπαρτίον δώδεκα πήχεων περιεκύκλου αὐτόν καὶ τὸ πάχος αὐτοῦ δακτύλων τεσσάρων κύκλω**
- 22** Mbi të ngrihej një kapitel prej bronzi, lartësia e një kapiteli ishte pesë kubitë; rreth e qark kapitelit kishte një rrjetëz dhe disa shegë, të gjitha prej bronzi. Shtylla tjetër me shegë, ishte e njëjlojtë me të.  
**And there was a crown of brass on it: the crown was five cubits high, circled with a network and apples all of brass; and the second pillar had the same.**  
**καὶ γείσος ἐπ' αὐτοῖς χαλκοῦν καὶ πέντε πήχεων τὸ μήκος ὑπεροχῇ τοῦ γείσους τοῦ ἑνός καὶ δίκτυον καὶ ῥοαὶ ἐπὶ τοῦ γείσους κύκλω τὰ πάντα χαλκᾶ καὶ κατὰ ταῦτα τῷ στύλῳ τῷ δευτέρῳ ὀκτὼ ῥοαὶ τῷ πήχει τοῖς δώδεκα πήχεσιν**
- 23** Rreth e qark kishte nëntëdhjetë e gjashtë shegë dhe tërë shegët rrotull rrjetëzës arrinin në njëqind.  
**There were ninety-six apples on the outside; the number of apples all round the network was a hundred.**  
**καὶ ἦσαν αἱ ῥοαὶ ἐνενήκοντα ἕξ τὸ ἐν μέρος καὶ ἦσαν αἱ πᾶσαι ῥοαὶ ἐπὶ τοῦ δικτύου κύκλω ἑκατόν**
- 24** Komandanti i rojes mori Serajahun, kryepriftin, Sofonian, priftin e dytë, dhe tre rojtarë të portës.  
**And the captain of the armed men took Seraiah, the chief priest, and Zephaniah, the second priest, and the three door-keepers;**  
**καὶ ἔλαβεν ὁ ἀρχιμάγειρος τὸν ἱερέα τὸν πρῶτον καὶ τὸν ἱερέα τὸν δευτερεύοντα καὶ τοὺς τρεῖς τοὺς φυλάττοντας τὴν ὁδὸν**
- 25** Nga qyteti ai mori edhe një eunuk që komandonte luftëtarët, shtatë burra ndër këshilltarët personalë të mbretit që u gjetën në qytet, sekretarin e komandantit të ushtrisë që rekrutonte popullin e vendit dhe gjashtëdhjetë burra nga populli i vendit që u gjetën në qytet.  
**And from the town he took the unsexed servant who was over the men of war, and seven of the king's near friends who were in the town, and the scribe of the captain of the army, who was responsible for getting the people of the land together in military order, and sixty men of the people of the land who were in the town.**  
**καὶ εὐνοῦχον ἓνα ὃς ἦν ἐπιστάτης τῶν ἀνδρῶν τῶν πολεμιστῶν καὶ ἑπτὰ ἀνδρας ὀνομαστοὺς τοὺς ἐν προσώπῳ τοῦ βασιλέως τοὺς εὐρεθέντας ἐν τῇ πόλει καὶ τὸν γραμματέα τῶν δυνάμεων τὸν γραμμ ατεύοντα τῷ λαῷ τῆς γῆς καὶ ἑξήκοντα ἀνθρώπους ἐκ τοῦ λαοῦ τῆς γῆς τοὺς εὐρεθέντας ἐν μέσῳ τῆς πόλεως**
- 26** Kështu Nebuzaradani, komandanti i rojeve, i mori dhe i çoi te mbreti i Babilonisë në Riblah,  
**These Nebuzaradan, the captain of the armed men, took with him to the king of Babylon at Riblah.**  
**καὶ ἔλαβεν αὐτοὺς ναβουζαρδαν ὁ ἀρχιμάγειρος καὶ ἦγαγεν αὐτοὺς πρὸς βασιλέα βαβυλωνός εἰς δεβλαθα**
- 27** dhe mbreti i Babilonisë i vrau në Riblah, në vendin e Hamathit.  
**And the king of Babylon put them to death at Riblah in the land of Hamath. So Judah was taken prisoner away from his land.**  
**καὶ ἐπάταξεν αὐτοὺς βασιλεὺς βαβυλωνός ἐν δεβλαθα ἐν γῇ αμαθ**
- 31** Në vitin e tridhjetë e shtatë të robërisë së Jehojakimit, mbretit të Judës, në muajin e dymbëdhjetë, më pesë të muajit, Evil-Merodaku, mbret i Babilonisë, vitin e parë të mbretërisë së tij e fali  
**And in the thirty-seventh year after Jehoiachin, king of Judah, had been taken prisoner, in the twelfth month, on the twenty-fifth day of the month, Evil-merodach, king of Babylon, in the first year after he became king, took Jehoiachin, king of Judah, out of prison.**  
**καὶ ἐγένετο ἐν τῷ τριακοστῷ καὶ ἑβδόμῳ ἔτει ἀποικισθέντος τοῦ ἰωακὶμ βασιλέως ἰουδα ἐν τῷ δωδεκάτῳ μηνὶ ἐν τῇ τετραδί καὶ εἰκάδι τοῦ μηνός ἔλαβεν οὐλαιμαραδαχ βασιλεὺς βαβυλωνός ἐν τῷ ἐν ἰαυτῷ ᾧ ἐβασίλευσεν τὴν κεφαλὴν ἰωακὶμ βασιλέως ἰουδα καὶ ἐξήγαγεν αὐτὸν ἐξ οἰκίας ἧς ἐφυλάττετο**
- 32** I foli me dashamirësi dhe vendosi ndenjësen e tij mbi atë të mbretërve që ishin me të në Babiloni.  
**And he said kind words to him and put his seat higher than the seats of the other kings who were with him in Babylon.**  
**καὶ ἐλάλησεν αὐτῷ χρηστὰ καὶ ἔδωκεν τὸν θρόνον αὐτοῦ ἐπάνω τῶν θρόνων τῶν βασιλέων τῶν μετ' αὐτοῦ ἐν βαβυλωνί**
- 33** Kështu Jehojakimi i ndërroi rrobat e robërisë së tij dhe hëngri gjithnjë bukën në prani të mbretit tërë ditë e jetës së tij.  
**And his prison clothing was changed, and he was a guest at the king's table every day for the rest of his life.**  
**καὶ ἤλλαξεν τὴν στολὴν τῆς φυλακῆς αὐτοῦ καὶ ἦσθιεν ἄρτον διὰ παντός κατὰ πρόσωπον αὐτοῦ πάσας τὰς ἡμέρας ἕως ἔζησεν**
- 34** Për ushqimin e tij i jepej rregullisht një racion ushqimi nga ana e mbretit të Babilonisë, një racion çdo ditë, deri ditën e vdekjes së tij, tërë ditë e jetës së tij.  
**And for his food, the king gave him a regular amount every day till the day of his death, for the rest of his life.**  
**καὶ ἡ σύνταξις αὐτῷ ἐδίδοτο διὰ παντός παρὰ τοῦ βασιλέως βαβυλωνός ἕξ ἡμέρας εἰς ἡμέραν ἕως ἡμέρας ἧς ἀπέθανεν .**
- 1** Si qëndron vallë i vetmuar qyteti që ishte plot e përplot me popull? E madhja midis kombeve është bërë si një e ve; princesha midis provincave i është nënshtruar haraçit.  
**See her seated by herself, the town which was full of people! She who was great among the nations has become like a widow! She who was a princess among the countries has come under the yoke of forced work!**  
**πῶς ἐκάθισεν μόνῃ ἡ πόλις ἡ πεπληθυμένη λαῶν ἐγενήθη ὡς χήρα πεπληθυμένη ἐν ἔθνεσιν ἄρχουσα ἐν χώραις ἐγενήθη εἰς φόρον**

- 2 Ajo qan me hidhërim natën, lotët vijëzojnë faqet e saj; midis gjithë atyre që e donin nuk ka njeri që ta ngushëllojë; tërë miqtë e saj e kanë tradhëtuar, janë bërë armiq të saj.  
She is sorrowing bitterly in the night, and her face is wet with weeping; among all her lovers she has no comforter: all her friends have been false to her, they have become her haters.  
κλαίουσα έκλαυσεν ἐν νυκτί καὶ τὰ δάκρυα αὐτῆς ἐπὶ τῶν σιαγόνων αὐτῆς καὶ οὐχ ὑπάρχει ὁ παρακαλῶν αὐτὴν ἀπὸ πάντων τῶν ἀγαπῶντων αὐτὴν πάντες οἱ φιλοῦντες αὐτὴν ἠθέτησαν ἐν αὐτῇ ἐγένετο αὐτῇ εἰς ἐχθρούς
- 3 Juda ka shkuar në robëri, mbi të rëndojnë pikëllimi dhe një skllavëri e rëndë; ai banon midis kombeve, nuk gjen prehje; tërë përndjekësit e tij e kanë arritur midis fatkeqësive.  
Judah has been taken away as a prisoner because of trouble and hard work; her living-place is among the nations, there is no rest for her: all her attackers have overtaken her in a narrow place.  
μετωκίσθη ἡ ἰουδαία ἀπὸ ταπεινώσεως αὐτῆς καὶ ἀπὸ πλήθους δουλείας αὐτῆς ἐκάθισεν ἐν ἔθνεσιν οὐχ εὔρεν ἀνάπαυσιν πάντες οἱ καταδιώκοντες αὐτὴν κατέλαβον αὐτὴν ἀνὰ μέσον τῶν θλιβόντων
- 4 Rrugët e Sionit mbajnë zi, sepse askush nuk vjen më në festat solemne; tërë portat e tij janë të shkreta, priftërinjtë e tij psherëtinjë, virgjëreshat e tij hidhërohen dhe ai është në trishtim.  
The ways of Zion are sad, because no one comes to the holy meeting; all her doorways are made waste, her priests are breathing out sorrow: her virgins are troubled, and it is bitter for her.  
ὁδοὶ σιων πενθοῦσιν παρὰ τὸ μὴ εἶναι ἐρχομένους ἐν ἑορτῇ πᾶσαι αἱ πύλαι αὐτῆς ἠφανισμένα οἱ ἱερεῖς αὐτῆς ἀναστενάζουσιν αἱ παρθέναι αὐτῆς ἀγόμεναι καὶ αὐτὴ πικραινομένη ἐν ἑαυτῇ
- 5 Kundërshtarët e tij janë bërë sundimtarë, armiqtë e tij begatohen, sepse Zoti e ka mjeruar për shkak të morisë së shkeljeve të tij; fëmijët e tij kanë shkuar në robëri përpara armikut.  
Those who are against her have become the head, everything goes well for her haters; for the Lord has sent sorrow on her because of the great number of her sins: her young children have gone away as prisoners before the attacker.  
ἐγένοντο οἱ θλιβόντες αὐτὴν εἰς κεφαλὴν καὶ οἱ ἐχθροὶ αὐτῆς εὐθνοῦσαν ὅτι κύριος ἐταπείνωσεν αὐτὴν ἐπὶ τὸ πλῆθος τῶν ἀσεβειῶν αὐτῆς τὰ νήπια αὐτῆς ἐπορεύθησαν ἐν αἰχμαλωσίᾳ κατὰ πρόσωπον οὐ θλιβόντος
- 6 Vajza e Sionit ka humbur tërë madhësinë e saj; krerët e tij janë bërë si drerë që nuk gjejnë kullotë; ecin pa forca përpara atyre që i ndjekin.  
And all her glory has gone from the daughter of Zion: her rulers have become like harts with no place for food, and they have gone in flight without strength before the attacker.  
καὶ ἐξῆλθεν ἐκ θυγατρὸς σιων πᾶσα ἡ εὐπρέπεια αὐτῆς ἐγένοντο οἱ ἄρχοντες αὐτῆς ὡς κριοὶ οὐχ εὐρίσκοντες νομὴν καὶ ἐπορεύοντο ἐν οὐκ ἰσχύϊ κατὰ πρόσωπον διώκοντος
- 7 Në ditët e trishtimit të tij dhe të endjes Jeruzalemi kujton tërë të mirat e çmuara që zotëronte qysh nga ditët e lashta. Kur populli i tij binte në dorë të armikut dhe askush nuk i vinte në ndihmë, kundërshtarët e tij e shikonin dhe qeshnin me shkatërrimin e tij.  
Jerusalem keeps in mind, in the days of her sorrow and of her wanderings, all the desired things which were hers in days gone by; when her people came into the power of her hater and she had no helper, her attackers saw their desire effected on her and made sport of her destruction.  
ἐμνήσθη ἱερουσαλημ ἡμερῶν ταπεινώσεως αὐτῆς καὶ ἀπωσμών αὐτῆς πάντα τὰ ἐπιθυμήματα αὐτῆς ὅσα ἦν ἐξ ἡμερῶν ἀρχαίων ἐν τῷ πεσεῖν τὸν λαὸν αὐτῆς εἰς χεῖρας θλιβόντος καὶ οὐκ ἦν ὁ βοηθῶν αὐτῇ ἰδόντες οἱ ἐχθροὶ αὐτῆς ἐγάλασαν ἐπὶ μετωκείᾳ αὐτῆς
- 8 Jeruzalemi ka mëkatur rëndë, prandaj është bërë një gjë e fëlliqur; tërë ata që e nderonin e përcmojnë, sepse e kanë parë lakuriq, po, ai psherëtin dhe kthetet prapa.  
Great is the sin of Jerusalem; for this cause she has become an unclean thing: all those who gave her honour are looking down on her, because they have seen her shame: now truly, breathing out grief, she is turned back.  
ἀμαρτίαν ἤμαρταν ἱερουσαλημ διὰ τοῦτο εἰς σάλον ἐγένετο πάντες οἱ δοξάζοντες αὐτὴν ἐταπείνωσαν αὐτὴν εἶδον γὰρ τὴν ἀσχημοσύνην αὐτῆς καὶ γε αὐτὴ στενάζουσα καὶ ἀπεστράφη ὀπίσω
- 9 Fëlliqësia e tij ishte në cepat e rrobave të tij, nuk mendonte për fundin e tij; prandaj ra në mënyrë të habitshme, pa pasur njeri që ta ngushëllojë: "Shiko, o Zot, dëshpërimin tim sepse armiku po ngrihet".  
In her skirts were her unclean ways; she gave no thought to her end; and her fall has been a wonder; she has no comforter: see her sorrow, O Lord; for the attacker is lifted up.  
ἀκαθαρσία αὐτῆς πρὸς ποδῶν αὐτῆς οὐκ ἐμνήσθη ἔσχατα αὐτῆς καὶ κατεβίβασεν ὑπέρογκα οὐκ ἔστιν ὁ παρακαλῶν αὐτὴν ἰδέ κύριε τὴν ταπεινώσιν μου ὅτι ἐμεγαλύνθη ἐχθρός
- 10 Kundërshtari ka shtrirë dorën mbi të gjitha thesaret e tua, sepse pa kombet të hyjnë në shenjtororen tënde; pikërisht ata që ti u kishe urdhëruar të mos hynin në kuvendin tënd.  
The hand of her hater is stretched out over all her desired things; for she has seen that the nations have come into her holy place, about whom you gave orders that they were not to come into the meeting of your people.  
χεῖρα αὐτοῦ ἐξεπέτασεν θλιβὼν ἐπὶ πάντα τὰ ἐπιθυμήματα αὐτῆς εἶδεν γὰρ ἔθνη εἰσελθόντα εἰς τὸ ἅγιασμα αὐτῆς ἃ ἐνετείλω μὴ εἰσελθεῖν αὐτὰ εἰς ἐκκλησίαν σου
- 11 Tërë populli i tij psherëtin duke kërkuar bukë; japin gjërat e tyre më të çmuara për ushqim me qëllim që të rifitojnë jetën. "Shiko, o Zot, dhe kqyr sa jam bërë i neveritshëm!". pranimi i mëkateve të tij dhe pasojat e tyre  
Breathing out grief all her people are looking for bread; they have given their desired things for food to give them life: see, O Lord, and take note; for she has become a thing of shame.  
πᾶς ὁ λαὸς αὐτῆς καταστενάζοντες ζητοῦντες ἄρτον ἔδωκαν τὰ ἐπιθυμήματα αὐτῆς ἐν βρώσει τοῦ ἐπιστρέψαι ψυχὴν ἰδέ κύριε καὶ ἐπίβλεψον ὅτι ἐγενήθη ἠτιμωμένη
- 12 "Asgjë e tillë mos t'ju ndodhë, o ju që kaloni afër. Soditni dhe shikoni, në se ka një dhimbje të ngjashme me dhembjen time, ajo që më brengos dhe që Zoti më ka dhënë ditën e zemërimit të tij të zjarrtë.  
Come to me, all you who go by! Keep your eyes on me, and see if there is any pain like the pain of my wound, which the Lord has sent on me in the day of his burning wrath.  
οὐ πρὸς ὑμᾶς πάντες οἱ παραπορευόμενοι ὁδὸν ἐπιστρέψατε καὶ ἴδετε εἰ ἔστιν ἄλγος κατὰ τὸ ἄλγος μου ὃ ἐγενήθη φθελγζάμενος ἐν ἐμοὶ ἐταπείνωσέν με κύριος ἐν ἡμέρᾳ ὀργῆς θυμοῦ αὐτοῦ

- 13 Nga lart ka dërguar një zjarr në kockat e mia, i kaplon ato; ka shtrirë një rrjetë në këmbët e mia, më ka kthyer prapa, më ka shkretuar në kapitjen e ditëve të mia.  
From on high he has sent fire into my bones, and it has overcome them: his net is stretched out for my feet, I am turned back by him; he has made me waste and feeble all the day.  
ἐξ ὕψους αὐτοῦ ἀπέστειλεν πῦρ ἐν τοῖς ὀστέοις μου κατήγαγεν αὐτό διεπέτασεν δίκτυον τοῖς ποσίν μου ἀπέστρεψέν με εἰς τὰ ὀπίσω ἔδωκέν με ἠφανισμένην ὅλην τὴν ἡμέραν ὀδυρομένην
- 14 Nga dora e tij është lidhur zgjedha e shkeljeve të mia, që lidhen bashkë dhe rëndojnë mbi qafën time; më ka pakësuar forcën time; Zoti më ka lënë në duart e atyre të cilëve nuk mund t'u bëj ballë.  
A watch is kept on my sins; they are joined together by his hand, they have come on to my neck; he has made my strength give way: the Lord has given me up into the hands of those against whom I have no power.  
ἐγγρηγορήθη ἐπὶ τὰ ἀσεβήματά μου ἐν χερσίν μου συνεπλάκησαν ἀνέβησαν ἐπὶ τὸν τράχηλόν μου ἠσθένησεν ἡ ἰσχύς μου ὅτι ἔδωκεν κύριος ἐν χερσίν μου ὀδύνας οὐ δυνήσομαι στήναι
- 15 Zoti ka rrëzuar në mesin tim tërë trimat e mi; ka thirrur kundër meje një kuvend për të shtypur të rinjtë e mi; Zoti ka shtypur si në një butinë bijën e virgjër të Judës.  
The Lord has made sport of all my men of war in me, he has got men together against me to send destruction on my young men: the virgin daughter of Judah has been crushed like grapes under the feet of the Lord.  
ἐξήρην πάντας τοὺς ἰσχυροὺς μου ὁ κύριος ἐκ μέσου μου ἐκάλεισεν ἐπ' ἐμὲ καιρὸν τοῦ συντρίψαι ἐκλεκτούς μου ληνὸν ἐπάτησεν κύριος παρθένω θυγατρὶ ἰουδα ἐπὶ τούτοις ἐγὼ κλαίω
- 16 Prandaj unë qaj; sytë e mi, vetë sytë e mi shkrihen ndër lot, sepse ngushëlluesi që do të mund të më jepte përsëri jetën është larg meje. Bijtë e mi janë të dëshpëruar, sepse armiku doli fitimtar<quot>.  
For these things I am weeping; my eye is streaming with water; because the comforter who might give me new life is far from me: my children are made waste, because the hater is strong.  
ὁ ὀφθαλμὸς μου κατήγαγεν ὕδωρ ὅτι ἐμακρύνθη ἀπ' ἐμοῦ ὁ παρακαλῶν με ὁ ἐπιστρέφων ψυχὴν μου ἐγένοντο οἱ υἱοί μου ἠφανισμένοι ὅτι ἐκραταιώθη ὁ ἐχθρὸς
- 17 Sioni zgjat duart e tij, por nuk ka njeri që ta ngushëllojë. Përsa i përket Jakobit, Zoti ka urdhëruar që ata që janë rreth tij të bëhen armiq të tij. Jeruzalemi është bërë në mes tyre si një gjë e papastër.  
Zion's hands are outstretched; she has no comforter; the Lord has given orders to the attackers of Jacob round about him: Jerusalem has become like an unclean thing among them.  
διεπέτασεν σιων χεῖρας αὐτῆς οὐκ ἔστιν ὁ παρακαλῶν αὐτήν ἐνετείλατο κύριος τῷ ἰακωβ κύκλω αὐτοῦ οἱ θλιβόντες αὐτόν ἐγενήθη ἱερουσαλημ εἰς ἀποκαθημένην ἀνὰ μέσον αὐτῶν
- 18 Zoti është i drejtë, sepse jam rebeluar kundër fjalës së tij. Dëgjoni, pra, o popuj mbarë, dhe shikoni dhimbjen time! Virgjëreshat e mia dhe të rinjtë e mi kanë shkuar në robëri.  
The Lord is upright; for I have gone against his orders: give ear, now, all you peoples, and see my pain, my virgins and my young men have gone away as prisoners.  
δίκαιος ἔστιν κύριος ὅτι τὸ στόμα αὐτοῦ παρεπίκρανα ἀκούσατε δὴ πάντες οἱ λαοὶ καὶ ἴδετε τὸ ἄλγος μου παρθένοι μου καὶ νεανίσκοι μου ἐπορεύθησαν ἐν αἰχμαλωσίᾳ
- 19 Thirra dashnorët e mi, por ata më kanë mashtruar; priftërinjtë e mi dhe pleqtë e mi nxorën frymën e fundit në qytet, ndërsa kërkonin ushqim për të shpëtuar jetën e tyre.  
I sent for my lovers, but they were false to me: my priests and my responsible men were breathing their last breath in the town, while they were looking for food to give them new life.  
ἐκάλεισα τοὺς ἐραστάς μου αὐτοὶ δὲ παρελογίσαντό με οἱ ἱερεῖς μου καὶ οἱ πρεσβύτεροί μου ἐν τῇ πόλει ἐξέλιπον ὅτι ἐζήτησαν βρώσιν αὐτοῖς ἵνα ἐπιστρέψωσιν ψυχὰς αὐτῶν καὶ οὐχ εὔρον
- 20 Shiko, o Zot, unë jam në ankth. Zorrët e mia dridhen, zemra ime është e tronditur brenda meje, sepse kam qënë rebele e madhe. Jashtë shpata më la pa bij, në shtëpi është si të jetë vdekje.  
See, O Lord, for I am in trouble; the inmost parts of my body are deeply moved; my heart is turned in me; for I have been uncontrolled: outside the children are put to the sword, and in the house there is death.  
ιδέ κύριε ὅτι θλίβομαι ἡ κοιλία μου ἐταράχθη καὶ ἡ καρδία μου ἐστράφη ἐν ἐμοὶ ὅτι παραπικραίνουσα παρεπίκρανα ἐξωθεν ἠτέκνωσέν με μάχαιρα ὥσπερ θάνατος ἐν οἴκῳ
- 21 Më dëgjojnë që psherëtim, askush nuk më ngushëllon. Tërë armiqtë e mi e kanë mësuar fatkeqësinë time dhe janë të kënaqur që ti ke bërë këtë gjë. Ti do të sjellësh ditën që ke lajmëruar, dhe atëherë do të jenë si unë.  
Give ear to the voice of my grief; I have no comforter; all my haters have news of my troubles, they are glad because you have done it: let the day of fate come when they will be like me.  
ἀκούσατε δὴ ὅτι στενάζω ἐγὼ οὐκ ἔστιν ὁ παρακαλῶν με πάντες οἱ ἐχθροί μου ἤκουσαν τὰ κακά μου καὶ ἐχάρησαν ὅτι σὺ ἐποίησας ἐπήγαγες ἡμέραν ἐκάλεισας καιρὸν καὶ ἐγένοντο ὅμοιοι ἐμοὶ
- 22 Le të vijë para teje tërë ligësia e tyre, dhe trajtoi ashtu si më ke trajtuar mua për shkak të të gjitha shkeljeve të mia. Sepse të shumta janë psherëtimat e mia dhe zemra ime lëngon.  
Let all their evil-doing come before you; do to them as you have done to me for all my sins: for loud is the sound of my grief, and the strength of my heart is gone.  
εἰσελθοὶ πᾶσα ἡ κακία αὐτῶν κατὰ πρόσωπόν σου καὶ ἐπιφύλλισον αὐτοῖς ὃν τρόπον ἐποίησαν ἐπιφυλλίδα περὶ πάντων τῶν ἁμαρτημάτων μου ὅτι πολλοὶ οἱ στεναγμοί μου καὶ ἡ καρδία μου λυπεῖται
- 1 Si bëhet që në zemërimin e tij Zoti ka mbuluar me një re bijën e Sionit? Ai ka hedhur nga qielli në tokë lavdinë e Izraelit dhe nuk u kujtua për ndenjjesen e këmbëve të tij ditën e zemërimit të tij.  
How has the daughter of Zion been covered with a cloud by the Lord in his wrath! he has sent down from heaven to earth the glory of Israel, and has not kept in memory the resting-place of his feet in the day of his wrath.  
πῶς ἐγνόφωσεν ἐν ὀργῇ αὐτοῦ κύριος τὴν θυγατέρα σιων κατέρριψεν ἐξ οὐρανοῦ εἰς γῆν δόξασμα ἰσραηλ καὶ οὐκ ἐμνήσθη ὑποποδίου ποδῶν αὐτοῦ ἐν ἡμέρᾳ ὀργῆς αὐτοῦ
- 2 Zoti i ka shkatërruar pa mëshirë të gjitha banesat e Jakobit; në zemërimin e tij ka shembur fortesat e bijës së Judës, i ka hedhur për tokë duke përdhosur mbretërinë dhe krerët e saj.  
The Lord has given up to destruction all the living-places of Jacob without pity; pulling down in his wrath the strong places of the daughter of Judah, stretching out on the earth the wounded, even her king and her rulers.  
κατεπόντισεν κύριος οὐ φεισάμενος πάντα τὰ ὠραῖα ἰακωβ καθεῖλεν ἐν θυμῷ αὐτοῦ τὰ ὀχυρώματα τῆς θυγατρὸς ἰουδα ἐκόλλησεν εἰς τὴν γῆν ἐβεβήλωσεν βασιλεία αὐτῆς καὶ ἄρχοντας αὐτῆς

- 3 Me një zemërim të zjarrtë ka thyer tërë fuqinë e Izraelit, ka tërhequr të djathtën e tij përpara armikut, ka djegur në mes të Jakobit si një zjarr flakërues që gllabëron gjithçka rreth e qark.  
In his burning wrath every horn of Israel has been cut off; his right hand has been turned back before the attacker: he has put a fire in Jacob, causing destruction round about.  
συνέκλασεν ἐν ὄργῃ θυμοῦ αὐτοῦ πᾶν κέρασ ἰσραηλ ἀπέστρεψεν ὀπίσω δεξιὰν αὐτοῦ ἀπὸ προσώπου ἐχθροῦ καὶ ἀνήψεν ἐν ἰακωβ ὡς πῦρ φλόγα καὶ κατέφαγεν πάντα τὰ κύκλω
- 4 Ka nderur harkun e tij si një armik, ka ngritur dorën e djathtë si një kundërshtar, ka shkatërruar të gjitha ato që ishin të këndshme për sytë në çadrën e bijës së Sionit, e ka derdhur zemërimin e tij si një zjarr.  
His bow has been bent for the attack, he has taken his place with his hand ready, in his hate he has put to death all who were pleasing to the eye: on the tent of the daughter of Zion he has let loose his passion like fire.  
ἐνέτεινεν τόξον αὐτοῦ ὡς ἐχθρός ἐστερέωσεν δεξιὰν αὐτοῦ ὡς ὑπεναντίος καὶ ἀπέκτεινεν πάντα τὰ ἐπιθυμήματα ὀφθαλμῶν μου ἐν σκηνῇ θυγατρὸς σιων ἐξέχεεν ὡς πῦρ τὸν θυμὸν αὐτοῦ
- 5 Zoti u bë si një armik; përpiu Izraelin, përpiu tërë pallatet e tij, shkatërroi fortesat e tij, shumëfishoi të qarat dhe vajtimet tek e bija e Judës.  
The Lord has become like one fighting against her, sending destruction on Israel; he has sent destruction on all her great houses, making waste his strong places: increasing the grief and the sorrow of the daughter of Judah.  
ἐγενήθη κύριος ὡς ἐχθρός κατεπόντισεν ἰσραηλ κατεπόντισεν πάσας τὰς βάρεις αὐτῆς διέφθειρεν τὰ ὄχυράματα αὐτοῦ καὶ ἐπλήθυνεν τῇ θυγατρὶ ἰουδα ταπεινουμένην καὶ τεταπεινωμένην
- 6 Shkatërroi tabernakullin e tij si një kopësht, prishi vendin ku mblihdet kuvendi; Zoti bëri të harrohen në Sion festat solemne dhe të shtunat dhe gjatë tërbimit e të zemërimit të tij hodhi poshtë mbretërit dhe priftërinj.  
And he has violently taken away his tent, as from a garden; he has made waste his meeting-place: the Lord has taken away the memory of feast and Sabbath in Zion, and in the passion of his wrath he is against king and priest.  
καὶ διεπέτασεν ὡς ἄμπελον τὸ σκῆνωμα αὐτοῦ διέφθειρεν ἑορτὴν αὐτοῦ ἐπελάθετο κύριος ὃ ἐποίησεν ἐν σιων ἑορτῆς καὶ σαββάτου καὶ παρώξυνεν ἐμβρυμῆματι ὄργῆς αὐτοῦ βασιλέα καὶ ἱερέα καὶ ἄρχοντα
- 7 Zoti braktisi altarin e tij, hodhi poshtë shenjtorren e tij, dorëzoi në dorë të armikut muret e fortesave të tij; ata lartuan britma në shtëpinë e Zotit si në një ditë feste solemne.  
The Lord has given up his altar and has been turned in hate from his holy place; he has given up into the hands of the attacker the walls of her great houses: their voices have been loud in the house of the Lord as in the day of a holy meeting.  
ἀπόσπαστο κύριος θυσιαστήριον αὐτοῦ ἀπετίναξεν ἀγίασμα αὐτοῦ συνέτριψεν ἐν χειρὶ ἐχθροῦ τεῖχος βάρειων αὐτῆς φωνὴν ἔδωκαν ἐν οἴκῳ κυρίου ὡς ἐν ἡμέρᾳ ἑορτῆς
- 8 Zoti vendosi të shkatërrojë muret e bijës së Sionit; vuri litarin, nuk ka hequr dorë nga shkatërrimi; ka bërë të vajtojë fortesa dhe mure; që të dyja lëngojnë.  
It is the Lord's purpose to make waste the wall of the daughter of Zion; his line has been stretched out, he has not kept back his hand from destruction: he has sent sorrow on tower and wall, they have become feeble together.  
καὶ ἐπέστρεψεν κύριος τοῦ διαφθεῖραι τεῖχος θυγατρὸς σιων ἐξέτεινεν μέτρον οὐκ ἀπέστρεψεν χεῖρα αὐτοῦ ἀπὸ καταπατήματος καὶ ἐπένθησεν τὸ προτείχισμα καὶ τεῖχος ὁμοθυμαδὸν ἠσθένησεν
- 9 Portat e tij janë fundosur në dhe; ai ka prishur dhe ka copëtuar shufrat e tyre; mbreti i tij dhe krerët e tij ndodhen midis kombeve; nuk ka më ligj, dhe profetët e tij nuk marrin asnjë vegim nga Zoti.  
Her doors have gone down into the earth; he has sent destruction on her locks: her king and her princes are among the nations where the law is not; even her prophets have had no vision from the Lord.  
ἐνεπάγησαν εἰς γῆν πύλαι αὐτῆς ἀπόλεσαν καὶ συνέτριψεν μογλοὺς αὐτῆς βασιλέα αὐτῆς καὶ ἄρχοντας αὐτῆς ἐν τοῖς ἔθνεσιν οὐκ ἔστιν νόμος καὶ γε προφηταὶ αὐτῆς οὐκ εἶδον ὄρασιν παρὰ κυρίου
- 10 Pleqtë e bijës së Sionit ulen për tokë në heshtje; kanë hedhur pluhur mbi kokën e tyre, kanë ngjeshur trupin me thes; virgjëreshat e Jeruzalemit ulin deri në tokë kokën e tyre.  
The responsible men of the daughter of Zion are seated on the earth without a word; they have put dust on their heads, they are clothed in haircloth: the heads of the virgins of Jerusalem are bent down to the earth.  
ἐκάθισαν εἰς τὴν γῆν ἐσιώπησαν πρεσβύτεροι θυγατρὸς σιων ἀνεβίβασαν χοῦν ἐπὶ τὴν κεφαλὴν αὐτῶν περιέζωσαντο σάκκους κατήγαγον εἰς γῆν ἀρχηγοὺς παρθένους ἐν ἱερουσαλημ
- 11 Sytë e mi konsumohen nga të qarat, zorrët e mia drithërohen, mëlcia ime përhapet për tokë për shkak të shkatërrimit të bijës së popullit tim, për ligështimin e fëmijëve dhe të foshnjave në gjii në sheshet e qytetit.  
My eyes are wasted with weeping, the inmost parts of my body are deeply moved, my inner parts are drained out on the earth, for the destruction of the daughter of my people; because of the young children and babies at the breast who are falling without strength in the open squares of the town.  
ἐξέλιπον ἐν δάκρυσιν οἱ ὀφθαλμοὶ μου ἐταράχθη ἡ καρδία μου ἐξεχύθη εἰς γῆν ἡ δόξα μου ἐπὶ τὸ σύντριμμα τῆς θυγατρὸς τοῦ λαοῦ μου ἐν τῷ ἐκλιπεῖν νήπιον καὶ θηλάζοντα ἐν πλατείαις πόλεως
- 12 Ata u kërkonin nënave të tyre: "Ku është gruri dhe vera?", ndërsa po ligështoheshin si të plagosur për vdekje në sheshet e qytetit dhe jepnin shpirt në prehrin e nënave të tyre.  
They say to their mothers, Where is grain and wine? when they are falling like the wounded in the open squares of the town, when their life is drained out on their mother's breast.  
ταῖς μητέραςιν αὐτῶν εἶπαν ποῦ σῖτος καὶ οἶνος ἐν τῷ ἐκλύεσθαι αὐτοὺς ὡς τραυματίας ἐν πλατείαις πόλεως ἐν τῷ ἐκχεῖσθαι ψυχὰς αὐτῶν εἰς κόλπον μητέρων αὐτῶν

- 13 Si mund të të jap zemër? Në çfarë do të të ngjas, o bijë e Jeruzalemit? Çfarë gjë do të krahasoj me ty që të të ngushëlloj, o bijë e virgjër e Jeruzalemit? Sepse shkatërrimi yt është i madh si deti; kush mund të të shërojë?  
 What example am I to give you? what comparison am I to make for you, O daughter of Jerusalem? what am I to make equal to you, so that I may give you comfort, O virgin daughter of Zion? for your destruction is great like the sea: who is able to make you well?  
 τί μαρτυρήσω σοι ἢ τί ὁμοιώσω σοι θύγατερ ιερουσαλημ τίς σώσει σε καὶ παρακαλέσει σε παρθένος θύγατερ σιων ὅτι ἐμεγαλύνθη ποτήριον συντριβῆς σου τίς ἰάσεται σε
- 14 Profetët e tu kanë pasur për ty vegime të rreme dhe të paarsyeshme; nuk kanë zbuluar lakuriq paudhësinë tënde që të largojnë robërinë prej teje; ata kanë shqiptuar për ty profeci të rreme dhe mashtruese.  
 The visions which your prophets have seen for you are false and foolish; they have not made clear to you your sin so that your fate might be changed: but they have seen for you false words, driving you away.  
 προφήται σου εἶδοσάν σοι μάταια καὶ ἀφοροσύνην καὶ οὐκ ἀπεκάλυψαν ἐπὶ τὴν ἀδικίαν σου τοῦ ἐπιστρέψαι αἰχμαλωσίαν σου καὶ εἶδοσάν σοι λήμματα μάταια καὶ ἐξώσματα
- 15 Tërë kalimtarët i rrahin duart kundër teje; fërshëllejnë dhe tundin kokën kundër bijës së Jeruzalemit: &quot;Ky qënka qyteti që e quanin &quot;bukuri e përsosur&quot;, &quot;gëzimi i tërë tokës&quot;?&quot;.  
 All who go by make a noise with their hands at you; they make hisses, shaking their heads at the daughter of Jerusalem, and saying, Is this the town which was the crown of everything beautiful, the joy of all the earth?  
 ἐκρότησαν ἐπὶ σὲ χεῖρας πάντες οἱ παραπορευόμενοι ὁδὸν ἐσύρισαν καὶ ἐκίνησαν τὴν κεφαλὴν αὐτῶν ἐπὶ τὴν θυγατέρα ιερουσαλημ ἢ αὕτη ἡ πόλις ἦν ἐροῦσιν στέφανος δόξης εὐφοροσύνη πάσης τῆς γῆς
- 16 Tërë armiqtë e tu hapin gojën kundër teje; fërshëllejnë dhe kërcëlljnë dhëmbët, dhe thonë: &quot;E kemi gëlltitur! Po, kjo është dita që prisnim; arritëm ta shohim&quot;.  
 All your haters are opening their mouths wide against you; making hisses and whistling through their teeth, they say, We have made a meal of her: certainly this is the day we have been looking for; it has come, we have seen it.  
 δὴνοιζαν ἐπὶ σὲ στόμα αὐτῶν πάντες οἱ ἐχθροὶ σου ἐσύρισαν καὶ ἔβρουζαν ὁδόντας εἶπαν κατεπίομεν αὐτὴν πλὴν αὕτη ἡ ἡμέρα ἦν προσεδοκῶμεν εὐρομεν αὐτὴν εἶδομεν
- 17 Zoti ka realizuar atë që kishte menduar; ka mbajtur fjalën që kishte dekretuar në ditët e lashta. Ka shkatërruar pa asnjë mëshirë, ka vepruar në mënyrë që armiku të gëzohet me ty, ka lavdëruar fuqinë e kundërshtarëve të tu.  
 The Lord has done that which was his purpose; he has put into force the orders which he gave in the days which are past; pulling down without pity, he has made your hater glad over you, lifting up the horn of those who were against you.  
 ἐποίησεν κύριος ἃ ἐνεθυμήθη συνετέλεσεν ῥήματα αὐτοῦ ἃ ἐνετείλατο ἐξ ἡμερῶν ἀρχαίων καθέλειν καὶ οὐκ ἐφείσατο καὶ ἠύφρανεν ἐπὶ σὲ ἐχθρόν ὕψωσεν κέρας θλιβόντός σε
- 18 Zemra e tyre i bërtet Zotit: &quot;O mure të bijës së Sionit, bëni që të derdhen lotët si një përrua ditën e natën. Mos i jepni qetësi vetes, mos paçin çlodhje bebet e syve tuaj.  
 Let your cry go up to the Lord: O wall of the daughter of Zion, let your weeping be flowing down like a stream day and night; give yourself no rest, let not your eyes keep back the drops of sorrow.  
 ἐβόησεν καρδία αὐτῶν πρὸς κύριον τείχη σιων καταγάγετε ὡς χειμάρρους δάκρυα ἡμέρας καὶ νυκτός μὴ δῶς ἔκνηψιν σεαυτῇ μὴ σιωπήσαιο θύγατερ ὁ ὀφθαλμὸς σου
- 19 Çohuni, bërtisni natën, në fillim të çdo vigjiljeje. Derdhni si ujë zemrën tuaj përpara fytyrës së Zotit. Ngrini duart në drejtim të tij për jetën e fëmijëve tuaj, që mpaken nga uria në hyrje të të gjitha rrugëve&quot;.  
 Up! give cries in the night, at the starting of the night-watches; let your heart be flowing out like water before the face of the Lord, lifting up your hands to him for the life of your young children who are falling down, feeble for need of food, at the top of every street.  
 ἀνάστα ἀγαλλίασαι ἐν νυκτὶ εἰς ἀρχὴς φυλακῆς σου ἔκχεον ὡς ὕδωρ καρδίαν σου ἀπέναντι προσώπου κυρίου ἄρον πρὸς αὐτὸν χεῖράς σου περὶ ψυχῆς νηπίων σου τῶν ἐκλυομένων λιμῶ ἐπ' ἀρχῆς πασῶν ἐξόδων
- 20 &quot;Shiko, o Zot, dhe shqyrto. Cilin ke trajtuar në këtë mënyrë? A duhet të hanin gratë frytin e barkut të tyre, fëmijët që përkëdhelnin? A duhet të vriteshin prifti dhe profeti në shenjtëroren e tij?  
 Look! O Lord, see to whom you have done this! Are the women to take as their food the fruit of their bodies, the children who are folded in their arms? are the priest and the prophet to be put to death in the holy place of the Lord?  
 ἰδέ κύριε καὶ ἐπιβλεψον τίνι ἐπεφύλλισας οὕτως εἰ φάγονται γυναῖκες καρπὸν κοιλίας αὐτῶν ἐπιφυλλίδα ἐποίησεν μάγειρος φονευθήσονται νήπια θηλάζοντα μαστούς ἀποκτενεῖς ἐν ἀγιάσματι κυρίου ἱερέα καὶ προφήτην
- 21 Të vegjëlit dhe pleqtë dergjen për tokë nëpër rrugë; virgjërshat e mia dhe të rinjtë e mi kanë rënë nga shpata; ti i ke vrarë ditën e zëmërimit tënd, i ke masakruar pa mëshirë.  
 The young men and the old are stretched on the earth in the streets; my virgins and my young men have been put to the sword: you have sent death on them in the day of your wrath, causing death without pity.  
 ἐκοιμήθησαν εἰς τὴν ἐξοδὸν παιδᾶριον καὶ πρεσβύτης παρθένοι μου καὶ νεανίσκοι μου ἐπορεύθησαν ἐν αἰχμαλωσίᾳ ἐν ῥομφαίᾳ καὶ ἐν λιμῶ ἀπέκτεινας ἐν ἡμέρᾳ ὀργῆς σου ἐμαγείρευσας οὐκ ἐφείσω



- 22 Ti ke mbledhur si për një ditë feste tmerret që më rrethojnë nga çdo anë. Në ditën e zemërimit të Zotit nuk pati as ikanak as të mbetur. Ata që kisha ushqyer me gji dhe që kisha rritur, i shfarosi armiku im&quot;;  
*As in the day of a holy meeting you have made fears come round me on every side, and no one got away or was kept safe in the day of the Lord's wrath: those who were folded in my arms, whom I took care of, have been sent to their destruction by my hater.*  
*ἐκάλεσεν ἡμέραν ἑορτῆς παρουκίας μου κυκλόθεν καὶ οὐκ ἐγένοντο ἐν ἡμέρᾳ ὀργῆς κυρίου ἀνασφωζόμενος καὶ καταλελειμμένος ὡς ἐπεκράτησα καὶ ἐπλήθυνα ἐχθρούς μου πάντας*
- 1 Unë jam njeriu që pa hidhërimin nën thuprën e tërbimit të tij.  
*I am the man who has seen trouble by the rod of his wrath.*  
*ἐγὼ ἀνὴρ ὁ βλέπων πτωχείαν ἐν ῥάβδῳ θυμοῦ αὐτοῦ ἐπ' ἐμέ*
- 2 Ai më ka udhëhequr dhe më ka bërë të eci nëpër terr dhe jo në dritë.  
*By him I have been made to go in the dark where there is no light.*  
*παρέλαβέν με καὶ ἀπήγαγεν εἰς σκότος καὶ οὐ φῶς*
- 3 Po, kundër meje ai ka kthyer disa herë dorën e tij tërë ditën.  
*Truly against me his hand has been turned again and again all the day.*  
*πλὴν ἐν ἐμοὶ ἐπέστρεψεν χεῖρα αὐτοῦ ὅλην τὴν ἡμέραν*
- 4 Ai ka konsumuar mishin tim dhe lëkurën time, ka coptuar kockat e mia.  
*My flesh and my skin have been used up by him and my bones broken.*  
*ἐπαλαίωσεν σάρκας μου καὶ δέρμα μου ὅστέα μου συνέτριψεν*
- 5 Ka ndërtuar fortësa kundër meje, më ka rrethuar me hidhërim dhe me ankth.  
*He has put up a wall against me, shutting me in with bitter sorrow.*  
*ἀνφοκοδόμησεν κατ' ἐμοῦ καὶ ἐκύκλωσεν κεφαλὴν μου καὶ ἐμόχθησεν*
- 6 Ka bërë që unë të banoj në vende plot errësirë, ashtu si të vdekurit prej shumë kohe.  
*He has kept me in dark places, like those who have been long dead.*  
*ἐν σκοτεινοῖς ἐκάθισέν με ὡς νεκροὺς αἰῶνος*
- 7 Më ka ndërtuar një mur rreth e qark, me qëllim që unë të mos dal; e ka bërë të rëndë zinxhirin tim.  
*He has put a wall round me, so that I am not able to go out; he has made great the weight of my chain.*  
*ἀνφοκοδόμησεν κατ' ἐμοῦ καὶ οὐκ ἐξελεύσομαι ἐβάρυνεν χαλκὸν μου*
- 8 Edhe kur bërtas dhe kërkoj ndihmë me zë të lartë, ai nuk pranon të dëgjojë lutjen time.  
*Even when I send up a cry for help, he keeps my prayer shut out.*  
*καὶ γε κεκράζομαι καὶ βοήσω ἀπέφραξεν προσευχὴν μου*
- 9 Ai i ka mbyllur rrugët e mia me gurë të prerë, i ka bërë shtigjet e mia plot me prita.  
*He has put up a wall of cut stones about my ways, he has made my roads twisted.*  
*ἀνφοκοδόμησεν ὁδοὺς μου ἐνέφραξεν τρίβους μου ἐτάραξεν*
- 10 Ai ka qenë për mua si një ari në pritë, si një luan në vende të fshehta.  
*He is like a bear waiting for me, like a lion in secret places.*  
*ἄρκος ἐνεδρεύουσα αὐτός μοι λέων ἐν κρυφαίοις*
- 11 Ka devijuar rrugët e mia, më ka coptuar dhe më ka dëshpëruar.  
*By him my ways have been turned on one side and I have been pulled in bits; he has made me waste.*  
*κατεδίωξεν ἀφεστηκότα καὶ κατέπαυσέν με ἔθετό με ἠφανισμένην*
- 12 Ka nderur harkun e tij dhe më ka bërë objekt të shigjetave të tij.  
*With his bow bent, he has made me the mark for his arrows.*  
*ἐνέτεινεν τόξον αὐτοῦ καὶ ἐστήλωσέν με ὡς σκοπὸν εἰς βέλος*

- 13 Ka bërë të depërtoj në zemrën time shigjetat e kukurës së tij.  
He has let loose his arrows into the inmost parts of my body.  
εἰσήγαγεν τοῖς νεφροῖς μου ἰοῦς φαρέτρας αὐτοῦ
- 14 Jam bërë tallja e tërë popullit tim, kënga e tij e tërë ditës.  
I have become the sport of all the peoples; I am their song all the day.  
ἐγενήθην γέλωσ παντὶ λαῶ μου ψαλμὸς αὐτῶν ὅλην τὴν ἡμέραν
- 15 Më ka ngopur me hidhërim, më ka bërë të pij pelin.  
He has made my life nothing but pain, he has given me the bitter root in full measure.  
ἐχόρτασέν με πικρίας ἐμέθυσέν με χολῆς
- 16 Më ka coptuar dhëmbët me zall, më ka mbuluar me hi.  
By him my teeth have been broken with crushed stones, and I am bent low in the dust.  
καὶ ἐξέβαλεν ψήφω ὀδόντας μου ἐψώμισέν με σποδόν
- 17 Ke larguar shpirtin tim nga paqja, kam harruar mirëqënien.  
My soul is sent far away from peace, I have no more memory of good.  
καὶ ἀπόσατο ἐξ εἰρήνης ψυχὴν μου ἐπελαθόμην ἀγαθὰ
- 18 Kam thënë: &quot;Është zhdukur besimi im dhe shpresa ime tek Zoti&quot;.  
And I said, My strength is cut off, and my hope from the Lord.  
καὶ εἶπα ἀπόλετο νεῖκός μου καὶ ἡ ἐλπίς μου ἀπὸ κυρίου
- 19 Kujtohu për pikëllimin dhe për endjen time, për pelinin dhe hidhërimin.  
Keep in mind my trouble and my wandering, the bitter root and the poison.  
ἐμνήσθην ἀπὸ πτωχείας μου καὶ ἐκ διωγμοῦ μου πικρίας καὶ χολῆς μου
- 20 Shpirti im kujtohet gjithnjë për këtë dhe është i rrëzuar brenda meje.  
My soul still keeps the memory of them; and is bent down in me.  
μνησθήσεται καὶ καταδολεσχήσει ἐπ' ἐμέ ἡ ψυχὴ μου
- 21 Këtë dua ta sjell në mëndje dhe prandaj dua të shpresoj.  
This I keep in mind, and because of this I have hope.  
ταύτην τάξω εἰς τὴν καρδίαν μου διὰ τοῦτο ὑπομενω
- 25 Zoti është i mirë me ata që kanë shpresë tek ai, me shpirtin që e kërkon.  
The Lord is good to those who are waiting for him, to the soul which is looking for him.  
ἀγαθὸς κύριος τοῖς ὑπομένουσιν αὐτὸν ψυχὴ ἢ ζητήσῃ αὐτὸν ἀγαθὸν
- 26 Gjë e mirë është të presësh në heshtje shpëtimin e Zotit.  
It is good to go on hoping and quietly waiting for the salvation of the Lord.  
καὶ ὑπομενεῖ καὶ ἡσυχάσει εἰς τὸ σωτήριον κυρίου
- 27 Gjë e mirë është për njeriun të mbajë zgjedhën në rininë e tij.  
It is good for a man to undergo the yoke when he is young.  
ἀγαθὸν ἀνδρὶ ὅταν ἄρῃ ζυγὸν ἐν νεότητι αὐτοῦ
- 28 Le të ulet i vetmuar dhe të qëndrojë në heshtje kur Perëndia ia imponon.  
Let him be seated by himself, saying nothing, because he has put it on him.  
καθήσεται κατὰ μόνας καὶ σιωπήσεται ὅτι ἤρεν ἐφ' ἑαυτῷ
- 30 Le ti japë faqen atij që e godet, të ngopet me fyerje.  
Let his face be turned to him who gives him blows; let him be full of shame.  
δώσει τῷ παῖοντι αὐτὸν σιαγόνα χορτασθήσεται ὄνειδισμῶν

- 31 Sepse Zoti nuk hedh poshtë për gjithnjë;  
For the Lord does not give a man up for ever.  
ὅτι οὐκ εἰς τὸν αἰῶνα ἀπόσεται κύριος
- 32 por, në rast se të hidhëron, do ti vijë keq sipas shumicës së zemërmirësive të tij,  
For though he sends grief, still he will have pity in the full measure of his love.  
ὅτι ὁ ταπεινώσας οἰκτιρήσει κατὰ τὸ πλήθος τοῦ ἐλέους αὐτοῦ
- 33 sepse nuk e bën me kënaqësi poshtërimin dhe hidhërimin e bijve të njerëzve.  
For he has no pleasure in troubling and causing grief to the children of men.  
ὅτι οὐκ ἀπεκρίθη ἀπὸ καρδίας αὐτοῦ καὶ ἐταπεινώσεν υἱοὺς ἀνδρῶς
- 34 Kur dikush shtyp nën këmbët e tij tërë robërit e dheut,  
In a man's crushing under his feet all the prisoners of the earth,  
τοῦ ταπεινώσαι ὑπὸ τοῦς πόδας αὐτοῦ πάντας δεσμίους γῆς
- 35 kur dikush shtrëmbëron të drejtën e një njeriu në prani të Më të Lartit,  
In his turning away the right of a man before the face of the Most High.  
τοῦ ἐκκλίνειν κρίσιν ἀνδρῶς κατέναντι προσώπου ὑψίστου
- 36 kur dikujt i bëhet një padrejtësi në çështjen e tij, a nuk e shikon Zoti?  
In his doing wrong to a man in his cause, the Lord has no pleasure.  
καταδικάσαι ἄνθρωπον ἐν τῷ κρίνεσθαι αὐτὸν κύριος οὐκ εἶπεν
- 37 Vallë kush thotë diçka që më pas realizohet, në rast se Zoti nuk e ka urdhëruar?  
Who is able to say a thing, and give effect to it, if it has not been ordered by the Lord?  
τίς οὕτως εἶπεν καὶ ἐγενήθη κύριος οὐκ ἐνετείλατο
- 38 E keqja dhe e mira a nuk vijnë vallë nga goja e Më të Lartit?  
Do not evil and good come from the mouth of the Most High?  
ἐκ στόματος ὑψίστου οὐκ ἐξελεύσεται τὰ κακὰ καὶ τὸ ἀγαθόν
- 39 Pse vallë ankohet një njeri i gjallë, një njeri për ndëshkimin e mëkateve të tij?  
What protest may a living man make, even a man about the punishment of his sin?  
τί γογγύσει ἄνθρωπος ζῶν ἀνὴρ περὶ τῆς ἁμαρτίας αὐτοῦ
- 40 Le të shqyrtojmë rrugët tona, t'i hetojmë dhe të kthehemi tek Zoti.  
Let us make search and put our ways to the test, turning again to the Lord;  
ἐξηρενήθη ἡ ὁδὸς ἡμῶν καὶ ἠτάσθη καὶ ἐπιστρέψωμεν ἕως κυρίου
- 41 Le të ngremë lart zemrat tona dhe duart tona në drejtim të Perëndisë të qiejve.  
Lifting up our hearts with our hands to God in the heavens.  
ἀναλάβωμεν καρδίας ἡμῶν ἐπὶ χειρῶν πρὸς ὑψηλὸν ἐν οὐρανῷ
- 42 Ne kemi kryer mëkate, kemi qënë rebelë dhe ti nuk na ke falur.  
We have done wrong and gone against your law; we have not had your forgiveness.  
ἡμαρτήσαμεν ἠσεβήσαμεν καὶ οὐχ ἴλασθης
- 43 Je mbështjellë në zëmërimin tënd dhe na ke ndjekur, na ke vrrarë pa mëshirë.  
Covering yourself with wrath you have gone after us, cutting us off without pity;  
ἐπεσκέπασας ἐν θυμῷ καὶ ἀπεδίωξας ἡμᾶς ἀπέκτεινας οὐκ ἐφείσω
- 44 Ti je mbështjellë në një re, në mënyrë që asnjë lutje të mos kalonte dot.  
Covering yourself with a cloud, so that prayer may not get through.  
ἐπεσκέπασας νεφέλην σεαυτῷ εἶνεκεν προσευχῆς

- 45 Na ke bërë plehra dhe mbeturina në mes të popujve.  
You have made us like waste and that for which there is no use, among the peoples.  
καμμύσαι με καὶ ἀπωσθῆναι ἔθηκας ἡμᾶς ἐν μέσῳ τῶν λαῶν
- 46 Tërë armiqtë tanë kanë hapur gojën kundër nesh.  
The mouths of all our haters are open wide against us.  
διήνοιξαν ἐφ' ἡμᾶς τὸ στόμα αὐτῶν πάντες οἱ ἐχθροὶ ἡμῶν
- 47 Na ka rënë mbi trup tmerri, laku, dëshpërimi i thellë dhe shkatërrimi.  
Fear and deep waters have come on us, wasting and destruction.  
φόβος καὶ θυμὸς ἐγενήθη ἡμῖν ἔπαρσις καὶ συντριβή
- 48 Rrëke uji rrjedhin nga sytë e mi për shkatërrimin e bijës së popullit tim.  
Rivers of water are running down from my eyes, for the destruction of the daughter of my people.  
ἀφέσεις ὑδάτων κατὰξει ὁ ὀφθαλμὸς μου ἐπὶ τὸ σύντριμμα τῆς θυγατρὸς τοῦ λαοῦ μου
- 49 Syri im derdh lot pa pushim, pa ndërprerje,  
My eyes are streaming without stopping, they have no rest,  
ὁ ὀφθαλμὸς μου κατεπόθη καὶ οὐ σιγήσομαι τοῦ μὴ εἶναι ἔκνηψιν
- 50 deri sa Zoti të mos vështrojë nga qielli dhe të mos shikojë.  
Till the Lord's eye is turned on me, till he sees my trouble from heaven.  
ἕως οὗ διακύβη καὶ ἴδῃ κύριος ἐξ οὐρανοῦ
- 51 Syri im i sjell dhembje shpirtit tim për të gjitha bijat e qytetit tim.  
The Lord is unkind to my soul, more than all the daughters of my town.  
ὁ ὀφθαλμὸς μου ἐπιφυλλιεῖ ἐπὶ τὴν ψυχὴν μου παρὰ πάσας θυγατέρας πόλεως
- 52 Ata që më urrejnë pa shkak më kanë gjuajtur si të isha zog.  
They who are against me without cause have gone hard after me as if I was a bird;  
θηρεύοντες ἐθήρευσάν με ὡς στρουθίον οἱ ἐχθροὶ μου δωρεάν
- 53 Kanë shkatërruar jetën time në gropë, më kanë hedhur gurë.  
They have put an end to my life in the prison, stoning me with stones.  
ἐθανάτωσαν ἐν λάκκῳ ζωῆν μου καὶ ἐπέθηκαν λίθον ἐπ' ἐμοί
- 54 Ujrat rrjedhin mbi kokën time, unë thoja: "Ka marrë fund për mua".  
Waters were flowing over my head; I said, I am cut off.  
ὑπερεχύθη ὕδωρ ἐπὶ κεφαλὴν μου εἶπα ἀπόσμαι
- 55 Përmenda emrin tënd, o Zot, nga thellësia e gropës.  
I was making prayer to your name, O Lord, out of the lowest prison.  
ἐπεκαλεσάμην τὸ ὄνομά σου κύριε ἐκ λάκκου κατωτάτου
- 56 Ti e dëgjove zërin tim; mos ia fshih veshin tënd psherëtimës sime, thirrjes time për ndihmë.  
My voice came to you; let not your ear be shut to my breathing, to my cry.  
φωνήν μου ἤκουσας μὴ κρύψῃς τὰ ὦτά σου εἰς τὴν δέησίν μου
- 57 Kur të kam thirrur ti je afruar; ke thënë: "Mos ki frikë!"  
You came near in the day when I made my prayer to you: you said, Have no fear.  
εἰς τὴν βοήθειάν μου ἤγγισας ἐν ἡ ἡμέρα ἐπεκαλεσάμην εἰπᾶς μοι μὴ φοβοῦ
- 58 O Zot ti ke mbrojtur çështjen e shpirtit tim, ti ke çliruar jetën time.  
O Lord, you have taken up the cause of my soul, you have made my life safe.  
ἐδίκασας κύριε τὰς δίκας τῆς ψυχῆς μου ἐλυτρόσω τὴν ζωὴν μου

- 59 O Zot, ti ke parë dëmin që kam pësuar, prandaj mbro çështjen time!  
O Lord, you have seen my wrong; be judge in my cause.  
εἶδες κύριε τὰς ταραχάς μου ἔκρινας τὴν κρίσιν μου
- 60 Ti ke parë tërë frymën e tyre të hakmarrjes, intrigat e tyre kundër meje.  
You have seen all the evil rewards they have sent on me, and all their designs against me.  
εἶδες πᾶσαν τὴν ἐκδίκησιν αὐτῶν εἰς πάντας διαλογισμοὺς αὐτῶν ἐν ἐμοί
- 61 Ti ke dëgjuar fyerjet e tyre, o Zot, tërë intrigat e tyre kundër meje,  
Their bitter words have come to your ears, O Lord, and all their designs against me;  
ἤκουσας τὸν ὀνειδισμὸν αὐτῶν πάντας τοὺς διαλογισμοὺς αὐτῶν κατ' ἐμοῦ
- 62 fjalimet e tyre që ngrihen kundër meje, atë që mendojnë kundër meje tërë ditën.  
The lips of those who came up against me, and their thoughts against me all the day.  
χεῖλη ἐπανιστανομένων μοι καὶ μελέτας αὐτῶν κατ' ἐμοῦ ὅλην τὴν ἡμέραν
- 63 Vër re kur ulen dhe kur ngrihen, unë jam kënga e tyre.  
Take note of them when they are seated, and when they get up; I am their song.  
καθέδραν αὐτῶν καὶ ἀνάστασιν αὐτῶν ἐπίβλεπον ἐπὶ τοὺς ὀφθαλμοὺς αὐτῶν
- 64 Shpërbleji, o Zot, sipas veprës së duarve të tyre.  
You will give them their reward, O Lord, answering to the work of their hands.  
ἀποδώσεις αὐτοῖς ἀνταπόδομα κύριε κατὰ τὰ ἔργα τῶν χειρῶν αὐτῶν
- 18 Një dru i mirë nuk mund të japë fryte të këqija, as një dru i keq të japë fryte të mira.  
*It is not possible for a good tree to give bad fruit, and a bad tree will not give good fruit.*  
*ου δυναται δενδρον αγαθον καρπους πονηρους ποιειν ουδε δενδρον σαπρον καρπους καλους ποιειν*
- 19 Çdo dru që nuk jep fryt të mirë pritet dhe hidhet në zjarr.  
*Every tree which does not give good fruit is cut down and put in the fire.*  
*παν δενδρον μη ποιουν καρπον καλον εκκοπτεται και εις πυρ βαλλεται*
- 20 Ju, pra, do t'i njihni profetët nga frytet e tyre.  
*So by their fruits you will get knowledge of them.*  
*αραγε απο των καρπων αυτων επιγνωσεσθε αυτους*
- 21 Jo çdo njeri që më thotë: "Zot, Zot"; do të hyjë në mbretërinë e qieve; por do të hyjë ai që kryen vullnetin e Atit tim që është në qiej.  
*Not everyone who says to me, Lord, Lord, will go into the kingdom of heaven; but he who does the pleasure of my Father in heaven.*  
*ου πας ο λεγων μοι κυριε κυριε εισελευσεται εις την βασιλειαν των ουρανων αλλ ο ποιων το θελημα του πατρος μου του εν ουρανοισ*
- 22 Shumë do të më thonë atë ditë: "O Zot, o Zot, a nuk profetizua ne në emrin tënd, a nuk i dëbua demonët në emrin tënd, a nuk kemi bërë shumë vepra të fuqishme në emrin tënd?"  
*A great number will say to me on that day, Lord, Lord, were we not prophets in your name, and did we not by your name send out evil spirits, and by your name do works of power?*  
*πολλοι ερουσιν μοι εν εκεινη τη ημερα κυριε κυριε ου τω σω ονοματι προσεφητευσαμεν και τω σω ονοματι δαιμονια εξεβαλομεν και τω σω ονοματι δυναμεις πολλας εποιησαμεν*
- 23 Dhe atëherë unë do t'u sqaroj atyre: "Unë s'ju kam njohur kurrë; largohuni nga unë, ju të gjithë, që keni bërë paudhësi".  
*And then will I say to them, I never had knowledge of you: go from me, you workers of evil.*  
*και τοτε ομολογησω αυτοις οτι ουδεποτε εγνων υμας αποχωρειτε απ εμου οι εργαζομενοι την ανομιαν*
- 24 Prandaj, ai që i dëgjon këto fjalë të mia dhe i vë në praktikë, mund të krahasohet prej meje me një njeri të zgjuar, që e ka ndërtuar shtëpinë e tij mbi shkëmb.  
*Everyone, then, to whom my words come and who does them, will be like a wise man who made his house on a rock;*  
*πας ον οστις ακουει μου τους λογους τουτους και ποιει αυτους ομοιωσω αυτον ανδρι φρονιμο οστις οικοδομησεν την οικιαν αυτου επι την πετραν*
- 25 Ra shiu, erdhi përmbytja, frynë erërat dhe u përplasën mbi atë shtëpi; por ajo nuk u shemb, sepse ishte themeluar mbi shkëmb.  
*And the rain came down and there was a rush of waters and the winds were driving against that house, but it was not moved; because it was based on the rock.*  
*και κατεβη η βροχη και ηλθον οι ποταμοι και επνευσαν οι ανεμοι και προσεπεσον τη οικια εκεινη και ουκ επεσεν θεμελιωτο γαρ επι την πετραν*
- 26 Përkundrazi ai që i dëgjon këto fjalë dhe nuk i vë në praktikë, do të krahasohet me një njeri budalla, që e ka ndërtuar shtëpinë e tij mbi rërë.  
*And everyone to whom my words come and who does them not, will be like a foolish man who made his house on sand;*  
*και πας ο ακουων μου τους λογους τουτους και μη ποιων αυτους ομοιωθησεται ανδρι μωρω οστις οικοδομησεν την οικιαν αυτου επι την αμμον*
- 27 Më pas ra shiu, erdhi përmbytja, frynë erërat dhe u përplasën mbi atë shtëpi; ajo u shemb dhe rrënim i saj që i madh".  
*And the rain came down and there was a rush of waters and the winds were driving against that house; and it came down and great was its fall.*  
*και κατεβη η βροχη και ηλθον οι ποταμοι και επνευσαν οι ανεμοι και προσεκοψαν τη οικια εκεινη και επεσεν και ην η πτωσις αυτης μεγαλη*
- 28 Tani kur Jezusi i mbaroi këto fjalë, turmat mbetën të habitura nga doktrina e tij,  
*And it came about, when Jesus had come to the end of these words, that the people were surprised at his teaching,*  
*και εγενετο οτε συνετελεσεν ο ιησους τους λογους τουτους εξεπλησσαντο οι οχλοι επι τη διδαχη αυτου*

- 29 sepse ai i mësonte, si një që ka autoritet dhe jo si skribët.  
for he was teaching as one having authority, and not as their scribes.  
ην γαρ διδασκων αυτους ως εξουσιαν εχων και ουχ ως οι γραμματεις
- 1 Tani kur Jezusi zbriti nga mali, turma të mëdha e ndiqnin.  
And when he had come down from the mountain, great numbers of people came after him.  
καταβαντι δε αυτω απο του ορους ηκολουθησαν αυτω οχλοι πολλοι
- 2 Dhe ja, një lebroz erdhi dhe e adhuroi, duke thënë: "O Zot, po të duash, ti mund të më shërosh".  
And a leper came and gave him worship, saying, Lord, if it is your pleasure, you have power to make me clean.  
και ιδου λεπρος ελθων προσεκυνει αυτω λεγων κυριε εαν θελης δυνασαι με καθαρισαι
- 3 Jezusi e shtriu dorën, e preku dhe i tha: "Po, unë dua, shërohu". Dhe në atë çast u shërua nga lebra e tij.  
And he put his hand on him, saying, It is my pleasure; be clean. And straight away he was made clean.  
και εκτεινας την χειρα ηψατο αυτου ο ιησους λεγων θελω καθαρισθητι και ευθεως εκαθαρισθη αυτου η λεπρα
- 4 Atëherë Jezusi i tha: "Ruhu se ia tregon kujt; por shko, paraqitu te prifti, bëj fljimin që ka urdhëruar Moisiu, me qëllim që kjo të jetë dëshmi për ta".  
And Jesus said to him, See that you say nothing about this to anyone; but go and let the priest see you and make the offering which was ordered by Moses, for a witness to them.  
και λεγει αυτω ο ιησους ορα μηδενι ειπης αλλ υπαγε σεαυτον δειξον τω ιερει και προσενεγκε το δωρον ο προσεταξεν μοσης εις μαρτυριον αυτοις
- 5 Kur Jezusi hyri në Kapernaum i erdhi një centurion duke iu lutur,  
And when Jesus was come into Capernaum, a certain captain came to him with a request,  
εισελθοντι δε τω ιησου εις καπερναουμ προσηλθεν αυτω εκατονταρχος παρακαλων αυτον
- 6 dhe duke thënë: "O Zot, shërbëtori im rri shtrirë në shtëpi i paralizuar dhe po vuan shumë".  
Saying, Lord, my servant is ill in bed at the house, with no power in his body, and in great pain.  
και λεγων κυριε ο παις μου βεβληται εν τη οικια παραλυτικος δεινως βασανιζομενος
- 7 Dhe Jezusi i tha: "Do të vij dhe do ta shëroj".  
And he said to him, I will come and make him well.  
και λεγει αυτω ο ιησους εγω ελθων θεραπευσω αυτον
- 8 Centurioni duke u përgjigjur i tha: "Zot, unë nuk jam i denjë që ti të hysh nën strehën time; por thuaj vetëm një fjalë dhe shërbëtori im do të shërohet.  
And the captain in answer said, Lord, I am not good enough for you to come under my roof; but only say the word, and my servant will be made well.  
και αποκριθεις ο εκατονταρχος εφη κυριε ουκ ειμι ικανος ινα μου υπο την στεγην εισελθης αλλα μονον ειπε λογον και ιαθησεται ο παις μου
- 9 Sepse unë jam një njeri nën urdhërin e të tjerëve, dhe i kam ushtarët nën vete; dhe, po t'i them dikujt: "Shko", ai shkon; dhe po t'i them një tjetri: "Eja", ai vjen; dhe po t'i them shërbëtorit tim: "Bëje këtë", ai e bën".  
Because I myself am a man under authority, having under me fighting men; and I say to this one, Go, and he goes; and to another, Come, and he comes; and to my servant, Do this, and he does it.  
και γαρ εγω ανθρωπος ειμι υπο εξουσιαν εχων υπ εμαυτον στρατιωτας και λεγω τουτω πορευθητι και πορευεται και αλλω ερχου και ερχεται και τω δουλω μου ποιησον τουτο και ποιει
- 10 Dhe Jezusi, kur i dëgjoi këto gjëra, u mrekullua dhe u tha atyre që e ndiqnin: "Në të vërtetë po ju them, se askund në Izrael nuk e gjeta një besim aq të madh.  
And when these words came to the ears of Jesus he was surprised, and said to those who came after him, Truly I say to you, I have not seen such great faith, no, not in Israel.  
ακουσας δε ο ιησους εθαυμασεν και ειπεν τοις ακολουθουσιν αμην λεγω υμιν ουδε εν τω ισραηλ τοσαυτην πιστιν ευρον
- 11 Unë po ju them se shumë do të vijnë nga lindja dhe nga perëndimi dhe do të ulen në tryezë me Abrahamin, me Isaakun dhe me Jakobin, në mbretërinë e qiejve,  
And I say to you that numbers will come from the east and the west, and will take their seats with Abraham and Isaac and Jacob, in the kingdom of heaven:  
λεγω δε υμιν οτι πολλοι απο ανατολων και δυσμων ηξουσιν και ανακιθησονται μετα αβρααμ και ισαακ και ιακωβ εν τη βασιλεια των ουρανων
- 12 por bijtë e mbretërisë do të flaken në errësirat e jashtme. Atje do të jetë e qara dhe kërcëllimi dhëmbëve".  
But the sons of the kingdom will be put out into the dark, and there will be weeping and cries of pain.  
οι δε υιοι της βασιλειας εκβληθησονται εις το σκοτος το εξωτερων εκει εσται ο κλαυθμος και ο βρυγμος των οδοντων
- 13 Dhe Jezusi i tha centurionit: "Shko dhe u bëftë ashtu si besove!". Dhe shërbëtori i tij u shërua që në atë çast.  
And Jesus said to the captain, Go in peace; as your faith is, so let it be done to you. And the servant was made well in that hour.  
και ειπεν ο ιησους τω εκατονταρχω υπαγε και ως επιστευσας γενηθητω σοι και ιαθη ο παις αυτου εν τη ωρα εκεινη

- 14 Pastaj Jezusi hyri në shtëpinë e Pjetrit dhe pa që e vjehrra ishte në shtrat me ethe.  
And when Jesus had come into Peter's house, he saw his wife's mother in bed, very ill.  
και ελθων ο ιησους εις την οικιαν πετρου ειδεν την πενθεραν αυτου βεβλημενην και πυρεσσοσαν
- 15 Dhe ai ia preku dorën dhe ethet e lanë; dhe ajo u ngrit dhe nisi t'u shërbejë.  
And he put his hand on hers and the disease went from her, and she got up and took care of his needs.  
και ηψατο της χειρος αυτης και αφηκεν αυτην ο πυρετος και ηγερθη και διηκονει αυτοις
- 16 Dhe kur u ngrys, i sollën shumë të pushtuar nga demonë; dhe ai, me fjalë, i dëboi frymërat dhe i shëroi të gjithë të sëmurët,  
And in the evening, they took to him a number of people who had evil spirits; and he sent the spirits out of them with a word, and made well all who were ill;  
οψιας δε γενομενης προσηγγεκαν αυτω δαμονιζομενους πολλους και εξεβαλεν τα πνευματα λογω και παντας τους κακως εχοντας εθεραπευσεν
- 17 që kështu të përmbushej fjala e profetit Isaia kur tha: "Ai i mori lëngatat tona dhe i mbarti sëmundjet tona".  
So that the word of Isaiah the prophet might come true: He himself took our pains and our diseases.  
οπως πληρωθη το ρηθεν δια ησαιου του προφητου λεγοντος αυτος τας ασθeneias ημων ελαβεν και τας νοσους εβαστασεν
- 18 Tani Jezusi, duke parë rreth tij turma të mëdha, urdhëroi që të kalonin në bregun tjetër.  
Now when Jesus saw a great mass of people about him, he gave an order to go to the other side.  
ιδων δε ο ιησους πολλους οχλους περι αυτον εκελευσεν απελθειν εις το περαν
- 19 Atëherë një skrib iu afrua dhe i tha: "Mësues, unë do të ndjek kudo që të shkosh".  
And there came a scribe and said to him, Master, I will come after you wherever you go.  
και προσελθων εις γραμματευσ ειπεν αυτω διδασκαλε ακολουθησω σοι οπου εαν απερχη
- 20 Dhe Jezusi i tha: "Dhelprat i kanë strofkat, dhe zogjtë e qiellit i kanë çerdhet, por Biri i njeriut nuk ka as ku të mbështetë kokën".  
And Jesus said to him, The foxes have holes, and the birds of heaven have a resting-place; but the Son of man has nowhere to put his head.  
και λεγει αυτω ο ιησους αι αλωπεκες φωλεους εχουσιν και τα πετεινα του ουρανου κατασκηνωσεις ο δε υιος του ανθρωπου ουκ εχει που την κεφαλην κλινη
- 21 Pastaj një tjetër nga dishepujt e tij i tha: "O Zot, më jep më parë leje të shkoj të varros atin tim".  
And another of the disciples said to him, Lord, let me first go and give the last honours to my father.  
ετερος δε των μαθητων αυτου ειπεν αυτω κυριε επιτρεψον μοι πρωτον απελθειν και θαψαι τον πατερα μου
- 22 Por Jezusi i tha: Më ndiq, dhe lëri të vdekurit të varrosin të vdekurit e vet".  
But Jesus said to him, Come after me; and let the dead take care of their dead.  
ο δε ιησους ειπεν αυτω ακολουθει μοι και αφες τους νεκρους θαψαι τους εαυτων νεκρους
- 23 Dhe mbasi ai hipi në barkë, dishepujt e tij e ndiqnin.  
And when he had got into a boat, his disciples went after him.  
και εμβαντι αυτω εις το πλοιον ηκολουθησαν αυτω οι μαθηται αυτου
- 24 Dhe ja, që u ngrit në det një stuhí aq e madhe, sa valët po e mbulonin barkën, por ai flinte.  
And there came up a great storm in the sea, so that the boat was covered with the waves: but he was sleeping.  
και ιδου σεισμος μεγας εγενετο εν τη θαλασση οστε το πλοιον καλυπτεσθαι υπο των κυματων αυτος δε εκαθευδεν
- 25 Dhe dishepujt e tij iu afruan dhe e zgjuan duke i thënë: "O Zot, na shpëto, ne po mbarojmë!"  
And they came to him, and, awaking him, said, Help, Lord; destruction is near.  
και προσελθοντες οι μαθηται αυτου ηγειραν αυτον λεγοντες κυριε σωσον ημας απολλυμεθα
- 26 Por ai u tha atyre: "Pse keni frikë, o njerëz besimpakë?". Dhe, pasi u ngrit, qortoi erërat dhe detin, dhe u bë bunacë e madhe.  
And he said to them, Why are you full of fear, O you of little faith? Then he got up and gave orders to the winds and the sea; and there was a great calm.  
και λεγει αυτοις τι δειλοι εστε ολιγοπιστοι τοτε εγερθεις επετιμησεν τοις ανεμοις και τη θαλασση και εγενετο γαληνη μεγαλη
- 27 Atëherë njëzërit u mrekulluan dhe thoshnin: "Kush është ky, të cilit po i binden deti dhe erërat?".  
And the men were full of wonder, saying, What sort of man is this, that even the winds and the sea do his orders?  
οι δε ανθρωποι εθαυμασαν λεγοντες ποταπος εστιν ουτος οτι και οι ανεμοι και η θαλασσα υπακουουσιν αυτω

- 28 Dhe kur arriti në bregun tjetër, në krahinën e Gergesenasve, i dolën para dy të demonizuar, që kishin dalë nga varret, dhe ishin aq të tërbuar sa që askush nuk mund të kalonte në atë udhë.  
And when he had come to the other side, to the country of the Gadarenes, there came out to him from the place of the dead, two who had evil spirits, so violent that no man was able to go that way.  
και ελθοντι αυτο εις το περαν εις την χωραν των γεργεσηνων υπηνησαν αυτο δυο δαιμονιζομενοι εκ των μνημειων εξερχομενοι χαλεποι λιαν ωστε μη ισχυειν τινα παρελθειν δια της οδου εκεινης
- 29 Dhe ja, ata filluan të bërtasin duke thënë: "Ç'është mes nesh dhe ty, Jezus, Biri i Perëndisë? Mos ke ardhur këtu të na mundosh para kohe?".  
And they gave a loud cry, saying, What have we to do with you, you Son of God? Have you come here to give us punishment before the time?  
και ιδου εκραζαν λεγοντες τι ημιν και σοι ιησου υιε του θεου ηλθες ωδε προ καιρου βασανισαι ημας
- 30 Jo larg tyre një tufë e madhe derrash po kulloste.  
Now there was, some distance away, a great herd of pigs taking their food.  
ην δε μακραν απ αυτων αγελη χοιρων πολλων βοσκομενη
- 31 Dhe demonët iu lutën duke i thënë: "Në qoftë se na dëbon, na lejo të shkojmë në atë tufë derrash".  
And the evil spirits made strong prayers to him, saying, If you send us out, let us go into the herd of pigs.  
οι δε δαιμονες παρεκαλουν αυτον λεγοντες ει εκβαλλεις ημας επιτρεψον ημιν απελθειν εις την αγελην των χοιρων
- 32 Dhe ai u tha atyre: "Shkoni!". Kështu ata, pasi dolën, hynë në atë tufë derrash; dhe ja, gjithë ajo tufë u hodh nga gremina në det, dhe u mbyt në ujë.  
And he said to them, Go. And they came out, and went into the pigs; and the herd went rushing down a sharp slope into the sea and came to their end in the water.  
και ειπεν αυτοις υπαγετε οι δε εξελθοντες απηλθον εις την αγελην των χοιρων και ιδου ωρμησεν πασα η αγελη των χοιρων κατα του κρημου εις την θαλασσαν και απεθανον εν τοις υδασιν
- 33 Dhe ata që i kullotnin ikën dhe, kur shkuan në qytet, i treguan të gjitha këto gjëra, duke përfshirë ngjarjen e të demonizuarve.  
And their keepers went in flight to the town and gave an account of everything, and of the men who had the evil spirits.  
οι δε βοσκοντες εφυγον και απελθοντες εις την πολιν απηγγειλαν παντα και τα των δαιμονιζομενων
- 34 Dhe ja, gjithë qyteti i doli para Jezusit; dhe, kur e panë, iu lutën që të largohej prej vendit të tyre.  
And all the town came out to Jesus; and seeing him they made request that he would go away from their part of the country.  
και ιδου πασα η πολις εξηλθεν εις συναντησιν τω ιησου και ιδοντες αυτον παρεκαλεσαν οπως μεταβη απο των οριων αυτων
- 1 Dhe ai, pasi hipi në barkë, kaloi në bregun tjetër dhe erdhi në qytetin e vet.  
And he got into a boat and went across and came to his town.  
και εμβας εις το πλοιον διεπερασεν και ηλθεν εις την ιδιαν πολιν
- 2 Dhe ja, iu paraqit një paralitik i shtrirë në vig; dhe Jezusi, kur pa besimin që kishin ata, i tha paralitikut: "Merr zemër, o bir, mëkatet e tua të janë falur!"  
And they took to him a man stretched on a bed who had no power of moving; and Jesus, seeing their faith, said to the man who was ill, Son, take heart; you have forgiveness for your sins.  
και ιδου προσεφερον αυτο παραλυτικον επι κλινης βεβλημενον και ιδων ο ιησους την πιστιν αυτων ειπεν τω παραλυτικο θαρσει τεκνον αφεωνται σοι αι αμαρτια σου
- 3 Atëherë disa skribë thanë me vete: "Ky po blasfemon!".  
And some of the scribes said among themselves, This man has no respect for God.  
και ιδου τινες των γραμματεων ειπον εν εαυτοις ουτος βλασφημει
- 4 Por Jezusi, duke njohur mendimet e tyre, tha: "Pse mendoni gjëra të mbrapështa në zemrat tuaja?  
And Jesus, having knowledge of what was in their minds, said, Why are your thoughts evil?  
και ιδων ο ιησους τας ενθυμησεις αυτων ειπεν ινα τι υμεις ενθυμεισθε πονηρα εν ταις καρδιας υμων
- 5 Në fakt, ç'është më e lehtë, të thuash: "Mëkatet e tua të janë falur", apo: "Çohu dhe ec";  
For which is the simpler, to say, You have forgiveness for your sins; or to say, Get up and go?  
τι γαρ εστιν ευκοπωτερον ειπειν αφεωνται σοι αι αμαρτια η ειπειν εγειραι και περιπατει
- 6 Tani, që ta dini se Biri i njeriut ka autoritet në tokë të falë mëkatet: Çohu (i tha paralitikut), merr vigun tënd dhe shko në shtëpinë tënde".  
But so that you may see that on earth the Son of man has authority for the forgiveness of sins, (then said he to the man who was ill,) Get up, and take up your bed, and go to your house.  
ινα δε ειδητε οτι εξουσιαν εχει ο υιος του ανθρωπου επι της γης αφιεναι αμαρτιας τοτε λεγει τω παραλυτικο εγερθεις αρον σου την κλινην και υπαγε εις τον οικον σου
- 7 Dhe ai u çua dhe shkoi në shtëpinë e vet.  
And he got up and went away to his house.  
και εγερθεις απηλθεν εις τον οικον αυτου

- 8 Turmat, kur e panë këtë, u çuditën dhe lëvdonin Perëndinë, që u kishte dhënë pushtet të tillë njerëzve.  
But when the people saw it they were full of fear, and gave glory to God who had given such authority to men.  
ιδοντες δε οι οχλοι εθαυμασαν και εδοξασαν τον θεον τον δοντα εξουσιαν τοιαυτην τοις ανθρωποις
- 9 Pastaj Jezusi, duke shkuar tutje, pa një burrë që rrinte në doganë, i quajtur Mate, dhe i tha: "Ndiqmë!". Dhe ai u çua dhe e ndoqi.  
And when Jesus was going from there, he saw a man whose name was Matthew, seated at the place where taxes were taken; and he said to him, Come after me. And he got up and went after him.  
και παραγων ο ιησους εκειθεν ειδεν ανθρωπον καθημενον επι το τελωνιον μαθβαιον λεγομενον και λεγει αυτω ακολουθει μοι και αναστας ηκολουθησεν αυτω
- 10 Dhe ndodhi që, kur Jezusi u ul në tryezë në shtëpi, erdhën shumë tagrambledhës dhe mëkatarë dhe u ulën në tryezë bashkë me të dhe me dishepujt e tij.  
And it came about, when he was in the house taking food, that a number of tax-farmers and sinners came and took their places with Jesus and his disciples.  
και εγενετο αυτου ανακειμενου εν τη οικια και ιδου πολλοι τελωναι και αμαρτωλοι ελθοντες συνανεκειντο τω ιησου και τοις μαθηταις αυτου
- 11 Farisenjtë, kur e panë këtë, u thanë dishepujt e tij: "Pse Mësuesi juaj ha bukë me tagrambledhësit dhe me mëkatarët?".  
And when the Pharisees saw it, they said to his disciples, Why does your Master take food with tax-farmers and sinners?  
και ιδοντες οι φαρισαιοι ειπον τοις μαθηταις αυτου διατι μετα των τελωνων και αμαρτωλων εσθιει ο διδασκαλος υμων
- 12 Jezusi, mbasi i dëgjoi, u tha atyre: "Nuk janë të shëndoshët ata që kanë nevojë për mjekun, por të sëmurët.  
But on hearing this he said, Those who are well have no need of a medical man, but those who are ill.  
ο δε ιησους ακουσας ειπεν αυτοις ου χρειαν εχουσιν οι ισχυοντες ιατρου αλλ οι κακως εχοντες
- 13 Tani shkoni dhe mësoni ç'do të thotë: "Unë dua mëshirë dhe jo flijime". Sepse unë nuk erdha për të thirrur në pendim të drejtët, por mëkatarët".  
But go and take to heart the sense of these words, My desire is for mercy, not offerings: for I have come not to get the upright, but sinners.  
πορευθεντες δε μαθετε τι εστιν ελεον θελω και ου θυσιαν ου γαρ ηλθον καλεσαι δικαιους αλλ αμαρτωλους εις μετανοιαν
- 14 Atëherë iu afruan dishepujt e Gjonit dhe i thanë: "Pse ne dhe farisenjtë agjërojmë shpesh, ndërsa dishepujt e tu nuk agjërojnë?".  
Then the disciples of John came to him, saying, Why do we and the Pharisees frequently go without food, but your disciples do not?  
τοτε προσερχονται αυτω οι μαθηται ιωαννου λεγοντες διατι ημεις και οι φαρισαιοι νηστευομεν πολλα οι δε μαθηται σου ου νηστεουσιν
- 15 Dhe Jezusi u tha atyre: "A mund të mbajnë zi dasmorët, ndërsa dhëndërrri është midis tyre? Por do të vijë koha kur do t'ua marrin dhëndërrin dhe atëherë ata do të agjërojnë.  
And Jesus said to them, Will the friends of the newly-married man be sad as long as he is with them? But the days will come when he will be taken away from them, and then will they go without food.  
και ειπεν αυτοις ο ιησους μη δυνανται οι υιοι του νυμφωνος πενθειν εφ οσον μετ αυτων εστιν ο νυμφιος ελευσονται δε ημεραι οταν απαρθη απ αυτων ο νυμφιος και τοτε νηστεουσιν
- 16 Askush nuk vë një copë prej stofi të ri mbi një petk të vjetër, sepse kështu arna bie dhe grisja bëhet më e madhe.  
And no man puts a bit of new cloth on an old coat, for by pulling away from the old, it makes a worse hole.  
ουδεις δε επιβαλλει επιβλημα ρακους αγναφου επι ιματιω παλαιω αιρει γαρ το πληρωμα αυτου απο του ιματιου και χειρον σχισμα γινεται
- 17 Dhe as nuk shtihet vera e re në kacekë të vjetër; përndryshe kacekët shpohen, vera derdhet dhe kacekët humbin; por shtihet vera e re në kacekë të rinj, kështu që ruhen të dy".  
And men do not put new wine into old wine-skins; or the skins will be burst and the wine will come out, and the skins are of no more use: but they put new wine into new wine-skins, and so the two will be safe.  
ουδε βαλλουσιν οινον νεον εις ασκους παλαιους ει δε μηγε ριγγυνται οι ασκοι και ο οινος εκχειται και οι ασκοι απολουνται αλλα βαλλουσιν οινον νεον εις ασκους καινους και αμφοτερα συντηρουνται
- 18 Ndërsa Jezusi u thoshte këto, iu afrua një nga krerët e sinagogës, ra përmbys para tij, dhe i tha: "Sapo më vdiq vajza, por eja, vëre dorën mbi të dhe ajo do të jetojë".  
While he was saying these things to them, there came a ruler and gave him worship, saying, My daughter is even now dead; but come and put your hand on her, and she will come back to life.  
ταυτα αυτου λαλουντος αυτοις ιδου αρχων ελθων προσεκυνη αυτω λεγων οτι η θυγατηρ μου αρτι ετελετησεν αλλα ελθων επιθες την χειρα σου επ αυτην και ζησεται
- 19 Dhe Jezusi u ngrit dhe e ndoqi bashkë me dishepujt e tij.  
And Jesus got up and went after him, and so did his disciples.  
και εγερθεις ο ιησους ηκολουθησεν αυτω και οι μαθηται αυτου
- 20 Dhe ja një grua, e cila vuante prej dymbëdhjetë vjetësh nga një fluks gjaku, iu afrua nga mbrapa dhe i preku cepin e rrobes së tij.  
And a woman, who for twelve years had had a flow of blood, came after him, and put her hand on the edge of his robe:  
και ιδου γυνη αιμορροουσα δωδεκα ετη προσελθουσα οπισθεν ησατο του κρασπεδου του ιματιου αυτου



- 21 Sepse thoshte me vete: "Po të prek vetëm rroben e tij, do të shërohem".  
Because, she said to herself, if I may but put my hand on his robe, I will be made well.  
ελεγεν γαρ εν εαυτη εαν μονον αψωμαι του ιματιου αυτου σωθησομαι
- 22 Jezusi u kthye, e pa dhe tha: "Merr zemër, o bijë; besimi yt të ka shëruar". Dhe që në atë çast gruaja u shërua.  
But Jesus, turning and seeing her, said, Daughter, take heart; your faith has made you well. And the woman was made well from that hour.  
ο δε ιησους επιστραφεις και ιδων αυτην ειπεν θαρσει θυγατερ η πιστις σου σεσωκεν σε και εσωθη η γωνη απο της ωρας εκεινης
- 23 Kur Jezusi arriti në shtëpinë e kryetarit të sinagogës dhe pa fyelltarët dhe turmën që zhurmonte,  
And when Jesus came into the ruler's house and saw the players with their instruments and the people making a noise,  
και ελθων ο ιησους εις την οικιαν του αρχοντος και ιδων τους αυλητας και τον οχλον θορυβουμενον
- 24 u tha atyre: "Largohuni, sepse vajza nuk ka vdekur, por fle". Dhe ata e përqeshnin.  
He said, Make room; for the girl is not dead, but sleeping. And they were laughing at him.  
λεγει αυτοις αναχωρειτε ου γαρ απεθανεν το κορασιον αλλα καθευδει και κατεγελων αυτου
- 25 Pastaj, kur turmën e nxorën jashtë, ai hyri, e zuri për dore vajzën dhe ajo u ngrit.  
But when the people were sent out, he went in and took her by the hand; and the girl got up.  
οτε δε εξεβληθη ο οχλος εισελθων εκρατησεν της χειρος αυτης και ηγερθη το κορασιον
- 26 Fama e kësaj u përhap në mbarë atë vend.  
And the news of it went out into all that land.  
και εξηλθεν η φημη αυτη εις ολην την γην εκεινην
- 27 Dhe ndërsa Jezusi po largohej prej andej, dy të verbër e ndiqnin duke bërtitur dhe duke thënë: "Ki mëshirë për ne, Bir i Davidit!".  
And when Jesus went on from there, two blind men came after him, crying out, Have mercy on us, you Son of David.  
και παραγοντι εκειθεν τω ιησου ηκολουθησαν αυτω δυο τυφλοι κραζοντες και λεγοντες ελεησον ημας υιε δαβιδ
- 28 Kur arriti në shtëpi, të verbërit iu afruan dhe Jezusi u tha atyre: "A besoni ju se unë mund ta bëj këtë gjë?". Ata iu përgjigjën: "Po, o Zot!".  
And when he had come into the house, the blind men came to him; and Jesus said to them, Have you faith that I am able to do this? They said to him, Yes, Lord.  
ελθοντι δε εις την οικιαν προσηλθον αυτω οι τυφλοι και λεγει αυτοις ο ιησους πιστευετε οτι δυναμι τουτο ποιησαι λεγουσιν αυτω ναι κυριε
- 29 Atëherë ai ua preku sytë, duke thënë: "U bëftë sipas besimit tuaj".  
Then he put his hand on their eyes, saying, As your faith is, let it be done to you.  
τοτε ηψατο των οφθαλμων αυτων λεγων κατα την πιστιν υμων γενηθητω υμιν
- 30 Dhe atyre iu hapën sytë. Pastaj Jezusi i urdhëroi rreptësisht duke thënë: "Ruhuni se mos e merr vesh njeri".  
And their eyes were made open. And Jesus said to them sharply, Let no man have knowledge of it.  
και ανεωχθησαν αυτων οι οφθαλμοι και ενεβριμησατο αυτοις ο ιησους λεγων ορατε μηδεις γινωσκετω
- 31 Por ata, sapo dolën, e përhapën famën e tij në mbarë atë vend.  
But they went out and gave news of him in all that land.  
οι δε εξελθοντες διεφημισαν αυτον εν ολη τη γη εκεινη
- 32 Dhe, kur ata po dilnin, i paraqitën një burrë memec dhe të demonizuar.  
And while they were going away, there came to him a man without the power of talking, and with an evil spirit.  
αυτων δε εξερχομενων ιδου προσηνεγκαν αυτω ανθρωπον κωφον δαιμονιζομενον
- 33 Dhe, mbasi e dëboi demonin, memeci foli dhe turmat u çuditën dhe thanë: "Nuk është parë kurrë një gjë e tillë në Izrael".  
And when the evil spirit had been sent out, the man had the power of talking; and they were all surprised, saying, Such a thing has never been seen in Israel.  
και εκβληθεντος του δαιμονιου ελαλησεν ο κωφος και εθαυμασαν οι οχλοι λεγοντες οτι ουδεποτε εφανη ουτως εν τω ισραηλ
- 34 Por farisenjtë thonin: "Ai i dëbon demonët me ndihmën e princit të demonëve!".  
But the Pharisees said, By the ruler of evil spirits, he sends evil spirits out of men.  
οι δε φαρισαιοι ελεγον εν τω αρχοντι των δαιμονιων εκβαλλει τα δαιμονια

- 35 Dhe Jezusi kalonte nëpër të gjitha qytetet dhe fshatrat, duke i mësuar në sinagogat e tyre, duke predikuar ungjillin e mbretërisë dhe duke shëruar çdo sëmundje e çdo lëngatë në popull.  
And Jesus went about all the towns and small places, teaching in their Synagogues and preaching the good news of the kingdom and making well all sorts of disease and pain.  
και περιηγεν ο ιησους τας πολεις πασας και τας κομιας διδασκων εν ταις συναγωγασι αυτων και κηρυσσων το ευαγγελιον της βασιλειας και θεραπευων πασαν νοσον και πασαν μαλακιαν εν τω λαω
- 36 Duke parë turmat, kishte dhembshuri për to, sepse ishin të lodhur dhe të shpërndarë si delet pa bari.  
But when he saw all the people he was moved with pity for them, because they were troubled and wandering like sheep without a keeper.  
ιδων δε τους οχλους εσπλαγχισθη περι αυτων οτι ησαν εκλελυμενοι και ερριμμενοι ωσει προβατα μη εχοντα ποιμενα
- 37 Atëherë ai u tha dishepujve të vet: "E korra është me të vërtetë e madhe, por punëtorët janë pak.  
Then he said to his disciples, There is much grain but not enough men to get it in.  
τοτε λεγει τοις μαθηταις αυτου ο μεν θερισμος πολυς οι δε εργαται ολιγοι
- 38 Lutjuni, pra, Zotit të të korrave, të dërgojë punëtorë në të korrat e tij".  
Make prayer, then, to the Lord of the grain-fields, that he may send out workers to get in his grain.  
δηθητε ουν του κυριου του θερισμου οπως εκβαλη εργατας εις τον θερισμον αυτου
- 1 Pastaj Jezusi i thirri të dymbëdhjetë dishepujt e tij rreth vetes dhe u dha autoritet t'i dëbojnë frymërat e ndyra, dhe të shërojnë çdo sëmundje e çdo lëngatë.  
And he got together his twelve disciples and gave them the power of driving out unclean spirits, and of making well all sorts of disease and pain.  
και προσκαλεσαμενος τους δωδεκα μαθητας αυτου εδωκεν αυτοις εξουσιαν πνευματων ακαθαρτων ωστε εκβαλλειν αυτα και θεραπευειν πασαν νοσον και πασαν μαλακιαν
- 2 Dhe emrat e dymbëdhjetë apostujve janë këta: i pari Simoni, i quajtur Pjetër dhe Andrea, vëllai i tij; Jakobi i Zebedeut dhe Gjoni, vëllai i tij;  
Now the names of the twelve are these: The first, Simon, who is named Peter, and Andrew, his brother; James, the son of Zebedee, and John, his brother;  
των δε δωδεκα αποστολων τα ονοματα εστιν ταυτα πρωτος σιμων ο λεγομενος πετρος και ανδρεας ο αδελφος αυτου ιακωβος ο του ζεβεδαιου και ιωαννης ο αδελφος αυτου
- 3 Filipi dhe Bartolomeu; Thomaï dhe Mateu tagrambledhësi, Jakobi i Alfeut dhe Lebeu, i mbiquajtur Tade;  
Philip and Bartholomew; Thomas and Matthew, the tax-farmer; James, the son of Alphaeus, and Thaddaeus;  
φιλιππος και βαρθολομαιος θωμας και ματθαιος ο τελωνης ιακωβος ο του αλφαιου και λεββαιος ο επικληθεις θαδδαιος
- 4 Simon Kananeasi dhe Judë Iskarioti, ai që më pas e tradhtoi.  
Simon the Zealot, and Judas Iscariot, who was false to him.  
σιμων ο κανανιτης και ιουδας ισκαριωτης ο και παραδους αυτον
- 5 Këta janë të dymbëdhjetët që Jezusi i dërgoi mbasi u dha këto urdhëra: "Mos shkoni ndër paganë dhe mos hyni në asnjë qytet të Samaritanëve,  
These twelve Jesus sent out and gave them orders, saying, Do not go among the Gentiles, or into any town of Samaria,  
τουτους τους δωδεκα απεστειλεν ο ιησους παραγγελιας αυτοις λεγων εις οδον εθνων μη απελθητε και εις πολιν σαμαρειτων μη εισελθητε
- 6 por shkoni më mirë te delet e humbura të shtëpisë së Izraelit.  
But go to the wandering sheep of the house of Israel,  
πορευεσθε δε μαλλον προς τα προβατα τα απολωλοτα οικου ισραηλ
- 7 Shkoni dhe predikoni duke thënë: "Mbretëria e qiejve u afërua"  
And, on your way, say, The kingdom of heaven is near.  
πορευομενοι δε κηρυσσετε λεγοντες οτι ηγγικεν η βασιλεια των ουρανων
- 8 Shëroni të sëmurët, pastroni lebrozët, ngjallni të vdekurit, dëboni demonët; falas morët, falas jepni.  
Make well those who are ill, give life to the dead, make lepers clean, send evil spirits out of men; freely it has been given to you, freely give.  
ασθενουντας θεραπευετε λεπρους καθαριζετε νεκρους εγειρετε δαιμονια εκβαλλετε δωρεαν ελαβετε δωρεαν δοτε
- 9 Mos grumbulloni ar, as argjend as bakër në qesen tuaj,  
Take no gold or silver or copper in your pockets;  
μη κτησησθε χρυσον μηδε αργυρον μηδε χαλκον εις τας ζωνας υμων
- 10 as trasta për udhë, as dy palë tunika, as sandale, as shkop, sepse punëtori është i denjë për ushqimin e vet.  
Take no bag for your journey and do not take two coats or shoes or a stick: for the workman has a right to his food.  
μη πηραν εις οδον μηδε δυο χιτωνας μηδε υποδηματα μηδε ραβδον αξιος γαρ ο εργατης της τροφης αυτου εστιν

- 11 Në çfarëdo qytet ose fshat që të hyni, pyetni në se ka aty ndonjë njeri të denjë dhe banoni tek ai deri sa të niseni.  
*And into whatever town or small place you go, make search there for someone who is respected, and make his house your resting-place till you go away.*  
 εις ην δ αν πολιν η κομην εισελθητε εξετασατε τις εν αυτη αξιος εστιν κακει μεινατε εως αν εξελθητε
- 12 Dhe kur hyni në shtëpi, e përshëndetni.  
*And when you go in, say, May peace be on this house.*  
 εισερχομενοι δε εις την οικιαν ασπασασθε αυτην
- 13 Dhe në se ajo shtëpi është e denjë, le të vijë paqja juaj mbi të; por, në se nuk është e denjë, paqja juaj le të kthehet përsëri tek ju.  
*And if the house is good enough, let your peace come on it: but if not, let your peace come back to you.*  
 και εαν μεν η η οικια αξια ελθετω η ειρηνη υμων επ αυτην εαν δε μη η αξια η ειρηνη υμων προς υμας επιστραφητω
- 14 Dhe në se dikush nuk ju pret dhe nuk i dëgjon fjalët tuaja, duke dalë nga ajo shtëpi ose nga ai qytet, shkundni pluhurin nga këmbët tuaja.  
*And whoever will not take you in, or give ear to your words, when you go out from that house or that town, put off its dust from your feet.*  
 και ος εαν μη δεξηται υμας μηδε ακουση τους λογους υμων εξερχομενοι της οικιας η της πολεωσ εκεινης εκτιναξατε τον κονιορτον των ποδων υμων
- 15 Dhe në të vërtetë po ju them se ditën e gjyqit, vendi i Sodomës dhe i Gomorës do të trajtohet me më shumë tolerancë se ai qytet.  
*Truly I say to you, It will be better for the land of Sodom and Gomorrah in the day of God's judging than for that town.*  
 αμην λεγω υμιν ανεκτοτερον εσται γη σοδομων και γομορρων εν ημερα κρισεωσ η τη πολει εκεινη
- 16 Ja, unë po ju dërgoj si dele në mes të ujçërve; jini, pra, të mënçur si gjarpërinjtë dhe të pastër si pëllumbat.  
*See, I send you out as sheep among wolves. Be then as wise as snakes, and as gentle as doves.*  
 ιδου εγω αποστελλω υμασ ωσ προβατα εν μεσω λυκων γινεσθε ουν φρονιμοι ωσ οι οφεισ και ακεραιοι ωσ αι περιστεραι
- 17 Por ruhuni nga njerëzit, sepse do t'ju zvarrisin përpara sinedrave të tyre dhe do t'ju fshikullojnë në sinagogat e tyre.  
*But be on the watch against men: for they will give you up to the Sanhedrins, and in their Synagogues they will give you blows;*  
 προσεχετε δε απο των ανθρωπων παραδωσουσιν γαρ υμασ εις συνεδρια και εν ταισ συναγωγαισ αυτων μαστιγωσουσιν υμασ
- 18 Dhe do t'ju çojnë përpara guvernatorëve dhe përpara mbretërve për shkakun tim, për të dëshmuar para tyre dhe para johebrenjve.  
*And you will come before rulers and kings because of me, for a witness to them and to the Gentiles.*  
 και επι ηγεμονασ δε και βασιλεισ αχθησεσθε ενεκεν εμου εις μαρτυριον αυτοισ και τοισ εθνεσιν
- 19 Dhe, kur t'ju dorëzojnë në duart e tyre, mos u shqetësoni se çfarë dhe si do të flisni; sepse në atë çast do t'ju jepet se çfarë duhet të thoni;  
*But when you are given up into their hands, do not be troubled about what to say or how to say it: for in that hour what you are to say will be given to you;*  
 οταν δε παραδιωσιν υμασ μη μεριμνησητε πως η τι λαλησητε δοθησεται γαρ υμιν εν εκεινη τη ωρα τι λαλησετε
- 20 sepse nuk do të jeni ju që do të flisni, por Fryma e Atit tuaj që do të flasë në ju.  
*Because it is not you who say the words, but the Spirit of your Father in you.*  
 ου γαρ υμεισ εστε οι λαλουντεσ αλλα το πνευμα του πατροσ υμων το λαλουν εν υμιν
- 21 Tani vëllai do të dorëzojë vëllanë në vdekje dhe ati të birin; dhe bijtë do të çohen kundër prindërve dhe do t'i vrasin.  
*And brother will give up brother to death, and the father his child: and children will go against their fathers and mothers, and put them to death.*  
 παραδωσει δε αδελφοσ αδελφον εις θανατον και πατηρ τεκνον και επαναστησονται τεκνα επι γονεισ και θανατωσουσιν αυτουσ
- 22 Dhe të gjithë do t'ju urrejnë për shkak të emrit tim; por ai që do të qëndrojë deri në fund, do të shpëtojë.  
*And you will be hated by all men because of my name: but he who is strong to the end will have salvation.*  
 και εσεσθε μισουμενοι υπο παντων δια το ονομα μου ο δε υπομεινας εις τελοσ ουτοσ σωθησεται
- 23 Por kur do t'ju përndjekin në një qytet, ikni në një tjetër, sepse në të vërtetë ju them se nuk do të përfundoni së përshkuari qytetet e Izraelit, para se të vijë Biri i njeriut.  
*But when they are cruel to you in one town, go in flight to another: for truly, I say to you, You will not have gone through the towns of Israel before the Son of man comes.*  
 οταν δε διωκωσιν υμασ εν τη πολει ταυτη φεугετε εις την αλλην αμην γαρ λεγω υμιν ου μη τελεσητε τασ πολεισ του ισραηλ εωσ αν ελθη ο υιοσ του ανθρωπου
- 24 Dishpulli nuk del mbi mësuësin, as shërbëtori mbi zotin e tij.  
*A disciple is not greater than his master, or a servant than his lord.*  
 ουκ εστιν μαθητησ υπερ τον διδασκαλον ουδε δουλοσ υπερ τον κυριον αυτου

- 25 I mjafton dishepullit të bëhet si mësuesi i tij dhe shërbëtorit të bëhet si zotëria e tij. Në se të zotin e shtëpisë e quajtën Beelzebub, aq më tepër do t'i quajnë ashtu ata të shtëpisë së tij!  
It is enough for the disciple that he may be as his master, and the servant as his lord. If they have given the name Beelzebub to the master of the house, how much more to those of his house!  
αρκετον τω μαθητη ινα γενηται ως ο διδασκαλος αυτου και ο δουλος ως ο κυριος αυτου ει τον οικοδεσποτην βεελζεβουλ εκαλεσαν ποσω μαλλον τους οικιακους αυτου
- 26 Mos ia kini frikën pra, sepse nuk ka gjë të fshehtë që të mos zbulohet dhe asnjë sekret që nuk do të njihet.  
Have, then, no fear of them: because nothing is covered which will not come to light, or secret which will not be made clear.  
μη ουν φοβηθητε αυτους ουδεν γαρ εστιν κεκαλυμμενον ο ουκ αποκαλυφθησεται και κρυπτον ο ου γνωσθησεται
- 27 Atë që unë ju them në terr, e thoni në dritë; dhe atë që dëgjoni të thënë në vesh, predikojeni mbi çatitë.  
What I say to you in the dark, say in the light: and what comes to your ear secretly, say publicly from the house-tops.  
ο λεγω υμιν εν τη σκοτια ειπατε εν τω φωτι και ο εις το ους ακουετε κηρυξατε επι των δωματων
- 28 Dhe mos kini frikë nga ata që vrasin trupin, por nuk mund të vrasin shpirtin; kini frikë më tepër nga ai që mund t'ua humbë shpirtin dhe trupin në Gehena.  
And have no fear of those who put to death the body, but are not able to put to death the soul. But have fear of him who has power to give soul and body to destruction in hell.  
και μη φοβηθητε απο των αποκτεινοντων το σωμα την δε ψυχην μη δυναμενων αποκτειναι φοβηθητε δε μαλλον τον δυναμενον και ψυχην και σωμα απολεσαι εν γεεννη
- 29 A nuk shiten vallë dy harabela për një aspër? Dhe, megjithatë asnjë prej tyre nuk bie për tokë pa dashjen e Atit tuaj.  
Are not sparrows two a farthing? and not one of them comes to an end without your Father:  
ουχι δυο στρουθια ασσαριου πωλειται και εν εξ αυτων ου πεσειται επι την γην ανευ του πατρος υμων
- 30 Sa për ju, madje edhe të gjitha fjetet e flokëve të kokës suaj janë të numëruara.  
But the hairs of your head are all numbered.  
υμων δε και αι τριχες της κεφαλης πασαι ηριθμημεναι εσιν
- 31 Mos kini frikë, pra; ju vleni më tepër se shumë harabela.  
Then have no fear; you are of more value than a flock of sparrows.  
μη ουν φοβηθητε πολλων στρουθιων διαφερετε υμεις
- 32 Prandaj kushdo që do të më rrëfenjë përpara njerëzve, dhe unë do ta rrëfejë përpara Atit tim që është në qiej.  
To everyone, then, who gives witness to me before men, I will give witness before my Father in heaven.  
πας ουν οστις ομολογησει εν εμοι εμπροσθεν των ανθρωπων ομολογησω καγω εν αυτω εμπροσθεν του πατρος μου του εν ουρανοις
- 33 Por kushdo që do të më mohojë përpara njerëzve, edhe unë do ta mohoj përpara Atit tim që është në qiej".  
But if anyone says before men that he has no knowledge of me, I will say that I have no knowledge of him before my Father in heaven.  
οστις δ αν αρνησηται με εμπροσθεν των ανθρωπων αρνησομαι αυτον καγω εμπροσθεν του πατρος μου του εν ουρανοις
- 34 "Mos mendoni se unë erdha të sjell paqen mbi tokë; nuk erdha të sjell paqen, por shpatën.  
Do not have the thought that I have come to send peace on the earth; I came not to send peace but a sword.  
μη νομισητε οτι ηλθον βαλειν ειρηνην επι την γην ουκ ηλθον βαλειν ειρηνην αλλα μαχαιραν
- 35 Sepse unë erdha ta ndaj birin nga ati, bijën nga nëna, nusen nga vjehrra,  
For I have come to put a man against his father, and the daughter against her mother, and the daughter-in-law against her mother-in-law:  
ηλθον γαρ διχασαι ανθρωπον κατα του πατρος αυτου και θυγατερα κατα της μητρος αυτης και νυμφην κατα της πενθερας αυτης
- 36 dhe armiq e njeriut do të jenë ata të shtëpisë së vet.  
And a man will be hated by those of his house.  
και εχθροι του ανθρωπου οι οικιακοι αυτου
- 37 Ai që e do të atin ose nënën më shumë se unë, nuk është i denjë për mua; dhe ai që e do birin ose bijën më shumë se unë, nuk është i denjë për mua.  
He who has more love for his father or mother than for me is not good enough for me; he who has more love for son or daughter than for me is not good enough for me.  
ο φιλων πατερα η μητερα υπερ εμε ουκ εστιν μου αξιος και ο φιλων υιον η θυγατερα υπερ εμε ουκ εστιν μου αξιος
- 38 Dhe ai që nuk e merr kryqin e vet dhe nuk vjen pas meje, nuk është i denjë për mua.  
And he who does not take his cross and come after me is not good enough for me.  
και ος ου λαμβανει τον σταυρον αυτου και ακολουθει οπισω μου ουκ εστιν μου αξιος

- 39 **Kush do të gjejë jetën e vet, do ta humbasë; por ai që do të humbasë jetën e vet për hirin tim, do ta gjejë përsëri.**  
**He who has the desire to keep his life will have it taken from him, and he who gives up his life because of me will have it given back to him.**  
*ο ευρων την ψυχην αυτου απολεσει αυτην και ο απολεσας την ψυχην αυτου ενεκεν εμου ευρησει αυτην*
- 40 **Ai që ju pranon, më pranon mua; dhe ai që më pranon mua, pranon atë që më ka dërguar.**  
**He who gives honour to you gives honour to me; and he who gives honour to me gives honour to him who sent me.**  
*ο δεχομενος υμας εμε δεχεται και ο εμε δεχομενος δεχεται τον αποστειλαντα με*
- 41 **Ai që pranon një profet në emër të një profeti, do të marrë shpërblimin që i takon profetit; dhe ai që pranon të drejtin në emër të të drejtit, do të marrë shpërblimin që i takon të drejtit.**  
**He who gives honour to a prophet, in the name of a prophet, will be given a prophet's reward; and he who gives honour to an upright man, in the name of an upright man, will be given an upright man's reward.**  
*ο δεχομενος προφητην εις ονομα προφητου μισθον προφητου ληφεται και ο δεχομενος δικαιον εις ονομα δικαιου μισθον δικαιου ληφεται*
- 42 **Dhe kushdo që i jep për të pirë qoftë edhe vetëm një gotë uji të freskët ndonjërit prej këtyre të vegjëlve në emër të një dishepulli, në të vërtetë ju them, që ai nuk do të humbë aspak shpërblimin e tij'.**  
**And whoever gives to one of these little ones a cup of cold water only, in the name of a disciple, truly I say to you, he will not go without his reward.**  
*και ος εαν ποτιση ενα των μικρων τουτων ποτηριον ψυχρου μονον εις ονομα μαθητου αμην λεγω υμιν ου μη απολεση τον μισθον αυτου*
- 1 **Mbasi Jezusi përfundoi dhënien e porosive të tij dymbëdhjetë dishepujve të vet, u largua nga ai vend, për të mësuar dhe për të predikuar në qytetet e tyre.**  
**And it came about that when Jesus had come to the end of giving these orders to his twelve disciples, he went away from there, teaching and preaching in their towns.**  
*και εγενετο οτε ετελεσεν ο ιησους διατασσεων τοις δωδεκα μαθηταις αυτου μεταβη εκειθεν του διδασκειν και κηρυσσειν εν ταις πολεσιν αυτων*
- 2 **Por Gjoni, që kishte dëgjuar në burg të flitej për veprat e Krishtit, dërgoi dy nga dishepujt e vet për t'i thënë:**  
**Now when John had news in prison of the works of the Christ, he sent his disciples**  
*ο δε ιωαννης ακουσας εν τω δεσμωτηριω τα εργα του χριστου πεμψας δυο των μαθητων αυτου*
- 3 **"A je ti ai që duhet të vijë, apo duhet të presim një tjetër?"**  
**To say to him, Are you he who is to come, or are we waiting for another?**  
*ειπεν αυτω συ ει ο ερχομενος η ετερον προσδοκομεν*
- 4 **Dhe Jezusi, duke u përgjigjur, u tha atyre: "Shkoni dhe i tregoni Gjonit gjërat që dëgjoni dhe shikoni:**  
**And Jesus, answering, said to them, Go and give news to John of the things which you are seeing and hearing:**  
*και αποκριθεις ο ιησους ειπεν αυτοις πορευθεντες απαγγειλατε ιωαννη α ακουετε και βλεπετε*
- 5 **Të verbërit po shohin, të çalët po ecin, lebrozët janë pastruar dhe të shurdhërit po dëgjojnë; të vdekurit po ngjallen dhe ungjilli po u predikohet të varfërve.**  
**The blind see; those who were not able to, are walking; lepers are made clean; those who were without hearing, now have their ears open; the dead come to life again, and the poor have the good news given to them.**  
*τυφλοι αναβλεπουσιν και χωλοι περιπατουσιν λεπροι καθαριζονται και κωφοι ακουουσιν νεκροι εγειρονται και πτωχοι ευαγγελιζονται*
- 6 **Lum ai që nuk do të skandalizohet nga unë!"**  
**And a blessing will be on him who has no doubts about me.**  
*και μακαριος εστιν ος εαν μη σκανδαλισθη εν εμοι*
- 7 **Dhe kur ata po largoheshin, Jezusi nisi t'u thotë turmave për Gjonin: "Çfarë keni dalë të shikoni në shkretëtirë? Kallamin që e tund era?**  
**And when they were going away, Jesus, talking of John, said to all the people, What went you out into the waste land to see? a tall stem moving in the wind?**  
*τουτων δε πορευομενων ηρξατο ο ιησους λεγειν τοις οχλοις περι ιωαννου τι εξηλθετε εις την ερημον θεασασθαι καλαμον υπο ανεμου σαλευομενον*
- 8 **Por çfarë keni dalë të shikoni? Njeriun e mbështjellur me rroba të buta? Ja, ata që veshin rroba të buta banojnë në pallatet mbretërore.**  
**But what went you out to see? a man delicately clothed? Those who have fair robes are in kings' houses.**  
*αλλα τι εξηλθετε ιδειν ανθρωπον εν μαλακοις ιματιοις ημφιεσμενον ιδου οι τα μαλακα φορουντες εν τοις οικοις των βασιλεων εισιν*
- 9 **Atëherë, pra, ç'dolët të shikoni? Një profet? Po, ju them: ai është më shumë se një profet.**  
**But why did you go out? to see a prophet? Yes, I say to you, and more than a prophet.**  
*αλλα τι εξηλθετε ιδειν προφητην ναι λεγω υμιν και περισσοτερον προφητου*

- 10 Sepse ky është ai për të cilin është shkruar: &quot;Ja, unë po dërgoj lajmëtarin tim para fytyrës sate; ai do ta bëjë gati rrugën tënde para teje&quot;;  
This is he of whom it has been said, See, I send my servant before your face, who will make ready your way before you.  
ουτος γαρ εστιν περι ου γεγραπται ιδου εγω αποσπελλω τον αγγελον μου προ προσωπου σου ος κατασκευασει την οδον σου εμπροσθεν σου
- 11 Në të vërtetë po ju them: ndër ata që janë lindur prej gruas nuk ka dalë kurrë ndonjë më i madh se Gjon Pagëzori; por më i vogli në mbretërinë e qiejve është më i madh se ai.  
Truly I say to you, Among the sons of women there has not been a greater than John the Baptist: but he who is least in the kingdom of heaven is greater than he.  
αμην λεγω υμιν ουκ εγηγερται εν γεννητοις γυναικων μειζων ιωαννου του βαπτιστου ο δε μικροτερος εν τη βασιλεια των ουρανων μειζων αυτου εστιν
- 12 Dhe qysh nga ditët e Gjon Pagëzorit e deri tash mbretëria e qiejve po pëson dhunë dhe të dhunshmit e grabitën.  
And from the days of John the Baptist till now, the kingdom of heaven is forcing its way in, and men of force take it.  
απο δε των ημερων ιωαννου του βαπτιστου εως αρτι η βασιλεια των ουρανων βιαζεται και βιασται αρπαζουσιν αυτην
- 13 Sepse të gjithë profetët dhe ligji kanë profetizuar deri te Gjoni.  
For all the prophets and the law were in force till John.  
παντες γαρ οι προφηται και ο νομος εως ιωαννου προεφητευσαν
- 14 Dhe, në daçi ta pranoni, ai është Elia, që duhej të vijë.  
And if you are able to see it, this is Elijah who was to come.  
και ει θελετε δεξασθαι αυτος εστιν ηλιας ο μελλων ερχεσθαι
- 15 Kush ka veshë për të dëgjuar, le të dëgjojë!  
He who has ears, let him give ear.  
ο εχων ωτα ακουειν ακουετω
- 16 Por me kë ta krahasoj këtë brez? Ai u ngjan fëmijëve që rrinë në sheshe dhe u drejtohen shokëve të tyre  
But what comparison may I make of this generation? It is like children seated in the market-places, crying out to one another,  
τινι δε ομοιωσω την γενεαν ταυτην ομοια εστιν παιδαριοις εν αγοραις καθημενοις και προσφωνουσιν τοις εταιροις αυτων
- 17 duke thënë: &quot;Ne i kemi rënë fyellit për ju dhe ju nuk kërcyet; nisëm vajin dhe ju nuk u brengosët&quot;;  
We made music for you and you did not take part in the dance; we gave cries of sorrow and you made no signs of grief.  
και λεγουσιν ηυλησαμεν υμιν και ουκ ωρχησασθε εθρηνησαμεν υμιν και ουκ εκοψασθε
- 18 Pra, erdhi Gjoni që as hante, as pinte, dhe ata thonë: &quot;Ai ka një demon&quot;;  
For John came, taking no food or drink, and they say, He has an evil spirit.  
ηλθεν γαρ ιωαννης μητε εσθιων μητε πινων και λεγουσιν δαιμονιον εχει
- 19 Erdhi Biri i njeriut, që ha dhe pi dhe ata thonë: &quot;Ja një grykës dhe një pijanec, miku i tagrambledhësve dhe i mëkatarëve&quot;; Por dituria është justifikuar nga bijtë e vet'.  
The Son of man has come feasting, and they say, See, a lover of food and wine, a friend of tax-farmers and sinners! And wisdom is judged to be right by her works.  
ηλθεν ο υιος του ανθρωπου εσθιων και πινων και λεγουσιν ιδου ανθρωπος φαγος και οινοποτις τελωνων φιλος και αμαρτωλων και εδικαιωθη η σοφια απο των τεκνων αυτης
- 20 Atëherë ai nisi t'i qortojë ato qytete, ku ishte kryer pjesa më e madhe e veprave të fuqishme të tij, sepse ato nuk ishin penduar duke thënë:  
Then he went on to say hard things to the towns where most of his works of power were done, because they had not been turned from their sins.  
τοτε ηρξατο ονειδιζειν τας πολεις εν αις εγενοντο αι πλεισται δυναμεις αυτου οτι ου μετενοησαν
- 21 "Mjerë ti, Korazin! Mjerë ti Betsaida! Sepse, në se në Tiro dhe në Sidon do të ishin kryer veprat e fuqishme që u bënë ndër ju, prej kohësh do të ishin penduar me thes dhe hi.  
- 19 Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë,  
**Go then, and make disciples of all the nations, giving them baptism in the name of the Father and of the Son and of the Holy Spirit:**  
 πορευθεντες ουν μαθητευσατε παντα τα εθνη βαπτιζοντες αυτους εις το ονομα του πατρος και του υιου και του αγιου πνευματος
- 20 dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës. Amen".  
**Teaching them to keep all the rules which I have given you: and see, I am ever with you, even to the end of the world.**  
 διδασκοντες αυτους τηρειν παντα οσα εντειλαμην υμιν και ιδου εγω μεθ υμων ειμι πασας τας ημερας εως της συντελειας του αιωνος αμην
- 1 Fillimi i Ungjillit të Jezu Krishtit, Birit të Perëndisë.  
**The first words of the good news of Jesus Christ, the Son of God.**  
 αρχη του ευαγγελιου ιησου χριστου υιου του θεου
- 2 Ashtu si është shkruar tek profetët: "Ja, unë po dërgoj lajmëtarin tim para fytyrës tënde, i cili do të përgatit udhën tënde përpara teje.  
**Even as it is said in the book of Isaiah the prophet, See, I send my servant before your face, who will make ready your way;**  
 ως γεγραπται εν τοις προφηταις ιδου εγω αποσπελλω τον αγγελον μου προ προσωπου σου ος κατασκευασει την οδον σου εμπροσθεν σου
- 3 Ka një zë që bërtet në shkretëtirë: "Përgatitni udhën e Zotit, drejtoni shtigjet e tij";  
**The voice of one crying in the waste land, Make ready the way of the Lord, make his roads straight;**  
 φωνη βοωντος εν τη ερημω ετοιμασατε την οδον κυριου ευθειας ποιειτε τας τριβους αυτου
- 4 Gjoni erdhi në shkretëtirë duke pagëzuar dhe duke predikuar një pagëzim pendese për faljen e mëkateve.  
**John came, and gave baptism in the waste land, preaching baptism as a sign of forgiveness of sin for those whose hearts were changed.**  
 εγενετο ιωαννης βαπτιζων εν τη ερημω και κηρυσσων βαπτισμα μετανοιας εις αφεσιν αμαρτιων
- 5 Dhe gjithë vendi i Judës dhe ata nga Jeruzalemi shkronin tek ai, dhe pagëzoheshin të gjithë nga ai në lumin Jordan, duke rrëfyer mëkatet e tyre.  
**And there went out to him all the people of Judaea, and all those of Jerusalem, and they were given baptism by him in the river Jordan, saying that they were sinners.**  
 και εξεπορευετο προς αυτον πασα η ιουδαια χωρα και οι ιεροσολυμιται και εβαπτιζοντο παντες εν τω ιορδανη ποταμω υπ αυτου εξομολογουμενοι τας αμαρτιας αυτων
- 6 Por Gjoni ishte i veshur me lesh deveje, mbante një brez lëkure përreth ijëve dhe ushqehet me karkaleca dhe me mjaltë të egër.  
**And John was clothed in camel's hair, with a leather band about him; and his food was locusts and honey.**  
 ην δε ιωαννης ενδεδυμενος τριχας καμηλου και ζωνην δερματινην περι την οσφον αυτου και εσθιων ακριδας και μελι αγριον
- 7 Ai predikonte duke thënë: "Pas meje po vjen një që është më i fortë se unë. Unë nuk jam i denjë as të ulem para tij për t'i zgjidhur lidhësat e sandaleve të tij.  
**And he said to them all, There is one coming after me who is greater than I, whose shoes I am not good enough to undo.**  
 και εκηρυσσεν λεγων ερχεται ο ισχυροτερος μου οπισω μου ου ουκ ειμι ικανος κυψας λυσαι τον ιμαντα των υποδηματων αυτου
- 8 Unë ju pagëzova me ujë, ndërsa ai do t'ju pagëzojë me Frymën e Shenjtë".  
**I have given you baptism with water, but he will give you baptism with the Holy Spirit.**  
 εγω μεν εβαπτισα υμας εν υδατι αυτος δε βαπτισει υμας εν πνευματι αγιω
- 9 Dhe ndodhi në ato ditë që Jezusi erdhi nga Nazareti i Galileës dhe u pagëzua nga Gjoni në Jordan.  
**And it came about in those days, that Jesus came from Nazareth of Galilee, and was given baptism by John in the Jordan.**  
 και εγενετο εν εκειναις ταις ημεραις ηλθεν ιησους απο ναζαρετ της γαλιλαιας και εβαπτισθη υπο ιωαννου εις τον ιορδανη
- 10 Dhe menjëherë, kur po dilte nga uji, pa se qiejtë po hapeshin dhe Fryma po zbriste mbi të si një pëllumb.  
**And straight away, coming up out of the water, he saw the heavens broken open and the Spirit coming down on him as a dove:**  
 και ευθεως αναβαινων απο του υδατος ειδεν σχιζομενους τους ουρανους και το πνευμα ωσει περιστερην καταβαινον επ αυτον

- 11 Dhe një zë erdhi nga qielli: "Ti je Biri im i dashur në të cilin jam kënaqur.  
And a voice came out of heaven, You are my dearly loved Son, with whom I am well pleased.  
και φωνη εγενετο εκ των ουρανων συ ει ο υιος μου ο αγαπητος εν ω ευδοκησα
- 12 Fill pas kësj, Fryma e Shenjtë e çoi në shkretëtirë;  
And straight away the Spirit sent him out into the waste land.  
και ευθως το πνευμα αυτον εκβαλλει εις την ερημον
- 13 dhe qëndroi në shkretëtirë dyzet ditë, i tunduar nga Satanai. Ishte bashkë me bishat dhe engjëjt i shërbenin.  
And he was in the waste land for forty days, being tested by Satan; and he was with the beasts; and the angels took care of him.  
και ην εκει εν τη ερημω ημερας τεσσαρακοντα πειραζομενος υπο του σατανα και ην μετα των θηριων και οι αγγελοι διηκουουν αυτω
- 14 Dhe mbasi e burgosën Gjonin, Jezusi erdhi në Galile duke predikuar ungjillin e mbretërisë së Perëndisë,  
Now after John had been put in prison, Jesus came into Galilee, preaching the good news of God,  
μετα δε το παραδοθηναι τον ιωαννην ηλθεν ο ιησους εις την γαλιλαιαν κηρυσσων το ευαγγελιον της βασιλειας του θεου
- 15 dhe duke thënë: "U mbush koha dhe mbretëria e Perëndisë është afër. Pendohuni dhe besoni ungjillin".  
And saying, The time has come, and the kingdom of God is near: let your hearts be turned from sin and have faith in the good news.  
και λεγων οτι πεπληρωται ο καιρος και ηγγικεν η βασιλεια του θεου μετανοειτε και πιστευετε εν τω ευαγγελιω
- 16 Ndërsa po kalonte gjatë bregut të detit të Galileës, ai pa Simonin dhe Andrean, vëllanë e tij, të cilët po hidhnin rrjetën në det sepse ishin peshkatarë.  
And going by the sea of Galilee, he saw Simon, and Andrew, the brother of Simon, putting a net into the sea: for they were fishermen.  
περιπατων δε παρα την θαλασσαν της γαλιλαιας ειδεν σιμωνα και ανδρεαν τον αδελφον αυτου βαλλοντας αμφιβληστρον εν τη θαλασση ησαν γαρ αλιεις
- 17 Dhe Jezusi u tha atyre: "Ndiqëni dhe unë do t'ju bëj peshkatarë njerëzish".  
And Jesus said to them, Come after me, and I will make you fishers of men.  
και ειπεν αυτοις ο ιησους δευτε οπισω μου και ποιησω υμας γενεσθαι αλιεις ανθρωπων
- 18 Dhe ata i lanë menjëherë rrjetat dhe e ndoqën.  
And they went straight from their nets, and came after him.  
και ευθως αφεντες τα δικτυα αυτων ηκολουθησαν αυτω
- 19 Mbasi eci edhe pak, pa Jakobin, bir in e Zebedeut dhe Gjonin, vëllanë e tij, të cilët ndreqnin rrjetat e tyre në barkë.  
And going on a little farther, he saw James, the son of Zebedee, and John his brother, who were in their boat stitching up their nets.  
και προβας εκειθεν ολιγον ειδεν ιακωβον τον του ζεβεδαιου και ιωαννην τον αδελφον αυτου και αυτους εν τω πλοιω καταρτιζοντας τα δικτυα
- 20 Dhe i thirri menjëherë; dhe ata e lanë atin e tyre Zebedeun në barkë me mëditësit dhe e ndoqën.  
And he said, Come after me: and they went away from their father Zebedee, who was in the boat with the servants, and came after him.  
και ευθως εκαλεσεν αυτους και αφεντες τον πατερα αυτων ζεβεδαιον εν τω πλοιω μετα τωνμισθωτων απηλθον οπισω αυτου
- 21 Pastaj hynë në Kapernaum dhe menjëherë, ditën e shtunë, ai hyri në sinagogë dhe i mësonte njerëzit.  
And they came to Capernaum; and on the Sabbath he went into the Synagogue and gave teaching.  
και εισπορευονται εις καπερναουμ και ευθως τοις σαββασιν εισελθων εις την συναγωγην εδιδασκεν
- 22 Dhe njerëzit habiteshin nga doktrina e tij, sepse ai i mësonte si një që ka pushtet dhe jo si skribët.  
And they were full of wonder at his teaching, because he gave it as one having authority, and not like the scribes.  
και εξεπλησσοντο επι τη διδαχη αυτου ην γαρ διδασκων αυτους ως εξουσιαν εχων και ουχ ως οι γραμματαις
- 23 Atëherë në sinagogën e tyre ishte një njeri i pushtuar nga një frymë e ndyrë, i cili filloi të bërtasë,  
And there was in their Synagogue a man with an unclean spirit; and he gave a cry,  
και ην εν τη συναγωγη αυτων ανθρωπος εν πνευματι ακαθαρτω και ανεκραζεν
- 24 duke thënë: "Ç'ka midis nesh dhe teje, o Jezus Nazareas? A erdhe të na shkatërrosh? Unë e di kush je: I Shenjti i Perëndisë".  
Saying, What have we to do with you, Jesus of Nazareth? have you come to put an end to us? I see well who you are, the Holy One of God.  
λεγων εα τι ημιν και σοι ιησου ναζαρηνη ηλθες απολεσαι ημας οйда σε τις ει ο αγιος του θεου

- 25 Por Jezusi e qortoi duke thënë: "Hesht dhe dil prej tij!".  
And Jesus said to him sharply, Be quiet, and come out of him.  
και επιτιμησεν αυτω ο ιησους λεγων φιμωθητι και εξελθε εξ αυτου
- 26 Dhe fryma e ndyrë, mbasi e sfiliti, dhe duke lëshuar një britmë të madhe doli prej tij.  
And the unclean spirit, shaking him violently, and crying with a loud voice, came out of him.  
και σπαραξαν αυτον το πνευμα το ακαθαρτον και κραξαν φωνη μεγαλη εξηλθεν εξ αυτου
- 27 Dhe të gjithë u mahnitën aq shumë sa pyesnin njeri tjetrin duke thënë: "Vallë ç'është kjo? Cfarë doktrinë e re qënka kjo? Ky i urdhëroka me autoritet edhe frymërat e ndyra, dhe ata i binden".  
And they were all greatly surprised, so that they put questions to one another, saying, What is this? a new teaching! with authority he gives orders even to the unclean spirits, and they do what he says.  
και εθαμβηθησαν παντες ωστε συζητειν προς αυτους λεγοντας τι εστιν τουτο τις η διδαχη η καινη αυτη οτι κατα εξουσιαν και τοις πνευμασις τοις ακαθαρτοις επιτασσει και υπακουουσιν αυτω
- 28 Dhe fama e tij u përhap menjëherë në mbarë krahinën përreth Galileës.  
And news of him went out quickly everywhere into all parts of Galilee round about.  
εξηλθεν δε η ακοη αυτου ευθως εις ολην την περιχωρον της γαλιλαιας
- 29 Sapo dolën nga sinagoga, erdhën në shtëpinë e Simonit dhe të Andreas, me Jakobin dhe Gjonin.  
And when they came out of the Synagogue, they went into the house of Simon and Andrew, with James and John.  
και ευθεως εκ της συναγωγης εξελθοντες ηλθον εις την οικιαν σιμωνος και ανδρεου μετα ιακωβου και ιωαννου
- 30 Vjehrra e Simonit ishte në shtrat me ethe dhe ata menjëherë i folën për të.  
Now Simon's wife's mother was ill, with a burning heat; and they gave him word of her:  
η δε πενθερα σιμωνος κατεκειτο πυρεσσοσα και ευθεως λεγουσιν αυτω περι αυτης
- 31 Atëherë ai u afrua, e kapi për dore dhe e ngriti. Menjëherë ethet e lanë dhe ajo nisi t'u shërbejë.  
And he came and took her by the hand, lifting her up; and she became well, and took care of their needs.  
και προσελθων ηγειρεν αυτην κρατησας της χειρος αυτης και αφικεν αυτην ο πυρετος ευθεως και διηκονει αυτοις
- 32 Në mbrëmje, pas perëndimit të diellit, i pranë të gjithë të sëmurit dhe të idemonizuarit.  
And in the evening, at sundown, they took to him all who were diseased, and those who had evil spirits.  
οψιας δε γενομενης οτε εδου ο ηλιος εφερον προς αυτον παντας τους κακως εχοντας και τους δαμονιζομενους
- 33 Dhe gjithë qyteti ishte mbledhur përpara derës.  
And all the town had come together at the door.  
και η πολις ολη επισυνηγμενη ην προς την θυραν
- 34 Ai shëroi shumë, që lëngonin nga sëmundje të ndryshme, dhe dëboi shumë demonë; dhe nuk i lejoi demonët të flasin, sepse ata e njihnin.  
And a number, who were ill with different diseases, he made well, and sent out evil spirits; but he did not let the evil spirits say anything, because they had knowledge of him.  
και εθεραπευσεν πολλους κακως εχοντας ποικιλαις νοσοις και δαμονια πολλα εξεβαλεν και ουκ ηφιεν λαλειν τα δαμονια οτι ηδεισαν αυτον
- 35 Pastaj, të nesërmen në mëngjes, kur ende ishte shumë errët, Jezusi u ngrit, doli dhe shkoi në një vend të vetmuar dhe atje u lut.  
And in the morning, a long time before daylight, he got up and went out to a quiet place, and there he gave himself up to prayer.  
και πρωι εννυχον λιαν αναστας εξηλθεν και απηλθεν εις ερημον τοπον κακει προσηυχετο
- 36 Dhe Simoni dhe ata që ishin me të e kërkonin.  
And Simon and those who were with him came after him.  
και κατεδιωξαν αυτον ο σιμων και οι μετ αυτου
- 37 Dhe, kur e gjetën, i thanë: "Të gjithë po të kerkojnë!".  
And when they came up with him, they said to him, Everyone is looking for you.  
και ευροντες αυτον λεγουσιν αυτω οτι παντες ζητουσιν σε
- 38 Dhe ai u tha atyre: "Lë të shkojmë në fshatrat e afërm që të predikoj edhe atje, sepse për këtë kam ardhur".  
And he said to them, Let us go to other parts into the nearest towns, so that I may give teaching there, because for this purpose I came.  
και λεγει αυτοις αγωμεν εις τας εχομενας κωμοπολεις ινα κακει κηρυξω εις τουτο γαρ εξηληλυθα

- 39 Dhe ai e përshkoi gjithë Galilenë duke predikuar nëpër sinagogat e tyre dhe duke dëbuar demonët.  
And he went into their Synagogues in every part of Galilee, preaching and driving out evil spirits.  
και ην κηρυσσων εν ταις συναγωγαίς αυτων εις ολην την γαλιλιαν και τα δαιμονια εκβαλλων
- 40 Dhe erdhi tek ai një lebroz i cili, duke iu lutur, ra në gjunj dhe i tha: "Po të duash, ti mund të më pastrosh".  
And a leper came to him and, going down on his knees before him, made a request, saying, If it is your pleasure, you have the power to make me clean.  
και ερχεται προς αυτον λεπρος παρακαλων αυτον και γονυπετων αυτον και λεγων αυτω οτι εαν θελης δυνασαι με καθαρισαι
- 41 Dhe Jezusi, duke e mëshiruar, shtriu dorën, e preku dhe i tha: "Po, e dua, qofsh pastruar!".  
And being moved with pity, he put out his hand, and touching him said to him, It is my pleasure; be made clean.  
ο δε ιησους σπλαγγισθεις εκτεινας την χειρα ηψατο αυτου και λεγει αυτω θελω καθαρισθητι
- 42 Dhe, posa tha këto, menjëherë lebra e la dhe u shërua.  
And straight away the disease went from him, and he was made clean.  
και ειποντος αυτου ευθεως απηλθεν απ αυτου η λεπρα και εκαθαρισθη
- 43 Pastaj, mbasi e paralajmëroi rreptësisht, menjëherë e largoi,  
And he sent him away, saying to him very sharply,  
και εμβριμησαμενος αυτω ευθεως εξεβαλεν αυτον
- 44 duke i thënë: "Ruhu se i tregon gjë ndokujt, por shko, paraqitu te prifti dhe ofro për pastrimin tënd sa ka urdhëruar Moisiu, si dëshmi për ta".  
See that you say nothing to any man: but go and let the priest see you, and make yourself clean by an offering of the things ordered by Moses, for a witness to them.  
και λεγει αυτω ορα μηδενι μηδεν ειπης αλλ υπαγε σεαυτον δειξον τω ιερει και προσενεγκε περι του καθαρισμου σου α προσεταξεν μοωσις εις μαρτυριον αυτοις
- 45 Por ai, sapo doli, filloi ta shpallë dhe ta përhapë fort faktin, sa që Jezusi nuk mund të hynte më publikisht në qytet, por qëndronte përjashta nëpër vende të vetmuara; dhe nga çdo anë vinin tek ai.  
But he went out, and made it public, giving an account of it everywhere, so that Jesus was no longer able to go openly into a town, but was outside in the waste land; and they came to him from every part.  
ο δε εξελθων ηρξατο κηρυσσειν πολλα και διαφημιζειν τον λογον ωστε μηκετι αυτον δυνασθαι φανερωσ εις πολιν εισελθειν αλλ εξω εν ερημοις τοποις ην και ηρχοντο προς αυτον πανταχοθεν
- 1 Pas disa ditësh, ai erdhi përsëri në Kapernaum dhe u muar vesh se ai gjendej në shtëpi;  
And when he came into Capernaum again after some days, the news went about that he was in the house.  
και παλιν εισηλθεν εις καπερναουμ δι ημερων και ηκουσθη οτι εις οικον εστιν
- 2 dhe menjëherë u mbledhën aq shumë njerëz, sa nuk gjeje më vend as përpara derës; dhe ai u predikonte Fjalën.  
And a great number had come together, so that there was no longer room for them, no, not even about the door: and he gave them teaching.  
και ευθεως συνηχθησαν πολλοι ωστε μηκετι χωρειν μηδε τα προς την θυραν και ελαλει αυτοις τον λογον
- 3 Atëherë i erdhën disa që i paraqitën një të paralizuar, që po e bartnin katër vetë.  
And four men came to him with one on a bed who had no power of moving.  
και ερχονται προς αυτον παραλυτικον φεροντες αιρομενον υπο τεσσαρων
- 4 Por, duke qenë se nuk mund t'i afroreshin për shkak të turmës, zbuluan çatinë në vendin ku ndodhej Jezusi dhe, mbasi hapën një vrimë, e lëshuan vigun mbi të cilin rrinte shtrirë i paralizuari.  
And when they were unable to get near him because of all the people, they got the roof uncovered where he was: and when it was broken up, they let down the bed on which the man was.  
και μη δυναμενοι προσεγγισαι αυτω δια τον οχλον απεστεργασαν την στεγην οπου ην και εξορυξαντες χαλωσιν τον κραββατον εφ ω ο παραλυτικος κατεκειτο
- 5 Jezusi, kur pa besimin e tyre, i tha të paralizuarit: "O bir, mëkatet e tua të janë falur!".  
And Jesus, seeing their faith, said to him, Son, you have forgiveness for your sins.  
ιδων δε ο ιησους την πιστιν αυτων λεγει τω παραλυτικω τεκνον αφεωνται σοι αι αμαρτια σου
- 6 Por aty po rrinin ulur disa shkribë, të cilët, në zemër të vet, po mendonin:  
But there were certain of the scribes seated there, and reasoning in their hearts,  
ησαν δε τινες των γραμματεων εκει καθημενοι και διαλογιζομενοι εν ταις καρδιας αυτων
- 7 "Pse vallë ky po flet blasfemi. Kush mund të falë mëkatet, veç Perëndisë vetë?".  
Why does this man say such things? he has no respect for God: from whom does forgiveness come but from God only?  
τι ουτος ουτως λαλει βλασφημιας τις δυναται αφιεναι αμαρτιας ει μη εις ο θεος



- 8 Por Jezusi, i cili menjëherë kuptoi në frymën e vet se ata po i mendonin këto gjëra në veten e tyre, u tha atyre: "Pse i mendoni këto gjëra në zemrat tuaja?  
And Jesus, having knowledge in his spirit of their thoughts, said to them, Why are you reasoning about these things in your hearts?  
και ευθεως επιγινους ο ιησους τω πνευματι αυτου οτι ουτως διαλογιζονται εν εαυτοις ειπεν αυτοις τι ταυτα διαλογιζεσθε εν ταις καρδιαις υμων
- 9 Çfarë është më lehtë: t'i thuash të paralizuarit: "Mëkatet e tua të janë falur", apo t'i thuash: "Çohu, merre vigun tënd dhe ec"  
Which is the simpler, to say to a man who is ill, You have forgiveness for your sins, or, Get up, take up your bed, and go?  
τι εστιν ευκοπωτερον ειπειν τω παραλυτικω αφεωνται σοι αι αμαρτια η ειπειν εγειραι και αρον σου τον κραββατον και περιπατει
- 10 Dhe tani, që ta dini se Biri i njeriut ka pushtet të falë mëkatet mbi dhe,  
But so that you may see that the Son of man has authority for the forgiveness of sins on earth, (he said to the man,)  
ινα δε ειδητε οτι εξουσιαν εχει ο υιος του ανθρωπου αφιεναι επι της γης αμαρτιας λεγει τω παραλυτικω
- 11 unë po të them (i tha të paralizuarit): Çohu, merre vigun tënd dhe shko në shtëpinë tënde!"  
I say to you, Get up, take up your bed, and go to your house.  
σοι λεγω εγειραι και αρον τον κραββατον σου και υπαγε εις τον οικον σου
- 12 Dhe ai u ngrit menjëherë, mori vigun e vet dhe doli përjashta në praninë e të gjithëve dhe kështu të gjithë u habitën dhe lëvduan Perëndinë duke thënë: "Një gjë të tillë s'e kemi parë kurrë!"  
And he got up, and straight away took up the bed and went out before them all, so that they were all full of wonder, and gave glory to God, saying, We have never seen anything like this.  
και ηγερω ευθεως και αρας τον κραββατον εξηλθεν εναντιον παντων ωστε εξιστασθαι παντας και δοξαζειν τον θεον λεγοντας οτι ουδεποτε ουτως ειδομεν
- 13 Jezusi doli përsëri gjatë bregut të detit dhe gjithë turma erdhi tek ai dhe ai e mësonte.  
And he went out again by the seaside; and all the people came to him, and he gave them teaching.  
και εξηλθεν παλιν παρα την θαλασσαν και πας ο οχλος ηρχετο προς αυτον και εδιδασκεν αυτους
- 14 Duke kaluar, pa Levin, birin e Alfeut, i cili qe ulur në vendin e tatimeve, dhe i tha: "Ndiqme!". Ai u ngrit dhe e ndoqi.  
And when he went by, he saw Levi, the son of Alphaeus, seated at the place where taxes were taken, and he said to him, Come with me. And he got up, and went with him.  
και παραγων ειδεν λεβιν τον του αλφαιου καθημενον επι το τελωνιον και λεγει αυτω ακολουθει μοι και αναστας ηκολουθησεν αυτω
- 15 Dhe ndodhi që, kur Jezusi ishte në tryezë në shtëpinë e Levit, shumë tagrambledhës dhe mëkatarë u ulën në tryezë me Jezusin dhe me dishepujt e tij; në fakt ishin shumë ata që e ndiqnin.  
And it came about that he was seated at meat in his house, and a number of tax-farmers and sinners were at table with Jesus and his disciples: for there were a great number of them, and they came after him.  
και εγενετο εν τω κατακεισθαι αυτον εν τη οικια αυτου και πολλοι τελωναι και αμαρτωλοι συνανεκειντο τω ιησου και τοις μαθηταις αυτου ησαν γαρ πολλοι και ηκολουθησαν αυτω
- 16 Atëherë skribët dhe farisenjtë, duke e parë se po hante me tagrambledhës dhe me mëkatarë, u thanë dishepujve të tij: "Qysh ha dhe pi ai bashkë me tagrambledhës e me mëkatarë?"  
And the scribes of the Pharisees, when they saw that he was taking food with the tax-farmers and sinners, said to his disciples, Why does he take food and drink with such men?  
και οι γραμματαις και οι φαρισαιοι ιδοντες αυτον εσθιοντα μετα των τελωνων και αμαρτωλων ελεγον τοις μαθηταις αυτου τι οτι μετα των τελωνων και αμαρτωλων εσθιει και πινει
- 17 Dhe Jezusi, kur e dëgjoi, u tha atyre: "Nuk janë të shëndoshet që kanë nevojë për mjekun, por të sëmurët; unë nuk erdha për të thirrur të drejtët, por mëkatarët për pendim.  
And Jesus, hearing it, said to them, Those who are well have no need of a medical man, but those who are ill: I have come not to get the upright but sinners.  
και ακουσας ο ιησους λεγει αυτοις ου χριειαν εχουσιν οι ισχυροντες ιατρον αλλ οι κακως εχοντες ουκ ηλθον καλεσαι δικαιους αλλα αμαρτωλους εις μετανοιαν
- 18 Atëherë dishepujt e Gjonit dhe ata të farisenjve po agjëronin. Ata erdhen te Jezusi dhe i thanë: "Përse dishepujt e Gjonit dhe ata të farisenjve agjërojnë, kurse dishepujt e tu nuk agjërojnë?"  
And John's disciples and the Pharisees were taking no food: and they came and said to him, Why do John's disciples and the disciples of the Pharisees go without food, but your disciples do not?  
και ησαν οι μαθηται ιωαννου και οι των φαρισαιων νηστευοντες και ερχονται και λεγουσιν αυτω διατι οι μαθηται ιωαννου και οι των φαρισαιων νηστεουσιν οι δε σοι μαθηται ου νηστεουσιν
- 19 Dhe Jezusi u përgjigj atyre: "Vallë a mund të agjërojnë dasmorët, ndërsa dhëndri është me ta? Për sa kohë kanë më vete dhëndrin, nuk mund të agjërojnë!"  
And Jesus said to them, Will the friends of a newly-married man go without food while he is with them? as long as they have him with them they will not go without food.  
και ειπεν αυτοις ο ιησους μη δυνανται οι υιοι του νυμφωνος εν ω ο νυμφιος μετ αυτων εστιν νηστευειν οσον χρονον μεθ εαυτων εχουσιν τον νυμφιον ου δυνανται νηστευειν
- 20 Por do të vijnë ditët kur do t'u merret dhëndri dhe atëherë, në ato ditë, ata do të agjërojnë.  
But the days will come when the husband will be taken away from them, and then they will go without food.  
ελευσονται δε ημεραι οταν απαρθη απ αυτων ο νυμφιος και τοτε νηστεουσιν εν εκειναις ταις ημεραις
- 21 Askush nuk qep një copë stof të ri mbi një rrobe të vjetër, përndryshe copa e re e shkul gjithë arnesën dhe shqyerja bëhet më keq.  
No man puts a bit of new cloth on an old coat: or the new, by pulling away from the old, makes a worse hole.  
και ουδεις επιβλημα ρακουσ αγναφου επιριραπει επι ιματιω παλαιω ει δε μη αιρει το πληρωμα αυτου το καινον του παλαιου και χειρον σχισμα γινεται

- 22 Po ashtu askush nuk shtie verë të re në kacekë të vjetër, përndryshe vera e re i prish kacekët, vera derdhet dhe kacekët shkojnë në dëm; porse vera e re duhet shtënë në kacekë të rinj".  
*And no man puts new wine into old wine-skins: or the skins will be burst by the wine, and the wine and the skins will be wasted: but new wine has to be put into new wine-skins.*  
 και ουδεις βαλλει οινον νεον εις ασκους παλαιους ει δε μη ρησσει ο οινος ο νεος τους ασκους και ο οινος εκχειται και οι ασκοι απολουνται αλλα οινον νεον εις ασκους καινους βλητεον
- 23 Por ndodhi që një ditë të shtunë ai po kalonte nëpër ara dhe dishepujt e tij, duke kaluar, filluan të këpusin kallingj.  
*And it came about that on the Sabbath day he was going through the grain-fields; and while they were walking, his disciples took the heads of grain.*  
 και εγενετο παραπορευεσθαι αυτον εν τοις σαββασιν δια των σποριμων και ηρξαντο οι μαθηται αυτου οδον ποιειν τιλλοντες τους σταχυας
- 24 Dhe farisenjtë i thanë: "Shih, përse po bëjnë atë që nuk është e ligjshme ditën e shtunë?".  
*And the Pharisees said to him, Why are they doing what it is not right to do on the Sabbath?*  
 και οι φαρισαιοι ελεγον αυτω ιδε τι ποιουσιν εν τοις σαββασιν ο ουκ εξεστιν
- 25 Por ai u tha atyre: "A nuk keni lexuar vallë ç'bëri Davidi, kur pati nevojë dhe kishte uri, ai dhe ç'qenë me të?".  
*And he said to them, Have you no knowledge of what David did, when he had need and was without food, he, and those who were with him?*  
 και αυτος ελεγεν αυτοις ουδεποτε ανεγνωτε τι εποιησεν δαβιδ οτε χρειαν εσχεν και επεινασεν αυτος και οι μετ αυτου
- 26 Se si hyri ai në shtëpinë e Perëndisë në kohën e kryepfritit Abiathar, dhe hëngri bukët e paraqitjes, të cilat nuk lejohet t'i hajë askush, përveç priftërinjve, dhe u dha edhe atyre që qenë me të?".  
*How he went into the house of God when Abiathar was high priest, and took for food the holy bread, which only the priests may take, and gave it to those who were with him?*  
 πως εισηλθεν εις τον οικον του θεου επι αβιαθαρ του αρχιερεως και τους αρτους της προθεσεως εφαγην ους ουκ εξεστιν φαγειν ει μη τοις ιερευσιν και εδωκεν και τοις συν αυτω ουσιν
- 27 Pastaj u tha atyre: "E shtuna është bërë për njeriun dhe jo njeriu për të shtunë.  
*And he said to them, The Sabbath was made for man, and not man for the Sabbath;*  
 και ελεγεν αυτοις το σαββατον δια τον ανθρωπον εγενετο ουχ ο ανθρωπος δια το σαββατον
- 28 Prandaj Biri i njeriut është zot edhe i së shtunës".  
*So that the Son of man is lord even of the Sabbath.*  
 ωστε κυριος εστιν ο υιος του ανθρωπου και του σαββατου
- 1 Pastaj ai hyri përsëri në sinagogë dhe aty ishte një njeri që kishte një dorë të tharë.  
*And he went again into the Synagogue; and there was a man there whose hand was dead.*  
 και εισηλθεν παλιν εις την συναγωγην και ην εκει ανθρωπος εξηραμμενην εχων την χειρα
- 2 Dhe ata po e ruanin në se do ta shëronte në ditën e së shtunës, që pastaj ta paditnin.  
*And they were watching him to see if he would make him well on the Sabbath day, so that they might have something against him.*  
 και παρατηρουν αυτον ει τοις σαββασιν θεραπευσει αυτον ινα κατηγορησωσιν αυτου
- 3 Dhe ai i tha njeriut që e kishte dorën të tharë: "Çohu në mes të të gjithëve!".  
*And he said to the man, Get up and come forward.*  
 και λεγει τω ανθρωπω τω εξηραμμενην εχοντι την χειρα εγειραι εις το μεσον
- 4 Dhe u tha atyre: "A është e lejueshme ditën e së shtunës të bësh të mirë apo të keqe, të shpëtosh një jetë apo ta vrasësh?". Por ata heshtnin.  
*And he said to them, Is it right to do good on the Sabbath or to do evil? to give life or to put to death? But they said nothing.*  
 και λεγει αυτοις εξεστιν τοις σαββασιν αγαθοποιησαι η κακοποιησαι ψυχην σωσαι η αποκτειναι οι δε εσιωπων
- 5 Atëherë ai, si i shikoi rreth e qark me zemërim, i hidhëruar për ngurtësinë e zemrës së tyre, i tha atij njeriu: "Shtrije dorën tënde!". Ai e shtriu, dhe dora e tij u shëndosh përsëri si tjetra.  
*And looking round on them he was angry, being sad because of their hard hearts; and he said to the man, Put out your hand. And he put it out, and his hand was made well.*  
 και περιβλεψαμενος αυτους μετ οργης συλλυπουμενος επι τη πορωσει της καρδιας αυτων λεγει τω ανθρωπω εκτεινον την χειρα σου και εξετεινεν και αποκατεσταθη η χειρ αυτου υγιης ως η αλλη
- 6 Dhe farisenjtë dolën jashtë e menjëherë bënin këshill bashkë me herodianët kundër tij, se si ta vrasin.  
*And the Pharisees went out, and straight away made designs with the Herodians about how they might put him to death.*  
 και εξελθοντες οι φαρισαιοι ευθεως μετα των ηρωδιανων συμβουλιον εποιουν κατ αυτου οπως αυτον απολεσωσιν
- 7 Por Jezusi me dishepujt e vet u tërhoq drejt detit; dhe një turmë e madhe nga Galilea i ndoqi; edhe nga Judea;  
*And Jesus went away with his disciples to the sea, and a great number from Galilee came after him: and from Judaea,*  
 και ο ιησους ανεχωρησεν μετα των μαθητων αυτου προς την θαλασσαν και πολυ πληθος απο της γαλιλαιας ηκολουθησαν αυτω και απο της ιουδαιας

- 8 dhe nga Jeruzalemi, nga Idumea, nga përtej Jordanit; gjithashtu një turmë e madhe nga rrethinat Etiros dhe të Sidonit, kur dëgjoji gjërat e medha që ai bënte, erdhi tek ai.  
*And from Jerusalem, and from Idumaea, and the other side of Jordan, and the country about Tyre and Sidon, a great number, hearing what great things he did, came to him.*  
 και απο ιεροσολυμων και απο της ιδουμαιας και περαν του ιορδανου και οι περι τυρον και σιδωνα πληθος πολυ ακουσαντες οσα εποιει ηλθον προς αυτον
- 9 Atëherë ai u tha dishepujve të tij të kenë gjithnjë gati një barkë, që populli mos e shtynte.  
*And he made a request to his disciples to have a little boat ready for him, so that he might not be crushed by the people;*  
 και ειπεν τοις μαθηταις αυτου ινα πλοιαριον προσκαρτερη αυτω δια τον οχλον ινα μη θλιβωσιν αυτον
- 10 Sepse ai kishte shëruar shumë veta, të gjithë që kishin sëmundje dyndeshin rreth tij që ta preknin.  
*For he had made such a great number well that all those who were diseased were falling down before him for the purpose of touching him.*  
 πολλους γαρ εθεραπευσεν ωστε επιπιπτεν αυτω ινα αυτου αφωνται οσοι ειχον μαστιγας
- 11 Dhe frymërat e ndyrë, kur e shihnin, binin përmbys para tij dhe bërtitnin, duke thënë: "Ti je Biri i Perëndisë!".  
*And the unclean spirits, whenever they saw him, went down before him, crying out, and saying, You are the Son of God.*  
 και τα πνευματα τα ακαθαρτα οταν αυτον εθεωρει προσεπιπτεν αυτω και εκραζεν λεγοντα οτι συ ει ο υιος του θεου
- 12 Por ai i qortoi rreptësisht që të mos thonin se kush ishte ai.  
*And he gave them special orders not to say who he was.*  
 και πολλα επετιμα αυτοις ινα μη αυτον φανερον ποιησωσιν
- 13 Pastaj ai u ngjit në mal dhe thirri pranë vetes ata që dëshiroi. Dhe ata erdhën tek ai.  
*And he went up into the mountain, and sent for those whom it was his pleasure to have with him: and they went to him.*  
 και αναβαινει εις το ορος και προσκαλειται ους ηθελεν αυτος και απηλθον προς αυτον
- 14 Dhe ai i caktoi dymbëdhjetë që të rrinin me të dhe që mund t'i dërgonte të predikojnë,  
*And he took twelve to be with him, so that he might send them out as preachers,*  
 και εποιησεν δωδεκα ινα ωσιν μετ αυτου και ινα αποστελλη αυτους κηρυσσειν
- 15 dhe të kishin pushtet të shëronin sëmundjet dhe të dëbonin demonët.  
*And give them the power of driving out evil spirits:*  
 και εχειν εξουσιαν θεραπειν τας νοσους και εκβαλλειν τα δαιμονια
- 16 Ata ishin: Simoni, të cilit ia vuri emrin Pjetër;  
*To Simon he gave the second name of Peter;*  
 και επεθηκεν τω σιμωνι ονομα πετρον
- 17 Jakobi, biri i Zebedeut, dhe Gjoni, vëllai i Jakobit, të cilave ua vuri emrin Boanerges, që do të thotë: "Bij të bubullimës";  
*And to James, the son of Zebedee, and John, the brother of James, he gave the second name of Boanerges, which is, Sons of thunder:*  
 και ιακωβον τον του ζεβεδαιου και ιωαννην τον αδελφον του ιακωβου και επεθηκεν αυτοις ονοματα βοανεργες ο εστιν υιοι βροντης
- 18 Andrea, Filipi, Bartolomeu, Mateu, Thomai, Jakobi i Alfeut, Tadeu, Simon Kananeasi,  
*And Andrew, and Philip, and Bartholomew, and Matthew, and Thomas, and James, the son of Alphaeus, and Thaddaeus, and Simon the Zealot;*  
 και ανδραν και φιλιππον και βαρθολομαιον και ματθαιον και θωμαν και ιακωβον τον του αλφαιου και θαδδαιον και σιμωνα τον κανανιτην
- 19 dhe Juda Iskarioti, i cili më pas e tradhëtoi.  
*And Judas Iscariot, who was false to him.*  
 και ιουδαν ισκαριωτην ος και παρεδωκεν αυτον και ερχονται εις οικον
- 20 Pastaj hynë në një shtëpi. Dhe u mbledhën përsëri një turmë aq e madhe, sa që as bukë s'mund të hanin.  
*And he went into a house. And the people came together again, so that they were not even able to take bread.*  
 και συνερχεται παλιν οχλος ωστε μη δυνασθαι αυτους μητε αρτον φαγειν
- 21 Dhe kur të afërmit e tij e morën vesh, shkuan ta marrin atë, sepse flitej: "Nuk është në vete".  
*And when his friends had news of it, they went out to get him, saying, He is off his head.*  
 και ακουσαντες οι παρ αυτου εξηλθον κρατησαι αυτον ελεγον γαρ οτι εξεστη

- 22 Kurse skribët, që kishin zbritur nga Jeruzalemi, thoshnin: "Ai e ka Beelzebubin dhe i dëbon demonët me princin e demonëve".  
And the scribes who came down from Jerusalem, said, He has Beelzebub, and, By the ruler of evil spirits he sends evil spirits out of men.  
και οι γραμματεις οι απο ιεροσολμων καταβαντες ελεγον οτι βεελζεβουλ εχει και οτι εν τω αρχοντι των δαιμονιων εκβαλλει τα δαιμονια
- 23 Por ai i thirri pranë vetes dhe u foli me anë të shëmbëlltyrave: "Si mund Satanai të dëbojë Satananë?  
And turning to them, he said to them in the form of a story, How is it possible for Satan to put out Satan?  
και προσκαλεσαμενος αυτους εν παραβολαις ελεγεν αυτοις πως δυναται σατανας σαταναν εκβαλλειν
- 24 Në qoftë se një mbretëri është përçarë kundër vetvetes, ajo mbretëri nuk mund të qëndrojë.  
If there is division in a kingdom, that kingdom will come to destruction;  
και εαν βασιλεια εφ εαυτην μερισθη ου δυναται σταθηναι η βασιλεια εκεινη
- 25 Dhe në qoftë se një shtëpi përçahet kundër vetvetes, ajo shtëpi nuk mund të qëndrojë.  
And if there is division in a house, that house will come to destruction;  
και εαν οικια εφ εαυτην μερισθη ου δυναται σταθηναι η οικια εκεινη
- 26 Kështu, në se Satanai ngrihet kundër vetvetes dhe është përçarë, nuk mbahet dot, por i erdhi fundi!  
And if Satan is at war with himself, and there is division in him, he will not keep his place but will come to an end.  
και ει ο σατανας ανεστη εφ εαυτον και μεμερισται ου δυναται σταθηναι αλλα τελος εχει
- 27 Askush nuk mund të hyjë në shtëpinë e njeriut të fortë dhe t'ia grabitë pasuritë e tij, pa e lidhur më parë njeriun e fortë; vetëm atëherë mund t'ia plaçkitë shtëpinë.  
But no one is able to go into the house of the strong man and take his goods, without first putting cords round the strong man, and then he will take his goods.  
ου δυναται ουδεις τα σκευη του ισχυρου εισελθων εις την οικιαν αυτου διαρπασαι εαν μη πρωτον τον ισχυρον δηση και τοτε την οικιαν αυτου διαρπασει
- 28 Në të vërtetë po ju them se bijve të njerëzve do t'u falet çfarëdo mëkat dhe çdo blasfemi që do të thonë;  
Truly, I say to you, The sons of men will have forgiveness for all their sins and for all the evil words they say:  
αμην λεγω υμιν οτι παντα αφεθησεται τα αμαρτηματα τοις υιοις των ανθρωπων και βλασφημια σασ αν βλασφημησωσιν
- 29 po për atë që do të blasfemojë kundër Frymës së Shenjtë nuk do të ketë falje përjetë; ai është fajtor për dënim të përjetshëm".  
But whoever says evil things against the Holy Spirit will never have forgiveness, but the evil he has done will be with him for ever:  
ος δ αν βλασφημηση εις το πνευμα το αγιον ουκ εχει αφεσιν εις τον αιωνα αλλ ενοχος εστιν αιωνιου κρισεως
- 30 Sepse ata thoshnin: "Ai ka një frymë të ndyrë!".  
Because they said, He has an unclean spirit.  
οτι ελεγον πνευμα ακαθαρτον εχει
- 31 Ndërkaq erdhën vëllezërit e tij dhe e ëma dhe, si ndaluan përjashta, dërguan ta thërrasin.  
And his mother and brothers came and were outside, and sent for him, requesting to see him.  
ερχονται ουν οι αδελφοι και η μητηρ αυτου και εξω εστουτες απεστειλαν προς αυτον φωνουντες αυτον
- 32 Turma ishte ulur përreth tij; dhe i thanë: "Ja, nëna jote dhe vëllezërit e tu janë përjashta dhe po të kërkojnë".  
And a great number were seated round him; and they said to him, See, your mother and your brothers are outside looking for you.  
και εκαθητο οχλος περι αυτον ειπον δε αυτω ιδου η μητηρ σου και οι αδελφοι σου εξω ζητουσιν σε
- 33 Por ai u përgjigj atyre duke thënë: "Kush është nëna ime, ose vëllezërit e mi?".  
And he said in answer, Who are my mother and my brothers?  
και απεκριθη αυτοις λεγων τις εστιν η μητηρ μου η οι αδελφοι μου
- 34 Pastaj duke vështruar rreth e qark mbi ata që ishin ulur rreth tij, tha: "Ja nëna ime dhe vëllezërit e mi!  
And looking round at those who were seated about him, he said, See, my mother and my brothers!  
και περιβλεψαμενος κυκλω τους περι αυτον καθημενους λεγει ιδε η μητηρ μου και οι αδελφοι μου
- 35 Sepse kushdo që bën vullnetin e Perëndisë, ai është vëllai im, motra ime dhe nëna!".  
Whoever does God's pleasure, the same is my brother, and sister, and mother.  
ος γαρ αν ποιηση το θελημα του θεου ουτος αδελφος μου και αδελφη μου και μητηρ εστιν

- 1 Pastaj nisi përsëri të mësojë në breg të detit; dhe rreth tij u mbledh një turmë aq e madhe, sa që ai hyri në barkë dhe rrinte ulur në det, ndërsa gjithë turma ishte në tokë pranë detit.  
And again he was teaching by the seaside. And a very great number of people had come to him, so that he got into a boat on the sea and took his seat; and all the people were on the land by the seaside.  
kai palin hrzato didaskein para την θαλασσαν και συνηχθη προς αυτον οχλος πολυς ωστε αυτον εμβαντα εις το πλοιον καθησθαι εν τη θαλασση και πας ο οχλος προς την θαλασσαν επι της γης ην
- 2 Dhe ai u mësonte atyre shumë gjëra në shëmbëlltyra, dhe u thoshte atyre në mësimin e tij:  
And he gave them teaching about a number of things in the form of stories, and said to them in his teaching, Give ear:  
kai edidaskein autous εν παραβολαις πολλα και ελεγεν αυτοις εν τη διδαχη αυτου
- 3 "Dëgjoni! Ja, doli mbjellësi të mbjellë.  
A man went out to put seed in the earth:  
akouete idou εξηλθεν ο σπειρων του σπειραι
- 4 Dhe ndodhi që kur hidhte farën, një pjesë e farës ra gjatë rrugës dhe zogjtë e qiellit erdhën dhe e hëngrën.  
And while he was doing it, some was dropped by the wayside, and the birds came and took it for food.  
kai eγενετο εν τω σπειρειν ο μιν επεσεν παρα την οδον και ηλθεν τα πετεινα του ουρανου και κατεφαγεν αυτο
- 5 Një pjesë tjetër ra në gurishte, ku nuk kishte shumë dhe dhe mbiu menjëherë, sepse s'kishte një tokë të thellë.  
And some went on the stones, where it had not much earth; and it came up straight away, because the earth was not deep:  
αλλο δε επεσεν επι το πετρωδες οπου ουκ ειχεν γην πολλην και ευθεως εξανετειλεν δια το μη εχειν βαθος γης
- 6 Por, kur doli dielli, u dogj; dhe me që nuk kishte rrënjë, u tha.  
And when the sun was high, it was burned; and because it had no root, it became dry and dead.  
ηλιου δε ανατειλαντος εκαυματισθη και δια το μη εχειν ριζαν εξηρανθη
- 7 Një pjesë tjetër ra midis ferrave; ferrat u rritën, e mbyten dhe nuk dha fryt.  
And some went among the thorns, and the thorns came up, and it had no room for growth and gave no fruit.  
kai αλλο επεσεν εις τας ακανθας και ανεβησαν αι ακανθαι και συνεπνιξαν αυτο και καρπον ουκ εδωκεν
- 8 Një pjesë tjetër ra në tokë të mirë, dhe solli frut që rritej, dhe u zhvillua për të dhënë njëra tridhjetë, tjetra gjashtëdhjetë dhe tjetra njëqind".  
And some, falling on good earth, gave fruit, coming up and increasing, and giving thirty, sixty, and a hundred times as much.  
kai αλλο επεσεν εις την γην την καλην και εδιδου καρπον αναβαινοντα και αυξανοντα και εφερεν εν τριακοντα και εν εξηκοντα και εν εκατον
- 9 Pastaj ai u tha atyre: "Kush ka veshë për të dëgjuar, le të dëgjojë!".  
And he said to them, Whoever has ears, let him give ear.  
kai ελεγεν αυτοις ο εχων ωτα ακουειν ακουετω
- 10 Tani kur ishte vetëm, ata që i rrinin përreth bashkë me të dymbëdhjetët e pyetën për shëmbëlltyrën.  
And when he was by himself, those who were round him with the twelve put questions to him about the purpose of the stories.  
οτε δε εγενετο καταμονας ηρωτησαν αυτον οι περι αυτον συν τοις δωδεκα την παραβολην
- 11 Dhe ai u tha atyre: "Juve u është dhënë të njihni misterin e mbretërisë së Perëndisë; kurse atyre që janë përjashta të gjitha këto jepen me shëmbëlltyra,  
And he said to them, To you is given the secret of the kingdom of God, but to those who are outside, all things are given in the form of stories;  
kai ελεγεν αυτοις υμιν δεδοται γνωβαι το μυστηριον της βασιλειας του θεου εκεινοις δε τοις εξω εν παραβολαις τα παντα γινεται
- 12 që: "Duke parë, të shohin, por të mos vën re; edhe duke dëgjuar, të dëgjojnë, por të mos kuptojnë, se mos pendohen dhe mëkatet u falen";  
So that seeing they may see, and it will not be clear to them; and hearing it, they will not get the sense; for fear that they may be turned again to me and have forgiveness.  
ινα βλεποντες βλεπωσιν και μη ιδωσιν και ακουοντες ακουωσιν και μη συνιωσιν μηποτε επιστρεψωσιν και αφεθη αυτοις τα αμαρτηματα
- 13 Pastaj u tha atyre: "Nuk e kuptoni këtë shëmbëlltyrë? Po atëhere si do t'i kuptoni të gjitha shëmbëlltyrat e tjera?  
And he said to them, If you are not clear about this story, how will you be clear about the others?  
kai λεγει αυτοις ουκ οιδατε την παραβολην ταυτην και πως πασας τας παραβολας γνωσεσθε
- 14 Mbjellësi mbjell fjalën.  
The seed is the word.  
ο σπειρων τον λογον σπειρει

- 15 Ata gjatë rrugës janë ata në të cilët mbillet fjala; por pasi e kanë dëgjuar atë, vjen menjëherë Satanai dhe ua heq fjalën e mbjellë në zemrat e tyre.  
And these are they by the wayside, where the word is planted; and when they have given ear, the Evil One comes straight away and takes away the word which has been planted in them.  
ουτοι δε εισιν οι παρα την οδον οπου σπειρεται ο λογος και οταν ακουσωσιν ευθεως ερχεται ο σατανας και αιρει τον λογον τον εσπαρμενον εν ταις καρδιας αυτων
- 16 Po ashtu ata që e marrin farën mbi nje gurishte janë ata që, kur e kanë dëgjuar fjalën, e pranojnë menjëherë me gëzim;  
And in the same way, these are they who are planted on the stones, who, when the word has come to their ears, straight away take it with joy;  
και ουτοι εισιν ομοιος οι επι τα πετρωδη σπειρομενοι οι οταν ακουσωσιν τον λογον ευθεως μετα χαρας λαμβανουσιν αυτον
- 17 por nuk kanë rrënjë në vetvete, dhe janë të përkohshëm; dhe kur vjen mundimi ose përndjekja për shkak të fjalës, skandalizohen menjëherë.  
And they have no root in themselves, but go on for a time; then, when trouble comes or pain, because of the word, they quickly become full of doubts.  
και ουκ εχουσιν ριζαν εν εαυτοις αλλα προσκαιροι εισιν ειτα γενομενης θλιψεως η διωγμου δια τον λογον ευθεως σκανδαλιζονται
- 18 Ata përkundrazi të cilët e marrin farën midis ferrave, janë ata që e dëgjojnë fjalën,  
And others are those planted among the thorns; these are they who have given ear to the word,  
και ουτοι εισιν οι εις τας ακανθας σπειρομενοι ουτοι εισιν οι τον λογον ακουοντες
- 19 por shqetësimet e kësaj bote, mashtrimet e pasurisë dhe lakmitë për gjëra të tjera që hynë, e mbyten fjalën dhe ajo bëhet e pafrytshme.  
And the cares of this life, and the deceits of wealth, and the desire for other things coming in, put a stop to the growth of the word, and it gives no fruit.  
και αι μεριμναι του αιωνος τουτου και η απατη του πλουτου και αι περι τα λοιπα επιθυμια εισπορευομεναι συμπνιγουσιν τον λογον και ακαρπος γινεται
- 20 Kurse ata që e morën farën në tokë të mirë, janë ata që e dëgjojnë fjalën, e pranojnë dhe japin fryt: një tridhjetë, tjetri gjashtëdhjetë dhe tjetri njëqind".  
And these are they who were planted on the good earth; such as give ear to the word, and take it into their hearts, and give fruit, thirty and sixty and a hundred times as much.  
και ουτοι εισιν οι επι την γην την καλην σπαρεντες οτινες ακουουσιν τον λογον και παραδεχονται και καρποφορουσιν εν τριακοντα και εν εξηκοντα και εν εκατον
- 21 Pastaj u tha atyre: "A merret vallë llamba për ta vënë nën babunë ose nën shtrat? A nuk vihet mbi dritëmbajtësen?  
And he said to them, When the light comes in, do people put it under a vessel, or under the bed, and not on its table?  
και ελεγεν αυτοις μητι ο λυχνος ερχεται ινα υπο τον μοδιον τεθη η υπο την κλινην ουχ ινα επι την λυχνιαν επιτεθη
- 22 Sepse nuk ka asgjë të fshehtë që të mos zbulohet, as kurrëgjë sekrete që të mos dalin në dritë.  
There is nothing covered which will not be seen openly, and nothing has been made secret which will not come to light.  
ου γαρ εστιν τι κρυπτον ο εαν μη φανερωθη ουδε εγενετο αποκρυφον αλλ ινα εις φανερον ελθη
- 23 Kush ka veshë për të dëgjuar, le të dëgjojë!"  
If any man has ears, let him give ear.  
ει τις εχει οτα ακουειν ακουετω
- 24 Dhe u tha atyre: "Vini re atë që dëgjon. Me atë masë që ju matni, do t'iu matet juve; edhe juve që dëgjon do t'iu jepet edhe më.  
And he said to them, Take care what you give ear to: in the same measure as you give you will get, and more will be given to you.  
και ελεγεν αυτοις βλεπετε τι ακουετε εν ω μετρω μετρειτε μετρηθησεται υμιν και προστεθησεται υμιν τοις ακουουσιν
- 25 Sepse atij që ka, do t'iu jepet, por atij që s'ka, do t'iu merret edhe ajo që ka.  
He who has, to him will be given: and he who has not, from him will be taken even that which he has.  
ος γαρ αν εχη δοθησεται αυτω και ος ουκ εχει και ο εχει αρθησεται απ αυτου
- 26 Tha akoma: "Mbretëria e Perëndisë është si një njeri që hedh farën në dhe.  
And he said, Such is the kingdom of God, as if a man put seed in the earth,  
και ελεγεν ουτως εστιν η βασιλεια του θεου ως εαν ανθρωπος βαλη τον σπορον επι της γης
- 27 Dhe natën dhe ditën, ndërsa ai fle dhe çohet, fara mbin dhe rritet, pa e ditur ai se si.  
And went to sleep and got up, night and day, and the seed came to growth, though he had no idea how.  
και καθευδη και εγειρηται νυκτα και ημεραν και ο σπορος βλαστανη και μηκυνηται ως ουκ οιδεν αυτος
- 28 Sepse dheu prodhon vetvetiu më parë kërcellin, pastaj kallirin, dhe më në fund kallirin plot me kokrra.  
The earth gives fruit by herself; first the leaf, then the head, then the full grain.  
αυτοματη γαρ η γη καρποφορει πρωτον χορτον ειτα σταχυν ειτα πληρη σιτον εν τω σταχυι

- 29 Dhe kur fryti piqet, menjëherë korrësi i vë drapërin, sepse erdhi koha e korrjes.  
But when the grain is ready, he quickly sends men to get it cut, because the time for cutting has come.  
οταν δε παραδω ο καρπος ευθεως αποστελλει το δρεπανον οτι παρεστηκεν ο θερισμος
- 30 Edhe tha: Me se ta krahasojmë mbretërinë e Perëndisë? Ose me çfarë shëmbëlltyre ta paraqesim?  
And he said, What picture may we give of the kingdom of God, or with what story may we make it clear?  
και ελεγεν τινι ομοιωσωμεν την βασιλειαν του θεου η εν ποια παραβολη παραβαλωμεν αυτην
- 31 Ajo i ngjan farës së sinapit, që, kur është mbjellë në dhe, është më e vogla nga të gjitha farërat që janë mbi dhe;  
It is like a grain of mustard seed, which, when it is put in the earth, is smaller than all the seeds on the earth,  
ως κοκκω σιναπεως ος οταν σπαρη επι της γης μικροτερος παντων των σπερματων εστιν των επι της γης
- 32 por, pasi mbillet, rritet dhe bëhet më e madhe se të gjitha barishtet; dhe lëshon degë aq të mëdha, sa zogjtë e qiellit mund të gjejnë strehë nën hijen e saj".  
But when it is planted, it comes up, and becomes taller than all the plants, and puts out great branches, so that the birds of heaven are able to take rest in its shade.  
και οταν σπαρη αναβαινει και γινεται παντων των λαχων μειζων και ποιει κλαδους μεγαλους ωστε δυνασθαι υπο την σκιαν αυτου τα πετεινα του ουρανου κατασκηνουν
- 33 Dhe me shumë shëmbëlltyra të tilla, u shpallte atyre fjalën, ashtu si ata ishin në gjendje ta kuptojnë.  
And with a number of such stories he gave them his teaching, as they were able to take it:  
και τοιαυταις παραβολαις πολλαις ελαλει αυτοις τον λογον καθως ηδυναντο ακουειν
- 34 Dhe nuk u fliste atyre pa shëmbëlltyra, ndërsa dishepujve të tij, veçmas, u shpjegonte çdo gjë.  
And without a story he said nothing to them: but privately to his disciples he made all things clear.  
χωρις δε παραβολης ουκ ελαλει αυτοις κατ ιδιαν δε τοις μαθηταις αυτου επελευν παντα
- 35 Tani po atë ditë, si u ngrys, u tha atyre: "Kalojmë te bregu matanë!  
And on that day, when the evening had come, he said to them, Let us go over to the other side.  
και λεγει αυτοις εν εκεινη τη ημερα οψιας γενομενης διελθωμεν εις το περαν
- 36 Dhe dishepujt, si e nisën popullin, e morrën me vete Jezusin, ashtu si ishte, në barkë. Me të ishin edhe disa barka të tjera të vogla.  
And going away from the people, they took him with them, as he was, in the boat. And other boats were with him.  
και αφεντες τον οχλον παραλαμβανουσιν αυτον ως ην εν τω πλοιω και αλλα δε πλοιαρια ην μετ αυτου
- 37 Ndërkaq shpërtheu një furtunë e madhe dhe valët përplaseshin mbi barkë aq shumë sa ajo po mbushej.  
And a great storm of wind came up, and the waves came into the boat, so that the boat was now becoming full.  
και γινεται λαλαψ ανεμου μεγαλη τα δε κυματα επεβαλλεν εις το πλοιον ωστε αυτο ηδη γεμιζεσθαι
- 38 Ai ndërkaq po flinte në këmbë mbi një jastëk. Ata e zgjuan dhe i thanë: "Mësues, a nuk merakosesh që ne po marrim fund?"  
And he himself was in the back of the boat, sleeping on the cushion: and they, awaking him, said, Master, is it nothing to you that we are in danger of destruction?  
και ην αυτος επι τη πρυμνη επι το προσκεφαλιον καθευδων και διεγειρουσιν αυτον και λεγουσιν αυτω διδασκαλε ου μελει σοι οτι απολλυμεθα
- 39 Dhe ai si u zgjua, e qortoi erën dhe i foli detit: "Pusho dhe fashitu!". Dhe era pushoi dhe u bë qetësi e madhe.  
And he came out of his sleep, and gave strong orders to the wind, and said to the sea, Peace, be at rest. And the wind went down, and there was a great calm.  
και διεγερθεις επετιμησεν τω ανεμο και ειπεν τη θαλασση σιωπα πεφιμωσο και εκοπασεν ο ανεμος και εγενετο γαληνη μεγαλη
- 40 Atëherë u tha atyre: "Pse jeni ju aq frikacakë? Vallë, si nuk keni besim?".  
And he said to them, Why are you full of fear? have you still no faith?  
και ειπεν αυτοις τι δειλοι εστε ουτως πως ουκ εχετε πιστιν
- 41 Dhe ata i zuri një frikë e madhe dhe i thoshnin njëritjetrit: "Vallë, kush është ky, që po i binden edhe era edhe deti?".  
And they took the food, and had enough; and they took up seven baskets full of the broken bits.  
εφαγον δε και εχορτασθησαν και ηραν περισσευματα κλασματος επτα σπιριδας
- 9 Ata që hëngrën ishin rreth katër mijë veta; pastaj i lejoi.  
And there were about four thousand people: and he sent them away.  
ησαν δε οι φαγοντες ως τετρακιςχιλιοι και απελυσεν αυτους
- 10 Dhe menjëherë hypi në barkë me dishepujt e vet dhe shkoi në rrethinën e Dalmanutës.  
And he got into the boat with his disciples straight away, and came into the country of Dalmanutha.  
και ευθεως εμβας εις το πλοιον μετα των μαθητων αυτου ηλθεν εις τα μερη δαλμανουθα
- 11 Atëherë erdhën farisenjtë dhe nisën të diskutojnë me të, duke i kërkuar një shenjë nga qielli për ta vënë në provë.  
And the Pharisees came out and put questions to him, requesting from him a sign from heaven, testing him.  
και εξηλθον οι φαρισαιοι και ηρξαντο συζητειν αυτω ζητουντες παρ αυτου σημειον απο του ουρανου πειραζοντες αυτον
- 12 Por ai, duke psherëtirë në frymë, tha: "Përse ky brez kërkon një shenjë? Në të vërtetë po ju them se këtij brezi nuk do t'i jepet asnjë shenjë".  
And he was very sad in spirit, and said, Why is this generation looking for a sign? truly, I say to you, No sign will be given to this generation.  
και αναστεναξας τω πνευματι αυτου λεγει τι η γενεα αυτη σημειον επιζηται αμην λεγω υμιν ει δοθησεται τη γενεα ταυτη σημειον
- 13 Atëherë i la, hipi përsëri në barkë dhe kaloi në bregun tjetër.  
And he went away from them, and again got into the boat and went across to the other side.  
και αφεις αυτους εμβας παλιν εις το πλοιον απηλθεν εις το περαν
- 14 Tani dishepujt kishin harruar të marrin bukë me vete, dhe në barkë s'kishin asgjë përveç një buke.  
And they had taken no thought to get bread; and they had only one cake of bread with them in the boat.  
και επελαθοντο λαβειν αρτους και ει μη ενα αρτον ουκ ειχον μεθ εαυτων εν τω πλοιω
- 15 Dhe Jezusi i qortoi duke thënë: "Kini kujdes, ruhuni nga majaja e farisenjve dhe nga majaja e Herodit!".  
And he said to them, Take care to be on the watch against the leaven of the Pharisees and the leaven of Herod.  
και διεστελλετο αυτοις λεγων ορατε βλεπετε απο της ζυμης των φαρισαιων και της ζυμης ηρωδου

- 16 Por ata diskutonin midis tyre duke thënë: "Nuk kemi bukë".  
And they said to one another, We have no bread.  
και διελογιζοντο προς αλληλους λεγοντες οτι αρτους ουκ εχομεν
- 17 Jezusi e vuri re dhe u tha: "Përse dis-kutoni që s'keni bukë? Ende nuk po e kuptoni e nuk e merrni vesh? Ende e keni zemrën të ngurtë?  
And Jesus, hearing it, said to them, Why are you reasoning among yourselves because you have no bread? do you still not see, and is it still not clear to you? are your hearts so hard?  
και γνους ο ιησους λεγει αυτοις τι διαλογιζεσθε οτι αρτους ουκ εχετε ουπω νοειτε ουδε συνιετε επι πεπωρωμενην εχετε την καρδιαν υμων
- 18 Keni sy dhe nuk shihni, keni veshë dhe nuk dëgjoni? Dhe nuk po mbani mend?  
Having eyes, do you not see? and having ears, have you no hearing? and have you no memory?  
οφθαλμους εχοντες ου βλεπετε και ωτα εχοντες ουκ ακουετε και ου μνημονευετε
- 19 Kur ndava të pesë bukët për të pesë mijtë, sa kosha plot me copa mblohdët?". Ata thanë: "Dymbëdhjetë".  
When I made a division of the five cakes of bread among the five thousand, what number of baskets full of broken bits did you take up? They said to him, Twelve.  
οτε τους πεντε αρτους εκλασα εις τους πεντακιςχιλιους ποσους κοφινους πληρεις κλασματων ηρατε λεγουσιν αυτω δωδεκα
- 20 "Po kur theva të shtatë bukët për të katër mijtët, sa shporta plot me bukë mblohdët?". Dhe ata thanë: "Shtatë".  
And when the seven among the four thousand, what number of baskets full of broken bits did you take up? And they said to him, Seven.  
οτε δε τους επτα εις τους τετρακιςχιλιους ποσων σφυριδων πληρωματα κλασματων ηρατε οι δε ειπον επτα
- 21 Dhe ai u tha atyre: "Po si, ende nuk po kuptoni?".  
And he said to them, Is it still not clear to you?  
και ελεγεν αυτοις πως ου συνιετε
- 22 Pastaj arriti në Betsaida; dhe i prunë një të verbër e iu lutën ta prekte.  
And they came to Beth-saida; and they took a blind man to him, requesting him to put his hands on him.  
και ερχεται εις βηθσαιδαν και φερουσιν αυτω τυφλον και παρακαλουσιν αυτον ινα αυτου αψηται
- 23 Atëherë e mori për dore të verbërin, e nxori jashtë fshatit dhe, pasi i pështyu në sy dhe vuri duart mbi të, e pyeti nëse shihte gjë.  
And he took the blind man by the hand, and went with him out of the town; and when he had put water from his mouth on his eyes, and put his hands on him, he said, Do you see anything?  
και επιλαβομενος της χειρας του τυφλου εξηγαγεν αυτον εξω της κομης και πτυσας εις τα ομματα αυτου επιθεις τας χειρας αυτω επηρωτα αυτον ει τι βλεπει
- 24 Dhe ai, duke hapur sytë, tha: "Po shoh njerëz si pemë që ecin".  
And looking up, he said, I see men; I see them like trees, walking.  
και αναβλεψας ελεγεν βλεπω τους ανθρωπους οτι ως δενδρα ορω περιπατουντας
- 25 Atëherë Jezusi i vuri përsëri duart mbi sytë dhe e bëri të shikojë lart; dhe atij iu kthye të parit dhe shikonte qartë gjithçka.  
Then again he put his hands on his eyes; and looking hard, he was able to see, and saw all things clearly.  
ειτα παλιν επεθηκεν τας χειρας επι τους οφθαλμους αυτου και εποιησεν αυτον αναβλεψαι και ενεβλεψεν τηλανγως απαντας
- 26 Dhe Jezusi e nisi të shikojë në shtëpinë e tij duke i thënë: "Mos hyr në fshat dhe mos ia trego askujt në fshat".  
And he sent him away to his house, saying, Do not even go into the town.  
και απεστειλεν αυτον εις τον οικον αυτου λεγων μηδε εις την κομην εισελθης μηδε ειπης τι εν τη κομη
- 27 Pastaj Jezusi shkoi bashkë me dishepujt e vet ndër fshatrat e Cesaresë së Filipit; dhe gjatë rrugës i pyeti dishepujt e vet duke u thënë atyre: "Kush thonë njerëzit se jam unë?".  
And Jesus went out, with his disciples, into the little towns round Caesarea Philippi; and on the way he put a question to his disciples, saying, Who do men say that I am?  
και εξηλθεν ο ιησους και οι μαθηται αυτου εις τας κομας καισαρειας της φιλιππου και εν τη οδω επηρωτα τους μαθητας αυτου λεγων αυτοις τινα με λεγουσιν οι ανθρωποι εινα
- 28 Ata u përgjigjën: "Disa Gjon Pagëzori, të tjerë Elia, dhe të tjerë një nga profetët".  
And they made answer, John the Baptist; and others, Elijah; but others, One of the prophets.  
οι δε απεκριθησαν ιωαννην τον βαπτιστην και αλλοι ηλιαν αλλοι δε ενα των προφητων
- 29 Dhe ai u tha atyre: "Po ju, kush thoni se jam?". Dhe Pjetri, duke iu përgjigjur i tha: "Ti je Krishti".  
And he said to them, But who do you say I am? Peter said in answer, You are the Christ.  
και αυτος λεγει αυτοις υμεις δε τινα με λεγετε ειναι αποκριθεις δε ο πετρος λεγει αυτω συ ει ο χριστος

- 30 Atëherë ai i urdhëroi rreptësisht që të mos i tregojnë askujt për të.  
**And he put them under orders not to say this of him to anyone.**  
 και επιτιμησεν αυτοις ινα μηδενι λεγωσιν περι αυτου
- 31 Pastaj nisi t'u mësojë atyre se Birit të njeriut i duhet të vuajë shumë gjëra, do të hidhet poshtë nga pleqtë, nga krerët e priftërinjve dhe nga skribët; se do të vritet dhe pas tri ditësh do të ringjallet.  
**And teaching them, he said that the Son of man would have to undergo much, and be hated by those in authority, and the chief priests, and the scribes, and be put to death, and after three days come back from the dead.**  
 και ηρξαστο διδασκειν αυτους οτι δει τον υιον του ανθρωπου πολλα παθειν και αποδοκιμασθηναι απο των πρεσβυτερων και αρχιερων και γραμματεων και αποκτανθηναι και μετα τρεις ημερας αναστηναι
- 32 Dhe ai i tha këto gjëra haptas. Atëherë Pjetri e mori mënjanë dhe filloi ta qortojë.  
**And he said this openly. And Peter took him, and was protesting.**  
 και παρρησια τον λογον ελαλει και προσλαβομενος αυτον ο πετρος ηρξαστο επιτιμαν αυτω
- 33 Por ai u kthye, shikoi dishepujt e vet dhe e qortoi Pjetrin, duke thënë: "Largohu nga unë, Satana, se ti nuk ke shqisën për gjërat e Perëndisë, por për gjërat e njerëzve!".  
**But he, turning about, and seeing his disciples, said sharply to Peter, Get out of my way, Satan: for your mind is not on the things of God, but on the things of men.**  
 ο δε επιστραφεις και ιδων τους μαθητας αυτου επιτιμησεν τω πετρω λεγων υπαγε οπισω μου σατανα οτι ου φρονεις τα του θεου αλλα τα των ανθρωπων
- 34 Pastaj e thirri pranë vetes turmën me dishepujt e vet dhe iu tha: "Kushdo që don të vijë pas meje, të mohojë vetveten, të marrë kryqin e vet dhe të më ndjekë,  
**And turning to the mass of people with his disciples, he said to them, If any man has the desire to come after me, let him give up all other desires, and take up his cross and come after me.**  
 και προσκαλεσαμενος τον οχλον συν τοις μαθηταις αυτου ειπεν αυτοις οστις θελει οπισω μου ελθειν απαρνησασθω εαυτον και αρατω τον σταυρον αυτου και ακολουθειτω μοι
- 35 sepse ai që don të shpëtojë jetën e vet, do ta humbasë; por ai që do të humbasë jetën e vet për hirin tim e për ungjillin, do të shpëtojë.  
**Whoever has a desire to keep his life, will have it taken from him; and whoever gives up his life because of me and the good news, will keep it.**  
 ος γαρ αν θελη την ψυχην αυτου σωσαι απολεσει αυτην ος δε αν απολεση την ψυχην αυτου ενεκεν εμου και του ευαγγελιου ουτος σωσει αυτην
- 36 Ç'dobi do të ketë njeriu të fitojë gjithë botën, nëse më pas do të humbë shpirtin e vet?  
**What profit has a man if he gets all the world with the loss of his life?**  
 τι γαρ ωφελησει ανθρωπον εαν κερδηση τον κοσμον ολον και ζημιωθη την ψυχην αυτου
- 37 Ose çfarë mund të japë njeriu në shkëmbim të shpirtit të vet?  
**And what would a man give in exchange for his life?**  
 η τι δωσει ανθρωπος ανταλλαγμα της ψυχης αυτου
- 38 Sepse kujtdo që do t'i vijë turp për mua dhe për fjalët e mia në mes të këtij brezi kurorëshkelës dhe mëkatar, për atë do t'i vijë turp edhe Birit të njeriut, kur të arrijë në lavdinë e Atit të vet, me engjëjt e shenjët".  
**Whoever has a feeling of shame because of me and my words in this false and evil generation, the Son of man will have a feeling of shame because of him, when he comes in the glory of his Father with the holy angels.**  
 ος γαρ αν επαισχυνθη με και τους εμους λογους εν τη γενεα ταυτη τη μοιχαλιδι και αμαρτωλω και ο υιος του ανθρωπου επαισχυνθησεται αυτον οταν ελθη εν τη δοξη του πατρος αυτου μετα των αγγων των αγγων
- 1 Pastaj u tha atyre: "Në të vërtetë ju them se midis jush që jeni këtu ka disa që nuk do ta shijojnë vdekjen para se të shohin të vijë me fuqi mbretëria e Perëndisë".  
**And he said to them, Truly I say to you, There are some here who will have no taste of death till they see the kingdom of God come with power.**  
 και ελεγεν αυτοις αμην λεγω υμιν οτι εισιν τινες των ωδε εστηκοτων οιτινες ου μη γευσωνται θανατου εως αν ιδωσιν την βασιλειαν του θεου εληλυθυιαν εν δυναμει
- 2 Mbas gjashtë ditësh Jezusi mori me vete Pjetrin, Jakobin e Gjonin dhe i çoi në vetmi, vetëm ata, mbi një mal të lartë; dhe u shpërfytyrua përpara tyre.  
**And after six days Jesus took with him Peter and James and John, and made them go up with him into a high mountain by themselves: and he was changed in form before them:**  
 και μεθ ημερας εξ παραλαμβανει ο ιησους τον πετρον και τον ιακωβον και τον ιωαννην και αναφερει αυτους εις ορος υψηλον κατ ιδιαν μονους και μετεμορφωθη εμπροσθεν αυτων
- 3 Dhe rrobat e tij u bënë të shndritshme dhe krejt të bardha, si bora, më të bardha nga sa nuk mund t'i zbardhojë asnjë rrobalarës mbi tokë.  
**And his clothing became shining, very white, as no cleaner on earth would make it.**  
 και τα ιματια αυτου εγενετο σπιλβοντα λευκα λιαν ως χιων οια γναφευς επι της γης ου δυναται λευκαναι
- 4 Dhe atyre iu shfaqën Elia me Moisiun, që po bisedonin me Jezusin.  
**And there came before them Elijah with Moses, and they were talking with Jesus.**  
 και ωφθη αυτοις ηλιας συν μοσει και ησαν συλλαλουντες τω ιησου

- 5 Atëherë Pjetri e mori fjalën dhe i tha Jezusit: "Mësues, për ne është mirë të jemi këtu; bëjmë, pra, tri çadra: një për ty, një për Moisiun dhe një për Elian!".  
And Peter said to Jesus, Master, it is good for us to be here: and let us make three tents; one for you, one for Moses, and one for Elijah.  
και αποκριθεις ο πετρος λεγει τω ιησου ραββι καλον εστιν ημας ωδε ειναι και ποιησωμεν σκηνας τρεις σοι μιαν και μοσει μιαν και ηλια μιαν
- 6 Në fakt ai nuk dinte çfarë thoshte, sepse ata ishin të trembur.  
Because he was not certain what to say, for they were in great fear.  
ου γαρ ηδει τι λαληση ησαν γαρ εκφοβοι
- 7 Pastaj erdhi një re dhe i mbuloi me hijen e vet; dhe nga reja doli një zë që tha: "Ky është Biri im i dashur; dëgjojeni!".  
And a cloud came over them; and a voice came out of the cloud, saying, This is my dearly loved Son, give ear to him.  
και εγενετο νεφελη επισκιαζουσα αυτοις και ηλθεν φωνη εκ της νεφελης λεγουσα ουτος εστιν ο υιος μου ο αγαπητος αυτου ακουετε
- 8 Dhe menjëherë ata shikuan rreth e qark, por nuk panë më asnjëri, përveçse Jezusi fill i vetëm me ta.  
And suddenly looking round about, they saw no one any longer, but Jesus only with themselves.  
και εξαπινα περιβλεψαμενοι ουκετι ουδενα ειδον αλλα τον ιησουν μονον μεθ εαυτων
- 9 Tani kur po zbrisnin nga mali, Jezusi i urdhëroi të mos i tregojnë askujt gjërat që kishin parë, derisa i Biri i njeriut të ringjallej prej së vdekuri.  
And while they were coming down from the mountain, he gave them orders not to give word to any man of the things they had seen, till the Son of man had come back from the dead.  
καταβαινοντων δε αυτων απο του ορους διεστειλατο αυτοις ινα μηδενι διηγησονται α ειδον ει μη οταν ο υιος του ανθρωπου εκ νεκρων αναστη
- 10 Ata e mbajtën porosinë dhe diskutonin mes tyre se ç'do të thoshte të ringjallej prej së vdekuri.  
And they kept the saying, questioning among themselves what the coming back from the dead might be.  
και τον λογον εκρατησαν προς εαυτους συζητουντες τι εστιν το εκ νεκρων αναστηναι
- 11 Pastaj e pyetën duke thënë: "Përse skribët thonë se më parë duhet të vijë Elia?".  
And they put a question to him, saying, Why do the scribes say that Elijah has to come first?  
και επηρωτων αυτον λεγοντες οτι λεγουσιν οι γραμματαις οτι ηλιαν δει ελθειν πρωτον
- 12 Dhe ai, duke u përgjigjur, u tha atyre: "Elia me të vërtetë duhet të vijë më parë dhe të rivendosë çdo gjë; por, ashtu siç është shkruar për Birin e njeriut, ai duhet të vuajë shumë gjëra dhe të përçmohet.  
And he said to them, Truly, Elijah does come first, and puts all things in order; and how is it said in the Writings that the Son of man will go through much sorrow and be made as nothing?  
ο δε αποκριθεις ειπεν αυτοις ηλιας μεν ελθων πρωτον αποκαθιστα παντα και πως γεγραπται επι τον υιον του ανθρωπου ινα πολλα παθη και εξουδενωθη
- 13 Por unë po ju them se Elia erdhi dhe me të bënë ç'dëshën, ashtu siç është shkruar për të".  
But I say to you that Elijah has come, and they have done to him whatever they were pleased to do, even as the Writings say about him.  
αλλα λεγω υμιν οτι και ηλιας εληλυθεν και εποιησαν αυτω οσα ηθελησαν καθως γεγραπται επ αυτον
- 14 Mbasi u kthye te dishepujt, pa një turmë të madhe rreth tyre dhe disa skribë që po grindeshin me ta.  
And when they came to the disciples, they saw a great mass of people about them, and scribes questioning them.  
και ελθων προς τους μαθητας ειδεν οχλον πολυν περι αυτους και γραμματαις συζητουντας αυτοις
- 15 Dhe menjëherë e gjithë turma, kur e pa, u habit dhe erdhi me vrap për ta përshëndetur.  
And straight away all the people, when they saw him, were full of wonder, and running to him, gave him worship.  
και ευθεως πας ο οχλος ιδων αυτον εξεθαμβηθη και προστρεχοντες ησπαζοντο αυτον
- 16 Atëherë ai i pyeti skribët: "Për çfarë po diskutoni me ta?".  
And he said, What are you questioning them about?  
και επηρωτησεν τους γραμματαις τι συζηταιτε προς αυτους
- 17 Dhe dikush nga turma, duke u përgjigjur, tha: "Mësues, të prura djalin tim që ka një frymë memece,  
And one of the number said to him in answer, Master, I came to you with my son, who has in him a spirit which takes away his power of talking;  
και αποκριθεις εις εκ του οχλου ειπεν διδασκαλε ηνεγκα τον υιον μου προς σε εχοντα πνευμα αλαλον

- 18 dhe e kap kudo, e përplas dhe ai shkumon, kërcëllon dhëmbët dhe i ngrijnë gjymtyrët. Dhe u thashë dishepujve të tu ta dëbojnë, por ata s'e bënë dot.  
*And wherever it takes him, it puts him down violently, streaming at the lips and twisted with pain; and his strength goes from him; and I made a request to your disciples to send it out, and they were not able.*  
*και οπου αν αυτον καταλαβη ρησσει αυτον και αφριζει και τριζει τους οδοντας αυτου και ξηραινεται και ειπον τοις μαθηταις σου ινα αυτο εκβαλωσιν και ουκ ισχυσαν*
- 19 Dhe ai duke u përgjigjur tha: "O brez që s'beson, deri kur do të jem me ju? Deri kur do t'ju duroj? Ma sillni këtu!".  
*And he said to them in answer, O generation without faith, how long will I have to be with you? how long will I put up with you? let him come to me.*  
*ο δε αποκριθεις αυτω λεγει ω γενεα απιστος εως ποτε προς υμας εσομαι εως ποτε ανεξομαι υμων φερετε αυτον προς με*
- 20 Dhe ata ia pranë. Por, sapo e pa, fryma e përplasi me forcë dhe fëmija, që kishte rënë përtokë, rrokullisej duke shkumuar.  
*And they took him to him: and when he saw him, the spirit in him straight away became violent; and he went down on the earth, rolling about and streaming at the lips.*  
*και ηνεγκαν αυτον προς αυτον και ιδων αυτον ευθεως το πνευμα εσπαραξεν αυτον και πεσων επι της γης εκυλιετο αφριζων*
- 21 Dhe Jezusi e pyeti babanë e atij: "Sa kohë ka që i ndodh kështu?". Dhe ai tha: "Që në fëmijëri.  
*And Jesus questioning the father said, How long has he been like this? And he said, From a child.*  
*και επηρωτησεν τον πατερα αυτου ποσος χρονος εστιν ως τουτο γεγονεν αυτω ο δε ειπεν παιδιοθεν*
- 22 Shpesh e ka hedhur në zjarr dhe në ujë për ta shkatërruar por, nëse mund të bësh diçka, ki mëshirë për ne dhe na ndihmo!".  
*And frequently it has sent him into the fire and into the water, for his destruction; but if you are able to do anything, have pity on us, and give us help.*  
*και πολλακις αυτον και εις πυρ εβαλεν και εις υδατα ινα απολεση αυτον αλλ ει τι δυνασαι βοηθησον ημιν σπλαγχμισθεις εφ ημας*
- 23 Dhe Jezusi i tha: "Nëse ti mund të besosh, çdo gjë është e mundshme për atë që beson".  
*And Jesus said to him, If you are able! All things are possible to him who has faith.*  
*ο δε ιησους ειπεν αυτω το ει δυνασαι πιστευσαι παντα δυνατα τω πιστευοντι*
- 24 Menjëherë babai i fëmijës, duke bërëtitur me lot, tha: "Unë besoj, o Zot, ndihmo mosbesimin tim".  
*Straight away the father of the child gave a cry, saying, I have faith; make my feeble faith stronger.*  
*και ευθεως κραζας ο πατηρ του παιδιου μετα δακρυων ελεγεν πιστευω κυριε βοηθει μου τη απιστια*
- 25 Atëherë Jezusi, duke parë se po vinte turma me vrap, e qortoi frymën e ndyrë duke thënë: "O frymë mamece dhe e shurdhët, unë po të urdhëroj, dil prej tij dhe mos hyr më kurrë tek ai!".  
*And when Jesus saw that the people came running together, he gave orders to the unclean spirit, saying to him, You, spirit, who are the cause of his loss of voice and hearing, I say to you, come out of him, and never again go into him.*  
*ιδων δε ο ιησους οτι επισυντρεχει οχλος επετιμησεν τω πνευματι τω ακαθαρτω λεγων αυτω το πνευμα το αλαλον και κωφον εγω σοι επιτασσω εξελθε εξ αυτου και μηκετι εισελθης εις αυτον*
- 26 Dhe demoni, duke bërëtitur dhe duke e sflitur fort, doli prej tij. Dhe fëmija mbeti si i vdekur, saqë shumë njerëz thoshin: "Ka vdekur".  
*And after crying out and shaking him violently, it came out: and the child became like one dead; so that most of them said, He is dead.*  
*και κραζαν και πολλα σπαραζαν αυτον εξηλθεν και εγενετο ωσει νεκρος ωστε πολλους λεγειν οτι απεθανεν*
- 27 Por Jezusi e zuri për dore, e ngriti dhe ai u çua në këmbë.  
*But Jesus took him by the hand, lifting him up; and he got up.*  
*ο δε ιησους κρατησας αυτον της χειρος ηγειρεν αυτον και ανεστη*
- 28 Kur Jezusi hyri në shtëpi, dishepujt e vet e pyetën veçmas: "Përse ne nuk mundëm ta dëbojmë?".  
*And when he had gone into the house, his disciples said to him privately, Why were we unable to send it out?*  
*και εισελθοντα αυτον εις οικον οι μαθηται αυτου επηρωτων αυτον κατ ιδιαν οτι ημεις ουκ ηδωνηθημεν εκβαλιν αυτο*
- 29 dhe ai u tha atyre: "Ky lloj frymërash nuk mund të dëbohet ndryshe, përveç, se me lutje dhe agjërim".  
*And he said to them, Nothing will make this sort come out but prayer.*  
*και ειπεν αυτοις τουτο το γενοσ εν ουδενι δυναται εξελθειν ει μη εν προσευχη και νηστεια*
- 30 Mbasi u nisën prej andej, kaluan nëpër Galileë; dhe ai nuk donte që ta merrte vesh njeri.  
*And they went out from there, through Galilee; and it was his desire that no man might have knowledge of it;*  
*και εκειθεν εξελθοντες παρεπορευοντο δια της γαλιλαιας και ουκ ηθελεν ινα τις γνω*

- 31 Ai, në fakt, i mësonte dishepujt e vet dhe u thoshte atyre: "Së shpejti Biri i njeriut do të dorëzohet në duart e njerëzve dhe ata do ta vrasin; dhe, pasi të jetë vrasë, ai do të ringjallet ditën e tretë".  
For he was giving his disciples teaching, and saying to them, The Son of man is given up into the hands of men, and they will put him to death; and when he is dead, after three days he will come back from the dead.  
εδίδασκεν γαρ τους μαθητας αυτου και ελεγεν αυτοις οτι ο υιος του ανθρωπου παραδιδοται εις χειρας ανθρωπων και αποκτενουσιν αυτον και αποκτανθεις τη τριτη ημερα αναστησεται
- 32 Por ata nuk i kuptonin këto fjalë dhe kishin frikë ta pyesnin.  
But the saying was not clear to them, and they were in fear of questioning him about it.  
οι δε ηγνωουν το ρημα και εφοβουντο αυτον επερωτησαι
- 33 Dhe arritën në Kapernaum; dhe kur hyri në shtëpi, i pyeti: "Për çfarë diskutonit ndërmjet jush rrugës?".  
And they came to Capernaum: and when he was in the house, he put the question to them, What were you talking about on the way?  
και ηλθεν εις καπερναουμ και εν τη οικια γενομενος επηρωτα αυτους τι εν τη οδω προς εαυτους διελογιζεσθε
- 34 Dhe ata heshtën, sepse rrugës kishin diskutuar se cili ndër ta ishte më i madhi.  
But they said nothing: because they had had an argument between themselves on the way, about who was the greatest.  
οι δε εσιωπων προς αλληλους γαρ διελεχθησαν εν τη οδω τις μειζων
- 35 Atëherë ai u ul, i thirri të dymbëdhjetët dhe u tha atyre: "Nëse dikush don të jetë i pari, le të bëhet i fundit i të gjithëve dhe shërbëtori i të gjithëve".  
And seating himself, he made the twelve come to him; and he said to them, If any man has the desire to be first, he will be last of all and servant of all.  
και καθισας εφωνησεν τους δωδεκα και λεγει αυτοις ει τις θελει πρωτος ειναι εσται παντων εσχατος και παντων διακονος
- 36 Dhe mori një fëmijë të vogël dhe e vuri në mes të tyre; pastaj e mori në krahë dhe u tha atyre:  
And he took a little child, and put him in the middle of them; and taking him in his arms, he said to them,  
και λαβων παιδιον εστησεν αυτο εν μεσω αυτων και εναγκαλισαμενος αυτο ειπεν αυτοις
- 37 "Cilido që pranon një nga këta fëmijë në emrin tim, më pranon mua; dhe kushdo që më pranon mua, nuk më pranon mua, por atë që më ka dërguar"  
Whoever will give honour to one such little child in my name, gives honour to me: and whoever gives honour to me, gives honour not to me, but to him who sent me.  
ος εαν εν των τοιουτων παιδιων δεξηται επι τω ονοματι μου εμε δεχεται και ος εαν εμε δεξηται ουκ εμε δεχεται αλλα τον αποστειλαντα με
- 38 Atëherë Gjoni mori fjalën dhe i tha: "Mësues, ne pamë një njeri që nuk na ndjek, që i dëbonte demonët në emrin tënd dhe ia ndaluan sepse ai nuk na ndjek".  
John said to him, Master, we saw one driving out evil spirits in your name: and we said that he might not, because he is not one of us.  
απεκριθη δε αυτο ο ιωαννης λεγων διδασκαλε ειδομεν τινα τω ονοματι σου εκβαλλοντα δαιμονια ος ουκ ακολουθει ημιν και εκωλυσαμεν αυτον οτι ουκ ακολουθει ημιν
- 39 Por Jezusi tha: "Mos ia ndaloni, sepse s'ka njeri që mund të bëjë një vepër të fuqishme në emrin tim, dhe fill pas kësaj të flasë keq për mua.  
But Jesus said, Say not so: for there is no man who will do a great work in my name, and be able at the same time to say evil of me.  
ο δε ιησους ειπεν μη κωλυετε αυτον ουδεις γαρ εστιν ος ποιησει δυναμιν επι τω ονοματι μου και δυνασεται ταχυ κακολογησαι με
- 40 Sepse kush nuk është kundër nesh, është me ne.  
He who is not against us is for us.  
ος γαρ ουκ εστιν καθ υμων υπερ υμων εστιν
- 41 Në fakt, kushdo që do t'ju japë të pini një gotë ujë në emrin tim, sepse jeni të Krishtit, në të vërtetë po ju them se me siguri nuk do ta humbasë shpërblimin e vet".  
Whoever gives you a cup of water, because you are Christ's, truly I say to you, he will in no way be without his reward.  
ος γαρ αν ποτιση υμας ποτηριον υδατος εν τω ονοματι μου οτι χριστου εστε αμην λεγω υμιν ου μη απολεση τον μισθον αυτου
- 42 "Dhe kush do të skandalizojë një nga këta të vegjël që besojnë në mua, do të ishte më mirë për të t'i varet në qafë një gur mulliri dhe të hidhet në det.  
And whoever is a cause of trouble to one of these little ones who have faith in me, it would be better for him if a great stone was put round his neck and he was dropped into the sea.  
και ος αν σκανδαλιση ενα των μικρων των πιστευοντων εις εμε καλον εστιν αυτο μαλλον ει περικεεται λιθος μυλικος περι τον τραχηλον αυτου και βεβληται εις την θαλασσαν
- 43 Tani nëse dora jote të skandalizon për mëkat, preje; është më mirë për ty të hysh dorëcung në jetë, sesa të kesh dy duar dhe të shkosh në Gehena, në zjarrin e pashueshëm,  
And if your hand is a cause of trouble to you, let it be cut off; it is better for you to go into life with one hand than to have two hands and go into hell, into the eternal fire.  
και εαν σκανδαλιζη σε η χειρ σου αποκοψον αυτην καλον σοι εστιν κυλλον εις την ζωην εισελθειν η τας δυο χειρας εχοντα απελθειν εις την γεενναν εις το πυρ το ασβεστον
- 44 atje ku krimbi i tyre nuk vdes dhe zja-rrin nuk fiket.  
[]  
οπου ο σκοληζ αυτων ου τελευτα και το πυρ ου σβεννυται

- 45 Dhe nëse këmba jote të skandalizon për mëkat, preje; është më mirë për ty të hysh i çalë në jetë, se sa të kesh dy këmbë dhe të të hedhin në Gehena, në zjarrin e pashueshëm,  
**And if your foot is a cause of trouble to you, let it be cut off: it is better for you to go into life with one foot than to have two feet and go into hell.**  
 και εαν ο πους σου σκανδαλιζη σε αποκοψον αυτον καλον εστιν σοι εισελθειν εις την ζωην χωλον η τους δυο ποδας εχοντα βληθηναι εις την γεενναν εις το πυρ το ασβεστον
- 46 atje ku krimbi i tyre nuk vdes dhe zjarri nuk fiket.  
 []  
 οπου ο σκοληξ αυτων ου τελευτα και το πυρ ου σβεννυται
- 47 Dhe nëse syri yt të skandalizon për mëkat, nxirre; është më mirë për ty të hysh me një sy në jetë sesa të kesh dy sy dhe të të hedhin në Gehenën e zjarrit,  
**And if your eye is a cause of trouble to you, take it out: it is better for you to go into the kingdom of God with one eye than, having two eyes, to go into hell,**  
 και εαν ο οφθαλμος σου σκανδαλιζη σε εκβαλε αυτον καλον σοι εστιν μονοφθαλμον εισελθειν εις την βασιλειαν του θεου η δυο οφθαλμους εχοντα βληθηναι εις την γεενναν του πυρος
- 48 atje ku krimbi i tyre nuk vdes dhe zja-rrri nuk fiket.  
**Where their worm is ever living and the fire is not put out.**  
 οπου ο σκοληξ αυτων ου τελευτα και το πυρ ου σβεννυται
- 49 Sepse gjithkush duhet të kripet me zjarr, dhe çdo fli duhet të kripet me kripë.  
**Everyone will be salted with fire.**  
 πας γαρ πυρι αλισθησεται και πασα θυσια αλι αλισθησεται
- 50 Kripa është e mirë, por nëse kripa bëhet e amësht, me se do t'i jepni shijen? Kini kripë në vetvete dhe jetoni në paqe njëri me tjetrin!".  
**Salt is good; but if the taste goes from it, how will you make it salt again? Have salt in yourselves, and be at peace one with another.**  
 καλον το αλας εαν δε το αλας αναλον γενηται εν τινι αυτο αρτυσετε εχετε εν εαυτοις αλας και ειρηνευετε εν αλληλοις
- 1 Mbasi u nis prej andej, Jezusi shkoi në krahinë e Judesë gjatë Jordanit dhe përsëri u mbledhën rreth tij turma; ai përsëri filloi t'i mësojë, siç e kishte zakon.  
**And he got up, and went into the country of Judaea on the other side of Jordan: and great numbers of people came together to him again; and, as was his way, he gave them teaching.**  
 κακειθεν αναστας ερχεται εις τα ορια της ιουδαιας δια του περαν του ιορδανου και συμπορευονται παλιν οχλοι προς αυτον και ως ειωθει παλιν εδιδασκεν αυτους
- 2 Dhe farisenjtë, për ta vënë në provë, e pyetën: "A është e ligjshme që burri ta lë gruan?".  
**And Pharisees came to him, testing him with the question, Is it right for a man to put away his wife?**  
 και προσελθοντες οι φαρισαιοι επηρωτησαν αυτον ει εξεστιν ανδρι γυναικα απολυσαι πειραζοντες αυτον
- 3 Dhe ai, duke u përgjigjur, u tha atyre: "Çfarë ju ka urdhëruar Moisiu?".  
**And he said to them in answer, What did Moses say you were to do?**  
 ο δε αποκριθεις ειπεν αυτοις τι υμιν εντειλατο μωσης
- 4 Ata thanë: "Moisiu ka lejuar të shkruhet letra e shkurorëzimit dhe ta lësh gruan".  
**And they said to him, Moses let us give her a statement in writing, and be free from her.**  
 οι δε ειπον μωσης επετρεψεν βιβλιον αποστασιου γραφαι και απολυσαι
- 5 Dhe Jezusi, duke u përgjigjur, u tha atyre: "Për shkak të ngurtësisë së zemrës suaj ai e shkroi atë rregull;  
**But Jesus said to them, Because of your hard hearts he gave you this law.**  
 και αποκριθεις ο ιησους ειπεν αυτοις προς την σκληροκαρδιαν υμων εγραψεν υμιν την εντολην ταυτην
- 6 por në fillim të krijimit, Perëndia i bëri mashkull e femër.  
**But from the first, male and female made he them.**  
 απο δε αρχης κτισεως αρσεν και θηλυ εποιησεν αυτους ο θεος
- 7 Për këtë arsye njeriu do ta braktisë babanë e tij dhe nënën e tij dhe do të bashkohet me gruan e tij;  
**For this cause will a man go away from his father and mother, and be joined to his wife;**  
 ενεκεν τουτου καταλειπει ανθρωπος τον πατερα αυτου και την μητερα και προσκολληθησεται προς την γυναικα αυτου
- 8 dhe të dy do të jenë një mish i vetëm; kështu nuk janë më dy, por një mish i vetëm.  
**And the two will become one flesh; so that they are no longer two, but one flesh.**  
 και εσονται οι δυο εις σαρκα μιαν ωστε ουκετι εισιν δυο αλλα μια σαρξ



- 9 Prandaj njeriu të mos ndajë atë që Perëndia e ka bashkuar!".  
 Let not that which has been joined together by God be parted by man.  
 ο ουν ο θεος συνεζευξεν ανθρωπος μη χωριζετω
- 10 Dhe në shtëpi dishepujt e vet e pyetën përsëri për këtë çështje.  
 And in the house the disciples put questions to him again about this thing.  
 και εν τη οικια παλιν οι μαθηται αυτου περι του αυτου επηρωτησαν αυτον
- 11 Atëherë ai u tha atyre: "Ai që lë gruan e vet dhe martohet me një tjetër, shkel kurorën me të.  
 And he said to them, Whoever puts away his wife and takes another, is false to his wife;  
 και λεγει αυτοις ος εαν απολυση την γυναικα αυτου και γαμηση αλλην μοιχεται επ αυτην
- 12 Po ashtu, nëse gruaja lë burrin e vet dhe martohet me një tjetër, shkel kurorën.  
 And if she herself puts away her husband and takes another, she is false to her husband.  
 και εαν γυνη απολυση τον ανδρα αυτης και γαμηθη αλλω μοιχεται
- 13 Atëherë i pranë disa fëmijë të vegjël që ai t'i prekte ata; por dishepujt i qortonin ata që i pranë.  
 And they took to him little children, so that he might put his hands on them: and the disciples said sharp words to them.  
 και προσεφερον αυτω παιδια ινα αφηται αυτων οι δε μαθηται επετιμων τοις προσφερουσιν
- 14 Kur Jezusi e pa këtë, i indinjuar, u tha atyre: "I lini fëmijët e vegjël të vijnë tek unë dhe mos i pengoni, sepse e tyre është mbretëria e Perëndisë.  
 And when Jesus saw it, he was angry, and said to them, Let the little children come to me, and do not keep them away; for of such is the kingdom of God.  
 ιδων δε ο ιησους ηγανακτησεν και ειπεν αυτοις αφετε τα παιδια ερχεσθαι προς με και μη κωλυετε αυτα των γαρ τοιουτων εστιν η βασιλεια του θεου
- 15 Në të vërtetë po ju them se kushdo që nuk e pranon mbretërinë e Perëndisë si një fëmijë i vogël, nuk do të hyjë në të".  
 Truly I say to you, Whoever does not put himself under the kingdom of God like a little child, will not come into it at all.  
 αμην λεγω υμιν ος εαν μη δεξηται την βασιλειαν του θεου ως παιδιον ου μη εισελθη εις αυτην
- 16 Dhe, si i mori në krahë, i bekoi duke vënë duart mbi ta.  
 And he took them in his arms, and gave them a blessing, putting his hands on them.  
 και εναγκαλισαμενος αυτα τιθεις τας χειρας επ αυτα ηυλογει αυτα
- 17 Tani kur po bëhej gati për rrugë, i doli përpara dikush me vrap; u gjunjëzua para tij dhe e pyeti: "Mësues i mirë, çfarë duhet të bëj që të trashëgoj jetën e përjetshme?".  
 And while he was going out into the way, a man came running to him, and went down on his knees, saying, Good Master, what have I to do so that I may have eternal life?  
 και εκπορευομενου αυτου εις οδον προσδραμων εις και γονυπετησας αυτον επηρωτα αυτον διδασκαλε αγαθε τι ποιησω ινα ζωην αιωνιον κληρονομησω
- 18 Dhe Jezusi i tha: "Përse më quan i mirë? Askush nuk është i mirë, përveç një të vetmi, domethënë Perëndisë.  
 And Jesus said to him, Why do you say I am good? no one is good but one, and that is God.  
 ο δε ιησους ειπεν αυτω τι με λεγεις αγαθον ουδεις αγαθος ει μη εις ο θεος
- 19 Ti i njeh urdhërimet: "Mos shkel kurorën. Mos vrit. Mos vidh. Mos bëj dëshmi të rreme. Mos mashtro. Ndero atin tënd dhe nënën tënde".  
 You have knowledge of what is said in the law, Do not put any one to death, Do not be untrue in married life, Do not take what is not yours, Do not give false witness, Do not get money by deceit, Give honour to your father and mother.  
 τας εντολας οιδας μη μοιχευσης μη φονευσης μη κλεψης μη ψευδομαρτυρησης μη αποστερησης τιμα τον πατερα σου και την μητερα
- 20 Dhe ai, duke iu përgjigjur, i tha: "Mësues, të gjitha këto i kam zbatuar që në fëmijërinë time".  
 And he said to him, Master, all these laws I have kept from the time when I was young.  
 ο δε αποκριθεις ειπεν αυτω διδασκαλε ταυτα παντα εφυλαξαμην εκ νεοτητος μου
- 21 Atëherë Jezusi e vështroi në fytyrë, ndjeu dashuri për të dhe i tha: "Një gjë të mungon; shko, shit të gjitha ato që ke dhe jepua të varfërve dhe do të kesh një thesar në qiell; pastaj eja, merre kryqin tënd dhe më ndiq".  
 And Jesus, looking on him and loving him, said, There is one thing needed: go, get money for your goods, and give it to the poor, and you will have wealth in heaven: and come with me.  
 ο δε ιησους εμβλεψας αυτω ηγαπησεν αυτον και ειπεν αυτω εν σοι υστερει υπαγε οσα εχεις πωλησον καιδος τοις πτωχοις και εξεις θησαυρον εν ουρανω και δευρο ακολουθει μοι αρας τον σταυρον

- 22 Por ai u trishtua për këto fjalë dhe u largua me keqardhje, sepse kishte shumë pasuri.  
But his face became sad at the saying, and he went away sorrowing: for he was one who had much property.  
ο δε στεγνωσας επι τω λογω απηλθεν λυπουμενος ην γαρ εχων κτηματα πολλα
- 23 Atëherë Jezusi, mbasi e hodhi vështrimin përreth, u tha dishepujve të vet: "Sa vështirë është për ata që kanë pasuri të hyjnë në mbretërinë e Perëndisë!".  
And Jesus, looking round about, said to his disciples, How hard it is for those who have wealth to come into the kingdom of God!  
και περιβλεψαμενος ο ιησους λεγει τοις μαθηταις αυτου πως δυσκολως οι τα χρηματα εχοντες εις την βασιλειαν του θεου εισελουσονται
- 24 Dishepujt u habitën shumë nga këto fjalë të tij. Por Jezusi foli përsëri dhe u tha atyre: "O bij, sa e vështirë është që të hyjnë në mbretërinë e Perëndisë ata që mbështeten te pasuria.  
And the disciples were full of wonder at his words. But Jesus said to them again, Children, how hard it is for those who put faith in wealth to come into the kingdom of God!  
οι δε μαθηται εθαμβουντο επι τοις λογοις αυτου ο δε ιησους παλιν αποκριθεις λεγει αυτοις τεκνα πως δυσκολον εστιν τους πεποιθοτας επι τοις χρημασιν εις την βασιλειαν του θεου εισελθειν
- 25 Është më e lehtë që një deve të kalojë nëpër vrimën e një gjilpëre, se sa të hyjë një i pasur në mbretërinë e Perëndisë".  
It is simpler for a camel to go through a needle's eye, than for a man of wealth to come into the kingdom of God.  
ευκοπωτερον εστιν καμηλον δια της τρυμαλιας της ραφιδος εισελθειν η πλουσιον εις την βασιλειαν του θεου εισελθειν
- 26 Dhe ata u çuditën edhe më tepër dhe i thoshin njëri-tjetrit: "Atëherë kush vallë mund të shpëtohet?".  
And they were greatly surprised, saying to him, Who then may have salvation?  
οι δε περισσως εξεπλησσαντο λεγοντες προς εαυτους και τις δυναται σωθηναι
- 27 Por Jezusi, duke i ngulur sytë mbi ta, u tha: "Kjo për njerëzit është e pamundur, por jo për Perëndinë, sepse gjithçka është e mundur për Perëndinë".  
Jesus, looking on them, said, With men it is impossible, but not with God: for all things are possible with God.  
εμβλεψας δε αυτοις ο ιησους λεγει παρα ανθρωποις αδυνατον αλλ ου παρα τω θεω παντα γαρ δυνατα εστιν παρα τω θεω
- 28 Atëherë Pjetri e mori fjalën dhe tha: "Ja, ne lamë çdo gjë dhe të kemi ndjekur".  
Peter said to him, See, we have given up everything, and come after you.  
και ηρξατο ο πετρος λεγειν αυτω ιδου ημεις αφηκαμεν παντα και ηκολουθησαμεν σοι
- 29 Jezusi, duke u përgjigjur, tha: "Në të vërtetë po ju them që nuk ka asnjëri që të ketë lënë shtëpinë, a vëllezërit a motrat, a atin, a nënën, a fëmijët ose arat për hirin tim dhe për ungjillin,  
Jesus said, Truly I say to you, There is no man who has given up house, or brothers, or sisters, or mother, or father, or children, or land, because of me and the good news,  
αποκριθεις δε ο ιησους ειπεν αμην λεγω υμιν ουδεις εστιν ος αφηκεν οικιαν η αδελφους η αδελφας η πατερα η μητερα η γυναικα η τεκνα η αγρους ενεκεν εμου και του ευαγγελιου
- 30 që të mos marrë tani, në këtë kohë, njëqindfish shtëpi, vëllezër, motra, nëna, fëmijë e ara, së bashku me përndjekje, dhe në botën e ardhshme, jeta e përjetshme.  
Who will not get a hundred times as much now in this time, houses, and brothers, and sisters, and mothers, and children, and land--though with great troubles; and, in the world to come, eternal life.  
εαν μη λαβη εκατονταπλασιονα νυν εν τω καιρω τουτω οικιας και αδελφους και αδελφας και μητερας και τεκνα και αγρους μετα διωγων και εν τω αιωνι τω ερχομενω ζωνν αιωνιον
- 31 Por shumë të parë do të jenë të fundit dhe shumë të fundit do të jenë të parët".  
But a great number who are first will be last: and those who are last will be first.  
πολλοι δε εσονται πρωτοι εσχατοι και οι εσχατοι πρωτοι
- 32 Ata ishin në udhëtim për t'u ngjitur në Jeruzalem, dhe Jezusi i paraprinte. Dhe ata ishin të tronditur dhe e ndiqnin me ndrojtje. Dhe ai i mblodhi përsëri të dymbëdhjetët mënjane dhe nisi t'u thotë çfarë do t'i ndodhte:  
And they were on the way, going up to Jerusalem; and Jesus was going before them: and they were full of wonder; but those who came after him were in fear. And again he took the twelve, and gave them word of the things which were to come on him,  
ησαν δε εν τη οδω αναβαινοντες εις ιεροσολυμα και ην προαγων αυτους ο ιησους και εθαμβουντο και ακολουθουντες εφοβουντο και παραλαβον παλιν τους δωδεκα ηρξατο αυτοις λεγειν τα μελλοντα αυτω συμβαινειν
- 33 "Ja, ne po ngjitemi në Jeruzalem dhe Biri i njeriut do t'u dorëzohet krerëve të priftërinjve dhe skribëve; dhe ata do ta dënojnë me vdekje dhe do ta dorëzojnë në duar të paganëve,  
Saying, See, we go up to Jerusalem; and the Son of man will be given up to the chief priests and the scribes; and they will give an order for his death, and will give him up to the Gentiles:  
οτι ιδου αναβαινομεν εις ιεροσολυμα και ο υιος του ανθρωπου παραδοθησεται τοις αρχιερευσιν και τοις γραμματευσιν και κατακρινουσιν αυτον θανατω και παραδωσουσιν αυτον τοις εθνεσιν
- 34 të cilët do ta tallin, do ta fshikullojnë, do ta pështyjnë dhe do ta vrasin, por ai, ditën e tretë, do të ringjallet".  
And they will make sport of him, and put shame on him, and give him cruel blows, and will put him to death; and after three days he will come back from the dead.  
και εμπαιξουσιν αυτω και μαστιγωσουσιν αυτον και εμπτυσουσιν αυτω και αποκτενουσιν αυτον και τη τριτη ημερα αναστησεται

- 35 Atëherë Jakobi dhe Gjoni, bij të Zebedeut, iu afruan dhe i thanë: "Mësues, ne dëshirojmë që ti të bësh për ne atë që do të të kërkojmë".  
And there came to him James and John, the sons of Zebedee, saying to him, Master, will you give us whatever may be our request?  
και προσπορευονται αυτω ιακωβος και ιωαννης οι υιοι ζεβεδαιου λεγοντες διδασκαλε θελομεν ινα ο εαν αιτησωμεν ποιησης ημιν
- 36 Dhe ai u tha atyre: "Çfarë doni të bëj për ju?"  
And he said to them, What would you have me do for you?  
ο δε ειπεν αυτοις τι θελετε ποιησαι με υμιν
- 37 Ata i thanë: "Na lejo që të ulemi njëri në të djathtën tënde dhe tjetri në të majtën tënde në lavdinë tënde".  
And they said to him, Let us be seated, one at your right hand and one at your left, in your glory.  
οι δε ειπον αυτω δος ημιν ινα εις εκ δεξιων σου και εις εξ ευωνυμων σου καθισωμεν εν τη δοξη σου
- 38 Dhe Jezusi u tha atyre: "Ju nuk dini çfarë kërkoni. A mund të pini ju kupën që unë do të pi dhe të pagëzoheni me atë pagëzim me të cilin unë jam pagëzuar?". Ata i thanë: "Po, mundemi".  
But Jesus said to them, You have no knowledge of what you are saying. Are you able to take of my cup? or to undergo the baptism which I am to undergo?  
ο δε ιησους ειπεν αυτοις ουκ οιδате τι αιτεισθε δυνασθε πειν το ποτηριον ο εγω πινω και το βαπτισμα ο εγω βαπτιζομαι βαπτισθηναι
- 39 Dhe Jezusi u tha atyre: "Vërtetë ju do të pini kupën që unë po pij dhe do të pagëzoheni me atë pagëzim me të cilin jam pagëzuar,  
And they said to him, We are able. And Jesus said to them, You will take of the cup from which I take; and the baptism which I am about to undergo you will undergo:  
οι δε ειπον αυτω δυναμεθα ο δε ιησους ειπεν αυτοις το μεν ποτηριον ο εγω πινω πιασθε και το βαπτισμα ο εγω βαπτιζομαι βαπτισθησεσθε
- 40 por nuk më takon mua të vë dikë të ulët në të djathtën time ose në të majtën time, por është për ata për të cilët është përgatitur".  
But to be seated at my right hand or at my left is not for me to give: but it is for those for whom it has been made ready.  
το δε καθισαι εκ δεξιων μου και εξ ευωνυμων μου ουκ εστιν εμον δουναι αλλ οις ητοιμασται
- 41 Kur i dëgjjuan këto, të dhjetë të tjerët filluan të indinjohen kundër Jakobit dhe Gjonit.  
And hearing this, the ten became very angry with James and John.  
και ακουσαντες οι δεκα ηρξαντο αγανακτειν περι ιακωβου και ιωαννου
- 42 Por Jezusi i thirri pranë vetes dhe tha: "Ju e dini që ata që konsiderohen sundues të kombeve i sundojnë ato dhe të mëdhenjtë e tyre ushtrojnë mbi to pushtetin e tyre;  
And Jesus made them come to him, and said to them, You see that those who are made rulers over the Gentiles are lords over them, and their great ones have authority over them.  
ο δε ιησους προσκαλεσαμενος αυτους λεγει αυτοις οιδατε οτι οι δοκουντες αρχειν των εθνων κατακυριευουσιν αυτων και οι μεγαλοι αυτων κατεξουσιαζουσιν αυτων
- 43 por kjo s'duhet të ndodhë midis jush; madje ai nga ju që do të dojë të bëhet i madh, do të jetë shërbëtori juaj;  
But it is not so among you: but whoever has a desire to become great among you, let him be your servant:  
ουχ ουτως δε εσται εν υμιν αλλ ος εαν θελη γενεσθαι μεγας εν υμιν εσται διακονος υμων
- 44 dhe kushdo nga ju që do të dojë të jetë i pari, do të jetë skllavi i të gjithëve.  
And whoever has a desire to be first among you, let him be servant of all.  
και ος αν θελη υμων γενεσθαι πρωτος εσται παντων δουλος
- 45 Sepse edhe Biri i njeriut nuk erdhi që t'i shërbejnë, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si çmim për shpengimin e shumë vetave".  
For truly the Son of man did not come to have servants, but to be a servant, and to give his life for the salvation of men.  
και γαρ ο υιος του ανθρωπου ουκ ηλθεν διακονηθηναι αλλα διακονησαι και δουναι την ψυχην αυτου λυτρον αντι πολλων
- 46 Kështu arritën në Jeriko. Kur ai po dilte nga Jeriko me dishepujt e tij dhe me një turmë të madhe, biri i Timoteut, Bartimeu i verbër, ishte ulur gjatë rrugës dhe lypte.  
And they came to Jericho: and when he was going out of Jericho, with his disciples and a great number of people, the son of Timaeus, Bartimeus, a blind man, was seated by the wayside, with his hand out for money.  
και ερχονται εις ιεριχω και εκπορευομενου αυτου απο ιεριχω και των μαθητων αυτου και οχλου ικανου υιος τιμαιου βαρτιμαιος ο τυφλος εκαθητο παρα την οδον προσαιτω
- 47 Kur dëgjoi se ai që po kalonte ishte Jezusi Nazareas, filloi të bërtasë dhe të thotë: "Jezus, Bir i Davidit, ki mëshirë për mua!".  
And when it came to his ears that it was Jesus of Nazareth, he gave a cry, and said, Jesus, Son of David, have mercy on me.  
και ακουσας οτι ιησους ο ναζωραιος εστιν ηρξατο κραζειν και λεγειν ο υιος δαβιδ ιησου ελεησον με
- 48 Shumë e qortonin që të heshte, por ai bërtiste edhe më fort: "Bir i Davidit, ki mëshirë për mua!".  
And some of them, turning in protest, gave him an order to be quiet: but he went on crying out all the more, Son of David, have mercy on me.  
και επετιμων αυτω πολλοι ινα σιωπηση ο δε πολλω μαλλον εκραζεν υιε δαβιδ ελεησον με

- 49 Dhe Jezusi qëndroi dhe urdhëroi që ta thërrasin. Ata e thirrën, pra, të verbërin duke i thënë: "Merr zemër, çohu, ai po të thërret!".  
And Jesus came to a stop and said, Let him come. And crying out to the blind man, they said to him, Be comforted: come, he has sent for you.  
και στας ο ιησους ειπεν αυτον φωνηθηναι και φωνουσιν τον τυφλον λεγοντες αυτω θαρσει εγεραι φωνει σε
- 50 Atëherë ai hodhi tej rrobën e tij, u ngrit dhe erdhi te Jezusi.  
And he, putting off his coat, got up quickly, and came to Jesus.  
ο δε αποβαλων το ιματιον αυτου αναστας ηλθεν προς τον ιησουν
- 51 Dhe Jezusi mori fjalën dhe i tha: "Çfarë do që unë të të bëj?". I verbëri i tha: "Rabboni, që të më kthehet të parit!".  
And Jesus said to him, What would you have me do to you? And the blind man said, Master, make me able to see.  
και αποκριθεις λεγει αυτω ο ιησους τι θελεις ποιησω σοι ο δε τυφλος ειπεν αυτω ραββوني ινα αναβλεπω
- 52 Dhe Jezusi i tha: "Shko, besimi yt të shëroi". Dhe në çast atij iu kthye të parit dhe nisi të ndjekë Jezusin në udhë.  
And Jesus said to him, Go on your way; your faith has made you well. And straight away he was able to see, and went after him in the way.  
ο δε ιησους ειπεν αυτω υπαγε η πιστις σου σεσωκεν σε και ευθεως ανεβλεψεν και ηκολουθει τω ιησου εν τη οδω
- 1 Tani kur iu afruan Jeruzalemit, drejt Betfage dhe Betania, afër malit të Ullinjve, Jezusi dërgoi dy nga dishepujt e vet,  
And when they came near to Jerusalem, to Beth-phage and Bethany, at the Mountain of Olives, he sent two of his disciples,  
και οτε εγγιζουσιν εις ιερουσαλημ εις βηθφαγη και βηθανιαν προς το ορος των ελαιων αποστελλει δυο των μαθητων αυτου
- 2 duke u thënë: "Shkoni në fshatin përballë dhe, posa të hyni aty, do të gjeni një kërriq të lidhur, mbi të cilin akoma nuk ka hipur askush; zgjidheni dhe ma sillni.  
And said to them, Go into the little town opposite: and when you come to it, you will see a young ass with a cord round his neck, on which no man has ever been seated; let him loose, and come back with him.  
και λεγει αυτοις υπαγετε εις την κομην την κατεναντι υμων και ευθεως εισπορευομενοι εις αυτην ευρησατε πωλον δεδεμενον εφ ον ουδεις ανθρωπων κεκαθικεν λυσαντες αυτον αγαγετε
- 3 Dhe në se ndokush iu thotë: "Pse po veproni kështu?", përgjigjuni: "I duhet Zotit. Ai do ta kthejë menjëherë këtu".  
And if anyone says to you, Why are you doing this? say, The Lord has need of him and will send him back straight away.  
και εαν τις υμιν ειπη τι ποιειτε τουτο ειπατε οτι ο κυριος αυτου χρειαν εχει και ευθεως αυτον αποστελει οδε
- 4 Ata shkuan dhe e gjetën kërriqin të lidhur afër një dëre, në rrugë, dhe e zgjidhën.  
And they went away and saw a young ass by the door outside in the open street; and they were getting him loose.  
απηλθον δε και ευρον τον πωλον δεδεμενον προς την θυραν εξω επι του αμφοδου και λουσιν αυτον
- 5 Disa nga të pranishmit u thanë atyre: "Ç'po bëni? Pse po e zgjidhni kërriqin?".  
And some of those who were there said to them, What are you doing, taking the ass?  
και τινες των εκει εστηκοτων ελεγον αυτοις τι ποιειτε λυοντες τον πωλον
- 6 Këta iu përgjigjën ashtu si u kishte thënë Jezusi dhe ata i lanë të shkojnë.  
And they said to them the words which Jesus had said; and they let them go.  
οι δε ειπον αυτοις καθως ενετειλατο ο ιησους και αφηκαν αυτους
- 7 Atëherë ia çuan Jezusit kërriqin, vunë mbi të mantelet e tyre dhe ai u ul mbi të.  
And they took the young ass to Jesus, and put their clothing on him, and he got on his back.  
και ηγαγον τον πωλον προς τον ιησουν και επεβαλον αυτω τα ιματια αυτων και εκαθισεν επ αυτω
- 8 Shumë njerëz i shtronin rrobat e tyre rrugës dhe të tjerë pritnin degë nga pemët dhe i hidhnin rrugës.  
And a great number put down their clothing in the way; and others put down branches which they had taken from the fields.  
πολλοι δε τα ιματια αυτων εστρωσαν εις την οδον αλλοι δε στοιβαδας εκοπτον εκ των δενδρων και εστρωννυον εις την οδον
- 9 Dhe si ata që pararendnin, edhe ata që ndiqnin Jezusin, thërrisnin dhe thonin: "Hosana! Bekuar është ai që vjen në emër të Zotit!  
And those who went in front, and those who came after, were crying, Glory: A blessing on him who comes in the name of the Lord:  
και οι προαγοντες και οι ακολουθουντες εκραζον λεγοντες ωσαννα ευλογημενος ο ερχομενος εν ονοματι κυριου
- 10 E bekuar është mbretëria e Davidit, atit tonë, që vjen në emër të Zotit. Hosana në vendet shumë të larta!".  
A blessing on the coming kingdom of our father David: Glory in the highest.  
ευλογημενη η ερχομενη βασιλεια εν ονοματι κυριου του πατρος ημων δαβιδ ωσαννα εν τοις υψιστοις

- 23 Kush më urren mua, urren edhe Atin tim.  
He who has hate for me has hate for my Father.  
ο εμε μισων και τον πατερα μου μισει
- 24 Po të mos kisha bërë në mes tyre vepra që askush tjetër nuk ka bërë, nuk do të kishin faj; por tani, përkundrazi, e kanë parë, dhe më kanë urreyer mua dhe Atin tim.  
If I had not done among them the works which no other man ever did, they would have had no sin: but now they have seen, and they have had hate in their hearts for me and my Father.  
ει τα εργα μη εποιησα εν αυτοις α ουδεις αλλος πεποιηκεν αμαρτιαν ουκ ειχον νυν δε και εωρακασιν και μεμισηκασιν και εμε και τον πατερα μου
- 25 Por kjo ndodhi që të përmbushet fjala e shkruar në ligjin e tyre: "Më kanë urreyer pa shkak"  
This comes about so that the writing in their law may be made true, Their hate for me was without cause.  
αλλ ινα πληρωθη ο λογος ο γεγραμμενος εν τω νομο αυτων οτι εμισησαν με δωρεαν
- 26 Por kur të vijë Ngushëlluesi, që do t'ju dërgoj prej Atit, Fryma e së vërtetës, që del nga Ati im, ai do të dëshmojë për mua.  
When the Helper comes, whom I will send to you from the Father even the Spirit of true knowledge who comes from the Father--he will give witness about me;  
οταν δε ελθη ο παρακλητος ον εγω πεμψω υμιν παρα του πατρος το πνευμα της αληθειας ο παρα του πατρος εκπορευεται εκεινος μαρτυρησει περι εμου
- 27 Edhe ju, gjithashtu, do të dëshmoni, sepse ishit me mua që nga fillimi".  
And you, in addition, will give witness because you have been with me from the first.  
και υμεις δε μαρτυρειτε οτι απ αρχης μετ εμου εστε
- 1 "Jua kam thënë këto gjëra, që të mos skandalizoheni.  
I have said these things to you so that you may not be in doubt.  
ταυτα λελαληκα υμιν ινα μη σκανδαλισθητε
- 2 Do t'ju përjashtojnë nga sinagogat; madje po vjen ora kur, kushdo që t'ju vrasë, do të mendojë se i ka kryer një shërbim Perëndisë.  
They will put you out of the Synagogues: yes, the time is coming when whoever puts you to death will have the belief that he is doing God's pleasure.  
αποσυναγωγους ποιησουσιν υμας αλλ ερχεται ωρα ινα πας ο αποκτεινας υμας δοξη λατρειαν προσφερειν τω θεω
- 3 Dhe do t'ju bëjnë këto gjëra, sepse nuk kanë njohur as Atin, as mua.  
They will do these things to you because they have not had knowledge of the Father or of me.  
και ταυτα ποιησουσιν υμιν οτι ουκ εγνωσαν τον πατερα ουδε εμε
- 4 Por unë jua kam thënë këto gjëra që, kur të vijë momenti, të kujtoheni se unë jua kisha thënë; por nga fillimi këto fjalë nuk jua pata thënë, sepse isha me ju.  
I have said these things to you so that when the time comes, what I have said may come to your mind. I did not say them to you at the first, because then I was still with you.  
αλλα ταυτα λελαληκα υμιν ινα οταν ελθη η ωρα μνημονευητε αυτων οτι εγω ειπον υμιν ταυτα δε υμιν εζ αρχης ουκ ειπον οτι μεθ υμων ημην
- 5 Por tani unë po shkoj tek ai që më ka dërguar, dhe askush nga ju s'po më pyet: "Ku po shkon?"  
But now I am going to him who sent me; and not one of you says to me, Where are you going?  
νυν δε υπαγω προς τον πεμψαντα με και ουδεις εζ υμων ερωτα με που υπαγεις
- 6 Madje, për shkak se ju thashë këto gjëra, trishtimi e ka mbushur zemrën tuaj.  
But your hearts are full of sorrow because I have said these things.  
αλλ οτι ταυτα λελαληκα υμιν η λυπη πεπληρωκεν υμων την καρδιαν
- 7 Megjithatë unë ju them të vërtetën: është mirë për ju që unë të shkoj, sepse, po nuk shkova, nuk do të vijë te ju Ngushëlluesi; por, po shkova, unë do t'ju dërgoj.  
But what I am saying is true: my going is for your good: for if I do not go away, the Helper will not come to you; but if I go, I will send him to you.  
αλλ εγω την αληθειαν λεγω υμιν συμφερει υμιν ινα εγω απελθω εαν γαρ μη απελθω ο παρακλητος ουκ ελευσεται προς υμας εαν δε πορευθω πεμψω αυτον προς υμας
- 8 Dhe kur të ketë ardhur, ai do ta bindë botën për mëkat, për drejtësi dhe për gjykim.  
And he, when he comes, will make the world conscious of sin, and of righteousness, and of being judged:  
και ελθων εκεινος ελεγει τον κοσμον περι αμαρτιας και περι δικαιοσυνης και περι κρισεως

- 9 Për mëkat, sepse nuk besojnë në mua;  
Of sin, because they have not faith in me;  
περι αμαρτίας μεν οτι ου πιστευουσιν εις εμε
- 10 për drejtësi, sepse unë po shkoj tek Ati dhe nuk do të më shihni më;  
Of righteousness, because I go to the Father and you will see me no more;  
περι δικαιοσυνης δε οτι προς τον πατερα μου υπαγω και ουκ ετι θεωρειτε με
- 11 për gjykim, sepse princi i kësaj bote është gjykuar.  
Of being judged, because the ruler of this world has been judged.  
περι δε κρισεως οτι ο αρχων του κοσμου τουτου κεκριται
- 12 Kam edhe shumë gjëra të tjera për t'ju thënë, por ato ende ju nuk mund t'i mbani.  
I have still much to say to you, but you are not strong enough for it now.  
ετι πολλα εχω λεγειν υμιν αλλ ου δυνασθε βασταζειν αρτι
- 13 Por, kur të vijë ai, Fryma e së vërtetës, ai do t'ju prijë në çdo të vërtetë, sepse ai nuk do të flasë nga vetja, por do të thotë gjitha ato gjëra që ka dëgjuar dhe do t'ju kumtojë gjërat që do vijnë.  
However, when he, the Spirit of true knowledge, has come, he will be your guide into all true knowledge: for his words will not come from himself, but whatever has come to his hearing, that he will say: and he will make clear to you the things to come.  
οταν δε ελθη εκεινος το πνευμα της αληθειας οδηγησει υμας εις πασαν την αληθειαν ου γαρ λαλησει αφ εαυτου αλλ οσα αν ακουση λαλησει και τα ερχομενα αναγγελει υμιν
- 14 Ai do të më përlevdojë, sepse do të marrë prej meje dhe do t'jua kumtojë.  
He will give me glory, because he will take of what is mine, and make it clear to you.  
εκεινος εμε δοξασει οτι εκ του εμου ληφεται και αναγγελει υμιν
- 15 Të gjitha gjërat që ka Ati janë të miat; për këtë ju thashë se ai do të marrë prej simes dhe do t'jua kumtojë.  
Everything which the Father has is mine: that is why I say, He will take of what is mine and will make it clear to you.  
παντα οσα εχει ο πατηρ εμα εστιν δια τουτο ειπον οτι εκ του εμου ληφεται και αναγγελει υμιν
- 16 Pas pak nuk do të më shihni më; e përsëri një kohë e shkurtër e do të më shihni, sepse unë po shkoj tek Ati".  
After a little time you will see me no longer; and then again, after a little time, you will see me.  
μικρον και ου θεωρειτε με και παλιν μικρον και οψεσθε με οτι εγω υπαγω προς τον πατερα
- 17 Atëherë disa nga dishepujt e tij thoshnin midis tyre: "Ç'është kjo që po na thotë: "Pas pak nuk do të më shihni më", dhe: "e përsëri një kohë e shkurtër e do të më shihni dhe: "Sepse unë po shkoj te Ati"?".  
So some of the disciples said one to another, What is this he is saying, After a little time, you will see me no longer; and then again, after a little time, you will see me? and, I am going to the Father?  
ειπον ουν εκ των μαθητων αυτου προς αλληλους τι εστιν τουτο ο λεγει ημιν μικρον και ου θεωρειτε με και παλιν μικρον και οψεσθε με και οτι εγω υπαγω προς τον πατερα
- 18 Thoshnin pra: "Ç'është kjo "Pas pak", për të cilën flet? Ne s'dimë ç'don të thotë".  
So they said again and again, What is this he is saying, A little time? His words are not clear to us.  
ελεγον ουν τουτο τι εστιν ο λεγει το μικρον ουκ οιδαμεν τι λαλει
- 19 Jezusi, pra, e kuptoi se ata donin ta pyesnin dhe u tha atyre: "Ju po pyesni njeri tjetrin pse thashë: "Pas pak nuk do të më shihni më", dhe: "E përsëri një kohë e shkurtër e do të më shihni"?".  
Jesus saw that they had a desire to put the question to him, so he said to them, Is this what you are questioning one with another, why I said, After a little time, you will see me no longer; and then again, after a little time, you will see me?  
εγνω ουν ο ιησους οτι ηθελον αυτον ερωταν και ειπεν αυτοις περι τουτου ζητατε μετ αλληλων οτι ειπον μικρον και ου θεωρειτε με και παλιν μικρον και οψεσθε με
- 20 Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: ju do të qani dhe do të mbani zi dhe bota do të gëzohet. Ju do të pikëlloheni, por pikëllimi juaj do të kthehet në gëzim.  
Truly I say to you, You will be weeping and sorrowing, but the world will be glad: you will be sad, but your sorrow will be turned into joy.  
αμην αμην λεγω υμιν οτι κλαυσετε και θρηνησετε υμεις ο δε κοσμος χαρησεται υμεις δε λυπηθησεσθε αλλ η λυπη υμων εις χαραν γενησεται
- 21 Gruaja, kur lind, ka dhembje, sepse i erdhi ora; por, sapo e ka lindur fëmijën, nuk kujton më ankthin prej gëzimit që lindi një qenie njerëzore në botë.  
When a woman is about to give birth she has sorrow, because her hour is come; but when she has given birth to the child, the pain is put out of her mind by the joy that a man has come into the world.  
η γυνη οταν τικτη λυπην εχει οτι ηλθεν η ωρα αυτης οταν δε γεννηση το παιδιον ουκ ετι μνημονευει της θλιψεως δια την χαραν οτι εγεννηθη ανθρωπος εις τον κοσμον

- 22 Kështu edhe ju tani jeni në dhembje, por unë do t'ju shoh përsëri dhe zemra juaj do të gëzohet, dhe askush nuk do t'ua heqë gëzimin tuaj.  
So you have sorrow now: but I will see you again, and your hearts will be glad, and no one will take away your joy.  
και υμεις ουν λυπην μεν νυν εχετε παλιν δε οψομαι υμας και χαρησεται υμων η καρδια και την χαραν υμων ουδεις αρει αφ υμων
- 23 Atë ditë ju nuk do të më bëni më asnjë pyetje. Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them se çdo gjë që t'i kërkoni Atit në emrin tim, ai do t'ju japë.  
And on that day you will put no questions to me. Truly I say to you, Whatever request you make to the Father, he will give it to you in my name.  
και εν εκεινη τη ημερα εμε ουκ ερωτησετε ουδεν αμην αμην λεγω υμιν οτι οσα αν αιτησητε τον πατερα εν τω ονοματι μου δωσει υμιν
- 24 Deri tani ju s'keni kërkuar asgjë në emrin tim; kërkoni dhe do të merrni, që gëzimi juaj të jetë i plotë.  
Up to now you have made no request in my name: do so, and it will be answered, so that your hearts may be full of joy.  
εως αρτι ουκ ητησατε ουδεν εν τω ονοματι μου αιτειτε και ληψεσθε ινα η χαρα υμων η πεπληρωμενη
- 25 Jua kam thënë këto gjëra në shëmbëlltyra, por po vjen ora kur nuk do t'ju flas më me shëmbëlltyra, por do t'ju flas haptas për Atin.  
All this I have said to you in veiled language: but the time is coming when I will no longer say things in veiled language but will give you knowledge of the Father clearly.  
ταυτα εν παροιμιας λελαληκα υμιν αλλ ερχεται ωρα οτε ουκ ετι εν παροιμιας λαλησω υμιν αλλα παρρησια περι του πατρος αναγγελω υμιν
- 26 Në atë ditë ju do të kërkoni në emrin tim; dhe nuk po them se unë do t'i lutem Atit për ju;  
In that day you will make requests in my name: and I do not say that I will make prayer to the Father for you,  
εν εκεινη τη ημερα εν τω ονοματι μου αιτησεσθε και ου λεγω υμιν οτι εγω ερωτησω τον πατερα περι υμων
- 27 Ati vetë në fakt ju do, sepse ju më deshët mua dhe keni besuar se unë dola nga Perëndia.  
For the Father himself gives his love to you, because you have given your love to me and have had faith that I came from God.  
αυτος γαρ ο πατηρ φιλει υμας οτι υμεις εμε πεφιληκατε και πεπιστευκατε οτι εγω παρα του θεου εξηλθον
- 28 Unë dola nga Ati dhe erdha në botë; përsëri po e lë botën dhe kthehem tek Ati".  
I came out from the Father and have come into the world: again, I go away from the world and go to the Father.  
εξηλθον παρα του πατρος και εληλυθα εις τον κοσμον παλιν αφημι τον κοσμον και πορευομαι προς τον πατερα
- 29 Dishepujt e tij i thanë: "Ja, ti tani po flet haptas dhe s'po përdor asnjë shëmbëlltyrë.  
His disciples said, Now you are talking clearly and not in veiled language.  
λεγουσιν αυτω οι μαθηται αυτου ιδε νυν παρρησια λαλεις και παροιμιαν ουδεμιαν λεγεις
- 30 Tani ne njohim se ti di gjithçka dhe s'ke nevojë që ndokush të të pyesë; prandaj ne besojmë se ke dalë nga Perëndia".  
Now we are certain that you have knowledge of all things and have no need for anyone to put questions to you: through this we have faith that you came from God.  
νυν οιδαμεν οτι οιδας παντα και ου χρειαν εχεις ινα τις σε ερωτα εν τωτου πιστευομεν οτι απο θεου εξηλθες
- 31 Jezusi u përgjigj atyre: "A besoni tani?  
Jesus made answer, Have you faith now?  
απεκριθη αυτοις ο ιησους αρτι πιστευετε
- 32 Ja, po vjen ora, madje tashmë ka ardhur, në të cilën ju do të shpërndaheni, secili për punë të vet, dhe do të më lini vetëm; por unë nuk jam vetëm, sepse Ati është me mua.  
See, a time is coming, yes, it is now here, when you will go away in all directions, every man to his house, and I will be by myself: but I am not by myself, because the Father is with me.  
ιδου ερχεται ωρα και νυν εληλυθεν ινα σκορπισθητε εκαστος εις τα ιδια και εμε μονον αφητε και ουκ εμι μονος οτι ο πατηρ μετ εμου εστιν
- 33 Jua kam thënë këto gjëra, që ta keni paqen në mua; në botë do të keni mundime, por merrni zemër, unë e munda botën!".  
I have said all these things to you so that in me you may have peace. In the world you have trouble: but take heart! I have overcome the world.  
ταυτα λελαληκα υμιν ινα εν εμοι ειρηνην εχητε εν τω κοσμω θλιψιν εχετε αλλα θαρσειτε εγω νενικηκα τον κοσμον
- 1 Jezusi tha këto gjëra, pastaj i ngriti sytë drejt qiellit dhe tha: "O Atë, ora ka ardhur, përlëvdo Birin tënd, që edhe Biri yt të të përlëvdojë,  
Jesus said these things; then, lifting his eyes to heaven, he said, Father, the time has now come; give glory to your Son, so that the Son may give glory to you:  
ταυτα ελαλησεν ο ιησους και επηρεν τους οφθαλμους αυτου εις τον ουρανον και ειπεν πατερ εληλυθεν η ωρα δοξασον σου τον υιον ινα και ο υιος σου δοξαση σε
- 2 sepse ti i ke dhënë pushtet mbi çdo mish, që t'u japë jetë të përjetshme të gjithë atyre që ti ia ke dhënë.  
Even as you gave him authority over all flesh, to give eternal life to all those whom you have given to him.  
καθως εδωκας αυτω εξουσιαν πασης σαρκος ινα παν ο δεδωκας αυτω δωση αυτοις ζωην αιωνιον

- 3 Dhe kjo është jeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar.  
*And this is eternal life: to have knowledge of you, the only true God, and of him whom you have sent, even Jesus Christ.*  
*αυτη δε εστιν η αιωνιος ζωη ινα γνωσκωσιν σε τον μονον αληθινον θεον και ον απεστειλας ιησουν χριστον*
- 4 Unë të kam përlëvduar mbi tokë; unë e kam kryer veprën që më ke dhënë të bëj.  
*I have given you glory on the earth, having done all the work which you gave me to do.*  
*εγω σε εδοξασα επι της γης το εργον ετελειωσα ο δεδωκας μοι ινα ποιησω*
- 5 Tani, pra, më përlëvdo, o Atë, pranë teje, me lavdinë që unë e kisha pranë teje para se të bëhej bota.  
*And now, Father, let me have glory with you, even that glory which I had with you before the world was.*  
*και νυν δοξασον με συ πατερ παρα σεαυτω τη δοξη η ειχον προ του τον κοσμον ιναι παρα σοι*
- 6 Unë ia kam dëftuar emrin tënd njerëzve që ti m'i ke dhënë nga bota; ishin të tutë dhe ti m'i ke dhënë; dhe ata e kanë zbatuar fjalën tënde.  
*I have given knowledge of your name to the men whom you gave me out of the world: yours they were, and you gave them to me, and they have kept your words.*  
*εφανερωσα σου το ονομα τοις ανθρωποις ους δεδωκας μοι εκ του κοσμου σοι ησαν και εμοι αυτους δεδωκας και τον λογον σου τετηρηκασιν*
- 7 Tani ata kanë njohur se të gjitha gjërat që ti më ke dhënë vijnë prej teje,  
*Now it is clear to them that whatever you have given to me comes from you:*  
*νυν εγνωκαν οτι παντα οσα δεδωκας μοι παρα σου εστιν*
- 8 sepse ua kam dhënë atyre fjalët që ti më ke dhënë mua; dhe ata i kanë pranuar dhe kanë njohur se me të vërtetë unë dola nga ti, dhe kanë besuar se ti më ke dërguar.  
*Because I have given them the words which you gave to me; and they have taken them to heart, and have certain knowledge that I came from you, and they have faith that you sent me.*  
*οτι τα ρηματα α δεδωκας μοι δεδωκα αυτοις και αυτοι ελαβον και εγνωσαν αληθως οτι παρα σου εξηλθον και επιστευσαν οτι συ με απεστειλας*
- 9 Unë lutem për ta, nuk lutem për botën, po për ata që më ke dhënë, sepse janë të tutë.  
*My prayer is for them: my prayer is not for the world, but for those whom you have given to me, because they are yours*  
*εγω περι αυτων ερωτω ου περι του κοσμου ερωτω αλλα περι ων δεδωκας μοι οτι σοι εισιν*
- 10 Dhe të gjitha gjërat e mia janë të tuat, dhe gjërat e tua janë të miat; dhe unë jam përlëvduar në to.  
*(All mine are yours, and yours are mine) and I have glory in them.*  
*και τα εμα παντα σα εστιν και τα σα εμα και δεδοξασμαι εν αυτοις*
- 11 Tani unë nuk jam më në botë, por ata janë në botë, dhe unë po vij te ti. O Atë i shenjtë, i ruaj ata në emrin tënd, ata që më ke dhënë, që të jenë një sikurse ne!  
*And now I will be no longer in the world, but they are in the world and I come to you. Holy Father, keep them in your name which you have given to me, so that they may be one even as we are one.*  
*και ουκ ετι ειμι εν τω κοσμω και αυτοι εν τω κοσμω εισιν και εγω προς σε ερχομαι πατερ αγιε τηρησον αυτους εν τω ονοματι σου ους δεδωκας μοι ινα ωσιν εν καθως ημεις*
- 12 Kur isha me ata në botë, unë i kam ruajtur në emrin tënd; unë i kam ruajtur ata që ti më ke dhënë dhe askush nga ata nuk ka humbur, përveç birit të humbjes, që të përmbushej Shkrimi.  
*While I was with them I kept them safe in your name which you have given to me: I took care of them and not one of them has come to destruction, but only the son of destruction, so that the Writings might come true.*  
*οτε ημην μετ αυτων εν τω κοσμω εγω ετηρουν αυτους εν τω ονοματι σου ους δεδωκας μοι εφυλαξα και ουδεις εξ αυτων απωλετο ει μη ο υιος της απωλειας ινα η γραφη πληρωθη*
- 13 Por tani unë po vij te ti dhe i them këto gjëra në botë, që gëzimi im të bëhet i plotë në ta.  
*And now I come to you; and these things I say in the world so that they may have my joy complete in them.*  
*νυν δε προς σε ερχομαι και ταυτα λαλω εν τω κοσμω ινα εχωσιν την χαραν την εμην πεπληρωμενην εν αυτοις*
- 14 Unë u kam dhënë atyre fjalën tënde dhe bota i ka urreyer, sepse nuk janë prej botës, ashtu si edhe unë nuk jam prej botës.  
*I have given your word to them; and they are hated by the world, because they are not of the world, even as I am not of the world.*  
*εγω δεδωκα αυτοις τον λογον σου και ο κοσμος εμισησεν αυτους οτι ουκ εισιν εκ του κοσμου καθως εγω ουκ ειμι εκ του κοσμου*
- 15 Unë nuk kërkoj që ti t'i heqësh nga bota, por që ti t'i mbrosh nga i ligu.  
*My prayer is not that you will take them out of the world, but that you will keep them from the Evil One.*  
*ουκ ερωτω ινα αρης αυτους εκ του κοσμου αλλ ινα τηρησης αυτους εκ του πονηρου*
- 16 Ata nuk janë nga bota, sikurse unë nuk jam nga bota.  
*They are not of the world any more than I am of the world.*  
*εκ του κοσμου ουκ εισιν καθως εγω εκ του κοσμου ουκ ειμι*



- 17 Shenjtëroji në të vërtetën tënde; fjala jote është e vërteta.  
 Make them holy by the true word: your word is the true word.  
 αγιασον αυτους εν τη αληθεια σου ο λογος ο σος αληθεια εστιν
- 18 Sikurse ti më ke dërguar mua në botë, po ashtu unë i kam dërguar ata në botë.  
 Even as you have sent me into the world, so I have sent them into the world.  
 καθως εμε απεστειλας εις τον κοσμον καγω απεστειλα αυτους εις τον κοσμον
- 19 Dhe unë për ta po shenjtëroj vetveten, që edhe ata të jenë të shenjtëruar në të vërtetë.  
 And for them I make myself holy, so that they may be made truly holy.  
 και υπερ αυτων εγω αγιαζω εμαυτον ινα και αυτοι ωσιν ηγιασμενοι εν αληθεια
- 20 Tani unë nuk lutem vetëm për ta, por edhe për ata që do të besojnë në mua me anë të fjalës së tyre,  
 My prayer is not for them only, but for all who will have faith in me through their word;  
 ου περι τουτων δε ερωτω μονον αλλα και περι των πιστευσοντων δια του λογου αυτων εις εμε
- 21 që të gjithë të jenë një, ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty; edhe ata të jenë një në ne, që bota të besojë se ti më ke dërguar.  
 May they all be one! Even as you, Father, are in me and I am in you, so let them be in us, so that all men may come to have faith that you sent me.  
 ινα παντες εν ωσιν καθως συ πατερ εν εμοι καγω εν σοι ινα και αυτοι εν ημιν εν ωσιν ινα ο κοσμος πιστευση οτι συ με απεστειλας
- 22 Dhe unë u kam dhënë lavdinë që më ke dhënë, që ata të jenë një, ashtu si ne jemi një.  
 And the glory which you have given to me I have given to them, so that they may be one even as we are one;  
 και εγω την δοξαν ην δεδωκας μοι δεδωκα αυτοις ινα ωσιν εν καθως ημεις εν εσμεν
- 23 Unë jam në ta dhe ti në mua, që të jenë të përsosur në unitet dhe që bota të njohë që ti më ke dërguar dhe që i ke dashur, ashtu si më ke dashur mua.  
 I in them, and you in me, so that they may be made completely one, and so that it may become clear to all men that you have sent me and that they are loved by you as I am loved by you.  
 εγω εν αυτοις και συ εν εμοι ινα ωσιν τετελειωμενοι εις εν και ινα γινωσκη ο κοσμος οτι συ με απεστειλας και ηγαπησας αυτους καθως εμε ηγαπησας
- 24 O Atë, unë dua që atje ku jam unë, të jenë me mua edhe ata që më ke dhënë, që ta shohin lavdinë time që ti më ke dhënë, sepse ti më ke dashur para themelimit të botës.  
 Father, it is my desire that these whom you have given to me may be by my side where I am, so that they may see my glory which you have given to me, because you had love for me before the world came into being.  
 πατερ ους δεδωκας μοι θελω ινα οπου ειμι εγω κακεινοι ωσιν μετ εμου ινα θεωρωσιν την δοξαν την εμην ην εδωκας μοι οτι ηγαπησας με προ καταβολης κοσμου
- 25 O atë i drejtë, bota nuk të ka njohur, por unë të kam njohur; dhe këta e kanë njohur se ti më ke dërguar.  
 Father of righteousness, I have knowledge of you, though the world has not; and to these it is clear that you sent me;  
 πατερ δικαιε και ο κοσμος σε ουκ εγνω εγω δε σε εγνω και ουτοι εγνωσαν οτι συ με απεστειλας
- 26 Dhe unë i kam bërë të njohin emrin tënd dhe do të bëj ta njohin akoma, që dashuria, me të cilën ti më ke dashur mua, të jetë në ta dhe unë në ta".  
 And I have given to them knowledge of your name, and will give it, so that the love which you have for me may be in them and I in them.  
 και εγνωρισα αυτοις το ονομα σου και γνωρισω ινα η αγαπη ην ηγαπησας με εν αυτοις η καγω εν αυτοις
- 1 Mbasi i tha këto gjëra, Jezusi doli me dishepujt e vet dhe shkoi përtej përroit të Kedronit, ku ishte një kopsht, në të cilin hyri ai me dishepujt e tij.  
 When Jesus had said these words he went out with his disciples over the stream Kedron to a garden, into which he went with his disciples.  
 ταυτα ειπων ο ιησους εξηλθεν συν τοις μαθηταις αυτου περαν του χειμαρρου των κεδρων οπου ην κηπος εις ον εισηλθεν αυτος και οι μαθηται αυτου
- 2 Dhe Juda, i cili po e tradhtonte, e njihje edhe ai atë vend, sepse shpesh herë Jezusi tërhiqej atje me dishepujt e tij.  
 And Judas, who was false to him, had knowledge of the place because Jesus went there frequently with his disciples.  
 ηδει δε και ιουδας ο παραδιδους αυτον τον τοπον οτι πολλακις συνηχθη ο ιησους εκει μετα των μαθητων αυτου
- 3 Atëherë Juda mori një grup ushtarësh dhe rojat e dërguara nga krerët e priftërinjve dhe nga farisenjtë, erdhi atje me fenerë, pishtarë dhe me armë.  
 So Judas, getting a band of armed men and police from the chief priests and Pharisees, went there with lights and with arms.  
 ο ουν ιουδας λαβων την σπειραν και εκ των αρχιερων και φαρισαιων υπηρετας ερχεται εκει μετα φανων και λαμπαδων και οπλων
- 4 Atëherë Jezusi, duke ditur gjithçka që do t'i ndodhte, doli dhe i pyeti: "Kë kërkoni?".  
 Then Jesus, having knowledge of everything which was coming on him, went forward and said to them, Who are you looking for?  
 ιησους ουν ειδως παντα τα ερχομενα επ αυτον εξελθων ειπεν αυτοις τινα ζητατε

- 5 Ata iu përgjigjën: "Jezusin Nazareas". Jezusi u tha atyre: "Unë jam!". Por Juda, që po e tradhtonte, ishte edhe ai me ta.  
Their answer was, Jesus the Nazarene. Jesus said, I am he. And Judas, who was false to him, was there at their side.  
απεκριθησαν αυτω ιησουν τον ναζωραιον λεγει αυτοις ο ιησους εγω ειμι ειστηκει δε και ιουδας ο παραδιδους αυτον μετ αυτων
- 6 Sapo ai u tha atyre: "Unë jam", ata u zmbrapsën dhe ranë për dhe.  
And when he said to them, I am he, they went back, falling to the earth.  
ως ουν ειπεν αυτοις οτι εγω ειμι απηλθον εις τα οπισω και επεσον χαμαι
- 7 Atëherë Jezusi i pyeti përsëri: "Kë kërkoni?". Ata thanë: "Jezusin Nazareas".  
So again he put the question to them, Who are you looking for? And they said, Jesus the Nazarene.  
παλιν ουν αυτους επηρωτησεν τινα ζηταιτε οι δε ειπον ιησουν τον ναζωραιον
- 8 Jezusi u përgjigj: "Ju kam thënë se unë jam; prandaj nëse më kërkoni mua, i lini këta të shkojnë";  
Jesus made answer, I have said that I am he; if you are looking for me, let these men go away.  
απεκριθη ο ιησους ειπον υμιν οτι εγω ειμι ει ουν εμε ζηταιτε αφετε τουτους υπαγειν
- 9 që të përmbushej fjala që kishte thënë: "Nuk kam humbur asnjë nga ata që më ke dhënë".  
(He said this so that his words might come true, I have kept safe all those whom you gave to me.)  
ινα πληρωθη ο λογος ον ειπεν οτι ους δεδωκας μοι ουκ απωλεσα εξ αυτων ουδενα
- 10 Atëherë Simon Pjetri, që kishte një shpatë, e nxori, i ra shërbëtorit të kryepriiftit dhe ia preu veshin e djathtë; dhe ai shërbëtor quhej Malk.  
Then Simon Peter, who had a sword, took it out and gave the high priest's servant a blow, cutting off his right ear. The servant's name was Malchus.  
σιμων ουν πετρος εχων μαχαιραν ειλκυσεν αυτην και επαισεν τον του αρχιερεως δουλον και απεκοψεν αυτου το ωτιον το δεξιον ην δε ονομα τω δουλω μαλχος
- 11 Por Jezusi i tha Pjetrit: "Fute shpatën tënde në mill; a nuk do ta pi unë kupën që më ka dhënë Ati?".  
Then Jesus said to Peter, Put back your sword: am I not to take the cup which my Father has given to me?  
ειπεν ουν ο ιησους τω πετρω βαλε την μαχαιραν σου εις την θηκην το ποτηριον ο δεδωκεν μοι ο πατηρ ου μη πιω αυτο
- 12 Atëherë grupi i ushtarëve, kapiteni dhe rojet e Judenjve e kapën Jezusin dhe e lidhën.  
Then the band and the chief captain and the police took Jesus and put cords round him.  
η ουν σπειρα και ο χιλιαρχος και οι υπηρεται των ιουδαιων συνελαβον τον ιησουν και εδησαν αυτον
- 13 E çuan më parë te Ana, sepse ishte vjehrrri i Kajafës, që ishte kryepriifti i atij viti.  
They took him first to Annas, because Annas was the father-in-law of Caiaphas who was the high priest that year.  
και απηγαγον αυτον προς ανναν πρωτον ην γαρ πενθερος του καιαφα ος ην αρχιερευς του ενιαυτου εκεινου
- 14 Kajafa ishte ai që i kishte këshilluar Judenjët se ishte e leverdishme që një njeri të vdiste për popullin.  
It was Caiaphas who had said to the Jews that it was in their interest for one man to be put to death for the people.  
ην δε καιαφας ο συμβουλευσας τοις ιουδαιοις οτι συμφερει ενα ανθρωπον απολεσθαι υπερ του λαου
- 15 Por Simon Pjetri dhe një dishepull tjetër ndiqnin Jezusit. Dhe ky dishepull ishte i njohur i kryepriiftit; dhe hyri me Jezusin në oborrin e kryepriiftit.  
And Simon Peter went after Jesus with another disciple. Now that disciple was a friend of the high priest and he went in with Jesus into the house of the high priest;  
ηκολουθει δε τω ιησου σιμων πετρος και ο αλλος μαθητης ο δε μαθητης εκεινος ην γνωστος τω αρχιερει και συνεισηλθεν τω ιησου εις την αυλην του αρχιερεως
- 16 Por Pjetri mbeti përjashta te dera. Atëherë dishepulli tjetër, që ishte i njohur i kryepriiftit, doli dhe i foli portieres dhe bëri të hyjë Pjetri.  
But Peter was kept outside at the door. Then this other disciple, who was a friend of the high priest, came out and had a word with the girl who kept the door, and took Peter in.  
ο δε πετρος ειστηκε προς τη θυρα εξω εξηλθεν ουν ο μαθητης ο αλλος ος ην γνωστος τω αρχιερει και ειπεν τη θυρωρω και εισηγαγεν τον πετρον
- 17 Dhe shërbëtorja portiere i tha Pjetrit: "Mos je edhe ti nga dishepujt e atij njeriu?". Ai u përgjigj: "Nuk jam".  
Then the girl who was the door-keeper said to Peter, Are you not one of this man's disciples? In answer he said, I am not.  
λεγει ουν η παιδισκη η θυρωρος τω πετρω μη και συ εκ των μαθητων ει του ανθρωπου τουτου λεγει εκεινος ουκ ειμι
- 18 Ndërkaq shërbëtorët dhe rojat ndezën një zjarr me qymyr dhe qëndronin në këmbë e ngroheshin, sepse bënte ftohtë; edhe Pjetri qëndronte në këmbë me ta dhe ngrohej.  
Now the servants and the police had made a fire of coals because it was cold; they were warming themselves in front of it and Peter was there with them, warming himself.  
ειστηκεσαν δε οι δουλοι και οι υπηρεται ανθρακιαν πεποιηκοτες οτι ψυχος ην και εθερμαινοντο ην δε μετ αυτων ο πετρος εστως και θερμαινομενος

- 19 Por kryepriifti e pyeti Jezusin për dishepujt e tij dhe për doktrinën e tij.  
Then the high priest put questions to Jesus about his disciples and his teaching.  
ο ουν αρχιερευς ηρωτησεν τον ιησουν περι των μαθητων αυτου και περι της διδαχης αυτου
- 20 Jezusi iu përgjigj: "Unë i kam folur haptas botës; gjithmonë kam mësuar në sinagogë e në tempull, ku mblihdhen të gjithë Judenjtë, dhe s'kam thënë asgjë në fshehtësi.  
Jesus made answer, I said things openly to the world at all times; I have given my teaching in the Synagogues and in the Temple to which all the Jews come; and I have said nothing secretly.  
απεκριθη αυτω ο ιησους εγω παρρησια ελαλησα τω κοσμο εγω παντοτε εδιδαξα εν τη συναγωγη και εν τω ιερω οπου παντοτε οι ιουδαιοι συνερχονται και εν κρυπτω ελαλησα ουδεν
- 21 Përse më pyet mua? Pyet ata që kanë dëgjuar ç'u kam thënë atyre; ja, ata i dinë gjërat që kam thënë".  
Why are you questioning me? put questions to my hearers about what I have said to them: they have knowledge of what I said.  
τι με επερωτας επερωτησεν τους ακηκοοτας τι ελαλησα αυτοις ιδε ουτοι οιδασιν α ειπον εγω
- 22 Posa i tha këto fjale, një nga rojat që i rrinin afër, i ra Jezusit me shuplakë, duke thënë: "Kështu i përgjigjesh kryepriiftit?".  
When he said this, one of the police by his side gave him a blow with his open hand, saying, Do you give such an answer to the high priest?  
ταυτα δε αυτου ειποντος εις των υπηρετων παρεστηκως εδωκεν ραπισμα τω ιησου ειπων ουτως αποκρινη τω αρχιερει
- 23 Jezusi i tha: "Po të kem folur keq, trego ku është e keqja; por, po të kem folur mirë, përse po më bie?".  
Jesus said in answer, If I have said anything evil, give witness to the evil: but if I said what is true, why do you give me blows?  
απεκριθη αυτω ο ιησους ει κακως ελαλησα μαρτυρησεν περι του κακου ει δε καλως τι με δερεις
- 24 Atëherë Ana e dërgoi të lidhur te Kajafa, kryepriifti.  
Then Annas sent him chained to Caiaphas, the high priest.  
απεστειλεν αυτον ο αννας δεδεμενον προς καιαφαν τον αρχιερεα
- 25 Ndërkaq Simon Pjetri qëndronte aty e ngrohej. I thanë, pra: "Mos je dhe ti nga dishepujt e tij?". Ai e mohoi dhe tha: "Nuk jam".  
But Simon Peter was still there warming himself by the fire. They said to him, Are you not one of his disciples? He said, No, I am not.  
ην δε σιμων πετρος εστος και θερμαινομενος ειπον ουν αυτω μη και συ εκ των μαθητων αυτου ει ηρησατο εκεινος και ειπεν ουκ ειμι
- 26 Por një nga shërbëtorët e kryepriiftit, farefisi i atij, të cilit Pjetri ia kishte prerë veshin, tha: "A s'të pashë në kopsht me të?".  
One of the servants of the high priest, a relation of him whose ear had been cut off by Peter, said, Did I not see you with him in the garden?  
λεγει εις εκ των δουλων του αρχιερευς συγγενης ων ου απεκοψεν πετρος το ωτιον ουκ εγω σε ειδον εν τω κηπω μετ αυτου
- 27 Dhe Pjetri e mohoi sërish, dhe menjëherë këndoi gjeli.  
Then again Peter said, No. And straight away a cock gave its cry.  
παλιν ουν ηρησατο ο πετρος και ευθεως αλεκτωρ εφωνησεν
- 28 Pastaj nga Kajafa e çuan Jezusin në pretorium; ishte mëngjes herët. Por ata nuk hynë në pretorium, që të mos bëheshin të papastër, por të mund të hanin Pashkën.  
So they took Jesus from the house of Caiaphas to the Praetorium. It was early. They themselves did not go into the Praetorium, so that they might not become unclean, but might take the Passover.  
αγουσιν ουν τον ιησουν απο του καιαφα εις το πραιτωριον ην δε πρωια και αυτοι ουκ εισηλθον εις το πραιτωριον ινα μη μιανθωσιν αλλ ινα φαγωσιν το πασχα
- 29 Dhe kështu Pilati doli jashtë drejt tyre dhe tha: "Ç'padi sillni kundër këtij njeriu?".  
So Pilate came out to them and put the question: What have you to say against this man?  
εξηλθεν ουν ο πιλatos προς αυτους και ειπεν τινα κατηγοριαν φερετε κατα του ανθρωπου τουτου
- 30 Ata u përgjigjën dhe i thanë: "Nëse ai të mos ishte keqbërës, nuk do ta kishim dorëzuar".  
They said to him in answer, If the man was not a wrongdoer we would not have given him up to you.  
απεκριθησαν και ειπον αυτω ει μη ην ουτος κακοποιος ουκ αν σοι παρεδωκαμεν αυτον
- 31 Atëherë Pilati u tha atyre: "Merreni ju dhe gjykojeni sipas ligjit tuaj" Por Judenjtë i thanë: "Neve nuk na lejohet të vrasim njeri".  
Then Pilate said to them, Take him yourselves and let him be judged by your law. But the Jews said to him, We have no right to put any man to death.  
ειπεν ουν αυτοις ο πιλatos λαβετε αυτον ημεις και κατα τον νομον ημων κρινατε αυτον ειπον ουν αυτω οι ιουδαιοι ημιν ουκ εξεστιν αποκτειναι ουδενα
- 32 Kjo ndodhi që të përmbushej fjala që kishte thënë Jezusi, kur kishte thënë se me ç'vdekje duhej të vdiste.  
(That the word of Jesus might come true, pointing to the sort of death he would have.)  
ινα ο λογος του ιησου πληρωθη ον ειπεν σημαινων ποιω θανατω ημελλεν αποθνησκειν

- 33 Atëherë Pilati hyri përsëri në pretorium, e thirri Jezusin dhe i tha: "A je ti mbreti i Judenjve?".  
Then Pilate went back into the Praetorium and sent for Jesus and said to him, Are you the King of the Jews?  
εισηλθεν ουν εις το πραιτωριον παλιν ο πιλατος και εφωνησεν τον ιησουν και ειπεν αυτω συ ει ο βασιλευς των ιουδαιων
- 34 Jezusi iu përgjigj: "E thua ti nga vetja, apo ta kanë thënë të tjerë për mua?".  
Jesus made answer, Do you say this of yourself, or did others say it about me?  
απεκριθη αυτω ο ιησους αφ εαυτου συ τουτο λεγεις η αλλοι σοι ειπον περι εμου
- 35 Pilati iu përgjigj: "Jam unë vallë Jude? Kombi yt dhe krerët e priftërinjve të dorëzuan tek unë; çfarë ke bërë?".  
Pilate said, Am I a Jew? Your nation and the chief priests have given you into my hands: what have you done?  
απεκριθη ο πιλατος μητι εγω ιουδαιος ειμι το εθνος το σον και οι αρχιερεις παρεδωκαν σε εμοι τι εποιησας
- 36 Jezusi u përgjigj: "Mbretëria ime nuk është e kësaj bote; po të ishte mbretëria ime e kësaj bote, shërbëtorët e mi do të luftonin që të mos u dorëzohesha Judenjve; porse tani mbretëria ime nuk është prej këtej".  
Jesus said in answer, My kingdom is not of this world: if my kingdom was of this world, my disciples would have made a good fight to keep me out of the hands of the Jews: but my kingdom is not here.  
απεκριθη ο ιησους η βασιλεια η εμη ουκ εστιν εκ του κοσμου τουτου ει εκ του κοσμου τουτου ην η βασιλεια η εμη οι υπηρεται αν οι εμοι ηγωνιζοντο ινα μη παραδοθω τοις ιουδαιοις νυν δε η βασιλεια η εμη ουκ εστιν εντευθεν
- 37 Atëherë Pilati i tha: "Ti, pra, qenke mbret?". Jezusi u përgjigj: "Ti thua se unë jam mbret; për këtë unë kam lindur dhe për këtë kam ardhur në botë; që të dëshmoj për të vërtetën; kush është për të vërtetën, e dëgjon zërin tim".  
Then Pilate said to him, Are you then a king? Jesus made answer, You say that I am a king. For this purpose was I given birth, and for this purpose I came into the world, that I might give witness to what is true. Every lover of what is true gives ear to my voice.  
ειπεν ουν αυτω ο πιλατος ουκουν βασιλευς ει συ απεκριθη ο ιησους συ λεγεις οτι βασιλευς ειμι εγω εγω εις τουτο γεγεννημαι και εις τουτο εληλυθα εις τον κοσμον ινα μαρτυρησω τη αληθεια πας ο ο ν εκ της αληθειας ακουει μου της φωνης
- 38 Pilati e pyeti: "Ç'është e vërteta?". Dhe, si foli këtë, doli përsëri para Judenjve dhe u tha atyre: "Unë nuk po gjej në të asnjë faj!  
Pilate said to him, True? what is true? Having said this he went out again to the Jews and said to them, I see no wrong in him.  
λεγει αυτω ο πιλατος τι εστιν αληθεια και τουτο ειπων παλιν εξηλθεν προς τους ιουδαιους και λεγει αυτοις εγω ουδεμιαν αιτιαν ευρισκω εν αυτω
- 39 Por ndër ju është zakon që unë t'ju liroj dikë për Pashkë; a doni, pra, që t'ju liroj mbretin e Judenjve?".  
But every year you make a request to me to let a prisoner go free at the Passover. Is it your desire that I let the King of the Jews go free?  
εστιν δε συνηθεια υμιν ινα ενα υμιν απολυσω εν τω πασχα βουλεσθε ουν υμιν απολυσω τον βασιλεια των ιουδαιων
- 40 Atëherë të gjithë bërtitën përsëri, duke thënë: "Jo këtë, por Barabanë!". Por Baraba ishte një kusar.  
Then again they gave a loud cry, Not this man, but Barabbas. Now Barabbas was an outlaw.  
εκραυγασαν ουν παλιν παντες λεγοντες μη τουτον αλλα τον βαραββαν ην δε ο βαραββας ληστης
- 1 Atëherë Pilati mori Jezusin dhe dha urdhër ta fshikullonin.  
Then Pilate took Jesus and had him whipped with cords.  
τοτε ουν ελαβεν ο πιλατος τον ιησουν και εμαστιγωσεν
- 2 Dhe ushtarët thurrën një kurorë me gjemba, ia vunë mbi krye dhe i veshën siper një mantel të purpurt,  
And the men of the army made a crown of thorns and put it on his head, and they put a purple robe on him.  
και οι στρατιωται πλεξαντες στεφανον εξ ακανθων επεθηκαν αυτου τη κεφαλη και ιματιον πορφυρου περιεβαλον αυτον
- 3 dhe thoshnin: "Tungjatjeta, o mbret i Judenjve"; dhe i binin me shuplaka.  
And they kept coming and saying, Long life to the King of the Jews! And they gave him blows with their hands.  
και ελεγον χαιρε ο βασιλευς των ιουδαιων και εδιδουν αυτω ραπισματα
- 4 Pastaj Pilati doli përsëri dhe u tha atyre: "Ja, po jua nxjerr jashtë, që ta dini se nuk gjej në të asnjë faj".  
And Pilate went out again and said to them, See, I let him come out to you to make it clear to you that I see no wrong in him.  
εξηλθεν ουν παλιν εξω ο πιλατος και λεγει αυτοις ιδε αγω υμιν αυτον εξω ινα γνωτε οτι εν αυτω ουδεμιαν αιτιαν ευρισκω

- 5 Jezusi, pra, doli, duke mbajtur kurorën prej gjembash dhe mantelin e purpurit. Dhe Pilati u tha atyre: "Ja njeriu!".  
Then Jesus came out with the crown of thorns and the purple robe. And Pilate said to them, Here is the man!  
εξηλθεν ουν ο ιησους εξω φορων τον ακανθινον στεφανον και το πορφυρου ιματιον και λεγει αυτοις ιδε ο ανθρωπος
- 6 Kur e panë krerët e priftërinjve dhe rojet, filluan të bërtasin, duke thënë: "Kryqëzoje, kryqëzoje!". Pilati u tha atyre: "Merreni ju dhe kryqëzoheni, sepse unë nuk gjej në të asnjë faj".  
So when the chief priests and the police saw him they gave a loud cry, To the cross! to the cross! Pilate said to them, Take him yourselves and put him on the cross: I see no crime in him.  
οτε ουν ειδον αυτον οι αρχιερεις και οι υπηρεται εκραυγασαν λεγοντες σταυρωσον σταυρωσον λεγει αυτοις ο πιλατος λαβετε αυτον υμεις και σταυρωσατε εγω γαρ ουχ ευρισκω εν αυτω αιτιαν
- 7 Judenjët iu përgjigjën: "Ne kemi një ligj dhe sipas ligjit tonë ai duhet të vdesë, sepse e bëri veten Bir të Perëndisë".  
And the Jews made answer, We have a law, and by that law it is right for him to be put to death because he said he was the Son of God.  
απεκριθησαν αυτω οι ιουδαιοι ημεις νομον εχομεν και κατα τον νομον ημων οφειλει αποθανειν οτι εαυτον υιον θεου εποιησεν
- 8 Kur Pilati i dëgjoi këto fjalë, kishte akoma më shumë frikë;  
When this saying came to Pilate's ears his fear became greater;  
οτε ουν ηκουσεν ο πιλατος τουτον τον λογον μαλλον εφοβηθη
- 9 dhe, si u kthye në pretorium, i tha Jezusit: "Nga je ti?". Por Jezusi nuk i dha kurrfarë përgjigje.  
And he went again into the Praetorium and said to Jesus, Where do you come from? But Jesus gave him no answer.  
και εισηλθεν εις το πραιτωριον παλιν και λεγει τω ιησου ποθεν ει συ ο δε ιησους αποκρισιν ουκ εδωκεν αυτω
- 10 Për këtë arsye Pilati i tha: "S'po më flet? ti s'e di që unë kam pushtet të të kryqëzoj dhe pushtet të të liroj?".  
Then Pilate said to him, You say nothing to me? is it not clear to you that I have power to let you go free and power to put you to death on the cross?  
λεγει ουν αυτω ο πιλατος εμοι ου λαλεις ουκ οιδας οτι εξουσιαν εχω σταυρωσαι σε και εξουσιαν εχω απολυσαι σε
- 11 Jezusi u përgjigj: "Ti nuk do të kishe asnjë pushtet përmbi mua, po të mos të qe dhënë prej së larti; prandaj ai që më dorëzoi tek ti ka faj më të madh".  
Jesus gave this answer: You would have no power at all over me if it was not given to you by God; so that he who gave me up to you has the greater sin.  
απεκριθη ο ιησους ουκ ειχες εξουσιαν ουδεμιαν κατα εμου ει μη ην σοι δεδομενον ανωθεν δια τουτου ο παραδιδους με σοι μειζονα αμαρτιαν εχει
- 12 Që nga ai moment Pilati kërkoi ta lironte; por Judenjët bërtisnin, duke thënë: "Po e lirove këtë, nuk je mik i Cezarit; kush e bën veten mbret, i kundërvihet Cezarit".  
Hearing this, Pilate had a desire to let him go free, but the Jews said in a loud voice, If you let this man go, you are not Caesar's friend: everyone who makes himself a king goes against Caesar.  
εκ τουτου εξητει ο πιλατος απολυσαι αυτον οι δε ιουδαιοι εκραζον λεγοντες εαν τουτον απολυσης ουκ ει φιλος του καισαρος πας ο βασιλευς αυτον ποιων αντιλεγει τω καισαρι
- 13 Pilati, pra, kur i dëgjoi këto fjalë, e çoi jashtë Jezusin dhe u ul në selinë e gjykatës, në vendin e quajtur "Kalldrëm", e në hebraisht "Gabbatha";  
So when these words came to Pilate's ear, he took Jesus out, seating himself in the judge's seat in a place named in Hebrew, Gabbatha, or the Stone Floor.  
ο ουν πιλατος ακουσας τουτον τον λογον ηγαγεν εξω τον ιησουν και εκαθισεν επι του βηματος εις τοπον λεγομενον λιθοστρωτον εβραϊστι δε γαββαθα
- 14 tani ishte dita e përgatitjes së Pashkës, dhe ishte afërsisht ora e gjashtë; dhe u tha Judenjve: "Ja mbreti juaj".  
(It was the day when they made ready for the Passover; and it was about the sixth hour.) And he said to the Jews, There is your King!  
ην δε παρασκευη του πασχα ωρα δε ωσει εκτη και λεγει τοις ιουδαιοις ιδε ο βασιλευς υμων
- 15 Por ata bërtitën: "Largoje! Largoje! Kryqëzoje!". Pilati u tha atyre: "Ta kryqëzoj mbretin tuaj?". Krerët e priftërinjve u përgjigjën: "Ne s'kemi mbret tjetër përveç Cezarit!".  
Then they gave a loud cry, Away with him! away with him! to the cross! Pilate said to them, Am I to put your King to death on the cross? The chief priests said in answer, We have no king but Caesar.  
οι δε εκραυγασαν αρον αρον σταυρωσον αυτον λεγει αυτοις ο πιλατος τον βασιλευς υμων σταυρωσω απεκριθησαν οι αρχιερεις ουκ εχομεν βασιλευς ει μη καισαρα
- 16 Atëherë ai ua dorëzoi që të kryqëzohej. Dhe ata e morën Jezusin dhe e çuan tutje.  
So then he gave him up to them to be put to death on the cross. And they took Jesus away;  
τοτε ουν παρεδωκεν αυτον αυτοις ινα σταυρωθη παρελαβον δε τον ιησουν και απηγαγον
- 17 Dhe ai, duke mbartur kryqin e tij, u nis drejt vendit që quhej "Kafka", që në hebraisht quhet "Golgota";  
And he went out with his cross on him to the place which is named Dead Man's Head (in Hebrew, Golgotha):  
και βασταζων τον σταυρον αυτου εξηλθεν εις τον λεγομενον κраниου τοπον ος λεγεται εβραϊστι γολγοθα
- 18 ku e kryqëzuan, dhe me të dy të tjerë, njërin në një anë e tjetrin në anën tjetër, dhe Jezusi në mes.  
Where they put him on the cross with two others, one on this side and one on that, and Jesus in the middle.  
οπου αυτον εσταυρωσαν και μετ αυτου αλλους δυο εντευθεν και εντευθεν μεσον δε τον ιησουν

- 19 Dhe Pilati shkroi edhe një mbishkrim dhe e vuri në kryq; dhe atje ishte shkruar: &quot;JEZUSI NAZAREAS, MBRETI I JUDENJVE&quot;;  
And Pilate put on the cross a statement in writing. The writing was: JESUS THE NAZARENE, THE KING OF THE JEWS.  
εγραψεν δε και τιτλον ο πιλατος και εθηκεν επι του σταυρου ην δε γεγραμμενον ιησους ο ναζωραιος ο βασιλευς των ιουδαιων
- 20 Kështu këtë mbishkrim e lexuan shumë nga Judenjët, sepse vendi ku u kryqëzua Jezusi ishte afër qytetit; dhe mbishkrimi ishte shkruar hebraisht, greqisht dhe latinisht.  
The writing was seen by a number of the Jews, for the place where Jesus was put to death on the cross was near the town; and the writing was in Hebrew and Latin and Greek.  
τουτον ουν τον τιτλον πολλοι ανεγνωσαν των ιουδαιων οτι εγγυς ην της πολεως ο τοπος οπου εσταυρωθη ο ιησους και ην γεγραμμενον εβραϊστι ελληνιστι ρωμαιστι
- 21 Prandaj krerët e priftërinjve të Judenjve i thanë Pilatit: "Mos shkruaj: &quot;Mbreti i Judenjve&quot;; por se ai ka thënë: &quot;Unë jam mbreti i Judenjve&quot;".  
Then the chief priests of the Jews said to Pilate, Do not put, The King of the Jews, but, He said, I am the King of the Jews.  
ελεγον ουν τω πιλατω οι αρχιερεις των ιουδαιων μη γραφε ο βασιλευς των ιουδαιων αλλ οτι εκεινος ειπεν βασιλευς ειμι των ιουδαιων
- 22 Pilati u përgjigj: "Atë që kam shkruar, e kam shkruar!".  
But Pilate made answer, What I have put in writing will not be changed.  
απεκριθη ο πιλατος ο γεγραφα γεγραφα
- 23 Dhe ushtarët, mbasi e kishin kryqëzuar Jezusin, morën rrobat e tij dhe bënë katër pjesë, një pjesë për çdo ushtar, dhe tunikën. Por tunika ishte pa tegel, e endur një copë nga maja e deri në fund.  
And when Jesus was nailed to the cross, the men of the army took his clothing, and made a division of it into four parts, to every man a part, and they took his coat: now the coat was without a join, made out of one bit of cloth.  
οι ουν στρατιωται οτε εσταυρωσαν τον ιησουν ελαβον τα ιματια αυτου και εποιησαν τεσσαρα μερη εκαστω στρατιωτη μερος και τον χιτονα ην δε ο χιτων αρραφος εκ των ανωθεν υφαντος δι ολου
- 24 Prandaj ata i thanë njëri-tjetrit: "Nuk e grisim, por hedhim short kujt t'i bjerë"; që të përmbushej Shkrimi, që thotë: "I ndanë midis tyre rrobat e mia, dhe hodhën short për tunikën time".  
Ushtarët, pra, i bënë këto gjëra.  
So they said among themselves, Let this not be cut up, but let us put it to the decision of chance and see who gets it. (They did this so that the Writings might come true, which say, They made a distribution of my clothing among them, and my coat they put to the decision of chance.) This was what the men of the army did.  
ειπον ουν προς αλληλους μη σχισωμεν αυτον αλλα λαχουμεν περι αυτου τινος εσται ινα η γραφη πληρωθη η λεγουσα διεμερισαντο τα ιματια μου εαυτοις και επι τον ιματισμον μου εβαλον κληρον οι μ εν ουν στρατιωται ταυτα εποιησαν
- 25 Por afër kryqit të Jezusit, qendronin nëna e tij dhe motra e nënës së tij, Maria e Kleopas dhe Maria Magdalenë.  
Now by the side of the cross of Jesus were his mother, and his mother's sister Mary, the wife of Cleopas, and Mary Magdalene.  
ειστηκεισαν δε παρα τω σταυρω του ιησου η μητηρ αυτου και η αδελφη της μητρος αυτου μαρια η του κλωπα και μαρια η μαγδαληνη
- 26 Atëherë Jezusi, kur pa nënën e tij dhe pranë saj dishepullin që donte, i tha nënës së tij: "O grua, ja biri yt!".  
So when Jesus saw his mother and the disciple who was dear to him, he said to his mother, Mother, there is your son!  
ιησους ουν ιδων την μητερα και τον μαθητην παρεστοτα ον ηγαπα λεγει τη μητρι αυτου γυναι ιδου ο υιος σου
- 27 Pastaj i tha dishepullit: "Ja nëna jote!". Dhe që në atë moment ai e mori në shtëpinë e vet.  
Then he said to the disciple, There is your mother! And from that hour the disciple took her to his house.  
ειτα λεγει τω μαθητη ιδου η μητηρ σου και απ εκεινης της ωρας ελαβεν αυτην ο μαθητης εις τα ιδια
- 28 Pas kësaj, Jezusi, duke ditur që tashmë çdo gjë ishte kryer, që të përmbushej Shkrimi, tha: "Kam etje!".  
After this, being conscious that all things had now been done so that the Writings might come true, Jesus said, Give me water.  
μετα τουτο ειδως ο ιησους οτι παντα ηδη τετελεσται ινα τελειωθη η γραφη λεγει διψω
- 29 Por aty ishte një enë plot me uthull. Pasi shtinë një sfungjer në uthull dhe e vunë në majë të një dege hisopi, ia afruan te goja.  
Now there was a vessel ready, full of bitter wine, and they put a sponge full of it on a stick and put it to his mouth.  
σκευος ουν εκειτο οζους μεστον οι δε πλησαντες σπογγον οζους και υσσωπω περιθεντες προσηνεγκαν αυτου τω στοματι
- 30 Kur Jezusi e mori uthullën, tha: "U krye!". Dhe duke ulur kryet, dha frymën.  
So when Jesus had taken the wine he said, All is done. And with his head bent he gave up his spirit.  
οτε ουν ελαβεν το οζος ο ιησους ειπεν τετελεσται και κλινας την κεφαλην παρεδωκεν το πνευμα

- 31 Duke qenë se ishte dita e Përgatitjes, me qëllim që trupat të mos qëndronin në kryq të shtunën, sepse ajo e shtunë ishte një ditë me rëndësi të veçantë, Judenjët i kërkuan Pilatit që atyre t'u thyheshin kërcinjtë dhe të hiqeshin që andej.  
Now it was the day of getting ready for the Passover, and so that the bodies might not be on the cross on the Sabbath (because the day of that Sabbath was a great day), the Jews made a request to Pilate that their legs might be broken, and that they might be taken away.  
οι ουν ιουδαιοι ινα μη μεινη επι του σταυρου τα σωματα εν τω σαββατω επει παρασκευη ην ην γαρ μεγαλη η ημερα εκεινου του σαββατου ηρωτησαν τον πιλατον ινα κατεαγωσιν αυτων τα σκελη και αρθωσιν
- 32 Ushtarët, pra, erdhën dhe ia thyen kërcinjtë të parit dhe pastaj edhe tjetrit që ishte kryqëzuar me të;  
So the men of the army came, and the legs of the first were broken and then of the other who was put to death on the cross with Jesus:  
ηλθον ουν οι στρατιωται και του μεν πρωτου κατεαζαν τα σκελη και του αλλου του συσταυρωθεντος αυτου
- 33 por, kur erdhën te Jezusi, dhe si panë se ai tashmë kishte vdekur, nuk ia thyen kërcinjtë,  
But when they came to Jesus, they saw that he was dead by this time, and so his legs were not broken;  
επι δε τον ιησουν ελθοντες ως ειδον αυτον ηδη τεθηκοτα ου κατεαζαν αυτου τα σκελη
- 34 por njëri nga ushtarët ia tejshpoi brinjën me një heshtë, dhe menjëherë i doli gjak e ujë.  
But one of the men made a wound in his side with a spear, and straight away there came out blood and water.  
αλλ εις των στρατιωτων λογη αυτου την πλευραν ενυξεν και ευθως εξηλθεν αιμα και υδωρ
- 35 Dhe ai që ka parë, ka dëshmuar për këtë, dhe dëshmia e tij është e vërtetë; dhe ai e di se thotë të vërtetën, që ju të besoni.  
And he who saw it has given witness (and his witness is true; he is certain that what he says is true) so that you may have belief.  
- 8 Pastaj i dha atij besëlidhjen e rrethprerjes. Dhe kështu Abrahamit i lindi Isaku dhe e rrethpreu të tetën ditë; Isakut i lindi Jakobi, dhe Jakobit dymbëdhjetë patriarkë.  
 And he made with him the agreement of which circumcision was the sign. And so Abraham had a son, Isaac, and gave him circumcision on the eighth day; and Isaac had a son, Jacob, and Jacob was the father of the twelve heads of the families of Israel.  
 και εδωκεν αυτω διαθηκην περιτομης και ουτως εγεννησεν τον ισαακ και περιετεμεν αυτον τη ημερα τη ογδοη και ο ισαακ τον ιακωβ και ο ιακωβ τους δωδεκα πατριαρχας
- 9 Patriarkët, duke pasur smirë Jozefin, e shitën në Egjipt, por Perëndia ishte me të;  
 And the brothers, moved with envy against Joseph, gave him to the Egyptians for money: but God was with him,  
 και οι πατριαρχαι ζηλωσαντες τον ιωσηφ απεδοντο εις αιγυπτον και ην ο θεος μετ αυτου
- 10 dhe e shpëtoi nga të gjitha mundimet e tij dhe i dha hir e urtësi para Faraonit, mbretit të Egjiptit, i cili e caktoi guvernator të Egjiptit dhe të mbarë shtëpisë së tij.  
 And made him free from all his troubles, and gave him wisdom and the approval of Pharaoh, king of Egypt, who made him ruler over Egypt and all his house.  
 και εξειλετο αυτον εκ πασων των θλιψεων αυτου και εδωκεν αυτω χαριν και σοφιαν εναντιον φαραω βασιλεως αιγυπτου και κατεστησεν αυτον ηγουμενον επ αιγυπτον και ολον τον οικον αυτου
- 11 Por ra një zi buke dhe u bë një shtrëngesë në gjithë vendin e Egjiptit dhe të Kanaanit, dhe etërit tanë nuk gjenin ushqime.  
 Now there was no food to be had in all Egypt and Canaan, and there was great trouble: and our fathers were not able to get food.  
 ηλθεν δε λιμος εφ ολην την γην αιγυπτου και χανααν και θλιψις μεγαλη και ουχ ευρισκον χορτασματα οι πατερες ημων
- 12 Por Jakobi dëgjoji se në Egjipt kishte grurë, dhe dërgoi atje herën e parë etërit tanë.  
 But Jacob, hearing that there was grain in Egypt, sent out our fathers the first time.  
 ακουσας δε ιακωβ οντα σιτα εν αιγυπτω εξαπεστειλεν τους πατερας ημων πρωτον
- 13 Herën e dytë Jozefi u tregoi që ta njihnin vëllezërit e tij dhe Faraonit iu njoftua farefisnia e Jozefit.  
 And the second time his brothers had a meeting with Joseph, and Pharaoh had knowledge of Joseph's family.  
 και εν τω δευτερω ανεγνωρισθη ιωσηφ τοις αδελφοις αυτου και φανερον εγενετο τω φαραω το γενος του ιωσηφ
- 14 Atëherë Jozefi dërgoi ta thërresin atin e vet Jakobin dhe gjithë farefisin e vet, gjithsej shtatëdhjetë e pesë veta.  
 Then Joseph sent for Jacob his father and all his family, seventy-five persons.  
 αποστειλας δε ιωσηφ μετεκαλεσατο τον πατερα αυτου ιακωβ και πασαν την συγγενειαν αυτου εν ψυχαις εβδομηκοντα πεντε
- 15 Jakobi zbriti në Egjipt, ku vdiq ai dhe etërit tanë.  
 And Jacob went down to Egypt, and came to his end there, and so did our fathers;  
 κατεβη δε ιακωβ εις αιγυπτον και ετελευτησεν αυτος και οι πατερες ημων
- 16 Ata pastaj i mbartën në Sikem dhe i varrosën në varrin që Abrahami pati blerë me argjend nga bijtë e Emorit, ati i Sikemit.  
 And they were taken over to Shechem, and put to rest in the place which Abraham got for a price in silver from the sons of Hamor in Shechem.  
 και μετετεθησαν εις συχημ και ετεθησαν εν τω μνηματι ο ωνησατο αβρααμ τιμης αργυριου παρα των υιων εμμορ του συχημ

- 17 Por, ndërsa po afrohej koha e premtimit që Perëndia i ishte betuar Abrahamit, populli u shtua dhe u shumua në Egjipt,  
But when the time was near for putting into effect the undertaking which God had given to Abraham, the people were increasing in Egypt,  
καθως δε ηγγιζεν ο χρονος της επαγγελιας ης ωμοσεν ο θεος τω αβρααμ ηρξησεν ο λαος και επληθυνθη εν αυγυπτω
- 18 derisa doli në Egjipt një mbret tjetër që nuk e kishte njohur Jozefin.  
Till another king came to power, who had no knowledge of Joseph.  
αχρις ου ανεστη βασιλευς ετερος ος ουκ ηδει τον ιωσηφ
- 19 Ky, duke vepruar me ligësi kundër skotës sonë, i keqtrajtoi etërit tanë deri sa t'i ekspozojnë foshnjat e tyre, që të mos mbeteshin gjallë.  
He, having evil designs against our nation, was cruel to our fathers, and they were forced to put out their young children, so that they might not go on living.  
ουτος κατασοφισαμενος το γενοσ ημων εκακωσεν τους πατερας ημων του ποιειν εκθετα τα βρεφη αυτων εις το μη ζωογονεισθαι
- 20 Në atë kohë lindi Moisiu, dhe ishte i bukur në sytë e Perëndisë; ai u ushqye për tre muaj në shtëpinë e të atit.  
At which time Moses came to birth, and he was very beautiful; and he was kept for three months in his father's house:  
εν ω καιρω εγεννηθη μωσης και ην ασειος τω θεω ος ανετραφη μηνας τρεις εν τω οικω του πατροσ αυτου
- 21 Dhe kur u ekspozua, e mori e bija e faraonit dhe e rriti si birin e vet.  
And when he was put out, Pharaoh's daughter took him and kept him as her son.  
εκτεθεντα δε αυτον ανειλετο αυτον η θυγατηρ φαραω και ανεθρεψατο αυτον εαυτη εις υιον
- 22 Kështu Moisiu u arsimua me gjithë diturinë e Egjiptasve dhe ishte i pushtetshëm në fjalë e në vepra.  
And Moses was trained in all the wisdom of Egypt, and was great in his words and works.  
και επαιδευθη μωσης παση σοφια αυγυπτιων ην δε δυνατοσ εν λογοις και εν εργοις
- 23 Po kur arriti në moshën dyzet vjeçare, i erdhi në zemër të shkojë e të vizitojë vëllezërit e tij: bijtë e Izraelit.  
But when he was almost forty years old, it came into his heart to go and see his brothers, the children of Israel.  
ωσ δε επληρουτο αυτω τεσσαρακονταετησ χρονοσ ανεβη επι την καρδιαν αυτου επισκεψασθαι τους αδελφουσ αυτου τους υιουσ ισραηλ
- 24 Kur pa se dikujt po i bëhej një padrejtësi, e mbrojti dhe ia mori hakun të shtypurit, duke vrarë Egjiptasin.  
And seeing one of them being attacked, he went to his help and gave the Egyptian a death-blow:  
και ιδων τινα αδικουμενον ημυνατο και εποιησεν εκδικησιν τω καταπονουμενω παταζασ τον αυγυπτιον
- 25 Dhe ai mendonte se vëllezërit e tij do ta kuptonin se Perëndia do t'u jepte çlirimin me anë të tij, por ata nuk e kuptuan.  
And he was hoping that his brothers would see that God had sent him to be their saviour; but they did not see.  
ενομιζεν δε συνιεναι τους αδελφουσ αυτου οτι ο θεοσ δια χειροσ αυτου διδωσιν αυτοις σωτηριαν οι δε ου συνηκαν
- 26 Të nesërmen ai u duk në mes tyre, ndërsa po ziheshin dhe i këshilloi për paqe, duke thënë: "O burra, ju jeni vëllezër, pse ia bëni me të padrejtë njëri-tjetrit?"  
And the day after, he came to them, while they were having a fight, and would have made peace between them, saying, Sirs, you are brothers; why do you do wrong to one another?  
τη τε επιουση ημερα ωφθη αυτοις μαχομενοις και συνηλασεν αυτοουσ εις ειρηνην ειπων ανδρες αδελφοι εστε υμεισ ινατι αδικειτε αλληλοουσ
- 27 Por ai që ia bënte me të padrejtë fqinjit të vete shtyu, duke thënë: "Kush të ka vënë ty të parë dhe gjykatës mbi ne?"  
But the man who was doing wrong to his neighbour, pushing him away, said, Who made you a ruler and a judge over us?  
ο δε αδικων τον πλησιον απωσατο αυτον ειπων τισ σε κατεστησεν αρχοντα και δικαστην εφ ημασ
- 28 Don të më vrasësh mua, ashtu si vrare dje Egjiptasin?"  
Will you put me to death as you did the Egyptian yesterday?  
μη ανελειν με συ θελεισ ον τροπον ανελεισ χθεσ τον αυγυπτιον
- 29 Për shkak të këtyre fjalëve Moisiu iku dhe banoi si i huaj në vendin e Madianit, ku i lindën dy bij.  
And at these words, Moses went in flight to the land of Midian, and was living there for a time, and had two sons.  
εφυγεν δε μωσης εν τω λογω τουτω και εγενετο παροικοσ εν γη μαδιαμ ου εγεννησεν υιουσ δυο
- 30 Si kaluan dyzet vjet, engjëlli i Zotit iu shfaq në shkretëtirën e malit Sinai, në flakën e zjarrit të një ferrishteje.  
At the end of forty years, an angel came to him in the waste land of Sinai, in the flame of a burning thorn-tree.  
και πληρωθεντων ετων τεσσαρακοντα ωφθη αυτω εν τη ερημω του ορουσ σινα αγγελοσ κυριου εν φλογι πυροσ βατου

- 31 Kur e pa, Moisiu mbeti i habitur nga sa shihte; dhe, kur po afrohej për të vërejtur, dëgjoi zërin e Zotit,  
And Moses, seeing it, was full of wonder, and when he came up to have a nearer view of it, the voice of the Lord came to him, saying,  
ο δε μωσης ιδων εθαυμασεν το οραμα προσερχομενου δε αυτου κατανοησαι εγενετο φωνη κυριου προς αυτον
- 32 që thoshte: "Unë jam Perëndia e etërve të tu, Perëndia e Abrahamit, Perëndia e Isakut dhe Perëndia e Jakobit". Por Moisiu, që dridhej i tëri, nuk guxonte të shikonte.  
I am the God of your fathers, the God of Abraham and of Isaac and of Jacob. And Moses, shaking with fear, kept his eyes from looking at it.  
εγω ο θεος των πατερων σου ο θεος αβρααμ και ο θεος ισαακ και ο θεος ιακωβ εντρομος δε γενομενος μωσης ουκ ετολμα κατανοησαι
- 33 Atëherë Perëndia i tha: "Hiqi sandalet nga këmbët e tua, sepse vendi ku ti po qëndron është tokë e shenjtë.  
And the Lord said, Take off the shoes from your feet, for the place where you are is holy.  
ειπεν δε αυτω ο κυριος λυσον το υποδημα των ποδων σου ο γαρ τοπος εν ω εστηκας γη αγια εστιν
- 34 Unë e kam parë qartë pikëllimin e popullit tim në Egjipt dhe i dëgjova psherëtimat e tyre, dhe kam zbritur për t'i çliruar; tani, pra, eja, unë do të të dërgoj në Egjipt!"  
Truly, I have seen the sorrows of my people in Egypt, and their cries have come to my ears, and I have come down to make them free: and now, come, I will send you to Egypt.  
ιδων ειδον την κακοσιν του λαου μου του εν αιγυπτω και του στεναγμου αυτων ηκουσα και κατεβην εξελεσθαι αυτους και νυν δευρο αποστελω σε εις αιγυπτον
- 35 Atë Moisiun që e kishin refuzuar, duke thënë: "Kush të vuri ty të parë dhe gjykatës?", po atë u dërgoi Perëndia si kryetar dhe çlirues me anë të engjëllit që i ishte shfaqur në ferrishtë.  
This Moses, whom they would not have, saying, Who made you a ruler and a judge? him God sent to be a ruler and a saviour, by the hand of the angel whom he saw in the thorn-tree.  
τουτον τον μωσσην ον ηρησαντο ειποντες τις σε κατεστησεν αρχοντα και δικαστην τουτον ο θεος αρχοντα και λυτρωτην απεστειλεν εν χειρι αγγελου του οφθεντος αυτω εν τη βατω
- 36 Ai i nxori jashtë, duke kryer shenja e mrekulli në vendin e Egjiptit, në Detin e Kuq dhe në shkretirë për dyzet vjet.  
This man took them out, having done wonders and signs in Egypt and in the Red Sea and in the waste land, for forty years.  
ουτος εξηγαγεν αυτους ποιησας τερατα και σημεια εν γη αιγυπτου και εν ερυθρα θαλασση και εν τη ερημω ετη τεσσαρακοντα
- 37 Ky është ai Moisi që u tha bijve të Izraelit: "Zoti, Perëndia juaj do të nxjerrë për ju, nga mesi i vëllezërve tuaj, një profet si mua. Dëgjojeni!"  
This is the same Moses, who said to the children of Israel, God will give you a prophet from among your brothers, like me.  
ουτος εστιν ο μωσσης ο ειπων τοις υιοις ισραηλ προφητην υμιν αναστησει κυριος ο θεος υμων εκ των αδελφων υμων ως εμε αυτου ακουσεσθε
- 38 Ky është ai që në kuvend, në shkretëtirë, ishte me engjëllin që i fliste mbi malin Sinai dhe me etërit tanë; dhe mori fjalët e jetës për të na e përçarur neve.  
This is the man who was in the church in the waste land with the angel who was talking to him in Sinai, and with our fathers; and to him were given the living words of God, so that he might give them to you.  
ουτος εστιν ο γενομενος εν τη εκκλησια εν τη ερημω μετα του αγγελου του λαλουντος αυτω εν τω ορει σινα και των πατερων ημων ος εδεξατο λογια ζωντα δουναι ημιν
- 39 Etërit tanë nuk deshën t'i binden atij; madje e hodhën poshtë dhe me zemrat e tyre u kthyen nga Egjipti,  
By whom our fathers would not be controlled; but they put him on one side, turning back in their hearts to Egypt,  
ω ουκ ηθελησαν υπηκοοι γενεσθαι οι πατερες ημων αλλ απωσαντο και εστραφησαν ταις καρδιαις αυτων εις αιγυπτον
- 40 duke i thënë Aaronit: "Na bëj disa perëndi që të na prijnë, sepse nuk dimë ç'i ka ndodhur këtij Moisiu që na nxori nga vendi i Egjiptit".  
And saying to Aaron, Make us gods to go before us: as for this Moses, who took us out of the land of Egypt, we have no idea what has become of him.  
ειποντες τω ααρων ποιησον ημιν θεους οι προπορευσονται ημων ο γαρ μωσης ουτος ος εξηγαγεν ημας εκ γης αιγυπτου ουκ οίδαμεν τι γεγονεν αυτω
- 41 Dhe në ato ditë ata bënë një viç, i ofruan fljirim idhullit dhe u gëzuan me veprën e duarve të tyre.  
And they made the image of a young ox in those days, and made an offering to it, and had joy in the work of their hands.  
και εμοσχοποιησαν εν ταις ημεραις εκειναις και ανηγαγον θυσιαν τω ειδωλω και ευφραινοντο εν τοις εργασις των χειρων αυτων
- 42 Atëherë Perëndia u tërhoq dhe i la t'i shërbejnë ushtrisë së qiellit, ashtu siç është shkruar në librin e profetëve: "O shtëpi e Izraelit, a më keni kushtuar fljime dhe olokauste për dyzet vjet në shkretëtirë?  
But God was turned from them and let them give worship to the stars of heaven, as it says in the book of the prophets, Did you make offerings to me of sheep and oxen for forty years in the waste land, O house of Israel?  
εστρεψεν δε ο θεος και παρεδωκεν αυτους λατρευειν τη στρατια του ουρανου καθως γεγραπται εν βιβλω των προφητων μη σφαγια και θυσιαις προσηνεγκατε μοι ετη τεσσαρακοντα εν τη ερημω οικος ισραηλ
- 43 Apo më shumë mbartët çadrën e Molokut dhe yllin e perëndisë suaj Remfan, imaxhe që i bëtë vetë për t'i adhuruar; për këtë arsye unë do t'ju shpërngul përtej Babilonisë".  
And you took up the tent of Moloch and the star of the god Rephan, images which you made to give worship to them: and I will take you away, farther than Babylon.  
και ανελαβετε την σκινην του μολοχ και το αστρον του θεου υμων ρεμφαν τους τυπους ος εποιησατε προσκυνειν αυτοις και μετοικιω υμας επεκεινα βαβυλωνος

- 44 Etërit tuaj në shkretëtirë kishin tabernakullin e dëshmisë, ashtu siç kishte urdhëruar ai që i pati thënë Moisiut ta bëjë sipas modelit që kishte parë.  
Our fathers had the Tent of witness in the waste land, as God gave orders to Moses to make it after the design which he had seen.  
η σκηνη του μαρτυριου ην εν τοις πατρασιν ημων εν τη ερημω καθως διαταξατο ο λαλων τω μοση ποιησαι αυτην κατα τον τυπον ον εωρακει
- 45 Dhe etërit tanë, pasi e morën, e mbartën me Jozueun në vendin që e kishin pushtuar johebrenjtë, të cilët Perëndia i dëboi para etërve tanë; dhe aty qëndroi deri në ditët e Davidit,  
Which our fathers, in their turn, took with them when, with Joshua, they came into the heritage of the nations whom God was driving out before the face of our fathers, till the time of David,  
ην και εισηγαγον διαδεξαμενοι οι πατερες ημων μετα ιησου εν τη κατασχεσει των εθνων ον εξωσεν ο θεος απο προσωπου των πατερων ημων εως των ημερων δαβιδ
- 46 i cili gjeti hir përpara Perëndisë dhe kërkoi të mund të gjente një banesë për Perëndinë e Jakobit.  
Who was pleasing to God; and he had a desire to make a holy tent for the God of Jacob.  
ος ευρεν χαριν ενωπιον του θεου και ητησατο ευρειν σκηνωμα τω θεω ιακωβ
- 47 Por qe Salomoni ai që ia ndërtoi një shtëpi.  
But Solomon was the builder of his house.  
σολομων δε ωκοδομησεν αυτω οικον
- 48 Por Shumë i Larti nuk banon në tempuj të ndërtuar nga dora e njeriut, sikurse thotë profeti:  
But still, the Most High has not his resting-place in houses made with hands, as the prophet says,  
αλλ ουχ ο υψιστος εν χειροποιητοις ναοις κατοικει καθως ο προφητης λεγει
- 49 "Qielli është froni im dhe toka stoli i këmbëve të mia; çfarë shtëpie do të më ndërtonit ju, thotë Zoti, ose cili do të qe vendi i pushimit tim?  
Heaven is the seat of my power, and earth is a resting-place for my feet: what sort of house will you make for me, says the Lord, or what is my place of rest?  
ο ουρανος μοι θρονος η δε γη υποποδιον των ποδων μου ποιον οικον οικοδομησετε μοι λεγει κυριος η τις τοπος της καταπαυσεως μου
- 50 A nuk i bëri të gjitha këto gjëra dora ime?".  
Did not my hand make all these things?  
ουχι η χειρ μου εποιησεν ταυτα παντα
- 51 O njerëz qafëfortë dhe me zemër e veshë të parrethprerë, ju gjithnjë e kundërshtoni Frymën e Shenjtë; ashtu siç bënë etërit tuaj, ashtu bëni edhe ju.  
You whose hearts are hard and whose ears are shut to me; you are ever working against the Holy Spirit; as your fathers did, so do you.  
σκληροτραχηλοι και απεριτητοι τη καρδια και τοις ωσιν υμεις αι τω πνευματι τω αγιω αντιπατετε ως οι πατερες υμων και υμεις
- 52 Cilin nga profetët nuk e përdoqën etërit tuaj? Ata vranë edhe ata që paralajmëronin ardhjen e të Drejtit, për të cilin tani ju jeni bërë tradhtarë dhe vrasës;  
Which of the prophets was not cruelly attacked by your fathers? and they put to death those who gave them the news of the coming of the Upright One; whom you have now given up and put to death;  
τινα των προφητων ουκ εδιωξαν οι πατερες υμων και απεκτειναν τους προκαταγγειλαντας περι της ελευσεως του δικαιου ου νυν υμεις προδοται και φονεις γεγενηθε
- 53 ju, që e morët ligjin të shpallur nga engjëjt dhe nuk e keni respektuar!".  
You, to whom the law was given as it was ordered by angels, and who have not kept it.  
οιτινες ελαβετε τον νομον εις διαταγας αγγελων και ουκ εφυλαξατε
- 54 Kur i dëgjuan këto fjalë, ata thereshin në zemër të tyre dhe kërcëllonin dhëmbët kundër tij.  
Hearing these things, they were cut to the heart and moved with wrath against him.  
ακουοντες δε ταυτα διεπριοντο ταις καρδιας αυτων και εβρυχον τους οδοντας επ αυτον
- 55 Por ai, mbushur me Frymë të Shenjtë, i nguli sytë nga qielli, pa lavdinë e Perëndisë dhe Jezusin që rrinte në këmbë në të djathtën e Perëndisë,  
But he was full of the Holy Spirit, and looking up to heaven, he saw the glory of God and Jesus at the right hand of God.  
υπαρχων δε πληρης πνευματος αγιου ατενισας εις τον ουρανον ειδεν δοξαν θεου και ιησουν εστωτα εκ δεξιων του θεου
- 56 dhe tha: "Ja, unë po shoh qiejt e hapur dhe Birin e njeriut që rri në këmbë në të djathtën e Perëndisë".  
And he said, Now I see heaven open, and the Son of man at the right hand of God.  
και ειπεν ιδου θεωρω τους ουρανους ανεωγμενους και τον υιον του ανθρωπου εκ δεξιων εστωτα του θεου
- 57 Por ata, duke lëshuar britma të forta, i zunë veshët dhe të gjithë tok u sulën mbi të;  
But with loud cries, and stopping their ears, they made an attack on him all together,  
κραζαντες δε φωνη μεγαλη συνεσχον τα ωτα αυτων και ωρμησαν ομοθυμαδον επ αυτον

- 58 dhe, si e nxorën jashtë qytetit, e vranë me gurë. Dëshmitarët i vunë rrobat e tyre te këmbët e një djaloshi, të quajtur Saul.  
**Driving him out of the town and stoning him: and the witnesses put their clothing at the feet of a young man named Saul.**  
 και εκβαλοντες εξω της πολεις ελιθοβολουν και οι μαρτυρες απεθεντο τα ιματια αυτων παρα τους ποδας νεανιου καλουμενου σαουλου
- 59 Kështu e vranë me gurë Stefanin, që i thërriste Jezusit dhe thoshte: "O Zoti Jezus, pranoje frymën time!".  
**And Stephen, while he was being stoned, made prayer to God, saying, Lord Jesus, take my spirit.**  
 και ελιθοβολουν τον στεφανον επικαλουμενον και λεγοντα κυριε ιησου δεξαι το πνευμα μου
- 60 Atëherë ra në gjunjë dhe bërtiti me zë të lartë: "O Zot, mos ua ngarko atyre këtë mëkat!". Dhe, si tha këtë, fjeti.  
**And going down on his knees, he said in a loud voice, Lord, do not make them responsible for this sin. And when he had said this, he went to his rest.**  
 θεις δε τα γονατα εκραξεν φωνη μεγαλη κυριε μη στησης αυτοις την αμαρτιαν ταυτην και τουτο ειπων εκοιμηθη
- 1 Por Sauli e kishte miratuar vrasjen e tij. Në atë kohë u bë një përndjekje e madhe kundër kishës që ishte në Jeruzalem; dhe të gjithë u shpërndanë nëpër krahinat e Judesë dhe të Samarisë, me përjashtim të apostujve.  
**And Saul gave approval to his death. Now at that time a violent attack was started against the church in Jerusalem; and all but the Apostles went away into all parts of Judaea and Samaria.**  
 σαυλος δε ην συνευδοκων τη αναρσει αυτου εγενετο δε εν εκεινη τη ημερα διωγμος μεγας επι την εκκλησιαν την εν ιεροσολυμοις παντες τε διεσπαρησαν κατα τας χωρας της ιουδαϊας και σαμαρειας πλην των αποστολων
- 2 Disa njerëz të përshpirtshëm e varrosën Stefanin dhe bënë gjëmë të madhe për të.  
**And God-fearing men put Stephen's body in its last resting-place, making great weeping over him.**  
 συνεκομισαν δε τον στεφανον ανδρες ευλαβεις και εποησαντο κοπετον μεγαν επ αυτω
- 3 Por Sauli po shkatërronte kishën: hynte shtëpi më shtëpi, merrte me vete burra dhe gra dhe i fuste në burg.  
**But Saul was burning with hate against the church, going into every house and taking men and women and putting them in prison.**  
 σαυλος δε ελυμαινετο την εκκλησιαν κατα τους οικους εισπορευομενος συρων τε ανδρας και γυναικας παρεδιδου εις φυλακην
- 4 Ata, pra, që ishin shpërndarë shkonin rreth e përqark, duke shpallur fjalën.  
**But those who had gone in flight went everywhere preaching the word.**  
 οι μεν ουν διασπαρευντες διηλθον ευαγγελιζομενοι τον λογον
- 5 Dhe Filipi zbriti në qytetin e Samarisë dhe u predikoi atyre Krishtin.  
**And Philip went down to Samaria and was teaching them about Christ.**  
 φιλιππος δε κατελθων εις πολιν της σαμαρειας εκηρυσσεν αυτοις τον χριστον
- 6 Dhe turmat, me një mendje të vetme, dëgjonin me vëmendje gjërat që thoshte Filipi, duke dëgjuar dhe duke parë mrekullitë që ai bënte.  
**And all the people gave attention to the words which Philip said, when they saw the signs which he did.**  
 προσειχον τε οι οχλοι τοις λεγομενοις υπο του φιλιππου ομοθυμαδον εν τω ακουειν αυτους και βλεπειν τα σημεια α εποιει
- 7 Frymëra të ndyra, pra, dilnin nga shumë të idemonizuar, duke bërtitur me zë të lartë; dhe shumë të paralizuar e të çalë shëroheshin.  
**For unclean spirits came out from those who had them, crying with a loud voice; and a number of those who were ill and broken in body were made well.**  
 πολλων γαρ των εχοντων πνευματα ακαθαρτα βοωντα μεγαλη φωνη εξηρχετο πολλοι δε παραλελυμενοι και χωλοι εθεραπευθησαν
- 8 Dhe në atë qytet u bë gëzim i madh.  
**And there was much joy in that town.**  
 και εγενετο χαρα μεγαλη εν τη πολει εκεινη
- 9 Prej kohësh në atë qytet ishte një njeri që quhej Simon, i cili merrej me magji dhe i bënte të çuditëshin njerëzit e Samarisë, gjoja sikur ishte njeri i madh.  
**But there was a certain man named Simon, who in the past had been a wonder-worker and a cause of surprise to the people of Samaria, saying that he himself was a great man:**  
 ανηρ δε τις ονοματι σιμων προυπηρχεν εν τη πολει μαγεων και εξιστων το εθνος της σαμαρειας λεγων ειναι τινα εαυτον μεγαν
- 10 Dhe të gjithë, nga më i madhi te më i vogli, ia vinin veshin, duke thënë: "Ky është fuqia e madhe e Perëndisë".  
**To whom they all gave attention, from the smallest to the greatest, saying, This man is that power of God which is named Great.**  
 ω προσειχον παντες απο μικρου εως μεγαλου λεγοντες ουτος εστιν η δυναμις του θεου η μεγαλη

- 11 Dhe e dëgjonin, sepse prej një kohe të gjatë ai i kishte mahnitur me mjeshtirinë e tij prej magjistari.  
And they gave attention to him, because for a long time his wonder-working powers had kept them under his control.  
προσειχον δε αυτο δια το ικανω χρονω ταις μαγειαις εξεστακεναι αυτους
- 12 Por, kur i besuan Filipit, që shpalli lajmin e mirë të gjërave të mbretërisë së Perëndisë dhe emrin e Jezu Krishtit, burra dhe gra u pagëzuan.  
But when they had faith in the good news given by Philip about the kingdom of God and the name of Jesus Christ, a number of men and women had baptism.  
οτε δε επιστευσαν τω φιλιππω ευαγγελιζομενω τα περι της βασιλειας του θεου και του ονοματος του ιησου χριστου εβαπτιζοντο ανδρες τε και γυναικες
- 13 Besoi edhe Simoni dhe, mbasi u pagëzua, rrinte vazhdimisht me Filipin; dhe, duke parë veprat e fuqishme dhe shenjat që ishin bërë, mbeti i çuditur.  
And Simon himself had faith and, having had baptism, he went with Philip and, seeing the signs and the great wonders which he did, he was full of surprise.  
ο δε σιμων και αυτος επιστευσεν και βαπτισθεις ην προσκαρτερων τω φιλιππω θεωρων τε σημεια και δυναμεις μεγαλας γινομενας εξιστατο
- 14 Por kur apostujt dëgjuan në Jeruzalem se Samaria kishte pranuar fjalën e Perëndisë, i dërguan atyre Pjetrin dhe Gjonin.  
Now when the Apostles at Jerusalem had news that the people of Samaria had taken the word of God into their hearts, they sent to them Peter and John;  
ακουσαντες δε οι εν ιεροσολυμοις αποστολοι οτι δεδεκται η σαμαρεια τον λογον του θεου απεστειλαν προς αυτους τον πετρον και ιωαννην
- 15 Kur këta arritën, u lutën për ta, që të merrnin Frymën e Shenjtë,  
Who, when they came there, made prayer for them, that the Holy Spirit might be given to them:  
οιτινες καταβαντες προσηυξαντο περι αυτων οπως λαβωσιν πνευμα αγιον
- 16 sepse ende nuk kishte zbritur mbi asnjë prej tyre, por ata vetëm ishin pagëzuar në emër të Zotit Jezus.  
For up to that time he had not come on any of them; only baptism had been given to them in the name of the Lord Jesus.  
ουπω γαρ ην επ ουδενι αυτων επιπετωκος μονον δε βεβαπτισμενοι υπηρχον εις το ονομα του κυριου ιησου
- 17 Atëherë vunë duart mbi ta dhe ata morën Frymën e Shenjtë.  
Then they put their hands on them, and the Holy Spirit came on them.  
τοτε επιτιθουν τας χειρας επ αυτους και ελαμβανον πνευμα αγιον
- 18 Dhe Simoni, kur pa se me vënien e duarve të apostujve jepej Fryma e Shenjtë, u ofroi atyre para,  
Now when Simon saw that the Holy Spirit was given through the touch of the Apostles' hands, he made them an offering of money, saying,  
θεασαμενος δε ο σιμων οτι δια της επιθεσεως των χειρων των αποστολων διδοται το πνευμα το αγιον προσηνεγκεν αυτοις χρηματα
- 19 duke thënë: "Ma jepni edhe mua këtë pushtet, që ai të cilit do t'i vë duart, të marrë Frymën e Shenjtë".  
Give me this power, so that when I put my hands on anyone he may get the Holy Spirit.  
λεγων δοτε καμοι την εξουσιαν ταυτην ινα ω αν επιθω τας χειρας λαμβανη πνευμα αγιον
- 20 Por Pjetri i tha: "Le të humbasë paraja jote dhe ti bashkë me të, sepse ti mendove se mund ta blesh me para dhuratën e Perëndisë.  
But Peter said, May your money come to destruction with you, because you had the idea that what is freely given by God may be got for a price.  
πετρος δε ειπεν προς αυτον το αργυριον σου συν σοι ειη εις απωλειαν οτι την δωρεαν του θεου ενομισας δια χρηματων κτασθαι
- 21 Ti nuk ke as pjesë as short në këtë gjë, sepse zemra jote nuk është e drejtë përpara Perëndisë.  
You have no part in this business, because your heart is not right before God.  
ουκ εστιν σοι μερις ουδε κληρος εν τω λογω τουτω η γαρ καρδια σου ουκ εστιν ευθεια ενοπιον του θεου
- 22 Pendohu, pra, për këtë ligësi që ke dhe lutju Perëndisë që, po të jetë e mundur, të të falet mendimi i zemrës sate.  
Let your heart be changed, and make prayer to God that you may have forgiveness for your evil thoughts.  
μετανοησον ουν απο της κακιας σου ταυτης και δεηθητι του θεου ει αρα αφεθησεται σοι η επινοια της καρδιας σου
- 23 Sepse unë të shoh se je në vrerin e hidhësisë dhe në prangat e paudhësisë".  
For I see that you are prisoned in bitter envy and the chains of sin.  
εις γαρ χολην πικριας και συνδεσμον αδικιας ορω σε οντα
- 24 Dhe Simoni, duke u përgjigjur, tha: "Lutjuni ju Zotit për mua, që të mos më ndodhë asgjë nga ato që thatë".  
And Simon, answering, said, Make prayer for me to the Lord, so that these things which you have said may not come on me.  
αποκριθεις δε ο σιμων ειπεν δεηθητε υμεις υπερ εμου προς τον κυριον οπως μηδεν επελθη επ εμε ων ειρηκατε



- 25 Ata, pra, pasi dhanë dëshmi dhe predikuan fjalën e Zotit, u kthyen në Jeruzalem, mbasi ungjillzuan shumë fshatra të Samaritanëve.  
So they, having given their witness and made clear the word of the Lord, went back to Jerusalem, giving the good news on their way in a number of the small towns of Samaria.  
οι μεν ουν διαμαρτυραμενοι και λαλησαντες τον λογον του κυριου υπεστρεψαν εις ιερουσαλημ πολλας τε κωμας των σαμαρειτων ευηγγελισαντο
- 26 Dhe një engjëll i Zotit i foli Filipit, duke i thënë: "Çohu dhe shko drejt jugut, në rrugën që nga Jeruzalemi zbret në Gaza; ajo është e shkretë".  
But an angel of the Lord said to Philip, Get up, and go to the south, to the road which goes from Jerusalem to Gaza, through the waste land.  
αγγελος δε κυριου ελαλησεν προς φιλιππον λεγων αναστηθι και πορευου κατα μεσημβριαν επι την οδον την καταβαινουσαν απο ιερουσαλημ εις γαζαν αυτη εστιν ερημος
- 27 Ai u ngrit dhe u nis; dhe ja, një njeri Etiopas, eunuk, një zyrtar i lartë i Kandaces, mbretëreshës së Etiopisë, përgjegjës i të gjitha thesareve të saj, i cili kishte ardhur në Jeruzalem për të adhuruar.  
And he went and there was a man of Ethiopia, a servant of great authority under Candace, queen of the Ethiopians, and controller of all her property, who had come up to Jerusalem for worship;  
και αναστας επορευθη και ιδου ανηρ αιθιοψ ευνουχος δυναστης κανδακης της βασιλεισης αιθιοπων ος ην επι πασης της γαζης αυτης ος εληλυθει προσκυνησων εις ιερουσαλημ
- 28 Tani ai po kthehej dhe, i ulur në karrocën e vet, lexonte profetin Isaia.  
He was going back, seated in his carriage, and was reading the book of the prophet Isaiah.  
ην τε υποστρεφων και καθημενος επι του αρματος αυτου και ανεγινωσκεν τον προφητην ησαιαν
- 29 Dhe Fryma i tha Filipit: "Afrohu dhe arrijë atë karrocë!".  
And the Spirit said to Philip, Go near, and get on his carriage.  
ειπεν δε το πνευμα τω φιλιπω προσελθε και κολληθητι τω αρματι τουτω
- 30 Filipi iu turr afër dhe, duke dëgjuar se po lexonte profetin Isaia, i tha: "A e kupton atë që lexon?".  
And Philip, running up to him, saw that he was reading Isaiah the prophet, and said to him, Is the sense of what you are reading clear to you?  
προσδραμων δε ο φιλιππος ηκουσεν αυτου αναγινωσκοντος τον προφητην ησαιαν και ειπεν αρα γε γινωσκεις α αναγινωσκεις
- 31 Ai tha: "E si do të mundja, po s'pata një që të më udhëzojë?". Pastaj iu lut Filipit të hipë dhe të ulet pranë tij.  
And he said, How is that possible when I have no guide? And he made Philip get up by his side.  
ο δε ειπεν πως γαρ αν δυναιμην εαν μη τις οδηγηση με παρεκαλεσεν τε τον φιλιππον αναβαντα καθισαι συν αυτω
- 32 Por pjesa e Shkrimit që ai po lexonte ishte kjo: "Atë e çuan si delja në thetore; dhe ashtu si qengji është memec përpara qethtarit, kështu ai nuk e hapi gojën e vet.  
Now the place in the book where he was reading was this: He was taken, like a sheep, to be put to death; and as a lamb is quiet when its wool is being cut, so he made no sound:  
η δε περιωχη της γραφης ην ανεγινωσκεν ην αυτη ως προβατον επι σφαγην ηχθη και ως αμνος εναντιον του κειροντος αυτον αφωνος ουτως ουκ ανοιγει το στομα αυτου
- 33 Në përuljen e tij iu mohua çfarëdolloj drejtësie; po kush do të mund ta përshkruajë brezin e tij? Sepse jeta e tij u hoq nga toka".  
Being of low degree, his cause was not given a hearing; who has knowledge of his family? for his life is cut off from the earth.  
εν τη ταπεινωσει αυτου η κρισις αυτου ηρθη την δε γενεαν αυτου τις διηγησεται οτι αιρεται απο της γης η ζωη αυτου
- 34 Dhe eunuku iu kthye Filipit dhe tha: "Të lutem, për kë e thotë profeti këtë? Për veten e vet apo për ndonjë tjetër?".  
And the Ethiopian said to Philip, About whom are these words said by the prophet? about himself, or some other?  
αποκριθεις δε ο ευνουχος τω φιλιπω ειπεν δεομαι σου περι τινος ο προφητης λεγει τουτο περι εαυτου η περι ετερου τινος
- 35 Atëherë e mori fjalën Filipit dhe, duke filluar nga ky Shkrim, i shpalli Jezusin.  
So Philip, starting from this writing, gave him the good news about Jesus.  
ανοιξας δε ο φιλιππος το στομα αυτου και αρξαμενος απο της γραφης ταυτης ευηγγελισατο αυτω τον ιησουν
- 36 Dhe, ndërsa po vazhdonin rrugën, arritën në një vend me ujë. Dhe eunuku tha: "Ja uji! Çfarë më pengon të pagëzohem?".  
And while they were going on their way, they came to some water, and the Ethiopian said, See, here is water; why may I not have baptism?  
ως δε επορευοντο κατα την οδον ηλθον επι τι υδωρ και φησιν ο ευνουχος ιδου υδωρ τι κωλνει με βαπτισθηναι
- 37 Dhe Filipi tha: "Nëse ti beson me gjithë zemër, mund ta bësh". Dhe ai u përgjigj duke thënë: "Unë besoj se Jezu Krishti është Biri i Perëndisë".  
[]  
ειπεν δε ο φιλιππος ει πιστευεις εξ ολης της καρδιας εξεστιν αποκριθεις δε ειπεν πιστευω τον υιον του θεου ειναι τον ιησουν χριστον
- 38 Urdhëroi atëherë të ndalet karroca, dhe të dy, Filipi dhe eunuku, zbritën në ujë dhe ai e pagëzoi.  
And he gave orders for the carriage to be stopped, and the two of them went down into the water, and Philip gave him baptism.  
και εκελευσεν στηναι το αρμα και κατεβησαν αμφοτεροι εις το υδωρ ο τε φιλιππος και ο ευνουχος και εβαπτισεν αυτον

- 39 Kur dolën nga uji, Fryma e Zotit e rrëmbeu Filipin dhe eunuku nuk e pa më; por e vazhdoi rrugën e tij me plot gëzim.  
And when they came up out of the water, the Spirit of the Lord took Philip away; and the Ethiopian saw him no more, for he went on his way full of joy.  
οτε δε ανεβησαν εκ του υδατος πνευμα κυριου ηρπασεν τον φιλιππον και ουκ ειδεν αυτον ουκετι ο ευνουχος επορευετο γαρ την οδον αυτου χαιρων
- 40 Por Filipi u gjet në Azot; dhe, duke vazhduar, ungjillëzoi të gjitha qytetet, derisa arriti në Cezare.  
But Philip came to Azotus, and went through all the towns, preaching the good news, till he came to Caesarea.  
φιλιππος δε ευρεθη εις αζωτον και διερχομενος ευηγγελιζετο τας πολεις πασας εως του ελθειν αυτον εις καισαρειαν
- 1 Ndërkaq Sauli, duke shfryrë akoma kërcënime dhe kërdi kundër dishepujve të Zotit, shkoi te kryepriifti,  
But Saul, still burning with desire to put to death the disciples of the Lord, went to the high priest,  
ο δε σαυλος ετι εμπνεων απειλης και φονου εις τους μαθητας του κυριου προσελθων τω αρχιερει
- 2 dhe kërkoi nga ai letra për sinagogat e Damaskut, me qëllim që, po të gjente ndonjë ihtar të Udhës, burra o gra, të mund t'i sillte të lidhur në Jeruzalem.  
And made a request for letters from him to the Synagogues of Damascus, so that if there were any of the Way there, men or women, he might take them as prisoners to Jerusalem.  
ητησατο παρ αυτου επιστολας εις δαμασκον προς τας συναγωγας οπως εαν τινας ευρη της οδου οντας ανδρας τε και γυναικας δεδεμενους αγαγη εις ιερουσαλημ
- 3 Por ndodhi që, ndërsa po udhëtonte dhe po i afrohej Damaskut, befaz rreth tij vetëtiu një dritë nga qielli.  
And while he was journeying, he came near Damascus; and suddenly he saw a light from heaven shining round him;  
εν δε τω πορευεσθαι εγενετο αυτον εγγιζειν τη δαμασκω και εξαιφνης περιηστραψεν αυτον φως απο του ουρανου
- 4 Dhe, si u rrëzua përtokë, dëgjoji një zë që i thoshte: "Saul, Saul, përse më përndjek?".  
And he went down on the earth, and a voice said to him, Saul, Saul, why are you attacking me so cruelly?  
και πεσων επι την γην ηκουσεν φωνην λεγουσαν αυτω σαουλ σαουλ τι με διωκεις
- 5 Dhe ai tha: "Kush je, Zot?". Dhe Zoti tha: "Unë jam Jezusi, që ti e përndjek; është e rëndë për ty të godasësh me shkelm kundër gjembave".  
And he said, Who are you, Lord? And he said, I am Jesus, whom you are attacking:  
ειπεν δε τις ει κυριε ο δε κυριος ειπεν εγω ειμι ηιησους ον συ διωκεις σκληρον σοι προς κεντρα λακτιζειν
- 6 Atëherë ai, duke u dridhur i tëri dhe i trembur, tha: "Zot, ç'don ti të bëj unë?". Dhe Zoti: "Çohu dhe hyr në qytet, dhe do të të thuhet ç'duhet të bësh".  
But get up, and go into the town, and it will be made clear to you what you have to do.  
τρεμων τε και θαμβων ειπεν κυριε τι με θελεις ποιησαι και ο κυριος προς αυτον αναστηθι και εισελθε εις την πολιν και λαληθησεται σοι τι σε δει ποιειν
- 7 Dhe njerëzit që udhëtonin me të ndaluan të habitur, sepse dëgjonin tingullin e zërit, por nuk shikonin njeri.  
And the men who were with him were not able to say anything; hearing the voice, but seeing no one.  
οι δε ανδρες οι συνοδευοντες αυτω εισηκεισαν εννεοι ακουοντες μεν της φωνης μηδενα δε θεωρουντες
- 8 Pastaj Sauli u çua nga toka, por, kur i çeli sytë, nuk shihte asnjëri; atëherë e morën për dore dhe e çuan në Damask.  
And Saul got up from the earth, and when his eyes were open, he saw nothing; and he was guided by the hand into Damascus.  
ηγερθη δε ο σαυλος απο της γης ανεωγμενων δε των οφθαλμων αυτου ουδενα εβλεπεν χειραγωγουντες δε αυτον εισηγαγον εις δαμασκον
- 9 Dhe mbeti tri ditë pa të parit, as hëngri as pju.  
And for three days he was not able to see, and he took no food or drink.  
και ην ημερας τρεις μη βλεπων και ουκ εφαγεν ουδε ειπεν
- 10 Në Damask ishte një dishepull me emër Anania, të cilit Zoti i tha në vegim: "Anania!". Dhe ai u përgjigj: "Ja ku jam, Zot!".  
Now there was a certain disciple at Damascus, named Ananias; and the Lord said to him in a vision, Ananias! and he said, Here I am, Lord.  
ην δε τις μαθητης εν δαμασκω ονοματι ανανιας και ειπεν προς αυτον ο κυριος εν οραματι ανανια ο δε ειπεν ιδου εγω κυριε
- 11 Dhe Zoti i tha: "Çohu dhe shko në rrugën e quajtur E drejtë, dhe kërkoni në shtëpinë e Judës një njeri nga Tarsi me emër Saul, i cili po lutet;  
And the Lord said to him, Get up, and go to the street which is named Straight, and make search at the house of Judas for one named Saul of Tarsus: for he is at prayer;  
ο δε κυριος προς αυτον αναστας πορευθητι επι την ρυμην την καλουμενην ευθειαν και ζητησον εν οικια ιουδα σαυλον ονοματι ταρσαα ιδου γαρ προσευχεται
- 12 ai ka parë në vegim një njeri, me emër Anania, duke hyrë dhe duke i vënë duart për t'ia kthyer dritën e syve".  
And he has seen a man named Ananias coming in and putting his hands on him, so that he may be able to see.  
και ειδεν εν οραματι ανδρα ονοματι ανανιαν εισελθοντα και επιθεντα αυτω χειρα οπως αναβλεψη

- 13 Atëherë Anania u përgjigj: "O Zot, nga shumë veta kam dëgjuar për këtë njeri se sa të këqija u ka bërë shenjtorëve të tu në Jeruzalem.  
But Ananias said, Lord, I have had accounts of this man from a number of people, how much evil he has done to your saints at Jerusalem:  
απεκριθη δε ο ανανιας κυριε ακηκοα απο πολλων περι του ανδρος τουτου οσα κακα εποιησεν τοις αγιοις σου εν ιερουσαλημ
- 14 Dhe ai ka këtu një autorizim nga krerët e priftërinjve për të burgosur të gjithë ata që thërrasin emrin tënd".  
And here he has authority from the chief priests to make prisoners all who give worship to your name.  
και ωδε εχει εξουσιαν παρα των αρχιερεων δησαι παντας τους επικαλουμενους το ονομα σου
- 15 Por Zoti i tha: "Shko, sepse ai është vegla që unë kam zgjedhur për ta sjellë emrin tim përpara johebrenjve, mbretërve dhe bijve të Izraelit.  
But the Lord said, Go without fear: for he is a special vessel for me, to give to the Gentiles and kings and to the children of Israel the knowledge of my name:  
ειπεν δε προς αυτον ο κυριος πορευου οτι σκευος εκλογης μοι εστιν ουτος του βαστασαι το ονομα μου ενωπιον εθνων και βασιλεων υιων τε ισραηλ
- 16 Sepse unë do t'i tregoj atij sa shumë i duhet të vuajë për emrin tim".  
For I will make clear to him what troubles he will have to undergo for me.  
εγω γαρ υποδειξω αυτω οσα δει αυτον υπερ του ονοματος μου παθειν
- 17 Atëherë Anania shkoi dhe hyri në atë shtëpi; dhe, duke i vënë duart, tha: "Vëlla Saul, Zoti Jezus, që të është shfaqur në rrugën nëpër të cilën ti po vije, më ka dërguar që të kesh përsëri dritën e syve dhe të mbushesh me Frymën e Shenjtë".  
And Ananias went out and came to the house, and putting his hands on him, said, Brother Saul, the Lord Jesus, whom you saw when you were on your journey, has sent me, so that you may be able to see, and be full of the Holy Spirit.  
απηλθεν δε ανανιας και εισηλθεν εις την οικιαν και επιθεις επ αυτον τας χειρας ειπεν σαουλ αδελφε ο κυριος απεσταλκεν με ιησους ο οφθεις σοι εν τη οδω η ηρχου οπως αναβλεψης και πλησθης πνευματος αγιου
- 18 Në këtë çast i ranë nga sytë disa si luspa, dhe ai fitoi përsëri të parit; pastaj u ngrit dhe u pagëzua.  
And straight away it seemed as if a veil was taken from his eyes, and he was able to see; and he got up, and had baptism;  
και ευθως απεπεσον απο των οφθαλμων αυτου ωσει λεπιδες ανεβλεψεν τε παραρημα και αναστας εβαπτισθη
- 19 Dhe, mbasi mori ushqim, ai u ripërtëri në forcë. Pastaj Sauli qëndroi disa ditë me dishepujt që ishin në Damask.  
And when he had taken food his strength came back. And for some days he kept with the disciples who were in Damascus.  
και λαβων τροφην ενισχυσεν εγενετο δε ο σαυλος μετα των εν δαμασκω μαθητων ημερας τινας
- 20 Dhe fillloi menjëherë të predikojë Krishtin në sinagoga se ai është Biri i Perëndisë.  
And straight away, in the Synagogues, he was preaching Jesus as the Son of God.  
και ευθως εν ταις συναγωγαις εκηρυσσεν τον χριστον οτι ουτος εστιν ο υιος του θεου
- 21 Dhe të gjithë ata që e dëgjonin çuditëshin dhe thoshnin: "Po a nuk është ky ai që në Jeruzalem përndiqte të gjithë ata që e thërrisnin këtë emër, dhe ka ardhur këtu me synim që t'i çojë si robër të krerët e priftërinjve?".  
And all those hearing him were full of wonder and said, Is not this the man who in Jerusalem was attacking all the worshippers of this name? and he had come here so that he might take them as prisoners before the chief priests.  
εξισταντο δε παντες οι ακουοντες και ελεγον ουχ ουτος εστιν ο πορθησας εν ιερουσαλημ τους επικαλουμενους το ονομα τουτου και ωδε εις τουτου εληλυθει ινα δεδεμενους αυτους αγαγη επι τους αρχιεραεις
- 22 Por Sauli bëhej gjithnjë e më i fortë dhe i hutonte Judenjët që banonin në Damask, duke ua vërtetuar se Jezusi është Krishti.  
But Saul went on increasing in power, and the Jews in Damascus were not able to give answers to the arguments by which he made it clear that Jesus was the Christ.  
σαυλος δε μαλλον ενεδυναμωτο και συνεχυνεν τους ιουδαιους τους κατοικουντας εν δαμασκω συμβιβαζων οτι ουτος εστιν ο χριστος
- 23 Pas shumë ditësh, Judenjët u konsultuan bashkë që ta vrasin.  
Then, after some days, the Jews made an agreement together to put him to death:  
ως δε πληρουντο ημεραι ικαναι συνεβουλευσαντο οι ιουδαιοι ανελειν αυτον
- 24 Por komploti i tyre u mor vesh nga Sauli. Dhe ditë e natë ata i ruanin portat e qytetit që të mund ta vrisnin;  
But Saul got knowledge of their design. And they kept watch day and night on the roads out of the town, so that they might put him to death:  
εγνωσθη δε τω σαυλω η επιβουλη αυτων παρετηρουν τε τας πυλας ημερας τε και νυκτος οπως αυτον ανελωσιν

- 25 atëherë dishepujt e morën natën dhe e zbritën poshtë nga muri, në një shportë.  
But his disciples took him by night and let him down from the wall in a basket.  
λαβοντες δε αυτον οι μαθηται νυκτος καθηκαν δια του τειχους χαλασαντες εν σπυριδι
- 26 Si arriti në Jeruzalem, Sauli u përpoq të bashkohej me dishepujt, por të gjithë kishin frikë nga ai, sepse nuk mund të besonin se ai ishte dishepull.  
And when he came to Jerusalem, he made an attempt to be joined to the disciples, but they were all in fear of him, not taking him for a disciple.  
παραγενομενος δε ο σαυλος εις ιερουσαλημ επειρατο κολλησθαι τοις μαθηταις και παντες εφοβουντο αυτον μη πιστευοντες οτι εστιν μαθητης
- 27 Atëherë Barnaba e mori dhe e çoi tek apostujt, dhe u tregoi se si ai, gjatë udhëtimit, e kishte parë Zotin që i kishte folur, dhe si kishte folur në Damask lirshëm në emër të Jezusit.  
But Barnabas took him to the Apostles and gave them an account of how he had seen the Lord on the road, and had given hearing to his words, and how at Damascus he had been preaching in the name of Jesus without fear.  
βαρναβας δε επιλαβομενος αυτον ηγαγεν προς τους αποστολους και διηγησατο αυτοις πως εν τη οδω ειδεν τον κυριον και οτι ελαλησεν αυτοω και πως εν δαμασκω επαρησιασατο εν τω ονοματι του ιησου
- 28 Kështu ai qëndroi me ta në Jeruzalem, dhe shkonte e vinte, dhe fliste lirshëm në emër të Zotit Jezus.  
And he was with them, going in and out at Jerusalem,  
και ην μετ αυτων εισπορευομενος και εκπορευομενος εν ιερουσαλημ και παρησιαζομενος εν τω ονοματι του κυριου ιησου
- 29 Ai u fliste dhe diskutonte me helenistët, por ata kërkonin ta vrisnin.  
Preaching in the name of the Lord without fear; and he had discussions with the Greek Jews; but they were working for his death.  
ελαλει τε και συνεζητει προς τους ελληνιστας οι δε επεχειρουν αυτον ανελειν
- 30 Por vëllezërit, kur e morën vesh, e çuan në Cezare dhe që andej e nisën për në Tars.  
And when the brothers had knowledge of it, they took him to Caesarea and sent him to Tarsus.  
επιγνοντες δε οι αδελφοι κατηγαγον αυτον εις καισαρειαν και εξασπετειλαν αυτον εις ταρσον
- 31 Kështu në mbarë Judenë, në Galile dhe në Samari kishat kishin paqe dhe ndërtoheshin. Dhe duke ecur në druajtjen e Zotit dhe në ngushëllimin e Frymës së Shenjtë, shumoheshin.  
And so the church through all Judaea and Galilee and Samaria had peace and was made strong; and, living in the fear of the Lord and in the comfort of the Holy Spirit, was increased greatly.  
αι μεν ουν εκκλησιαι καθ ολης της ιουδαιας και γαλιλαιας και σαμαρειας ειχον ειρηνην οικοδομουμεναι και πορευομεναι τω φοβω του κυριου και τη παρακλησει του αγιου πνευματος επληθυνοντο
- 32 Por ndodhi që, ndërsa Pjetri po e përshkonte gjithë vendin, erdhi edhe te shenjtorët që banonin në Lida.  
And it came about that while Peter was going through all parts of the country he came to the saints who were living at Lydda.  
εγενετο δε πετρον διερχομενον δια παντων κατελθειν και προς τους αγιους τους κατοικουντας λυδδαν
- 33 Aty ai gjeti një njeri me emër Enea, i cili tashmë prej tetë vjetësh dergjej në shtrat, sepse ishte i paralizuar.  
And there was a certain man there, named Aeneas, who for eight years had been in bed, without power of moving.  
ευρεν δε εκει ανθρωπον τινα αινεαν ονοματι εξ ετων οκτω κατακειμενον επι κραββατω ος ην παραλελυμενος
- 34 Pjetri i tha: "Enea, Jezusi, Krishti, të shëron; çohu dhe ndreqe shtratin". Dhe ai u ngrit menjëherë.  
And Peter said to him, Aeneas, Jesus Christ makes you well: get up and make your bed. And straight away he got up.  
και ειπεν αυτοω ο πετρος αινεα ιαται σε ιησους ο χριστος αναστηθι και στρωσον σεαυτω και ευθεως ανεστη
- 35 Dhe të gjithë banorët e Lidës dhe të Saronit e panë dhe u kthyen te Zoti.  
And all those living in Lydda and Sharon saw him, and were turned to the Lord.  
και ειδον αυτον παντες οι κατοικουντες λυδδαν και τον σαρωναν οτινες επεστρεψαν επι τον κυριον
- 36 Por në Jopë ishte një dishepull me emër Tabitha, që do të thotë Gazelë; ajo bënte shumë vepra të mira dhe jepte shumë lëmoshë.  
Now there was at Joppa a certain disciple named Tabitha, that is, Dorcas: this woman was given to good works and acts of mercy at all times.  
εν ιοπη δε τις ην μαθητρια ονοματι ταβιθα η διερμηνευομενη λεγεται δορκας αυτη ην πληρης αγαθων εργαων και ελεημοσυνων ον ποιεει
- 37 Por në ato ditë ndodhi që ajo u sëmur dhe vdiq. Pasi e lanë, e vunë në një dhomë në katin e sipërm.  
And it came about, in those days, that she got ill and came to her death: and when she had been washed, they put her in a room which was high up.  
εγενετο δε εν ταις ημεραις εκειναις ασθeneησασαν αυτην αποθανειν λουσαντες δε αυτην εθηκαν εν υπερωω

- 38 Dhe, duke qenë se Lida është afër Jopës, dishepujt, kur morën vesh se Pjetri ndodhej atje, i dërguan dy burra që ta lutnin të vijë tek ata pa vonesë.  
*And because Lydda was near Joppa, the disciples, having knowledge that Peter was there, sent two men to him, requesting him to come to them straight away.*  
 εγγυς δε ουσης λυδδης τη ιωπη οι μαθηται ακουσαντες οτι πετρος εστιν εν αυτη απεστειλαν δυο ανδρας προς αυτον παρακαλουντες μη οκνησαι διελθειν εως αυτων
- 39 Atëherë Pjetri u ngrit dhe u nis bashkë me ta. Sapo arriti, e çuan në dhomën lart; të gjitha gratë e veja i dolën atij duke qarë dhe i treguan tunikat dhe veshjet që kishte punuar Gazela, sa ishte bashkë me to.  
*And Peter went with them. And when he had come, they took him into the room: and all the widows were there, weeping and putting before him the coats and clothing which Dorcas had made while she was with them.*  
 αναστας δε πετρος συνηλθεν αυτοις ον παραγενομενον ανηγαγον εις το υπερωον και παρεστησαν αυτω πασαι αι χηραι κλαιουσαι και επιδεικνυμεναι χιτωνας και ιματια οσα εποιει μετ αυτων ουσα η δ ορκας
- 40 Atëherë Pjetri, mbasi i nxori jashtë të gjithë, u ngjunjëzua dhe u lut. Pastaj iu kthye trupit dhe tha: "Tabitha, çohu!". Dhe ajo i hapi sytë dhe, si pa Pjetrin, u ngrit ndenjtur.  
*But Peter made them all go outside, and went down on his knees in prayer; and turning to the body, he said, Tabitha, get up. And, opening her eyes, she saw Peter and got up.*  
 εκβαλων δε εξω παντας ο πετρος θεις τα γονατα προσηυξατο και επιστρεφας προς το σωμα ειπεν ταβιθα αναστηθι η δε ηνοιξεν τους οφθαλμους αυτης και ιδουσα τον πετρον ανεκαθισεν
- 41 Ai i dha dorën dhe e ndihmoi të ngrihet; dhe, si thirri shenjtorët dhe gratë e veja, ua tregoi të gjallë.  
*And he took her hand, lifting her up; and, sending for the saints and widows, he gave her to them, living.*  
 δους δε αυτη χειρα ανεστησεν αυτην φωνησας δε τους αγιους και τας χηρας παρεστησεν αυτην ζωσαν
- 42 Kjo u muar vesh në mbarë Jopën, dhe shumë veta besuan në Zotin.  
*And news of it went all through Joppa, and a number of people had faith in the Lord.*  
 γνωστον δε εγενετο καθ ολης της ιωπης και πολλοι επιστευσαν επι τον κυριον
- 43 Dhe Pjetri qëndroi disa ditë në Jopë, në shtëpinë e njëfarë Simoni, regjës lëkurësh.  
*And he was living in Joppa for some time with Simon, a leather-worker.*  
 εγενετο δε ημερας ικανας μειναι αυτον εν ιωπη παρα τινι σιμωνι βυρσει
- 1 Por në Cezare ishte njëfarë njeriu me emër Kornel, centurion i kohortës, që quhej Italik;  
*Now there was a certain man in Caesarea, named Cornelius, the captain of the Italian band of the army;*  
 ανηρ δε τις ην εν καισαρεια ονοματι κορνηλιος εκατονταρχης εκ σπειρης της καλουμενης ιταλικης
- 2 ai ishte njeri i perëndishëm dhe që e druante Perëndinë me gjithë shtëpinë e tij; i jepte shumë lëmoshë popullit dhe vazhdimisht i lutej Perëndisë.  
*A serious-minded man, fearing God with all his family; he gave much money to the poor, and made prayer to God at all times.*  
 ευσεβης και φοβουμενος τον θεον συν παντι τω οικω αυτου ποιων τε ελεημοσυνας πολλας τω λαω και δεομενος του θεου διαπαντος
- 3 Ai pa qartë në një vegim, aty nga ora e nëntë e ditës, një engjëll të Perëndisë që hyri tek ai dhe i tha: "Kornel!".  
- 36 Sepse Davidi, mbasi zbatoi këshillën e Perëndisë në brezin e tij, vdiq dhe u bashkua me etërit e vet dhe pa kalbje,  
Now David, having done God's work for his generation, went to sleep, and was put with his fathers, and his body came to destruction:  
δαβιδ μεν γαρ ιδια γενεα υπηρετησας τη του θεου βουλη εκοιμηθη και προσεθεθη προς τους πατερας αυτου και ειδεν διαφθοραν
- 37 por ai, që e ka ringjallur Perëndia, nuk ka parë kalbje.  
But he, who was lifted up by God, did not see destruction.  
ον δε ο θεος ηγειρεν ουκ ειδεν διαφθοραν
- 38 Le ta dini, pra, o vëllezër, se nëpërmjet tij ju është shpallur falja e mëkateve,  
And so, let it be clear to you, my brothers, that through this man forgiveness of sins is offered to you:  
γνωστον ουν εστω υμιν ανδρες αδελφοι οτι δια τουτου υμιν αφεις αμαρτιων καταγγελλεται
- 39 dhe se, me anë të tij, ai që beson është shfajësuar nga të gjitha gjërat, që nuk mund të shfajsohej me anë të ligjit të Moisiut.  
And through him everyone who has faith is made free from all those things, from which the law of Moses was not able to make you free.  
και απο παντων ων ουκ ηδυνηθητε εν τω νομω μουσεως δικαιοθηναι εν τουτω πας ο πιστευων δικαιουται
- 40 Kini kujdes, pra, që të mos ju ndodhë ajo që është thënë në profetët:  
So take care that these words of the prophets do not come true for you;  
βλεπετε ουν μη επελθη εφ υμας το ειρημενον εν τοις προφηταις

- 41 "Shikoni, o përbuzës, mrekullohuni dhe do të treteni, sepse unë po kryej një vepër në ditët tuaja, një vepër, të cilën ju nuk do ta besoni, po t'ju tregonte dikush";  
See, you doubters, have wonder and come to your end; for I will do a thing in your days to which you will not give belief, even if it is made clear to you.  
ιδετε οι καταφρονηται και θαυμασατε και αφανισθητε οτι εργον εγω εργαζομαι εν ταις ημεραις υμων εργον ω ου μη πιστευσητε εαν τις εκδιχηται υμιν
- 42 Dhe kur Judenjtë dolën nga sinagoga, johebrenjtë u lutën që të shtunën e ardhshme t'u flisnin përsëri për këto gjëra.  
And when they went out, they made a request that these words might be said to them again on the Sabbath after.  
εξιοντων δε εκ της συναγωγης των ιουδαιων παρεκαλουν τα εθνη εις το μεταξυ σαββατον λαληθηναι αυτοις τα ρηματα ταυτα
- 43 Dhe, mbasi u shpërnda mbledhja, shumë nga Judenjtë dhe nga prozelitët e perëndishëm i ndiqnin Palin dhe Barnabën, të cilët, duke u folur atyre, i bindën të ngulmojnë në hir të Perëndisë.  
Now when the meeting was ended, a number of the Jews and of the God-fearing Gentiles who had become Jews, went after Paul and Barnabas: who put before them how important it was to keep on in the grace of God.  
λυθεισης δε της συναγωγης ηκολουθησαν πολλοι των ιουδαιων και των σεβομενων προσηλυτων το παυλω και το βαρναβα οιτινες προσλαουντες αυτοις επειθον αυτοις επιμενειν τη χαριτι του θεου
- 44 Të shtunën tjetër gati gjithë qyteti u mbledh për të dëgjuar fjalën e Perëndisë.  
And on the Sabbath after, almost all the town came together to give hearing to the word of God.  
τω δε ερχομενω σαββατω σχεδον πασα η πολις συνηχθη ακουσαι τον λογον του θεου
- 45 Por Judenjtë, duke parë turmën, u mbushën me smirë dhe u kundërviheshin thënieve të Palit, duke kundërshtuar dhe duke blasfemuar.  
But when the Jews saw such a great number of people, they were full of envy and said evil words against Paul's preaching.  
ιδοντες δε οι ιουδαιοι τους οχλους πλησθησαν ζηλου και αντελεγον τοις υπο του παυλου λεγομενοις αντιλεγοντες και βλασφημουντες
- 46 Atëherë Pali dhe Barnaba, duke folur lirisht, thanë: "Ishte e nevojshme që fjala e Perëndisë t'ju shpallej ju më së pari; por, ngaqë ju e hidhni poshtë dhe nuk e çmoni veten të denjë për jetën e përjetshme, ja, ne po u drejtohem johebrenjve.  
Then Paul and Barnabas without fear said, It was necessary for the word of God to be given to you first; but because you will have nothing to do with it, and have no desire for eternal life, it will now be offered to the Gentiles.  
παρησιασαμενοι δε ο παυλος και ο βαρναβας ειπον υμιν ην αναγκαιον πρωτον λαληθηναι τον λογον του θεου επειδη δε αποθεισθε αυτον και ουκ αξιους κρινετε εαυτους της αιωνιου ζωης ιδου στρεφομεθα εις τα εθνη
- 47 Sepse kështu na ka urdhëruar Zoti: "Unë të vura si dritë të johebrenjve, që ti ta çosh shpëtimin deri në skajin e dheut";  
For so the Lord has given us orders, saying, I have given you for a light to the Gentiles so that you may be for salvation to the ends of the earth.  
ουτως γαρ εντεταλται ημιν ο κυριος τεθεικα σε εις φως εθνον του ειναι σε εις σωτηριαν εως εσχατου της γης
- 48 Johebrenjtë, kur dëgjuan, u gëzuan dhe lëvdonin fjalën e Zotit; dhe të gjithë sa ishin të paracaktuar për jetën e pasosur besuan.  
And the Gentiles, hearing this, were glad and gave glory to the word of God: and those marked out by God for eternal life had faith.  
ακουοντα δε τα εθνη εχαIRON και εδοξάζον τον λογον του κυριου και επιστευσαν οσοι ησαν τεταγμενοι εις ζωην αιωνιον
- 49 Dhe fjala e Zotit përhapej në mbarë atë vend.  
And the word of the Lord went through all the country.  
διεφερετο δε ο λογος του κυριου δι ολης της χωρας
- 50 Por Judenjtë i nxitën disa gra të perëndishme të shtresës së lartë, si dhe parinë e qytetit, dhe ngjallën një përndjekje kundër Palit dhe Barnabës dhe i dëbuan jashtë kufijve të tyre.  
But the Jews, working up the feelings of the God-fearing women of high position and of the chief men of the town, got an attack started against Paul and Barnabas, driving them out of those parts.  
οι δε ιουδαιοι παρωτρυναν τας σεβομενας γυναικας και τας ευσημονας και τους πρωτους της πολεως και επιγειραν διωγμον επι τον παυλον και τον βαρναβαν και εξεβαλον αυτοις απο των οριων αυτων
- 51 Atëherë ata, mbasi shkundën pluhurin e këmbëve të tyre kundër tyre, shkuan në Ikon.  
But they, shaking off the dust of that place from their feet, came to Iconium.  
οι δε εκτιναζαμενοι τον κονιορτον των ποδων αυτων επ αυτοις ηλθον εις ικονιον
- 52 Dhe dishepujt ishin mbushur me gëzim dhe me Frymën e Shenjtë.  
And the disciples were full of joy and of the Holy Spirit.  
οι δε μαθηται πληρουντο χαρας και πνευματος αγιου
- 1 Ndodhi që edhe në Antioki ata hynë në sinagogën Ejudenjve dhe folën në mënyrë të tillë, sa një turmë e madhe Judenjsh dhe Grekësh besuan,  
Now in Iconium they went together to the Synagogue of the Jews and gave such teaching that a great number of Jews and Greeks had faith.  
εγενετο δε εν ικονιω κατα το αυτο εισελθειν αυτοις εις την συναγωγην των ιουδαιων και λαλησαι ουτως ωστε πιστευσαι ιουδαιοι τε και ελληνων πολυ πληθος



- 2 Porjudenjtë që nuk besuan i nxitën dhe i acaruan shpirtrat e johebrenjve kundër vëllezërve.  
But those Jews who had not the faith, made the minds of the Gentiles bitter against the brothers.  
οι δε απειθουντες ιουδαιοι επηγειραν και εκακωσαν τας ψυχας των εθνων κατα των αδελφων
- 3 Ata, pra, qëndruan shumë kohë atje, duke folur lirisht në Zotin, i cili jepte dëshmi fjalës së hirit të tij, duke lejuar që me anë të duarve të tyre të bëheshin shenja dhe mrekulli.  
So they kept there for a long time, taking heart in the Lord, who gave witness to the word of his grace by causing signs and wonders to be done by their hands.  
ικανον μεν ουν χρονον διετριψαν παρρησιαζομενοι επι τω κυριω τω μαρτυρουντι τω λογω της χαριτος αυτου και διδοντι σημεια και τερατα γινεσθαι δια των χειρων αυτων
- 4 Por popullsia e qytetit u nda: disa mbanin anën e Judenjve dhe të tjerë atë të apostujve.  
But there was a division among the people of the town; some were on the side of the Jews and some on the side of the Apostles.  
εσχισθη δε το πληθος της πολεως και οι μεν ησαν συν τοις ιουδαιοις οι δε συν τοις αποστολοις
- 5 Por kur u bë një orvatje nga ana e johebrenjve dhe e Judenjve me krerët e tyre për t'i keqtrajtuar apostujt dhe për t'i vrrarë me gurë,  
And when a violent attempt was made by the Gentiles and the Jews, with their rulers, to make an attack on them and have them stoned,  
ως δε εγενετο ορμη των εθνων τε και ιουδαιων συν τοις αρχουσιν αυτων υβρισαι και λιθοβολησαι αυτους
- 6 ata e morën vesh dhe ikën në qytetet e Likaonisë: në Listra, në Derbë dhe në krahinën përreth,  
Having got news of it, they went in flight to the towns of Lycaonia, Lystra, and Derbe, and the country round about:  
συνιδοντες κατεφυγον εις τας πολεις της λυκαονιας λυστραν και δερβην και την περιχωρον
- 7 dhe atje vazhduan të ungjillëzonin.  
And went on preaching the good news there.  
κακει ησαν ευαγγελιζομενοι
- 8 Dhe në Listra ishte një njeri me këmbë të paralizuara, që rrinte gjithnjë ndenjur dhe nuk kishte ecur kurrë, sepse ishte sakat që nga barku i së ëmës.  
And at Lystra there was a certain man, who from birth had been without the use of his feet, never having had the power of walking.  
και τις ανηρ εν λυστροις αδυνατος τοις ποσιν εκαθητο χωλος εκ κοιλιας μητρος αυτου υπαρχων ος ουδεποτε περιεπατηκει
- 9 Ky e dëgjoi duke folur Palin, i cili nguli sytë mbi të dhe pa se ai kishte besim për t'u shëruar,  
This man was giving ear to the preaching of Paul, who, looking at him, and seeing that he had faith to be made well,  
ουτος ηκουεν του παυλου λαλουντος ος ατενισας αυτω και ιδων οτι πιστιν εχει του σωθηναι
- 10 dhe tha me zë të lartë: "Çohu në këmbë!". Dhe ai hovi lart dhe nisi të ecë.  
Said in a loud voice, Get up on your feet. And, jumping up, he went walking about.  
ειπεν μεγαλη τη φωνη αναστηθι επι τους ποδας σου ορθος και ηλλετο και περιεπατει
- 11 Turma, kur pa ç'kishte bërë Pali, e ngriti zërin duke thënë në gjuhën likaonike: "Perënditë zbritën ndër ne, në trajtë njeriu".  
And when the people saw what Paul had done, they said in a loud voice, in the language of Lycaonia, The gods have come down to us in the form of men.  
οι δε οχλοι ιδοντες ο εποιησεν ο παυλος επηραν την φωνην αυτων λυκαονιστι λεγοντες οι θεοι ομοιωθεντες ανθρωποις κατεβησαν προς ημας
- 12 Dhe e quanin Barnabën Jupiter, Palin Mërkur, sepse ai fliste më shumë.  
And they gave the name of Jupiter to Barnabas, and to Paul that of Mercury, because he was the chief talker.  
εκαλουν τε τον μεν βαρναβαν δια τον δε παυλον ερμην επειδη αυτος ην ο ηγουμενος του λογου
- 13 Atëherë prifti i Jupiterit, që e kishte tempullin në hyrje të qytetit të tyre, solli dema me kurora pranë portave dhe donte të ofronte një flijim bashkë me turmën.  
And the priest of the image of Jupiter, which was before the town, took oxen and flowers to the doors of the town, and was about to make an offering with the people.  
ο δε ιερευς του διος του οντος προ της πολεως αυτων ταυρους και στεμματα επι τους πυλωνας ενεγκας συν τοις οχλοις ηθελεν θυειν
- 14 Por apostujt Barnaba dhe Pal, kur dëgjuan këtë, i grisën rrobat e tyre dhe u turrën në mes të turmës, duke thirrur e duke thënë:  
But when this came to the ears of the Apostles, Paul and Barnabas, they went running out among the people, parting their clothing, and crying out,  
ακουσαντες δε οι αποστολοι βαρναβας και παυλος διαρρηξαντες τα ιματια αυτων εισεπηδησαν εις τον οχλον κραζοντες

- 15 "O burra, pse bëni këto gjëra? Edhe ne jemi njerëz me të njëjtën natyrë si ju, dhe po ju shpallim lajmin e mirë, që ju nga këto gjëra të kota të ktheheni te Perëndia e gjallë që ka bërë qiellin, dheun, detin dhe të gjitha gjërat që janë në ta.  
 Good people, why are you doing these things? We are men with the same feelings as you, and we give you the good news so that you may be turned away from these foolish things to the living God, who made the heaven and the earth and the sea and all things in them:  
 και λεγοντες ανδρες τι ταυτα ποιειτε και ημεις ομοιοπαθεις εσμεν υμιν ανθρωποι ευαγγελιζομενοι υμας απο τωτων ματαιων επιστρεφειν επι τον θεον τον ζωντα ος εποιησεν τον ουρανον και την γην και την θαλασσαν και παντα τα εν αυτοις
- 16 Në brezat që shkuan ai la që të gjitha kombet të ndjekin rrugët e tyre;  
 Who in the past let all nations go in the ways which seemed good to them.  
 ος εν ταις παρωχημεναις γενεαις εισαεν παντα τα εθνη πορευεσθαι ταις οδοις αυτων
- 17 por nuk e la veten e vet pa dëshmi, duke bërë mirë, duke na dhënë shira prej qiellit dhe stinë të frytshme dhe duke i mbushur zemrat tona me ushqim dhe gëzim".  
 But he was not without witness, because he did good, and gave you rain from heaven and times of fruit, making your hearts full of food and joy.  
 και τοι γε ουκ αμαρτυρον εαυτον αφηκεν αγαθοποιων ουρανοθεν ημιν υετους διδους και καιρους καρποφορους επιπλων τροφης και ευφροσυνης τας καρδιας ημων
- 18 Duke thënë këto gjëra, mundën t'i ndalin me vështirësi turmat që të mos u bëjnë flijim.  
 And even with these words, it was hard for them to keep the people from making an offering to them.  
 και ταυτα λεγοντες μολις κατεπαυσαν τους οχλους του μη θειν αυτοις
- 19 Por në atë kohë erdhën disa Judenj nga Antiokia dhe nga Ikonii; ata, mbasi ia mbushën mendjen turmës, e gjuajtën me gurë Palin dhe, duke menduar se kishte vdekur, e tërhoqën zvarrë jashtë qytetit.  
 But some Jews came to that place from Antioch and Iconium, and got control over the people; and after stoning Paul, they had him pulled out of the town, taking him for dead.  
 επιλθον δε απο αντιοχειας και ικονιου ιουδαιοι και πεισαντες τους οχλους και λιθασαντες τον παυλον εσυρον εξω της πολεως νομισαντες αυτον τεθναται
- 20 Por, kur dishepujt u mblodhën rreth tij, ai u ngrit dhe hyri në qytet; dhe të nesërmen u nis me Barnabën për në Derbë.  
 But when the disciples came round him, he got up and went into the town: and the day after he went away with Barnabas to Derbe.  
 κυκλωσαντων δε αυτον των μαθητων αναστας εισηλθεν εις την πολιν και τη επαυριον εξηλθεν συν τω βαρναβα εις δερβην
- 21 Dhe, mbasi ungjillëzuan atë qytet dhe bënë shumë dishepuj, u kthyen në Listra, në Ikon dhe në Antioki,  
 And having made a number of disciples through the preaching of the good news in that town, they went back to Lystra and Iconium and Antioch,  
 ευαγγελιασαμενοι τε την πολιν εκεινην και μαθητευσαντες ικανους υπεστρεψαν εις την λυστραν και ικονιον και αντιοχειαν
- 22 duke fuqizuar shpirtërat e dishepujve dhe duke i këshilluar që të ngulmojnë në besim, dhe duke thënë se me shumë pikëllime duhet të hyjmë në mbretërinë e Perëndisë.  
 Making strong the souls of the disciples, saying to them that they were to keep the faith, and that we have to go through troubles of all sorts to come into the kingdom of God.  
 επιστηριζοντες τας ψυχας των μαθητων παρακαλουντες εμμενειν τη πιστει και οτι δια πολλων θλιψεων δει ημας εισελθειν εις την βασιλειαν του θεου
- 23 Dhe mbasi caktuan për ta pleqtë në çdo kishë, u lutën dhe agjëruan, i lanë në dorën e Zotit, në të cilin kishin besuar.  
 And when they had made selection of some to be rulers in every church, and had given themselves to prayer and kept themselves from food, they put them into the care of the Lord in whom they had faith.  
 χειροτονησαντες δε αυτοις πρεσβυτερους κατ εκκλησιαν προσευξαμενοι μετα νηστειων παρεθεντο αυτους τω κυριω εις ον πεπιστευκεισαν
- 24 Dhe, mbasi e përshkuan Pisidinë, ardhën në Panfili.  
 And they went through Pisidia and came to Pamphylia.  
 και διελθοντες την πισιδιαν ηλθον εις παμφυλιαν
- 25 Dhe, mbasi e shpallën fjalën në Pergë, zbritën në Atali.  
 And, after preaching the word in Perga, they went down to Attalia;  
 και λαλησαντες εν περγη τον λογον κατεβησαν εις ατταλειαν
- 26 Pastaj që andej lundruan për në Antioki, prej nga ishin rekomanduar në hir të Perëndisë për veprën që posa kishin kryer.  
 And from there they went by ship to Antioch, where they had been handed over to the grace of God for the work which they had not done.  
 κακειθεν απεπλευσαν εις αντιοχειαν οθεν ησαν παραδεδομενοι τη χαριτι του θεου εις το εργον ο επληρωσαν

- 27 Si arritën atje, mblodhën kishën dhe treguan ç'gjëra të mëdha kishte kryer Perëndia me anë të tyre dhe si u kishte hapur johebrenjve derën e besimit.  
And when they came there, and had got the church together, they gave them an account of all the things which God had done through them, and how he had made open a door of faith to the Gentiles.  
παραγομενοι δε και συναγαγοντες την εκκλησιαν ανηγγειλαν οσα εποιησεν ο θεος μετ αυτων και οτι ηνοιξεν τοις εθνεσιν θυραν πιστεως
- 28 Dhe qëndruan atje me dishepujt mjaft kohë.  
And they were with the disciples there for a long time.  
διετριβον δε εκει χρονον ουκ ολιγον συν τοις μαθηταις
- 1 Dhe disa, që zbritën nga Judeja, mësonin vëllezërit: "Nëse nuk jeni rrethprerë sipas ritit të Moisiut, nuk mund të shpëtoheni".  
Now certain men came down from Judaea, teaching the brothers and saying that without circumcision, after the rule of Moses, there is no salvation.  
και τινες κατελθοντες απο της ιουδαιας εδιδασκον τους αδελφους οτι εαν μη περιτεμνησθε τω εθει μουσεως ου δυνασθε σωθηαι
- 2 Duke qenë se u bë një grindje jo e vogël dhe një diskutim nga ana e Palit dhe e Barnabës me ata, u dha urdhër që Pali, Barnaba dhe disa të tjerë nga ata të ngjiten në Jeruzalem tek apostujt dhe te pleqtë për këtë çështje.  
And after Paul and Barnabas had had no little argument and discussion with them, the brothers made a decision to send Paul and Barnabas and certain others of them to the Apostles and the rulers of the church at Jerusalem about this question.  
γενομενης ουν στασεως και συζητησεως ουκ ολιγης τω παυλω και τω βαρναβα προς αυτους εταξαν αναβαινειν παυλον και βαρναβαν και τινας αλλους εξ αυτων προς τους αποστολους και πρεσβυτερο υς εις ιερουσαλημ περι του ζητηματος τουτου
- 3 Ata, pra, si u përcollën nga kisha, kaluan nëpër Feniki dhe Samari, duke treguar kthimin e johebrenjve dhe duke u sjellë gëzim të madh mbarë vëllezërve.  
So they, being sent on their way by the church, went through Phoenicia and Samaria, giving news of the salvation of the Gentiles, to the great joy of all the brothers.  
οι μεν ουν προπεμφθεντες υπο της εκκλησιας διηρχοντο την φοινικην και σαμαρειαν εκδιγουμενοι την επιστροφην των εθνων και εποιουν χαραν μεγαλην πασιν τοις αδελφοις
- 4 Kur arritën në Jeruzalem, u pritën nga kisha, nga apostujt dhe nga pleqtë dhe treguan për gjërat e mëdha që Perëndia kishte bërë me anën e tyre.  
And when they came to Jerusalem, they had a meeting with the church and the Apostles and the rulers, and they gave an account of all the things which God had done through them.  
παραγομενοι δε εις ιερουσαλημ απεδεχθησαν υπο της εκκλησιας και των αποστολων και των πρεσβυτερων ανηγγειλαν τε οσα ο θεος εποιησεν μετ αυτων
- 5 Por u ngritën disa nga sekti i farisenjve, që kishin besuar dhe thanë: "Duhet rrethprerë johebrenjtë dhe të urdhërohen të zbatojnë ligjin e Moisiut".  
But some of the Pharisees, who were of the faith, got up and said, It is necessary for these to have circumcision and to keep the law of Moses.  
εξανεστησαν δε τινες των απο της αιρεσεως των φαρισαιων πεπιστευκοτες λεγοντες οτι δει περιτεμνειν αυτους παραγγελλειν τε τηρειν τον νομον μουσεως
- 6 Atëherë apostujt dhe pleqtë u mblodhën për ta shqyrtuar këtë problem.  
And the Apostles and the rulers of the church came together and gave thought to the question.  
σνηχθησαν δε οι αποστολοι και οι πρεσβυτεροι ιδειν περι του λογου τουτου
- 7 Dhe duke qenë se lindi një diskutim i madh, Pjetri u çua në këmbë dhe u tha atyre: "Vëllezër, ju e dini se që në kohët e para Perëndia midis nesh më zgjodhi mua, që me anë të gojës sime johebrenjtë të dëgjojnë fjalën e ungjillit dhe të besojnë.  
And when there had been much discussion, Peter got up and said to them, My brothers, you have knowledge that some time back it was God's pleasure that by my mouth the good news might be given to the Gentiles so that they might have faith.  
πολλης δε συζητησεως γενομενης αναστας πετρος ειπεν προς αυτους ανδρες αδελφοι υμεις επιστασθε οτι αφ ημερων αρχαιων ο θεος εν ημιν εξελεξατο δια του στοματος μου ακουσαι τα εθνη τον λογον του ευαγγελιου και πιστευσαι
- 8 Perëndia, që i njeh zemrat, u ka dhënë atyre dëshmi, duke u dhënë Frymën e Shenjtë, sikurse edhe neve;  
And God, the searcher of hearts, was a witness to them, giving them the Holy Spirit even as he did to us;  
και ο καρδιογνωστης θεος εμαρτυρησεν αυτοις δους αυτοις το πνευμα το αγιον καθως και ημιν
- 9 dhe ai nuk bëri asnjë dallim midis nesh dhe atyre, duke i pastruar zemrat e tyre me anë të besimit.  
Making no division between them and us, but making clean their hearts by faith.  
και ουδεν διεκρινεν μεταξυ ημων τε και αυτων τη πιστει καθαρισας τας καρδιας αυτων
- 10 Tani, pra, pse e tundoni Perëndinë, duke u vënë mbi qafën e dishepujve një zgjedhë që as etërit tanë e as ne nuk mund ta mbajmë?  
Why then are you testing God, by putting on the neck of the disciples a yoke so hard that not even our fathers or we were strong enough for it?  
νυν ουν τι πειραζετε τον θεον επιθειναι ζυγον επι τον τραχηλον των μαθητων ον ουτε οι πατερες ημων ουτε ημεις ισχυσαμεν βαστασαι

- 11 Po ne besojmë se do të shpëtohem me anë të hirit të Zotit Jezu Krishtit, dhe në të njëjtën mënyrë edhe ata".  
But we have faith that we will get salvation through the grace of the Lord Jesus in the same way as they.  
αλλα δια της χαριτος κυριου ιησου χριστου πιστευομεν σωθηναι καθ ον τροπον κακεινοι
- 12 Atëherë e gjithë turma heshti, dhe rrinte e dëgjonte Barnabën dhe Palin, që tregonin ç'shenja e mrekulli kishte bërë Perëndia me anë të tyre ndër johebrenj.  
And all the people were quiet while Barnabas and Paul gave an account of the signs and wonders which God had done among the Gentiles by them.  
εσιγησεν δε παν το πληθος και ηκουον βαρναβα και παυλου εξηγουμενων οσα εποιησεν ο θεος σημεια και τερατα εν τοις εθνεσιν δι αυτων
- 13 Dhe si heshtën ata, Jakobi e mori fjalën dhe tha: "Vëllezër, më dëgjoni!  
And when they had come to an end, James, answering, said, My brothers, give ear to me:  
μετα δε το σιγησαι αυτους απεκριθη ιακωβος λεγων ανδρες αδελφοι ακουσατε μου
- 14 Simoni ka treguar si i ka vizituar për herë të parë Perëndia johebrenjtë, që të zgjedhë nga ata një popull për emrin e tij.  
Symeon has given an account of how God was first pleased to take from among the Gentiles a people for himself.  
συμεων εξηγησατο καθως πρωτον ο θεος επισκεψατο λαβειν εξ εθνων λαον επι τω ονοματι αυτου
- 15 Me këtë gjë pajtohen fjalët e profetëve, sikundër është shkruar:  
And this is in agreement with the words of the prophets, as it is said,  
και τουτω συμφωνουσιν οι λογοι των προφητων καθως γεγραπται
- 16 "Pas këtyre gjërave, unë do të kthehem dhe do ta rindërtoj tabernakullin e Davidit që është rrëzuar, do t'i restauroj gërmadhat e tij dhe do ta ngre përsëri më këmbë,  
After these things I will come back, and will put up the tent of David which has been broken down, building up again its broken parts and making it complete:  
μετα ταυτα αναστρεψω και ανοικοδομησω την σκηνην δαβιδ την πεπτωκυια και τα κατεσκαμμενα αυτης ανοικοδομησω και ανορθωσω αυτην
- 17 që mbetja e njerëzve dhe të gjitha johebrenjtë mbi të cilat thirret emri im, të kërkojnë Zotin, thotë Zoti që i bën të gjitha këto"  
So that the rest of men may make search for the Lord, and all the Gentiles on whom my name is named,  
οπως αν εκζητησωσιν οι καταλοιποι των ανθρωπων τον κυριον και παντα τα εθνη εφ ους επικεκληται το ονομα μου επ αυτους λεγει κυριος ο ποιων ταυτα παντα
- 18 Prej kohësh janë të njohura te Perëndia të gjitha veprat e tij.  
Says the Lord, who has made these things clear from the earliest times.  
γνωστα απ αιωνος εστιν τω θεω παντα τα εργα αυτου
- 19 Prandaj unë gjykoj që të mos i bezdisim ata nga johebrenjtë që kthehen te Perëndia,  
For this reason my decision is, that we do not put trouble in the way of those who from among the Gentiles are turned to God;  
διο εγω κρινω μη παρενοχλειν τοις απο των εθνων επιστρεφουσιν επι τον θεον
- 20 por t'u shkruhet atyre që të heqin dorë nga ndotjet e idhujve, nga kurvëria, nga gjërat e mbytura dhe nga gjaku.  
But that we give them orders to keep themselves from things offered to false gods, and from the evil desires of the body, and from the flesh of animals put to death in ways against the law, and from blood.  
αλλα επιστειλαι αυτοις του απεχεσθαι απο των αλισγηματων των ειδωλων και της πορνειας και του πνικτου και του αιματος
- 21 Sepse Moisiu që nga kohët e lashta ka njerëz të cilët në çdo qytet e predikojnë atë, duke qënë i lexuar çdo të shtunë në sinagoga".  
For Moses, from times long past, has his preachers in every town, reading his law in the Synagogues every Sabbath.  
μοσης γαρ εκ γενεων αρχαιων κατα πολιν τοις κηρυσσοντας αυτον εχει εν ταις συναγωγαις κατα παν σαββατον αναγινωσκομενος
- 22 Atëherë iu duk e mirë apostujve dhe pleqve me gjithë kishën të dërgojnë në Antioki, me Palin dhe Barnabën, disa njerëz të zgjedhur nga ata: Judën, mbiquajtur Barsaba, dhe Silën, njerëz me autoritet ndër vëllezërit,  
Then it seemed good to the Apostles and the rulers and all the church, to send men from among them to Antioch with Paul and Barnabas; Judas, named Barsabbas, and Silas, chief men among the brothers:  
τοτε εδοξεν τοις αποστολοις και τοις πρεσβυτεροις συν ολη τη εκκλησια εκλεξαμενους ανδρας εξ αυτων πεμψαι εις αντιοχειαν συν τω παυλω και βαρναβα ιουδαν τον επικαλουμενον βαρσαβαν και σιλαν ανδρας ηγουμενους εν τοις αδελφοις
- 23 me një letër të shkruar nga dora e tyre që thoshte: "Apostujt, pleqtë dhe vëllezërit, vëllezërve nga johebrenjtë që janë në Antioki, Siri dhe Kiliki, përshëndetje.  
And they sent a letter by them, saying, The Apostles and the older brothers, to the brothers who are of the Gentiles in Antioch and Syria and Cilicia, may joy be with you:  
γραψαντες δια χειρος αυτων ταδε οι αποστολοι και οι πρεσβυτεροι και οι αδελφοι τοις κατα την αντιοχειαν και συριαν και κιλικιαν αδελφοις τοις εξ εθνων χαιρειν

- 24 Duke qenë se morëm vesh se disa që erdhën prej nesh, por të cilëve ne nuk u kishim dhënë asnjë porosi, ju kanë shqetësuar me fjalë duke trazuar shpirtat tuaj, duke thënë se ju duhet të rrethpiteni dhe të zbatoni ligjin,  
Because we have knowledge that some who went from us have been troubling you with their words, putting your souls in doubt; to whom we gave no such order;  
επειδη ηκουσαμεν οτι τινες εξ ημων εξελθοντες εταραξαν μας λογοις ανασκευαζοντες τας ψυχας υμων λεγοντες περιτεμεσθαι και τηρειν τον νομον ος ου διεστειλαμεθα
- 25 na u duk e mirë neve, të mbledhur tok me një zemër, të zgjedhim disa njerëz dhe t'i dërgojmë bashkë me të dashurit tanë Barnaba dhe Pal,  
It seemed good to us, having come to an agreement together, to send these men to you, with our well loved Barnabas and Paul,  
εδοξεν ημιν γενομενοις ομοθυμαδον εκλεξαμενους ανδρας πεμψαι προς υμας συν τοις αγαπητοις ημων βαρναβα και παυλω
- 26 njerëz që kanë përkushtuar jetën e tyre për emrin e Zotit tonë Jezu Krishtit.  
Men who have given up their lives for the name of our Lord Jesus Christ.  
ανθρωποις παραδεδοκοσιν τας ψυχας αυτων υπερ του ονοματος του κυριου ημων ιησου χριστου
- 27 Kemi dërguar, pra, Judën dhe Silën; edhe ata do t'ju tregojnë me gojë të njëjtat gjëra.  
And so we have sent Judas and Silas, who will say the same things to you themselves, by word of mouth.  
απεσταλαμεν ουν ιουδαν και σιλαν και αυτους δια λογου απαγγελοντας τα αυτα
- 28 Në fakt na u duk mirë Frymës së Shenjtë dhe neve që të mos ju ngarkojmë asnjë barrë tjetër përveç këtyre gjërave të nevojshme:  
For it seemed good to the Holy Spirit and to us, to put on you nothing more than these necessary things;  
εδοξεν γαρ τω αγιω πνευματι και ημιν μηδεν πλεον επιτιθεσθαι υμιν βαρος πλην των επαναγκες τουτων
- 29 që ju të hiqni dorë nga gjërat e flijjuara idhujve, nga gjaku, nga gjërat e mbytura dhe nga kurvëria; do të bëni mirë të ruheni nga këto. Qofshi mirë".  
To keep from things offered to false gods, and from blood, and from things put to death in ways which are against the law, and from the evil desires of the body; if you keep yourselves from these, you will do well. May you be happy.  
απεχεσθαι ειδωλοθυτων και αιματος και πνικτου και πορνειας εξ ων διατηρουντες εαυτους ευ πραξετε ερρωσθε
- 30 Ata, pra, mbasi u ndanë, zbritën në Antiokia dhe, si mbledhën kuvendin, e dorëzuan letrën.  
So they, being sent away, came down to Antioch, and having got the people together, they gave them the letter.  
οι μεν ουν απολυθεντες ηλθον εις αντιοχειαν και συναγαγοντες το πληθος επεδωκαν την επιστολην
- 31 Dhe ata, mbasi e lexuan, u gëzuan për ngushëllimin.  
And after reading it, they were glad of its comfort.  
αναγνοντες δε εχαρησαν επι τη παρακλησει
- 32 Dhe Juda e Sila, që ishin edhe ata profetë, me shumë fjalë i nxitën vëllezërit dhe i forcuan.  
And Judas and Silas, who themselves were prophets, gave teaching to the brothers and made them strong in the faith.  
ιουδας τε και σιλας και αυτοι προφηται οντες δια λογου πολλου παρεκαλεσαν τους αδελφους και επεστηριξαν
- 33 Mbasi ndenjën atje ca kohë, u dërguan prapë me paqtim nga vëllezërit tek apostujt.  
And when they had been there for some time, they were sent back in peace by the brothers to those who had sent them.  
ποιησαντες δε χρονον απελυθησαν μετ ειρηνης απο των αδελφων προς τους αποστολους
- 34 Por Silës iu duk mirë të mbetej aty.  
[]  
εδοξεν δε τω σιλα επιμειναι αυτου
- 35 Edhe Pali e Barnaba qëndruan në Antioki, duke mësuar dhe duke shpallur me shumë të tjerë fjalën e Zotit.  
But Paul and Barnabas kept on in Antioch, teaching and preaching the word of God, with a number of others.  
παυλος δε και βαρναβας διετριβον εν αντιοχεια διδασκοντες και ευαγγελιζομενοι μετα και ετερων πολλων τον λογον του κυριου
- 36 Pas disa ditësh Pali i tha Barnabës: "Le të kthehemi të shohim vëllezërit tanë në çdo qytet, ku kemi shpallur fjalën e Perëndisë, për të parë si janë".  
And after some days, Paul said to Barnabas, Let us go back and see the brothers in every town where we have given the word of God, and see how they are.  
μετα δε τινας ημερας ειπεν παυλος προς βαρναβαν επιστρεψαντες δη επισκεψομεθα τους αδελφους ημων κατα πασαν πολιν εν αις κατηγγειλαμεν τον λογον του κυριου πως εχουσιν

- 37 Dhe Barnaba donte të merrte me vete Gjonin, të quajtur Mark.  
And Barnabas had a desire to take with them John, named Mark.  
βαρναβας δε εβουλευσατο συμπαραλαβειν τον ιωαννην τον καλουμενον μαρκον
- 38 Por Pali mendonte se nuk duhej marrë me vete atë që ishte ndarë prej tyre në Pamfili, dhe nuk kishte shkuar me ata në punë.  
But Paul was of the opinion that it was not right to take with them one who had gone away from them in Pamphylia, and had not gone on with the work.  
παυλος δε ηξιου τον αποσταντα απ αυτων απο παμφυλιας και μη συνελθοντα αυτοις εις το εργον μη συμπαραλαβειν τουτον
- 39 Atëherë lindi një grindje saqë ata u ndanë njëri nga tjetri; pastaj Barnaba, mbasi mori Markun, lundroi për në Qipro.  
And there was a sharp argument between them, so that they were parted from one another, and Barnabas took Mark with him and went by ship to Cyprus;  
εγενετο ουν παροξυσμος ωστε αποχωρισθηναι αυτοις απ αλληλων τον τε βαρναβαν παραλαβοντα τον μαρκον εκπλευσαι εις κυπρον
- 40 Por Pali zgjodhi Silën dhe u nis, pasi vëllezërit e lanë në hir të Perëndisë.  
But Paul took Silas and went away with the blessing of the brothers.  
παυλος δε επιλεξαμενος σιλαν εξηλθεν παραδοθεις τη χαριτι του θεου υπο των αδελφων
- 41 Dhe përshkoi Sirinë dhe Kilikinë, duke i forcuar kishat.  
And he went through Syria and Cilicia, making the churches stronger in the faith.  
δηρχετο δε την συριαν και κιλικιαν επιστηριζων τας εκκλησιας
- 1 Dhe ai arriti në Derbë dhe në Listra; këtu ishte një dishepull me emër Timote, biri i një gruaje judease besimtare, por me baba grek,  
And he came to Derbe and Lystra: and there was a certain disciple there named Timothy, whose mother was one of the Jews of the faith, but his father was a Greek;  
κατηντησεν δε εις δερβην και λυστραν και ιδου μαθητης τις ην εκει ονοματι τιμοθεος υιος γυναικος τινος ιουδαιας πιστης πατρος δε ελληνος
- 2 për të cilin jepnin dëshmi të mirë vëllezërit e Listrës dhe të Ikonit.  
Of whom the brothers at Lystra and Iconium had a high opinion.  
ος εμαρτυρειτο υπο των εν λυστροις και ικονιω αδελφων
- 3 Pali deshi që të dilte me të; kështu e mori, e rrethpreu për shkak të Judenjve që ishin në ato vende, sepse të gjithë e dinin se babai i tij ishte grek.  
Paul had a desire for him to go with him, and he gave him circumcision because of the Jews who were in those parts: for they all had knowledge that his father was a Greek.  
τουτον ηθελησεν ο παυλος συν αυτω εξελθειν και λαβων περιετεμεν αυτον δια τους ιουδαιους τους οντας εν τοις τοποις εκεινοις ηδειςαν γαρ απαντες τον πατερα αυτου οτι ελλην υπηρχεν
- 4 Dhe, duke kaluar nëpër qytete, i urdhëronin ata të zbatojnë vendimet që ishin marrë nga apostujt dhe nga pleqtë në Jeruzalem.  
And on their way through the towns, they gave them the rules which had been made by the Apostles and the rulers of the church at Jerusalem, so that they might keep them.  
ως δε διεπορευοντο τας πολεις παρεδιδουν αυτοις φυλασσειν τα δογματα τα κεκριμενα υπο των αποστολων και των πρεσβυτερων των εν ιερουσαλημ
- 5 Kishat, pra, po forcoheshin në besim dhe rriteshin në numër përditë.  
So the churches were made strong in the faith and were increased in number every day.  
αι μεν ουν εκκλησιαι εστερεουντο τη πιστει και επερισσεουν τω αριθμω καθ ημεραν
- 6 Kur ata po kalonin nëpër Frigji dhe në krahinën e Galatisë, u penguan nga Fryma e Shenjtë që të shpallin fjalën në Azi.  
And after they had gone through the land of Phrygia and Galatia, the Holy Spirit did not let them take the word into Asia;  
διελθοντες δε την φρυγιαν και την γαλατικην χωραν κολουθεντες υπο του αγιου πνευματος λαλησαι τον λογον εν τη ασια
- 7 Si arritën në kufijtë e Misisë, ata kërkuan të shkojnë në Bitini, por Fryma nuk i lejoi.  
And having come to Mysia, they made an attempt to go into Bithynia, but the Spirit of Jesus did not let them;  
ελθοντες κατα την μυσιαν επειραζον κατα την βιθυνιαν πορευεσθαι και ουκ ειασεν αυτοις το πνευμα
- 8 Kështu, pasi e përshkuan Misinë, zbritën në Troas.  
And going past Mysia, they came down to Troas.  
παρελθοντες δε την μυσιαν κατεβησαν εις τρωαδα
- 9 Gjatë natës Palit iu shfaq një vegim. I rrinte para një burrë Maqedonas, që i lutej dhe i thoshte: "Kalo në Maqedoni dhe na ndihmo".  
And Paul had a vision in the night; a man of Macedonia came, requesting him, and saying, Come over into Macedonia and give us help.  
και οραμα δια της νυκτος ωφθη τω παυλω ανηρ τις ην μακεδων εστως παρακαλων αυτον και λεγων διαβας εις μακεδονιαν βοηθησον ημιν

- 10 Mbasi e pa vegimin, kërkuam menjëherë të shkojmë në Maqedoni, të bindur se Zoti na kishte thirrur që t'ua shpallim atyre ungjillin.  
And when he had seen the vision, straight away we made the decision to go into Macedonia, for it seemed certain to us that God had sent us to give the good news to them.  
ως δε το οραμα ειδεν ευθεως εξητησαμεν εξελθειν εις την μακεδονιαν συμβιβαζοντες οτι προσκεκληται ημας ο κυριος ευαγγελισασθαι αυτους
- 11 Prandaj, duke lundruar nga Troasi, u drejtuar për në Samotrakë, dhe të nesërmen në Neapolis,  
So, from Troas we went straight by ship to Samothrace and the day after to Neapolis;  
αναχθεντες ουν απο της τρωαδος ευυδρομησαμεν εις σαμοθρακην τη τε επιουση εις νεαπολιν
- 12 dhe prej andej në Filipi, që është qyteti i parë i asaj ane të Maqedonisë dhe koloni romake; dhe qëndruam disa ditë në atë qytet.  
And from there to Philippi, which is the most important town of Macedonia and a Roman colony: and we were there for some days.  
εκειθεν τε εις φιλιππους ητις εστιν πρωτη της μεριδος της μακεδονιας πολις κολωνια ημεν δε εν ταυτη τη πολει διατριβοντες ημερας τινας
- 13 Ditën e së shtunës dolëm jashtë qytetit anës lumit, ku ishte vendi i zakonshëm për lutje; dhe, si u ulëm, u flisim grave që ishin mbledhur atje.  
And on the Sabbath we went outside the town, by the river, where we had an idea that there would be a place of prayer; and, being seated, we had talk with the women who had come together.  
τη τε ημερα των σαββατων εξηλθομεν εξω της πολεως παρα ποταμον ου νομιζετο προσευχη ειναι και καθισαντες ελαουμεν ταις συνελθουσαις γυναξιν
- 14 Dhe një grua, me emër Lidia, që ishte tregtare të purpurtash, nga qyteti i Tiatirës dhe që e adhuronte Perëndinë, po dëgjonte. Dhe Zoti ia hapi zemrën për të dëgjuar gjërat që thoshte Pali.  
And a certain woman named Lydia, a trader in purple cloth of the town of Thyatira, and a God-fearing woman, gave ear to us: whose heart the Lord made open to give attention to the things which Paul was saying.  
και τις γυνη ονοματι λυδια πορφυροπολις πολεως θυατειρων σεβομενη τον θεον ηκουεν ης ο κυριος διηνοιζεν την καρδιαν προσεχειν τοις λαουμενοις υπο του παυλου
- 15 Pasi ajo u pagëzua me familjen e saj, na u lut duke thënë: "Në qoftë se më keni gjykuar se jam besnike ndaj Zotit, hyni në shtëpinë time dhe rrini". Dhe na detyroi të pranojmë.  
And when she and her family had had baptism, she made a request to us, saying, If it seems to you that I am true to the Lord, come into my house and be my guests. And she made us come.  
ως δε εβαπτισθη και ο οικος αυτης παρεκαλεσεν λεγουσα ει κεκρικατε με πιστην τω κυριω ειναι εισελθοντες εις τον οικον μου μεινατε και παρεβιασατο ημας
- 16 Dhe, kur po shkonim për lutje, na doli para një skllave e re që kishte një frymë falli, e cila, duke u treguar fatin njerëzve, u sillte shumë fitime zotërinjve të saj.  
And when we were going to the place of prayer, we came across a girl with a spirit which gave knowledge of the future, whose masters made great profit from her power.  
εγενετο δε πορευομενων ημων εις προσευχην παιδικην τινα εχουσαν πνευμα πυθωνος απαντησαι ημιν ητις εργασιαν πολλην παρειχεν τοις κυριοις αυτης μαντευομενη
- 17 Ajo u vu të ndjekë Palin dhe ne, dhe bërtiste duke thënë: "Këta njerëz janë shërbëtorë të Perëndisë Shumë të Lartë dhe ju shpallën udhën e shpëtimit".  
She came after Paul and us, crying out and saying, These men are the servants of the Most High God, who are giving you news of the way of salvation.  
αυτη κατακολουθησασα τω παυλω και ημιν εκραζεν λεγουσα ουτοι οι ανθρωποι δουλοι του θεου του υψιστου εισιν οιτινες καταγγελλουσιν ημιν οδον σωτηριας
- 18 Dhe ajo e bëri këtë shumë ditë me radhë, por Pali, i mërzitur, u kthye dhe i tha frymës: "Unë të urdhëroj në emër të Jezu Krishtit të dalësh prej saj". Dhe fryma doli që në atë çast.  
And this she did on a number of days. But Paul was greatly troubled and, turning, said to the spirit, I give you orders in the name of Jesus Christ, to come out of her. And it came out that very hour.  
τουτο δε εποιει επι πολλας ημερας διαπονηθεις δε ο παυλος και επιστρεψας τω πνευματι ειπεν παραγγελλω σοι εν τω ονοματι ιησου χριστου εξελθειν απ αυτης και εξηλθεν αυτη τη ωρα
- 19 Por zotërinjtë e saj, kur panë se u humbi shpresa e fitimit të tyre, i kapën Palin dhe Silën dhe i tërhoqën te sheshi i tregut përpara arkondëve;  
But when her masters saw that their hope of profit was gone, they took Paul and Silas, pulling them into the market-place before the rulers;  
ιδοντες δε οι κυριοι αυτης οτι εξηλθεν η ελπις της εργασιας αυτων επιλαβομενοι τον παυλον και τον σιλαν ειλικυσαν εις την αγοραν επι τους αρχοντας
- 20 dhe si ua paraqitën pretorët, thanë: "Këta njerëz, që janë Judenj, e turbullojnë qytetin tonë,  
And when they had taken them before the authorities, they said, These men, who are Jews, are greatly troubling our town;  
και προσαγαγοντες αυτους τοις στρατηγοις ειπον ουτοι οι ανθρωποι εκταρασσουν ημων την πολιν ιουδαιοι υπαρχοντες
- 21 dhe predikojnë zakone që për ne, që jemi Romakë, nuk është e ligjshme t'i pranojmë dhe t'i zbatojmë".  
Teaching rules of living which it is not right for us to have or to keep, being Romans.  
και καταγγελλουσιν εθη α ουκ εξεστιν ημιν παραδεχεσθαι ουδε ποιειν ρωμαιοις ουσιν
- 22 Atëherë turma u lëshua e gjitha bashkë kundër tyre: dhe pretorëve, ua grisën atyre rrobat dhe urdhëruan t'i rrahin me kamxhik.  
And the people made an attack on them all together: and the authorities took their clothing off them, and gave orders for them to be whipped.  
και συνεπεστη ο οχλος κατ αυτων και οι στρατηγοι περιρρηξαντες αυτων τα ιματια εκελευον ραβδιζειν
- 23 Dhe si i rrahën me shumë goditje, i futën në burg duke urdhëruar rojtarin e burgut t'i ruajë me kujdes.  
And when they had given them a great number of blows, they put them in prison, giving orders to the keeper of the prison to keep them safely:  
πολλας τε επιθεντες αυτοις πληγας εβαλον εις φυλακην παραγγειλαντες τω δεσμοφυλακι ασφαλως τηρειν αυτους

- 24** Ky, si mori një urdhër të tillë, i futi në pjesën më të brendshme të burgut dhe ua shtrëngoi këmbët në dru.  
*And he, having such orders, put them into the inner prison with chains on their feet.*  
 os παραγγελιαν τοιαυτην ειληφως εβαλεν αυτους εις την εσωτερην φυλακην και τους ποδας αυτων ησφαλισατο εις το ξυλον
- 25** Aty nga mesnata Pali dhe Sila po luteshin dhe i këndonin himne Perëndisë; dhe të burgosurit i dëgjonin.  
*But about the middle of the night, Paul and Silas were making prayers and songs to God in the hearing of the prisoners;*  
 κατα δε το μεσονυκτιον παυλος και σιλας προσευχομενοι υμνουν τον θεον επηκροωντο δε αυτων οι δεσμοιοι
- 26** Befas u bë një tërmet i madh, sa që u tundën themelet e burgut; dhe në atë çast u hapën të gjitha dyert dhe të gjithëve iu zgjidhën prangat.  
*And suddenly there was an earth-shock, so that the base of the prison was moved: and all the doors came open, and everyone's chains came off.*  
 αφω δε σεισμος εγενετο μεγας ωστε σαλευθηναι τα θεμελια του δεσμοτηριου ανεωχθησαν τε παραχημα αι θυραι πασαι και παντων τα δεσμα ανεθη
- 27** Rojtari i burgut, kur u zgjua dhe pa dyert e burgut të hapura, nxori shpatën dhe donte të vriste veten, duke menduar se të burgosurit kishin ikur.  
*And the keeper, coming out of his sleep, and seeing the prison doors open, took his sword and was about to put himself to death, fearing that the prisoners had got away.*  
 εξυπνος δε γενομενος ο δεσμοφυλαξ και ιδων ανεωγμενας τας θυρας της φυλακης σπασαμενος μαχαιραν εμελλεν εαυτον αναρειν νομιζων εκπεφευγεναι τους δεσμοιοις
- 28** Por Pali thirri me zë të lartë: "Mos i bëj ndonjë të keqe vetes, sepse ne të gjithë jemi këtu".  
*But Paul said in a loud voice, Do yourself no damage, for we are all here.*  
 εφωνησεν δε φωνη μεγαλη ο παυλος λεγων μηδεν πραξης σεαυτω κακον απαντες γαρ εσμεν ενθαδε
- 29** Atëherë ai kërkoi një dritë, u turr brenda dhe duke u dridhur i tëri u ra ndër këmbë Palit dhe Silës;  
*And he sent for lights and came rushing in and, shaking with fear, went down on his face before Paul and Silas,*  
 αιτησας δε φωτα εισεπηδησεν και εντρομος γενομενος προσεπεσεν τω παυλω και τω σιλα
- 30** pastaj i nxori jashtë dhe tha: "Zotërinj, ç'duhet të bëj unë që të shpëtohem?".  
*And took them out and said, Sirs, what have I to do to get salvation?*  
 και προαγαγων αυτους εξω εφη κυριοι τι με δει ποιειν ινα σωθω
- 31** Dhe ata i thanë: "Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote".  
*And they said, Have faith in the Lord Jesus, and you and your family will have salvation.*  
 οι δε ειπον πιστευσον επι τον κυριον ιησουν χριστον και σωθηση συ και ο οικος σου
- 32** Pastaj ata i shpallën fjalën e Zotit atij dhe gjithë atyre që ishin në shtëpinë e tij.  
*And they gave the word of the Lord to him and to all who were in his house.*  
 και ελαλησαν αυτω τον λογον του κυριου και πασιν τοις εν τη οικια αυτου
- 33** Dhe ai i mori që në atë orë të natës dhe ua lau plagët. Dhe ai dhe të gjithë të tijtë u pagëzuan menjëherë.  
*And that same hour of the night, he took them, and when he had given attention to their wounds, he and all his family had baptism straight away.*  
 και παραλαβων αυτους εν εκεινη τη ωρα της νυκτος ελουσεν απο των πληγων και εβαπτισθη αυτος και οι αυτου παντες παραχημα
- 34** Mbasi i çoi në shtëpinë e vet, ua shtroi tryezën dhe u gëzua me gjithë familjen e tij që kishte besuar në Perëndinë.  
*And he took them into his house and gave them food, and he was full of joy, having faith in God with all his family.*  
 αναγαγων τε αυτους εις τον οικον αυτου παρεθηκεν τραπεζαν και ηγαλλιασατο πανοικι πεπιστευκος τω θεω
- 35** Kur u gdhi, pretorët dërguan liktorët t'i thonë rojtarit të burgut: "Lëri të lirë ata njerëz".  
*But when it was day, the authorities sent the police, saying, Let these men go.*  
 ημερας δε γενομενης απεστειλαν οι στρατηγοι τους ραβδουχοις λεγοντες απολυσον τους ανθρωπους εκεινοιοις
- 36** Dhe rojtari i burgut i tregoi Palit këto fjalë: "Pretorët kanë dërguar fjalë që të lirohemi; dilni, pra, dhe shkoni në paqe".  
*And the keeper said to Paul, The authorities have given orders to let you go: come out now, and go in peace.*  
 απηγγειλεν δε ο δεσμοφυλαξ τους λογοιοις τουτους προς τον παυλον οτι απεσταλκασι οι στρατηγοι ινα απολυθητε νυν ουν εξελθοντες πορευεσθε εν ειρηνη



- 37 Por Pali u tha atyre: "Mbasi na kanë rrahur botërisht pa qenë të dënuar në gjyq, ne që jemi qytetarë romakë, na futën në burg dhe tani na nxjerrin fshehtas? Jo, kurrësi! Le të vijnë vetë ata të na nxjerrin jashtë".  
But Paul said to them, They have given us who are Romans a public whipping without judging us, and have put us in prison. Will they now send us out secretly? no, truly, let them come themselves and take us out.  
ο δε παυλος εφη προς αυτους δειραντες ημας δημοσια ακατακριτους ανθρωπους ρωμαιους υπαρχοντας εβαλον εις φυλακην και νυν λαθρα ημας εκβαλλουσιν ου γαρ αλλα ελθοντες αυτοι ημας εξαγαγε τωσαν
- 38 Liktorët ua tregon këto fjalë pretorëve; dhe ata, kur dëgjuan se ishin qytetarë romakë, u frikësuan.  
And the police gave an account of these words to the authorities, and they were full of fear on hearing that they were Romans;  
ανηγγιλαν δε τοις στρατηγοις οι ραβδουχοι τα ρηματα ταυτα και εφοβηθησαν ακουσαντες οτι ρωμαιοι εισιν
- 39 Atëherë erdhën dhe iu lutën atyre, dhe si i nxorën, iu lutën që të largohen nga qyteti.  
Then they came and made prayers to them, requesting them, when they had taken them out, to go away from the town.  
και ελθοντες παρεκαλεσαν αυτους και εξαγαγοντες ηρωτων εξελθειν της πολεως
- 40 Atëherë ata, si dolën nga burgu, hynë në shtëpinë e Lidias dhe, kur panë vëllezërit, i ngushëlluan; dhe ikën.  
And they came out of the prison and went to the house of Lydia: and when they had seen the brothers they gave them comfort and went away.  
εξελθοντες δε εκ της φυλακης εισηλθον εις την λυδιαν και ιδοντες τους αδελφους παρεκαλεσαν αυτους και εξηλθον
- 1 Dhe mbasi kishin kaluar nëpër Amfipoli dhe nëpër Apoloni, arritën në Thesaloniki, ku ishte sinagoga e Judenjve.  
Now when they had gone through Amphipolis and Apollonia they came to Thessalonica, where there was a Synagogue of the Jews:  
διοδευσαντες δε την αμφιπολιν και απολλωνιαν ηλθον εις θεσσαλονικην οπου ην η συναγωγη των ιουδαιων
- 2 Dhe Pali, sipas zakonit të vet, hyri tek ata dhe tri të shtuna me radhë u paraqiti argumente nga Shkrimet,  
And Paul, as he generally did, went in to them, and on three Sabbath days had discussions with them from the holy Writings,  
κατα δε το ειωθος τω παυλω εισηλθεν προς αυτους και επι σαββατα τρια διελεγετο αυτοις απο των γραφων
- 3 duke deklaruar dhe duke treguar atyre se Krishti duhej të vuante dhe të ringjallej prej së vdekurish dhe duke thënë: "Ky Jezusi që unë ju shpall është Krishti".  
Saying to them clearly and openly that Christ had to be put to death and come back to life again; and that this Jesus, whom, he said, I am preaching to you, is the Christ.  
διανοιγων και παρατιθεμενος οτι τον χριστον εδει παθειν και αναστηναι εκ νεκρων και οτι ουτος εστιν ο χριστος ιησους ον εγω καταγγελλω υμιν
- 4 Disa nga ata besuan dhe u bashkuan me Palin dhe Silën, si dhe një numër i madh Grekësh të përshpirtshëm dhe jo pak gra të rëndësishme.  
And some of them had faith, and were joined to Paul and Silas; and a number of the God-fearing Greeks, and some of the chief women.  
και τινες εξ αυτων επεισησαν και προσεκληρωθησαν τω παυλω και τω σιλα των τε σεβομενων ελληνων πολυ πληθος γυναικων τε των πρωτων ουκ ολιγαι
- 5 Por Judenjtë, të cilët nuk kishin besuar, patën smirë dhe morën me vete disa njerëz të këqij nga ata të rrugëve të tregut dhe, si mbledhën një turmë, e bënë rrëmujë qytetin; edhe sulmuan shtëpinë e Jasonit dhe kërkonin ata për t'i nxjerrë përpara popullit.  
But the Jews, being moved with envy, took with them certain low persons from among the common people, and getting together a great number of people, made an outcry in the town, attacking the house of Jason with the purpose of taking them out to the people.  
ζηλωσαντες δε οι απειθουντες ιουδαιοι και προσελαβομενοι των αγοραιων τινας ανδρας πονηρους και οχλοποιησαντες εθορυβουν την πολιν επισταντες τε τη οικια ιασονος εζητουν αυτους αγαγειν εις τον δημον
- 6 Por, mbasi nuk i gjetën, e hoqën zvarrë Jasonin dhe disa vëllezër përpara krerëve të qytetit, duke thirrur: "Ata që e kanë bërë rrëmujë botën, kanë ardhur edhe këtu,  
And when they were not able to get them, they took Jason and some of the brothers by force before the rulers of the town, crying, These men, who have made trouble all over the world have now come here;  
μη ευροντες δε αυτους εσυρον τον ιασονα και τινας αδελφους επι τους πολιταρχας βοωντες οτι οι την οικουμενην αναστατωσαντες ουτοι και ενθαδε παρεισιν
- 7 dhe Jasoni këta i priti; të gjithë këta veprojnë kundër statuteve të Cezarit, duke thënë se është një mbret tjetër, Jezusi".  
Whom Jason has taken into his house: and they are acting against the orders of Caesar, saying that there is another king, Jesus.  
ους υποδεδεκται ιασων και ουτοι παντες απεναντι των δογματων καισαρος πραττουσιν βασιλεια λεγοντες ετερον ειναι ιησουν
- 8 Edhe nxitën popullin dhe krerët e qytetit, që i dëgjonin këto gjëra.  
And hearing these things the people and the rulers of the town were troubled.  
εταραξαν δε τον οχλον και τους πολιταρχας ακουοντας ταυτα

- 9 Por ata, mbasi morën një dorëzani nga Jasoni dhe nga të tjerët, i lejuan të shkojnë.  
*And having made Jason and the others give an undertaking to keep the peace, they let them go.*  
- 35 Dhe në çdo gjë ju kam treguar se, duke u munduar në këtë mënyrë, duhet të ndihmohen të lëngatët dhe të kujtohen fjalët e Zotit Jezus, i cili tha: &quot;Ka më shumë lumturi të japësh sesa të marrësh!&quot;".  
In all things I was an example to you of how, in your lives, you are to give help to the feeble, and keep in memory the words of the Lord Jesus, how he himself said, There is a greater blessing in giving than in getting.  
παντα υπεδειξα υμιν οτι ουτως κοπιωντας δει αντιλαμβανεσθαι των ασθενουντων μνημονευειν τε των λογων του κυριου ιησου οτι αυτος ειπεν μακαριον εστιν διδοναι μαλλον η λαμβανειν
- 36 Dhe, si kishte thënë këto gjëra, u ul mbi gjunjë dhe u lut me ata të gjithë.  
And having said these words, he went down on his knees in prayer with them all.  
και ταυτα ειπων θεις τα γονατα αυτου συν πασιν αυτοις προσηξατο
- 37 Atëherë të gjithë qanë me të madhe, e rroknin në qafë Palin dhe e puthnin,  
And they were all weeping, falling on Paul's neck and kissing him,  
ικανος δε εγενετο κλαυθμος παντων και επιπεσοντες επι τον τραχηλον του παυλου καταφιλουν αυτον
- 38 të hidhëruar sidomos për fjalën që kishte thënë, se nuk do ta shihnin më fytyrën e tij. Pastaj e përcollën në anije.  
Being sad most of all because he had said that they would not see his face again. And so they went with him to the ship.  
οδυνουμενοι μαλιστα επι τω λογω ω ειρηκει οτι ουκετι μελλουσιν το προσωπον αυτου θεωρειν προπεμπον δε αυτον εις το πλοιον
- 1 Mbasi u ndamë nga ta, lundruam dhe, duke shkuar drejt, arritëm në Koos, ditën tjetër në Rodos dhe që andej në Patara.  
And after parting from them, we put out to sea and came straight to Cos, and the day after to Rhodes, and from there to Patara:  
ως δε εγενετο αναχθηναι ημας αποσπασθεντας απ αυτων ευθυδρομησαντες ηλθομεν εις την κων τη δε εξης εις την ροδον κακειθεν εις παταρα
- 2 Edhe, si gjetëm një anije që shkonte për Feniki, hipëm dhe lundruam.  
And as there was a ship going to Phoenicia, we went in it.  
και ευροντες πλοιον διαπερων εις φοινικην επιβαντες ανηχθημεν
- 3 Pamë nga larg Qipron dhe e lamë në të majtë, vazhduam lundrimin për në Siri dhe dolëm në Tiro, sepse atje anija kishte për të shkarkuar.  
And when we had come in view of Cyprus, going past it on our left, we went on to Syria, and came to land at Tyre: for there the goods which were in the ship had to be taken out.  
αναφαναντες δε την κυπρον και καταλιποντες αυτην ευωνυμον επλεομεν εις συριαν και κατιχθημεν εις τυρον εκεισε γαρ ην το πλοιον αποφορτιζομενον τον γομον
- 4 Dhe, si i gjetëm dishepujt, qëndruam atje shtatë ditë; të shtyrë nga Fryma, ata i thoshin Palit të mos ngjitej në Jeruzalem.  
And meeting the disciples we were there for seven days: and they gave Paul orders through the Spirit not to go up to Jerusalem.  
και ανευροντες τους μαθητας επεμειναμεν αυτου ημερας επτα οιτινες τω παυλω ελεγον δια του πνευματος μη αναβαινειν εις ιερουσαλημ
- 5 Kur i plotësua ato ditë, u nisëm dhe shkuam; dhe na përcollën të gjithë, me gra e me fëmijë, deri jashtë qytetit; dhe si u ulëm në gjunjë në breg, u lutëm.  
And when these days came to an end, we went on our journey; and they all, with their wives and children, came with us on our way till we were out of the town: and after going on our knees in prayer by the sea,  
οτε δε εγενετο ημας εξαρτισαι τας ημερας εξελθοντες επορευομεθα προπεμποντων ημας παντων συν γουναξιν και τεκνοις εως εξω της πολεως και θεντες τα γονατα επι τον αιγιαλον προσηξαμεθα
- 6 Dhe, mbasi u përsëndetëm, hipëm në anije, kurse ata u kthyen në shtëpitë e veta.  
We said our last words to one another, and got into the ship, and they went back to their houses.  
και ασπασαμενοι αλληλους επεβημεν εις το πλοιον εκεινοι δε υπεστρεψαν εις τα ιδια
- 7 Kur mbaruam lundrimin, nga Tiro erdhëm në Ptolemaidë dhe, si përsëndetëm vëllezërit, kaluam një ditë me ta.  
And journeying by ship from Tyre we came to Ptolemais; and there we had talk with the brothers and were with them for one day.  
ημεις δε τον πλουν διανυσαντες απο τυρου κατηνησαμεν εις πτολεμαιδα και ασπασαμενοι τους αδελφους εμειναμεν ημεραν μιαν παρ αυτοις
- 8 Të nesërmen u nisëm (ne që ishim shokë me Palin), arritëm në Cezare dhe hymë në shtëpinë e Filip ungjilltarit, që ishte një nga të shtatët, dhe ndenjëm tek ai.  
And on the day after, we went away and came to Caesarea, where we were guests in the house of Philip, the preacher, who was one of the seven.  
τη δε επαυριον εξελθοντες οι περι τον παυλον ηλθον εις καισαρειαν και εισελθοντες εις τον οικον φιλιπου του ευαγγελιστου του οντος εκ των επτα εμειναμεν παρ αυτο
- 9 Por ai kishte katër bija virgjëresha, që profetizonin.  
And he had four daughters, virgins, who were prophets.  
τουτω δε ησαν θυγατρες παρθενοι τεσσαρες προφητεουσαι

- 10 Dhe, pasi qëndruam ne atje shumë ditë, zbriti nga Judeja një farë profeti me emër Agabo.  
*And while we were waiting there for some days, a certain prophet, named Agabus, came down from Judaea.*  
*επιμενοντων δε ημων ημερας πλειους κατηλθεν τις απο της ιουδαιας προφητης ονοματι αγαβος*
- 11 Si erdhi te ne, ai mori brezin e Palit, lidhi duart dhe këmbët e veta dhe tha: "Këtë thotë Fryma e Shenjtë: Kështu do ta lidhin Judenjët në Jeruzalem burrin, të cilit i përket ky brez dhe do t'a dorëzojnë johebrenjëve".  
*And he came to us, and took the band of Paul's clothing, and putting it round his feet and hands, said, The Holy Spirit says these words, So will the Jews do to the man who is the owner of this band, and they will give him up into the hands of the Gentiles.*  
*και ελθων προς ημας και αρας την ζωνην του παυλου δησας τε αυτου τας χειρας και τους ποδας ειπεν ταδε λεγει το πνευμα το αγιον τον ανδρα ου εστιν η ζωνη αυτη ουτως δησουσιν εν ιερουσαλημ οι ιουδαιοι και παραδωσουσιν εις χειρας εθνων*
- 12 Kur i dëgjuam këto gjëra, ne dhe vendësit iu lutëm që të mos ngjitej në Jeruzalem.  
*And hearing these things, we and those who were living in that place made request to him not to go to Jerusalem.*  
*ως δε ηκουσαμεν ταυτα παρεκαλουμεν ημεις τε και οι εντοπιοι του μη αναβαινειν αυτον εις ιερουσαλημ*
- 13 Por Pali u përgjigj: "Ç'po bëni ju, duke qarë e duke ma copëtuar zemrën? Sepse unë jam gati jo vetëm për të qenë i lidhur, por edhe për të vdekur në Jeruzalem për emrin e Zotit Jezus".  
*Then Paul said, What are you doing, weeping and wounding my heart? for I am ready, not only to be a prisoner, but to be put to death at Jerusalem for the name of the Lord Jesus.*  
*απεκριθη δε ο παυλος τι ποιειτε κλαιοντες και συνθρυπτοντες μου την καρδιαν εγω γαρ ου μονον δεθηναι αλλα και αποθανειν εις ιερουσαλημ ετοιμος εχω υπερ του ονοματος του κυριου ιησου*
- 14 Dhe, mbasi nuk i mbushej mendja, ne pushuam duke thënë: "U bëftë vullneti i Zotit!".  
*And as he might not be moved we did no more, saying, Let the purpose of God be done.*  
*μη πειθομενου δε αυτου ησυχασαμεν ειποντες το θελημα του κυριου γενεσθω*
- 15 Dhe pas atyre ditëve, bëmë gati gjërat tona, dhe u ngjitëm në Jeruzalem.  
*And after these days we got ready and went up to Jerusalem.*  
*μετα δε τας ημερας ταυτας αποσκευασαμενοι ανεβαινομεν εις ιερουσαλημ*
- 16 Me ne erdhën edhe disa dishepuj nga Cezareja dhe prunë me ta njëfarë Mnasoni, lindur në Qipro, një dishepull i vjetër, tek i cili do të bujtënim.  
*And some of the disciples from Caesarea went with us, taking a certain Mnason of Cyprus, one of the early disciples, in whose house we were to be living.*  
*συνηλθον δε και των μαθητων απο καισαρειας συν ημιν αγωντες παρ ω ξενισθωμεν μνασωνι τινι κυπριω αρχαιω μαθητη*
- 17 Kur arritëm në Jeruzalem, vëllezërit na pritën me gëzim.  
*And when we came to Jerusalem, the brothers were pleased to see us.*  
*γενομενων δε ημων εις ιεροσολυμα ασμενωσ εδεξαντο ημας οι αδελφοι*
- 18 Të nesërmen Pali u tërhoq me ne te Jakobi, dhe erdhën të gjithë pleqtë.  
*And on the day after, Paul went with us to James, and all the rulers of the church were present.*  
*τη δε επιουση εισηει ο παυλος συν ημιν προς ιακωβον παντες τε παρεγενοντο οι πρεσβυτεροι*
- 19 Mbasi i përshëndeti, Pali u tregoi atyre, një për një, të gjitha sa kishte bërë Zoti ndër johebrenjë me anë të shërbesës së tij.  
*And when he had said how glad he was to see them, he gave them a detailed account of the things which God had done through his work among the Gentiles.*  
*και ασπασαμενος αυτους εξηγειτο καθ εν εκαστον ων εποιησεν ο θεος εν τοις εθνεσιν δια της διακονιας αυτου*
- 20 Dhe ata, kur dëgjuan këtë, përlëvduan Perëndinë dhe i thanë Palit: "Vëlla, ti po sheh sa mijëra Judenj ka që kanë besuar; dhe të gjithë i përbahen me zell ligjit.  
*And hearing it, they gave praise to God; and they said to him, You see, brother, what thousands there are among the Jews, who have the faith; and they all have a great respect for the law:*  
*οι δε ακουσαντες εδοξασον τον κυριον ειπον τε αυτο θεωρεισ αδελφε ποσαι μυριαδες εισιν ιουδαιων των πεπιστευκοτων και παντες ζηλωται του νομου υπαρχουσιν*
- 21 Tani ata morën vesh për ty se ti i mëson të gjithë Judenjës që jetojnë midis johebrenjëve të shkëputen nga Moisiu, duke thënë që të mos i rrethpresin djemtë dhe të mos ndjekin më zakonet.  
*And they have had news of you, how you have been teaching all the Jews among the Gentiles to give up the law of Moses, and not to give circumcision to their children, and not to keep the old rules.*  
*κατηρηθησαν δε περι σου οτι αποστασιαν διδασκεισ απο μωσεως τους κατα τα εθνη παντας ιουδαιους λεγων μη περιτεμνειν αυτους τα τεκνα μηδε τοις εθεσιν περιπατειν*
- 22 Po atëherë, ç'duhet të bëhet? Duhet patjetër që të mblidhet populli, sepse do ta marrin vesh se ke ardhur.  
*What then is the position? They will certainly get news that you have come.*  
*τι ουν εστιν παντως δει πληθος συνελθειν ακουσονται γαρ οτι εληλυθασ*

- 23 Bëje, pra, atë që të themi: ne kemi katër burra, që kanë bërë një premtim solemn;  
Do this, then, which we say to you: We have four men who have taken an oath;  
τουτο ουν ποιησον ο σοι λεγομεν εισιν ημιν ανδρες τεσσαρες ευχην εχοντες εφ εαυτων
- 24 merri dhe pastrohu me ta, dhe paguaj për ta që të rruajnë kokën; kështu të gjithë do ta mësojnë se s'janë gjë ato që kanë dëgjuar për ty, por se edhe ti ecën duke respektuar ligjin.  
Go with these, and make yourself clean with them, and make the necessary payments for them, so that they may be free from their oath: and everyone will see that the statements made about you are not true, but that you put yourself under rule, and keep the law.  
τουτους παραλαβον αγνισθητι συν αυτοις και δαπανησον επ αυτοις ινα ζυρησωνται την κεφαλην και γνωσιν παντες οτι ων κατηχηνται περι σου ουδεν εστιν αλλα στοιχεις και αυτος τον νομον φυλασσων
- 25 Dhe sa për johebrenjtë që kanë besuar, ne u kemi shkruar atyre, mbasi vendosëm që ata nuk kanë ç'të respektojnë lidhur me këtë, por se të ruhen nga gjërat që u flijohen idhujve, nga gjaku, nga gjërat e mbytura dhe nga kurvëria".  
But as to the Gentiles who have the faith, we sent a letter, giving our decision that they were to keep themselves from offerings made to false gods, and from blood, and from the flesh of animals put to death in ways against the law, and from the evil desires of the body.  
περι δε των πεπιστευκοτων εθνων ημεις επεστελαμεν κριναντες μηδεν τοιουτου τηρειν αυτους ει μη φυλασσεσθαι αυτους το τε ειδωλοθυτον και το αιμα και πνικτον και πορνειαν
- 26 Atëherë Pali i mori me vete ata burra dhe, të nesërmen, pasi u pastrua bashkë me ta, hyri në tempull dhe deklaroi plotësimin e ditëve të pastrimit, dhe kur do të paraqitej oferta për secilin nga ata.  
Then Paul took the men, and on the day after, making himself clean with them, he went into the Temple, giving out the statement that the days necessary for making them clean were complete, till the offering was made for every one of them.  
τοτε ο παυλος παραλαβων τους ανδρας τη εχομενη ημερα συν αυτοις αγνισθεις εισηει εις το ιερον διαγγελων την εκπληρωσιν των ημερων του αγνισμου εως ου προσηνεχθη υπερ ενος εκαστου αυτων η προσφορα
- 27 Por, kur po mbusheshin shtatë ditët, Judenjët e Azisë, duke e parë në tempull, e nxitën turmën dhe vunë duart mbi të,  
And when the seven days were almost ended, the Jews from Asia, seeing him in the Temple, got the people together and put their hands on him,  
ως δε εμελλον αι επτα ημεραι συντελεισθαι οι απο της ασιας ιουδαιοι θεασαμενοι αυτον εν τω ιερω συνεχον παντα τον οχλον και επεβαλον τας χειρας επ αυτον
- 28 duke bërtitur: "O burra të Izraelit, na ndihmoni! Ky është ai njeri që u mëson të gjithëve dhe kudo kundër popullit, kundër ligjit dhe kundër këtij vendi; përveç kësaj ai i ka sjellë Grekët në tempull dhe e ka ndotur këtë vend të shenjtë".  
Crying out, Men of Israel, come to our help: this is the man who is teaching all men everywhere against the people and the law and this place: and in addition, he has taken Greeks into the Temple, and made this holy place unclean.  
κραζοντες ανδρες ισραηλιται βοηθειτε ουτος εστιν ο ανθρωπος ο κατα του λαου και του νομου και του τοπου τουτου παντας πανταχου διδασκων ετι τε και ελληνας εισηγαγεν εις το ιερον και κεκοινω κεν τον αγιον τοπον τουτου
- 29 Sepse ata kishin parë më përpara Trofimin nga Efesi bashkë me Palin në qytet, dhe mendonin se ai e kishte sjellë në tempull.  
For they had seen him before in the town with Trophimus of Ephesus, and had the idea that Paul had taken him with him into the Temple.  
ησαν γαρ προεωρακοτες τροφιμον τον εφεσιον εν τη πολει συν αυτω ον ενομιζον οτι εις το ιερον εισηγαγεν ο παυλος
- 30 Dhe gjithë qyteti ziente, dhe u mblodhën njerëzit; dhe, si e kapën Palin, e nxorrën jashtë tempullit dhe dyert u mbyllën menjëherë.  
And all the town was moved, and the people came running together and put their hands on Paul, pulling him out of the Temple: and then the doors were shut.  
εκινηθη τε η πολις ολη και εγενετο συνδρομη του λαου και επιλαβομενοι του παυλου ειλικον αυτον εξω του ιερου και ευθεως εκλεισθησαν αι θυραι
- 31 Dhe, ndërsa kërkonin ta vrisnin, tribunit të kohortës i shkoi lajmi se gjithë Jeruzalemi ishte turbulluar.  
And while they were attempting to put him to death, news came to the chief captain of the band that all Jerusalem was out of control.  
ζητουντων δε αυτον αποκτειναι ανεβη φασις τω χιλιαρχω της σπειρης οτι ολη συγκεχυται ιερουσαλημ
- 32 Ai mori menjëherë ushtarë dhe centurionë dhe u sul kundër tyre. Dhe këta, kur panë tribunit dhe ushtarët, pushuan së rrahuri Palin.  
And straight away he took some armed men and went quickly down to them: and the Jews, seeing them, gave no more blows to Paul.  
ος εξ αυτης παραλαβων στρατιωτας και εκατονταρχους κατεδραμεν επ αυτους οι δε ιδοντες τον χιλιαρχον και τους στρατιωτας επαυσαντο τυπτοντες τον παυλον
- 33 Atëherë tribuni u afrua, e zuri dhe urdhëroi që ta lidhnin me dy zinxhirë, pastaj pyeti cili ishte dhe ç'kishte bërë.  
Then the chief captain came near and took him, and gave orders for him to be put in chains, questioning them as to who he was and what he had done.  
τοτε εγγισας ο χιλιαρχος επελαβετο αυτου και εκελευσεν δεθηναι αλυσειν δυσιν και επυνθανετο τις αν ειη και τι εστιν πεποιηκος
- 34 Në turmë disa bërtisnin një gjë, të tjerë një tjetër; dhe, mbasi nuk mori vesh dot të vërtetën për trazirën, urdhëroi që ta sillnin në fortesë.  
And some said one thing and some another, among the people: and as he was not able to get a knowledge of the facts because of the noise, he gave orders for Paul to be taken into the army building.  
αλλοι δε αλλο τι εβουον εν τω οχλω μη δυναμενος δε γνωναι το ασφαλες δια τον θορυβον εκελευσεν αγεσθαι αυτον εις την παρεμβολην

- 35 Dhe kur arriti te shkallaret, ndodhi që, për shkak të dhunës së turmës, duhej të bartej nga ushtarët,  
 And when he came on to the steps, he was lifted up by the armed men, because of the force of the people;  
 οτε δε εγενετο επι τους αναβαθμους συνεβη βασταζεσθαι αυτον υπο των στρατιωτων δια την βιαν του οχλου
- 36 sepse masa e popullit vinte pas duke bërtitur: "Vdekje!".  
 For a great mass of people came after them, crying out, Away with him!  
 ηκολουθει γαρ το πληθος του λαου κραζον αιρε αυτον
- 37 Kur Pali do të hynte në fortesë, i tha tribunit: "A më lejohet të them diçka?". Ai u përgjigj: "A di greqisht?  
 And when Paul was about to be taken into the building, he said to the chief captain, May I say something to you? And he said, Have you a knowledge of Greek?  
 μελλων τε εισαγεσθαι εις την παρεμβολην ο παυλος λεγει τω χιλιαρχω ει εξεστιν μοι ειπειν τι προς σε ο δε εφη ελληνιστι γινωσκεις
- 38 Mos je vallë ai Egjiptasi që disa ditë më parë ngriti krye dhe nxori në shkretëtirë katër mijë gjakësorë?".  
 Are you by chance the Egyptian who, before this, got the people worked up against the government and took four thousand men of the Assassins out into the waste land?  
 ουκ αρα συ ει ο αιγυπτιος ο προ τουτων των ημερων αναστατωσας και εξαγαγων εις την ερημον τους τετρακιςχιλιους ανδρας των σικαριων
- 39 Dhe Pali tha: "Unë jam një Jude nga Tarsi, qytetar i një qyteti të Kilikisë që s'është i padëgjuar; dhe të lutem më lejo t'i flas popullit".  
 But Paul said, I am a Jew of Tarsus in Cilicia, which is not an unimportant town: I make a request to you to let me say a word to the people.  
 ειπεν δε ο παυλος εγω ανθρωπος μεν ειμι ιουδαιος ταρσευς της κιλικιας ουκ ασημου πολεως πολιτης δεομαι δε σου επιτρεψον μοι λαλησαι προς τον λαον
- 40 Dhe, mbasi e lejoi, Pali, duke qëndruar në këmbë mbi shkallarët, i bëri shenjë me dorë popullit. Dhe, si u bë heshtje e madhe, i foli në gjuhën hebraike, duke thënë:  
 And when he let him do so, Paul, from the steps, made a sign with his hand to the people, and when they were all quiet, he said to them in the Hebrew language,  
 επιτρεψαντος δε αυτου ο παυλος εστως επι των αναβαθμων κατεσεισεν τη χειρι τω λαω πολλης δε σιγης γενομενης προσεφωνησεν τη εβραιδι διαλεκτω λεγων
- 1 "Vëllezër dhe etër, dëgjoni çfarë ju them tani për mbrojtjen time".  
 My brothers and fathers, give ear to the story of my life which I now put before you.  
 ανδρες αδελφοι και πατερες ακουσατε μου της προς υμας νυν απολογιας
- 2 Kur dëgjuan se u fliste atyre në gjuhën hebraike, heshtën edhe më shumë. Pastaj ai tha:  
 And, hearing him talking in the Hebrew language, they became the more quiet, and he said,  
 ακουσαντες δε οτι τη εβραιδι διαλεκτω προσεφωνει αυτοις μαλλον παρεσχον ησυχιαν και φησιν
- 3 "Në të vërtetë unë jam një Jude, lindur në Tars të Kilikisë dhe rritur në këtë qytet te këmbët e Gamalielit, edukuar me përpikërinë e ligjit të etërve tanë, plot me zell për Perëndinë, sikurse jeni ju të gjithë sot;  
 I am a Jew of Tarsus in Cilicia by birth, but I had my education in this town at the feet of Gamaliel, being trained in the keeping of every detail of the law of our fathers; given up to the cause of God with all my heart, as you are today.  
 εγω μεν ειμι ανηρ ιουδαιος γεγεννημενος εν ταρσω της κιλικιας ανατεθραμμενος δε εν τη πολει ταυτη παρα τους ποδας γαμαλιηλ. πεπαιδευμενος κατα ακριβειαν του πατρουου νομου ζηλωτης υπαρχων του θεου καθως παντες υμεις εστε σημερον
- 4 unë kam përndjekur këtë Udhë deri në vdekje, duke lidhur dhe duke futur në burg burra dhe gra,  
 And I made attacks on this Way, even to death, taking men and women and putting them in prison.  
 ος ταυτην την οδον εδιωξα αχρι θανατου δεσμευων και παραδιδους εις φυλακας ανδρας τε και γυναικας
- 5 sikurse jep dëshmi për mua kryepriifti dhe gjithë sinedri i pleqve, prej të cilëve mora edhe letra për vëllezërit dhe shkova në Damask për të sjellë të lidhur në Jeruzalem ata që ishin atje, që të ndëshkoheshin.  
 Of which the high priest will be a witness, and all the rulers, from whom I had letters to the brothers; and I went into Damascus, to take those who were there as prisoners to Jerusalem for punishment.  
 ως και ο αρχιερευς μαρτυρει μοι και παν το πρεσβυτεριον παρ ων και επιστολας δεξαμενος προς τους αδελφους εις δαμασκον επορευομην αξων και τους εκεισε οντας δεδεμενους εις ιερουσαλημ ινα τιμωρηθωσιν
- 6 Dhe më ndodhi që, kur isha duke udhëtuar dhe po i afrohesha Damaskut, aty nga mesi i ditës, papritmas një dritë e madhe nga qielli vetëtiu rreth meje.  
 And it came about that while I was on my journey, coming near to Damascus, about the middle of the day, suddenly I saw a great light from heaven shining round me.  
 εγενετο δε μοι πορευομενω και εγγιζοντι τη δαμασκω περι μεσημβριαν εξαιφνης εκ του ουρανου περιστραψαι φως ικανον περι εμε

- 7 Dhe unë rashë përdhe dhe dëgjova një zë që po më thoshte: &quot;Saul, Saul, përse më përndjek?&quot;;  
 And when I went down on the earth, a voice came to my ears saying to me, Saul, Saul, why are you attacking me so cruelly?  
 επεσον τε εις το εδαφος και ηκουσα φωνης λεγουσης μοι σαουλ σαουλ τι με διωκεις
- 8 Dhe unë u përgjigja: &quot;Kush je ti, o Zot?&quot;; Edhe ai më tha: &quot;Unë jam Jezus Nazareasi, të cilin ti e përndjek&quot;;  
 And I, answering, said, Who are you; Lord? And he said to me, I am Jesus of Nazareth, whom you are attacking.  
 εγω δε απεκριθην τις ει κυριε ειπεν τε προς με εγω ειμι ιησους ο ναζωραιος ον συ διωκεις
- 9 Edhe ata që ishin me mua e panë dritën dhe u trembën, por nuk dëgjuan zërin e atij që më fliste.  
 And those who were with me saw the light, but the voice of him who was talking to me came not to their ears.  
 οι δε συν εμοι οντες το μεν φως εθεασαντο και εμφοβοι εγενοντο την δε φωνην ουκ ηκουσαν του λαλουντος μοι
- 10 Unë thashë: &quot;O Zot, ç'duhet të bëj?&quot;; Zoti më tha: &quot;Çohu dhe shko në Damask! Atje do të të thuhet çfarë të është urdhëruar të bësh&quot;;  
 And I said, What have I to do, Lord? And the Lord said to me, Get up, and go into Damascus; and it will be made clear to you what you have to do.  
 ειπον δε τι ποιησω κυριε ο δε κυριος ειπεν προς με αναστας πορευου εις δαμασκον κακει σοι λαληθησεται περι παντων ων τετακται σοι ποιησαι
- 11 Dhe, mbasi unë nuk shihja asgjë për shkak të shkëlqimit të asaj drite, më morën për dore ata që ishin me mua; dhe hyra në Damask.  
 And because I was unable to see because of the glory of that light, those who were with me took me by the hand, and so I came to Damascus.  
 ως δε ουκ ενεβλεπον απο της δοξης του φωτος εκεινου χειραγωγουμενος υπο των συνοντων μοι ηλθον εις δαμασκον
- 12 Dhe njëfarë Anania, njeri i perëndishëm sipas ligjit, për të cilin jepnin dëshmi të gjithë Judenjtë që banonin aty,  
 And one Ananias, a God-fearing man, who kept the law, and of whom all the Jews in that place had a high opinion,  
 ανανιας δε τις ανηρ ευσεβης κατα τον νομον μαρτυρουμενος υπο παντων των κατοικουντων ιουδαιων
- 13 erdhi tek unë, dhe duke qëndruar pranë meje, tha: &quot;O vëlla Saul, shiko përsëri!&quot;; Dhe në atë çast unë fitova përsëri dritën e syve dhe e shikova.  
 Came to my side and said, Brother Saul, let your eyes be open. And in that very hour I was able to see him.  
 ελθων προς με και επιστας ειπεν μοι σαουλ αδελφε αναβλεψον καγω αυτη τη ωρα ανεβλεψα εις αυτον
- 14 Pastaj vazhdoi: &quot;Perëndia i etërve tanë të ka paracaktuar të njohësh vullnetin e tij, ta shohësh të Drejtin dhe të dëgjosh një zë nga goja e tij.  
 And he said, You have been marked out by the God of our fathers to have knowledge of his purpose, and to see the Upright One and to give ear to the words of his mouth.  
 ο δε ειπεν ο θεος των πατερων ημων προεχειρισατο σε γνωνα το θελημα αυτου και ιδειν τον δικαιον και ακουσαι φωνην εκ του στοματος αυτου
- 15 Sepse ti duhet të dëshmosh për të tek të gjithë njerëzit për ato që ke parë dhe ke dëgjuar.  
 For you will be a witness for him to all men of what you have seen and of what has come to your ears.  
 οτι εση μαρτυς αυτω προς παντας ανθρωπους ων εωρακας και ηκουσας
- 16 Dhe tani ç'pret? Çohu dhe ji i pagëzuar dhe i larë nga mëkatet e tua, duke thirrur emrin e Zotit&quot;;  
 And now, why are you waiting? get up, and have baptism, for the washing away of your sins, giving worship to his name.  
 και νυν τι μελλεις αναστας βαπτισαι και απολουσαι τας αμαρτιας σου επικαλεσαμενος το ονομα του κυριου
- 17 Dhe ndodhi që, kur u ktheva në Jeruzalem dhe isha duke u lutur në tempull, u rrëmbeva në ekstazë,  
 And it came about that when I had come back to Jerusalem, while I was at prayer in the Temple, my senses became more than naturally clear,  
 εγενετο δε μοι υποστρεψαντι εις ιερουσαλημ και προσευχομενου μου εν τω ιερω γενεσθαι με εν εκστασει
- 18 dhe pashë Zotin që më thoshte: &quot;Nxito dhe dil shpejt nga Jeruzalemi, sepse ata nuk do ta pranojnë dëshminë tënde për mua&quot;;  
 And I saw him saying to me, Go out of Jerusalem straight away because they will not give hearing to your witness about me.  
 και ιδειν αυτον λεγοντα μοι σπευσον και εξελθε εν ταχει εξ ιερουσαλημ διοτι ου παραδεξονται σου την μαρτυριαν περι εμου
- 19 Atëherë unë thashë: &quot;O Zot, ata e dinë vetë se unë burgosja dhe rrihja nga një sinagogë te tjetra ata që besonin në ty;  
 And I said, Lord, they themselves have knowledge that I went through the Synagogues putting in prison and whipping all those who had faith in you:  
 καγω ειπον κυριε αυτοι επιστανται οτι εγω ημην φυλακιζων και δερων κατα τας συναγωγας τους πιστευοντας επι σε
- 20 kur u derdh gjaku i Stefanit, dëshmorit tënd, edhe unë isha i pranishëm, e miratoja vdekjen e tij dhe ruaja rrobat e atyre që e vrisnin.  
 And when Stephen your witness was put to death, I was there, giving approval, and looking after the clothing of those who put him to death.  
 και οτε εξεχειτο το αιμα στεφανου του μαρτυρος σου και αυτος ημην εφεστως και συνευδοκων τη αναρσει αυτου και φυλασσων τα ιματια των αναιρωντων αυτον



- 21 Por ai më tha: "Shko, sepse unë do të të dërgoj larg midis johebrenjve";  
 And he said to me, Go, for I will send you far away to the Gentiles.  
 και ειπεν προς με πορευου οτι εγω εις εθνη μακραν εξαποστελω σε
- 22 Ata e dëgjuan deri në këtë pikë; pastaj ngritën zërin duke thënë: "Hiqe nga bota një njeri të tillë, sepse nuk është i denjë të rrojë!".  
 And they gave him a hearing as far as this word; then with loud voices they said, Away with this man from the earth; it is not right for him to be living.  
 ηκουον δε αυτου αχρι τουτου του λογου και επηραν την φωνην αυτων λεγοντες αιρε απο της γης τον τοιουτον ου γαρ καθηκον αυτον ζην
- 23 Duke qenë se ata bërtisnin, duke i flakur rrobat e duke ngritur pluhurin në erë,  
 And while they were crying out, and pulling off their clothing, and sending dust into the air,  
 κρυναζοντων δε αυτων και ριπτουντων τα ματια και κονιορτον βαλλοντων εις τον αερα
- 24 kryemijësi urdhëroi ta çonin Palin në fortesë, duke urdhëruar që ta marrin në pyetje duke e rrahur me kamxhik, që të merrej vesh për çfarë arsye ata bërtisnin kështu kundër tij.  
 The chief captain gave orders for him to be taken into the army building, saying that he would put him to the test by whipping, so that he might have knowledge of the reason why they were crying out so violently against him.  
 εκελευσεν αυτον ο χιλιαρχος αγεσθαι εις την παρεμβολην ειπον μαστιξιν ανεταζεσθαι αυτον ινα επιγνω δι ην αιτιαν ουτως επεφονουν αυτω
- 25 Por, kur e shtrinë, të lidhur me rripa, Pali i tha centurionit që ishte aty: "A është e ligjshme për ju të rrihni me kamxhik një qytetar romak, ende të pagjykuar?".  
 And when they had put leather bands round him, Paul said to the captain who was present, Is it the law for you to give blows to a man who is a Roman and has not been judged?  
 ως δε προειπεν αυτον τοις μασιν ειπεν προς τον εστοτα εκατονταρχον ο παυλος ει ανθρωπον ρωμαιον και ακατακριτον εξεστιν υμιν μαστιζειν
- 26 Kur e dëgjoi, centurioni shkoi e i tregoi kryemijësit duke thënë: "Çfarë do të bësh? Ky njeri është një qytetar romak!".  
 And hearing this, the man went to the chief captain and gave him an account of it, saying, What are you about to do? for this man is a Roman.  
 ακουσας δε ο εκατονταρχος προσελθων απηγγειλεν τω χιλιαρχω λεγον ορα τι μελλεις ποιειν ο γαρ ανθρωπος ουτος ρωμαιος εστιν
- 27 Atëherë kryemijësi shkoi te Pali dhe e pyeti: "Më thuaj, a je një qytetar romak?". Ai tha: "Po, jam!".  
 And the chief captain came to him and said, Give me an answer, are you a Roman? And he said, Yes.  
 προσελθων δε ο χιλιαρχος ειπεν αυτω λεγε μοι ει συ ρωμαιος ει ο δε εφη ναι
- 28 Kryemijësi u përgjigj: "Unë e kam fituar këtë qytetëri me një shumë të madhe". Pali tha: "Kurse unë e kam qysh prej lindjes!".  
 And the chief captain said, I got Roman rights for myself at a great price. And Paul said, But I had them by birth.  
 απεκριθη τε ο χιλιαρχος εγω πολλου κεφαλαιου την πολιτειαν ταυτην εκτησαμην ο δε παυλος εφη εγω δε και γεγεννημαι
- 29 Menjëherë ata që duhet ta merrnin në pyetje u larguan prej tij; dhe vetë kryemijësi, kur mori vesh se ai ishte qytetar romak, pati frikë që e kishte lidhur.  
 Then those who were about to put him to the test went away: and the chief captain was in fear, seeing that he was a Roman, and that he had put chains on him.  
 ευθεις ουν απεστησαν απ αυτου οι μελλοντες αυτον ανεταζειν και ο χιλιαρχος δε εφοβηθη επιγνους οτι ρωμαιος εστιν και οτι ην αυτον δεδεκωσ
- 30 Të nesërmen, duke dashur të marrë vesh me saktësi përse ishte akuzuar nga Judenjët, e zgjidhi nga prangat dhe urdhëroi krerët e priftërinjve dhe gjithë sinedrin të vinin. Pastaj, si e sollën poshtë Palin, e nxori përpara tyre.  
 But on the day after, desiring to have certain knowledge of what the Jews had to say against him, he made him free, and gave orders for the chief priests and all the Sanhedrin to come together, and he took Paul and put him before them.  
 τη δε επαυριον βουλομενος γνωαι το ασφαλες το τι κατηγορειται παρα των ιουδαιων ελυσεν αυτον απο των δεσμων και εκελευσεν ελθειν τους αρχιερεις και ολον το συνεδριον αυτων και καταγαγων τον παυλον εστησεν εις αυτους
- 1 Pali, duke shikuar nga sinedri, tha: "Vëllezër, deri në këtë unë jam sjellë përpara Perëndisë me ndërgjegje krejt të mirë".  
 And Paul, looking fixedly at the Sanhedrin, said, My brothers, my life has been upright before God till this day.  
 ατεισας δε ο παυλος τω συνεδριω ειπεν ανδρες αδελφοι εγω παση συνειδησει αγαθη πεπολιτευμαι τω θεω αχρι ταυτης της ημερας
- 2 Kryepriifti Anania u dha urdhër atëherë atyre që ishin pranë tij ta godisnin në gojë.  
 And the high priest, Ananias, gave orders to those who were near him to give him a blow on the mouth.  
 ο δε αρχιερευς ανανιας επεταξεν τοις παρεστωσιν αυτω τυπειν αυτου το στομα
- 3 Atëherë Pali i tha: "Perëndia do të të godasë ty, o mur i zbardhur. Ti je ulur të më gjykos sipas ligjit dhe, duke e nëpërkëmbur atë, jep urdhër të më godasin".  
 Then Paul said to him, God will give blows to you, you whitewashed wall: are you here to be my judge by law, and by your orders am I given blows against the law?  
 τοτε ο παυλος προς αυτον ειπεν τυπειν σε μελλει ο θεος τοιχε κεκονιαμενε και συ καθη κρινων με κατα τον νομον και παρανομον κελειεις με τυπεσθαι

- 4 Dhe ata që ishin të pranishëm thanë: "E fyen ti kryepriftin e Perëndisë?".  
 And those who were near said, Do you say such words against God's high priest?  
 οι δε παρευστωτες ειπον τον αρχιερεα του θεου λοιδορεις
- 5 Pali u përgjigj: "Nuk e dija, o vëllezër, se është kryeprift, sepse është shkruar: &quot;Ti nuk do të flasësh keq për princin e popullit tënd&quot;".  
 And Paul said, Brother, I had no idea that he was the high priest: for it has been said, You may not say evil about the ruler of your people.  
 εφη τε ο παυλος ουκ ηδειν αδελφοι οτι εστιν αρχιερευς γεγραπται γαρ αρχοντα του λαου σου ουκ ερεις κακως
- 6 Pali, pra, duke ditur se një pjesë ishte nga saducenj dhe tjetra nga farisenj, i thirri sinedrit: "Vëllezër, unë jam farise, bir farisenjsh; për shkak të shpresës dhe të ringjalljes të së vdekurve unë po gjykohe".  
 But when Paul saw that half of them were Sadducees and the rest Pharisees, he said in the Sanhedrin, Brothers, I am a Pharisee, and the son of Pharisees: I am here to be judged on the question of the hope of the coming back from the dead.  
 γνους δε ο παυλος οτι το εν μερος εστιν σαδδουκαιων το δε ετερον φαρισαιων εκραξεν εν τω συνεδριω ανδρες αδελφοι εγω φαρισαιος ειμι υιος φαρισαιου περι ελπιδος και αναστασεως νεκρων εγω κ ρινομαι
- 7 Sapo tha këtë, lindi një grindje ndërmjet farisenjve dhe saducenjve, dhe kuvendi u përçaz;  
 And when he had said this, there was an argument between the Pharisees and the Sadducees, and a division in the meeting.  
 τουτο δε αυτου λαλησαντος εγενετο στασις των φαρισαιων και των σαδδουκαιων και εσχισθη το πληθος
- 8 sepse saducenjtë thonë se nuk ka ringjallje, as engjëll, as frymë, ndërsa farisenjtë pohojnë edhe njëherë dhe tjetrën.  
 For the Sadducees say that there is no coming back from the dead, and no angels or spirits: but the Pharisees have belief in all these.  
 σαδδουκαιοι μεν γαρ λεγουσιν μη ειναι αναστασιν μηδε αγγελων μητε πνευμα φαρισαιοι δε ομολογουσιν τα αμφοτερα
- 9 Atëherë u bë një zhurmë e madhe. Skribët e palës së farisenjve u çuan në këmbë dhe protestonin duke thënë: "Ne nuk gjejmë asgjë të keqe te ky njeri; dhe nëse i ka folur një frymë ose një engjëll të mos luftojmë kundër Perëndisë".  
 And there was a great outcry: and some of the scribes on the side of the Pharisees got up and took part in the discussion, saying, We see no evil in this man: what if he has had a revelation from an angel or a spirit?  
 εγενετο δε κραυγη μεγαλη και ανασταντες οι γραμματεις του μερους των φαρισαιων διεμαχοντο λεγοντες ουδεν κακον ευρισκομεν εν τω ανθρωπω τουτω ει δε πνευμα ελαλησεν αυτω η αγγελος μη θε ομαχομεν
- 10 Dhe duke qenë se grindja po shtohet, tribuni, nga druajtja se mos Pali bëhej copa-copa prej tyre, u dha urdhër ushtarëve të zbresin dhe ta heqin nga mesi i tyre, dhe ta çojnë përsëri në fortesë.  
 And when the argument became very violent, the chief captain, fearing that Paul would be pulled in two by them, gave orders to the armed men to take him by force from among them, and take him into the army building.  
 πολλης δε γενομενης στασεως ευλαβηθεις ο χιλιαρχος μη διασπασθη ο παυλος υπ αυτων εκελευσεν το στρατευμα καταβαν αρπασαι αυτον εκ μεσου αυτων αγειν τε εις την παρεμβολην
- 11 Një natë më pas, Zoti iu shfaq atij dhe tha: "Pal, kurajo, sepse sikurse ke dhënë dëshmi për mua në Jeruzalem, ashtu duhet të dëshmosh edhe në Romë".  
 And the night after, the Lord came to his side and said, Be of good heart, for as you have been witnessing for me in Jerusalem, so will you be my witness in Rome.  
 τη δε επιουση νυκτι επιστας αυτω ο κυριος ειπεν θαρσει παυλε ως γαρ διεμαρτυρω τα περι εμου εις ιερουσαλημ ουτως σε δει και εις ρωμην μαρτυρησαι
- 12 Kur zbardhi dita, disa Judenj kurdisën një komplot duke u lidhur me betim që të mos hanë dhe të mos pinë derisa të kenë vrarë Palin.  
 And when it was day, the Jews came together and put themselves under an oath that they would take no food or drink till they had put Paul to death.  
 γενομενης δε ημερας ποιησαντες τινες των ιουδαιων συστροφιη ανθεματισαν εαυτους λεγοντες μητε φαγειν μητε πειν εως ου αποκτεινωσιν τον παυλον
- 13 Ata që kishin bërë këtë komplot ishin më tepër se dyzet.  
 And more than forty of them took this oath.  
 ησαν δε πλειους τεσσαρακοντα οι ταυτην την συνωμοσιαν πεποιηκοτες
- 14 Ata u paraqitën para krerëve të priftërinjve dhe para pleqve dhe thanë: "Ne jemi lidhur me betim të mos vëmë gjë në gojë, derisa të vrasim Palin.  
 And they came to the chief priests and the rulers and said, We have taken a great oath to take no food till we have put Paul to death  
 οτινιες προσελθοντες τοις αρχιερευσιν και τοις πρεσβυτεροις ειπον αναθεματι ανεθεματισαμεν εαυτους μηδενος γευσασθαι εως ου αποκτεινωμεν τον παυλον
- 15 Ju, pra, me sinedrin, i bëni një kërkesë tribunit që t'jua sjellë nesër, gjoja se doni ta hetoni më thellë çështjen e tij; dhe ne, para se të afrohet, do të jemi gati ta vrasim".  
 So now, will you and the Sanhedrin make a request to the military authorities to have him sent down to you, as if you were desiring to go into the business in greater detail; and we, before ever he gets to you, will be waiting to put him to death.  
 νυν ουν υμεις εμφανισατε τω χιλιαρχω συν τω συνεδριω οπως αυριον αυτον καταγαγη προς υμας ως μελλοντας διαγινωσκειν ακριβεστερον τα περι αυτου ημεις δε προ του εγγισαι αυτον ετοιμοι εσμε ν του ανελειν αυτον

- 16 Por djali i motrës së Palit, si e mori vesh kurthin, rendi në fortesë dhe, mbasi hyri, i tregoi Palit.  
But Paul's sister's son had word of their design, and he came into the army building and gave news of it to Paul.  
ακουσας δε ο υιος της αδελφης παυλου το ενεδρον παραγενομενος και εισελθων εις την παρεμβολην απηγγειλεν τω παυλω
- 17 Atëherë Pali thirri një nga centurionët pranë vetes dhe i tha: "Çoje këtë djalë tek kryemijëshi, sepse ka diçka për t'i thënë".  
And Paul sent for a captain and said, Take this young man to your chief, for he has news for him.  
προσκαλεσαμενος δε ο παυλος ενα των εκατονταρχων εφη τον νεανιαν τουτον απαγαγε προς τον χιλιαρχον εχει γαρ τι απαγγειλαι αυτο
- 18 Atëherë ai e mori dhe e çoi tek kryemijëshi dhe tha: "Pali, i burgosuri, më thirri dhe m'u lut të sjell këtë djalë, sepse ka diçka për të të thënë".  
So he took him to the chief captain and said, Paul, the prisoner, made a request to me to take this young man to you, for he has something to say to you.  
ο μεν ουν παραλαβων αυτον ηγαγεν προς τον χιλιαρχον και φησιν ο δεσμιος παυλος προσκαλεσαμενος με ηρωτησεν τουτον τον νεανιαν αγαγειν προς σε εχοντα τι λαλησαι σοι
- 19 Atëherë kryemijësi e kapi për dore, e mori mënjandë dhe e pyeti: "Çfarë ke për të më thënë?".  
And the chief took him by the hand and, going on one side, said to him privately, What is it you have to say to me?  
επιλαβομενος δε της χειρος αυτου ο χιλιαρχος και αναχωρησας κατ ιδιαν επυνθανετο τι εστιν ο εχεις απαγγειλαι μοι
- 20 Ai tha: "Judenjtë janë marrë vesh që të të kërkojnë që nesër ta nxjerrësh Palin poshtë, në sinedër, se gjoja dashkan ta hetojnë më thellë çështjen e tij.  
And he said, The Jews are in agreement together to make a request to you for Paul to be taken, on the day after this, into the Sanhedrin, to be questioned in greater detail.  
ειπεν δε οτι οι ιουδαιοι συνεθεντο του ερωτησαι σε οπως αυριον εις το συνεδριον καταγαγης τον παυλον ως μελλοντες τι ακριβεστερον πυθανεσθαι περι αυτου
- 21 Prandaj ti mos ua vër veshin, sepse më shumë se dyzet burra nga ata kanë ngritur kurth kundër tij, sepse janë zotuar duke u lidhur me betim, të mos hanë e të mos pinë, derisa ta kenë vrarë; dhe tani janë gati dhe presin që ti t'ua lejosh atyre".  
But do not give way to them, for more than forty of them are waiting for him, having taken an oath not to take food or drink till they have put him to death: and now they are ready, waiting for your order.  
συ ουν μη πεισθης αυτοις ενεδρευουσιν γαρ αυτον εξ αυτων ανδρες πλειους τεσσαρακοντα οιτινες ανεθεματισαν εαυτους μητε φαγειν μητε πειν εως ου ανελωσιν αυτον και νυν ετοιμοι εισιν προσδεχομενοι την απο σου επαγγελιαν
- 22 Tribuni, pra, e la të shkojë djalin, duke e urdhëruar që të mos i tregojë kurrkujt se e kishte vënë në dijeni për këto gjëra.  
So the chief captain let the young man go, saying to him, Do not say to anyone that you have given me word of these things.  
ο μεν ουν χιλιαρχος απελυσεν τον νεανιαν παραγγειλας μηδενι εκλαλησαι οτι ταυτα ενεφανισας προς με
- 23 Pastaj thirri dy centurionë dhe u tha: "Bëni gati që nga ora tre e natës dyqind ushtarë, shtatëdhjetë kalorës dhe dyqind shtizëmbajtës, për të shkuar deri në Cezare".  
And he sent for two captains and said, Make ready two hundred men, with seventy horsemen and two hundred spearmen, to go to Caesarea, at the third hour of the night:  
και προσκαλεσαμενος δυο τινας των εκατονταρχων ειπεν ετοιμασατε στρατιωτας διακοσιους οπως πορευθωσιν εως καισαρειας και ιππεις εβδομηκοντα και δεξιολαβους διακοσιους απο τριτης ωρας της νυκτος
- 24 Dhe u tha të bëjnë gati kuajt që ta hipte Pali dhe ta çonin shëndoshë e mirë te qeveritari Feliks.  
And get beasts so that they may put Paul on them, and take him safely to Felix, the ruler.  
κτηνη τε παραστησαι ινα επιβιασαντες τον παυλον διασωσωσιν προς φιλικα τον ηγεμονα
- 25 Ai shkroi një letër me këtë përmbajtje:  
And he sent a letter in these words:  
γραψας επιστολην περιεχουσαν τον τυπον τουτον
- 26 "Klaud Lisia, qeveritarit shumë të shkëlqyeshëm Feliks, shëndet.  
Claudius Lysias, to the most noble ruler, Felix, peace be with you.  
κλαυδιος λυσιας τω κρατιστω ηγεμονι φιλικι χαιρειν
- 27 Ky njeri ishte kapur nga Judenjtë që ishin gati ta vrisnin, kur ia mbërrita unë me ushtarët dhe e lirova, sepse mora vesh se ishte qytetar romak.  
This man was taken by the Jews, and was about to be put to death by them, when I came on them with the army and took him out of danger, having knowledge that he was a Roman.  
τον ανδρα τουτον συλληφθεντα υπο των ιουδαιων και μελλοντα ανααιρεσθαι υπ αυτων επιστας συν τω στρατευματι εξειλομην αυτον μαθων οτι ρωμαιοσ εστιν
- 28 Dhe, duke dashur të di fajin për të cilin e akuzonin, e nxora para sinedrit të tyre.  
And, desiring to get at the reason for their attack on him, I took him down to their Sanhedrin:  
βουλομενος δε γνωμαι την αιτιαν δι ην ενεκαλουν αυτω καταγαγον αυτον εις το συνεδριον αυτων

- 29 Përfundova se e kishin akuzuar për çështje që lidheshin me ligjin e tyre dhe që ai nuk kishte asnjë faj që të meritonte vdekjen e as burgimin.  
Then it became clear to me that it was a question of their law, and that nothing was said against him which might be a reason for prison or death.  
on ευρον εγκαλουμενον περι ζητηματων του νομου αυτων μηδεν δε αξιον θανατου η δεσμων εγκλημα εχοντα
- 30 Dhe, kur më njoftuan për kurthin që Judenjtë i ngritën këtij njeriu, ta nisa menjëherë, duke u dhënë urdhër paditësve të parashtrajnë para teje ankimet që kanë kundër tij. Qofsh me shëndet!".  
And when news was given to me that a secret design was being made against the man, I sent him straight away to you, giving orders to those who are against him to make their statements before you.  
μηνυθεισης δε μοι επιβουλης εις τον ανδρα μελλειν εσεσθαι υπο των ιουδαιων εξ αυτης επεμψα προς σε παραγγελιας και τοις κατηγοροις λεγειν τα προς αυτον επι σου ερωωσο
- 31 Ushtarët, pra, sipas urdhrit të dhënë, morën në dorëzimin Palin dhe e çuan natën në Antipatridë.  
So the armed men, as they were ordered, took Paul and came by night to Antipatris.  
οι μεν ουν στρατιωται κατα το διατεταγμενον αυτοις αναλαβοντες τον παυλον ηγαγον δια της νυκτος εις την αντιπατριδα
- 32 Të nesërmen, pasi ua lanë si detyrë kalorësve të shkojnë me të, u kthyen në fortesë.  
But on the day after, they sent the horsemen on with him, and went back to their place:  
τη δε επαυριον εασαντες τους ιππεις πορευεσθαι συν αυτω υπεστρεψαν εις την παρεμβολην
- 33 Ata, pasi arritën në Cezare dhe ia dorëzuan letrën qeveritarit, i paraqitën edhe Palin.  
And they, when they came to Caesarea, gave the letter to the ruler, and took Paul before him.  
οιτινες εισελθοντες εις την καισαρειαν και αναδοντες την επιστολην τω ηγεμονι παρεστησαν και τον παυλον αυτω
- 34 Mbasi e lexoi letrën, qeveritari e pyeti Palin nga ç'krahinë ishte; dhe, kur mori vesh se ishte nga Kilikia,  
And after reading it, he said, What part of the country do you come from? And, hearing that he was from Cilicia,  
αναγνους δε ο ηγεμων και επερωτησας εκ ποιας επαρχιας εστιν και πυθομενος οτι απο κιλικιας
- 35 i tha: "Unë do të të dëgjoj kur të mbërrijnë edhe paditësit e tu". Dhe urdhëroi që ta ruanin në pretoriumin e Herodit.  
I will give hearing to your cause, he said, when those who are against you have come. And he gave orders for him to be kept in Herod's Praetorium.  
διακουσομαι σου εφη οταν και οι κατηγοροι σου παραγενωνται εκελευσεν τε αυτον εν τω πραιτωριω του ηρωδου φυλασσεσθαι
- 1 Por pas pesë ditësh erdhi kryepriifti Anania bashkë me pleqtë dhe me një gojtar, një farë Tertuli; ata dolën përpara qeveritarit për të akuzuar Palin.  
And after five days, the high priest, Ananias, came with certain of the rulers, and an expert talker, one Tertullus; and they made a statement to Felix against Paul.  
μετα δε πεντε ημερας κατεβη ο αρχιερευς ανανιας μετα των πρεσβυτερων και ρητορος τερτυλλου τινος οιτινες ενεφανισαν τω ηγεμονι κατα του παυλου
- 2 Kur u thirr Pali, Tertuli filloi ta akuzojë duke thënë:  
And when he had been sent for, Tertullus, starting his statement, said, Because by you we are living in peace, and through your wisdom wrongs are put right for this nation,  
κληθεντος δε αυτου ηρξατο κατηγορειν ο τερτυλλος λεγων
- 3 "Fort i shkëlqyeri Feliks, ne e pranojmë në gjithçka e për gjithçka dhe me mirënjohje të thellë se paqja të cilën gëzojmë dhe reformat dobiprurëse që janë zbatuar për këtë komb janë vepër e masave të tua largpamëse.  
In all things and in all places we are conscious of our great debt to you, most noble Felix.  
πολλης ειρηνης τυγχανοντες δια σου και κατορθωματων γινομενων τω εθνει τουτω δια της σης προνοιας παντη τε και πανταχου αποδεχομεθα κρατιστε φιλιξ μετα πασης ευχαριστιας
- 4 Por, për të mos të shqetësuar më gjatë, të lutem me mirësinë tënde, të na dëgjosh shkurtimisht.  
But, so that I may not make you tired, I make a request to you of your mercy, to give hearing to a short statement.  
ινα δε μη επι πλειον σε εγκοπω παρακαλω ακουσαι σε ημων συντομως τη ση επιεικεια
- 5 Ne kemi gjetur se ky njeri është një murtajë dhe shkakton trazira midis gjithë Judenjve që janë në botë dhe është kryetari i sektit të Nazarenave.  
For this man, in our opinion, is a cause of trouble, a maker of attacks on the government among Jews through all the empire, and a chief mover in the society of the Nazarenes:  
ευροντες γαρ τον ανδρα τουτον λοιμον και κινουντα στασιν πασιν τοις ιουδαιοις τοις κατα την οικουμενην πρωτοστατην τε της των ναζωραιων αιρεσεως
- 6 Ai, madje, u përpoq të përdhosë tempullin; dhe ne e zumë dhe deshëm ta gjykonim sipas ligjit tonë.  
Who, in addition, was attempting to make the Temple unclean: whom we took,  
ος και το ιερον επειρασεν βεβηλωσαι ον και εκρατησαμεν και κατα τον ημετερον νομον ηθελησαμεν κρινειν
- 7 Por erdhi tribuni Lisia dhe e mori me forcë nga duart tona,  
[]  
παρελθων δε λυσιας ο χιλιαρχος μετα πολλης βιας εκ των χειρων ημων απηγαγεν

- 8 duke i urdhëruar paditësit e tij të vijnë tek ti; duke e hetuar atë, do të mundësh ti vetë të marrësh vesh prej tij të vërtetën e të gjitha gjërave, për të cilat ne e akuzojmë".  
And from whom you will be able, by questioning him yourself, to get knowledge of all the things which we say against him.  
κελευσας τους κατηγορους αυτου ερχεσθαι επι σε παρ ου δυνηση αυτος ανακρινας περι παντων τουτων επιγνωαι ων ημεις κατηγορουμεν αυτου
- 9 Edhe Judenjët u bashkuan, duke pohuar se kështu qëndronin gjërat.  
And the Jews were in agreement with his statement, saying that these things were so.  
συνεθεντο δε και οι ιουδαιοι φασκοντες ταυτα ουτως εχειν
- 10 Atëherë Pali, mbasi qeveritari i bëri shenjë të flasë, u përgjigj: "Duke ditur se prej shumë vjetësh ti je gjykatësi i këtij kombi, flas edhe më me guxim në mbrojtje të vetes.  
Then when the ruler had given him a sign to make his answer, Paul said, Because I have knowledge that you have been a judge over this nation for a number of years, I am glad to make my answer:  
απεκριθη δε ο παυλος νευσαντος αυτω του ηγεμονος λεγειν εκ πολλων ετων οντα σε κριτην τω εθνει τουτω επισταμενος ευθυμοτερον τα περι εμαυτου απολογουμαι
- 11 Jo më shumë se dymbëdhjetë ditë më parë, siç mund ta verifikosh, unë u ngjita në Jeruzalem për të adhruar.  
Seeing that you are able to make certain of the fact that it is not more than twelve days from the time when I came up to Jerusalem for worship;  
δυναμενου σου γνωαι οτι ου πλειους εισιν μοι ημεραι η δεκαδυο αφ ης ανεβην προσκυνησων εν ιερουσαλημ
- 12 Dhe këta nuk më gjetën në tempull duke u grindur me ndonjë, ose duke nxitur turmën as në sinagogat as edhe nëpër qytet;  
And they have not seen me in argument with any man in the Temple, or working up the feelings of the people, in the Synagogues or in the town:  
και ουτε εν τω ιερω ευρον με προς τινα διαλεγομενον η επισυστασιν ποιουντα οχλου ουτε εν ταις συναγωγαις ουτε κατα την πολιν
- 13 dhe as mund të provojnë gjërat për të cilat tani më akuzojnë.  
And they are not able to give facts in support of the things which they say against me now.  
ουτε παραστησαι με δυνανται περι ων νυν κατηγορουσιν μου
- 14 Por unë po të rrëfej këtë: sipas Udhës që ata e quajnë sekt, unë i shërbej kështu Perëndisë së etërve, duke u besuar të gjitha gjërave që janë shkruar në ligjin dhe në profetët,  
But this I will say openly to you, that I do give worship to the God of our fathers after that Way, which to them is not the true religion: but I have belief in all the things which are in the law and in the books of the prophets:  
ομολογω δε τουτο σοι οτι κατα την οδον ην λεγουσιν αιρεσιν ουτως λατρευω τω πατρω θεω πιστευων πασιν τοις κατα τον νομον και τοις προφηταις γεγραμμενοις
- 15 duke pasur shpresë në Perëndinë, të cilën edhe këta e kanë, se do të ketë një ringjallje të të vdekurve, qoftë të të drejtëve, qoftë të të padrejtëve.  
Hoping in God for that which they themselves are looking for, that there will be a coming back from the dead for upright men and wrongdoers.  
ελπιδα εχων εις τον θεον ην και αυτοι ουτοι προσδεχονται αναστασιν μελλειν εσεσθαι νεκρων δικαιων τε και αδικων
- 16 Prandaj unë përpiqem të kem vazhdimisht një ndërgjegje të paqortueshme përpara Perëndisë dhe përpara njerëzve.  
And in this, I do my best at all times to have no reason for shame before God or men.  
εν τουτω δε αυτος ασκω απροσκοπον συνειδησιν εχειν προς τον θεον και τους ανθρωπους διαπαντος
- 17 Tani, pas shumë vjetësh, unë erdha të sjell lëmosha dhe oferta kombit tim.  
Now after a number of years I came to give help and offerings to my nation:  
δι ετων δε πλειονων παρεγενομην ελεημοσυνας ποιησων εις το εθνος μου και προσφορας
- 18 Por, tek po bëja këtë, ata më gjetën të pastruar në tempull, pa asnjë tubim ose trazirë.  
και λεγοντες ουαι ουαι η πολις η μεγαλη η περιβεβλημενη βυσσινον και πορφυρου και κοκκινον και κεχρυσωμενη εν χρυσω και λιθω τιμω και μαργαριταις
- 17 Të gjithë kapitenët, të gjithë pasagjerët dhe detarët, dhe të gjithë ata që tregtojnë nëpërmjet detit do të qëndrojnë nga larg  
For in one hour such great wealth has come to nothing. And every shipmaster, and all who are sailing on the sea, and sailors and all who get their living by the sea, were watching from far away,  
οτι μια ωρα ηρημωθη ο τοσουτος πλουτος και πας κυβερνητης και πας επι των πλοιων ο ομιλος και ναυται και οσοι την θαλασσαν εργαζονται απο μακροθεν εστησαν
- 18 dhe, duke parë tymin e zjarrit të saj, do të klithin: "Cili qytet i përngjante këtij qyteti të madh?"  
And crying out when they saw the smoke of her burning, saying, What town is like the great town?  
και εκραζον ορωντες τον καπνον της πυρωσεως αυτης λεγοντες τις ομοια τη πολει τη μεγαλη
- 19 Dhe do të hedhin pluhur mbi kryet, do të bërtasin, duke qarë e duke vajtuar, duke thënë: "Ah! Ah! Qyteti i madh, në të cilën u pasuruan të gjithë ata që kishin anije në det nga mrekullia e saj, sepse për një moment u shkretua!  
And they put dust on their heads, and were sad, weeping and crying, and saying, Sorrow, sorrow for the great town, in which was increased the wealth of all who had their ships on the sea because of her great stores! for in one hour she is made waste.  
και εβαλον χουν επι τας κεφαλας αυτων και εκραζον κλαιοντες και πενθουντες λεγοντες ουαι ουαι η πολις η μεγαλη εν η επλουτησαν παντες οι εχοντες πλοια εν τη θαλασση εκ της τιμοτητος αυτης οτι μια ωρα ηρημωθη
- 20 Gëzohu përmbi të, o qiell, dhe ju apostuj të shenjtë dhe profetë, sepse Perëndia duke e gjykuar vuri në vend drejtësinë!"  
Be glad over her, heaven, and you saints, and Apostles, and prophets; because she has been judged by God on your account.  
ευφραινου επ αυτην ουρανε και οι αγιοι αποστολοι και οι προφηται οτι εκρινεν ο θεος το κριμα υμων εξ αυτης
- 21 Dhe një engjëll i fuqishëm ngriti një gur të madh me përmasat sa një mokër dhe e hodhi në det, duke thënë: "Me të njëjtin vrull do të hidhet Babilona, qyteti i madh, dhe nuk do të gjendet më;  
And a strong angel took up a stone like the great stone with which grain is crushed, and sent it into the sea, saying, So, with a great fall, will Babylon, the great town, come to destruction, and will not be seen any more at all.  
και ηρεν εις αγγελος ισχυρος λιθον ως μυλλον μεγαν και εβαλεν εις την θαλασσαν λεγων ουτως ορμηματι βληθησεται βαβυλων η μεγαλη πολις και ου μη ευρεθη ετι
- 22 dhe zëri i harpistëve, i muzikantëve, i fyelltarëve dhe borizanëve nuk do të dëgjohet më te ti; dhe çdo mjeshtër i çfarëdo eksperti i arteve nuk do të gjendet më te ti, dhe nuk do të dëgjohet më te ti zëri i gurit të mullirit.  
And the voice of players and makers of music will never again be sounding in you; and no worker, expert in art, will ever again be living in you; and there will be no sound of the crushing of grain any more at all in you;  
και φωνη καθαρωδων και μουσικων και αυλητων και σαλπιστων ου μη ακουσθη εν σοι ετι και πας τεχνιτης πασης τεχνης ου μη ευρεθη εν σοι ετι και φωνη μυλου ου μη ακουσθη εν σοι ετι

- 23 Dhe dritë llambe nuk do të ndriçojë më në ty; edhe zë dhëndri dhe nuseje nuk do të dëgjohej më te ti; sepse tregtarët e tu ishin të mëdhenjtë e dheut, sepse gjithë kombet u mashtruan me magjinë tënde.  
And never again will the shining of lights be seen in you; and the voice of the newly-married man and the bride will never again be sounding in you: for your traders were the lords of the earth, and by your evil powers were all the nations turned out of the right way.  
και φως λυχου ου μη φανη εν σοι επι και φωνη νυμφιου και νυμφης ου μη ακουσθη εν σοι επι οτι οι εμποροι σου ησαν οι μεγαιστανες της γης οτι εν τη φαρμακεια σου επλανηθησαν παντα τα εθνη
- 24 Sepse në të u gjet gjak profetësh dhe shenjtorësh, dhe i gjithë atyre që janë vlarë mbi dhe".  
And in her was seen the blood of prophets and of saints, and of all who have been put to death on the earth.  
και εν αυτη αιμα προφητων και αγιων ευρεθη και παντων των εσφαγμενων επι της γης
- 1 Dhe pas këtyre dëgjova në qiell zërin e madh të një turme të shumtë, duke thënë: "Aleluja! Shpëtimi, dhe lavdia, dhe nderimi, dhe fuqia i përkasin Zotit, Perëndisë sonë,  
After these things there came to my ears a sound like the voice of a great band of people in heaven, saying, Praise to the Lord; salvation and glory and power be to our God:  
και μετα ταυτα ηκουσα φωνην οχλου πολλου μεγαλην εν τω ουρανω λεγοντος αλληλουια η σωτηρια και η δοξα και η τιμη και η δυναμις κυριω τω θεω ημων
- 2 sepse të vërteta dhe të drejta janë gjykimet e tij! Ai në fakt gjykoj laviren e madhe, që e prishi dheun me kurvërinë e saj, dhe mori hak për gjakun e shërbëtorëve të vet të derdhur prej dorës së saj".  
For true and upright are his decisions; for by him has the evil woman been judged, who made the earth unclean with the sins of her body; and he has given her punishment for the blood of his servants.  
οτι αληθιναι και δικαιαι αι κρισεις αυτου οτι εκρινεν την πορνην την μεγαλην ητις εφθειρεν την γην εν τη πορνεια αυτης και εξεδικησεν το αιμα των δουλων αυτου εκ της χειρος αυτης
- 3 Dhe thanë për të dytën herë: "Aleluja! Dhe tymi i saj ngjitet në shekuj të shekujve".  
And again they said, Praise to the Lord. And her smoke went up for ever and ever.  
και δευτερον ειρηκαν αλληλουια και ο καπνος αυτης αναβαινει εις τους αιωνας των αιωνων
- 4 Dhe ranë përmbys të njëzet e katër pleqtë, dhe të katër qeniet e gjalla, dhe adhuruan Perëndinë, që ulej mbi fron, duke thënë: "Amen, Aleluja!".  
And the four and twenty rulers and the four beasts went down on their faces and gave worship to God who was seated on the high seat, saying, Even so, praise to the Lord.  
και επεσαν οι πρεσβυτεροι οι εικοσι και τεσσαρες και τα τεσσαρα ζωα και προσεκυνησαν τω θεω τω καθημενω επι του θρονου λεγοντες αμην αλληλουια
- 5 Dhe nga fronti erdhi një zë, duke thënë: "Lëvdoni Perëndinë tonë, gjithë ju shërbëtorë të tij dhe ju që e druani, dhe të vegjlit dhe të mëdhenjtë".  
And a voice came from the high seat, saying, Give praise to our God, all you his servants, small and great, in whom is the fear of him.  
και φωνη εκ του θρονου εξηλθεν λεγουσα αινειτε τον θεον ημων παντες οι δουλοι αυτου και οι φοβουμενοι αυτον και οι μικροι και οι μεγαλοι
- 6 Dhe dëgjova një si zë i një turme të madhe, dhe si zë shumë ujërash dhe si zë bubullimash të forta, që thoshte: "Aleluja, sepse filloi të mbretërojë Zoti, Perëndia ynë, i Plotfuqishmi!.  
And there came to my ears the voice of a great army, like the sound of waters, and the sound of loud thunders, saying, Praise to the Lord: for the Lord our God, Ruler of all, is King.  
και ηκουσα ως φωνην οχλου πολλου και ως φωνην υδατων πολλων και ως φωνην βροντων ισχυρων λεγοντας αλληλουια οτι εβασιλευσεν κυριος ο θεος ο παντοκρατωρ
- 7 Le të gëzohemi dhe të ngazëllohemi dhe le t'i japim atij lavdi, sepse erdhi dasma e Qengjit dhe nusja e tij është përgatitur!  
Let us be glad with delight, and let us give glory to him: because the time is come for the Lamb to be married, and his wife has made herself ready.  
χαιρωμεν και αγαλλιωμεθα και δωμεν την δοξαν αυτω οτι ηλθεν ο γαμος του αρνιου και η γυνη αυτου ητοιμασεν εαυτην
- 8 Dhe i është dhënë të vishet me li të hollë, të pastër dhe të shkëlqyeshëm, sepse liri i hollë janë veprat e drejta të shenjtorëve".  
And to her it was given to be clothed in delicate linen, clean and shining: for the clean linen is the righteousness of the saints.  
και εδοθη αυτη ινα περιβαληται βυσσινον καθαρον και λαμπρον το γαρ βυσσινον τα δικαιωματα εστιν των αγιων
- 9 Dhe më tha: "Shkruaj: Lum ata që janë ftuar në gostinë e dasmës së Qengjit". Dhe më tha: "Këto janë fjalët e vërteta të Perëndisë".  
And he said to me, Put in the book, Happy are the guests at the bride-feast of the Lamb. And he said to me, These are the true words of God.  
και λεγει μοι γραφον μακαριοι οι εις το δειπνον του γαμου του αρνιου κεκλημενοι και λεγει μοι ουτοι οι λογοι αληθινοι εισιν του θεου
- 10 Edhe rashë përpara këmbëve të tij për ta adhruar, por ai më tha: "Ruaju se e bën, unë jam bashkëshërbëtori yt si dhe i vëllezërve të tu që kanë dëshminë e Jezusit. Perëndinë adhuroje! Sepse dëshmia e Jezusit është frymë e profecisë".  
And I went on my face before his feet to give him worship. And he said to me, See you do it not: I am a brother-servant with you and with your brothers who keep the witness of Jesus: give worship to God: for the witness of Jesus is the spirit of the prophet's word.  
και επεσον εμπροσθεν των ποδων αυτου προσκυνησαι αυτω και λεγει μοι ορα μη συνδουλος σου ειμι και των αδελφων σου των εχοντων την μαρτυριαν του ιησου τω θεω προσκυνησον η γαρ μαρτυρια του ιησου εστιν το πνευμα της προφητειας

- 11 Dhe pashë qiellin e hapur, dhe ja, një kalë i bardhë, dhe ai që e kalëronte quhet Besniku dhe i Vërteti; dhe ai gjykon dhe lufton me drejtësi.  
And the heaven was open; and I saw a white horse, and he who was seated on it was named Certain and True; and he is judging and making war in righteousness.  
και ειδον τον ουρανον ανεωγμενον και ιδου ιππος λευκος και ο καθημενος επ αυτον καλουμενος πιστος και αληθινος και εν δικαιοσυνη κρινει και πολεμει
- 12 Dhe sytë e tij ishin si flakë zjarri dhe mbi kryet e tij ishin shumë kurora; edhe kishte një emër të shkruar, që askush nuk e di përveç atij;  
And his eyes are a flame of fire, and crowns are on his head; and he has a name in writing, of which no man has knowledge but himself.  
οι δε οφθαλμοι αυτου ως φλοξ πυρος και επι την κεφαλην αυτου διαδηματα πολλα εχων ονομα γεγραμμενον ο ουδεις οιδεν ει μη αυτος
- 13 Dhe ishte i veshur me një rrobe të ngjyer në gjak; dhe emri i tij quhet: &quot;Fjala e Perëndisë&quot;.  
And he is clothed in a robe washed with blood: and his name is The Word of God.  
και περιβεβλημενος ιματιον βεβαμμενον αιματι και καλειται το ονομα αυτου ο λογος του θεου
- 14 Dhe ushtritë që janë në qiell e ndiqnin mbi kuaj të bardhë, të veshur me rroba liri të hollë, të bardhë dhe të pastër.  
And the armies which are in heaven went after him on white horses, clothed in delicate linen, white and clean.  
και τα στρατευματα εν τω ουρανω ηκολουθει αυτω εφ ιπποις λευκοις ενδεδυμενοι βυσσινον λευκον και καθαρον
- 15 Dhe nga goja e tij dilte një shpatë e mprehtë për të goditur me të kombet; dhe ai do të qeverisë me skeptër prej hekuri dhe ai vet do të shkelë vozën e verës së mërisë dhe të zemërimit të Perëndisë së plotfuqishëm.  
And out of his mouth comes a sharp sword, with which he overcomes the nations: and he has rule over them with a rod of iron: and he is crushing with his feet the grapes of the strong wrath of God the Ruler of all.  
και εκ του στοματος αυτου εκπορευεται ρομφαια οξεια ινα εν αυτη πατασση τα εθνη και αυτος ποιμανει αυτους εν ραβδω σιδηρα και αυτος πατει την ληνον του οινου του θυμου και της οργης του θεου του παντοκρατορος
- 16 Dhe mbi rroben e vet dhe mbi kofshën ishte shkruar një emër: MBRETI I MBRETËRVE dhe ZOTI I ZOTËRVE.  
And on his robe and on his leg is a name, KING OF KINGS, AND LORD OF LORDS.  
και εχει επι το ιματιον και επι τον μηρον αυτου το ονομα γεγραμμενον βασιλευς βασιλεων και κυριος κυριων
- 17 Dhe pashë një engjëll që qëndronte në këmbë në diell; dhe bërtiti me zë të madh duke u thënë gjithë shpendëve që fluturojnë në mes të qiellit: "Ejani, mblihduni në gostinë e madhe të Perëndisë,  
And I saw an angel taking his place in the sun; and he was crying with a loud voice, saying to all the birds in flight in the heavens, Come together to the great feast of God;  
και ειδον ενα αγγελον εστωτα εν τω ηλιω και εκραζεν φωνη μεγαλη λεγων πασιν τοις ορνειοις τοις πετομενοις εν μεσουρανηματι δευτε και συναγεσθε εις το δειπνον του μεγαλου θεου
- 18 që të hani mish mbretërisë, dhe mish kapitenësh, dhe mish njerëzish të fuqishëm, dhe mish kuajsh dhe kalorësish, dhe mishin e të gjithë njerëzve, të të lirëve dhe të skllëvërve, dhe të të vegjëlve dhe të të mëdhenjve".  
So that you may take for your food the flesh of kings, and of captains, and of strong men, and of horses and of those who are seated on them, and the flesh of all men, free and unfree, small and great.  
ινα φαγητε σαρκας βασιλεων και σαρκας χιλιαρχων και σαρκας ισχυρων και σαρκας ιππων και των καθημενων επ αυτων και σαρκας παντων ελευθερων και δουλων και μικρων και μεγαλων
- 19 Dhe pashë bishën, dhe mbretërit e dheut, dhe ushtritë e tyre të mbledhura që të bënin luftë kundër atij që kalëronte kalin dhe kundër ushtrisë së tij.  
And I saw the beast, and the kings of the earth, and their armies, come together to make war against him who was seated on the horse and against his army.  
και ειδον το θηριον και τους βασιλεις της γης και τα στρατευματα αυτων συνηγμενα ποιησαι πολεμον μετα του καθημενου επι του ιππου και μετα του στρατευματος αυτου
- 20 Dhe bisha u kap, dhe bashkë me të profeti i rremë që kishte bërë shenja përpara saj, me të cilat i mashtrou ata që morën damkën e bishës, dhe ata që adhuruan figurën e saj; që të dy i hodhën të gjallë në liqenin e zjarritë që digjet me squfur;  
And the beast was taken, and with him the false prophet who did the signs before him, by which they were turned from the true way who had the mark of the beast, and who gave worship to his image: these two were put living into the sea of ever-burning fire.  
και επισθη το θηριον και μετα τουτου ο ψευδοπροφητης ο ποιησας τα σημεια ενωπιον αυτου εν οις επλανησεν τους λαβοντας το χαραγμα του θηριου και τους προσκυνοντας τη εικονι αυτου ζωντας εβληθησαν οι δυο εις την λιμνην του πυρος την καιομενην εν τω θειω
- 21 dhe të tjerët u vranë me shpatë, që dilte nga goja e atij që kalëronte kalin, dhe të gjitha shpendët u ngopën me mishrat e tyre.  
And the rest were put to death with the sword of him who was on the horse, even the sword which came out of his mouth: and all the birds were made full with their flesh.  
και οι λοιποι απεκτανθησαν εν τη ρομφαια του καθημενου επι του ιππου τη εκπορευομενη εκ του στοματος αυτου και παντα τα ορνεα εχορτασθησαν εκ των σαρκων αυτων
- 1 Dhe pashë një engjëll që zbriste nga qielli, duke pasur çelësin e humnerës, dhe një zinxhir të madh në dorë.  
And I saw an angel coming down out of heaven, having the key of the great deep and a great chain in his hand.  
και ειδον αγγελον καταβαινοντα εκ του ουρανου εχοντα την κλειδα της αβυσσου και αλυσιν μεγαλην επι την χειρα αυτου

- 2 Ai e kapi dragoin, gjarpërin e lashtë, që është djalli dhe Satani, dhe e lidhi për një mijë vjet,  
And he took the dragon, the old snake, which is the Evil One and Satan, and put chains on him for a thousand years,  
και εκρατησεν τον δρακοντα τον οφιν τον αρχαιον ος εστιν διαβολος και σατανας και εδησεν αυτον χιλια ετη
- 3 dhe e hodhi atë në humnerë, dhe e mbylli atë dhe vulosi mbi të, që të mos i mashtrojë më kombet, deri sa të mbushen një mijë vjet; dhe pas këtyre ai duhet zgjidhur për pak kohë.  
And put him into the great deep, and it was shut and locked over him, so that he might put the nations in error no longer, till the thousand years were ended: after this he will be let loose for a little time.  
και εβαλεν αυτον εις την αβυσσον και εκλεισεν αυτον και εσφραγισεν επανω αυτου ινα μη πλανηση τα εθνη ετι αχρι τελεσθη τα χιλια ετη και μετα ταυτα δει αυτον λυθηναι μικρον χρονον
- 4 Dhe pashë frone, dhe ata u ulën mbi to dhe atyre iu dha pushteti që të gjykojnë edhe pashë shpirtat e atyre që u ishin prerë kokat për dëshminë e Jezusit dhe për fjalën e Perëndisë, dhe të cilët nuk e kishin adhruar bishën, dhe as figurën e saj dhe nuk kishin marrë damkë mbi ballin e tyre dhe në duart e tyre. Këta u kthyen në jetë e mbretëruan me Krishtin për një mijë vjet.  
And I saw high seats, and they were seated on them, and the right of judging was given to them: and I saw the souls of those who were put to death for the witness of Jesus, and for the word of God, and those who did not give worship to the beast, or to his image, and had not his mark on their brows or on their hands; and they were living and ruling with Christ a thousand years.  
και ειδον θρονους και εκαθισαν επ αυτους και κριμα εδοθη αυτοις και τας ψυχας των πεπελεκισμενων δια την μαρτυριαν ιησου και δια τον λογον του θεου και οιτινες ου προσεκυνησαν τω θηριω ουτ ε την εικονα αυτου και ουκ ελαβον το χαραγμα επι το μετωπον αυτων και επι την χειρα αυτων και εζησαν και εβασιλευσαν μετα χριστου τα χιλια ετη
- 5 Por të vdekurit e tjerë nuk u kthyen në jetë deri sa të mbusheshin një mijë vjet. Kjo është ringjallja e parë.  
The rest of the dead did not come to life again till the thousand years were ended. This is the first coming back from the dead.  
οι δε λοιποι των νεκρων ουκ ανεζησαν εως τελεσθη τα χιλια ετη αυτη η αναστασις η πρωτη
- 6 I lum dhe i shenjtë është ai që ka pjesë në ringjalljen e parë. Mbi ata vdekja e dytë nuk ka pushtet, por ata do të jenë priftërinj të Perëndisë dhe të Krishtit dhe do të mbretërojnë me të një mijë vjet.  
Happy and holy is he who has a part in this first coming: over these the second death has no authority, but they will be priests of God and of Christ, and will be ruling with him a thousand years.  
μακαριος και αγιος ο εχων μερος εν τη αναστασει τη πρωτη επι τούτων ο θανατος ο δευτερος ουκ εχει εξουσιαν αλλ εσονται ιερεις του θεου και του χριστου και βασιλευσουσιν μετ αυτου χιλια ετη
- 7 Dhe kur të kryhen të një mijë vjetët, Satani do të zgjidhet nga burgu i tij,  
And when the thousand years are ended, Satan will be let loose out of his prison,  
και οταν τελεσθη τα χιλια ετη λυθησεται ο σατανας εκ της φυλακης αυτου
- 8 dhe do të dalë të mashtrojë kombet që janë në të katër anët e dheut, Gogun e Magogun, që t'i mbledhë ata për luftë; numri i tyre do të jetë si rëra e detit.  
And will go out to put in error the nations which are in the four quarters of the earth, Gog and Magog, to get them together to the war, the number of whom is like the sands of the sea.  
και εξελευσεται πλανησαι τα εθνη τα εν ταις τεσσαρσιν γωνιας της γης τον γωγ και τον μαγωγ συναγαγειν αυτους εις πολεμον ων ο αριθμος ως η αμμος της θαλασσης
- 9 Dhe ata do të lëvizin në të gjithë sipërfaqen e dheut dhe do ta rrethojnë fushën e shenjtorëve dhe qytetin e dashur. Por nga qielli do të zbrësë zjarr, i dërguar nga Perëndia, dhe do t'i përprijë.  
And they went up over the face of the earth, and made a circle about the tents of the saints, and the well loved town: and fire came down out of heaven for their destruction.  
και ανεβησαν επι το πλατος της γης και εκυκλωσαν την παρεμβολην των αγιων και την πολιν την ηγαπημενην και κατεβη πυρ απο του θεου εκ του ουρανου και κατεφαγεν αυτους
- 10 Atëherë djallin që i kishte mashtruar, do ta hedhin në liqenin e zjarrit e të squfurit, ku janë bisha dhe profeti i rremë; dhe do të mundohen ditë e natë në shekuj të shekujve.  
And the Evil One who put them in error was sent down into the sea of ever-burning fire, where the beast and the false prophet are, and their punishment will go on day and night for ever and ever.  
και ο διαβολος ο πλανων αυτους εβληθη εις την λιμνην του πυρος και θειου οπου το θηριον και ο ψευδοπροφητης και βασανισθησονται ημερας και νυκτος εις τους αιωνας των αιωνων
- 11 Pastaj pashë një fron të madh të bardhë dhe atë që ulej mbi të, nga prania e të cilit iku dheu dhe qielli, dhe nuk u gjet vend për ata.  
And I saw a great white seat, and him who was seated on it, before whose face the earth and the heaven went in flight; and there was no place for them.  
και ειδον θρονον λευκον μεγαν και τον καθημενον επ αυτου ου απο προσωπου εφυγεν η γη και ο ουρανος και τοπος ουχ ευρεθη αυτοις
- 12 Dhe pashë të vdekurit, të mëdhenj e të vegjël, që rrinin në këmbë përpara Perëndisë, edhe librat u hapën; dhe u hap një libër tjetër, që është libri i jetës; dhe të vdekurit u gjykuan në bazë të gjërave të shkruara në libra, sipas veprave të tyre.  
And I saw the dead, great and small, taking their places before the high seat; and the books were open, and another book was open, which is the book of life; and the dead were judged by the things which were in the books, even by their works.  
και ειδον τους νεκρους μικρους και μεγαλους εστωτας ενωπιον του θεου και βιβλια ηνεωχθησαν και βιβλιον αλλο ηνεωχθη ο εστιν της ζωης και εκριθησαν οι νεκροι εκ των γεγραμμενων εν τοις βιβλιοις κατα τα εργα αυτων
- 13 Dhe deti i dorëzoi të vdekurit që ishin në të, dhe vdekja dhe Hadesi dorëzuan të vdekurit që ishin në ta; dhe ata u gjykuan secili sipas veprave të veta.  
And the sea gave up the dead which were in it; and death and Hell gave up the dead which were in them; and they were judged every man by his works.  
και εδοκεν η θαλασσα τους εν αυτη νεκρους και ο θανατος και ο αιδης εδοκαν τους εν αυτοις νεκρους και εκριθησαν εκαστος κατα τα εργα αυτων



- 14 Pastaj vdekja dhe Hadesi u flakën në liqenin e zjarrit. Kjo është vdekja e dytë.  
And death and Hell were put into the sea of fire. This is the second death, even the sea of fire.  
και ο θανατος και ο αδης εβληθησαν εις την λιμνην του πυρος ουτος εστιν ο δευτερος θανατος
- 15 Dhe, nëse ndokush nuk u gjet i shkruar në librin e jetës, u flak në liqenin e zjarrit.  
And if anyone's name was not in the book of life, he went down into the sea of fire.  
και ει τις ουχ ευρεθη εν τη βιβλω της ζωης γεγραμμενος εβληθη εις την λιμνην του πυρος
- 1 Dhe pashë një qiell të ri dhe një dhe të ri; sepse qielli i parë dhe dheu i parë kishin shkuar, dhe deti nuk ishte më.  
And I saw a new heaven and a new earth: for the first heaven and the first earth were gone; and there was no more sea.  
και ειδον ουρανον καινρον και γην καινην ο γαρ πρωτος ουρανος και η πρωτη γη παρηλθεν και η θαλασσα ουκ εστιν ετι
- 2 Dhe unë, Gjoni, pashë qytetin e shenjtë, Jeruzalemin e ri, që zbriste nga qielli, nga Perëndia, që ishte bërë gati si nuse e stolisur për burrin e vet.  
And I saw the holy town, new Jerusalem, coming down out of heaven from God, like a bride made beautiful for her husband.  
και εγω ιωαννης ειδον την πολιν την αγιαν ιερουσαλημ καινην καταβαινουσαν απο του θεου εκ του ουρανου ητοιμασμενην ως νυμφην κεκοσμημενην τω ανδρι αυτης
- 3 Dhe dëgjova një zë të madh nga qielli që thoshte: "Ja tabernakulli i Perëndisë me njerëzit! Dhe ai do të banojë me ta; edhe ata do të jenë populli i tij dhe vetë Perëndia do të jetë bashkë me ta, Perëndi e tyre.  
And there came to my ears a great voice out of the high seat, saying, See, the Tent of God is with men, and he will make his living-place with them, and they will be his people, and God himself will be with them, and be their God.  
και ηκουσα φωνης μεγαλης εκ του ουρανου λεγουσης ιδου η σκινη του θεου μετα των ανθρωπων και σκηνωσει μετ αυτων και αυτοι λαοι αυτου εσονται και αυτος ο θεος εσται μετ αυτων θεος αυτων
- 4 Dhe Perëndia do të thajjë çdo lot nga sytë e tyre; dhe vdekja nuk do të jetë më; as brengë, as klithma, as mundim, sepse gjërat e mëparshme shkuan".  
And he will put an end to all their weeping; and there will be no more death, or sorrow, or crying, or pain; for the first things have come to an end.  
και εξαλειψει ο θεος παν δακρυον απο των οφθαλμων αυτων και ο θανατος ουκ εσται ετι ουτε πενθος ουτε κραυγη ουτε πονος ουκ εσται ετι οτι τα πρωτα απηλθον
- 5 Dhe ai që rrinte mbi fron tha: "Ja, unë i bëj të gjitha gjërat të reja". Dhe më tha: "Shkruaj, sepse këto fjalë janë të vërteta dhe besnike".  
And he who is seated on the high seat said, See, I make all things new. And he said, Put it in the book; for these words are certain and true.  
και ειπεν ο καθημενος επι του θρονου ιδου καινα παντα ποιω και λεγει μοι γραφον οτι ουτοι οι λογοι αληθινοι και πιστοι εισιν
- 6 Edhe më tha: "U bë! Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi! Atij që ka etje unë do t'i jap si dhuratë nga burimi i ujit të jetës.  
And he said to me, It is done. I am the First and the Last, the start and the end. I will freely give of the fountain of the water of life to him who is in need.  
και ειπεν μοι γεγονεν εγω ειμι το α και το ω η αρχη και το τελος εγω τω διψωντι δωσω εκ της πηγης του υδατος της ζωης δωρεαν
- 7 Kush fiton do t'i trashëgojë të gjitha gjërat; dhe do të jem për të Perëndi dhe ai do të jetë për mua bir.  
He who overcomes will have these things for his heritage; and I will be his God, and he will be my son.  
ο νικων κληρονομησει παντα και εσομαι αυτω θεος και αυτος εσται μοι ο υιος
- 8 Kurse për frikacakët dhe të pabesët, dhe të neveritshmit dhe vrasësit, dhe kurvëruesit, dhe magjistarët, dhe idhujtarët, dhe gjithë gënjeshtarët, pjesa e tyre do të jetë në liqenin që digjet me zjarr dhe squfur, që është vdekja e dytë".  
But those who are full of fear and without faith, the unclean and takers of life, those who do the sins of the flesh, and those who make use of evil powers or who give worship to images, and all those who are false, will have their part in the sea of ever-burning fire which is the second death.  
δειλοισ δε και απιστοις και εβδελυγμενοις και φονευσιν και πορνοις και φαρμακευσιν και ειδωλολατραις και πασιν τοις ψευδεσιν το μερος αυτων εν τη λιμνη τη καιομενη πυρι και θειω ο εστιν δευτερος θανατος
- 9 Pastaj erdhi drejt meje një nga të shtatë engjëjt që kishin të shtatë kupat plot me shtatë plagët e fundit, dhe foli me mua, duke thënë: "Eja, do të të tregoj nusen, gruan e Qengjit".  
And one of the seven angels who had the seven vessels in which were the seven last punishments, came and said to me, Come here, and see the bride, the Lamb's wife.  
και ηλθεν προς με εις των επτα αγγελων των εχοντων τας επτα φιαλας τας γεμουσας των επτα πληγων των εσχατων και ελαλησεν μετ εμου λεγων δευρο δειξω σοι την νυμφην του αρνιου την γυναικα
- 10 Dhe më çoi në Frymë mbi një mal të madh dhe të lartë, dhe më tregoi qytetin e madh, Jeruzalemin e shenjtë, që zbriste nga qielli, nga Perëndia,  
And he took me away in the Spirit to a great and high mountain, and let me see the holy town Jerusalem, coming down out of heaven from God,  
και απηνεγκεν με εν πνευματι επ ορος μεγα και υψηλον και εδειξεν μοι την πολιν την μεγαλην την αγιαν ιερουσαλημ καταβαινουσαν εκ του ουρανου απο του θεου
- 11 duke pasur lavdinë e Perëndisë. Dhe shkëlqimi i saj i ngjante me një gur shumë të çmuar, si gur diaspri kristalor.  
Having the glory of God: and her light was like a stone of great price, a jasper stone, clear as glass:  
εχουσαν την δοξαν του θεου και ο φωστηρ αυτης ομοιος λιθω τιμωτατω ως λιθω ιασπιδι κρυσταλλιζοντι

- 12 Ai kishte një mur të madh dhe të lartë me dymbëdhjetë porta, dhe te portat dymbëdhjetë engjëj, dhe emra të shkruar mbi to, të cilat janë emrat e të dymbëdhjetë fiseve të bijve të Izraelit.  
She had a wall great and high, with twelve doors, and at the doors twelve angels; and names on them, which are the names of the twelve tribes of the children of Israel.  
εχουσαν τε τειχος μεγα και υψηλον εχουσαν πυλωνας δωδεκα και επι τοις πυλωσιν αγγελους δωδεκα και ονοματα επιγεγραμμενα α εστιν των δωδεκα φυλων των υιων ισραηλ.
- 13 Nga lindja ishin tri porta, nga veriu tri porta, nga jugu tri porta dhe nga perëndimi tri porta.  
And on the east were three doors; and on the north three doors; and on the south three doors; and on the west three doors.  
απ ανατολης πυλωνες τρεις απο βορρα πυλωνες τρεις απο νοτου πυλωνες τρεις απο δυσμων πυλωνες τρεις
- 14 Dhe muri i qytetit kishte dymbëdhjetë themele dhe mbi to ishin emrat e dymbëdhjetë apostujve të Qengjit.  
And the wall of the town had twelve bases, and on them the twelve names of the twelve Apostles of the Lamb.  
και το τειχος της πολεως εχον θεμελιους δωδεκα και εν αυτοις ονοματα των δωδεκα αποστολων του αρνιου
- 15 Dhe ai që fliste me mua kishte një kallam ari, për të matur qytetin, dyert e tij dhe murin e tij.  
And he who was talking with me had a gold measuring-rod to take the measure of the town, and of its doors, and its wall.  
και ο λαλων μετ εμου ειχεν καλαμον χρυσουν ινα μετρηση την πολιν και τους πυλωνας αυτης και το τειχος αυτης
- 16 Dhe qyteti kishte formë katërkëndësh, dhe gjatësia e tij është sa gjerësia; ai e mati qytetin me kallamin deri në dymbëdhjetë mijë stade; gjatësia, gjërësia dhe lartësia e tij janë të barabartë.  
And the town is square, as wide as it is long; and he took the measure of the town with the rod, one thousand and five hundred miles: it is equally long and wide and high.  
και η πολις τετραγωνος κειται και το μηκος αυτης τοσουτον εστιν οσον και το πλατος και εμετρησεν την πολιν τω καλαμω επι σταδιων δωδεκα χιλιαδων το μηκος και το πλατος και το υψος αυτης ισ α εστιν
- 17 Mati edhe murin, që ishte njëqind e dyzet e katër kubitë, me matje njeriu, domethënë engjëllit.  
And he took the measure of its wall, one hundred and forty-four cubits, after the measure of a man, that is, of an angel.  
και εμετρησεν το τειχος αυτης εκατον τεσσαρακοντα τεσσαρων πηχων μετρον ανθρωπου ο εστιν αγγελου
- 18 Muri ishte bërë ishte prej diaspri; dhe qyteti ishte prej ari të kulluar, i ngjashëm me kristal transparent.  
And the building of its wall was of jasper, and the town was clear gold, clear as glass.  
και ην η ενδομησις του τειχους αυτης ιασπις και η πολις χρυσιον καθαρον ομοια υαλω καθαρω
- 19 Themelet e murit të qytetit ishin stolisur me gjithfarë gurësh të çmuar; themeli i parë ishte prej diaspri, i dyti prej safiri, i treti prej kalcedoni, i katërti prej smeraldi,  
The bases of the wall of the town had ornaments of all sorts of beautiful stones. The first base was jasper; the second, sapphire; the third, chalcedony; the fourth, emerald;  
και οι θεμελιοι του τειχους της πολεως παντι λιθω τιμω κεκοσμημενοι ο θεμελιος ο πρωτος ιασπις ο δευτερος σαπφειρος ο τριτος χαλκηδων ο τεταρτος σμαραγδος
- 20 i pesti prej sardoniku, i gjashti prej sardi, i shtati prej krizoliti, i teti prej berili, i nënti prej topazi, i dhjeti prej krizopazi, i njëmbëdhjeti prej hiacinti, i dymbëdhjeti prej ametisti.  
The fifth, sardonyx; the sixth, sardius; the seventh, chrysolite; the eighth, beryl; the ninth, topaz; the tenth, chrysoprase; the eleventh, jacinth; the twelfth, amethyst.  
ο πεμπτος σαρδονυξ ο εκτος σαρδιος ο εβδομος χρυσολιθος ο ογδοος βηρυλλος ο ενατος τοπαζιον ο δεκατος χρυσοπρασος ο ενδεκατος υακινθος ο δωδεκατος αμεθυστος
- 21 Dhe të dymbëdhjetë portat ishin dymbëdhjetë margaritarë, secila portë ishte bërë prej një margaritari të vetëm, edhe sheshi i qytetit ishte prej ari të kulluar, si kristal i transparent.  
And the twelve doors were twelve pearls; every door was made of one pearl; and the street of the town was clear gold, as clear as glass.  
και οι δωδεκα πυλωνες δωδεκα μαργαριται ανα εις εκαστος των πυλωνων ην εξ ενος μαργαριτου και η πλατεια της πολεως χρυσιον καθαρον ως υαλος διαφανης
- 22 Dhe nuk pashë asnjë tempull në të; sepse Zoti Perëndi i plotfuqishëm dhe Qengji janë tempulli i tij.  
And I saw no Temple there; because the Lord God, the Ruler of all, and the Lamb are its Temple.  
και ναον ουκ ειδον εν αυτη ο γαρ κυριος ο θεος ο παντοκρατωρ ναος αυτης εστιν και το αρνιον
- 23 Dhe qyteti nuk ka nevojë për diell, as për hënë që të ndriçojnë në të, sepse lavdia e Perëndisë e ndriçon atë, dhe llamba e tij është Qengji.  
And the town has no need of the sun, or of the moon, to give it light: for the glory of God did make it light, and the light of it is the Lamb.  
και η πολις ου χρειαν εχει του ηλιου ουδε της σεληνης ινα φαινωσιν εν αυτη η γαρ δοξα του θεου εφωτισεν αυτην και ο λυχνος αυτης το αρνιον
- 24 Dhe kombet e të shpëtuarve do të ecin në dritën e tij; dhe mbretërit e dheut do të sjellin lavdinë dhe nderin e tyre në të.  
And the nations will go in its light: and the kings of the earth will take their glory into it.  
και τα εθνη των σωζομενων εν τω φωτι αυτης περιπατησουσιν και οι βασιλεις της γης φερουσιν την δοξαν και την τιμην αυτων εις αυτην
- 25 Dhe portat e tij nuk do të mbyllen asnjëherë gjatë ditës, sepse nuk do të ketë asnjëherë natë.  
And the doors of it will never be shut by day (for there is no night there):  
και οι πυλωνες αυτης ου μη κλεισθωσιν ημερας νυξ γαρ ουκ εσται εκει

- 26 Edhe në të do të sjellin lavdinë dhe nderin e kombeve.  
And the glory and honour of the nations will come into it:  
και οισουσιν την δοξαν και την τιμην των εθνων εις αυτην
- 27 Edhe nuk do të hyjë asgjë e papastër dhe askush që kryen neveri e gënjeshtë, por vetëm ata që janë të shkruar në librin e jetës të Qengjit.  
And nothing unclean may come into it, or anyone whose works are cursed or false; but only those whose names are in the Lamb's book of life.  
και ου μη εισελθη εις αυτην παν κοινουν και ποιουν βδελυγμα και ψευδος ει μη οι γεγραμμενοι εν τω βιβλιω της ζωης του αρνιου
- 1 Dhe më tregoi lumin e pastër të ujit të jetës, te kthjellët si kristali, që dilte nga froni i Perëndisë dhe i Qengjit.  
And I saw a river of water of life, clear as glass, coming out of the high seat of God and of the Lamb,  
και εδειξεν μοι καθαρον ποταμον υδατος ζωης λαμπρον ως κρυσταλλον εκπορευομενον εκ του θρονου του θεου και του αρνιου
- 2 Në mes të sheshit të qytetit, këtej e andej lumit, ishte druri i jetës që jep dymbëdhjetë fruta, dhe që nxjerr frutin e saj në çdo muaj; dhe gjetet e drurit janë për shërim të kombeve.  
In the middle of its street. And on this side of the river and on that was the tree of life, having twelve sorts of fruits, giving its fruit every month; and the leaves of the tree give life to the nations.  
εν μεσω της πλατειας αυτης και του ποταμου εντευθεν και εντευθεν ξυλον ζωης ποιουν καρπους δωδεκα κατα μηνια ενα εκαστον αποδιδουν τον καρπον αυτου και τα φυλλα του ξυλου εις θεραπειαν των εθνων
- 3 Dhe asnjë mallkim nuk do të ketë më; dhe në të do të jetë froni i Perëndisë dhe i Qengjit, dhe shërbëtorët e tij do t'i shërbejnë;  
And there will be no more curse: and the high seat of God and of the Lamb will be there; and his servants will be worshipping him;  
και παν καταναθεμα ουκ εσται ετι και ο θρονος του θεου και του αρνιου εν αυτη εσται και οι δουλοι αυτου λατρευουσιν αυτω
- 4 ata do të shohin fytyrën e tij; dhe emri i tij do të jetë mbi ballin e tyre.  
And they will see his face; and his name will be on their brows.  
και οψονται το προσωπον αυτου και το ονομα αυτου επι των μετωπων αυτων
- 5 Dhe atje natë nuk do të ketë; edhe nuk kanë nevojë për llambë, as për dritë dielli, sepse Zoti Perëndi i ndriçon; dhe ata do të mbretërojnë në shekuj të shekujve.  
And there will be no more night; and they have no need of a light or of the shining of the sun; for the Lord God will give them light: and they will be ruling for ever and ever.  
και νυξ ουκ εσται εκει και χρειαν ουκ εχουσιν λυχνον και φωτος ηλιου οτι κυριος ο θεος φωτιζει αυτους και βασιλευσουσιν εις τους αιωνας των αιωνων
- 6 Dhe më tha: "Këto fjalë janë besnike dhe të vërteta; dhe Zoti, Perëndi i profetëve të shenjtë, dërgoi engjëllin e tij, për t'u treguar shërbëtorëve të tij gjërat që duhet të ndodhin për së shpejti.  
And he said to me, These words are certain and true: and the Lord, the God of the spirits of the prophets, sent his angel to make clear to his servants the things which are now to come about.  
και ειπεν μοι ουτοι οι λογοι πιστοι και αληθινοι και κυριος ο θεος των αγιων προφητων απεστειλεν τον αγγελον αυτου δειξαι τοις δουλοις αυτου α δει γενεσθαι εν ταχει
- 7 Ja, unë vij shpejt; lum ai që i ruan fjalët e profecisë së këtij libri".  
See, I come quickly. A blessing on him who keeps the words of this book of the prophet.  
ιδου ερχομαι ταχυ μακαριος ο τηρων τους λογους της προφητειας του βιβλιου τουτου
- 8 Dhe unë, Gjoni, jam ai që kam parë dhe dëgjuar këto gjëra; dhe kur dëgjova dhe pashë, rashë për ta adhurar përpara këmbëve të engjëllit që m'i tregonte këto gjëra.  
And I, John, am he who saw these things and to whose ears they came. And when I had seen and given ear, I went down on my face to give worship at the feet of the angel who made these things clear to me.  
και εγω ιωαννης ο βλεπων ταυτα και ακουων και οτε ηκουσα και εβλεψα επεσα προσκνησαι εμπροσθεν των ποδων του αγγελου του δεικνυοντος μοι ταυτα
- 9 Dhe ai më tha: "Ruaju se e bën! Sepse unë jam bashkëshërbëtori yt dhe i vëllezërve të tu, profetë, dhe të atyre që i ruajnë fjalët e këtij libri. Adhuro Perëndinë!".  
And he said to me, See you do it not; I am a brother-servant with you and with your brothers the prophets, and with those who keep the words of this book: give worship to God.  
και λεγει μοι ορα μη συνδουλος σου γαρ ειμι και των αδελφων σου των προφητων και των τηρουντων τους λογους του βιβλιου τουτου τω θεω προσκνησον
- 10 Pastaj më tha: "Mos i vulos fjalët e profecisë së këtij libri, sepse koha është afër.  
And he said to me, Let not the words of this prophet's book be kept secret, because the time is near.  
και λεγει μοι μη σφραγισης τους λογους της προφητειας του βιβλιου τουτου οτι ο καιρος εγγυς εστιν
- 11 Kush është i padrejtë, le të vazhdojë të jetë i padrejtë, kush është i ndyrë le të vazhdojë të jetë i ndyrë, kush është i drejtë le të vazhdojë të praktikojë drejtësinë, dhe kush është i shenjtë le të vazhdojë të shenjtërohet.  
Let the evil man go on in his evil: and let the unclean be still unclean: and let the upright go on in his righteousness: and let the holy be holy still.  
ο αδικων αδικησατω ετι και ο ρυπων ρυπωσατω ετι και ο δικαιος δικαιοθητω ετι και ο αγιος αγιασθητω ετι

- 12 Dhe ja, unë vij shpejt, dhe shpërblimi im është me mua, për t'i dhënë gjithsecilit sipas veprave që ai ka bërë.  
See, I come quickly; and my reward is with me, to give to every man the outcome of his works.  
και ιδου ερχομαι ταχυ και ο μισθος μου μετ εμου αποδουναι εκαστω ως το εργον αυτου εσται
- 13 Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi, i pari dhe i fundit".  
I am the First and the Last, the start and the end.  
εγω ειμι το α και το ω αρχη και τελος ο πρωτος και ο εσχατος
- 14 Lum ata që i kryejnë urdhërimet e tij, që të kenë të drejtën për drurin e jetës dhe për të hyrë në portat e qytetit.  
A blessing on those whose robes are washed, so that they may have a right to the tree of life, and may go in by the doors into the town.  
μακαριοι οι ποιουντες τας εντολας αυτου ινα εσται η εξουσια αυτων επι το ξυλον της ζωης και τοις πυλωσιν εισελθωσιν εις την πολιν
- 15 Jashtë janë qentë, magjistarët, kurvarët, vrasësit, idhujtarët dhe kushdo që do dhe zbaton gënjeshtrenë.  
Outside are the dogs, and those who make use of evil powers, those who make themselves unclean, and the takers of life, and those who give worship to images, and everyone whose delight is in what is false.  
εξω δε οι κυνες και οι φαρμακοι και οι πορνοι και οι φονεις και οι ειδωλολατραι και πας ο φιλων και ποιων ψευδος
- 16 "Unë, Jezusi, dërgova engjëllin tim për t'ju dëshmuar për këto gjëra nëpër kisha. Unë jam Rrënja dhe pasardhja e Davidit, ylli i ndritshëm i mëngjesit".  
I, Jesus, have sent my angel to give witness to you of these things in the churches. I am the root and the offspring of David, the bright and morning star.  
εγω ιησους επεμψα τον αγγελον μου μαρτυρησαι υμιν ταυτα επι ταις εκκλησιας εγω ειμι η ριζα και το γενοσ του δαβιδ ο αστηρ ο λαμπρος και ορθρινος
- 17 Dhe Fryma dhe nusja thonë: "Eja!". Dhe ai që dëgjon le të thotë: "Eja!". Dhe ai që ka etje, le të vijë; dhe ai që do, le të marrë si dhuratë ujin e jetës.  
And the Spirit and the bride say, Come. And let him who gives ear, say, Come. And let him who is in need come; and let everyone desiring it take of the water of life freely.  
και το πνευμα και η νυμφη λεγουσιν ελθε και ο ακουων ειπατω ελθε και ο διψων ελθετω και ο θελων λαμβανετω το υδωρ ζωης δωρεαν
- 18 Unë i deklaroj kujt do që dëgjon fjalët e profecisë së këtij libri, se nëse ndokush do t'i shtojë këtyre gjërave, Perëndia do të dërgojë mbi të plagët e përshkruara në këtë libër.  
For I say to every man to whose ears have come the words of this prophet's book, If any man makes an addition to them, God will put on him the punishments which are in this book:  
συμμαρτυρουμαι γαρ παντι ακουοντι τουσ λογουσ της προφητειας του βιβλιου τουτου εαν τις επιτιθη προς ταυτα επιθησει ο θεος επ αυτον τας πληγασ τας γεγραμμενας εν βιβλιω τουτω
- 19 Dhe nëse dikush heq nga fjalët e librit të kësaj profecie, Perëndia do t'i heqë pjesën e tij nga libri i jetës nga qyteti i shenjtë, dhe nga gjërat që janë përshkruar në këtë libër.  
And if any man takes away from the words of this book, God will take away from him his part in the tree of life and the holy town, even the things which are in this book.  
και εαν τις αφαιρη απο των λογων βιβλιου της προφητειας ταυτης αφαιρησει ο θεος το μεροσ αυτου απο βιβλιου της ζωης και εκ της πολεωσ της αγιασ και των γεγραμμενων εν βιβλιω τουτω
- 20 Ai që dëshmon për këto gjëra, thotë: "Po, unë vij shpejt. Amen". Po, eja, Zoti Jezus.  
He who gives witness to these things says, Truly, I come quickly. Even so come, Lord Jesus.  
λεγει ο μαρτυρων ταυτα ναι ερχομαι ταχυ αμην ναι ερχου κυριε ιησου
- 21 Hiri i Zotit Jezu Krisht qoftë me ju të gjithë. Amen.  
The grace of the Lord Jesus be with the saints. So be it.  
η χαρισ του κυριου ημων ιησου χριστου μετα παντων υμων αμην